



**THE AIRE CENTRE**

Advice on Individual Rights in Europe



**CIVIL  
RIGHTS  
DEFENDERS**



# **Pavarësia dhe Paanshmëria e Gjyqësorit**

Shikim mbi jurisprudencën përkatëse të  
Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut

Shtator 2021





**THE AIRE CENTRE**  
Advice on Individual Rights in Europe



# Pavarësia dhe Paanshmëria e Gjyqësorit

Shikim mbi jurisprudencën  
përkatëse të Gjykatës Evropiane  
të të Drejtave të Njeriut

## Redaktorë

.....

**Biljana Braithwaite**, Drejtoreshë e Programit për Ballkanin Perëndimor, Qendra AIRE

**Catharina Harby**, Konsulente e Lartë Ligjore, Qendra AIRE

**Goran Miletić**, Drejtor për Evropë, Mbrojtësit e Të Drejtave Civile

## Kontribues kryesorë

.....

**Ledi Bianku**, ish-Gjyqtar i Gjykatës Evropiane të të Drejtave të

Njeriut dhe Profesor i Asociuar, Universiteti i Strasburgut

**Hannah Smith**, Avokate dhe Menaxhere Ligjore e Projektit, Qendra AIRE

Gjithashtu i jemi mirënjohës/e **Katie Scarlett-Wetherall** dhe

**William Ferris** për kontributin e tyre në këtë publikim.

© 2021 AIRE Centre

Kopje e shtypur

500

Ky version origjinal në anglisht është përkthyer gjithashtu në gjuhët boshnjake/kroate/malazeze/serbe, shqipe dhe maqedone

Dizajni nga

Kliker Dizajn

Shtypur nga

Zeppelin Pro

## Parathënie

Mbrojtja e pavarësisë dhe paanshmërisë së gjyqësorit është aspekti domosdoshëm i mbështetjes së shtetit të së drejtës. Ekzistenca e një sistemi gjyqësor të pavarur dhe të paanshëm kërkohet me qëllim që autoritetet e Shteteve të japin llogari kur veprimet e tyre vënë në rrezik ose janë në kundërshtim me parimet e shtetit të së drejtës. Siç është shprehur vetë Dhoma e Madhe e Gjykatës së Strasburgut, “nacioni i ndarjes së pushteteve mes ekzekutivit dhe gjyqësorit ka rëndësi gjithnjë e më të madhe në praktikën e saj gjyqësore”. E njëjta gjë vlen edhe për “rëndësinë e mbrojtjes së pavarësisë së gjyqësorit”.<sup>[1]</sup>

Të kuptuarit dhe zbatimi i kriterëve të së drejtës për seancë dëgjimore nga një “gjykatë e pavarur dhe e paanshme të ngritur me ligj” sipas nenit 6 të KEDNj-së janë dy aspekte thelbësore të përpjekjeve për fuqizimin e shtetit të së drejtës në tërë Ballkanin Perëndimor. Ky publikim shpjegon parimet kyçe të dala nga Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut gjatë interpretimit dhe zbatimit të së drejtës për seancë dëgjimore nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e ngritur me ligj, dhe përmban përmbledhje të disa prej çështjeve më relevante në lidhje me këtë temë.

Ruajtja e pavarësisë dhe paanshmërisë së gjyqësorit është thelbësore jo vetëm për plotësimin e kriterëve të nenit 6 të KEDNj-së, por edhe për të siguruar mbrojtjen efektive nga gjykatat të të gjitha të drejtave të tjera të Konventës. Prandaj, ky publikim gjithashtu thekson ndërveprimin mes nenit 6 dhe shumë të drejtave të tjera në Konventë.

Ndërkohë që kjo temë mund të jetë posaçërisht me rëndësi për juridiksionet e Ballkanit Perëndimor, çështja se ku duhet të qëndrojë ekuilibri i fuqive mes degëve të ndryshme të qeverisë është e rëndësishme për të gjitha vendet e Evropës. Mosmarrëveshjet e kohëve të fundit që kanë dalë para GjEDNj-së dhe GjDBE-së tregojnë se ka ndasi gjithnjë e më të mëdha brenda Shteteve në Evropë lidhur me mënyrat se si duhet të ndahet pushteti mes ekzekutivit, parlamentit dhe gjyqësorit, si dhe mënyrave se si duhet të rregullohet ekuilibri i pushteteve.

Siç bëhet e qartë në këtë publikim, si GjEDNj-ja ashtu edhe GjDBE-ja vazhdojnë të zhvillojnë qasjet e tyre ndaj pyetjeve të tilla. Praktikrat gjyqësore të kohëve të fundit shfaqin një zhvendosje të rëndësishme në trajtimin nga Gjykata e Strasburgut të çështjeve që kanë të bëjnë me pavarësinë dhe paanshmërinë. Për shembull, fokusi i

---

1 *Baka k. Hungarisë, vendimi i Dhomës së Madhe i 23 qershorit 2016, Nr. 20261/12, §88 (i përfshirë si përmbledhje në këtë publikim).*

saj i shtuar mbi nevojën që gjykatat të jenë “të ngritura me ligj” si kriter vetqëndrues. Struktura dhe analiza e këtij publikimi përfshijnë zhvillimet më të fundit në praktikën gjyqësore të të dy gjykatave evropiane në lidhje me këtë temë dhe pasqyrojnë këtë evolucion të kohëve të fundit në qasjen e GjEDNJ-së.

Kriza e Covid-19 e ka shtuar më tej rëndësinë e kësaj teme, për shkak se kufizimet e gjera të vëna ndaj të drejtave të njeriut në përpjekje për të përmbajtur pandeminë duhet të shqyrtohen nga një gjyqësor i pavarur dhe i paanshëm. Në të njëjtën kohë, pandemia ka prekur mundësinë e gjykatave për të zhvilluar seanca me persona të pranishëm dhe për të funksionuar me kapacitet normal. Nevoja për të ruajtur pavarësinë dhe paanshmërinë e gjyqësorit duhet të jetë konsideratë qendrore në marrjen e vendimeve se si të trajtohen çështjet e prapambetura në gjykata si pasojë. Më tej, diskutimet rreth mënyrave se si të ruhet më mirë pavarësia dhe paanshmëria e gjyqësorit duhet të marrin parasysh realitetin e ri të pandemisë, ku seancat dëgjimore po mbahen gjithnjë e më shumë në distancë.

Secili prej faktorëve të mësipërm e bëjnë tematikën e publikimit të këtij viti veçanërisht aktuale për të gjitha Shtetet Anëtare të KEDNJ-së. Prandaj shpresojmë që ky udhërrëfyes të jetë mjet i dobishëm për të gjithë ata/ato që kërkojnë të interpretojnë dhe të zbatojnë praktikën gjyqësore të KEDNJ-së në lidhje me pavarësinë dhe paanshmërinë e gjyqësorit, në një kohë kur ky parim duket se është gjithnjë e më i rrezikuar para gjykatave nacionale dhe Gjykatave evropiane.

Siç theksohet në këtë publikim, përgjegjësia për ruajtjen e pavarësisë dhe paanshmërisë së gjyqësorit nuk u përket vetëm gjyqtarëve dhe anëtarëve të gjykatave. E drejta për seancë dëgjimore nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e ngritur me ligj angazhon detyrime për institucione të ndryshme, dhe në fakt për shoqërinë në tërësi. Për shembull, ministrat, politikanët dhe media kanë secili rolin e tyre.

Ky publikim formon një pjesë të Projektit për Platformën e Shtetit të së Drejtës, një platformë rajonale online e dizajnuar nga Qendra AIRE dhe Mbrojtësit e të Drejtave Civile (Civil Rights Defenders) për të ofruar informacione rreth zhvillimeve në shtetin e së drejtës, e veçanërisht rreth jurisprudencës më të fundit nga GjEDNJ-ja, në gjuhën angleze dhe në gjuhët e vendeve të Ballkanit perëndimor.

Publikimi gjithashtu ofron kornizën e diskutimeve rreth temës së pavarësisë dhe paanshmërisë së gjyqësorit në Forumin e Tetë Vjetor Rajonal të Shtetit të së Drejtës për Evropën Juglindore. Që prej vitit 2014, ky Forum ka bashkuar përfaqësues të gjykatave ndërkombëtare, supreme dhe kushtetuese, kryetarë të këshillave

gjqësore, drejtorë të akademive dhe institucioneve të kualifikimit gjyqësor, agjentë të qeverive para Gjykatës së Strasburgut, përfaqësues të OJQ-ve, dhe ekspertë të njohur ligjorë për të diskutuar rreth çështjeve relevante sipas Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut për juridiksionin e Strasburgut dhe juridiksionet nacionale nga tërë Europa që marrin pjesë në Forum. Ky Forum do të transmetohet në kohë reale, duke mundësuar që pjesëmarrësit nga tërë Europa ta ndjekin dhe të marrin pjesë online.

Shpresojmë që ky publikim t'u mundësojë lexuesve që të kuptojnë më tej se çfarë ngërthen nocioni i një gjykate 'të pavarur dhe të paanshme'. Në mënyrë të veçantë, shpresojmë që ai të ofrojë udhërrëfim praktik se si mund të mbrohet sa më efektivisht ky parim jetik i pavarësisë dhe paanshmërisë.

**Goran Miletic**

Drejtor për Evropë  
Civil Rights Defenders



**Biljana Braithwaite**

Drejtoreshë e Programit për Ballkanin Perëndimor  
The AIRE Centre



## Përmbajtja

<b>Parathënie .....</b>	<b>5</b>
<b>Lista e shkurtesave .....</b>	<b>15</b>
Rreth citimeve, shënimeve në fund të faqes dhe përmbledhjeve të çështjeve .	16
Referencat mbi Nenet dhe Protokollat .....	16
<b>(1) HYRJE .....</b>	<b>17</b>
<b>(2) NENI 6 DHE E DREJTA PËRKATËSE NDËRKOMBËTARE DHE E BE-së .....</b>	<b>20</b>
a) E drejta ndërkombëtare.....	20
b) E drejta e BE-së dhe jurisprudenca e GjDBE-së.....	21
<b>(3) KUJT / CILAVE ORGANE U APLIKOHET KRITERI I PAVARËSISË DHE PAANSHMËRISË? .....</b>	<b>24</b>
a) Gjykatat .....	24
b) Ndihmësgjyqtarët, Juratët/Anëtarët e Jurisë dhe Të Tjerë që Kryejnë Funksione Gjyqësore .....	25
c) Ekzekutivi, Legjislativi dhe Autoritetet e Tjera Shtetërore .....	26
<b>(4) GJYKATA E NGRITUR ME LIGJ .....</b>	<b>27</b>
a) Testi tre-hapësh për të përcaktuar nëse një gjykatë është ngritur me ligj... ..	28
b) Diversiteti i gjyqësorit .....	31
<b>(5) PAVARËSIA.....</b>	<b>33</b>
a) Të Përkufizuarit e Pavarësisë .....	33
b) Pavarësia nga Kush? .....	34
Fuqitë e tjera të Shtetit (ekzekutivi dhe parlamenti) .....	34
Ato që kërkojnë drejtësi (palët në procedurë).....	35
Gjyqtarë të tjerë dhe anëtarë të tjerë të gjyqësorit (pavarësia e brendshme) .....	35
Shoqëria në përgjithësi.....	36



<b>c) Kriteret për të Përcaktuar nëse një Gjykatë është e Pavarur .....</b>	<b>36</b>
i) Emërimi i gjyqtarëve .....	36
Kush i emëron gjyqtarët? .....	37
Kualifikimet dhe trajnimi .....	40
ii) Mandati në detyrë .....	41
Shkarkimi .....	41
Kohëzgjatja e mandatit .....	43
iii) Garancitë kundër presioneve të jashtme .....	44
Mbrotjtet kundër sanksioneve dhe shkarkimit nga detyra .....	44
Marrëdhëniet hierarkike dhe udhëzimet dhënë gjyqtarëve .....	46
iv) Dukja e pavarësisë .....	47
Fuqia për të marrë vendime detyruese pa u modifikuar nga organet jogjyqësore .....	49
 <b>(6) PAANSHMËRIA .....</b>	 <b>51</b>
<b>a) Të Përkufizuarit e paanshmërisë .....</b>	<b>51</b>
<b>b) Paanshmëria objektive dhe subjektive .....</b>	<b>51</b>
i) Paanshmëria subjektive .....	52
ii) Paanshmëria objektive .....	52
<b>c) Paanshmëria funksionale .....</b>	<b>53</b>
i) Ushtrimi i funksioneve gjyqësore dhe jashtëgjyqësore .....	54
Gjyqtarët të cilët janë gjithashtu anëtarë të legjislativit dhe/ose të ekzekutivit .....	54
Ushtrimi i roleve si këshilluese ashtu edhe gjykuese .....	55
Gjyqtarët që veprojnë edhe si përfaqësues ligjorë .....	55
Roli i ankuesit, dëshmitarit dhe/ose prokurorit .....	56
ii) Ushtrimi i funksioneve të ndryshme gjyqësore brenda të njëjtës procedurë ose në procedura të ndërlidhura .....	58
Procedura të ndara por të ndërlidhura .....	58
Role të ndryshme gjyqësore brenda të njëjtës procedurë .....	59
<b>d) Paanshmëria personale .....</b>	<b>62</b>
i) Sjellja gjatë çështjes, përfshirë vërejtjet e bëra ose gjuha e përdorur .....	63
ii) Deklarimet publike në lidhje me një çështje .....	63
Përdorimi i mediave sociale .....	64
iii) Interesat personale në çështje / lidhjet me palët / afërsia / njohjet ose asociimi .....	65

Lidhjet mes gjyqtarëve dhe palëve .....	65
Lidhjet mes gjyqtarëve .....	66
Gjykatat speciale .....	67
Stereotipizimi .....	67

## **(7) MBROJTJA E PAVARËSISË DHE PAANSHMËRISË..... 69**

<b>a) Roli i gjyqësorit .....</b>	<b>70</b>
i) Aspekte të tjera të së drejtës për proces të rregullt sipas nenit 6 .....	70
Prezumimi i pafajësisë .....	70
Seanca brenda një afati të arsyeshëm (kur kontestimi i një gjyqtari e bën procedurën të zgjatur) .....	71
ii) Arsyetimi i vendimeve përfundimtare .....	72
iii) Publiciteti i vendimeve përfundimtare dhe arsyeve .....	74
iv) Trajnimi, detyrat dhe etika e gjyqtarëve .....	76
v) Riparimi i defekteve në apel .....	77
<b>b) Roli i institucioneve të tjera.....</b>	<b>78</b>
i) Këshillat gjyqësore, organet disiplinore dhe procedurat disiplinore .....	78
A zbatohet neni 6 në procedurat disiplinore kundër gjyqtarëve?.....	78
Zbatimi i nenit 6 në kontekstin e procedurave kundër gjyqtarëve .....	80
ii) Roli i medias.....	82
Këqyrja e gjyqësorit .....	82
Impakti i raportimeve mediale mbi paanshmërinë dhe prezumimin e pafajësisë .....	82
Kontributi drejt transparencës dhe publicitetit .....	83
iii) Roli i parlamentit dhe ekzekutivit.....	84
Zbatimi i vendimeve gjyqësore .....	85
Komentet publike dhe ndërhyrjet në çështje për të ushtruar presion .....	86

## **(8) MARRËDHËNIA MES PAVARËSISË DHE PAANSHMËRISË DHE NENEVE TË TJERA TË KONVENTËS..... 88**

<b>a) Mbrojtjet procedurale .....</b>	<b>88</b>
i) Neni 2 – E drejta e jetës .....	88
ii) Neni 3 – Mbrojtja kundër torturës dhe keqtrajtimit .....	90
iii) Neni 4 – Ndalimi i skllavërisë dhe punës së detyruar .....	91
iv) Neni 5 – E drejta për liri dhe siguri .....	92
v) Neni 8 – E drejta e jetës private dhe familjare.....	94
vi) Neni 10 – Liria e shprehjes .....	95

vii) Neni 13 – E drejta për zgjidhje efektive .....	96
viii) Neni 1 i Protokollit Nr. 1.....	97
ix) Neni 3 i Protokollit Nr. 1 .....	98
<b>b) Të drejtat e gjyqtarëve .....</b>	<b>99</b>
i) Neni 5 – E drejta e lirisë dhe sigurisë .....	100
ii) Neni 8 – E drejta e jetës private dhe familjare .....	101
Shkarkimi për shkak të aktiviteteve në jetën private të një gjyqtari.....	101
Impakti i shkarkimit në jetën private të një gjyqtari .....	102
iii) Neni 9 – Liria e fesë .....	103
iv) Neni 10 – Liria e shprehjes.....	104
Shprehja publike e pikëpamjeve nga një gjyqtar .....	104
Detyra e gjyqtarëve për përmbajtje në lidhje me	
komentet publike rreth çështjeve të tyre.....	106
Detyra e gjyqtarëve për përmbajtje nga komentet e	
tyre në lidhje me njerëz të tjerë, kolegë dhe gjyqtarë të tjerë .....	106
Rëndësia e pjesëmarrjes së gjyqtarëve në debate	
publike rreth çështjeve që kanë të bëjnë me gjyqësorin	
dhe administrimin e drejtësisë .....	109
Kritikat ndaj gjyqtarëve prej personave	
që nuk janë pjesë e gjyqësorit .....	110
Kritikat nga avokatët .....	111
v) Neni 11 – Liria e tubimit dhe organizimit.....	111
 <b>(9) PËRFUNDIM .....</b>	<b>113</b>
 <b>Përmbledhje të Çështjeve .....</b>	<b>114</b>
 <b>(1) E Drejta për Gjykatë të Ngritur me Ligj .....</b>	<b>114</b>
GUÐMUNDUR ANDRI ÁSTRÁÐSSON k. ISLANDËS .....	114
XERO FLOR W POLSCE SP. Z O.O. k. POLONISË .....	122
 <b>(2) Pavarësia – nga Degët e tjera të Qeverisë (përfshirë</b>	
<b>Përgjegjësinë e Degëve të tjera të Qeverisë për të mbështetur</b>	
<b>Pavarësinë dhe Paanshmërinë) .....</b>	<b>127</b>
KINSKÝ k. REPUBLIKËS ÇEKE .....	127
McGONNELL k. MBRETËRISË SË BASHKUAR .....	132
SHARRXHI DHE TË TJERË k. SHQIPËRISË .....	135
E RAFINERIVE GREKE STRAN DHE STRATIS ANDREADIS k. GREQISË.....	139
VAN DE HURK k. HOLANDËS .....	143
ZIELINKSKI DHE PRADAL DHE GONZALEZ DHE TË TJERË k. FRANCËS .....	147

<b>(3) Pavarësia – nga Palët në Procedura dhe nga Gjyqtarët e tjerë ose Anëtarët e tjerë të Gjyqësorit.....</b>	<b>151</b>
AGROKOMPLEKS k. UKRAINËS .....	151
BORGERS k. BELGJIKËS .....	155
CAMPBELL DHE FELL k. MBRETËRISË SË BASHKUAR.....	158
COOPER k. MBRETËRISË SË BASHKUAR DHE	
GRIEVES k. MBRETËRISË SË BASHKUAR .....	163
FINDLAY k. MBRETËRISË SË BASHKUAR.....	168
ÖCALAN k. TURQISË.....	172
SRAMEK k. AUSTRISË .....	178
STAFFORD k. MBRETËRISË SË BASHKUAR.....	181
<b>(4) Pavarësia – Emërimi i Gjyqtarëve .....</b>	<b>184</b>
LANGBORGER k. SUEDISË .....	184
THIAM k. FRANCËS .....	188
<b>(5) Pavarësia – Garancitë kundër Presioneve të Jashtme .....</b>	<b>192</b>
CRAXI k. ITALISË.....	192
DENISOV k. UKRAINËS .....	197
HENRYK URBAN DHE RYSZARD URBAN k. POLONISË .....	202
MAKTOUF DHE DAMJANOVIĆ k. BOSNJE DHE HERCEGOVINËS.....	205
MATYJEK k. POLONISË .....	209
OLEKSANDR VOLKOV k. UKRAINËS .....	212
RAMOS NUNES DE CARVALHO E SÁ k. PORTUGALISË.....	218
TSANOVA-GEÇEVA k. BULLGARISË.....	223
<b>(6) Dukja e Pavarësisë.....</b>	<b>227</b>
BELIOS k. ZVICRËS .....	227
<b>(7) Paanshmëria – Paanshmëria Objektive dhe Subjektive.....</b>	<b>230</b>
HARABIN k. SLLOVAKISË.....	230
MICALLEF k. MALTËS .....	234
<b>(8) Paanshmëria – Paanshmëria Personale .....</b>	<b>237</b>
CHIM DHE PRZYWIECZERSKI k. POLONISË .....	237
LAVENTS k. LETONISË .....	241
MITROV k. ISH-REPUBLIKËS JUGOSLLAVE TË MAQEDONISË.....	246
OLUJIĆ k. KROACISË .....	250

<b>(9) Paanshmëria – Paanshmëria Funktionale .....</b>	<b>254</b>
DE CUBBER k. BELGJIKËS .....	254
GEROVSKA POPČEVSKA, JAKŠOVSKI DHE TRIFUNOVSKI, dhe POPOSKI DHE DUMA k. ISH-REPUBLIKËS JUGOSLLAVE TË MAQEDONISË .....	257
KLEYN DHE TË TJERË k. HOLANDËS .....	261
MITRINOVSKI k. ISH-REPUBLIKËS JUGOSLLAVE TË MAQEDONISË.....	264
OBERSCHLICK k. AUSTRIËS .....	267
REMLI k. FRANCËS .....	271
WETTSTEIN k. ZVICRËS .....	274
<b>(10) Marrëdhënia mes Pavarësisë dhe Paanshmërisë, dhe aspekteve të tjera të nenit 6 dhe të drejtave të tjera të Konventës.....</b>	<b>277</b>
BAKA k. HUNGARISË.....	277
GUTSANNOVI k. BULLGARISË .....	283
MAESTRI k. ITALISË .....	288
MORICE k. FRANCËS .....	291
MUSTAFA TUNÇ DHE FECIRE TUNÇ k. TURQISË.....	297
PITKEVICH k. RUSISË.....	301
<b>(11) Përmbledhje të Gjykatës së Drejtësisë së Bashkimit Evropian .....</b>	<b>305</b>
Hyrje në Gjykatën e Drejtësisë së Bashkimit Evropian .....	305
VENDIMI I GJYKATËS SË DREJTËSISË SË BASHKIMIT EVROPIAN NË ÇËSHTJEN LM .....	308
VENDIMI I GJYKATËS SË DREJTËSISË SË BASHKIMIT EVROPIAN NË ÇËSHTJEN KOMISIONI EVROPIAN k. REPUBLIKËS SË POLONISË.....	312
URDHRI I GJYKATËS SË DREJTËSISË SË BASHKIMIT EVROPIAN NË ÇËSHTJEN KOMISIONI k. POLONISË .....	317
VENDIMI I GJYKATËS SË DREJTËSISË SË BASHKIMIT EVROPIAN NË ÇËSHTJEN A.K. k. KRAJOWA RADA SĄDOWNICTWA; DHE CP DHE DO k. SĄD NAJWYŻSZY .....	322
URDHRI I GJYKATËS SË DREJTËSISË SË BASHKIMIT EVROPIAN NË ÇËSHTJEN KOMISIONI k. POLONISË .....	328
VENDIMI I GJYKATËS SË DREJTËSISË TË BASHKIMIT EVROPIAN NË ÇËSHTJEN AZ.....	332
VENDIMI I GJYKATËS SË DREJTËSISË SË BASHKIMIT EVROPIAN NË ÇËSHTJET E BASHKUARA TË ASOCIAËIA ‘FORUMUL JUDECĂTORILOR DIN ROMÂNIA’ V INSPECËIA JUDICIARĂ DHE PESË TË TJERËVE.....	337



## Lista e shkurtesave

Tabela e mëposhtme përshkruan domethënien e shkurtimeve dhe shkurtesave të ndryshme të përdorura në këtë Udhërrëfyes.

Abbreviation	Definition
<b>KKGJE</b>	Këshilli Konsultativ i Gjyqtarëve Evropianë, organ këshillimor i KE-së në lidhje me çështje të pavarësisë, paanshmërisë dhe kompetencës së gjyqtarëve
<b>GJDBE</b>	Gjykata e Drejtësisë e Bashkimit Evropian
<b>KE</b>	Këshilli i Evropës
<b>Plani i Veprimit i KE-së</b>	Plani i Veprimit i Bashkimit Evropian për Fuqizimin e Pavarësisë dhe Paanshmërisë Gjyqësore CM(2016)36
<b>Konventa / KEDNJ</b>	Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut
<b>Shtet Anëtar / Shteti</b>	Shteti(et) Kontraktuese i(të) Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut
<b>Gjykata / GjEDNJ</b>	Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut
<b>Karta Evropiane mbi Statusin e Gjyqtarëve</b>	Karta Evropiane mbi Statusin e Gjyqtarëve e miratuar nga pjesëmarrës të vendeve evropiane dhe dy shoqata ndërkombëtare të gjyqtarëve në takimin e mbajtur në Strasburg më 8-10 korrik 1998, mbështetur nga takimi i Kryetarëve të Gjykatave Supreme të vendeve të Evropës Qendrore dhe Lindore i mbajtur në Kiev më 12-14 tetor 1998 dhe përsëri në takimin e gjyqtarëve dhe përfaqësuesve të Ministrive të Drejtësisë nga 25 vende evropiane në Lisbonë më 8-10 prill 1999.
<b>Magna Carta e Gjyqtarëve</b>	Magna Carta e Gjyqtarëve (Parimet Themelore), e miratuar nga KKGJE-ja në mbledhjen e saj të 11-të plenare (Strasburg, 17-19 nëntor 2010), e cila përmbledh dhe kodifikon përfundimet kryesore të Opinioneve që ajo ka miratuar.
<b>Parimet Bazë të OKB-së</b>	Parimet Bazë të Kombeve të Bashkuara mbi Pavarësinë e Gjyqësorit, të miratuara në Kongresin e Shtatë të Kombeve të Bashkuara për Parandalimin e Krimit dhe Trajtimin e Kryesve të Veprave të mbajtur në Milano prej 26 gusht deri më 6 shtator 1985 dhe të mbështetura nga rezolutat e Asamblesë së Përgjithshme 40/32 të 29 nëntorit 1985 dhe 40/146 të 13 dhjetorit 1985.

Abbreviation	Definition
<b>Komisioni i Venedikut</b>	Komisioni Evropian për Demokraci përmes Ligjit, organ këshillimor i KE-së, i përbërë nga ekspertë të pavarur në fushën e të drejtës kushtetuese.
<b>Raporti i Komisionit të Venedikut mbi Pavarësinë e Sistemit Gjyqësor Pjesa I</b>	Raporti i Komisionit të Venedikut mbi Pavarësinë e Sistemit Gjyqësor Pjesa I: Pavarësia e Gjyqtarëve, miratuar nga Komisioni i Venedikut në Sesionin e 82-të Plenar (Venedik, 12-13 mars 2010), CDL-AD(2010)004.

### **Rreth citimeve, shënimeve në fund të faqes dhe përmbledhjeve të çështjeve**

Për çështjet e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, referencat përmbajnë emrin me shkronja të pjerrëta, datën e vendimit ose vendimit përfundimtar, dhe numrin e kërkesës. Gjithashtu, shënohet se cilat çështje që përmenden në tekst janë përfshirë si përmbledhje në Pjesën 2 të këtij Udhërrëfyese.

### **Referencat mbi Nenet dhe Protokollet**

Të gjitha referencat ndaj neneve dhe Protokolleve bëjnë fjalë për nenet dhe Protokollet e KEDNj-së, nëse nuk shënohet ndryshe.



## (1) HYRJE

E drejta për qasje në gjykatë sipas nenit 6 të KEDNj-së konsiderohet nga GjEDNj-ja si një prej elementeve konceptuale themelore të nocionit të shtetit të së drejtës dhe si gurthemeli i shoqërive demokratike evropiane. Ky Udhërrëfyes fokusohet në analizën e të ashtuquajturave kritere institucionale të nenit 6 § 1, të cilat kanë të bëjnë me “gjykatën e pavarur dhe të paanshme të krijuar me ligj”.

Kriteret procedurale të nenit 6 § 1 ndodhen jashtë fushëveprimit të analizës kryesore të Udhërrëfyesit. Megjithatë, Udhërrëfyesi merr në konsideratë elemente të tjera të nenit 6, përfshirë të drejtën për seancë të drejtë dhe publike brenda një kohe të arsyeshme sipas nenit 6 § 1 dhe të drejtën e prezumimit të pafajësisë sipas nenit 6 § 2, për sa kohë që pajtueshmëria me këto elemente të nenit 6 shërben për të mbrojtur dhe fuqizuar pavarësinë dhe paanshmërinë e gjyqësorit.<sup>[2]</sup>

Nocioni i ndarjes së pushteteve mes ekzekutivit dhe gjyqësorit, dhe rëndësia e mbrojtjes së pavarësisë së gjyqësorit, kanë marrë rëndësi gjithnjë e më të madhe në praktikën gjyqësore të Gjykatës. Ruajtja e besimit publik tek gjyqësori dhe mbrojtja e pavarësisë së tij nga pushtetet e tjera të qeverisë është aspekt thelbësor i mbështetjes së parimeve themelore të shtetit të së drejtës dhe ndarjes së pushteteve. Në fakt, kryetari aktual i GjEDNj-së ka deklaruar se:

*“Pa gjykata të pavarura si pjesë e një strukture demokratike që mbron dhe ruan të drejtat themelore, parimi i shtetit të së drejtës është një enë e zbrazët. Pa gjyqtarë të pavarur, sistemi i Konventës nuk mund të funksionojë.”<sup>[3]</sup>*

Neni 6 § 1 i KEDNj-së parashikon që:

*“Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, e cila vendos si për mosmarrëveshje në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile, ashtu edhe për bazueshmërinë e çdo akuze penale në ngarkim të tij.”*

---

2 Shih seksionin e këtij Udhërrëfyesi: ‘Mbrojtja e pavarësisë dhe paanshmërisë’.

3 Robert Spano, ‘Shteti i së drejtës si ylli orientues i Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut: Gjykata e Strasburgut dhe pavarësia e gjyqësorit’, Eur Law J. 2021;1-17. Shih në mënyrë të veçantë faqen 8: <https://doi.org/10.1111/eulj.12377>.

Qysh prej çështjeve të saj të hershme, Gjykata ka konsideruar se garancitë e ofruara nga nenit 6 duhet të interpretohen si një tërësi. Gjatë shqyrtimit nëse ka pasur shkelje të së drejtës për proces të drejtë Gjykata ka vlerësuar garancitë e ndryshme sipas nenit 6 së bashku, duke marrë parasysh “drejtësinë e tërësishme” të procedurës. Kjo vlen sidomos sa i përket kritereve institucionale të cilat janë fokusi i këtij Udhërrëfyese, e drejta për seancë dëgjimore nga një “gjykatë e pavarur dhe e paanshme e ngritur me ligj” që parashikohet nga fjalia e parë e nenit 6 § 1.

Në praktikën e saj të gjatë Gjykata ka zhvilluar katër kritere kyçe në lidhje me ato kritere institucionale, të cilat ajo i ka përdorur për të përcaktuar nëse një gjykatë mund të konsiderohet se është “e pavarur”: (i) mënyra e emërimit të anëtarëve të saj; (ii) kohëzgjatja e mandatit të tyre; (iii) ekzistenca e garancive kundër presioneve të jashtme; dhe (iv) nëse organi paraqet dukjen e pavarësisë.

Tradicionalisht, Gjykata e ka vlerësuar pajtueshmërinë me këto kritere me radhë, duke marrë parasysh secilin prej katër kritereve. Fakti nëse mangësitë në njërin prej katër kritereve mjaftonte për të dëmtuar një “gjykatë të pavarur dhe të paanshme të ngritur me ligj” shpesh varej nga shkalla deri ku këto mangësi kundërshtoheshin nga ekzistenca e mbrojtjeve në lidhje me kriteret e tjera. Për shembull, kohëzgjatja e mandatit të detyrës gjyqësore pranueshëm mund të ishte më e shkurtër në disa raste, në qoftë se sistemi i emërimit vlerësohej si i drejtë.

Megjithatë, në praktikën e saj të kohëve të fundit, Gjykata ka trajtuar kriterin që një gjykatë duhet të jetë “e ngritur me ligj” si element i vetëm dhe i pavarur i testit të pajtueshmërisë me nenin 6. Ajo ka gjetur se, në rrethana të caktuara, gjetja që një gjykatë nuk është ngritur sipas ligjit mund të jetë e mjaftueshme për të përbërë shkelje të nenit 6, pa kërkuar shqyrtimin e elementeve të tjera të pavarësisë dhe paanshmërisë sipas nenit 6 § 1.<sup>[4]</sup>

Struktura e këtij Udhërrëfyese mëton të pasqyrojë këtë ndryshim të rëndësishëm në qasjen e Gjykatës. Udhërrëfyese së pari përkufizon se për cilat organe dhe institucione zbatohen kriteret e “ngritjes me ligj”, “pavarësisë” dhe “pavarësisë”. Më pas ai analizon secilin prej këtyre tre kritereve institucionale nën dritën e praktikës gjyqësore të GjEDNJ-së dhe, aty ku duhet, praktikën gjyqësore të GjDBE-së.

Struktura e këtij Udhërrëfyese gjithashtu mëton të pasqyrojë faktin se “pavarësia” dhe “paanshmëria” përfaqësojnë dy koncepte të dallueshme të cilat, edhe pse

4 *Guðmundur Andri Ástráðsson k. Islandës*, vendimi i Dhomës së Madhe i 1 dhjetorit 2020, nr. 26374/18 (përfshirë si përmbledhje në publikim).

shpesh merren së bashku nga Gjykata, në fakt u përkasin kritereve të ndryshme. Andaj konceptet e pavarësisë dhe paanshmërisë analizohen në dy kapituj të ndarë të Udhërrëfyesit, me qëllim që të ofrojnë shqyrtim të mjaftueshëm për shqetësimet e ndryshme që mund të ngrihen sipas këtyre dy kritereve.<sup>[5]</sup>

Më tej, Udhërrëfyesi analizon mënyrat se si duhet të mbrohen pavarësia dhe paanshmëria, si dhe institucionet dhe organizatat që janë përgjegjëse për këtë. Në fund, Udhërrëfyesi diskuton mënyrat se si mund të ndërveprojnë të drejtat e tjera të Konventës me pavarësinë dhe paanshmërinë.

Përveç praktikës gjyqësore relevante të GjEDNJ-së dhe GjDBE-së, ky Udhërrëfyes mbështetet në instrumentet që përdoren për pavarësi dhe paanshmëri në gjyqësor të cilat janë zhvilluar nga KE-ja, përfshirë ato nëpërmjet Komisionit të Venedikut dhe Opinioneve të KKGJË (Këshilli Konsultativ i Gjyqtarëve Evropianë). KKGJË, i cili është organ këshillimor i KE-së për çështje të pavarësisë, paanshmërisë dhe kompetencave të gjyqtarëve, përbëhet ekskluzivisht nga gjyqtarë, dhe në këtë aspekt është unik në Evropë, e në fakt në botë.<sup>[6]</sup> Prandaj, Opinioneve të KKGJË-së ofrojnë një kornizë të dobishme brenda së cilës mund të shqyrtohen karakteristikat e një sistemi gjyqësor, si dhe mbrojtjet që duhet të ekzistojnë për të plotësuar kriteret e KEDNJ-së.

Gjykata në vendimet e saj shpesh i referohet parimeve të vendosura me anë të këtyre instrumenteve. Disa shembuj që vlejné të përmenden, të cilat referohen në këtë Udhërrëfyes, përfshijnë:

- » Opinioni N° 1 (2001) i KKGJË-së për Standardet Lidhur me Pavarësinë e Gjyqësorit dhe Mos-Shkarkimin e Gjyqtarëve
- » Opinioni N° 3 (2002) i KKGJË-së për etikën dhe përgjegjshmërinë e gjyqtarëve
- » Rekomandimi CM/Rec (2010)12 i Komitetit të Ministrave të KE-së për Gjyqtarët: pavarësia, efikasiteti dhe përgjegjësitë
- » Plani i Veprimit i KE-së për fuqizimin e pavarësisë dhe paanshmërisë gjyqësore, CM(2016)36
- » Magna Carta e Gjyqtarëve
- » Raporti i Komisionit të Venedikut për Pavarësinë e Sistemit Gjyqësor
- » Karta Evropiane mbi Statutin për Gjyqtarët.

---

5 Për shembull, tek *Demicoli k. Maltës*, vendimi i 27 gushtit 1991, nr. 13057/87, një çështje lidhur me shkeljen e procedurave të privilegjeve para Dhomës së Përfaqësuesve të Maltës, Komisioni gjeti mungesë të pavarësisë, ndërsa Gjykata gjeti mungesë të paanshmërisë.

6 Shih <https://www.coe.int/en/web/ccje> "Rreth Këshillit Konsultativ të Gjyqtarëve Evropianë (KKGJË)", Këshilli i Evropës.

## (2) NENI 6 DHE E DREJTA PËRKATËSE NDËRKOMBËTARE DHE E BE-së

### a) E drejta ndërkombëtare

Përveç KEDNJ-së dhe praktikës gjyqësore të Gjykatës, ka një sërë instrumentesh ndërkombëtare të cilat po ashtu mund të shërbejnë për të përcaktuar saktësisht se çfarë kërkon “gjykata e pavarur dhe e paanshme e ngritur me ligj” nga Shtetet në praktikë, si dhe për të përcaktuar nëse kjo e drejtë është shkelur.

Konventa nuk mund të konsiderohet si e tillë që ekziston në vakuum, dhe duhet të interpretohet në kuadër të parimeve të përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare.<sup>[7]</sup> Ky parim interpretimi është vazhdim i asaj që përcaktohet në nenin 53:

*“Asnjë nga dispozitat e kësaj Konvente nuk duhet të interpretohet sikur kufizon ose cenon të drejtat e njeriut dhe liritë themelore që mund të sigurohen nga legjislacioni i çdo Pale të Lartë Kontraktuese ose nga çdo marrëveshje tjetër në të cilën kjo Palë e Lartë Kontraktuese është palë.”*

Për shembull, GjEDNJ-ja ka marrë parasysh këto tekste ndërkombëtare dhe parime të pavarësisë së gjyqësorit gjatë shqyrtimit të shkeljeve të pretenduara të nenit 6.<sup>[8]</sup>

- » Parimet bazë të OKB-së
- » Komentin e Përgjithshëm të UNHRC-së nr. 32 për Nenin 14 të Paktit Ndërkombëtar lidhur me të Drejtat Civile dhe Politike (e drejta për barazi para gjykatave dhe tribunaleve dhe për proces të drejtë) publikuar më 23 gusht 2007
- » Kartën Universale të Gjyqtarit, miratuar nga Shoqata Ndërkombëtare e Gjyqtarëve më 17 nëntor 1999
- » Parimet e Bangalores për Sjelljen Gjyqësore (Draft-Kodi i Bangalores për Sjelljen Gjyqësore i vitit 2001 i miratuar nga Grupi Gjyqësor për Fuqizimin e Integritetit Gjyqësor, i rishikuar në Takimin e Tryezës së Rrumbullakët të Kryetarëve të Gjykatave i mbajtur në Hagë në nëntor 2002).

Prandaj, parimet e diskutuar në këtë Udhërrëfyes iu përmbahen këtyre standardeve ndërkombëtare.

7 *Hassan k. Mbretërisë së Bashkuar*, vendimi i Dhomës së Madhe i 16 shtatorit 2014, nr. 29750/09, § 77.

8 *Baka k. Hungarisë*, vendimi i Dhomës së Madhe i 23 qershorit 2016, nr. 20261/12, §§ 57-60 (përfshirë si përmbledhje në publikim).

## b) E drejta e BE-së dhe jurisprudenca e GjDBE-së

Ndërkohë që GjDBE dhe GjEDNj janë sisteme të pavarura gjyqësore,<sup>[9]</sup> informalisht dy gjykatat kanë të përbashkët një gamë të gjerë vlerash dhe parimesh. Në disa rrethana dy gjykatat mbështeten tek arsyetimet dhe interpretimet e njëra-tjetrës në lidhje me të drejta të caktuara themelore që kanë të përbashkëta. Për shembull, GjDBE-ja e ka integruar formalisht jurisprudencën e GjEDNj-së brenda një pjese të parimeve të përgjithshme të së drejtës së BE-së.<sup>[10]</sup>

Neni 47 (e drejta për zgjidhje efektive dhe proces të drejtë) i Kartës Evropiane për të Drejtat Themelore parashikon që:

*“Çdo person ka të drejtën për seancë të drejtë publike brenda një kohe të arsyeshme prej një gjykate të pavarur dhe të paanshme të ngritur me ligj. Çdo person duhet të ketë mundësinë për të marrë këshillim, mbrojtje dhe përfaqësim”.*

Së fundi, GjDBE ka konfirmuar lidhjen e fortë mes nocionit të shtetit të së drejtës, si vlerë e shoqërive evropiane, dhe të drejtës për qasje në gjykatë të pavarur dhe të paanshme.<sup>[11]</sup> Në interpretimin e kriterëve të paragrafit të dytë të Nenit 47 të Kartës së BE-së, GjDBE synon të ruajë një nivel mbrojtjeje i cili nuk bie nën nivelin e mbrojtjes të përcaktuar sipas nenit 6 të KEDNj-së, siç interpretohet nga GjEDNj-ja.<sup>[12]</sup> Kështu, interpretimi i Nenit 47 të Kartës është i bazuar në praktikën gjyqësore të GjEDNj-së të bazuar në nenin 6 § 1 të Konventës.<sup>[13]</sup>

Nga ana e saj, GjEDNj është mbështetur shprehimisht tek vendimet e GjDBE-së gjatë zhvillimit të praktikës së saj gjyqësore të bazuar në nenin 6 të KEDNj-së,<sup>[14]</sup> duke

9 Autoriteti i GjDBE-së vjen prej sistemit ligjor të Bashkimit Evropian dhe vendos mbi zbatimin dhe interpretimin e të drejtës së BE-së, ndërkohë që autoriteti i GjEDNj-së vjen prej sistemit ligjor të KE-së dhe vendos mbi zbatimin dhe interpretimin e KEDNj-së.

10 A.K. k. *Krajowa Rada Sądowictwa dhe CP dhe DO k. Sąd najwyższy*, vendimi i 19 nëntorit 2019, nr. C-585/18, C-624/18 dhe C-625/18 (përfshirë si përmbledhje në publikim).

11 *Komisioni k. Polonisë*, vendimi i Dhomës së Madhe i 24 qershorit 2019, nr. C-619/18.

12 *Erik Simpson dhe HG k. Këshillit të Bashkimit Evropian dhe Komisionit Evropian*, vendimi i Dhomës së Madhe i 26 marsit 2020, nr. C-542/18 RX-II dhe C-543/18 RX-II, § 72.

13 A.K. k. *Krajowa Rada Sądowictwa dhe CP dhe DO k. Sąd najwyższy*, vendimi i 19 nëntorit 2019, nr. C-585/18, C-624/18 dhe C-625/18 (përfshirë si përmbledhje në publikim).

14 Për shembull, *Guðmundur Andri Ástráðsson k. Islandës*, vendimi i Dhomës së Madhe i 1 dhjetorit 2020, nr. 26374/18, § 239 (përfshirë si përmbledhje në publikim).

manifestuar atë që mund të quhet *marrëdhënie simbiotike* mes dy gjykatave në këtë fushë të së drejtës.<sup>[15]</sup> Hyrja e këtij Udhërrëfyese diskuton ndryshimin e kohëve të fundit të Gjykatës në qasjen ndaj mënyrës se si ajo analizon pyetjen nëse një gjykatë mund të konsiderohet se është “e pavarur”.<sup>[16]</sup> Me këtë qasje të re, GjEDNj i referohet gjerësisht praktikës gjyqësore të GjDBE-së, për shembull kur citon një vendim të GjDBE-së i cili pranoi se e drejta për “gjykatë të ngritur me ligj” përfshin procesin e emërimit të gjyqtarëve.<sup>[17]</sup>

Opinionin i përbashkët (pjesërisht pajtues, pjesërisht mospajtues) në këtë çështje argumentoi, nga ana tjetër, se vendimet e GjDBE-së të cituara nga shumica jo domosdoshmërisht e mbështesnin logjikën e qëndrimit të shumicës, pra ekzistencën e një të drejte të mëvetësishme për “gjykatë të ngritur me ligj” të shkëputur prej një vlerësimi konkret të pavarësisë dhe paanshmërisë, dhe pasojat automatike që rrjedhin nga parregullsitë në procedurën e emërimeve gjyqësore.<sup>[18]</sup>

Ndërkohë që për interpretimin e saktë të praktikës gjyqësore të GjDBE-së nuk u ra dakord njëzëri, ajo që është e qartë nga ky vendim është se të kuptuarit e praktikës gjyqësore relevante të GjDBE-së në lidhje me të drejtën e një seance dëgjimore nga një “gjykatë e pavarur dhe e paanshme e ngritur me ligj” po bëhet gjithnjë e më i rëndësishëm kur bëhet fjalë për kriteret e nenit 6 të KEDNj-së.

Gjykata po ashtu merr parasysh vërejtjet dhe raportet e Komisionit Evropian (“Komisioni”) në lidhje me qëndrueshmërinë e pavarësisë së gjyqësorit në Shtetet Anëtare, cilësinë e rregullave të tyre nacionale për garantimin e pavarësisë dhe paanshmërisë, dhe çdo problem apo shqetësim në lidhje me pavarësinë dhe paanshmërinë që ngrihet nga Komisioni.<sup>[19]</sup>

15 Robert Spano, ‘Shteti i së drejtës si ylli orientues i Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut: Gjykata e Strasburgut dhe pavarësia e gjyqësorit’, E Drejta Evropiane (Eur Law) J. 2021:1–17, seksioni 4.4: Marrëdhënia simbiotike mes Strasburgut dhe Luksemburgut në lidhje me pavarësinë gjyqësore.

16 Shih diskutimin e *Guðmundur Andri Ástráðsson k. Islandës*, vendimi i Dhomës së Madhe i 1 dhjetorit 2020, nr. 26374/18 (përfshirë si përmbledhje në publikim) në seksionin e këtij Udhërrëfyese: ‘Hyrje’.

17 *Guðmundur Andri Ástráðsson k. Islandës*, vendimi i Dhomës së Madhe i 1 dhjetorit 2020, nr. 26374/18, § 228 (përfshirë si përmbledhje në publikim).

18 *Guðmundur Andri Ástráðsson k. Islandës*, vendimi i Dhomës së Madhe i 1 dhjetorit 2020, nr. 26374/18, §§ 37-40 (përfshirë si përmbledhje në publikim).

19 *Guðmundur Andri Ástráðsson k. Islandës*, vendimi i Dhomës së Madhe i 1 dhjetorit 2020, nr. 26374/18, §130 (përfshirë si përmbledhje në publikim), ku Gjykata mori parasysh Raportin e Progresit të vitit 2011 për Islandën nga Komisioni Evropian.

Prandaj, përmbajtja e këtij Udhërrëfyesi mbështetet mbi parimet dhe praktikën gjyqësore të GjDBE-së në lidhje me kriteret e pavarësisë dhe paanshmërisë, përfshirë interpretimin nga GjDBE-ja e praktikës gjyqësore relevante të KEDNj-së. Kështu pjesa më relevante e praktikës gjyqësore të GjDBE-së është përmbledhur në pjesën e dytë të këtij Udhërrëfyesi: *‘Përmbledhje të vendimeve’*.

## (3) KUJT / CILAVE ORGANE U APLIKOHET KRITERI I PAVARËSISË DHE PAANSHMËRISË?

### a) Gjykatat

E drejta për seancë të drejtë sipas nenit 6 § 1 kërkon që një çështje të dëgjohej nga një “gjykatë e pavarur dhe e paanshme e ngritur me ligj”. Kështu që kriteri i ligjshmërisë, pavarësisë dhe paanshmërisë i aplikohet çdo organi që ka statusin e “gjykatës” ose “tribunalit” brenda kuptimit të nenit 6 § 1 të Konventës.

Nocioni i “gjykatës” ose “tribunalit” është nocion autonom sipas KEDNJ-së.<sup>[20]</sup> Për t’u kategorizuar si i tillë sipas nenit 6 § 1, nuk është e nevojshme që institucioni të jetë i klasifikuar si ‘gjykatë’ ose ‘tribunal’ nga legjislati i Shtetit në fjalë, e as nuk është e nevojshme që institucioni të jetë i integruar në makinerinë gjyqësore standarde të vendit në fjalë. Një gjykatë ose tribunal mund të merret me një fushë të caktuar, ose mund të vendosë në lidhje me një numër të vogël çështjesh specifike, jashtë sistemit të gjykatave të rregullta brenda një Shteti.<sup>[21]</sup>

Sipas GjDBE-së (në atë kohë GjDKE, Gjykata e Drejtësisë e Komuniteteve Evropiane) faktorët relevantë që përcaktojnë nëse një institucion duhet të konsiderohet gjykatë janë:

*“burimi ligjor i institucionit, karakteri i tij i përhershëm, kompetenca e përgjithshme për të zgjidhur mosmarrëveshje, respekti për parimin e kontradiktorialitetit, ... në lidhje me mosmarrëveshjet përkatëse dhe zbatimin e rregullave të së drejtës.”<sup>[22]</sup>*

GjDBE ka vendosur që nocioni i “gjykatës” duhet të interpretohet:

*“... në kuptimin material: aftësia e saj funksionale për të zgjidhur çështje brenda juridiksionit të saj mbi bazën e rregullave të së drejtës, sipas procedurave të ndjekura në një mënyrë të caktuar.”<sup>[23]</sup>*

20 Jean-Paul Costa (fish-Kryetar i GjEDNJ-së, “Çfarë është gjykata e ngritur me ligj?” (frëngj.: ‘Qu’est-ce qu’un tribunal établi par la loi?’), tek Procesi i Drejtë: Vështrime Rajonale dhe Ndërkombëtare – Liber Amicorum Linos Alexandri Sicilianos, f. 102.

21 Mutu dhe Pechstein k. Zvicrës, vendimi i 2 tetorit 2018, nr. 40575/10 dhe nr. 67474/10, § 139.

22 Vaasens GÖbbels k. Beamtenfonds voor het Mijbedrijf, vendimi i 30 qershorit 1966, Çështja 61-65.

23 Sramek k. Austrisë, vendimi i 22 tetorit 1984, nr. 8790/79 (përfshirë si përmbledhje në publikim): Ky sqarim konceptual gjithashtu gjendet në shumë vendime të tjera, si Qipro k. Turqisë, vendimi i Dhomës së Madhe i 12 majit 2014, nr.



Prandaj, tribunali karakterizohet nga funksionet që kryen e jo nga mënyra si etiketohet. Pyetja kyçe është nëse personi apo autoriteti përkatës i shërben një funksioni gjyqësor, pra a vendos çështje brenda kompetencës së tij, të cilat janë mosmarrëveshje, mbi bazën e shtetit të së drejtës, dhe a zhvillohen këto procedura në një mënyrë të parashikuar.

Pushteti për të marrë vendime me fuqi detyruese, të cilat nuk mund të ndryshohen nga një autoritet jo-gjyqësor, është gjithashtu i ngërthyer brenda nocionit të “tribunalit”.<sup>[24]</sup> Vetëm pushteti për të lëshuar opinione këshilluese nuk mjafton për të përbërë tribunali<sup>[25]</sup>.

Shembuj të organeve të cilat janë gjetur se kanë statusin e tribunalit brenda kuptimit të nenit 6 § 1 përfshijnë:

- » një autoritet rajonal i transaksioneve të pronave;<sup>[26]</sup>
- » një bord kompensimi i dëmeve penale;<sup>[27]</sup>
- » Gjykata e Arbitrazhit për Sportin;<sup>[28]</sup> dhe
- » një komision arbitrazhi i futbollit.<sup>[29]</sup>

## **b) Ndhimësgjyqtarët, Anëtarët e Jurive dhe Të Tjerë që Kryejnë Funksione Gjyqësore**

---

Parimet e vendosura në praktikën e Gjykatës në lidhje me pavarësinë dhe paanshmërinë e gjyqësorit u zbatohen njësoj anëtarëve të jurisë, ndihmësgjyqtarëve dhe zyrtarëve të tjerë që ushtrojnë funksione gjyqësore, siç janë ndihmësgjyqtarët, kancelarët, sekretarët ligjorë dhe stafi administrativ.<sup>[30]</sup> Për shembull, Gjykata ka vlerësuar zyrtarët e mëposhtëm për pajtueshmërinë e tyre me kriteret e pavarësisë dhe paanshmërisë sipas nenit 6 § 1:

---

25781/94, dhe më së fundi *Guðmundur Andri Ástráðsson k. Islandës*, vendimi i Dhomës së Madhe i 1 dhjetorit 2020, nr. 26374/18, § 219 (përfshirë si përmbledhje në publikim).

24 *Van de Hurk k. Holandës*, vendimi i 19 prillit 1994, nr. 16034/90, § 45 (përfshirë si përmbledhje në publikim).

25 *Bentham k. Holandës*, vendimi i 23 tetorit 1985, nr. 8848/80, § 40.

26 *Sramek k. Austrisë*, vendimi i 22 tetorit 1984, nr. 8790/79, § 36 (përfshirë si përmbledhje në publikim).

27 *Rolf Gustafson k. Suedisë*, vendimi i 1 korrikut 1997, nr. 23196/94, § 48.

28 *Mutu dhe Pechstein k. Zvicrës*, vendimi i 2 tetorit 2018, nr. 40575/10 dhe nr. 67474/10, § 149.

29 *Ali Riza dhe të Tjerë k. Turqisë*, vendimi i 28 janarit 2020, nr. 30226/10 dhe nr. 5506/16, §§ 202-204.

30 *Bellizzi k. Maltës*, vendimi i 21 qershorit 2011, nr. 46575/09, §51; *Cooper k. Mbretërisë së Bashkuar*, vendimi i Dhomës së Madhe i 16 dhjetorit 2003, nr. 48843/99, § 123 (përfshirë si përmbledhje në publikim).

- » Anëtarët në një bord për rishikimin e qirasë.<sup>[31]</sup>
- » kandidatët për pozicionin e gjyqtarit të gjykatës së rrethit, të njohur si ndihmësgjyqtarë, të cilët duhet të punojnë tri vjet si ndihmësgjyqtarë para se të bëhen gjyqtarë;<sup>[32]</sup> dhe
- » anëtarët e jurisë në një çështje lidhur me shpifje.<sup>[33]</sup>

### c) Ekzekutivi, Legjislativi dhe Autoritetet e Tjera Shtetërore

Gjykata ka theksuar se detyrimi për të garantuar gjykimin nga një “gjykatë e pavarur dhe e paanshme” sipas nenit 6 § 1 nuk kufizohet brenda gjyqësorit. Ai gjithashtu nënkupton detyrime mbi ekzekutivin, legjislativin dhe çdo autoritet tjetër shtetëror (pavarësisht nga niveli i tij) për të respektuar dhe për t’iu përmbajtur vendimeve të gjykatave, edhe kur nuk janë dakord me to.

Është parakusht i domosdoshëm për besimin publik tek gjykatat dhe, më gjerësisht, për shtetin e së drejtës që organet dhe autoritetet e tjera shtetërore të respektojnë autoritetin e gjykatave. Vetëm zbatimi i mbrojtjeve kushtetuese të pavarësisë dhe paanshmërisë nuk mjafton; mbrojtje të tilla gjithashtu duhet të inkorporohen efektivisht në qëndrimet dhe praktikatat e përditshme administrative.<sup>[34]</sup>

Kjo qasje përqafohet nga instrumentet përkatëse të KE-së. Plani i Veprimit i KE-së për fuqizimin e pavarësisë dhe paanshmërisë gjyqësore thekson rëndësinë e përhapjes së kulturës së respektit për pavarësinë dhe paanshmërinë gjyqësore në shoqëri në përgjithësi, dhe veçanërisht në mesin e ekzekutivit dhe legjislativit.<sup>[35]</sup> Plani i Veprimit i KE-së dhe Shtojca e tij parashtrajnë se duhet të ndërmerren veprimet e mëposhtme:

- » Së pari, të vendosen dhe të përmirësohen garancitë ligjore të pavarësisë dhe paanshmërisë gjyqësore.
- » Së dyti, të ngrihen ose të futen strukturat, politikatat dhe praktikatat e nevojshme për të siguruar që këto garanci të respektohen në praktikë dhe të kontribuojnë në funksionimin e duhur të degës së gjyqësorit në një shoqëri demokratike të bazuar mbi të drejtat e njeriut dhe shtetin e së drejtës.

31 *Langborger k. Suedisë*, vendimi i 22 qershorit 1989, nr. 11179/84 (përfshirë si përmbledhje në publikim).

32 *Henryk Urban dhe Ryszard Urban k. Polonisë*, vendimi i 30 nëntorit 2010, nr. 23614/08 (përfshirë si përmbledhje në publikim).

33 *Holm k. Suedisë*, vendimi i 25 nëntorit 1993, nr. 14191/88, § 30.

34 *Agrokompleks k. Ukrainës*, vendimi i 6 tetorit 2011, nr. 23465/03, § 136 (përfshirë si përmbledhje në publikim).

35 Plani i Veprimit i KE-së, f. 7.

## (4) GJYKATA E NGRITUR ME LIGJ

Siç u diskutua në hyrjen e këtij Udhërrëfyese, kohët e fundit Gjykata ka artikuluar të drejtën për “gjykatë të ngritur me ligj” si e drejtë e vetqëndrueshme sipas nenit 6.<sup>[36]</sup>

Kriteri që gjykata të jetë “e ngritur me ligj” do të thotë që: (i) duhet të ekzistojë legjislacioni vendas që parashikon dhe rregullon ngritjen dhe kompetencat e organeve juridike; dhe (ii) ky legjislacion duhet të respektohet në praktikë.

Qëllimi i shprehjes “e ngritur me ligj” është të sigurojë që organizimi juridik në një shoqëri demokratike të mos varet nga diskrecioni i ekzekutivit, por të jetë i rregulluar me ligjet që dalin nga Parlamenti.<sup>[37]</sup> Si e drejtë e vetqëndrueshme, ajo ka një “ndërmarrëdhënie shumë të afërt” me garancitë e “pavarësisë dhe paanshmërisë”.<sup>[38]</sup>

Pavarësisht nga fakti se Gjykata kujton “ndërmarrëdhënien shumë të afërt” të saj me garancitë e “pavarësisë dhe paanshmërisë”, gjetja që një gjykatë nuk është “ngritur me ligj” në vetvete mund të përbëjë arsye për të gjetur shkelje të nenit 6, pa pasur nevojë të shqyrtohet nëse gjykatës në fjalë i ka munguar pavarësia apo paanshmëria.<sup>[39]</sup> GjDBE e ka konsideruar si argument *d'ordre public* (argument i rendit publik) i cili duhet të ekzaminohet nga gjykatat e interesuara *proprio motu*, pra me nismën e vet atyre.<sup>[40]</sup> Prandaj, ky Udhërrëfyese analizon kriterin që një gjykatë të

36 *Guðmundur Andri Ástráðsson k. Islandës*, vendimi i Dhomës së Madhe i 1 dhjetorit 2020, nr. 26374/18 (përfshirë si përmbledhje në publikim).

37 *Guðmundur Andri Ástráðsson k. Islandës*, vendimi i Dhomës së Madhe i 1 dhjetorit 2020, nr. 26374/18, §§ 211, 214 (përfshirë si përmbledhje në publikim).

38 *Guðmundur Andri Ástráðsson k. Islandës*, vendimi i Dhomës së Madhe i 1 dhjetorit 2020, nr. 26374/18, § 231 (përfshirë si përmbledhje në publikim).

39 *Guðmundur Andri Ástráðsson k. Islandës*, vendimi i Dhomës së Madhe i 1 dhjetorit 2020, nr. 26374/18, § 295 (përfshirë si përmbledhje në publikim): shumica e Dhomës së Madhe (12 vota me 5 vota) gjeti se nuk ishte e nevojshme të shqyrtohej ndaras ankesa e kërkuetit në lidhje me mungesën e pavarësisë dhe paanshmërisë së gjyqtarsë së Gjykatës së Apelit tek çështja në fjalë.

40 *Chronopost dhe La Poste k. UFXE dhe Të Tjerëve*, vendimi i Dhomës së Madhe i 1 korrikut 2008, C341/06 P dhe C342/06 P, §§ 44 deri 50 (a); *FV k. Këshillit*, vendimi i Gjykatës së Përgjithshme (Dhoma e Apelit) i 23 janarit 2018, T 639/16 P; *Erik Simpson k. Këshillit dhe HG k. Komisionit*, vendimi i Dhomës së Madhe i 26 marsit 2020, C-542/18, § 45 dhe C-543/18, § 57. Do të jetë interesante të shihet nëse dhe në ç'mënyrë ky kriter i vendosur nga GjDBE-ja do të ndikojë në interpretimin e kriterit të tretë të vendosur nga GjEDN-ja tek *Guðmundur Andri Ástráðsson k. Islandës*, pra çështja e shqyrtimit efektiv nga gjykatat vendase të shkeljes përkatëse të së drejtës vendase. Pyetja është nëse argumenti i politikave publike do të ishte i tillë që, edhe nëse shkelja e kriterit që gjykata të jetë e ngritur me ligj nuk ngrihet nga

“ngrihet me ligj” në këtë seksion të veçantë, para se të marrë në shqyrtim kriteret e “pavarësisë” dhe “paanshmërisë” në seksione të ndara më poshtë.

Procesi i emërimit të gjyqtarëve është element i brendshëm i konceptit të “ngritjes” së një gjykate apo tribunali sipas ligjit.<sup>[41]</sup> Prandaj, procesi i emërimit të gjyqtarëve duhet të zhvillohet në pajtim me parimin e shtetit të së drejtës dhe në përputhje me rregullat e aplikueshme të së drejtës vendase në fuqi në kohën materiale.<sup>[42]</sup>

### **a) Testi tre-hapësh për të përcaktuar nëse një gjykatë është ngritur me ligj**

Procesi i emërimit të gjyqtarëve ka domethënie thelbësore për funksionimin dhe legjitimitetin e duhur të gjyqësorit në një Shtet demokratik të qeverisur nga shteti i së drejtës. Gjetjet e parregullsive në ngritjen e një gjykate ose në procesin e emërimeve gjyqësore të cilat çojnë në gjetjen se një gjykatë nuk është “gjykatë e ngritur me ligj” mund të kenë pasoja të konsiderueshme për parimet e sigurisë ligjore dhe mos-shkarkimit të gjyqtarëve. Për këtë arsye, Gjykata ka vendosur testin tre-hapësh të përshkruar më poshtë, me qëllim që të përcaktojë nëse defektet në procedurën e emërimit të gjyqtarëve ose në ngritjen e gjykatës janë aq të rënda sa që shkelin kriteret e nenit 6 të KEDNJ-së.<sup>[43]</sup>

#### **1. A ka pasur shkelje të dukshme të së drejtës vendase?**

Së pari, është e nevojshme të konstatohet nëse ata/o që bëjnë emërimet kanë vepruar në përputhje me procedurat dhe detyrimet vendase të cilat rregullojnë mënyrën se si emërohen gjyqtarët. Për shembull, në qoftë se ka procedura të caktuara votimi, a janë ndjekur ato? Ose, në qoftë se emëruesit duhet të japin arsyetime për të mbështetur vendimet e tyre, a kanë bërë ata kërkimet e

kërkuesit në shkallë vendi, fakti që ajo nuk është shqyrtuar proprio motu nga gjykatat vendase nuk do të ndikonte në pranueshmërinë e pretendimit për mos-shërimin e zgjidhjeve vendase, e faktikisht do të ishte në favor të gjetjes së një shkeljeje të pjesës së tretë të testit të përdorur në *Guðmundur Andri Ástráðsson*.

41 *Guðmundur Andri Ástráðsson k. Islandës*, vendimi i Dhomës së Madhe i 1 dhjetorit 2020, nr. 26374/18, § 227 (përfshirë si përmbledhje në publikim).

42 *Guðmundur Andri Ástráðsson k. Islandës*, vendimi i Dhomës së Madhe i 1 dhjetorit 2020, nr. 26374/18, § 98 (përfshirë si përmbledhje në publikim).

43 *Guðmundur Andri Ástráðsson k. Islandës*, vendimi i Dhomës së Madhe i 1 dhjetorit 2020, nr. 26374/18, (përfshirë si përmbledhje në publikim): testi me tri pjesë u vendos në kontekstin e të drejtës për gjykatë ‘të ngritur me ligj’ sipas nenit 6, por Gjykata pranoi se ankesa e bërë rreth pavarësisë dhe paanshmërisë së gjyqësorit rridhte nga i njëjti problem – defektet në procedurën e emërimit të gjyqtarëve, kështu që nuk qe e nevojshme të shqyrtohej çështja e pavarësisë dhe paanshmërisë ndaras prej çështjes së gjykatës së ngritur me ligj.

duhura rreth kandidatëve dhe a kanë ofruar fakte për të mbështetur vendimet e tyre? Shteti gjithashtu mund të gjendet se ka shkelur të drejtën vendase kur procedura e zhvilluar për emërimin e një gjyqtari injoron vendimet e një gjykate kushtetuese lidhur me mënyrën se si duhet të zhvillohet.<sup>[44]</sup>

2. A ka qenë shkelja e së drejtës vendase pjesë e ndonjë rregulle themelore të procedurës së emërimeve gjyqësore?

Së dyti, është e nevojshme të vlerësohet nëse çdo shkelje e të drejtës vendase, që është konstatuar në fazën 1, ka pasur peshë të atillë saqë të dëmtojë legjitimitetin e procedurës së emërimeve duke minuar vetë thelbin e të drejtës për gjykatë të ngritur me ligj. Pyetja është nëse defektet në procedurë i kanë dhënë shkas një pasigurie të mjaftueshme rreth motiveve për një emërim të caktuar, për t'i dhënë shkas më tej frikës serioze për ndërhyrje të papërshtatshme tek gjyqësori, dhe për të njetosur legjitimitetin e tërë procesit.<sup>[45]</sup> Dhoma e Madhe konsideron se shkelje të tilla të rënda mund të përfshijnë, për shembull, emërimin e personave që nuk plotësojnë kriteret ligjore ose shkelje të tjera të cilat dëmtojnë qëllimin dhe efektin e kriterit për të qenë “e ngritur me ligj”, ashtu siç interpretohet nga Gjykata.<sup>[46]</sup> Gjykata gjithashtu ka deklaruar se dështimi i vazhdueshëm për të vepruar në përputhje me vendimet relevante të gjykatës kushtetuese të Shtetit në lidhje me emërimin e gjyqtarëve do të përbënin shkelje të rëndë të së drejtës vendase, sepse kjo do të dëmtonte shtetin e së drejtës, parimin e sigurisë ligjore, ndarjen e pushteteve dhe autoritetin e gjyqësorit.<sup>[47]</sup>

44 *Xero Flor w Polsce sp. z o.o. k. Polonisë*, vendimi i 7 majit 2021, no. 4907/18, §272 (përfshirë si përmbledhje në publikim).  
*Vini re: në kohën e shkruarjes, vendimi nuk ka marrë formë të prerë në rrethanat e cekura në nenin 44 § 2 të KEDNJ-së.*

45 *Guðmundur Andri Ástráðsson k. Islandës*, vendimi i Dhomës së Madhe i 1 dhjetorit 2020, nr. 26374/18, § 270 (përfshirë si përmbledhje në publikim): Gjykata gjeti se vendimi për ta vënë propozimin e Ministres për kandidatët gjyqësorë në një votim të vetëm në Parlament, në vend të një votimi për secilin prej kandidatëve, siç kërkohej nga ligjet vendase, në vetvete nuk do të kishte përbërë shkelje të së drejtës për “gjykatë të ngritur me ligj”, sidomos duke pasur parasysh që deputetëve u ishte ofruar mundësia për të kërkuar votime të ndara. Megjithatë, procedura e votimit u gjet se kishte përmbytur shkelje të rënda të procedurës së kërkuar të cilat Ministrja e Drejtësisë tashmë i kishte kryer, siç ishte shpërfillja nga Ministria e rregullit procedural themelor sipas të cilit ajo duhet ta bazonte vendimin e saj mbi hetime dhe vlerësime të mjaftueshme. Ky rregull procedural u vlerësua se ishte mbrojtje e rëndësishme për ta parandaluar Ministrën nga veprimet e motivuara politikisht ose të papërshtatshme të cilat do të dëmtonin pavarësinë e gjyqësorit.

46 *Guðmundur Andri Ástráðsson k. Islandës*, vendimi i Dhomës së Madhe i 1 dhjetorit 2020, nr. 26374/18, § 246 (përfshirë si përmbledhje në publikim).

47 *Xero Flor w Polsce sp. z o.o. k. Polonisë*, vendimi i 7 majit 2021, no. 4907/18, § 272 (përfshirë si përmbledhje në publikim).  
*Vini re: në kohën e shkruarjes, vendimi nuk ka marrë formë të prerë në rrethanat e cekura në nenin 44 § 2 të KEDNJ-së.*

### 3. A janë shqyrtuar dhe zgjidhur efektivisht shkeljet e pretenduara nga gjykatat vendase?

Në fund, çdo shkelje e pretenduar duhet t'i nënshtrohet shqyrtimit gjyqësor. Vetëm fakti që shkeljet i nënshtrohen shqyrtimit nga një gjykatë më e lartë nuk mjafton për të përmbushur kriteret e nenit 6. Shqyrtimi gjyqësor duhet të jetë efektiv, çka do të thotë se gjykata shqyrtuese duhet të vendosë ekuilibrin e drejtë mes ruajtjes së parimit të sigurisë ligjore dhe respektimit të shtetit të së drejtës.

Testi me tre hapa më lart përdoret për të përcaktuar nëse defektet në procesin e përzgjedhjes gjyqësore shkelin të drejtën vendase e rrjedhimisht përbëjnë shkelje të nenit 6. Përveç kësaj, instrumentet përkatëse ndërkombëtare dhe evropiane përmbajnë udhëzime se si duhet strukturuar saktësisht procesi i përzgjedhjes në nivel nacional dhe çfarë hapash duhet të përmbajë.<sup>[48]</sup> Magna Carta e Gjyqtarëve, për shembull, deklaroi se vendimet rreth përzgjedhjes, emërimit dhe karrierës së gjyqtarëve duhet të bazohen mbi kriteret objektive dhe duhet të merren nga një organ përgjegjës për garantimin e pavarësisë.<sup>[49]</sup>

KKGJE-ja rekomandon që autoritetet përgjegjëse në Shtetet Anëtare për bërjen dhe këshillimin rreth emërimeve dhe promovimeve duhet të hartojnë, të publikojnë dhe të efektivizojnë kriteret objektive, me qëllim të sigurimit që përzgjedhja dhe karriera e gjyqtarëve të jenë “të bazuara në merita, duke pasur parasysh kualifikimet, karakterin, aftësitë dhe efikasitetin”. Merita nuk përkufizohet vetëm si çështje e njohurive ligjore, shkathtësive analitike apo cilësive të shkëlqyera akademike. Ajo gjithashtu duhet të përfshijë çështje të karakterit, gjykimit, afërsisë, shkathtësive komunikuese, efikasitetit për të sjellë vendime, etj. dhe vlerësohet se ka rëndësi thelbësore që gjyqtari të ketë sensin e drejtësisë dhe sensin e paanshësisë. Kriteret të tilla mund të jenë të vështira për t'u vlerësuar në praktikë; prandaj KKGJE-ja ka theksuar se duhet të zbatohen procedura transparente dhe praktika koherente gjatë aplikimit të këtyre kriterëve.

48 Parimet Bazë të OKB-së, për shembull, deklarojnë se personat e zgjedhur për poste gjyqësore duhet të jenë persona me karakter dhe të aftë që kanë trajnimin ose kualifikimet e duhura në fushën e drejtësisë. Të gjitha metodat e përzgjedhjes gjyqësore duhet të kenë mbrojtje kundër emërimeve gjyqësore për motive të papërshtatshme.

49 Magna Carta e gjyqtarëve, § 5; shih gjithashtu [https://search.coe.int/cm/Pages/result\\_details.aspx?ObjectID=09000016805afb78](https://search.coe.int/cm/Pages/result_details.aspx?ObjectID=09000016805afb78) “Rekomandimi CM/Rec(2010)12 i Komitetit të Ministrave për Shtetet Anëtare në lidhje me gjyqtarët: pavarësia, efikasiteti dhe përgjegjësitë”, Komiteti i Ministrave i KE-së, 17 nëntor 2010, Kapitulli VI, § 44: “Vendimet në lidhje me përzgjedhjen dhe karrierën e gjyqtarëve duhet të bazohen mbi kriteret objektive të paracaktuara nga ligji ose nga autoritetet kompetente. Këto vendime duhet të bazohen mbi merita, duke pasur parasysh kualifikimet, shkathtësitë dhe kapacitetet e kërkuara për të gjykuar çështjet duke zbatuar ligjin e ndërkohë duke respektuar dinjitetin njerëzor.”

Plani i Veprimit i KE-së<sup>[50]</sup> po ashtu pohon se duhet të ketë pjesëmarrje mjaftueshëm të përshtatshme gjatë përzgjedhjes, emërimit dhe promovimit të gjyqtarëve, duke kufizuar njëkohësisht ndërhyrjet ekzekutive ose parlamentare në këtë proces.<sup>[51]</sup>

Prandaj tani, parimi që të gjitha vendimet në lidhje me emërimin dhe karrierën profesionale të gjyqtarëve duhet të bazohen mbi merita, duke aplikuar kritere objektive brenda kornizave të ligjit, është i padiskutueshëm sipas instrumenteve përkatëse ndërkombëtare dhe evropiane. Ekzistenca e standardeve objektive kërkohet jo vetëm për të përjashtuar ndikimet politike, por edhe për të shmangur rrezikun e favoritizmit, konservatizmit dhe preferencës politike (ose “klonimit”), të cilat ekzistojnë në qoftë se emërimet bëhen në mënyrë të pastrukturuar ose mbi bazën e rekomandimeve personale.<sup>[52]</sup>

## b) Diversiteti i gjyqësorit

Për sa i përket diversitetit të anëtarëve të gjyqësorit, procesi i emërimit të një gjyqtari të ri duhet të jetë në përputhje me kriteret e ligjit përkatës vendas mbi bazarinë.<sup>[53]</sup>

Instrumentet përkatëse ndërkombëtare gjithashtu inkurajojnë nxitjen e përfaqësimit më të madh të grave dhe pakicave në gjyqësor.<sup>[54]</sup> Komisioni i Venecias, ndërkohë që thekson se merita duhet të jetë kriteri parësor në përzgjedhjen e anëtarëve të gjyqësorit, ka deklaruar se diversiteti brenda gjyqësorit mundëson që

50 Plani i Veprimit i KE-së, Veprimi 1.2.

51 KKGJE-ja e pranon se në disa vende ka, nga aspekti kushtetues, ndikim të drejtpërdrejt politik në emërimin e gjyqtarëve. Kur ndodh kjo, qëllimi i një sistemi të tillë duhet të jetë që gjyqësorit t'i jepet njëfarë përfundimi demokratik direkt gjatë ushtrimit të funksioneve të tij. Qëllimi nuk mund të jetë që emërimet gjyqësore t'u nënshtrohen konsideratave politike të partive. Kur ekziston rreziku se ai po përdoret, ose mund të përdoret, në mënyrë të tillë, atëherë kjo metodë do të përbënte më shumë rrezik sesa avantazh për pavarësinë.

52 CCJE (2001) Op. N° 1.

53 *Guðmundur Andri Ástráðsson k. Islandës*, vendimi i Dhomës së Madhe i 1 dhjetorit 2020, nr. 26374/18, §§ 260-262 (përfshirë si përmbledhje në publikim).

54 Parimet Bazë të OKB-së parashikojnë që gjatë përzgjedhjes së gjyqtarëve nuk duhet të ketë diskriminim ndaj personit për shkak të racës, ngjyrës, seksit, besimit fetar, opinionit politik apo tjetër, prejardhjes nacionale apo sociale, pasurisë, lindjes apo statusit, përveç rastit kur kriteri që një kandidat për post gjyqësor të jetë shtetas i një vendi të dhënë nuk konsiderohet diskriminues; Raporti i Raportuesit Special për pavarësinë e gjyqtarëve dhe avokatëve: <https://undocs.org/A/HRC/32/34> deklarën se Shtetet gjithashtu duhet të sigurohen që secili/a mund t'i futet profesionit ligjor, shërbimeve prokuroriale dhe gjyqësorit pa asnjë lloj diskriminimi, veçanërisht për shkak të gjinisë; Shtetet duhet të promovojnë përfaqësim më të madh të grave dhe pakicave.

publiku të ketë besim dhe ta pranojë gjyqësorin në tërësi. Prandaj, pozitën gjyqësore duhet të jenë të hapura dhe duhet t'u jepet qasje të gjithë personave të kualifikuar në të gjithë sektorët e shoqërisë.<sup>[55]</sup> Më tej, Plani i Veprimit i KE-së deklaron se ekuilibri gjinor dhe, më përgjithësisht, përfaqësimi i shoqërisë në tërësi, në përbërjen e gjyqësorit duhet të promovohet në të gjitha nivelet, përfshirë edhe në nivelet më të larta.<sup>[56]</sup> KKGJE-ja konsideron se është e udhës të inkurajohen aplikante femra për emërimet gjyqësore si dhe nga pakicat etnike, dhe ka theksuar nevojën për të arritur barazi mes grave dhe burrave në gjyqësor.<sup>[57]</sup>

---

55 Shih <https://rm.coe.int/1680700a63>: Raporti i Komisionit të Venedikut për Pavarësinë e Sistemit Gjyqësor Pjesa I.

56 Plani i Veprimit i KE-së, Veprimi 1.2.

57 KKGJE (2001) Op. N° 1, § 31.



## (5) PAVARËSIA

### a) Të Përkufizuarit e Pavarësisë

---

Pavarësia i referohet lirisë nga presionet e jashtme mbi vendimmarrjen gjyqësore dhe nënkupton ekzistencën e garancive kundër ndikimeve të papërshtatshme mbi gjyqtarët gjatë kryerjes së rolit të tyre gjykues. Pavarësia dëmtohet kur organet e tjera të shtetit ndërhyjnë në një çështje gjyqësore.

Koncepti i pavarësisë përfshin si pavarësinë e jashtme, ashtu edhe atë të brendshme. Pavarësia e jashtme i referohet pavarësisë nga: organet e tjera të qeverisë, pra ekzekutivi dhe parlamenti,<sup>[58]</sup> palët në procedura para një gjykate<sup>[59]</sup> dhe shoqëria në tërësi. Pavarësia e brendshme i referohet pavarësisë nga anëtarët e tjerë të gjyqësorit.<sup>[60]</sup> Të prezantuarit në publik si një sistem i pavarur gjithashtu është i rëndësishëm për të mbrojtur besimin publik tek gjyqësori, përfshirë besimin e palëve në procedura para gjykatave.

Nocioni i pavarësisë ngërthen ekzistencën e mbrojtjeve procedurale për të ndarë gjyqësorin nga fuqitë e tjera të Shtetit dhe palë të tjera të cilat mund të ndikojnë në vendim-marrjen e tyre. Varësia ose pavarësia e gjyqësorit vlerësohet duke iu referuar këtyre mbrojtjeve, duke parë veçanërisht mënyrën e emërimit të anëtarëve të gjyqësorit, mandatin e tyre, ekzistencën e garancive kundër presioneve të jashtme dhe faktin nëse një organ paraqet dukjen e pavarësisë.

Pavarësia gjyqësore duhet të jetë statutore, funksionale dhe financiare.<sup>[61]</sup> Kjo do të thotë që ajo duhet të garantohet në lidhje me aktivitetet gjyqësore dhe në mënyrë të veçantë në lidhje me rekrutimin, emërimin deri në moshën e pensionimit, promovimin, mos-shkarkimin, trajnimin, imunitetin gjyqësor, disiplinimin, shpërblimin dhe financimin e gjyqësorit.

Të gjitha organet e Shtetit, përfshirë ekzekutivin, parlamentin dhe çdo gjyqtar/e, janë përgjegjës/e për promovimin dhe mbrojtjen e pavarësisë gjyqësore.

---

58 *Beaumontin k. Francës*, vendimi i 24 nëntorit 1994, nr. 15287/89, § 38.

59 *Sramek k. Austrisë*, vendimi i 22 tetorit 1984, nr. 8790/79, § 42 (përfshirë si përmbledhje në publikim).

60 *Agrokompleks k. Ukrainës*, vendimi i 6 tetorit 2011, nr. 23465/03, § 137.

61 *Magna Carta e Gjyqtarëve*.

## b) Pavarësia nga Kush?

Pavarësia duhet të garantohet në lidhje me pushtetet e tjera të Shtetit, ata që kërkojnë drejtësi, gjyqtarë të tjerë, dhe shoqëria në përgjithësi, me anë të rregullave nacionale të nivelit më të lartë.<sup>[62]</sup>

### Pushtetet e tjera të Shtetit (ekzekutivi dhe parlamenti)

Është thelbësore në çdo demokraci që gjyqtarët të jenë të pavarur nga organet e tjera të shtetit, dhe nocioni i ndarjes së pushteteve mes ekzekutivit dhe gjyqësorit ka marrë rëndësi gjithnjë e më të madhe në praktikën e Gjykatës.<sup>[63]</sup> Megjithatë, krahas këtij theksi tek rëndësia e ndarjes së pushteteve, Gjykata ka theksuar se as neni 6 e asnjë dispozitë e Konventës nuk kërkojnë që Shtetet t'u përmbahen ndonjë koncepti teorik kushtetues në lidhje me kufijtë e lejueshëm të ndërveprimeve mes pushteteve të Shtetit.<sup>[64]</sup>

Ajo që është thelbësore është që të ketë garanci të mjaftueshme për të siguruar që gjyqtarët të jenë të lirë nga presioni ose ndikimi prej organeve të tjera të Shtetit gjatë kryerjes së detyrave të tyre. Në praktikë, garanci të tilla mund të marrin forma të ndryshme, dhe Gjykata vlerëson një sërë faktorësh në kontekstin specifik të një çështjeje të dhënë për të parë nëse sistemi dhe mbrojtjet e ngritura janë në përputhje me kriteret e nenit 6. Kjo përfshin proceset e emërimit gjyqësor, promovimin dhe shkarkimin, mandatin dhe garanci të tjera kundër presioneve të jashtme, të cilat diskutohen më me hollësi në seksionet e këtij Udhërrëfyese: 'Kriteret e përdorura për të përcaktuar nëse një gjykatë është e pavarur' dhe 'Emërimi i gjyqtarëve'.

Pavarësia e gjyqtarëve dëmtohet kur anëtarë të ekzekutivit përpiqen të ndërhyjnë direkt dhe të ndikojnë tek rezultati i një çështjeje para gjykatave,<sup>[65]</sup> për shembull kur i shkruajnë gjykatave për të ushtruar presion mbi to, kur bëjnë kundërshtime duke kërkuar anulimin ose rishikimin e një vendimi përfundimtar, ose kur bëjnë komente me tone të forta para anëtarëve të gjyqësorit në lidhje me një çështje.

62 Magna Carta e Gjyqtarëve, § 3

63 *Stafford k. Mbretërisë së Bashkuar*, vendimi i Dhomës së Madhe i 28 majit 2002, nr. 46295/99, § 78 (përfshirë si përmbledhje në publikim).

64 *Kleyn dhe të Tjerë k. Hollandës*, vendimi i Dhomës së Madhe i 6 majit 2003, nr. 39343/98 (përfshirë si përmbledhje në publikim).

65 *Sovtransavto Holding k. Ukrainës*, vendimi i 25 korrikut 2002, nr. 48553/99, § 80.

Fakti që një anëtar i ekzekutivit ose i legjislativit është anëtar i një organi gjyqësor gjithashtu mund të shkatërrojë pavarësinë e tij,<sup>[66]</sup> por nuk është gjithmonë kështu.<sup>[67]</sup> Thjesht prania e një anëtari të legjislativit ose ekzekutivit në një gjykatë, në vetvete, nuk mjafton për të ngritur dyshime rreth pavarësisë së gjykatës. Teoria e ndarjes së pushteteve nuk mund të thirret në mënyrë abstrakte, pa prova që prania e një anëtari të ekzekutivit ose legjislativit në një gjykatë përbën kërcënim për pavarësinë e saj në kontekstin specifik të një çështjeje të dhënë.<sup>[68]</sup>

Për shembull, fakti që një anëtar i legjislativit po ashtu mund të jetë anëtar i një gjykate apeli nuk u gjet nga Gjykata të ishte problem kur ai person nuk kishte ushtruar asnjë funksion të mëhershëm legjislativ, ekzekutiv ose këshillues në lidhje me lëndën ose me çështjet ligjore para gjykatës, dhe anëtarësia e tij në një parti politike nuk kishte asnjë lidhje me asnjërën prej palëve në procedurë ose me thelbin e çështjes.<sup>[69]</sup> Megjithatë, u gjet se pavarësia ishte dëmtuar kur një ministër drejtësie që ishte anëtar i një bordi disiplinor kishte nisur procedurat e kontestuara kundër kërkuesit gjatë periudhës kur vepronte në cilësinë e anëtarit të ekzekutivit.<sup>[70]</sup>

### Ata/ato që kërkojnë drejtësi (palët në procedurë)

---

Anëtarët e një gjykate gjithashtu duhet të jenë të pavarur nga palët e tjera në procedura. Kur anëtarët e një gjykate përfshijnë dikë që është në pozicion varësie - sa i përket detyrave të tij dhe organizatës së cilës i shërben - ndaj njëres prej palëve, kjo hedh dyshime mbi pavarësinë e gjykatës, edhe kur nuk ka asnjë tregues se ata marrin udhëzime prej palëve.<sup>[71]</sup>

### Gjyqtarë të tjerë dhe anëtarë të tjerë të gjyqësorit (pavarësia e brendshme)

---

Pavarësia gjyqësore gjithashtu kërkon që gjyqtarët individualë të jenë të lirë prej ndikimeve të papërshtatshme nga anëtarët e tjera të gjyqësorit dhe që të

---

66 *Gerevska Popčevska k. Ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë*, vendimi i 7 janarit 2016, nr. 48783/07, (përfshirë si përmbledhje në publikim).

67 *Pabla Ky k. Finlandës*, vendimi i 22 qershorit 2004, nr. 47221/99, §§ 31-35.

68 *Pabla Ky k. Finlandës*, vendimi i 22 qershorit 2004, nr. 47221/99, §34.

69 *Pabla Ky k. Finlandës*, vendimi i 22 qershorit 2004, nr. 47221/99, §§ 31-35.

70 *Gerovska Popčevska k. Ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë*, vendimi i 7 janarit 2016, nr. 48783/07, §§ 53-55 (përfshirë si përmbledhje në publikim).

71 *Sramek k. Austrisë*, vendimi i 22 tetorit 1984, nr. 8790/79, § 42 (përfshirë si përmbledhje në publikim).

ekzistojnë mbrojtje të mjaftueshme për të siguruar pavarësinë e gjyqtarëve vis-à-vis mbikqyrësve të tyre gjyqësorë.<sup>[72]</sup>

### Shoqëria në përgjithësi

Pavarësia gjyqësore po ashtu kërkon që të merret parasysh roli i veçantë i gjyqësorit në shoqëri. Si garantues i drejtësisë, vlerë themelore në një Shtet të qeverisur nga shteti i së drejtës, gjyqësori duhet të gëzojë besimin publik në qoftë se do që të ketë sukses gjatë kryerjes së detyrave të tij. Prandaj, mund të lindë nevoja për ta mbrojtur këtë besim nga sulme të rënda dëmtuese kundër gjyqësorit, si për shembull në media, të cilat muund të jenë të pabazuara. Kjo është më se e vërtetë kur merret parasysh fakti se gjyqtarët që kritikohen kanë për detyrë të jenë diskretë, gjë që i pengon nga të dhënit përgjigje.<sup>[73]</sup> Megjithatë, në përgjithësi, duke ditur se gjyqtarët formojnë një institucion themelor të Shtetit, mund të pritet që ata t'i nënshtrohen kritikave brenda kufijve të lejueshëm.<sup>[74]</sup>

### c) Kriteret për të Përcaktuar nëse një Gjykatë është e Pavarur

Pas shqyrtimit nëse një gjykatë është “e ngritur me ligj”, duke marrë parasysh faktorët e diskutuar në seksionin e këtij Udhërrëfyesi ‘Gjykata e ngritur me ligj’, faktorët e mëposhtëm gjithashtu kanë rëndësi për të përcaktuar nëse një gjykatë mund të konsiderohet se është e pavarur.

#### i) Emërimi i gjyqtarëve

Procesi i emërimit të gjyqtarëve ka domethënie themelore për funksionimin e duhur dhe legjitimitetin e gjyqësorit në një Shtet demokratik ku sundon shteti i së drejtës. Prandaj mënyra e emërimit të gjyqtarëve është gjetur se është element i qenësishëm i konceptit të “ngritjes” së një gjykate me ligj.<sup>[75]</sup> Çështja nëse emërimi i gjyqtarëve është në përputhje me ligjin diskutohet më lart në seksionin e këtij Udhërrëfyesi ‘Gjykata e ngritur me ligj’. Megjithatë, fakti që gjyqtarët janë emëruar në përputhje me kriteret formale ligjore mund të mos mjaftojë për të arritur në përfundimin se gjyqtarët e emëruar në këtë mënyrë janë në fakt të pavarur, dhe mund të duhen analiza të mëtejshme. Faktorët e mëtejshëm, më poshtë, në lidhje

72 *Agrokompleks k. Ukrainës*, vendimi i 6 tetorit 2011, nr. 23465/03, § 137 (përfshirë si përmbledhje në publikim).

73 *Morice k. Francës*, vendimi i Dhomës së Madhe i 23 prillit 2015, nr. 29369/10, § 128 (përfshirë si përmbledhje në publikim).

74 *July and SARL Libération k. Francës*, vendimi i 14 shkurtit 2008, nr. 20893/03, § 74.

75 *Guðmundur Andri Ástráðsson k. Islandës*, vendimi i Dhomës së Madhe i 1 dhjetorit 2020, nr. 26374/18, § 227 (përfshirë si përmbledhje në publikim).

me emërimin e gjyqtarëve, si për shembull kush i emëron gjyqtarët, gjithashtu kanë rëndësi për të përcaktuar nëse një gjykatë ose gjyqtar është i pavarur.

### Kush i emëron gjyqtarët?

---

Fakti që gjyqtarët nominohen nga parlamenti ose emërohen nga ministrat e qeverisë, në vetvete, nuk e dëmton pavarësinë e tyre.<sup>[76]</sup> Për shembull, kur Presidenti i një Shteti firmos dekretet për të emëruar gjyqtarë të rinj, dhe kjo nuk përfaqëson veçse plotësimin formal të një procesi vendimmarrës të zhvilluar nga një organ tjetër, kjo nuk e dëmton pavarësinë e personave në fjalë.<sup>[77]</sup>

Gjykata e ka pranuar që simpatitë politike mund të luajnë rol në procesin e emërimit të gjyqtarëve, por që vetëm ekzistenca e simpative të tilla nuk duhet t'i japë shkas dyshimeve rreth pavarësisë së gjyqtarëve të emëruar.<sup>[78]</sup> Ajo gjithashtu ka njohur faktin se në shumë sisteme gjyqtarët emërohen nga ministrat e drejtësisë.<sup>[79]</sup>

Ajo që ka rëndësi, kur gjyqtarët emërohen nga anëtarët e legjislativit ose ekzekutivit, është të sigurohet që ka rregulla dhe mbrojtje të mjaftueshme për të garantuar pavarësinë e gjyqtarëve pas emërimit. Duhet të jetë e qartë që, pasi emërohen, gjyqtarët të mos i nënshtrohen presioneve apo ndikimit nga ata që i kanë nominuar apo emëruar dhe që të mos marrin udhëzime rreth mënyrës se si duhet ta zhvillojnë rolin e tyre. Mbrojtje të tilla mund të përfshijnë:

---

76 *Fillipini k. San Marinos*, vendimi i 26 gushtit 2003, nr. 10526/02.

77 *Thiam k. Francës*, vendimi i 18 tetorit 2018, nr. 80018/12, §§ 80-82 (përfshirë si përmbledhje në publikim): nuk kishte shkelje të nenit 6 kur pushteti për të emëruar gjyqtarë i ushtruar nga Presidenti i Republikës mori formën e një instrumenti të krijuar nga Presidenti me propozim të Ministrit të Drejtësisë, mbi bazën e "miratimit detyrues" të Conseil Supérieur de la Magistrature [CSM] (Komisioni Kombëtar për Shërbim Ligjor) në përputhje me Nenin 65 të Kushtetutës. Në praktikë, ekzekutivi nuk mund të emëronte një gjyqtar duke shpërfillur vendimin e CSM-së, dhe Gjykata konkludoi, duke pasur parasysh prerogativat e CSM-së, roli i të cilit është, bashkë me Presidentin, të garantojë pavarësinë e gjyqësorit, se nënshkrimi nga Presidenti i instrumenteve për emërimin e gjyqtarëve të rinj ose për ngritjen në detyrë apo emërimet në poste të reja nuk ishte asgjë më shumë sesa kulminacioni formal i procesit vendimmarrës përkatës, dhe për se nuk dëmtonte pavarësinë e gjyqtarëve në fjalë. Përveç kësaj, ushtrimi i pushtetit të CSM-së për "propozim" dhe "miratim detyrues" përbënte mbrojtje thelbësore kundër rrezikut të presionit të ekzekutivit mbi gjyqtarët.

78 *Thiam k. Francës*, vendimi i 18 tetorit 2018, nr. 80018/12, §§ 80-82 (përfshirë si përmbledhje në publikim).

79 *Campbell dhe Fell k. Mbretërisë së Bashkuar*, vendimi i 28 qershorit 1984, nr. 7819/77 dhe nr. 7878/77 (përfshirë si përmbledhje në publikim).

- » Sigurinë e mandatit të përhershëm për gjyqtarët.
- » Ekzistencën e ligjeve që pengojnë që gjyqtarëve t'u jepen udhëzime nga ekzekutivi gjatë kohës që ushtrojnë rolin e tyre gjyqësor.
- » Sigurinë që nuk ka lidhje hierarkike mes gjyqtarëve dhe departamenteve që i emërojnë ata, për të garantuar që, pasi emërohen, ata nuk janë në pozicion varësie në lidhje me ata që i nominojnë ose i emërojnë.<sup>[80]</sup>

Gjykata ka gjetur shkelje të nenit 6 kur kryetari dhe nënkryetari i një divizioni për mosmarrëveshje në marinë u emëruan dhe u shkarkuan nga detyra prej Ministrit të Drejtësisë. Mungesa e mbrojtjes ndaj mos-shkarkimit të gjyqtarëve nënkuptonte që ata të mbeteshin në pozicion varësie hierarkike vis-à-vis Ministrit pas emërimit të tyre dhe prandaj nuk mund të shiheshin si të pavarur.<sup>[81]</sup>

Pavarësia po ashtu mund të dëmtohet kur një gjyqtar emërohet nga ose mban lidhje të afërta me palë të cilat kanë interes në rezultatin e procedurave para atij gjyqtari, deri në atë masë sa kjo lidhje me palët do të prekte ekuilibrin e interesave dhe vendimmarrjen e gjykatës gjatë vendosjes mbi mosmarrëveshjen ose pretendimin.<sup>[82]</sup>

Komisioni i Venecias,<sup>[83]</sup> KKGJE-ja<sup>[84]</sup> dhe Komiteti i Ministrave i KE-së<sup>[85]</sup> të gjithë rekomandojnë ngritjen e këshillave gjyqësore të pavarura ose organe të ngjashme, të pajisura me garanci kushtetuese në lidhje me përbërjen, fuqitë dhe autonominë e tyre, për të ushtruar ndikim vendimtar mbi vendimet lidhur me emërimin dhe karrierën e gjyqtarëve. Ato e pranojnë se në disa demokraci më të vjetra ekzekutivi mund të ketë njëfarë ndikimi tek emërimet gjyqësore. Megjithatë, kjo do të duhej të

80 *Clarke k. Mbretërisë së Bashkuar*, vendimi i 25 gushtit 2005, nr. 23695/02: thjesht fakti që gjyqtarët e rrethit dhe të qarkut ishin emëruar nga Lordi Kancelar nuk e dëmtonte pavarësinë e tyre, meqenëse nuk kishte lidhje hierarkike apo organizacionale mes gjyqtarëve dhe Departamentit të Lordit Kancelar, që do të thotë se nuk nuk kishte rrezik të presioneve të jashtme mbi gjyqtarët për të marrë vendime të caktuara për çështje të caktuara.

81 *Brudnicka k. Polonisë*, vendimi i 3 marsit 2005, nr. 54723/00.

82 *Langborger k. Suedisë*, vendimi i 22 qershorit 1989, nr. 11179/84 (përfshirë si përmbledhje në publikim): shkelje e nenit 6 kur kërkuesi kërkoi fshirjen e një klauzole negociuese nga kontrata e tij e qirasë, dhe anëtarët e gjykatës ishin nominuar nga dhe kishin lidhje të ngushta me dy shoqata të cilat kishin interes në vazhdimin e ekzistimit të kësaj klauzole; *Thaler k. Austrisë*, vendimi i 3 shkurtit 2005, nr. 58141/00: shkelje e nenit 6 kur vlerësuesit e emëruar nga Komisioni Rajonal i Apeleve ishin nominuar nga dhe kishin lidhje të afërta me dy organet të cilat kishin përpiluar marrëveshjen e përgjithshme për të cilën bëhej fjalë.

83 Raporti i Komisionit të Venedikut për Pavarësinë e Sistemit Gjyqësor Pjesa I.

84 KKGJE (2001) Op. N° 1.

85 Shih [https://search.coe.int/cm/Pages/result\\_details.aspx?ObjectID=09000016805afb78](https://search.coe.int/cm/Pages/result_details.aspx?ObjectID=09000016805afb78) "Rekomandimi CM/Rec(2010)12 i Komitetit të Ministrave drejtuar Shteteve Anëtare në lidhje me gjyqtarët: pavarësia, efikasiteti dhe përgjegjësitë", Komiteti i Ministrave i KE-së, 17 nëntor 2010, Kapitulli IV dhe Kapitulli VI §§ 46.

ndodhte vetëm kur: pushtete të tilla janë të kufizuara nga kultura dhe tradita ligjore të cilat kanë evoluar në kohë për të mbrojtur pavarësinë e gjyqësorit; kur ekzistojnë garanci që sigurojnë se procedurat për emërimin e gjyqtarëve janë transparente dhe të pavarura në praktikë; dhe kur vendimet për emërimin e gjyqtarëve merren duke u bazuar në kriteret objektive.

Edhe në sistemet ligjore ku standardet e mira janë respektuar për hir të traditës, nën vrotimin e shtypit të lirë, vitet e fundit është njohur gjithnjë e më shumë nevoja e mbrojtjes më objektive dhe formale të pavarësisë në procedurën e emërimeve. Për shembull, Karta Evropiane e Statutit për Gjyqtarët parashikon:

*“Në lidhje me çdo vendim që ka të bëjë me përzgjedhjen, punësimin, emërimin, përparimin në karrierë ose përfundimin e mandatit të një gjyqtari, statuti parashikon ndërhyrjen e një autoriteti të pavarur nga pushtetet ekzekutive dhe legjislative në të cilin të paktën gjysma e anëtarëve janë gjyqtarë të zgjedhur nga kolegët e tyre përmes metodave që garantojnë përfaqësimin më të gjerë të gjyqësorit.”<sup>[86]</sup>*

Prandaj, ndërkohë që Gjykata e pranon se ministrat e qeverisë dhe anëtarët e parlamentit mund të luajnë rol në nominimin dhe emërimin e gjyqtarëve, ngritja e një këshilli gjyqësor të pavarur, të përbërë kryesisht nga gjyqtarë të zgjedhur nga kolegët e tyre, me ndikim detyrues mbi vendimet emërimin dhe karrierën e gjyqtarëve, është mënyrë efektive për të siguruar që pavarësia e gjyqësorit nuk dëmtohet në fazën e emërimit.<sup>[87]</sup>

Në një vendim të rëndësishëm të GjDBE-së në lidhje me reformat gjyqësore në Poloni,<sup>[88]</sup> dhe në mënyrë të veçantë me pavarësinë e Dhomës Disiplinore të Gjykatës Supreme të Polonisë, GjDBE-ja ka përcaktuar tre kriteret që janë relevante për të arritur në përfundimin nëse një gjykatë, pavarësisht se është ngritur në përputhje me dispozitat ligjore nacionale, mund të konsiderohet e pavarur ose jo sipas të drejtës së BE-së. GjDBE-ja theksoi, së pari, se fakti që gjyqtarët e Dhomës Disiplinore emëroheshin nga Presidenti i Republikës, për se, nuk krijonte marrëdhënie varësie, në qoftë se kur vinin në detyrë gjyqtarët ishin të mbrojtur nga presionet e jashtme dhe nuk merrnin udhëzime nga ekzekutivi. Së dyti, GjDBE-ja theksoi se Dhoma Disiplinore ishte ngritur në të njëjtën kohë dhe kishte juridiksionin mbi të drejtën

86 Karta Evropiane për Statusin e Gjyqtarëve, § 1.3.

87 *Thiam k. Francës*, vendimi i 18 tetorit 2018, nr. 80018/12 (përfshirë si përmbledhje në publikim).

88 *A.K. k. Krajowa Rada Sądownicta dhe CP dhe DO k. Sądnajwyższy*, vendimi i 19 nëntorit 2019, nr. C-585/18, nr. C-624/18 dhe nr. C-625/18, §§ 133-134 (përfshirë si përmbledhje në publikim).

e Gjykatës Supreme të Polonisë e cila parashikonte pensionimin e hershëm të gjyqtarëve në detyrë të kësaj Gjykate Supreme<sup>[89]</sup>. Së treti, GjDBE-ja vuri në dukje se Dhoma Disiplinore, e cila gëzonte pothuajse autonomi të plotë nga Gjykata Supreme, përbëhej nga gjyqtarë të sapoemëruar e jo nga gjyqtarë në detyrë.<sup>[90]</sup> GjDBE-ja doli në përfundimin se këto tre elemente, të vlerësuara së bashku, mund të ngrinin dyshime rreth pavarësisë së Dhomës Disiplinore sipas Nenit 47 të Kartës së BE-së për të Drejtat Themelore.<sup>[91]</sup>

## Kualifikimet dhe trajnimi

Prania e gjyqtarëve dhe anëtarëve të gjyqësorit që janë profesionistë, të kualifikuar në mënyrë të ligjshme, është tregues i theksuar i pavarësisë dhe shihet si garanci kundër presioneve të jashtme.<sup>[92]</sup> Në fakt, Magna Carta e Gjyqtarëve parashikon që:

*“Trajnimi fillestar dhe gjatë detyrës është e drejtë dhe detyrë për gjyqtarët. Trajnimi / aftësimi është element i rëndësishëm për ruajtjen e pavarësisë së gjyqtarëve si dhe për cilësinë dhe efikasitetin e sistemit gjyqësor.”<sup>[93]</sup>*

Është në përputhje me nenin 6 që ndihmësgjyqtarët të marrin pjesë në gjykatë. Thjesht fakti që një anëtar i një gjykate nuk ka kualifikime apo trajnim ligjor nuk e skualifikon atë nga marrja pjesë në gjykatë dhe nuk është i mjaftueshëm për të hedhur dyshime mbi pavarësinë ose paanshmërinë e gjykatës. Megjithatë, duhet të ketë mbrojtje të mjaftueshme të pavarësisë së ndihmësgjyqtarëve, duke pasur parasysh se ata me gjasë nuk gëzojnë të njëjtën mbrojtje si gjyqtarët.<sup>[94]</sup> Për shembull,

89 A.K. k. *Krajowa Rada Sądowicta dhe CP dhe DO k. Sąd najwższy*, vendimi i 19 nëntorit 2019, nr. C-585/18, nr. C-624/18 dhe nr. C-625/18, §§ 147-149 (përfshirë si përmbledhje në publikim). Në lidhje me përputhshmërinë e Të Drejtës për Gjykatën Supreme me të drejtën e BE-së, shih *Komisioni k. Polonisë*, vendimi i Dhomës së Madhe i 24 qershorit 2019, nr. C-619/18 (përfshirë si përmbledhje në publikim).

90 A.K. k. *Krajowa Rada Sądowicta dhe CP dhe DO k. Sąd najwższy*, vendimi i 19 nëntorit 2019, nr. C-585/18, nr. C-624/18 dhe nr. C-625/18, §§ 150-151 (përfshirë si përmbledhje në publikim).

91 A.K. k. *Krajowa Rada Sądowicta and CP and DO k. Sąd najwższy*, vendimi i 19 nëntorit 2019, nr. C-585/18, C-624/18 dhe nr. C-625/18, § 153 (përfshirë si përmbledhje në publikim).

92 *Maktouf dhe Damjanović k. Bosnje dhe Hercegovinës*, vendimi i Dhomës së Madhe i 18 korrikut 2013, nr. 2312/08 dhe nr. 34179/08 (përfshirë si përmbledhje në publikim): ku fakti që gjyqtarët ndërkombëtarë të emëruar në Gjykatën e Shtetit ishin të deleguar nga mesi i gjyqtarëve profesionistë të vendeve të tyre respektive u gjet se përfaqëonte garanci shtesë kundër presioneve të jashtme.

93 Magna Carta e Gjyqtarëve, § 8.

94 *İbrahim Gürkan k. Turqisë*, vendimi i 3 korrikut 2012, nr. 10987/10: ku mungesa e kualifikimeve ligjore të oficerit ushtarak në trupën e gjykatës penale ushtarake nuk u konsiderua se pengonte pavarësinë ose paanshmërinë e tij,



mund të ekzistojë kriteri që gjyqtarët profesionistë të marrin pjesë në gjykatë krahas ndihmësgjyqtarëve, dhe/ose që gjyqtarët profesionistë të kenë votën vendimtare në çdo vendim që merret.<sup>[95]</sup> Në këtë aspekt, Gjykata gjithashtu ka theksuar se “...sa më lart që qëndron një gjykatë në hierarkinë gjyqësore, aq më të rrepta duhet të jenë kriteret e aplikueshme për përzgjedhjen.”<sup>[96]</sup>

## ii) Mandati në detyrë

### Shkarkimi

Gjykata përgjithësisht konsideron se mos-shkarkimi i gjyqtarëve gjatë mandatit të tyre në detyrë është element përbërës sa i përket pavarësisë<sup>[97]</sup> së tyre, dhe ajo ka gjetur shkelje të nenit 6 § 1 kur anëtarët e një gjykate mund të shkarkoheshin nga detyra prej një ministri të qeverisë.<sup>[98]</sup> Del problem me nenin 6 atëherë kur shkarkimi i gjyqtarëve vlerësohet se krijon marrëdhënie varësie hierarkike mes gjyqtarëve dhe ministrave që i emërojnë ata, duke dëmtuar kështu besimin tek pavarësia e gjyqësorit dhe duke mjegulluar dukjen e pavarësisë.<sup>[99]</sup>

Mungesa e njohjes formale që gjyqtarët janë të pashkarkueshëm në vetvete nuk është e barabartë me mungesën e pavarësisë, në qoftë se mos-shkarkimi i gjyqtarëve njihet në fakt dhe ekzistojnë garanci të tjera të nevojshme për pavarësinë.<sup>[100]</sup>

por ku Gjykata gjeti shkelje të nenit 6 për shkak se oficeri ushtarak mbetej në shërbim të ushtrisë, i nënshtrohej disiplinës ushtarake, dhe ishte emëruar si gjyqtar nga eprorët e tij në hierarki, që do të thotë se ai nuk gëzonte të njëjtat mbrojtje kushtetuese që kishin dy gjyqtarët e tjerë ushtarakë në gjykatën penale.

95 *Le Compte, Van Leuven dhe De Meyere k. Belgjikës*, vendimi i 23 qershorit 1981, nr. 6878/75 dhe nr. 7238/75: prania e fiks të njëjtit numër anëtarësh të gjyqësorit si edhe numri i mjekëve në Këshillin e Apeleve të Shoqatës së Mjekësisë, veçanërisht kur një anëtar i gjyqësorit vepronte gjithmonë si Kryetar, me të drejtë vote në Këshillin e Apeleve, e mbështeti përfundimin e Gjykatës se Këshilli ishte i pavarur.

96 *Guðmundur Andri Ástráðsson k. Islandës*, vendimi i Dhomës së Madhe i 1 dhjetorit 2020, nr. 26374/18, § 222 (përfshirë si përmbledhje në publikim).

97 *Campbell dhe Fell k. Mbretërisë së Bashkuar*, vendimi i 28 qershorit 1984, nr. 7819/77 dhe 7878/77 (përfshirë si përmbledhje në publikim).

98 *Brudnicka k. Polonisë*, vendimi i 3 marsit 2005, nr. 54723/00; ku gjyqtarët ishin të emëruar nga dhe gjithashtu mund të shkarkoheshin prej detyrës nga Ministri i Drejtësisë, në marrëveshje me Ministrin e Transportit dhe Çështjeve Detare.

99 *Brudnicka k. Polonisë*, vendimi i 3 marsit 2005, nr. 54723/00, § 41.

100 *Sacilor-Lormines k. Francës*, vendimi i 9 nëntorit 2006, nr. 65411/01; *Campbell dhe Fell k. Mbretërisë së Bashkuar*, vendimi i 28 qershorit 1984, nr. 7819/77 dhe nr. 7878/77, § 80 (përfshirë si përmbledhje në publikim).

Në një situatë ku nuk ka rregulla për mos-shkarkimin e gjyqtarëve, d.m.th. kur nuk ka dispozita që mundësojnë shkarkimin e gjyqtarëve e as dispozita që garantojnë mos-shkarkimin e tyre, Gjykata vlerëson nëse, në realitet, ekziston mundësia reale që një gjyqtar të shkarkohet gjatë mandatit në detyrë. Kur gjyqtari mund të shkarkohet vetëm në rrethanat më të jashtëzakonshme, kjo me gjasë nuk e dëmton pavarësinë e tij.<sup>[101]</sup>

Në qoftë se ekziston mundësia që gjyqtarët mund të shkarkohen nga detyra, duhet të ketë mbrojtje të mjaftueshme procedurale dhe substanciale për të siguruar që kjo mundësi nuk dëmton pavarësinë e tyre. Kështu është edhe kur fuqia për të shkarkuar një gjyqtar përdoret rrallë, ose kurrë, për shkak se ekzistenca e kësaj mundësie ende mund të dëmtojë besimin tek gjyqësori dhe dukjen e pavarësisë.<sup>[102]</sup> Shembuj të mbrojtjeve të cilat mund të ndihmojnë për të mbrojtur pavarësinë kur ekziston mundësia e shkarkimit përfshijnë:<sup>[103]</sup>

- » Përcaktimi i qartë në ligj i bazave faktike mbi të cilat një gjyqtar mund të shkarkohet nga detyra.
- » Kufizimi i bazave mbi të cilat një gjyqtar mund të shkarkohet, për shembull vetëm për arsye paaftësie ose sjelljeje të pahijshme, dhe përjashtimi i mundësisë që gjyqtarët të shkarkohen për përmbajtjen e vendimmarrjes së tyre gjyqësore.

101 *Campbell dhe Fell k. Mbretërisë së Bashkuar*, vendimi i 28 qershorit 1984, nr. 7819/77 dhe nr. 7878/77, § 80 (përfshirë si përmbledhje në publikim): ku nuk kishte rregulla për shkarkimin e anëtarëve të një Bordi, e as garanci për mos-shkarkimin e tyre. U duk se Sekretari i Brendshëm mund të kërkonte dorëheqjen e një anëtari, por se një gjë e tillë do të bëhej vetëm në rrethanat më të pazakonta. Prandaj ekzistenca e kësaj mundësie nuk u pa si kërcënim për pavarësinë e anëtarëve të një Bordi.

102 *Henryk Urban dhe Ryszard Urban k. Polonisë*, vendimi i 30 nëntorit 2010, nr. 23614/08 (përfshirë si përmbledhje në publikim): një dispozitë legjislative që lejonte Ministrin e Drejtësisë të shkarkonte ndihmësgjyqtarët u gjet se shkelte nenin 6 § 1 pavarësisht nga fakti se Ministri nuk e kishte përdorur asnjëherë fuqinë e tij për të shkarkuar një ndihmësgjyqtar, sepse ekzistenca e dispozitës ishte e mjaftueshme për të minuar dukjen e pavarësisë.

103 *Henryk Urban dhe Ryszard Urban k. Polonisë*, vendimi i 30 nëntorit 2010, nr. 23614/08 (përfshirë si përmbledhje në publikim): u gjet se kishte mbrojtje të pamjaftueshme procedurale dhe substanciale për shkak se ligjet që jepnin fuqinë për të shkarkuar ndihmësgjyqtarët nuk specifikonin se çfarë bazash faktike mund të shërbenin si bazë për të shkarkuar një ndihmësgjyqtar, vendimi për shkarkim u mor nga Ministri e jo nga një gjykatë, dhe kishte garanci të pamjaftueshme në lidhje me mandatin e ndihmësgjyqtarëve sepse ata nuk punësoheshin për një periudhë të caktuar minimale. Nga ana tjetër, tek *Campbell dhe Fell k. Mbretërisë së Bashkuar*, vendim i 28 qershorit 1984, nr. 7819/77 dhe nr. 7878/77, (përfshirë si përmbledhje në publikim), anëtarët e Bordit ishin të emëruar për mandate të fiksuara 3-vjeçare, dhe tek *Clarke k. Mbretërisë së Bashkuar*, vendimi i 25 gushtit 2005, nr. 23695/02, vendimet për të shkarkuar gjyqtarët e qarkut dhe të rrethit u nënshtuan shqyrtimit gjyqësor, dhe bazat mbi të cilat ata mund të shkarkoheshin u kufizuan me paaftësi dhe sjellje të pahijshme.

- » Garantimi që çdo vendim për shkarkimin e një gjyqtari t'i nënshtrohet shqyrtimit gjyqësor efektiv.<sup>[104]</sup>
- » Emërimi i gjyqtarëve me mandate të fiksuara minimale.

### Kohëzgjatja e mandatit

---

Mandatet e fiksuara të detyrës për gjyqtarët zakonisht shihen si garanci e pavarësisë, por vetëm në qoftë se kohëzgjatja është mjaftueshëm e gjatë. Megjithatë, Gjykata nuk ka përcaktuar kohëzgjatjen minimale të mandatit që kërkohet për të mbrojtur pavarësinë. Marrja në konsideratë e faktit nëse kohëzgjatja e mandatit mjafton për të mbrojtur pavarësinë varet nga konteksti më i gjerë, përfshirë mbrojtjet e tjera që ekzistojnë. Për shembull:

- » Mandati gjashtë-vjeçar është gjetur se përbën mbrojtje të mjaftueshme.<sup>[105]</sup>
- » Mandatet tre-vjeçare konsideroheshin të shkurtra, por të pranueshme, kur pozitat gjyqësore në fjalë ishin të papaguara dhe ku do të kishte qenë e vështirë të gjindeshin vullnetarë sikur mandatet të ishin më të gjata.<sup>[106]</sup>
- » Mandatet katër-vjeçare për gjyqtarët ushtarakë janë konsideruar tepër të shkurtra kur aspekte të tjera të statusit të gjyqtarëve e vinin pavarësinë e tyre në pikëpyetje, për shembull për shkak se gjyqtarët ishin shërbyes të cilët vazhdonin të ishin të varur ndaj disiplinës ushtarake dhe mandatet e të cilëve nuk mund të rinovoheshin.
- » Mandatet katër-vjeçare për gjyqtarët ushtarakë, në kontekste të tjera, është konsideruar se ishin të mjaftueshme, për shembull kur gjyqtarët ishin zgjedhur në mesin e gjyqtarëve ushtarakë, ata nuk mund të shkarkoheshin me vendim të ekzekutivit ose të hierarkisë ushtarake gjatë mandatit të tyre, dhe nuk i nënshtroheshin ndonjë vlerësimi gjatë mandatit nga autoritetet ekzekutive ose ushtarake.

Standardet ndërkombëtare pohojnë se kusht i nevojshëm për një gjyqësor të pavarur është që gjyqtarët të kenë sigurinë e qëndrimit në detyrë dhe të mos i nënshtrohen shkarkimit arbitrar nga detyra. Për shembull, parimet bazë të OKB-së parashikojnë që:

---

104 *Clarke k. Mbretërisë së Bashkuar*, vendimi i 25 gushtit 2005, nr. 23695/02.

105 *Le Compte, Van Leuven dhe De Meyere k. Belgjikës*, vendimi i 23 qershorit 1981, nr. 6878/75 dhe nr. 7238/75.

106 *Campbell dhe Fell k. Mbretërisë së Bashkuar*, vendimi i 28 qershorit 1984, nr. 7819/77 dhe nr. 7878/77, (përfshirë si përmbledhje në publikim).

“11. Mandati i gjyqtarëve, pavarësia e tyre, siguria, shpërblimi i përshtatshëm, kushtet e shërbimit, pensionet dhe mosha e pensionimit të tyre duhet të jenë mjaftueshëm të garantuara me ligj.

12. Gjyqtarët, pavarësisht nëse janë të emëruar ose të zgjedhur, duhet të kenë qëndrim të garantuar në detyrë deri në një moshë të detyrueshme pensionimi ose deri në skadimin e mandatit të tyre në detyrë, kur kjo ekziston.”<sup>[107]</sup>

### iii) Garancitë kundër presioneve të jashtme

Për të mbrojtur pavarësinë gjyqësore, duhet të ketë garanci që sigurojnë se gjyqtarët janë të lirë nga ndikimet e papërshtatshme si nga brenda ashtu edhe nga jashtë gjyqësorit. Kjo përfshin të siguruarit që gjyqtarët të jenë të lirë nga presionet ose udhëzimet nga kolegët gjyqtarë, ata që kanë përgjegjësi administrative në gjykatë siç është kryetari i gjykatës ose kryetari i një divizioni të gjykatës, përveç garancive kundër ndikimeve të jashtme, për shembull nga palët në procedura, anëtarët e qeverisë ose parlamentit dhe çdo organ tjetër i jashtëm.<sup>[108]</sup>

Garanci të tilla mund të përfshijnë mbrojtjet kundër sanksioneve dhe shkarkimit nga detyra për arsye të paduhura, të siguruarit që gjyqtarët të mos i nënshtrohen udhëzimeve dhe të mos jenë në pozicion varësie hierarkike, ku një hierarki e tillë mund të ndikonte në pavarësinë e vendimmarrjes së tyre.

### Mbrojtjet kundër sanksioneve dhe shkarkimit nga detyra

Siç u diskutua në paragrafin i) lart, siguria e qëndrimit në detyrë vlerësohet nga Gjykata të jetë mbrojtje e rëndësishme kundër presioneve dhe ndikimit politik.<sup>[109]</sup>

Në lidhje me shkarkimin dhe sanksionimin e gjyqtarëve, faktorët relevantë për mbrojtjen e pavarësisë së tyre përfshijnë: arsyet për të cilat gjyqtarët mund të shkarkohen dhe/ose të sanksionohen; kush ose cili organ zhvillon procedurat disiplinore kundër tyre; dhe drejtësia procedurale e procedurave disiplinore ose të shkarkimit, përfshirë faktin nëse vendimi për të shkarkuar ose sanksionuar një gjyqtar i nënshtrohet shqyrtimit gjyqësor.<sup>[110]</sup>

107 Parimet Bazë të OKB-së.

108 *Agrokompleks k. Ukrainës*, vendimi i 6 tetorit 2011, nr. 23465/03, § 137 (përfshirë si përmbledhje në publikim).

109 *Thiam k. Francës*, vendimi i 18 tetorit 2018, nr. 80018/12 (përfshirë si përmbledhje në publikim).

110 *Baka k. Hungarisë*, vendimi i Dhomës së Madhe i 23 qershorit 2016, nr. 20261/12, (përfshirë si përmbledhje në publikim):

Çdo vendim për të sanksionuar ose shkarkuar një gjyqtar duhet të jetë i hapur për shqyrtim nga një organ që ushtron fuqi gjyqësore. Nuk është problem në qoftë se organi që shqyrtonte vendimin disiplinor gjithashtu i nënshtrohet të njëjtit organ disiplinor, të njëjtave rregullore dhe sanksione si edhe pala në procedurë,<sup>[111]</sup> për sa kohë që ekzistojnë masa të mjaftueshme për të mbrojtur pavarësinë e organit shqyrtues nga organi disiplinor.<sup>[112]</sup> Gjykata e pranon se të gjithë gjyqtarët i nënshtrohen ligjit në përgjithësi, dhe rregullave të disiplinës dhe etikës profesionale, dhe se, gjatë kryerjes së detyrave të tyre gjyqësore, atyre mund t'u duhet që të shqyrtojnë çështje të shumëllojshme duke e ditur se, në një pikë të caktuar të karrierës së tyre, ata vetë mund të gjenden në pozicion të ngjashëm me ndonjë palë, përfshirë ndonjë të pandehur. Një rrezik thjesht abstrakt i llojit të tillë nuk mund të shihet si i aftë për të hedhur dyshime mbi pavarësinë e një gjyqtari në mungesë të rrethanave specifike në lidhje me situatën individuale të tij/saj.

Gjykata ka theksuar rëndësinë gjithnjë e më të madhe që instrumentet ndërkombëtare dhe ato të KE-së, si dhe praktika e gjykatave ndërkombëtare dhe praktika e organeve të tjera ndërkombëtare, i japin drejtësisë procedurale në çështjet që kanë të bëjnë me shkarkimin ose heqjen e gjyqtarëve, dhe këqyrin me shumë kujdes çdo pretendim që mandatet gjyqësore janë përfunduar para kohe. Gjykata ka cituar instrumentet ndërkombëtare dhe ato të KE-së të cilat propozojnë mbrojtjet e mëposhtme të pavarësisë:<sup>[113]</sup>

shkelje e nenit 6 ku mandati i Kryetarit të Gjykatës Supreme u përfundua para kohe për shkak të pikëpamjeve dhe qëndrimeve që ai kishte shprehur publikisht në cilësinë e tij zyrtare dhe ku përfundimi i mandatisë të tij as nuk u shqyrtua, as nuk qe i hapur për shqyrtim nga asnjë organ që ushtronte fuqi gjyqësore.

111 *Ramos Nunes de Carvalho e Sá k. Portugalisë*, vendimi i Dhomës së Madhe i 6 nëntorit 2018, nr. 55391/13, 57728/13 dhe 74041/13, §§ 157-165 (përfshirë si përmbledhje në publikim), ku Divizioni Gjyqësor i Gjykatës Supreme shqyrtoi një apel kundër një vendimi disiplinor të Këshillit të Lartë të Gjyqësorit, por gjithashtu vetë i nënshtrohej fuqive disiplinore të Këshillit të Lartë. Kjo nuk u gjet të ishte problem, në mënyrë të veçantë sepse gjyqtarët e Gjykatës Supreme u gjetën se ishin tepër të kualifikuar dhe shpesh në fazat e fundit të karrierës së tyre, që do të thotë se ata nuk kalonin më nëpër vlerësimin e performancës së tyre e as nuk kërkonin ngritje në detyrë, dhe autoriteti disiplinor i KLGJ-së mbi ta në fakt ishte më shumë teorik.

112 *Ramos Nunes de Carvalho e Sá k. Portugalisë*, vendimi i Dhomës së Madhe i 6 nëntorit 2018, nr. 55391/13, 57728/13 dhe 74041/13, §§ 157-165; ku Gjykata krahasoi vendimin e saj me vendimin tek *Oleksandr Volkov k. Ukrainës*, vendimi i 6 shkurtit 2018, nr. 21722/11 (përfshirë si përmbledhje në publikim); në çështjen e fundit, fakti që gjyqtarët e Gjykatës së Lartë Administrative (GJLA) ishin nën juridiksionin disiplinor të Këshillit të Lartë të Drejtësisë së Ukrainës (KLD) u gjet se ishte problem sepse KLD-ja kishte fuqi të gjera në lidhje me karrierën e gjyqtarëve në GJLA (emërimi, disiplinimi dhe shkarkimi) dhe se mungonin mbrojtje të rëndësishme për pavarësinë dhe paanshmërinë e KLD-së, përfshirë shumë mangësi të tjera strukturore në procedurat para KLD-së dhe dukjes së njëanshmërisë mbi baza të tjera.

113 *Baka k. Hungarisë*, vendimi i Dhomës së Madhe i 23 qershorit 2016, nr. 20261/12, §§ 72-86 (përfshirë si përmbledhje në publikim).

- » Gjyqtarët t'i nënshtrohen pezullimit ose shkarkimit vetëm për arsye të paaftësisë së vërtetuar, shpalljes fajtor për një krim ose sjellje që i bën të paaftë për të zhvilluar detyrat profesionale.<sup>[114]</sup>
- » Të përgatiten dhe të shpërndahen standarde për të përcaktuar jo vetëm sjelljet që mund të çojnë drejt shkarkimit nga detyra, por gjithashtu çdo sjellje që mund të çojë drejt hapave disiplinorë ose ndryshimit të statusit, përfshirë, për shembull, lëvizjen në një gjykatë tjetër ose një zonë tjetër.<sup>[115]</sup>
- » Vendimet në procedurat disiplinore, të pezullimit ose të shkarkimit të kalojnë nëpër shqyrtim të pavarur<sup>[116]</sup> me mundësinë e rekursit para gjykatës.<sup>[117]</sup>

### Marrëdhëniet hierarkike dhe udhëzimet dhënë gjyqtarëve

#### Pavarësia e brendshme gjyqësore

Pavarësia gjyqësore kërkon që gjyqtarët individualë të jenë të lirë nga ndikimet e papërshtatshme – jo vetëm nga jashtë gjyqësorit, por edhe nga brenda tij. Mungesa e mbrojtjeve të mjaftueshme që sigurojnë pavarësinë e gjyqtarëve karshi eprrorëve të tyre gjyqësorë mund ta çojë Gjykatën në përfundimin se dyshimet e një kërkuesi për pavarësinë dhe paanshmërinë e një gjykate mund të thuhet se mund të kenë qenë objektivist të justifikuar.<sup>[118]</sup>

Varësia e një gjykate më të ulët ndaj një gjykate më të lartë ka gjasa të shkaktojë probleme në lidhje me pavarësinë kur një gjykatë më e lartë i jep udhëzime direkte

114 Parimet Bazë të OKB-së, § 18; shih gjithashtu fjalën hyrëse të Raportuesit të Posaçëm në Forumin e gjashtë vjetor të Gjyqtarëve dhe Avokatëve në Gjenevë, i organizuar nga Komisioni Ndërkombëtar i Juristëve, i cili u përqendrua tek llogaridhënia juridike, 14 dhjetor 2015; [https://search.coe.int/cm/Pages/result\\_details.aspx?ObjectID=09000016805afb78](https://search.coe.int/cm/Pages/result_details.aspx?ObjectID=09000016805afb78): Rekomandimi CM/Rec(2010)12 i Komitetit të Ministrave drejtuar Shteteve Anëtare në lidhje me gjyqtarët: pavarësia, efikasiteti dhe përgjegjësitë, Komiteti i Ministrave i KE-së, 17 nëntor 2010, §50: “Një emërim i përhershëm duhet të përfundohet vetëm në rastet e shkeljeve të rënda të dispozitave disiplinore ose penale të përcaktuara me ligj, ose kur një gjyqtar/e nuk është më në gjendje të kryejë funksionet gjyqësore. Pensionimi i parakohshëm duhet të jetë i mundur vetëm me kërkesë të gjyqtarit/es në fjalë ose për arsye mjekësore.”

115 KKGJE (2001) Op. N° 1, §60.

116 Parimet Bazë të OKB-së, § 20.

117 Magna Carta e Gjyqtarëve, §6; shih gjithashtu KKGJE (2001) Op. N° 1, §59: Shtetet do të duhej të mendonin për ngritjen, me ligj, të një organi të veçantë kompetent i cili të ketë për detyrë zbatimin e çdo lloji sanksioni dhe mase disiplinore, ku me të nuk merret asnjë gjykatë, dhe vendimet e të cilit kontrollohen nga një organ gjyqësor më i lartë, ose i cili është vetë organ gjyqësor më i lartë.

118 *Agrokompleks k. Ukrainës*, vendimi i 6 tetorit 2011, nr. 23465/03, § 137.

një gjykatë më të ulët, ose kur gjykata më e lartë ka kontroll efektiv mbi karrierat e gjyqtarëve të gjykatës më të ulët.<sup>[119]</sup>

### Pavarësia e jashtme

Kur anëtarët e një gjykatë janë për nga hierarkia të varur nga ekzekutivi, edhe kjo shkakton mangësi në lidhje me pavarësinë. Për shembull, kur anëtarët e një gjykatë janë gjithashtu të punësuar nga departamentet e qeverisë dhe janë, në aspektin material, hierarkik dhe administrativ, të varur nga ekzekutivi për të ardhurat e tyre dhe pozicionin e tyre në gjykatë.<sup>[120]</sup>

Më tej, gjyqtarët nuk mund të marrin udhëzime nga ministrat gjatë kryerjes së rolit të tyre gjykuës. Megjithatë, mund jetë në përputhje me kriterin e pavarësisë që një ministër të lëshojë direktiva të përgjithshme në lidhje me kryerjen e funksioneve të tyre.<sup>[121]</sup>

### **iv) Dukja e pavarësisë**

---

Për të përcaktuar nëse një gjykatë mund të konsiderohet se është e pavarur siç kërkohet nga neni 6 § 1, është gjithashtu e nevojshme të vlerësohet nëse një gjykatë paraqet dukjen e pavarësisë.<sup>[122]</sup> Dukja e pavarësisë është e rëndësishme për të ruajtur besimin që gjykatat në shoqëri demokratike duhet të frymëzojnë tek publiku e mbi të gjitha, sidomos kur bëhet fjalë për procedura penale, tek të akuzuarit.<sup>[123]</sup>

Pra, kur një palë ka dyshime legjitime rreth pavarësisë së një gjykatë, kjo mund të ngrejë çështje sipas nenit 6, edhe kur kanë dalur probleme lidhur me pavarësinë si çështje fakti.<sup>[124]</sup>

---

119 *Findlay k. Mbretërisë së Bashkuar*, vendimi i 25 shkurtit 1997, nr. 22107/93 (përfshirë si përmbledhje në publikim); *Ibrahim Gürkan k. Turqisë*, vendimi i 3 korrikut 2012, nr. 10987/10; *Agrokompleks k. Ukrainës*, vendimi i 6 tetorit 2011, nr. 23465/03.

120 *Oleksandr Volkov k. Ukrainës*, vendimi i 6 shkurtit 2018, nr. 21722/11 (përfshirë si përmbledhje në publikim).

121 *Campbell dhe Fell k. Mbretërisë së Bashkuar*, vendimi i 28 qershorit 1984, nr. 7819/77 dhe 7878/77, (përfshirë si përmbledhje në publikim).

122 *Sramek k. Austrisë*, vendimi i 22 tetorit 1984, nr. 8790/79, § 42 (përfshirë si përmbledhje në publikim).

123 *Incal k. Turqisë*, vendimi i Dhomës së Madhe i 9 qershorit 1998, nr. 22678/93, § 71.

124 *Sramek k. Austrisë*, vendimi i 22 tetorit 1984, nr. 8790/79, § 42 (përfshirë si përmbledhje në publikim): Gjykata nuk u kufizua me pasojat që mund kishte pasur konkretisht statusi i varur i raportuesit (anëtar i gjykatës) karshi Zyrtarit të Transaksioneve (palë në procedurë). Për shkak se anëtarët e gjykatës përfshinin një person i cili ishte në pozitë varësie, sa i përkiste detyrave të tij dhe organizimit të shërbimit të tij, karshi njëres prej palëve, dyshimet e palës paditëse rreth

Ndërkohë që qëndrimi i palëve është i rëndësishëm, ai nuk është vendimtar. Shqetësimet e tyre, deri në njëfarë mase, duhet të jenë objektivisht të justifikuara.<sup>[125]</sup> Me nenin 6 del problem në lidhje me pavarësinë në qoftë se “një vëzhgues objektiv” sheh arsye për t’u shqetësuar në rrethanat e çështjes në fjalë.<sup>[126]</sup> Për shembull, në situatat e mëposhtme, Gjykata nuk gjeti se shqetësimet e palëve rreth pavarësisë ishin objektivisht të justifikuara:

- » Kur Bordi përgjegjës për gjykimin e ankesave të të burgosurve kundër administratës së burgut gjithashtu kryente një sërë rolesh administrative në burg dhe kishte kontakte të shpeshta me administratën e burgut. Ndërkohë që Gjykata e pranoi se Bordi mund të perceptohej si ‘i lidhur nga afër’ me ekzekutivin dhe administratën e burgut, kjo nuk mjaftonte për të treguar mungesë pavarësie, meqenëse Bordi nuk ishte fare i varur nga menaxhmenti i burgut. Përshtypja e të burgosurve u vlerësua se ishte ‘e pashmangshme’ në kushtet e mbajtjes të mbyllur, por nuk ishte e justifikueshme për një vëzhgues objektiv.<sup>[127]</sup>
- » Kur Lordi Kancelar kishte fuqinë për të shkarkuar gjyqtarët e qarkut dhe të rrethit të cilët vendosën në procedurën e kërkuesve kundër Departamentit të Lordit Kancelar. Gjykata gjeti se një vëzhgues objektiv nuk do të kishte pasur arsye për t’u shqetësuar rreth shkarkimit të një gjyqtari në kushtet e kësaj çështjeje sepse: nuk kishte pasur raste kur fuqia e shkarkimit kishte prekur paanshmërinë; në fakt, nuk kishte pasur praktikisht asnjë rast të shkarkimit të ndonjë gjyqtari rrethi ose qarku nga Lordi Kancelar; dhe fuqia e shkarkimit i nënshtrohej shqyrtimit gjyqësor.<sup>[128]</sup>

Dështimi për të paraqitur dukjen e pavarësisë, megjithatë, ka kontribuar në gjetjen e shkëljes së nenit 6 në shumë çështje. Në disa çështje ka qenë vendimtar, edhe kur ka pasur mbrojtje të tjera të vendosura. Për shembull:

- » Kur një anëtar i policisë shërbeu në Bordin e Policisë në cilësinë e tij personale. Megjithëse ai nuk i nënshtrohej urdhrave, kishte bërë betimin dhe nuk mund

---

pavarësisë së atij personi u gjet se ishin legjitime. Një situatë e tillë u gjet se ndikonte seriozishtë besimin publik tek gjykatat, që do të thotë se kishte shkëlje të nenit 6.

125 *Sacilor-Lormines k. France*, vendimi i 9 nëntorit 2006, nr. 65411/01, § 63.

126 *Clarke k. Mbretërisë së Bashkuar*, vendimi i 25 gushtit 2005, nr. 23695/02; *Campbell dhe Fell k. Mbretërisë së Bashkuar*, vendimi i 28 qershorit 1984, nr. 7819/77 dhe nr. 7878/77. (përfshirë si përmbledhje në publikim).

127 *Campbell dhe Fell k. Mbretërisë së Bashkuar*, vendimi i 28 qershorit 1984, nr. 7819/77 dhe nr. 7878/77, § 81 (përfshirë si përmbledhje në publikim).

128 *Clarke k. Mbretërisë së Bashkuar*, vendimi i 25 gushtit 2005, nr. 23695/02.



të shkarkohej, Gjykata gjeti shkelje të nenit 6 sepse ai ishte një shërbyes civil që iu kthye detyrave të departamentit të tij, që do të thotë se ai mund të shihej si anëtar i forcës policore i varur nga eprorët dhe besnik ndaj kolegëve, gjë që mund të dëmtonte besimin që duhet të frymëzojnë gjykatat.<sup>[129]</sup>

- » Kur një prej gjyqtarëve të një Gjykate të Sigurisë Kombëtare ishte gjyqtar ushtarak, ndërsa kërkuesi ishte civil. Gjykata vendosi që kishte shkelje të nenit 6 § 1 sepse kërkuesi mund të kishte frikë legjitime që gjyqtari ushtarak mund t'i lejonte vetes që të ndikohej në mënyrë të papërshtatshme nga konsiderata të cilat nuk kishin të bënin fare me natyrën e çështjes.<sup>[130]</sup>
- » Kur një Përmbaues i pranishëm në Gjykatën Mbretërore kishte qenë i përfshirë fillimisht, personalisht dhe drejtpërdrejt në një çështje gjatë kohës që ai kryesonte Diskutimet e Shtetit në kohën kur u miratua Plani Zhvillimor. Megjithëse u vendos që në atë çështje nuk vihej në pyetje njëanshmëria e Përmbauesit, Gjykata gjeti shkelje të nenit 6 sepse ky akumulim funksionesh i jepte shkas dyshimeve në lidhje me pavarësinë dhe paanshmërinë e tij.<sup>[131]</sup>

### Fuqia për të marrë vendime detyruese pa u modifikuar nga organet jogjyqësore

Respekti nga organet e tjera të shtetit në lidhje me autoritetin e gjykatave është parakusht i domosdoshëm për besimin publik tek gjykatat dhe, më gjerësisht, për shtetin e së drejtës.<sup>[132]</sup> Prandaj, për të mbrojtur pavarësinë gjyqësor, autoritetet ekzekutive nuk duhet të ndërhyjnë në procedura gjyqësore, për shembull ato nuk duhet të tentojnë anulimin e vendimeve ose vënien mënjane të vendimeve përfundimtare.<sup>[133]</sup>

Fuqia për të marrë vendime detyruese të cilat nuk mund të modifikohen nga autoritete jo-gjyqësore është i ngërthyer në garancitë e nenit 6.<sup>[134]</sup> Ekzistenca e fuqisë së një ministri për të vënë mënjane vendimet e marra nga një gjykatë mund të dëmtojë pavarësinë e një gjykate, edhe kur një pushtet i tillë duket se nuk ushtrohet në praktikë.<sup>[135]</sup> Më tej, nuk ka rëndësi nëse ndërhyrjet nga degët ekzekutive ose legjislative të qeverisë faktikisht ndikojnë në rrjedhën e procedurave. Ekzistenca e

129 *Belilos k. Zvicrës*, vendimi i 28 prillit 1988, nr. 10328/83 (përfshirë si përmbledhje në publikim).

130 *Incal k. Turqisë*, vendimi i Dhomës së Madhe i 9 qershorit 1998, nr. 22678/93.

131 *McGonnell k. Mbretërisë së Bashkuar*, vendimi i 8 shkurtit 2000, nr. 28488/95, (përfshirë si përmbledhje në publikim).

132 *Agrokompleks k. Ukrainës*, vendimi i 6 tetorit 2011, nr. 23465/03, § 137, (përfshirë si përmbledhje në publikim).

133 *Sovtransavto Holding k. Ukrainës*, vendimi i 25 korrikut 2002, nr. 48553/99.

134 *Van de Hurk k. Holandës*, vendimi i 19 prillit 1994, nr. 16034/90 (përfshirë si përmbledhje në publikim).

135 *Van de Hurk k. Holandës*, vendimi i 19 prillit 1994, nr. 16034/90 (përfshirë si përmbledhje në publikim).

një fuqje të tillë ose fakti i një tentative të tillë tregon mungesë respekti për detyrën gjyqësore, çka në vetvete është në papajtueshmëri me nocionin e “gjykatës së pavarur dhe të paanshme” brenda kuptimit të nenit 6 § 1 të Konventës.<sup>[136]</sup>

---

136 *Agrokompleks k. Ukrainës*, vendimi i 6 tetorit 2011, nr. 23465/03, § 134, (përfshirë si përmbledhje në publikim).

## (6) PAANSHMËRIA

### a) Të Përkufizuarit e paanshmërisë

Paanshmëria e gjyqtarëve është një kriter tjetër institucional që duhet të përmbushet për t'u plotësuar kërkesat e nenit 6 § 1. Ky kriter është po aq i rëndësishëm sa edhe pavarësia, dhe Gjykata zakonisht i analizon pavarësinë dhe paanshmërinë së bashku.

Paanshmëria i referohet mungesës së paragjytimeve ose anësisë nga një gjykatë ose një gjyqtar individual.<sup>[137]</sup>

Ekzistenca e paanshmërisë, ose mungesa e saj, mund të testohet në mënyra të ndryshme. Për shembull, Gjykata merr parasysh paanshmërinë objektive dhe subjektive të një gjyqtari ose gjykate për të përcaktuar nëse ato janë në përputhje me kërkesat e nenit 6. Gjykata po ashtu ka identifikuar lloje të ndryshme të situatave në të cilat mund të dalë çështja e mungesës së paanshmërisë gjyqësore, përfshirë situata të natyrës funksionale dhe ato që kanë të bëjnë me karakterin dhe sjelljen personale të një gjyqtari. Secila prej këtyre kategorive diskutohet me hollësi më poshtë.

Është përgjegjësi parësore e çdo gjyqtari/eje individual/e që të identifikojë çdo pengesë ndaj pjesëmarrjes së tij/saj në procedurë dhe ose të tërhiqet ose, kur përballlet me një situatë në të cilën është e diskutueshme nëse ai/ajo do të duhej të skualifikohet, sadoqë ligji nuk e përjashton në mënyrë të qartë, ta sjellë çështjen në vëmendje të palëve për t'u lejuar atyre që ta kontestojnë pjesëmarrjen e tij/saj.<sup>[138]</sup>

### b) Paanshmëria objektive dhe subjektive

Në lidhje me paanshmërinë objektive dhe subjektive, Gjykata është shprehur se nuk ka një ndarje të theksuar mes këtyre dy nocioneve.<sup>[139]</sup> E njëjta situatë, ose e njëjta sjellje e një gjyqtari, mund të shkaktojë shqetësime në sytë e një vëzhguesi (testi objektiv) dhe gjithashtu mund t'u japë shkas dyshimeve rreth bindjeve personale të gjyqtarit (testi subjektiv). Nëse një çështjeje i bie të trajtohet sipas njërit test ose tjetrit, ose të dyve, kjo varet nga faktet e veçanta të sjelljes së kontestuar.<sup>[140]</sup>

137 *Micallef k. Maltës*, vendimi i Dhomës së Madhe i 15 tetorit 2009, nr. 17056/06, § 93 (përfshirë si përmbledhje në publikim).

138 *Sigriður Elín Sigfúsdóttir k. Islandës*, vendimi i 25 shkurtit 2020, nr. 41382/17, § 35.

139 *Kyprianou k. Qipros*, vendimi i Dhomës së Madhe i 15 dhjetorit 2005, nr. 73797/01, § 119.

140 *Kyprianou k. Qipros*, vendimi i Dhomës së Madhe i 15 dhjetorit 2005, nr. 73797/01, § 95.

## i) Paanshmëria subjektive

Testi subjektiv i paanshmërisë kërkon vlerësimin e faktit nëse një gjyqtar/e ka ndonjë paragjykim ose anësi personale në një çështje të dhënë. Bindjet personale, interesat dhe sjellja e një gjyqtari/eje në një çështje të caktuar janë të gjitha aspekte relevante për të përcaktuar paanshmërinë subjektive të tij/saj, për shembull kur një gjyqtar/e shprehet me tone të ashpra për arsye personale ndaj palëve në procedurë.<sup>[141]</sup>

Gjatë zbatimit të testit subjektiv, Gjykata në vazhdimësi është shprehur se paanshmëria personale e një gjyqtari duhet të presupozohet deri në momentin kur nuk ka prova për të kundërtën.<sup>[142]</sup> Prandaj mund të jetë e vështirë (sadoqë natyrisht jo e pamundur) të konstatohet shkelja e nenit 6 për shkak të paanshmërisë subjektive. Për shkak të kësaj vështirësie, Gjykata shpesh përqendrohet në testin objektiv të paanshmërisë<sup>[143]</sup>, dhe në çështjet ku është e vështirë të provohet mungesa e paanshmërisë subjektive ende mund të jetë e mundur të provohet mungesa e paanshmërisë objektive.

Megjithatë, sjellja e gjyqtarëve mund të jetë e mjaftueshme për të arritur në përfundimin se ka shkelje të kriterit të paanshmërisë sipas testit subjektiv. Për shembull: pranimi i ndjenjave personale pas veprimeve të ndonjërisë palë në gjyq; përdorimi i gjuhës së theksuar gjatë procedurave; dhe shprehja e opinionëve rreth fajësisë së kërkuesit/es në fazat e hershme të një gjyqi, mund të çojnë në gjetjen e shkeljes së paanshmërisë sipas testit subjektiv.<sup>[144]</sup>

## ii) Paanshmëria objektive

Testi objektiv i paanshmërisë përfshin përcaktimin e faktit nëse, përveç sjelljes personale të gjyqtarit, ekzistojnë fakte të vërtetueshme të cilat i japin shkas dyshimeve ose frikës legjitime që një gjyqtari ose gjykate të caktuar i mungon paanshmëria. Për shembull, për shkak se një gjyqtar ka lidhje hierarkie ose personale me palët e tjera në procedura,<sup>[145]</sup> ose për shkak se një gjyqtar ka rol të dyfishtë ose role të shumta në të njëjtat procedura.<sup>[146]</sup>

141 *De Cubber k. Belgjikës*, vendimi i 26 tetorit 1984, nr. 9186/80, § 25 (përfshirë si përmbledhje në publikim).

142 *Kyprianou k. Qipros*, vendimi i Dhomës së Madhe i 15 dhjetorit 2005, nr. 73797/01, § 119; *Hauschildt k. Danimarkës*, vendimi i 24 majit 1989, nr. 10486.83, § 47.

143 *Micallef k. Maltës*, vendimi i Dhomës së Madhe i 15 tetorit 2009, nr. 17056/06, § 95 (përfshirë si përmbledhje në publikim).

144 *Kyprianou k. Qipros*, vendimi i Dhomës së Madhe i 15 dhjetorit 2005, nr. 73797/01, §§ 129-133.

145 *Ibid Kyprianou k. Qipros*, vendimi i Dhomës së Madhe i 15 dhjetorit 2005, nr. 73797/01, § 97.

146 *Mežnarić k. Kroacisë*, vendimi i 15 korrikut 2005, nr. 71615/01, § 36; *Èettstein k. Zvicrës*, vendimi i 21 dhjetorit 2000, nr.

Siç u diskutua në seksionin e këtij Udhërrëfyesi: ‘Dukja e pavarësisë’, paraqitja e dukjes objektive të paanshmërisë është e rëndësishme për të ngjallur dhe ruajtur besimin publik tek gjyqësori, duke pasur parasysh se “drejtësia nuk duhet vetëm të vihet në vend, por duhet edhe të shihet që po vihet në vend”.<sup>[147]</sup>

Qëndrimet dhe dyshimet rreth paanshmërisë që ka një palë e caktuar janë të rëndësishme por jo vendimtare. Gjithashtu, frika e palës duhet të jetë objektive dhe justifikuar.<sup>[148]</sup> Prandaj duhet të vendoset në secilën çështje individuale nëse situata që çon drejt dyshimeve për paanshmërinë është e një natyre dhe shkalle të tillë që tregojnë mungesë paanshmërie të gjykatës.<sup>[149]</sup>

Për të plotësuar kërkesat e paanshmërisë objektive, duhet të ketë garanci dhe mbrojtje të mjaftueshme për të përjashtuar të gjitha dyshimet legjitime në lidhje me paanshmërinë e një gjyqtari. Për shembull, ekzistenca e procedurave dhe rregulloreve nacionale për të siguruar paanshmërinë, siç janë rregullat e tërheqjes së gjyqtarëve.<sup>[150]</sup>

Paanshmëria e gjyqtarëve, sipas dy testeve, subjektiv dhe objektiv, mund të testohet në dy kategori situatash që analizohen më poshtë: situata të natyrës funksionale dhe situata të natyrës personale.

### c) Paanshmëria funksionale

---

Ky aspekt i paanshmërisë ka të bëjë me përbërjen e gjykatave dhe funksioneve që kryen një gjyqtar, për shembull nëse një gjyqtar kryen funksione të ndryshme brenda procesit gjyqësor, ose ushtrimi i funksioneve gjyqësore dhe jashtë-gjyqësore në lidhje me të njëjtën çështje.

---

33958/96, § 47 (përfshirë si përmbledhje në publikim).

147 *De Cubber k. Belgjikës*, vendimi i 26 tetorit 1984, nr. 9186/80, § 26 (përfshirë si përmbledhje në publikim).

148 *Micallef k. Maltës*, vendimi i Dhomës së Madhe i 15 tetorit 2009, nr. 17056/06, § 96 (përfshirë si përmbledhje në publikim).

149 *Micallef k. Maltës*, vendimi i Dhomës së Madhe i 15 tetorit 2009, nr. 17056/06, § 97 (përfshirë si përmbledhje në publikim).

150 *Micallef k. Maltës*, vendimi i Dhomës së Madhe i 15 tetorit 2009, nr. 17056/06, § 99 (përfshirë si përmbledhje në publikim): “Rregulla të tilla vënë në dukje shqetësimin e legjislaturës nacionale për të larguar të gjitha dyshimet e arsyeshme në lidhje me paanshmërinë e gjyqtarit ose gjykatës në fjalë dhe janë përpjekje për të siguruar paanshmërinë duke eliminuar shkaqet e këtyre shqetësimeve. Përveç se sigurojnë mungesën e anësisë, ato gjithashtu synojnë të heqin çdo dukje të anësisë dhe kështu shërbejnë për të promovuar besimin që duhet të frymëzojnë gjykatat tek publiku.”

## ***i) Ushtrimi i funksioneve gjyqësore dhe jashtëgjyqësore***

Paanshmëria mund të dëmtohet kur një institucion ose një gjyqtar kryen funksione të dyfishta ose funksione të mbivendosura. Për shembull, kur një institucion luan rol këshillues si dhe rol gjykues, ose kur një anëtar i një gjykate është gjithashtu deputet në parlament, është anëtar i ekzekutivit, vepron si përfaqësues ligjor dhe si gjyqtar, ose duket se luan po ashtu edhe rolin e paditësit, prokurorit ose dëshmitarit në një çështje.

Thjesht fakti që një gjykatë ose një gjyqtar kryen një rol tjetër ose punon për një institucion tjetër nuk e dëmton automatikisht paanshmërinë. Gjykata shqyrton faktet e veçanta të secilës çështje për të vlerësuar masën deri ku ky funksionalitet i dyfishtë i jep shkas dyshimeve legjitime rreth paanshmërisë dhe ndikon në dukjen e kërkuar të paanshmërisë. Faktorët relevantë në këtë vlerësim përfshijnë: masën e përfshirjes jashtëgjyqësore të një gjyqtari në çështje relevante për procedurat gjyqësore; koha që ka kaluar mes ushtrimit të funksionit të tij jashtëgjyqësor dhe procedurave gjyqësore që janë duke u zhvilluar.<sup>[151]</sup>

Po ashtu, është thelbësore që kur një organ ka potencial për konflikt rolesh, të bëhet e ditur se cilët anëtarë të atij organi kanë marrë pjesë në vendimmarrje, në mënyrë që të paktën të ekzistojë mundësia për të kontestuar pjesëmarrjen e një anëtarit të tillë në një vendim. Kjo mundësi e kontestimit është mbrojtje e rëndësishme për paanshmërinë.<sup>[152]</sup>

### **Gjyqtarët të cilët janë gjithashtu anëtarë të legjislativit dhe/ose të ekzekutivit**

Thjesht fakti që një gjyqtar është gjithashtu anëtar i legjislativit ose ekzekutivit nuk mjafton për të hedhur dyshime mbi paanshmërinë e tij. Çështja kyçe është shkalla deri ku, në cilësinë e tij si anëtar i legjislativit ose ekzekutivit, ai është përfshirë në miratimin e ligjeve, ose rregullave ekzekutive, të cilat po shqyrtohen gjatë procedurës gjyqësore. Çdo përfshirje e drejtpërdrejtë, aktive ose formale, me gjasë hedh dyshime mbi paanshmërinë e një gjyqtari që më pas thirret për të vendosur në një mosmarrëveshje në lidhje me ato rregulla.<sup>[153]</sup>

151 *McConnell k. Mbretërisë së Bashkuar*, vendimi i 8 shkurtit 2000, nr. 28488/95, §§ 52-57.

152 *Vernes k. Francës*, vendimi i 20 janarit 2011, nr. 30183/06, §§ 42-44.

153 *McConnell k. Mbretërisë së Bashkuar*, vendimi i 8 shkurtit 2000, nr. 28488/95, §§ 55-57: ku një Përmbarues ishte qenë aktivisht dhe formalisht i përfshirë në fazat përgatitore të rregulloreve në fjalë, kjo mund të hedhë dyshime mbi paanshmërinë e tij kur ai më pas vendosi, si gjyqtar i vetëm, në një mosmarrëveshje në lidhje me faktin nëse kishte arsye për t'u distancuar nga rregulloret (përfshirë si përmbledhje në publikim).

Megjithatë, kur një anëtar i legjislativit i cili është anëtar i trupit gjykues në një gjykatë nuk ka qenë i përfshirë në hartimin ose miratimin e ligjeve për të cilat zhvillohet gjyqi, dhe nuk ka tregues që ai ka pasur ndonjë lidhje paraprake me thelbin e çështjes, thjesht statusi i tij si anëtar i parlamentit në vetvete nuk mjafton për të hedhur dyshime mbi paanshmërinë e tij. Për shembull, kur një anëtar i parlamentit gjykon në lidhje me ligje të miratuara para se ai të merrte detyrën si anëtar i parlamentit, dhe ai nuk ka lidhje të tjera politike me procedurën.<sup>[154]</sup>

### Ushtrimi i roleve si këshilluese ashtu edhe gjykuese

Fakti që një organ gjyqësor gjithashtu luan rol këshillues në vetvete nuk mjafton për të dëmtuar paanshmërinë. Çështja kyçe është nëse puna këshilluese ka lidhje me të njëjtën çështje, të njëjtin vendim, ose me një çështje analoge me atë që organi duhet të gjykojë.<sup>[155]</sup> Për shembull, kur një organ gjykimor ka dhënë opinione këshilluese në lidhje me një temë të gjerë ose të përgjithshme, kjo nuk do ta pengonte atë nga të gjykuarit e një çështjeje të caktuar e cila hyn brenda asaj teme të përgjithshme.<sup>[156]</sup>

Megjithatë, ky funksionalitet i dyfishtë do të dëmtonte paanshmërinë kur i jep shkas dyshimeve objektivist të justifikuara që anëtarët e gjykatës ndihen të bllokuar nga opinioni këshillues që kanë dhënë më parë kur gjykojnë një çështje. Pjesëmarrja e tyre mund të shihet si e tillë që dëmton dukjen e pavarësisë dhe paanshmërisë.<sup>[157]</sup>

### Gjyqtarët që vepronë edhe si përfaqësues ligjorë

Fakti që një gjyqtar ka luajtur rolin e avokatit të palës kundërshtarë dhe rolin e gjyqtarit në të njëjtën procedurë e dëmton paanshmërinë e tij. Edhe kur përfshirja e mëparshme e një gjyqtari si avokat për palën kundërshtarë ka qenë e vogël, nuk ka zgjatur më shumë se dy muaj, dhe ka ndodhur nëntë vjet para se procedura të vinte para tij si gjyqtar, fakti që ai ka vepruar si kundërshtar i kërkuarit në të njëjtën procedurë ishte vendimtar.<sup>[158]</sup>

154 *Pabla Ky k. Finlandës*, vendimi i 22 qershorit 2004, nr. 47221/99, §§ 33-34; shih gjithashtu *Kleyn dhe të Tjerë k. Holandës*, vendimi i Dhomës së Madhe i 6 majit 2003, nr. 39343/98 (përfshirë si përmbledhje në publikim).

155 *Kleyn dhe të Tjerë k. Holandës*, vendimi i Dhomës së Madhe i 6 majit 2003, nr. 39343/98 (përfshirë si përmbledhje në publikim).

156 *Kleyn dhe të Tjerë k. Holandës*, vendimi i Dhomës së Madhe i 6 majit 2003, nr. 39343/98 (përfshirë si përmbledhje në publikim): Fakti që Këshilli i Shtetit kishte dhënë opinione këshilluese në lidhje me infrastrukturën e transportit nuk e dëmtoi paanshmërinë e tij kur gjykoji në lidhje me apelet e mëpasme ndaj vendimeve për shtetkalimet.

157 *Procola k. Luksemburgut*, vendimi i 28 shtatorit 1995, nr. 14570/89; *Martinie k. Francës*, vendimi i Dhomës së Madhe i 12 prillit 2006, nr. 58675/00, § 53; *Zahirović k. Kroacisë*, vendimi i 25 prillit 2013, nr. 58590/11, §§ 44-50.

158 *Mežnarić k. Kroacisë*, vendimi i 15 korrikut 2005, nr. 71615/01, § 36.

Paanshmëria e një gjyqtari gjithashtu mund të dëmtohet kur një gjyqtar vepron si përfaqësues ligjor i palës kundërshtare ndaj kërkesit në procedura të ndara por paralele. Kur dy procedura përkohësisht në kohë, është legjitime që një kërkesë të ketë shqetësime se gjyqtari do të vazhdojë ta shohë atë si pala kundërshtare, edhe në qoftë se nuk ka lidhje materiale mes dy procedurave.<sup>[159]</sup>

Ka më pak gjasa të dalin probleme kur një gjyqtar luan rol të dyfishtë në procedura të cilat nuk përkohësisht në kohë. Gjykata gjithashtu merr parasysh kohën që ka kaluar mes dy procedurave, dhe shkallën deri ku ato kanë lidhje me të njëjtën lëndë.<sup>[160]</sup>

### Roli i ankuesit, dëshmitarit dhe/ose prokurorit

Një gjyqtar nuk mund të presupozohet se është asnjëherë në qoftë se efektivisht vepron si ankues, dëshmitar dhe/ose prokuror në të njëjtën çështje ku ai vepron si gjyqtar. Për shembull, kur gjyqtarët të cilët kanë qenë objekt kritikash në lidhje me mënyrën se si i kanë zhvilluar procedurat më pas kanë marrë vendimin për të nisur procedura për shpërfillje të gjykatës kundër atyre që i kanë kritikuar, i kanë gjykuar çështjet dhe i kanë dënua kërkesit, ky konfuzion i roleve të ankuesit, dëshmitarit, prokurorit dhe gjyqtarit është gjetur në mënyrë të vetëdukshme se ka nxitur frikën e justifikuar në lidhje me përputhshmërinë me kriterin e paanshmërisë.<sup>[161]</sup>

Shembuj të tjerë ku paanshmëria është dëmtuar për shkak se një gjyqtar është vlerësuar se ka vepruar, efektivisht, edhe si gjyqtar edhe si ankues përfshijnë:

- » Kur një gjyqtar i Gjykatës Supreme ka kërkuar nisjen e procedurave disiplinore kundër një gjyqtari tjetër, dhe gjithashtu ka qenë anëtar i trupit gjykues i cili ka vendosur për shkarkimin e këtij gjyqtari tjetër për sjellje të pahijshme.<sup>[162]</sup>
- » Kur një gjyqtar i Gjykatës Supreme ka votuar në lidhje me një opinion që ka gjetur sjellje të pahijshme tek gjyqtari kërkes dhe më pas ka qenë anëtar i trupës që ka vendosur për shkarkimin e atij gjyqtari.<sup>[163]</sup>

159 *Wettstein k. Zvicrës*, vendimi i 21 dhjetorit 2000, nr. 33958/96, § 44-47 (përfshirë si përmbledhje në publikim).

160 *Puolitaivala dhe Pirttiaho k. Finlandës*, vendimi i 23 nëntorit 2004, nr. 54857/00, §§ 46-54.

161 *Kyprianou k. Qipros*, vendimi i Dhomës së Madhe i 15 dhjetorit 2005, nr. 73797/01, § 127.

162 *Mitrinovski k. Ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë*, vendimi i 30 prillit 2015, nr. 6899/12, §§ 38-46.

163 *Gerevska Popčevska k. Ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë*, vendimi i 7 janarit 2016, nr. 48783/07, (përfshirë si përmbledhje në publikim).



Kur një gjyqtar ka luajtur rol hetues para një gjyqi, ose kur ka pasur përkim të pjesshëm mes ndjekjes penale dhe gjyqit, mund të dalë çështje në lidhje me paanshmërinë në qoftë se një gjyqtar ka qenë aktivisht i përfshirë në vendimet lidhur me gjyqin. Për shembull:

- » Kur gjyqtarët e një gjykate penale të apelit më herët kanë marrë vendime të cilat përmbanin deklarime që dukej se paragjykonin fajësinë e të akuzuarit.<sup>[164]</sup>
- » Kur dy gjyqtarë në trupin gjykues më herët kanë refuzuar një apel kundër bërjes së akuzës penale mbi bazën e “provave të pamjaftueshme” që është kryer vepër penale.<sup>[165]</sup>
- » Kur një gjyqtar më herët ka qenë kryetar i seksionit të prokurorisë publike e cila ka nisur ndjekjen penale në një çështje kundër tij.<sup>[166]</sup>

Megjithatë, fakti që një gjyqtar ka njohuri të mëhershme rreth një dosjeje gjyqësore ose ka qenë më herët i përfshirë në vendimet e marra para një gjyqi jo domosdoshmërisht e dëmton paanshmërinë.<sup>[167]</sup> Për shembull, kur një gjyqtar më herët ka bërë vlerësimin e ekzistencës së një çështjeje *prima facie* ose ka vlerësuar nëse një i dyshuar duhet të mbahet në paraburgim, duke marrë parasysh rreziqet e përsëritjes së veprës, shkaktimit të dëmit ose pengimit të procedurave penale. Ngjashëm, pjesëmarrja në konsultimet e trupit gjykues e një *gjyqtari raportues* nuk e prek paanshmërinë në qoftë se raportuesi nuk ka qenë i përfshirë në “udhëzimin” ose përpilimin e akuzave.<sup>[168]</sup>

Çështjet mund të dalin edhe kur një gjyqtar, ose një trupë gjyqtarësh, duket se merr rolin e prokurorit gjatë procedurës. Për shembull, kur, në mungesë të prokurorit publik, gjyqtari fton dhe merr në pyetje një dëshmitar<sup>[169]</sup> ose detyrohet të marrë përsipër rolin e paraqitjes dhe mbështetjes së provave kundër të pandehurit.<sup>[170]</sup>

164 *Chesne k. Francës*, vendimi i 22 prillit 2010, nr. 29808/06, §§ 37-40.

165 *Castillo Algar k. Spanjës*, vendimi i 28 tetorit 1998, nr. 28194/95.

166 *Piersack k. Belgjikës*, vendimi i 26 tetorit 1984, nr. 8692/79.

167 *Morel k. Francës*, vendimi i 6 qershorit 2000, nr. 34130/96.

168 *Tedesco k. Francës*, vendimi i 10 majit 2007, nr. 11950/02.

169 *Ozerov k. Rusisë*, vendimi i 18 majit 2010, nr. 64962/01, §§ 53-55.

170 *Karelin k. Rusisë*, vendimi i 20 shtatorit 2016, nr. 926/08, §§ 72-75.

## **ii) Ushtrimi i funksioneve të ndryshme gjyqësore brenda të njëjtës procedurë ose në procedura të ndërlidhura**

Vlerësimi nëse pjesëmarrja e të njëjtit gjyqtar në faza të ndryshme të një çështjeje është në përputhje me kriterin e paanshmërisë sipas nenit 6 § 1 bëhet sipas rastit, duke marrë parasysh rrethanat e secilës çështje individuale. Kjo qasje sipas rastit zbatohet gjithashtu kur i njëjti gjyqtar merr pjesë në procedura penale dhe civile të cilat janë të lidhura nga aspekti faktik.<sup>[171]</sup> Pyetja kyçe ka të bëjë me shkallën deri ku ekziston një lidhje mes çështjeve substanciale të përcaktuara nga gjyqtari në një fazë tjetër të procedurave, ose në procedura të ndërlidhura.<sup>[172]</sup>

### **Procedura të ndara por të ndërlidhura**

Nuk është problem në vetvete, sipas nenit 6, në qoftë se i njëjti gjyqtar merr pjesë në procedura të ndara të cilat kanë lidhje me të njëjtat fakte. Për shembull, kur një gjyqtar luan rol në një çështje penale dhe më pas është anëtar i trupës në një padi të ndërlidhur që ka të bëjë me kompensim civil. Për të mbrojtur paanshmërinë në këtë kontekst është thelbësore që dy procedurat të kenë të bëjnë me çështje të ndryshme.

Dyshime legjitime rreth paanshmërisë mund të lindin kur çështjet ligjore, si dhe faktet në procedura të ndërlidhura, janë të njëjta. Për shembull, kur në secilën çështje zbatohet i njëjti standard prove, pra gjetja e një gjyqtari në një çështje ka gjasa të paragjykojë gjetjen e tij në një çështje tjetër.<sup>[173]</sup>

Megjithatë, gjetja e përgjegjësisë penale në një procedura nuk paragjykon gjetjen e përgjegjësisë civile, ose anasjelltas. Për shembull, për shkak se zbatohen standarde të ndryshme të provave.<sup>[174]</sup>

Problemet e paanshmërisë jo domosdoshmërisht shfaqen për shkak se një gjyqtar është pjesëtar i trupës në gjyqe të ndara penale kundër dy kërkuesve të bashkakuar. Për të mbrojtur paanshmërinë në këtë kontekst, gjyqtari nuk duhet të jetë i lidhur mbas vendimit të tij në lidhje me kërkuesin e parë kur merr në konsideratë çështjen e kërkuesit të dytë. Përkundrazi, gjykata duhet ta konsiderojë me mendje të freskët

171 *Pasquini k. San Marinos*, vendimi i 2 majit 2015, nr. 50956/16, §§ 148-149.

172 *Toziczka k. Polonisë*, vendimi i 25 korrikut 2012, nr. 29995/08, § 36.

173 *Fatullayev k. Azerbajxhanit*, vendimi i 22 prillit 2010, nr. 40984/07, §§ 136-140: baza legjitime për të dyshuar tek paanshmëria e një gjyqtari kur në procedurat civile dhe penale për shpifje të bazuara në të njëjtat deklarata vendimet u morën në vazhdimësi nga i njëjti gjyqtar, dhe çështja kryesore ishte identike në secilin rast.

174 *Lie dhe Bernsten k. Norvegjisë*, vendimi i 16 dhjetorit 1999, nr. 25130/94.

komplet çështjen e kërkuarit të dytë, në procedura kontradiktorialiteti, duke bërë të mundur që kërkuari i dytë të paraqesë argumente të reja ligjore dhe të parashtrojë prova të tjera.<sup>[175]</sup>

Nuk lindin dyshime rreth pavarësisë së një gjyqtari në qoftë se ai ka bërë komente kalimtare rreth kërkuarit të dytë gjatë çështjes së kërkuarit të parë, për sa kohë që këto komente nuk tregojnë se ai ka formuluar ndonjë mendim të pafavorshëm për kërkuarin. Megjithatë, lindin dyshime rreth paanshmërisë në qoftë se një gjyqtar ka bërë një gjetje fakti në çështjen e kërkuarit të parë e cila mund të ndikojë në çështjen e kërkuarit të dytë. Ose, në qoftë se gjyqtari ka bërë ndonjë deklarament ose ka përdorur ndonjë shprehje që ka krijuar përshtypjen se ai tashmë e ka marrë vendimin në lidhje me çështjen e kërkuarit të dytë.<sup>[176]</sup>

Fakti që një gjyqtar ka njohuri të hollësishme ekzistuese rreth një lënde, ose fakti që një gjyqtar ka ndërmarrë një analizë paraprake të informacioneve në dispozicion, nuk e pengon atë gjyqtar që të shihet si i paanshëm gjatë marrjes së vendimit në lidhje me themelet e një çështjeje, për sa kohë që analiza e parashtuar në vendimin e tij përfundimtar është e bazuar në provat e paraqitura dhe në argumentet e dëgjua në seancë.<sup>[177]</sup>

## Role të ndryshme gjyqësore brenda të njëjtës procedurë

---

Përgjithësisht, gjyqtarët nuk duhet të përfshihen në seanca apeli kundër vetë atyre, dhe nuk duhet të përfshihen në marrjen e vendimeve për të njëjtat çështje në forume të ndryshme. Megjithatë, impakti mbi paanshmërinë i përfshirjes së tyre në faza të ndryshme të procedurave varet nga faktet e veçanta të çështjes.

### Të njëjtat çështje në forume ose kontekste të ndryshme

Dyshimet legjitime rreth paanshmërisë mund të lindin kur një gjyqtar ose gjykatë ka qenë i/e përfshirë më herët në raste relevante për çështjen që kanë përpara. Çështjet ngrihen në qoftë se, në kuadër të trajtimit të mëhershëm të çështjes nga ana e tij/tyre, gjyqtari ose gjykata ka ndërmarrë qëndrim të qartë në lidhje me çështjet relevante për çështjen që kishte përpara. Për shembull, kur një Gjykatë e

---

175 *Khodorkovskiy dhe Lebedev k. Rusisë*, vendimi i 25 korrikut 2013, nr. 11082/06 dhe nr. 13772/05, § 544; *OOO 'Vesti' dhe Ukhov k. Rusisë*, vendimi i 30 majit 2013, nr. 21724/03.

176 *Khodorkovskiy dhe Lebedev k. Rusisë*, vendimi i 25 korrikut 2013, nr. 11082/06 dhe nr. 13772/05, § 544; *OOO 'Vesti' dhe Ukhov k. Rusisë*, vendimi i 30 majit 2013, nr. 21724/03.

177 *Morel k. Francës*, vendimi i 6 qershorit 2000, nr. 34130/96, § 45.

Auditimit më herët kishte kontribuar në një raport publik lidhur me keqmenaxhimin e fondeve publike dhe i ishte referuar në mënyrë specifike kërkuetit çështjen e të cilit gjykata e kishte përpara, u gjet se deklaratat në raport legjitimisht mund të interpretoheshin si të tilla që përbënin paragjykim ndaj vendosjes së çështjes në lidhje me keqmenaxhimin nga kërkueti të fondeve publike.<sup>[178]</sup>

Gjithashtu, mund të jetë problematike në qoftë se një gjyqtar ka vendosur paraburgimin paragjyqësor të një personi për shkak të “dyshimeve specifikisht të vërtetura” dhe më pas ka vendosur për fajësinë e të njëjtit person.<sup>[179]</sup>

Megjithatë, nuk ka problem në qoftë se një gjyqtar i cili vendos në lidhje me meritat e çështjes së një kërkueti më herët ka refuzuar ankesën e tij rreth mos-respektimit të afateve procedurale, pa shprehur kurrfarë qëndrimi në lidhje me meritat.<sup>[180]</sup>

### Dëgjimi i apeleve kundër vetë vendimeve të tyre

Përgjithësisht, një gjyqtar nuk duhet të dëgjojë apele në lidhje me vendimin e vetë atij, dhe atij nuk duhet t'i kërkohej të përcaktojë nëse interpretimi ose zbatimi i ligjit nga ana e tij në një vendim të mëhershëm ka qenë ose jo i saktë.<sup>[181]</sup> Në qoftë se një gjyqtar ka qenë i përfshirë në faza të ndryshme të së njëjtës procedurë, faktorët e mëposhtëm janë relevantë për të vlerësuar se si ndikon kjo në paanshmërinë e tij:

- » Shkalla e përfshirjes së tij në fazat e ndryshme të çështjes, për shembull nëse ai e ka kryesuar procedurën, ose nëse ka pasur votë vendimtare.<sup>[182]</sup>

178 *Beausoleil k. Francës*, vendimi i 6 tetorit 2016, nr. 63979/11.

179 *Hauschildt k. Danimarkës*, vendimi i 24 majit 1989, nr. 10486.83, §§ 51-52.

180 *Berhani k. Shqipërisë*, vendimi i 27 majit 2010, nr. 847/05.

181 *Driza k. Shqipërisë*, vendimi i 13 nëntorit 2007, nr. 33771/02: Gjykata gjeti se përbërja e Trupave të Përbashkëta të Gjykatës së Lartë përbante gjashtë gjyqtarë të cilët gjithashtu kishin marrë pjesë në formacionet gjyqësore të Trupave të Gjykatës së Lartë të cilat më herët kishin vendosur çështjen e kërkuetit. Prandaj Gjykata gjeti shkelje të nenit 6 § 1 të Konventës duke zbatuar testin objektiv të paanshmërisë.

182 *De Haan k. Hollandës*, vendimi i 26 gushtit 1997, nr. 22839/93, § 51: shkelje e nenit 6 ku tipari vendimtar i çështjes ishte që gjyqtari kryesoi një trupë të ftuar për të vendosur në lidhje me një kundërshtim ndaj një vendimi për të cilin ai vetë ishte përgjegjës. Po ashtu që me rëndësi që ai ishte personi i vetëm përgjegjës për vendimin fillestar; *Fazli Aslaner k. Turqisë*, vendimi i 4 marsit 2014, nr. 36073/04: ku vetëm tre prej tridhjetenjë gjyqtarëve në një trup gjyqësor kishin marrë pjesë në fazat e mëhershme të procedurës, por me rëndësi ishte që njëri prej atyre tre gjyqtarëve kryesoi trupën me tridhjetenjë gjyqtarë dhe udhëhoqi konsultimet në atë çështje.

- » Numri i gjyqtarëve të përfshirë, për shembull nëse ai ka qenë pjesë e një trupi gjykues të madh, ose nëse ka qenë gjyqtari i vetëm që ka vendosur në lidhje me çështjen.<sup>[183]</sup>
- » Nëse ka gjyqtarë të tjerë profesionistë të përfshirë në secilën fazë të çështjes, ose nëse gjyqtari është pjesë e një trupe me ndihmësgjyqtarë.<sup>[184]</sup>
- » Shkalla deri ku fazat e ndryshme të procedurës kanë të bëjnë me pyetje ose pika të ndryshme. Problemet lindin kur të njëjtat fakte, prova dhe argumente ligjore shpalosen para të njëjtëve gjyqtarë për të vendosur nëse vetë ata kanë bërë gabime gjatë zbatimit të ligjit prej vetë atyre.<sup>[185]</sup>
- » Shkalla deri ku ekzistojnë mbrojtje të mjaftueshme për të siguruar që roli i dyfishtë i gjyqtarit nuk dëmton paanshmërinë.<sup>[186]</sup>
- » Nëse ka arsye / justifikime legjitime përse gjyqtarët po marrin pjesë në faza të ndryshme të procedurës.<sup>[187]</sup>

- 183 *De Haan k. Hollandës*, vendimi i 26 gushtit 1997, nr. 22839/93; *Fazlı Aslaner k. Turqisë*, vendimi i 4 marsit 2014, nr. 36073/04, § 37: për të parë shembuj të rasteve kur Gjykata i ka rrëzuar ankesat për shkak të numrit të vogël të gjyqtarëve në fjalë në trupa gjykuese të cilat marrin vendime shumicë, shih *Ferragut Pallach k. Spanjës*, vendimi i 28 shkurtit 2006, nr. 1182/03; *Garrido Guerrero k. Spanjës*, vendimi i 2 shkurtit 2000, nr. 43715/98; *OOO "Vesti" dhe Ukhov k. Rusisë*, vendimi i 30 majit 2013, nr. 21724/03, § 83; dhe për të parë shembuj kur Gjykata ka gjetur shkelje të së drejtës për gjykatë të paanshme, duke marrë parasysh edhe numrin e madh të gjyqtarëve në fjalë edhe detyrat e tyre si kryetar ose raportues i trupës, shih *Cardona Serrat k. Spanjës*, vendimi i 26 tetorit 2010, nr. 38715/06; dhe *Olujić k. Kroacisë*, vendimi i 5 shkurtit 2009, nr. 22330/05, § 67 (përfshirë si përmbledhje në publikim).
- 184 *De Haan k. Hollandës*, vendimi i 26 gushtit 1997, nr. 22839/93, § 51: ku u vendos se ishte domethënësi fakti që trupi përbëhej nga një gjyqtar profesional dhe dy ndihmësgjyqtarë.
- 185 *San Leonard Band Club k. Maltës*, vendimi i 29 korrikut 2004, nr. 77562/01, § 64: shkelje e nenit 6 ku Gjykata e Apelit u ftua të vërtetonte nëse vendimi i saj i mëhershëm ishte bazuar në keqinterpretimin e ligjit, pra të njëjtët gjyqtarë u ftuan të vendosnin nëse vetë ata kishin bërë gabim në zbatimin e ligjit. Ky rast mund të shihet në kontrast me *Thomann k. Zvicrës*, vendimi i 10 qershorit 1998, nr. 17602/91 ku të njëjtët gjyqtarë morën pjesë në procedurën e rigjykitimit, por e shqyrtuan komplet çështjen nën një prizëm krejtësisht tjetër, duke marrë parasysh informacione të reja e të plota, dhe nuk vendosën në lidhje me gabimet e tyre të supozuara.
- 186 *Ramos Nunes de Carvalho e Sá k. Portugalisë*, vendimi i Dhomës së Madhe i 6 nëntorit 2018, nr. 55391/13, 57728/13 dhe 74041/13, §§ 153-156 (përfshirë si përmbledhje në publikim): nuk ka shkelje të nenit 6 ku Kryetari i Gjykatës Supreme ishte gjithashtu kryetar i organit administrativ vendimi i të cilit ishte duke u shqyrtuar në apel, ishte me rëndësi që ankesa kishte të bënte me gjykatën më të lartë në Portugal, të përbërë nga gjyqtarë profesionistë, me mandat të garantuar, të cilët i nënshtroheshin rregullave strikte të tilla që garantonin pavarësinë dhe paanshmërinë – për shembull kishte kritere objektive për emërimin gjyqtarët nuk vepronin sipas udhëzimeve, dhe Kryetari i Gjykatës Supreme në fakt nuk ishte anëtar i divizionit gjyqësor, pra ai nuk kishte mundësi të ushtronte ndikim tek gjyqtarët në asnjë formë.
- 187 *Fazlı Aslaner k. Turqisë*, vendimi i 4 marsit 2014, nr. 36073/04: shkelje e nenit 6 ku, në një trupë me tridhjetenjë gjyqtarë, vetëm tre prej tyre kishin marrë pjesë në një fazë të mëhershme të procedurës. Megjithëse numri i gjyqtarëve paanshmëria

Në lidhje me vendimin nëse një palë ka leje për apel, nuk është domosdoshmërisht në shpërputhje me kriterin e paanshmërisë kur i njëjti gjyqtar përfshihet në vendimin rreth meritave të çështjes, dhe më pas përfshihet në procedurën ku shqyrtohet pranueshmëria e një apeli kundër atij vendimi.<sup>[188]</sup>

#### d) Paanshmëria personale

Paanshmëria personale ka të bëjë me sjelljen personale të një gjyqtari, për shembull deklaratimet që bën në kuadër të procedurës, vërejtjet në media, ose çdo lidhje personale që mund të ketë më çështjen ose me palët në të. Ka të bëjë me vlerësimin e faktit nëse një gjyqtar shfaq ndonjë anësi personale ndaj ose kundër një pale.

Ekziston një presupozim i fortë i paanshmërisë personale, në qoftë se nuk ka prova për të kundërtën.<sup>[189]</sup> Për shembull, supozohet se gjyqtarët profesionistë, si rezultat i kualifikimeve të tyre, nuk do të ndikoheshin nga shtypi armiqësor ose komentet e pafavorshme ndaj të akuzuarve.<sup>[190]</sup> Edhe kur një gjyqtar ka qëndrim të fortë negativ ndaj çështjes ose karakterit të një të akuzuari, ose shfaq sjellje të ashpër pa nevojë, një sjellje e tillë nuk është domosdoshmërisht e mjaftueshme për të treguar anësi ose paragjykim personal.<sup>[191]</sup> Lloji i provave që kërkohen për të treguar anësi personale përfshin prova që gjyqtari ka shfaqur armiqësi ose keqdashje ndaj një pale, ose ka organizuar që çështja t'i caktohet atij për arsye personale.<sup>[192]</sup>

Megjithatë, duhet të ketë mekanizma efektive për të kontestuar anësinë e një gjyqtari ose gjykate. Në qoftë se ngrihet një kontestim mbi këtë bazë, gjykata duhet ta trajtojë atë dhe ose të marrë veprime për ta adresuar atë (për shembull duke përjashtuar gjyqtarët nëse ata gjenden se kanë shfaqur anësi), ose të ofrojë arsye të mjaftueshme dhe bindëse se përse nuk janë ndërmarrë veprime të mëtejshme, për të larguar dyshimet në lidhje me bindjet personale të gjyqtarit / gjykatës.<sup>[193]</sup>

e të cilëve u kontestua ishte i ulët në krahasim me numrin total të gjyqtarëve në trupin gjykyes, Gjykata gjeti shkelje pjesërisht për shkak se nuk ishte dhënë justifikim për nevojën e përfshirjes së tre gjyqtarëve në fjalë në atë trup gjykyes. Dhe së dyti, njëri prej tyre tre gjyqtarëve kishte kryesuar trupin gjykyes me tridhjetenjë gjyqtarë dhe kishte udhëhequr konsultimet në lidhje me atë çështje. Prandaj Gjykata gjeti se dyshimet e kërkuarit ndaj paanshmërisë së trupit gjykyes ishin objektivist të justifikuara (§§ 40-43; krahaso me çështjet e tjera të cituara në § 38 të vendimit përfundimtar).

188 *Warsicka k. Polonisë*, vendimi i 16 janarit 2007, nr. 2065/03, §§ 38-47.

189 *Le Compte, Van Leuven dhe De Meyere k. Belgjikës*, vendimi i 23 qersorit 1981, nr. 6878/75 dhe 7238/75.

190 *Craxi k. Italisë*, vendimi i 5 dhjetorit 2002, nr. 34896/97 (përfshirë si përmbledhje në publikim).

191 *Ranson k. Mbretërisë së Bashkuar*, vendimi i 2 shtatorit 2003, nr. 14180/03.

192 *De Cubber k. Belgjikës*, vendimi i 26 tetorit 1984, nr. 9186/80, § 25 (përfshirë si përmbledhje në publikim).

193 *Harabin k. Slovakisë*, vendimi i 20 nëntorit 2012, nr. 58688/11 (përfshirë si përmbledhje në publikim).

## ***i) Sjellja gjatë çështjes, përfshirë vërejtjet e bëra ose gjuha e përdorur***

---

Gjuha e përdorur, ose komentet e bëra nga një gjyqtar gjatë një çështjeje, mund të ofrojnë prova që atij i mungon shkëputja e duhur nga një çështje që kërkohet për të kryer funksionin e tij.<sup>[194]</sup>

Megjithatë, ekziston një prag goxha i lartë për të gjetur që sjellja gjatë çështjes shfaq anësi ose mungesë paanshmërie. Komentet e papërshtatshme, madje edhe ato që mund të tregojnë sjellje joprofesionale, me gjasë nuk janë të mjaftueshme.<sup>[195]</sup> Gjuha e përdorur nga një gjyqtar duhet të tregojë ofendim personal ose përfshirje personale në një çështje, ose duhet të jetë aq e theksuar sa të përçojë armiqësi, indinjatë ose shok, ndryshe nga qasja e shkëputur që pritet nga deklaratimet gjyqësore.<sup>[196]</sup>

Çështje të paanshmërisë gjithashtu mund të ngrihen kur një gjyqtar ndërhyr në marrëveshjet miqësore mes palëve, për shembull kur i bën presion një paditësi civil për të arritur marrëveshje në çështje.<sup>[197]</sup>

## ***ii) Deklarimet publike në lidhje me një çështje***

---

Për të ruajtur dukjen e paanshmërisë, gjyqtarët duhet të përmbahen nga bërja e komenteve publike rreth çështjeve ku janë të përfshirë, ose aspekteve të ndryshme të lidhura me çështjet e tyre, edhe kur shtypi i provokon për komente. Në mënyrë të veçantë, ata duhet të shmangin bërjen e komenteve kritike për palët e përfshira,<sup>[198]</sup>

---

194 *Vardanyan dhe Nanushyan k. Armenisë*, vendimi i 27 tetorit 2016, nr. 8001/07, § 82: ku përdorimi i gjuhës nga gjyqtari gjatë seancës u gjet qartazi se ishte në gjendje të shkaktoje frikën legjitime që refuzimi i kërkuetit për të pranuar një ofertë për marrëveshje miqësore mund të kishte efekt negativ mbi shqyrtimin nga Dhoma të themeleve të çështjes së tij.

195 *Ilseher k. Gjermanisë*, vendimi i Dhomës së Madhe i 4 dhjetorit 2018, nr. 27505/14, § 289: ku koment i papërshtatshëm i një gjyqtari mbi rrezikshmërinë e një kërkueti i cili tashmë ishte dënuar për vrasje për kënaqësi seksuale u gjet se ishte joprofessional, por jo aq sa të tregonte se gjyqtari ishte personalisht i njëanshëm karshi kërkuetit.

196 *Kyprianou k. Qipros*, vendimi i Dhomës së Madhe i 15 dhjetorit 2005, nr. 73797/01: ku gjyqtarët, në vendimin e tyre për dënimin, pranuan se ata ishin “ofenduar thellë” “si persona” nga kërkueti.

197 *Kyprianou k. Qipros*, vendimi i Dhomës së Madhe i 15 dhjetorit 2005, nr. 73797/01: ku një gjyqtar i bëri presion një paditësi civil që të arrinte marrëveshje për çështjen duke paralajmëruar se gjykatat gjithmonë i jepnin rëndësi se cila palë refuzonte të bënte marrëveshje. Gjykata gjeti se kjo shkaktoi frikën legjitime që atij i mungonte paanshmëria kur paditësi refuzoi të bënte marrëveshje.

198 *Lovents k. Letonisë*, vendimi i 28 nëntorit 2002, nr. 58442/00, §§ 118-121 (përfshirë si përmbledhje në publikim); *Olujiç k. Kroacisë*, vendimi i 5 shkurtit 2009, nr. 22330/05, §§ 61-68 (përfshirë si përmbledhje në publikim).

ose komente të cilat tregojnë se ata tashmë e kanë krijuar mendimin e tyre për çështjen në fjalë.<sup>[199]</sup> Gjykata konsideron se, në parim, gjyqtari duhet ta mendojë vetë dorëheqjen e tij nga trupi gjykues në qoftë se ka bërë deklarata publike në lidhje me rezultatin e çështjes.<sup>[200]</sup>

Megjithatë, fakti që një gjyqtar ka pikëpamje të njohura politike të kundërta me ato të të akuzuarit, ose fakti që një gjyqtar më herët ka shprehur kritika rreth ligjeve mbi bazën e të cilave ai duhet të gjykojë, në vetvete nuk është tregues i problemeve të paanshmërisë.<sup>[201]</sup>

Kur një anëtar i familjes së gjyqtarit bën deklarata publike në lidhje me një çështje, për shembull në media sociale ose në shtyp, Gjykata merr parasysh:

- (i) Nëse karakteri i atyre deklaratave ka qenë i tillë që ngre shqetësime objektive të justifikueshme rreth paanshmërisë së procedurës, për shembull nëse deklaratat mund të shihen si përpjekje për të shfrytëzuar postin gjyqësor të familjarit ose për të ndikuar tek një gjyqtar; dhe
- (ii) Nëse deklaratat e publikuara mund të thuhet se kanë pasur lidhje me vetë gjyqtarin, për shembull nëse ka prova se:
  - a) gjyqtari është ndikuar nga deklarata e familjarit të tij;
  - b) deklaratat kanë dalë nga diskutimet mes gjyqtarit dhe familjarit të tij; ose
  - c) gjyqtari ka rëndë dakord me komentet ose ka qenë në dijeni se ato do të postoheshin.<sup>[202]</sup>

### Përdorimi i mediave sociale

Përdorimi i mediave sociale nga gjyqtarët është shembull aktual i ekuilibrit që duhet të vendoset mes kriterit të paanshmërisë personale dhe të drejtës së gjyqtarit për lirinë e shprehjes dhe organizimit (shih gjithashtu seksionin e këtij Udhërrëfyesi: ‘Të drejtat e gjyqtarëve’). Në një kohë kur përfshirja e komuniteteve të cilave u shërbejnë gjyqtarët gjithnjë e më shumë përfshin pjesëmarrjen në aktivitetet online, gjyqtarëve nuk duhet t’iu ndalohej pjesëmarrja e përshtatshme në media sociale. Kjo çështje se çfarë përbën pjesëmarrje të përshtatshme në media sociale do të shqyrtohet nga Gjykata në një çështje të komunikuar e cila ka të bëjë me faktin nëse

199 Buscemi k. Italisë, vendimi i 16 shtatorit 1999, nr. 29569/95.

200 Rustavi 2 Broadcasting Company Ltd dhe Të Tjerë k. Gjeorgjisë, vendimi i 18 korrikut 2019, nr. 16812/17, § 342.

201 Previti k. Italisë, vendimi i 8 dhjetorit 2009, nr. 45291/06, §§ 249-269.

202 Rustavi 2 Broadcasting Company Ltd dhe Të Tjerë k. Gjeorgjisë, vendimi i 18 korrikut 2019, nr. 16812/17, § 344.



mund të konsiderohet i paanshëm ose jo një gjyqtar që është “mik” (“friend”) në rrjete sociale me një prej palëve në një çështje.<sup>[203]</sup>

Zyra e Kombeve të Bashkuara për Drogë dhe Krime rekomandon futjen e rregullave dhe trajnimeve në lidhje me përdorimin e mediave sociale për gjyqtarët për t’u siguruar që përdorimi i tyre të jetë në përputhje me detyrat e tyre etike dhe të mos prekë paanshmërinë e tyre personale.<sup>[204]</sup>

### ***iii) Interesat personale në çështje / lidhjet me palët / afërsia / njohjet ose asociimi***

#### **Lidhjet mes gjyqtarëve dhe palëve**

Lidhjet profesionale, financiare ose personale mes një gjyqtari dhe një pale në një çështje, ose avokatit të palës, mund të shkaktojnë dyshime në lidhje me paanshmërinë, megjithëse kjo varet nga rrethanat e çështjes dhe natyra e lidhjeve në fjalë.

Lidhjet familjare mes një gjyqtari dhe një pale në procedurë, ose përfaqësuesit të palës, mund të ngrenë çështje,<sup>[205]</sup> por nuk nënkuptojnë automatikisht që ka pasur shkelje të kriterit të paanshmërisë.<sup>[206]</sup> Duhet të ekzistojnë sisteme që garantojnë që gjyqtarët nuk marrin pjesë në trupë gjatë apelit në rastet kur familjarët e tyre veprojnë si prokurorë.<sup>[207]</sup> Kur një i afërm i një gjyqtari punon për firmën ligjore që përfaqëson një palë, është e rëndësishme të merret në konsideratë:<sup>[208]</sup>

203 *Chaves Fernandes Figueiredo k. Zvicrës*, komunikuar më 28 gusht 2019, nr. 55603/18: në këtë aspekt, Gjykata Franceze e Kasacionit mbajti qëndrimin që: “... termi ‘mik’ (‘friend’) i përdorur kur flitet për persona të cilët pajtohen të hyjnë në kontakt përmes rrjeteve sociale nuk i referohet miqësisë në sensin tradicional të fjalës... ekzistenca e kontakteve mes këtyre personave të ndryshëm në rrjete sociale nuk mjafton për të karakterizuar një njëanshmëri të veçantë, duke qenë se rrjetet sociale janë thjesht një mënyrë e caktuar komunikimi mes njerëzve që kanë të njëjtat interesa dhe, në këtë rast, të njëjtin profesion”. (Shih: arrët n° 1 du 5 Janvier 2017 (16-12.394), Cour de cassation - Deuxième chambre civile - ECLI:FR:CCASS:2017:C200001).

204 Shih [https://www.unodc.org/res/ji/import/international\\_standards/social\\_media\\_guidelines/social\\_media\\_guidelines\\_final.pdf](https://www.unodc.org/res/ji/import/international_standards/social_media_guidelines/social_media_guidelines_final.pdf) “Non-Binding Guidelines on the Use of Social Media by Judges”, United Nations Office on Drugs and Crime, 2019 / “Rregullat Jo-Detyruese mbi Përdorimin e Mediave Sociale nga Gjyqtarët”, Zyra e Kombeve të Bashkuara për Drogë dhe Krime, 2019.

205 *Micallef k. Maltës*, vendimi i Dhomës së Madhe i 15 tetorit 2009, nr. 17056/06, § 102 (përfshirë si përmbledhje në publikim).

206 *Ramljak k. Kroacisë*, vendimi i 27 qershorit 2017, nr. 5856/13, § 29.

207 *Dailienė k. Lituaniës*, vendimi i 16 tetorit 2018, nr. 23532/14, § 45.

208 *Nicholas k. Qipros*, vendimi i 9 janarit 2018, nr. 63246/10, § 62; shih gjithashtu *Ramljak k. Kroacisë*, vendimi i 27 qershorit 2017, nr. 5856/13, §§ 38-39: u gjetën dyshimet rreth paanshmërisë objektive kur djali i një gjyqtari që ishte

- » Marrëdhënia mes gjyqtarit dhe të afërmit të tij (për shembull, afërsia e marrëdhënies baba-bir ka më shumë gjasa të çojë drejt gjetjes së mungesës së paanshmërisë sesa një lidhje më e largët familjare).
- » Madhësia e firmës ligjore, struktura e brendshme organizative e saj, dhe domethënia financiare e çështjes për firmën ligjore.
- » Nëse i afërmi ka qenë i përfshirë në çështjen në fjalë, ose ka punuar me të tjerë që kanë qenë të përfshirë, dhe pozita e të afërmit në firmën ligjore.
- » Çdo interes ose përfitim të mundshëm financiar të të afërmit (dhe sasia e një përfitimi të tillë kur është relevante).

Shembuj të tjerë të rasteve kur është gjetur mungesë paanshmërie, jashtë kontekstit të lidhjeve familjare të gjyqtarit me palët në çështje, përfshijnë:

- » Kur gjyqtari në të kaluarën ka pasur lidhje jo të mira (negative) me, ose mosaprovim, ndaj një kërkuesi.<sup>[209]</sup>
- » Kur një gjyqtar, duke vepruar në një kapacitet / rol tjetër, ka lidhje të rregullta, të afërta dhe financiarisht fitimprurëse me një palë në procedurë,<sup>[210]</sup> ose ka pranuar asete nga njëra prej palëve.<sup>[211]</sup>
- » Kur një gjyqtare së fundi ka qenë i përfshirë në marrëveshje financiare mes bashkëshortit të saj dhe bankës e cila ishte palë në procedurë.<sup>[212]</sup>
- » Kur një gjyqtar ka marrëdhënie personale me viktimën në procedurën penale.<sup>[213]</sup>

## Lidhjet mes gjyqtarëve

Lidhjet personale mes gjyqtarëve gjithashtu mund të hedhin dyshime mbi paanshmërinë e tyre.<sup>[214]</sup> Megjithatë, thjesht fakti që gjyqtarët njihen me njëri-tjetrin

anëtar i trupit gjykues punonte si stazhier për firmën ligjore që përfaqësonte një palë, duke marrë parasysh që ishte firmë e vogël, faktin që djali punonte nga afër me dy avokatët e çështjes, dhe natyrën e lidhjes baba-bir.

- 209 *Oleksandr Volkov k. Ukrainës*, vendimi i 6 shkurtit 2018, nr. 21722/11, § 116 (përfshirë si përmbledhje në publikim).
- 210 *Pescador Valero k. Spanjës*, vendimi i 17 qershorit 2003, nr. 62435/00: ku lidhjet e rregullta, të afërta dhe financiarisht fitimprurëse të një gjyqtari si profesor në universitetin e paditur nga kërkuesi i justifikuan dyshimet që atij mund t'i mungonte paanshmëria.
- 211 *Belukha k. Ukrainës*, vendimi i 9 nëntorit 2006, nr. 33949/02: ku një gjyqtar kishte kërkuar dhe pranuar asete, pra një kompjuter për gjykatën, falas nga pala tjetër.
- 212 *Petur Thor Sigurdsson k. Islandës*, vendimi i 10 prillit 2003, nr. 39731/98, § 45.
- 213 *Mitrov k. Ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë*, vendimi i 2 qershorit 2016, nr. 45959/09, §§ 49 dhe 55.
- 214 *Mitrov k. Ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë*, vendimi i 2 qershorit 2016, nr. 45959/09, §§ 54-56: ku Gjykata gjeti dukjen e paanshmërisë kur kërkuesi u ndoq penalisht në lidhje me vdekjen në aksident trafiku të vajzës së

si kolegë, ose ndajnë të njëjtat zyra, në vetvete nuk mjafton për të hedhur dyshime mbi paanshmërinë e tyre. Kjo është posaçërisht e vërtetë në vende të vogla, ku mund të jetë e zakonshme që një profesionist ligjor të kryejë funksione të shumta (për shembull, si avokat dhe si gjyqtar) dhe/ose që një pjesë e madhe e profesionistëve ligjorë ta njohin njëri-tjetrin.<sup>[215]</sup>

Megjithatë, duke ditur rëndësinë e dukjes së paanshmërisë, çdo lidhje mes gjyqtarëve që mund të sjellë dyshime mbi paanshmërinë duhet të bëhet e ditur që në fillim, për të mundësuar përcaktimin e hapur dhe të informuar të faktit nëse mund të dalin probleme, dhe nëse është e nevojshme heqja e një gjyqtari nga çështja në fjalë.<sup>[216]</sup>

Kur një kryetar gjykate ka lidhje me një palë në çështje, por nuk është anëtar i trupit gjykues që vendos në lidhje me çështjen, impakti i kësaj mbi paanshmërinë varet nga rrethanat. Faktorët relevantë përfshijnë shkallën e ndikimit që mund të ushtrojë kryetari mbi çështjen, dhe presioni (qoftë direkt apo indirekt) që ai ose ajo mund të ushtrojë mbi gjyqtarët e trupit gjykues në çështje.<sup>[217]</sup>

## Gjykatat speciale

---

Kur ka lidhje profesionale mes një kërkuesi dhe anëtarëve të trupit gjykues në një gjykatë speciale, ky fakt i vetëm nuk mjafton për të hedhur dyshime mbi paanshmërinë e tyre. Zakonisht kërkohet që të tregohen lidhje më direkte mes palëve dhe anëtarëve të gjykatës dhe të vërtetohet se ka arsye legjitime për të dyshuar se interesat e gjyqtarit/ëve në fjalë janë në kundërshtim me ato të palëve në çështje.<sup>[218]</sup>

## Stereotipizimi

---

Plani i Veprimit i KE-së gjithashtu thekson nevojën për t'i bërë ballë ndikimit negativ të stereotipizimit në vendimmarrjen gjyqësore, në mënyrë që të respektohet

kryegjyqtars në gjykatë penale. Gjyqtari që kryesoi gjyqin kishte qenë koleg me kryegjyqtaren për disa vite, pjesë e një grupi kolegësh, dhe gjithashtu kishte qenë asistent i saj.

215 *Bellizzi k. Maltës*, vendimi i 21 qershorit 2011, nr. 46575/09, § 57.

216 *Nicholas k. Qipro*s, vendimi i 9 janarit 2018, nr. 63246/10, §§ 64-66.

217 *Parlov-Tkalcic k. Kroacisë*, vendimi i 22 dhjetorit 2009, nr. 24810/06, §§ 82-97.

218 *Langborger k. Suedisë*, vendimi i 22 qershorit 1989, nr. 11179/84 (përfshirë si përmbledhje në publikim): ku dy ndihmësgjyqtarë në Gjykatën për Çështje Strehimi dhe Qiramarrje kishin lidhje të afërta me dy shoqata të cilat donin të ruanin një klauzolë të kontestuar nga kërkuesi, ku ekzistonte frika legjitime se interesat e tyre ishin në kundërshtim me ato të kërkuesit.

dhe të përmirësohet dukja e paanshmërisë. Veprimet 2.4 dhe 2.5 kërkojnë që gjyqtarët të marrin trajnime të hollësishme, të thella dhe të diversifikuara për të kryer detyrat e tyre në mënyrë të kënaqshme dhe për të siguruar që stereotipet gjyqësore të mos komprometojnë të drejtat e grupeve të ndjeshme për qasje në gjykatë të paanshme. Cilësia e trajnimit fillestar dhe gjatë detyrës për gjyqtarët duhet të fuqizohet duke ofruar burime të mjaftueshme për të garantuar që programet e trajnimit të përmbushin kriteret e kompetencës, të qenit të hapur, dhe paanshmërisë që janë të ngërthyera në detyrën gjyqësore.<sup>[219]</sup>

---

219 Plani i Veprimit i KE-së, Veprimet 2.4 dhe 2.5.

## (7) MBROJTJA E PAVARËSISË DHE PAANSHMËRISË

Të siguruarit që procedurat gjyqësore janë transparente dhe llogaridhënia e gjyqtarëve janë në mesin e mbrojtjeve më të fuqishme të një sistemi gjyqësor të pavarur dhe të paanshëm.<sup>[220]</sup>

Siç u diskutua më lart, paraqitja e dukjes së pavarësisë dhe paanshmërisë është pjesë jetike e përmbushjes së kriterëve të pavarësisë dhe paanshmërisë sipas nenit 6. Besimi i publikut tek gjykatat mbështetet në komunikimin efektiv me publikun. Palët në procedura dhe publiku i gjerë duhet të kenë mundësi që të kenë qasje dhe t'i kuptojnë vendimet e marra nga gjykatat. Kjo kontribon në ruajtjen e pavarësisë dhe paanshmërisë, dhe siguron që kur gjyqtarët nuk duken të paanshëm ose të pavarur ata të japin llogari.

Detyrimi për të komunikuar vendimet gjyqësore përfundimtare dhe për të siguruar llogaridhënien e gjyqtarëve duhet të shërbejë për të forcuar, e jo për të dëmtuar, pavarësinë e gjyqësorit. Ndërkohë që vendimet përfundimtare duhet të arsyetohen dhe të shpallen publikisht, gjyqtarët nuk duhet të detyrohen që të justifikojnë arsyet e vendimeve të tyre jashtë procedurave gjyqësore dhe jashtë rolit të tyre gjyqësor kur, për shembull, japin arsytetime për votën e tyre në opinione të ndara që i bashkangjiten vendimit përfundimtar.<sup>[221]</sup> As nuk duhet të përfshihen në komente publike rreth çështjeve deri në atë masë sa shkojnë përtej personale, pra deri aty ku të preket paanshmëria e tyre.

Siç diskutohet më poshtë, përgjegjësia për ruajtjen e llogaridhënies dhe transparencës së gjyqësorit, me qëllim të mbrojtjes së pavarësisë dhe paanshmërisë, bie së pari mbi vetë gjykatat, dhe gjithashtu mbi institucione të tjera siç janë këshillat gjyqësore dhe organet disiplinore të gjyqësorit, parlamenti, qeveria dhe mediat.

---

220 Shih <https://www.gov.uk/government/news/lord-reeds-address-at-the-judicial-forum-in-bosnia-and-herzegovina> "Fjalimi i Lordit Reed në Forumin Gjyqësor në Bosnje dhe Hercegovinë", Ambasada Angleze në Sarajevë, 28 nëntor 2019.

221 Shih [https://search.coe.int/cm/Pages/result\\_details.aspx?ObjectID=09000016805afb78](https://search.coe.int/cm/Pages/result_details.aspx?ObjectID=09000016805afb78) "Rekomandimi CM/Rec(2010)12 i Komitetit të Ministrave të Vendeve Anëtare në lidhje me gjyqtarët: pavarësia, efikasiteti dhe përgjegjësitë", Komiteti i Ministrave i KE-së, 17 nëntor 2010, Kreu II, § 15.

## a) Roli i gjyqësorit

### i) Aspekte të tjera të së drejtës për proces të rregullt sipas nenit 6

#### Prezumimi i pafajësisë

Neni 6 §§ 2 dhe 3 përmban disa garanci specifike të cilat zbatohen vetëm në kontekstin e procedurave penale. Neni 6 § 2 parashikon:

*“Çdo person i akuzuar për një veprë penale prezumohet i pafajshëm, deri sa fajësia e tij të provohet ligjërisht.”*

Ka përkim të konsiderueshëm mes prezumimit të pafajësisë sipas nenit 6 § 2 dhe kriterëve të pavarësisë dhe paanshmërisë sipas nenit 6 § 1. Mbrojtja e njërit prej këtyre aspekteve të nenit 6 mund të ndihmojë që të mbrohet aspekti tjetër. Ngjashëm, veprimet që dëmtojnë kriteret e pavarësisë dhe paanshmërisë gjithashtu mund të shkelin nenin 6 § 2.

Për shembull, kur një gjyqtar bën deklarata në të cilat kritikohet pala mbrojtëse, ose të cilat duket se paraqesin qëndrim përfundimtar në lidhje me rezultatin e gjyqit, kjo mund të bëjë që kërkuesi të ketë dyshime legjitime rreth paanshmërisë së gjyqtarit. Njëkohësisht, mund të sugjerojë edhe që gjyqtari është duke vepruar sipas përshtypjes që pala është fajtorë dhe duhet të vërtetohet pafajësinë e vet, në kundërshtim me prezumimin e pafajësisë sipas nenit 6 § 2.<sup>[222]</sup>

Prezumimi i pafajësisë zbatohet sipas arsyeve operative të dhëna në një vendim përfundimtar në një çështje penale, si dhe në deklaratat e bëra nga një gjyqtar para vendimit të tij.<sup>[223]</sup> Prandaj, gjyqtarët duhet të shmangin bërjen e deklaramëve që lënë të kuptohet një vlerësim të parakohshëm të fajësisë së të pandehurit, pavarësisht nëse janë deklarata publike, deklarime gjatë procedurës, ose deklarata në kuadër të pjesës operative të vendimit përfundimtar. Ky kriter gjithashtu vepron si mbrojtës i paanshmërisë, sepse i pengon gjyqtarët nga bërja e komenteve të cilat mund të paraqesin dukjen e anësisë karshi një të pandehuri.<sup>[224]</sup>

Siç diskutohet në seksionin e këtij Udhërrëfyese: ‘Paanshmëria funksionale’, pjesëmarrja e një gjyqtari në procedura të dyfishta mund të dëmtojë kriterin e

222 Lavents k. Letonisë, vendimi i 28 nëntorit 2002, nr. 58442/00, §§ 118-119 (përfshirë si përmbledhje në publikim).

223 Cleve k. Gjermanisë, vendimi i 15 janarit 2015, nr. 48144/09, § 41.

224 Gutsanovi k. Bullgarisë, vendimi i 15 tetorit 2013, nr. 34529/10 (përfshirë si përmbledhje në publikim).

pavarësisë dhe paanshmërisë. Ngjashëm, prezumimi i pafajësisë zbatohet në vendime gjyqësore ose komente gjatë procedurave të cilat nuk janë të drejtuara kundër kërkuesit si “i akuzuar” por të cilat kanë lidhje me procedurat penale që njëkohësisht vazhdojnë kundër kërkuesit, kur një gjyqtar lë të kuptohet një vlerësim të parakohshëm të fajësisë së kërkuesit si pjesë e këtyre procedurave paralele.<sup>[225]</sup>

### **Seanca brenda një afati të arsyeshëm (kur kontestimi i një gjyqtari e bën procedurën të zgjatur)**

---

Neni 6 § 1 parashikon që:

*“Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe **brenda një afati të arsyeshëm**, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e ngritur me ligj.”* (Theksi i shtuar)

Gjykata ka theksuar në mënyrë të vazhdueshme rëndësinë e administrimit të drejtësisë brenda një afati kohor të arsyeshëm, meqenëse vonesa të tilla mund të rrezikojnë efektivitetin dhe kredibilitetin e një sistemi ligjor.<sup>[226]</sup>

Shtetet e kanë për detyrim sipas nenit 6 § 1 që të organizojnë sistemet e tyre gjyqësore në mënyrë të atillë që gjykatat e tyre të mund të përmbushin të gjitha kriteret e nenit 6.<sup>[227]</sup> Prandaj, kriteri për të zhvilluar procedurat brenda një afati të arsyeshëm vepron si mbrojtës i pavarësisë dhe paanshmërisë, sepse i detyron Shtetet të organizojnë sistemet e tyre ligjore në mënyrë që një kërkues të mos pengohet nga ngritja e dyshimeve rreth pavarësisë ose paanshmërisë së një gjyqtari për shkak të frikës se kundërshtimet e tij mund të shkaktojnë zgjatjen e procedurave për një periudhë të paarsyeshme kohore.

Gjatë shqyrtimit se çfarë përbën “afat të arsyeshëm” Gjykata merr në konsideratë një sërë faktorësh, përfshirë kompleksitetin e çështjes, sjelljen e kërkuesit dhe atë të autoriteteve përkatëse, dhe çfarë rrezikon kërkuesi në mosmarrëveshje. Kur një kërkues bën mocione dhe apele të njëpasnjëshme, ky vlerësohet si fakt objektiv që nuk mund t’i atribuohet Shtetit, dhe i cili duhet të merret parasysh gjatë vlerësimit të arsyeshmërisë.<sup>[228]</sup>

---

225 Böhmer k. Gjermanisë, vendimi i 13 tetorit 2002, nr. 37568/97, § 67.

226 Scordino k. Italisë (Nr. 1), vendimi i Dhomës së Madhe i 29 marsit 2006, nr. 36813/97, § 224.

227 Dobbertin k. Francës, vendimi i 25 shkurtit 1993, nr. 13089/87, § 44.

228 O’Neill and Lauchlan k. Mbretërisë së Bashkuar, vendimi i 28 qershorit 2016, nr. 41516/10.

Megjithatë, neni 6 § 1 nuk pretendon që kërkuesi të bashkëpunojë aktivisht me autoritetet gjyqësore, dhe ai nuk mund të fajësohet për shfrytëzimin e plotë të zgjidhjeve në dispozicion sipas të drejtës vendase, sidomos kur apelet e një kërkuesi e kanë arritur qëllimin e ndreqjes së parregullsive që i atribuohen autoriteteve gjyqësore.<sup>[229]</sup> Prandaj, Shtetet Anëtare nuk mund mos gjejnë se procedurat kanë qenë pa arsye të gjata duke argumentuar që ankesat e kërkuesit në lidhje me pavarësinë dhe paanshmërinë kanë shkaktuar vonesa. Shtetet duhet t'i trajtojnë ankesa të tilla pa vonesë nga ana e tyre<sup>[230]</sup> dhe t'i menaxhojnë procedurat në mënyrë aktive për të siguruar që, edhe në qoftë se dalin probleme me pavarësinë dhe paanshmërinë, procedurat të mos zgjasin për një periudhë të paarsyeshme kohore.

## **ii) Arsyetimi i vendimeve përfundimtare**

Me qëllim që të sigurohet llogaridhënia e gjyqësorit, si palët ashtu edhe publiku i gjerë duhet të jenë në gjendje t'i kuptojnë vendimet e ndërmjetme dhe ato përfundimtare që merren nga gjykatat. Kjo është mbrojtje jetike kundër arbitraritetit dhe është faktor që ndihmon forcimin e besimit publik në një sistem gjyqësor objektiv dhe transparent.<sup>[231]</sup> Të kuptuarit e një vendimi është gjithashtu parakusht për ngritjen e një kontesti ose për shqyrtimin e atij vendimi. Prandaj neni 6 §1 kërkon që gjykatat të japin arsye për vendimet e tyre përfundimtare. Kjo nuk do të thotë se gjykatat janë të detyruara të japin përgjigje të detajuara për çdo argument që paraqet kërkuesi. Megjithatë, ato duhet të ofrojnë përgjigje specifike për argumentet të cilat janë vendimtare për procedurat. Këto arsye duhet të jenë të mjaftueshme që:

- » Të justifikojnë dhe të shpjegojnë përse është marrë vendimi.
- » Të tregojnë para palëve që ato (palët) janë dëgjuar.
- » T'u japin palëve mundësinë për të apeluar kundër një vendimi dhe për të mundësuar shqyrtimin efektiv të vendimit nga organi i apelit.
- » Të mundësojnë ekzaminimin publik të administrimit të drejtësisë.<sup>[232]</sup>

Ndërkohë që vendimet përfundimtare duhet të jenë të arsyetuara dhe të shpallura publikisht, gjyqtarët nuk do të duhej të detyroheshin që të justifikojnë arsyet për

229 *Dobbertin k. Francës*, vendimi i 25 shkurtit 1993, nr. 13089/87, § 43.

230 *O'Neill dhe Lauchlan k. Mbretërisë së Bashkuar*, vendimi i 28 qershorit 2016, nr. 41516/10, § 92.

231 *Suominen k. Finlandës*, vendimi i 1 korrikut 2003, nr. 37801/97, § 37.

232 *Suominen k. Finlandës*, vendimi i 1 korrikut 2003, nr. 37801/97, § 37; *Hirvisaari k. Finlandës*, vendimi i 27 shtatorit 2001, nr. 49684/99, § 30; shih gjithashtu [https://www.echr.coe.int/Documents/Seminar\\_background\\_paper\\_2019\\_ENG.pdf](https://www.echr.coe.int/Documents/Seminar_background_paper_2019_ENG.pdf) "Fuqizimi i besimit tek gjyqësori", punim paraprak për Seminarin Gjyqësor 2019, Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut, fq. 19.



vendimet e tyre përfundimtare.<sup>[233]</sup> Detyrimi për të dhënë arsye sipas nenit 6 § 1 nuk ka të bëjë me mjaftueshmërinë ose cilësinë e arsyeve të dhëna për një vendim të marrë. Në qoftë se procedurat në tërësi janë të drejta, ankesat për mjaftueshmërinë, ose përmbajtjen specifike ose bazën e arsyeve të dhëna, nuk angazhojnë nenin 6 nëse vendimi i marrë nga një gjykatë vendase nuk duket arbitrar ose dukshëm i paarsyeshëm.<sup>[234]</sup>

Shkalla e detyrimit për të dhënë arsye ndryshon sipas natyrës së një vendimi dhe rrethanave të një çështjeje.<sup>[235]</sup> Për shembull, një gjykatë apeli mund të veprojë në përputhje me detyrimin e saj për të dhënë arsyetim të mjaftueshëm, thjesht duke inkorporuar ose duke mbështetur arsyetimin e një gjykate më të ulët kur rrëzon një vendim apeli. Megjithatë, duhet të jetë e qartë se gjykata ose autoriteti më i ulët ka dhënë arsye të mjaftueshme për t'u mundësuar palëve të shfrytëzojnë në mënyrë efektive të drejtën e tyre për apel dhe që gjykata e apelit në fakt i ka adresuar çështjet thelbësore të cilat kaë dalë para juridiksionit të saj, dhe nuk i ka mbështetur gjetjet pa i analizuar ose vlerësuar më tej.<sup>[236]</sup>

Gjatë vlerësimit nëse arsyet e dhëna në një vendim janë në përputhje me nenin 6, po ashtu është e nevojshme të merren parasysh kulturat dhe praktikrat e ndryshme ligjore të Shteteve Anëtare. Për shembull, dispozitat e ndryshme statutoare dhe rregullat e ndryshme zakonore që rregullojnë dhënien e arsyeve, si dhe qasjet e ndryshme ndaj dhënies së opinioneve ligjore dhe prezantimit e përpilimit të vendimeve përfundimtare.<sup>[237]</sup>

233 Shih [https://search.coe.int/cm/Pages/result\\_details.aspx?ObjectID=09000016805afb78](https://search.coe.int/cm/Pages/result_details.aspx?ObjectID=09000016805afb78) "Rekomandimi CM/Rec(2010)12 i Komitetit të Ministrave të Shteteve Anëtare në lidhje me gjyqtarët", Komiteti i Ministrave i KE-së, 17 nëntor 2010, Kreu II, § 15.

234 *Khamidov k. Ruisë*, vendimi i 15 nëntorit 2007, nr. 72118/01, § 170: në përgjithësi, një vendim gjyqësor vendas përshkruhet si arbitrar vetëm kur paragjykon procedurat ku nuk jepen arsye fare, ose kur arsyet e dhëna janë të bazuara në gabime të dukshme faktike ose ligjore të bëra nga gjykata vendase, që rezultojnë në 'mohim të drejtësisë' (shih *Moreira Ferreira k. Portugalisë* (Nr. 2), vendimi i Dhomës së Madhe i 11 korrikut 2017, nr. 19867/12).

235 *Ruiz Torija k. Spanjës*, vendimi i 9 dhjetorit 1994, nr. 18390/91, §§ 29-30; *Van de Hurk k. Hollandës*, vendimi i 19 prillit 1994, nr. 16034/90, § 61 (përfshirë si përmbledhje në publikim).

236 *Sale k. Francës*, vendimi i 21 marsit 2006, nr. 39765/04, § 17; *Helle k. Finlandës*, vendimi i 19 dhjetorit 1997, nr. 20772/92.

237 *Gorou k. Greqisë* (Nr. 2), vendimi i Dhomës së Madhe i 20 marsit 2009, nr. 12686/03, § 37; *Ruiz Torija k. Spanjës*, vendimi i 9 dhjetorit 1994, nr. 18390/91, § 29; *Van de Hurk k. Hollandës*, vendimi i 19 prillit 1994, nr. 16034/90, § 61 (përfshirë si përmbledhje në publikim).

### iii) Publiciteti i vendimeve përfundimtare dhe arsyeve

Neni 6 § 1 garanton të drejtën për “*seancë të drejtë dhe publike*” (theksi i shtuar). Të siguruarit që procedurat gjyqësore janë publike është një mënyrë tjetër përmes së cilës ruhet dhe inkurajohet besimi publik tek gjyqësori, mundësohet ekzaminimi i gjyqësorit dhe ofrohet mbrojtje kundër arbitraritetit.<sup>[238]</sup>

Si vendimi përfundimtar ashtu edhe arsyet e një vendimi duhet të bëhen publike, për t’u siguruar që publiku të jetë në gjendje të kuptojë përse një pretendim është pranuar ose refuzuar. Për shembull, Gjykata ka gjetur shkelje të nenit 6 kur një gjykatë e shkallës së parë ka lexuar në publik bazat e përgjithshme mbi të cilat është bazuar vendimi i saj, por ku një kopje e plotë e vendimit përfundimtar të arsyetuar i është dhënë vetëm pjesëmarrësve në procedurë.<sup>[239]</sup>

Edhe në rastet që kanë të bëjnë me çështje të sigurisë kombëtare ose informacione sekrete, interesat e sigurisë kombëtare dhe/ose konfidencialitetit nuk janë më të rëndësishme sesa nevoja për bërjen publike të vendimeve përfundimtare. Në raste të tilla, Shtetet duhet të përdorin teknika për të adresuar shqetësimet legjitime të sigurisë, pa mohuar kërkesën për publikim, për shembull, duke anonimizuar vendimet përfundimtare ose duke hequr vetëm ato pjesë të vendimeve gjyqësore zbulimi i të cilave do të komprometonte sigurinë kombëtare ose sigurinë e të tjerëve, në mënyrë që publiku sidoqoftë të ketë qasje në pjesët e tjera të vendimit përfundimtar.<sup>[240]</sup>

Masat praktike që mund të merren nga gjykatat për të shtuar bërjen publike të vendimeve përfundimtare dhe arsyetimeve, pa komprometuar pavarësinë dhe paanshmërinë e gjyqësorit, përfshijnë:<sup>[241]</sup>

- » Shtimin e qasjes fizike në gjykata, në mënyrë që pjesëtarët e publikut dhe gazetarët të mund të hyjnë lirisht dhe të shohin shpalljen e vendimeve kur është e përshtatshme.
- » Mundësimi që seancat e gjykatave supreme / më të larta të apelit në një Shtet Anëtar nganjëherë të zhvillohen në qytete ose rajone të ndryshme, për t’u siguruar që pjesëtarët e publikut në tërë Shtetin të mund të vijnë dhe t’i shohin procedurat personalisht.

238 *Fazlyiski k. Bullgarisë*, vendimi i 16 prillit 2013, nr. 40908/05, § 64.

239 *Ryakib Biryukov k. Rusisë*, vendimi i 17 janarit 2008, nr. 14810/02.

240 *Raza k. Bullgarisë*, vendimi i 11 shkurtit 2010, nr. 31465/08, § 53.

241 Shih <https://www.gov.uk/government/news/lord-reeds-address-at-the-judicial-forum-in-bosnia-and-herzegovina>

“Fjala e Lordit Reed në Forumin Gjyqësor në Bosnje dhe Hercegovinë”, Ambasada Angleze në Sarajevë, 28 nëntor 2019.

- » Filmimi ose transmetimi i drejtpërdrejtë në internet (live-streaming) i seancave dhe shpalljes së vendimeve përfundimtare.<sup>[242]</sup>
  - Transmetimi i drejtpërdrejtë në internet (live-streaming) mund të bëhet në mënyrë anonime dhe me vonesa të shkurtra për të siguruar që të mos transmetohet gabimisht diçka konfidenciale.
  - Kur një gjykatë nuk e ka teknologjinë e duhur për të anonimizuar një seancë të drejtpërdrejtë, seanca mund të incizohet në mënyrë që një incizim i anonimizuar i seancës / vendimit përfundimtar të mund të vendoset më pas në faqen e internetit të gjykatës.
- » Krijimi i video-përmbledhjeve të shkurtra dhe të kuptueshme të vendimeve përfundimtare, të cilat mund t'u shpërndahen mediave dhe mund të vendosen në faqen e internetit të gjykatës.
- » Bashkëpunimi me gazetarët / përfaqësuesit e mediave për t'i ndihmuar ato që të përhapin informacionet dhe analizën e vendimeve përfundimtare drejt publikut të gjerë, përfshirë:
  - Duke informuar gazetarët se kur do të shpallen vendimet përfundimtare, në mënyrë që ata të mund të marrin pjesë në seancë.
  - Shpërndarja e kopjeve të plota të vendimeve përfundimtare me interes publik dhe/ose dhënia e një kumtese për shtyp ose përmbledhjeje të vendimit përfundimtar për gazetarët.
- » Publikimi i udhërrëfyeseve, fletëfakteve dhe notave informative për të ndihmuar që njerëzit të kuptojnë praktikën gjyqësore, procedurat dhe tekstet zyrtare të një gjykate.<sup>[243]</sup>

Ndërkohë që bashkëpunimi me mediat ndihmon për t'u siguruar që vendimet përfundimtare raportohen gjerësisht dhe saktësisht, qasja e mediave tek vetë gjyqtarët duhet të jetë e kufizuar për të siguruar që gjyqtarët të mbeten jopersonalë dhe të ruajnë dukjen e paanshmërisë. Një ekip i punonjësve të medias që punon me gjyqtarët, dhe puna e të cilit mbikqyret nga ata, duhet të ketë përgjegjësinë për t'u marrë me mediat.

---

242 Për shembull, si pjesë e një plani më të gjerë për fuqizimin e transparencës së veprimeve të saj, në shkurt 2021 Gjykata e Bosnje dhe Hercegovinës filloi të transmetonte gjyqin penal të famshëm "Fadil Novalić dhe të tjerë" në YouTube. Iu lejua qasje gazetarëve të cilët u verifikuan dhe të miratuan nga Gjykata e Bosnje dhe Hercegovinës si dhe institucioneve dhe organizatave me të cilat Gjykata kishte marrëveshje bashkëpunimi (përfshirë organizatat që monitoronin gjyqet). Gjykata planifikon ta zgjerojë këtë sistem me çështje të tjera penale me interes publik.

243 Shih për shembull publikimin nga GJEDNj-ja të shënimeve informative rreth praktikës gjyqësore: <https://www.echr.coe.int/Pages/home.aspx?p=casela&analysis/clin>, udhërrëfyesit e praktikës gjyqësore: <https://www.echr.coe.int/Pages/home.aspx?p=casela&analysis/guides&c=#>, dhe fletëfaktet: [http://www.echr.coe.int/Pages/home.aspx?p=press/factsheets&c=#n1347890855564\\_pointer/](http://www.echr.coe.int/Pages/home.aspx?p=press/factsheets&c=#n1347890855564_pointer/).

#### iv) Trajnimi, detyrat dhe etika e gjyqtarëve

Për të ruajtur paanshmërinë, gjyqtarët duhet t'i marrin vendimet vetëm duke zbatuar rregullat e ligjit. Ata nuk duhet të marrin parasysht asnjë konsideratë tjetër që bie jashtë zbatimit të rregullave të ligjit.<sup>[244]</sup> Prandaj, gjyqtarët duhet t'i dinë dhe t'i kuptojnë rregullat e ligjit, dhe t'i zbatojnë ato në mënyrë të pavarur dhe të paanshme. Siç thuhet më lart, trajnimi për ligjin dhe zhvillimet e reja ligjore është element i rëndësishëm në mbrojtjen e pavarësisë së gjyqtarëve si dhe për cilësinë dhe efikasitetin e sistemit gjyqësor.<sup>[245]</sup>

Përveç të kuptuarit të ligjit, gjyqtarët gjithashtu duhet të mbajnë një shkallë të lartë kompetence profesionale. Sjellja e gjyqtarëve gjatë aktiviteteve të tyre profesionale shihet nga publiku si aspekt thelbësor i kredibilitetit të gjykatave, dhe është pazgjydhshëmrisht e lidhur me dukjen e paanshmërisë dhe besimin publik tek gjykatat.<sup>[246]</sup>

Aspektet etike të sjelljes së gjyqtarëve janë veçanërisht të rëndësishme për ruajtjen e pavarësisë, paanshmërisë dhe besimit tek sistemi gjyqësor.<sup>[247]</sup> Metodrat e përdorura për të zgjidhur mosmarrëveshjet gjithmonë duhet të ushqejnë besim. Pushteti dhënë gjyqtarëve është i lidhur ngusht me vlerat e drejtësisë, të vërtetës dhe lirisë. Standardet e sjelljes për gjyqtarët janë realizim i këtyre vlerave dhe parakusht për besimin tek administrimi i drejtësisë.

Opinionin N° 3 (2002) i KKGJE-së mbi etikën dhe përgjegjësitë e gjyqtarëve rekomandon futjen e parimeve dhe rregullave të caktuara etike për të qeverisur sjelljen profesionale të gjyqtarëve të cilat duhet të jenë krejtësisht të ndara dhe të synojnë qëllime të ndryshme prej sistemeve dhe rregullave disiplinore të gjyqtarëve. Sipas këtij Opinioni, parime të tilla të sjelljes duhet të përfshijnë kriteret në vijim:<sup>[248]</sup>

- » Gjyqtarët duhet t'i zhvillojnë detyrat e tyre pa favorizime dhe pa shprehje paragjykimi ose anësie. Ata duhet të tregojnë respektin e duhur për parimin e trajtimit të barabartë të palëve, dhe të ruajnë ekuilibrin mes palëve për të siguruar që secili të ketë seancë të drejtë.

244 KKGJE (2002) Op. N° 3, § 23.

245 Magna Carta e Gjyqtarëve, § 8.

246 KKGJE (2002) Op. N° 3, § 22.

247 KKGJE (2002) Op. N° 3, § 8.

248 KKGJE (2002) Op. N° 3, §§23 – 25 dhe 50.

- » Gjyqtarët duhet të tregojnë konsideratën e merituar ndaj të gjithë personave (për shembull palë, dëshmitarë, avokatë) pa bërë dallime në baza të paligjshme ose të papërputhshme me kryerjen e duhur të funksioneve të tyre.
- » Gjyqtarët duhet të sigurohen që të mbajnë një nivel të lartë kompetence profesionale përmes trajnimeve bazë dhe atyre të mëtejshme, gjë që i pajis ata me kualifikimet e duhura.
- » Gjyqtarët duhet të sillen me ndershmëri në detyrë dhe në jetën private.

Sa i përket mënyrës se si këto rregulla / parime duhet të formulohen dhe të jetësohen, KKGJE-ja konsideron që në secilin Shtet Anëtar duhet të përgatitet 'një deklaratë e standardeve të sjelljes profesionale'.<sup>[249]</sup> Deklarata të tilla duhet të përpilohen nga vetë gjyqtarët dhe duhet të shoqërohen nga: (i) trajnimi i duhur bazë ose i mëtejshëm për sjelljen profesionale, dhe (ii) krijimi i grupeve të nivelit të lartë, të përbërë nga përfaqësues të interesave të ndryshme të përfshira në administrimin e drejtësisë, për të marrë në shqyrtim çështjet etike dhe për të shpërndarë konkluzionet e tyre.

### v) Riparimi i defekteve në apel

Në disa rrethana, defektet në lidhje me pavarësinë dhe paanshmërinë e një gjykate më të ulët mund të riparohen me anë të shqyrtimit të vendimeve të tyre nga një gjykatë më e lartë. Për të ndodhur kjo, nuk duhet të ketë dyshime rreth pavarësisë dhe paanshmërisë së gjykatës më të lartë të apelit e cila shqyrton vendimin e gjykatës më të ulët.

Gjykata më e lartë duhet të ketë juridiksion të plotë për të rishqyrtuar dhe ridëgjuar çështjet që dalin para gjykatës më të ulët.<sup>[250]</sup> Kur gjendet një defekt, gjykata më e lartë duhet të prishë vendimin e gjykatës më të ulët në tërësi.<sup>[251]</sup>

Shkalla deri ku defektet mund të riparohen në apel gjithashtu varet nga konteksti dhe natyra e një çështjeje. Për shembull, mungesa e pavarësisë mund të ketë më pak gjasa të rregullohet me anë të rishqyrtimit në kontekst penal.<sup>[252]</sup>

249 KKGJE (2002) Op. N° 3, §54, 46 dhe 48.

250 *Holm k. Suedisë*, vendimi i 25 nëntorit 1993, nr. 14191/88: ku fakti që si juridiksioni i Gjykatës së Apelit ashtu edhe ai i Gjykatës së Rrethit ishin të kufizuar nga kushtet e verdiktit të jurisë nënkuptoi që defekti në procedurën para kësaj gjykate së fundit nuk mund të riparohet duke bërë apel tek gjykata e parë; *Le Compte, Van Leuven dhe De Meyere k. Belgjikës*, vendimi i 23 qershorit 1981, nr. 6878/75 dhe 7238/75.

251 *Henryk Urban dhe Ryszard Urban k. Polonisë*, vendimi i 30 nëntorit 2010, nr. 23614/08 (përfshirë si përmbledhje në publikim).

252 *Findlay k. Mbretërisë së Bashkuar*, vendimi i 25 shkurtit 1997, nr. 22107/93 (përfshirë si përmbledhje në publikim).

## b) Roli i institucioneve të tjera

### i) Këshillat gjyqësore, organet disiplinore dhe procedurat disiplinore

Siç diskutohet në seksionet e këtij Udhërrëfyese: ‘Kushtet e detyrës’ dhe ‘Garancitë kundër presioneve të jashtme’, kushtet në të cilat gjyqtarët mund të shkarkohen, ose t’u nënshtrohen procedurave disiplinore, duhet të jenë të kufizuara dhe duhet të sigurojnë pajtueshmërinë me kriteret e pavarësisë dhe paanshmërisë.

Organi përgjegjës për dëgjimin e procedurave disiplinore kundër një gjyqtari gjithashtu duhet të veprojë në pajtueshmëri me kriteret e pavarësisë dhe paanshmërisë, dhe procedurat në tërësi duhet të jenë në pajtueshmëri me të gjitha aspektet e të drejtës për seancë të rregullt sipas nenit 6 § 1.<sup>[253]</sup>

#### A zbatohet neni 6 në procedurat disiplinore kundër gjyqtarëve?

Respektimi i garancive të nenit 6 është veçanërisht i rëndësishëm në procedurat disiplinore kundër një gjyqtari duke qenë se aty është në rrezik besimi i publikut tek funksionimi dhe pavarësia e gjyqësorit.<sup>[254]</sup>

Procedurat disiplinore kundër gjyqtarëve paraqesin një kombinim të rrezikshëm mes gjyqësorit dhe ekzekutivit, me rrezikun që procedura të tilla përdoren nga qeveritë për të ndëshkuar gjyqtarët për rezultatet ose përmbajtjen e vendimeve të tyre, duke ndërhyrë kështu tek pavarësia dhe paanshmëria e tyre. Megjithatë, ekzistenca e mundësisë së nisjes së procedurës disiplinore kundër një gjyqtari gjithashtu është e nevojshme për të siguruar që ai vepron në pajtueshmëri me detyrimet e tij profesionale. Prandaj mbrojtjet e nenit 6 në këtë kontekst përfaqësojnë një siguri

253 Shih vendimin e kohëve të fundit të GjDBE-së, *Asociația "Forumul Judecătorilor Din România"*, vendimi i Dhomës së Madhe i 18 majit 2021, çështjet e bashkuara C-83/19, C-127/19, C-195/19, C-291/19, C-355/19, C-397/19, §207 (përfshirë si përmbledhje në këtë publikim): “...Neni 2 dhe nënparagrafi i dytë i Nenet 19(1) të TBE-së dhe Vendimi 2006/928 duhet të interpretohen si të tillë që e lënë jashtë legjislacionin nacional të miratuar nga qeveria e një Shteti Anëtar, i cili lejon që qeveria të bëjë emërime të përkohshme në pozita menaxheriale të organit gjyqësor përgjegjës për kryerjen e hetimeve disiplinore dhe nisjen e procedurave disiplinore kundër gjyqtarëve dhe prokurorëve, pa ndjekur procedurën e zakonshme të emërimit që parashtron ligji vendas, kur ai legjislacion u jep shkas dyshimeve të arsyeshme se pushteti dhe funksionet e atij organi mund të përdoren si instrument për të ushtruar presion ose kontroll politik mbi aktivitetet e atyre gjyqtarëve dhe prokurorëve.”

254 *Harabin k. Slovakisë*, vendimi i 20 nëntorit 2012, nr. 58688/11, § 133 (përfshirë si përmbledhje në publikim); *Ramos Nunes de Carvalho e Sá k. Portugalisë*, vendimi i Dhomës së Madhe i 6 nëntorit 2018, nr. 55391/13, 57728/13 dhe 74041/13, § 196 (përfshirë si përmbledhje në publikim).

kyçe për të parandaluar kërcënimin e keqpërdorimit të procedurave disiplinore për të ushtruar presion ndaj gjyqtarëve.<sup>[255]</sup>

Instrumentet ndërkombëtare dhe ato të KE-së, si dhe praktika gjyqësore e Gjykatës dhe e gjykatave ndërkombëtare, i japin rëndësi gjithnjë e më të madhe drejtësisë procedurale në çështje që kanë të bëjnë me shkarkimin ose heqjen e gjyqtarëve. Në mënyrë të veçantë, ato specifikojnë se një autoritet që është i pavarur nga ekzekutivi dhe legjislativi duhet të përfshihet në çdo vendim që prek përfundimin e mandatit të një gjyqtari.<sup>[256]</sup>

Këshillat gjyqësore, ose organet disiplinore profesionale, shpesh përfshihen në gjykimin e procedurave të nisura kundër gjyqtarëve. Siç diskutohet në seksionin e këtij Udhërrëfyesi: *‘Kujt / Cilave organe u zbatohet kriteri i pavarësisë dhe paanshmërisë?’*, koncepti i “gjykatës” për qëllimet e nenit 6 përfshin çdo organ ose autoritet që ushtron funksione të rregullta gjyqësore, pavarësisht se si etiketohen / klasifikohen në nivel nacional. Prandaj, kriteret e nenit 6 mund t’u zbatohen organeve disiplinore, siç janë Këshillat e Larta të gjyqësorit, dhe kriteret e pavarësisë dhe paanshmërisë të cilat diskutohen me hollësi në seksionet e këtij Udhërrëfyesi: *‘Pavarësia’* dhe *‘Paanshmëria’* zbatohen kur këto organe gjykojnë në procedura kundër gjyqtarëve.<sup>[257]</sup>

Në qoftë se një organ disiplinor profesional nuk vepron në pajtueshmëri me kërkesat e nenit 6, çdo vendim gjatë procedurës disiplinore duhet t’i nënshtrohet

255 Shih <https://www.coe.int/en/web/cjje/-/we-need-to-talk-about-disciplinary-proceedings-new-verfassungsblog-podcast-with-the-cjje-s-presidenti> “Duhet të flasim rreth procedurave disiplinore”: Podcasti i ri me Kryetarin e KKGJE-së, KKGJE.

256 Shih *Baka k. Hungarisë*, vendimi i Dhomës së Madhe i 23 qershorit 2016, nr. 20261/12, § 64 (përfshirë si përmbledhje në publikim) dhe citatin aty, për shembull: Parimet Bazë të OKB-së: “Vendimet në procedura disiplinore, të pezullimit ose të shkarkimit duhet t’i nënshtrohen një shqyrtimi të pavarur. Ky parim mund të mos zbatohet në rastin e vendimeve të gjykatës më të lartë dhe atyre të legjislaturës në procedura para gjyqit ose në procedura të ngjashme” dhe Karta Evropiane e Statusit për Gjyqtarët, § 1.3: “Sa i përket çdo vendimi që ndikon në përzgjedhjen, punësimin, emërimin, avancimin në karrierë ose përfunsimi e mandatit të një gjyqtari, statuti parashikon ndërhyrjen e një autoriteti të pavarur nga pushteti ekzekutiv dhe ai legjislativ në të cilët së paku gjysma e anëtarëve të trupës janë gjyqtarë të zgjedhur nga kolegët e tyre me anë të metodave që garantojnë përfaqësimin më të gjerë të gjyqësorit”.

257 Gjykata ka shqyrtuar pavarësinë e gjyqtarëve në lidhje me një vendim të marrë nga Këshilli i Lartë i Gjyqësorit (organi i tyre disiplinor) në shumë raste, siç janë *Oleksandr Volkov k. Ukrainës*, vendimi i 6 shkurtit 2018, nr. 21722/11 (përfshirë si përmbledhje në publikim); *Denisov k. Ukrainës*, vendimi i Dhomës së Madhe i 25 shtatorit 2018, nr. 76639/11 (përfshirë si përmbledhje në publikim); dhe *Ramos Nunes de Carvalho e Sá k. Portugalisë*, vendimi i Dhomës së Madhe i 6 nëntorit 2018, nr. 55391/13, 57728/13 dhe 74041/13, (përfshirë si përmbledhje në publikim).

kontrollit vijues nga “një organ gjyqësor që ka juridiksion të plotë” dhe i cili i ofron garancitë e nenit 6 § 1.<sup>[258]</sup>

Ndërkohë që procedurat disiplinore kundër gjyqtarëve përgjithësisht janë ‘procedura civile’, pra që angazhojnë mbrojtjet e nenit 6 § 1, ka situata të caktuara në të cilat procedurat kundër një gjyqtari mund të jenë procedura penale, pra që angazhojnë mbrojtjet e nenit 6 §§ 2 dhe 3. Kjo varet nga natyra e akuzave të bëra kundër gjyqtarit dhe nga ashpërsia e sanksioneve me të cilat përballet ai. Për shembull, procedurat e lustracionit kundër një gjyqtari mund të përbënin procedura ‘penale’.<sup>[259]</sup>

### Zbatimi i nenit 6 në kontekstin e procedurave kundër gjyqtarëve

Duke ditur rëndësinë e domethënies së procedurave disiplinore kundër një gjyqtari, Gjykata ka përcaktuar disa mbrojtje specifike, ose konsiderata, të cilat duhet të merren parasysh kur shqyrtohet nëse procedura kundër një gjyqtari është në pajtueshmëri me nenin 6.<sup>[260]</sup> Për shembull:

- » Kriteret për plotësimin e nenit 6 në këtë kontekst u zbatohen si procedurat disiplinore në shkallën e parë, ashtu edhe procedurat gjyqësore në apel.
- » Procedurat në shkallën e parë duhet të ndërthejnë mbrojtje procedurale dhe, kur një kërkues ka gjasa të përballet me ndëshkime shumë të rënda, gjithashtu duhet të përfshijnë masa të përshtatshme për të konstatuar faktet, për shembull mundësinë për të bërë paraqitje me gojë.<sup>[261]</sup>
- » Kriteri për të mbajtur seancë dëgjimore publike duhet të përdoret vetëm si masë e jashtëzakonshme e cila është e justifikuar si duhet në kuadër të praktikës gjyqësore të Gjykatës.<sup>[262]</sup>

258 *Le Compte, Van Leuven dhe De Meyere k. Belgjikës*, vendimi i 23 qershorit 1981, nr. 6878/75 dhe 7238/75, § 29.

259 *Matyjek v. Polonisë*, vendimi i 24 prillit 2007, nr. 38184/03 (përfshirë si përmbledhje në publikim); *Engel dhe Tjërë k. Hollandës*, vendimi i 8 qershorit 1976, nr. 5100/71, 5101/71, 5102/71, 5354/72 dhe 5370/72, §§ 82-83; *Oleksandr Volkov k. Ukrainës*, vendimi i 6 shkurtit 2018, nr. 21722/11, § 93 (përfshirë si përmbledhje në publikim).

260 *Ramos Nunes de Carvalho e Sá k. Portugalisë*, vendimi i Dhomës së Madhe i 6 nëntorit 2018, nr. 55391/13, 57728/13 dhe 74041/13, § 196 (përfshirë si përmbledhje në publikim).

261 *Ramos Nunes de Carvalho e Sá k. Portugalisë*, vendimi i Dhomës së Madhe i 6 nëntorit 2018, nr. 55391/13, 57728/13 dhe 74041/13, § 198 (përfshirë si përmbledhje në publikim).

262 *Ramos Nunes de Carvalho e Sá k. Portugalisë*, vendimi i Dhomës së Madhe i 6 nëntorit 2018, nr. 55391/13, 57728/13 dhe 74041/13, § 210 (përfshirë si përmbledhje në publikim).



- » Përbërja e organit disiplinor duhet të jetë kryesisht me gjyqtarë profesionistë, siç është njohur në Kartën Evropiane të Statutit për Gjyqtarët.<sup>[263]</sup>
- » Përfshirja e Prokurorit të Përgjithshëm si anëtar i këshillit gjyqësor përgjegjës për disiplinimin dhe shkarkimin e gjyqtarëve ka gjasa të ngrejë shqetësime, sepse mund të ketë efekt pengues tek gjyqtarët (e madje edhe mund të perceptohet si kërcënim potencial), meqenëse Prokurori i Përgjithshëm merr pjesë në shumë çështje në të cilat gjyqtarët duhet të marrin vendime.<sup>[264]</sup>

Gjykata po ashtu ka ekzaminuar çështjen e pavarësisë dhe paanshmërisë së gjyqtarëve në gjykatën e apelit, kur ata gjyqtarë janë nën autoritetin e këshillit gjyqësor ose një organi disiplinor vendimin e të cilit janë duke e shqyrtuar. Faktorët e mëposhtëm janë me rëndësi për të përcaktuar nëse ky rol i dyfishtë përbën problem sipas nenit 6:

- » Nëse ka ndonjë mangësi strukturore serioze në sistemin gjyqësor të Shtetit.
- » Nëse ka dukje të anësisë brenda organit disiplinor.<sup>[265]</sup>
- » Shkalla e fuqisë që organi disiplinor mund të ushtrojë në lidhje me karrierën e gjyqtarëve në gjykatën e apelit.<sup>[266]</sup>
- » Shkalla deri ku anëtarët e ekzekutivit ose legjislativit janë të përfshirë në procedurat disiplinore ose marrin pjesë në shqyrtimin e vendimit disiplinor.<sup>[267]</sup>

263 *Oleksandr Volkov k. Ukrainës*, vendimi i 6 shkurtit 2018, nr. 21722/11, (përfshirë si përmbledhje në publikim): ku ishte problem fakti që vetëm 3 prej 16 anëtarëve të trupës në këshillin e gjyqësorit ishin gjyqtarë profesionistë.

264 *Oleksandr Volkov k. Ukrainës*, vendimi i 6 shkurtit 2018, nr. 21722/11, § 114 (përfshirë si përmbledhje në publikim).

265 *Oleksandr Volkov k. Ukrainës*, vendimi i 6 shkurtit 2018, nr. 21722/11, § 130 (përfshirë si përmbledhje në publikim); *Denisov k. Ukrainës*, vendimi i Dhomës së Madhe i 25 shtatorit 2018, nr. 76639/11, § 79 (përfshirë si përmbledhje në publikim); *Ramos Nunes de Carvalho e Sá k. Portugalisë*, vendimi i Dhomës së Madhe i 6 nëntorit 2018, nr. 55391/13, 57728/13 dhe 74041/13, §§ 157-165 (përfshirë si përmbledhje në publikim).

266 Fakti që Këshilli ishte përgjegjës për emërimin, disiplinimin dhe shkarkimin e gjyqtarëve që shqyrtuan vendimin e tyre në *Oleksandr Volkov k. Ukrainës*, vendimi i 6 shkurtit 2018, nr. 21722/11, (përfshirë si përmbledhje në publikim) dëmtoi pavarësinë dhe paanshmërinë e tyre, ndërsa tek *Ramos Nunes de Carvalho e Sá k. Portugalisë*, vendimi i Dhomës së Madhe i 6 nëntorit 2018, nr. 55391/13, 57728/13 dhe 74041/13 (përfshirë si përmbledhje në publikim), gjyqtarët e apelit nuk kalonin më nëpër vlerësimet të performancës e as nuk pretendonin ngritje në detyrë, dhe autoriteti disiplinor i këshillit mbi ta realisht ishte më shumë teorik.

267 Shih *Oleksandr Volkov k. Ukrainës*, vendimi i 6 shkurtit 2018, nr. 21722/11, (përfshirë si përmbledhje në publikim): ku vendosja e mëtejshme e çështjes së kërkuesit nga Parlamenti kontriboi në politizimin e procedurës dhe ngriti nevojën për përputhshmëri strikte me kriteret e nenit 6.

## ii) Roli i medias

Siç diskutohet në seksionin e këtij Udhërrëfyese: ‘*Publiciteti i vendimeve përfundimtare dhe arsyeve*’, bërja publike e vendimeve gjyqësore siguron këqyrjen e gjyqësorit nga publiku dhe përbën mbrojtje kundër arbitraritetit, duke mbrojtur kështu pavarësinë dhe paanshmërinë e gjyqësorit. Prandaj, mediat luajnë rol të rëndësishëm në mbrojtjen e pavarësisë dhe paanshmërisë së gjyqësorit, për shembull kur kritikojnë dhe hetojnë imtësisht vendimet përfundimtare dhe me anë të raportimit të saktë dhe të përgjegjshëm rreth çështjeve.

### Këqyrja e gjyqësorit

Në rolin e saj si ‘rojtare’, media mund të ndihmojë në këqyrjen e funksionimit të gjyqësorit, mund të theksojë rastet kur kërcënohen pavarësia dhe paanshmëria, dhe mund të japë kontribut konstruktiv në përmirësimin e strukturave dhe praktikave të gjykatave.<sup>[268]</sup>

Duke pasur parasysh këtë, mediat nuk duhet të ndalohen nga të kritikuarit e gjyqësorit, përfshirë organizimin ose funksionimin e tij.<sup>[269]</sup> Edhe polemikat e ashpra ose kritikave të ekzagjeruara janë të lejuara sipas KEDNJ-së, kur kritika të tilla janë të bazuara në hulumtime dhe opinione ekspertësh dhe kanë të bëjnë me çështje të rënda.<sup>[270]</sup>

### Impakti i raportimeve mediatike mbi paanshmërinë dhe prezumimin e pafajësisë

Në situata të caktuara, një fushatë mediatike helmuese mund të ndikojë në drejtësinë e një gjyqi duke dëmtuar paanshmërinë e gjykatave dhe/ose prezumimin e pafajësisë.

Faktorët e rëndësishëm për vlerësimin e impaktit të një fushate mediatike mbi drejtësinë e një gjyqi përfshijnë: kohën që ka kaluar mes fushatës mediatike dhe fillimit të gjyqit; nëse çështja vendoset nga gjyqtarë profesionistë (gjyqtarët profesionistë vlerësohet se kanë më pak gjasa të ndikohen nga një fushatë mediale sesa ndihmësgjyqtarët, për shembull); nëse publikimet e kontestuara kanë mundur

268 *Fazliyski k. Bullgarisë*, vendimi i 16 prillit 2013, nr. 40908/05, § 69; *De Haes dhe Gijssels k. Belgjikës*, vendimi i 24 shkurtit 1997, nr. 19983/92 § 33.

269 KKGE (2001) Op. N° 1, § 33.

270 *De Haes dhe Gijssels k. Belgjikës*, vendimi i 24 shkurtit 1997, nr. 19983/92.

t'i atribuohen, ose të informohen nga, autoritetet; nëse ka prova që sugjerojnë se publikimet kanë ndikuar tek gjyqtarët dhe kështu kanë paragjykuar rezultatin e procedurave; dhe nëse gjykata ka marrë vendime përfundimtare të mirarsyetuara në lidhje me çështjen.<sup>[271]</sup>

Pyetja kyçe është nëse, në rrethanat specifike të çështjes, frika e kërkuesit se fushata mediatike ka ndikuar tek gjyqtari mund të vendoset të jetë objektiviisht e justifikuar.

### Kontributi drejt transparencës dhe publicitetit

---

Roli i mediave është thelbësor në transmetimin e informacioneve drejt publikut në lidhje me rolin dhe aktivitetet e gjykatave.<sup>[272]</sup> Mediat mund të ndihmojnë në rritjen e besimit publik tek gjyqësori dhe në përmirësimin e të kuptuarit publik të funksionimit të tij dhe impaktin e vendimeve të tij, duke ndihmuar kështu në mbrojtjen e dukjes së pavarësisë dhe paanshmërisë.

KKGjE-ja ka theksuar se gjykata duhet të marrë iniciativa direkte për të komunikuar me publikun dhe për të bashkëpunuar me mediat, për t'u siguruar që transparenca dhe publiciteti i vendimeve përfundimtare të mos varen vetëm nga veprimet ose raportimet në media.

Seksioni i këtij Udhërrëfyesi: '*Publiciteti i vendimeve përfundimtare dhe arsyeve*' përmban sugjerime praktike se si gjykatat dhe media mund të punojnë së bashku për të shtuar transparencën dhe publicitetin e vendimeve përfundimtare. Disa prej atyre sugjerimeve gjithashtu rekomandohen nga KKGjE-ja. Sugjerime të mëtejshme të bëra nga KKGjE-ja për mënyrat se si mund të sigurohet që media të kontribuojë në mbrojtjen, e jo dëmtimin, e pavarësisë së gjyqësorit përfshijnë:<sup>[273]</sup>

- » Gjyqtarët duhet të shprehen vetëm me anë të vendimeve përfundimtare dhe nuk duhet t'i shpjegojnë vendimet e tyre në shtyp.
- » Shtetet duhet të krijojnë ekipe për t'ua komunikuar mediave përmbledhjet e vendimeve të gjykatës, duke ofruar informacione faktike rreth vendimeve të tilla, dhe për të informuar mediat se kur dhe ku do të zhvillohen seancat. Gjyqtarët duhet të kenë rol mbikqyrës ndaj çdo zëdhënësi të gjykatës ose anëtarit të personelit që është përgjegjës për marrjen përsipër të këtyre roleve.

---

271 Paulikas k. Lituanisë, vendimi i 24 janarit 2017, nr. 57435/09; Čivinskaitė k. Lituanisë, vendimi i 15 shtatorit 2020, nr. 21218/12.

272 KKGjE (2005) Op. N° 7, § 9.

273 KKGjE (2005) Op. N° 7 (2005).

- » Shtetet duhet të ngrenë një organ të pavarur për të trajtuar problemet e shkaktuara nga tregimet në media rreth një çështjeje gjyqësore, ose vështirësive të hasura nga një gazetar gjatë marrjes së informacioneve rreth një çështjeje.
- » Çdo profesion (gjyqtarët dhe gazetarët) duhet të hartojë një kod praktikash në lidhje me marrëdhëniet me përfaqësuesit e profesioneve të tjera dhe me raportimin e çështjeve gjyqësore. Gjyqësori përcakton kushtet në të cilat mund të bëhen deklaratat në media lidhur me çështjet gjyqësore, ndërsa gazetarët krijojnë vetë rregullat e tyre për raportimin e çështjeve aktuale, sa i përket publikimit të emrave (ose fotografive) të personave të përfshirë në mosmarrëveshje dhe raportimit të vendimeve përfundimtare në çështje të cilat ngjallin interes të madh publik.

Shembuj të masave të tilla mund të gjenden brenda vetë GJEDNj-së. Për shembull, Zyra e Shqypit e Gjykatës ka zyrtarë për shtyp të cilët janë të gatshëm të ndihmojnë gazetarët me kërkesa specifike dhe t'u përgjigjen pyetjeve të tyre në shumë gjuhë të ndryshme. Kumtesat për shtyp përfshijnë përmbledhje të vendimeve përfundimtare të Gjykatës dhe vendimeve të tjera si dhe informacione rreth çështjeve në proces dhe aktiviteteve të Gjykatës në përgjithësi. Kumtesat për shtyp mund të ndiqen në mënyrë sistematike përmes llogarisë së Gjykatës në Twitter, duke u abonuar në vegzat RSS, ose duke u regjistruar në listën elektronike të saj.

### ***iii) Roli i parlamentit dhe ekzekutivit***

Siç diskutohet në seksionin e këtij Udhërrëfyese: *'Kujt / Cilave organe u zbatohet kriteri i pavarësisë?'*, neni 6 § 1 nënkupton detyrime mbi ekzekutivin, legjislativin dhe autoritetet e tjera të Shtetit për të mbrojtur të drejtën e procesit me anë të një "gjykate të pavarur dhe të paanshme". Autoritetet shtetërore duhet ta respektojnë autoritetin e gjykatave dhe të mbrojnë pavarësinë dhe paanshmërinë e gjyqësorit në sjelljet dhe praktikat e tyre të përditshme administrative.<sup>[274]</sup> Ato kanë përgjegjësinë për të zbatuar vendimet gjyqësore në mënyrë efektive dhe për t'u përmbajtur nga ndërhyrja në çështje për të mbrojtur pavarësinë dhe paanshmërinë e gjyqësorit. Në rrethana të caktuara, ato gjithashtu duhet të përmbahen nga bërja e komenteve publike në lidhje me procedurat.

274 Agrokompleks k. Ukrainës, vendimi i 6 tetorit 2011, nr. 23465/03, § 136.

## Zbatimi i vendimeve gjyqësore

Fuqia për të marrë një vendim detyrues i cili nuk mund të modifikohet nga një autoritet jo-gjyqësor në dëm të një pale individuale është i ngërthyer në vetë nocionin e “gjykatës”, siç edhe konfirmohet nga fjala “përcaktim”.<sup>[275]</sup>

Gjykata ka theksuar se kjo fuqi është pjesë përbërëse e kriterit të “pavarësisë” sipas nenit 6 § 1.<sup>[276]</sup> Gjykata ka gjetur se e drejta për gjykatë të pavarur dhe të paanshme:

*“...do të ishte iluzion në qoftë se sistemi ligjor vendas i një Shteti Kontraktues do të lejonte që një vendim përfundimtar detyrues të mbetej jo-operativ në dëm të njëjës palë. Do të ishte e pakonceptueshme që neni 6 paragrafi 1 (neni 6-1) të përshkruante me hollësi garancitë procedurale që kanë palët në mosmarrëveshje – procedura të cilat janë të drejta, publike dhe të shpejta – pa mbrojtur zbatimin e vendimeve gjyqësore; në qoftë se neni 6 (neni 6) interpretohet si i tillë që ka të bëjë vetëm me qasjen në gjykatë dhe zhvillimin e procedurave atëherë kjo mund të sjellë situata të papërputhshme me parimin e shtetit të së drejtës të cilin Shtetet Kontraktuese janë zotuar ta respektojnë kur kanë ratifikuar Konventën... Prandaj, ekzekutimi i një vendimi përfundimtar të marrë nga cilado gjykatë duhet të shihet si pjesë integrale e “gjyqit” për qëllimet e nenit 6 (neni 6)...”<sup>[277]</sup>*

Siguria ligjore, e cila është një prej aspekteve themelore të shtetit të së drejtës, kërkon që kur gjykatat e vendosin përfundimisht një çështje, vendimi i tyre nuk duhet të vihet në pyetje. Një sistem gjyqësor i karakterizuar nga mundësia e marrjes këmbëngulëse në pyetje dhe anulimet e përsëritura të vendimeve përfundimtare shkel nenin 6 § 1 të Konventës.<sup>[278]</sup> Përpjekjet e qëllimshme nga agjencitë shtetërore për të parandaluar zbatimin e një vendimi përfundimtar të zbatueshëm dhe aprovimi i heshtur, ose qoftë edhe tolerimi, i këtyre përpjekjeve nga degët legislative<sup>[279]</sup> ose

275 *Van de Hurk k. Hollandës*, vendimi i 19 prillit 1994, nr. 16034/90, § 45 (përfshirë si përmbledhje në publikim).

276 *Van de Hurk k. Hollandës*, vendimi i 19 prillit 1994, nr. 16034/90, § 45 (përfshirë si përmbledhje në publikim); shih gjithashtu, *Bentham k. Hollandës*, vendimi i 23 tetorit 1985, nr. 8848/80, § 40; *H. k. Belgjikës*, vendimi i 30 nëntorit 1987, nr. 8950/80 § 50 (përfshirë si përmbledhje në publikim); *Bellilos k. Zvicrës*, vendimi përfundimtar i 28 prillit 1988, nr. 10328/83, § 64 (përfshirë si përmbledhje në publikim).

277 *Hornsby k. Greqisë*, vendimi i 19 marsit 1997, nr. 18357/91, § 40.

278 *Sovtransavto Holding k. Ukrainës*, vendimi i 25 korrikut 2002, nr. 48553/99, §§ 74 dhe 77.

279 *Rafineritë Greke Stran dhe Stratis Andreadis k. Greqisë*, vendimi i 9 dhjetorit 1994, nr. 13427/87, § 49; *Scordino k. Italisë* (Nr. 1), vendimi i Dhomës së Madhe i 29 marsit 2006, nr. 36813/97; *Sharra dhe Të Tjerë k. Shqipërisë*, vendimi i 10 nëntorit

ekzekutive<sup>[280]</sup> të qeverisë të gjitha këto janë në gjendje të dëmtojnë kredibilitetin dhe autoritetin e gjyqësorit dhe të rrezikojnë efektivitetin e tij.<sup>[281]</sup> Këtu përfshihen konkluzionet nga anëtarë të degëve legislative ose ekzekutive të qeverisë gjatë procedurave ligjore, siç janë modifikimi i ligjit të zbatueshëm në një mosmarrëveshje në të cilën Shteti është një prej palëve,<sup>[282]</sup> ose mos-zbatimi i një vendimi të përkohshëm, që rrezikon rezultatin e tërë procedurës.<sup>[283]</sup> Përrjashtimet nga ky rregull pranohen vetëm kur kjo është e nevojshme për arsye imponuese dhe justifikohen vetëm për të korrigjuar gabimet e drejtësisë.<sup>[284]</sup>

Vënia në pyetje e vendimeve përfundimtare nga anëtarët e ekzekutivit nuk është e pranueshme, dhe ekzistenca e pushtetit të anëtarëve të ekzekutivit për të kërkuar ose bërë shqyrtimin mbikqyrës të vendimeve përfundimtare për një periudhë të pakufizuar, pasi ato vendime janë marrë, është në papajtueshmëri me nenin 6.<sup>[285]</sup> Kjo kërkesë për mbështetjen dhe ndjekjen e vendimeve përfundimtare është posaçërisht e rëndësishme në kontekstin e mbështetjes së vendimeve që kanë të bëjnë me veprimet e ekzekutivit ose legjislativit, për shembull procesi që ndjekin për emërimin e gjyqtarëve. Dështimi i organeve legislative dhe ekzekutive të qeverisë në respektimin e vendimeve përkatëse të Gjykatës Kushtetuese në lidhje me procesin e emërimit të gjyqtarëve mund të çojë në shkelje të nenit 6 për shkak se gjykata nuk është “e ngritur me ligj” dhe prandaj gjyqësori nuk është i mbrojtur nga ndikimet e paligjshme prej jashtë.<sup>[286]</sup>

## Komentet publike dhe ndërhyrjet në çështje për të ushtruar presion

Deklaratat publike të bëra nga politikanët, varësisht nga përmbajtja dhe mënyra e dhënies së deklaratave të tilla, mund të dëmtojnë të drejtën për seancë dëgjimore nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme. Kur vendoset nëse deklaratat ose ndërhyrjet

2015, nr. 25038/08, 64376/09, 64399/09, 347/10, 1376/10, 4036/10, 12889/10, 20240/10, 29442/10, 29617/10, 33154/11 dhe 2032/12.

280 *Tregoubenko k. Ukrainës*, vendimi i 2 nëntorit 2004, nr. 61333/00, § 36; *Sharxhi dhe Të Tjerë k. Shqipërisë*, vendimi i 11 janarit 2018, nr. 10613/16 (përfshirë si përmbledhje në publikim).

281 *Bronioëski k. Polonisë*, vendimi i Dhomës së Madhe i 28 shtatorit 2005, nr. 31443/96, § 176.

282 *Rafinëritë Greke Stran dhe Stratis Andreadis k. Greqisë*, vendimi i 9 dhjetorit 1994, nr. 13427/87.

283 *Sharxhi dhe Të Tjerë k. Shqipërisë*, vendimi i 11 janarit 2018, nr. 10613/16 (përfshirë si përmbledhje në publikim).

284 *Ryabykh k. Rusisë*, vendimi i 24 korrikut 2003, nr. 52854/99, § 52.

285 *Brumărescu k. Rumanisë*, vendimi i Dhomës së Madhe i 28 tetorit 1999, nr. 28342/95.

286 *Xero Flor w Polsce sp. z o.o. v. Poland*, vendimi i 7 majit 2021, nr. 4907/18, §287 (përfshirë si përmbledhje në publikim); shih gjithashtu seksionin e këtij Udhërrëfyty: ‘Gjykata e ngritur me ligj’. *Ju lutemi vini re: në kohën e shkrimit ky vendim nuk ka marrë ende formë të prerë në rrethanat e cekura në nenin 44 § 2 të KEDNJ-së.*

në procedura nga ministrat ose politikanët kanë shkelur nenin 6, është me rëndësi të merret në konsideratë:

- » Rangu / vjetërsia e politikanëve të cilët kanë bërë komente, dhe numri i ministrave që kanë bërë komente.
- » Nëse komentet kanë qenë të drejtuara specifikisht drejt gjyqësorit.<sup>[287]</sup>
- » Forca / natyra e komenteve – për shembull, komente të forta negative, ose shprehja e opinioneve të qarta kanë më shumë gjasa të dëmtojnë pavarësinë dhe paanshmërinë.<sup>[288]</sup>
- » Momenti kur janë dhënë komentet dhe numri i ndërhyrjeve të bëra.
- »

Neni 6 mund të shkelet me anë të komenteve, kërcënimeve ose presioneve të ushtruara nga ministrat edhe kur nuk ka prova që ato kanë pasur ndikim tek gjyqtarët. Këtu rrezikohet dukja e paanshmërisë dhe angazhohet neni 6 kur deklaratat ose veprimet e politikanëve krijojnë një atmosferë ose përshtypje që veprimet dhe vendimet e gjyqtarëve gjatë procedurave janë duke u vëzhguar nga afër prej qeverisë.<sup>[289]</sup>

---

287 *Kinsky k. Republikës Çeke*, vendimi i 9 shkurtit 2012, nr. 42856/06, §93, në kontrast me *Mosteanu dhe Tërë k. Rumanisë*, vendimi i 26 nëntorit 2002, nr. 33176/96, § 42: ku deklarata publike e Presidentit që rikthimi i vendimeve përfundimtare nuk duhet të zbatohet u konsiderua nga Gjykata se i drejtohej kryesisht administratës së ngarkuar me zbatimin e vendimeve. Ngjashëm, tek *Xheraj k. Shqipërisë*, vendimi i 29 korrikut 2008, nr. 37959/02, Presidenti i Republikës kërkoi që Prokurori i Përgjithshëm të rihapte procedurën penale kundër kërkuesit pas një vendimi përfundimtar për shfajësim. Kjo rihapje u konsiderua nga Gjykata si shkelje e nenit 6 § 1 sepse ajo vuri mënjanë një vendim gjyqësor përfundimtar.

288 *Kinsky k. Republikës Çeke*, vendimi i 9 shkurtit 2012, nr. 42856/06, § 91.

289 *Kinsky k. Republikës Çeke*, vendimi i 9 shkurtit 2012, nr. 42856/06, § 98.

## (8) MARRËDHËNIA MES PAVARËSISË DHE PAANSHMËRISË DHE NENEVE TË TJERA TË KONVENTËS

### a) Mbrojtjet procedurale

Detyrimi i Shteteve për të garantuar seancën ose hetimet nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme mund të dalë sipas neneve të tjera të Konventës, përveç nenit 6. Gjykata ka theksuar se pavarësia është një prej elementeve përbërëse më të rëndësishme të nocionit të “gjykatës”, siç përmendet në shumë nene të Konventës.<sup>[290]</sup> Kjo mund të ndodhë në kontekstin e detyrimeve specifike procedurale hetimore të cilat dalin prej neneve 2, 3 dhe 5 të Konventës. Përndryshe, pajtueshmëria me një detyrim të tillë mund të formojë një pjesë të vlerësimit lidhur me faktin nëse një ndërhyrje tek nenet 8-10 është në pajtueshmëri me parimin e proporcionalitetit dhe është në përputhje me ligjin.

#### i) Neni 2 – E drejta e jetës

Neni 2 i KEDNj-së mbron të drejtën e jetës. Sipas nenit 2, Shtetet kanë një detyrim të theksuar për të zhvilluar hetime efektive rreth vdekjes së një individi në rrethanat kur ka dyshime për shkelje të detyrimeve substanciale të Shtetit sipas nenit 2.<sup>[291]</sup>

Natyra dhe fushëveprimi i saktë i detyrave hetimore varet nga rrethanat e një çështjeje të veçantë, por së paku hetimet duhet të jenë efektive, që do të thotë se duhet të jenë në gjendje të konstatojnë faktet, të identifikojnë përgjegjësit dhe, nëse duhet, të caktojnë formën e dukur të ndëshkimit ose zgjidhjes. Për këtë qëllim, Gjykata ka vendosur që detyrimi procedural sipas nenit 2 të Konventës kërkon që Shtetet të kenë sistem ligjor të pavarur efektiv.<sup>[292]</sup>

Kjo garanci e procedurës së kontradiktorialitetit para një gjyqtari të pavarur dhe të paanshëm duhet të shihet si i tillë që ofron mbrojtjen më të fortë të një procedure efektive në gjetjen e fakteve dhe përcaktimin e përgjegjësisë,<sup>[293]</sup> qoftë penale apo e ndonjë lloji tjetër.

290 *Šilih k. Slovenisë*, vendimi i Dhomës së Madhe i 9 prillit 2009, nr. 71463/01, § 159.

291 *Šilih k. Slovenisë*, vendimi i Dhomës së Madhe i 9 prillit 2009, nr. 71463/01, § 159.

292 *Lopes de Sousa Fernandes k. Portugalisë*, vendimi i Dhomës së Madhe i 19 dhjetorit 2017, nr. 56080/13, § 214; *Sinim k. Turqisë*, vendimi i 6 qershorit 2017, nr. 9441/10, § 59; *Ciechońska k. Polonisë*, vendimi i 14 qershorit 2011, nr. 19776/04, § 66.

293 *McKerr k. Mbretërisë së Bashkuar*, vendimi i 4 majit 2001, nr. 28883/95, § 134.



Për të qenë efektivë, ata që mbajnë përgjegjësi për kryerjen e hetimeve duhet të jenë të pavarur nga ata që janë të përfshirë në ngjarje. Kriteri i pavarësisë i përgjegjësve të hetimeve duhet të kuptohet si i tillë që nuk përfshin vetëm pavarësinë formale por edhe pavarësinë *de facto* prej atyre që supozohet se janë të implikuar në rrethana ku ka humbje jete ose ku jeta vihet në rrezik.<sup>[294]</sup> Nëse kjo pavarësi është e pranishme në një çështje të dhënë, kjo varet nga rrethanat konkrete të çështjes.<sup>[295]</sup>

Nuk duhet të ketë varësi hierarkike, lidhje institucionale ose praktike mes atyre që zhvillojnë hetimet dhe atyre që janë nën hetime.<sup>[296]</sup> Për shembull, kur hetimet ndaj policisë zhvillohen nga oficerë të lidhur me ose të varur nga ata që janë objekt i hetimeve, mbikqyrja e këtyre hetimeve nga një organ i pavarur nuk mjafton për të përmbushur kriteret e nenit 2. Në vend të kësaj, duhet të ngrihet një agjenci hetimore krejtësisht e pavarur.<sup>[297]</sup>

Sipas nenit 2, hetimet për shkelje të mundshme të së drejtës së jetës duhet të zhvillohen menjëherë, me shpejtësi të arsyeshme. Edhe kur mund të ketë pengesa ose vështirësi që pengojnë përparimin e hetimeve rreth një situatë të caktuar, reagimi i shpejtë i autoriteteve është jetik për ruajtjen e besimit publik në faktin që ato iu përmbahen shtetit të së drejtës dhe parandalimit të dukjes së përplasjeve ose tolerimit të akteve të paligjshme, të cilat mund të dëmtojnë pavarësinë e hetimeve.<sup>[298]</sup> Përveç kësaj, konkluzionet e hetimeve duhet të bazohen në analiza të tërësishme, objektive dhe të paanshme të të gjitha elementeve përkatëse të çështjes.<sup>[299]</sup>

Detyrime të tilla në lidhje me operimin e një sistemi gjyqësor të pavarur për qëllimet e aspektit procedural të nenit 2, nuk mbulojnë vetëm rastet kur jeta vihet në rrezik me qëllim, por edhe rastet kur jeta vihet në rrezik si pasojë e neglizhencës.<sup>[300]</sup> Më saktë, në kontekstin e kujdesit shëndetësor, detyrimi pozitiv sipas nenit 2 kërkon që Shtetet të ngrënë një sistem gjyqësor efektiv dhe të pavarur për t'u siguruar që shkak i vdekjes së pacientëve nën kujdesin e profesionit mjekësor, pavarësisht nëse

294 *Armani Da Silva k. Mbretërisë së Bashkuar*, vendimi i Dhomës së Madhe i 3 marsit 2016, nr. 5878/08, § 232.

295 *Mustafa Tunç dhe Fecire Tunç k. Turqisë*, vendimi i Dhomës së Madhe i 14 prillit 2015, nr. 24014/05, §§ 222-224 (përfshirë si përmbledhje në publikim).

296 *Shoqata "21 dhjetori 1989" dhe Tërë k. Rumanisë*, vendimi i 24 majit 2011, nr. 33810/07 dhe nr. 18817/08: shkelje e nenit 2 ku hetimet i ishin besuar prokurorëve ushtarakë të cilët, si shumica e të akuzuarve, përfshirë oficerë të rangut të lartë, kishin marrëdhënie varësie brenda hierarkisë ushtarake.

297 *McKerr k. Mbretërisë së Bashkuar*, vendimi i 4 majit 2001, nr. 28883/95, § 128.

298 *Šilih k. Slovenisë*, vendimi i Dhomës së Madhe i 9 prillit 2009, nr. 71463/01, § 195.

299 *Armani Da Silva k. Mbretërisë së Bashkuar*, vendimi i Dhomës së Madhe i 3 marsit 2016, nr. 5878/08, § 240.

300 *Ciechońska k. Polonisë*, vendimi i 14 qershorit 2011, nr. 19776/04, § 66, *Anna Todorova k. Bullgarisë*, § 72.

bëhet fjalë për sektorin publik apo privat, të mund të konstatohet dhe përgjegjësit të japin llogari.<sup>[301]</sup>

## ii) Neni 3 – Mbrojtja kundër torturës dhe keqtrajtimit

Neni 3 parashikon që askush nuk duhet t'i nënshtrohet torturës, trajtimit ose ndëshkimit çnjerëzor ose poshtërues. Ashtu si neni 2, edhe neni 3 përmban detyrimin e theksuar procedural për të kryer hetime efektive për shkeljet e mundshme të nenit. Shtetet e kanë për detyrim të parandalojnë dhe të ofrojnë zgjidhje për torturën dhe forma të tjera të keqtrajtimit, dhe neni 3 kërkon që të zhvillohen hetime efektive zyrtare rreth pretendimeve të argumentueshme për tortura ose keqtrajtime.

Koncepti i hetimeve 'efektive' kërkon që hetimet të kryhen nga hetues të pavarur që nuk kanë lidhje me personat e akuzuar për shkelje të nenit 3,<sup>[302]</sup> dhe që detyrimet pozitive sipas nenit 3 të pasqyrojnë, në masë të madhe, detyrimet e diskutuara në seksionin e këtij Udhërrëfyesi: 'Neni 2 – E drejta e jetës'.

Gjykata ka gjetur që hetimeve efektive, procedurat penale, ndjekjet penale, dhe vendosja e sanksioneve disiplinore të duhura për shkeljen e nenit 3 janë:

*“jetike për të garantuar që efekti pengues i sistemit gjyqësor të jetë në rregull dhe që domethënia e rolit që i kërkohet të luajë në parandalimin e shkeljeve dhe ndalimin e keqtrajtimit të mos dëmtohet ...”<sup>[303]</sup>*

Ky detyrim është posaçërisht i rëndësishëm duke pasur parasysh se shumë raste keqtrajtimesh ndodhin në duart e zyrtarëve të qeverisë dhe në institucionet e heqjes së lirisë. Autoritetet shtetërore janë të detyruara të reagojnë në mënyrë efektive dhe të pavarur jo vetë në rastet e pretendimeve për tortura ose keqtrajtime,<sup>[304]</sup> por gjithashtu edhe kur vihen në dijeni se akte të tilla mund të kenë ndodhur, në prani të lëndimeve të dukshme, për shembull.<sup>[305]</sup>

301 *Šilih k. Sllovenisë*, vendimi i Dhomës së Madhe i 9 prillit 2009, nr. 71463/01; *Lopes de Sousa Fernandes k. Portugalisë*, vendimi i Dhomës së Madhe i 19 dhjetorit 2017, nr. 56080/13, § 214.

302 *Taraburca k. Moldavisë*, vendimi i 6 dhjetorit 2011, nr. 18919/10, § 54.

303 *Gäfgen k. Gjermanisë*, vendimi i Dhomës së Madhe i 1 qershorit 2010, nr. 22978/05, § 121.

304 *Shih Aksoy k. Turqisë*, vendimi i 18 dhjetorit 1996, nr. 21987/93, § 59.

305 *Taraburca k. Moldavisë*, vendimi i 6 dhjetorit 2011, nr. 18919/10, § 56.

Qasja tek gjyqtarët e pavarur duhet të garantohet jo vetëm kur bëhet fjalë për regjimin e heqjes së lirisë,<sup>[306]</sup> por edhe kur janë në rrezik të drejtat dhe liritë e personave të paraburgosur.<sup>[307]</sup>

Një element tjetër i të drejtës për qasje në një mekanizëm gjyqësor të pavarur dhe të paanshëm, i cili është thelbësor në mbrojtjen e individëve nga keqtrajtimi është e drejta që kërkuesi të marrë pjesë efektivisht në procedura gjyqësore për të mbrojtur pozicionin e tij.<sup>[308]</sup> Vetëm gjyqtarët e pavarur dhe të paanshëm mund të ofrojnë një garanci të tillë të pjesëmarrjes efektive.<sup>[309]</sup>

Çështja e pavarësisë së gjyqësorit është po ashtu kritike në kuadër të Urdhërarrestit Evropian brenda BE-së.<sup>[310]</sup>

### **iii) Neni 4 – Ndalimi i skllavërisë dhe punës së detyruar**

E drejta për të mos qenë viktimë e akteve që kualifikohen si skllavëri ose punë e detyruar, e mbrojtur nga neni 4 i KEDNJ-së, gjithashtu ngërthen detyrime procedurale për Shtetet Anëtare, të përpiluara në të njëjtat kushte si ato të neneve 2 dhe 3, të përmendura lart.<sup>[311]</sup>

Të njëjtat kriterë të pavarësisë, thellësisë, shpejtësisë, mbikqyrjes publike dhe përfshirjes së viktimës janë të pranishme në çështjet e pretendimeve për skllavëri, trafikim me qenie njerëzore dhe punë e detyruar, të cilat hyjnë brenda këtij neni.<sup>[312]</sup>

306 *Ramirez Sanchez k. Francës*, vendimi i Dhomës së Madhe i 4 korrikut 2006, nr. 59450/00, §§ 139 dhe 145-146.

307 *Golder k. Mbretërisë së Bashkuar*, vendimi i 21 shkurtit 1975, nr. 4451/70.

308 *Margaretić k. Kroacisë*, vendimi i 5 qershorit 2014, nr. 16115/13, § 128; *Altay k. Turqisë (Nr. 2)*, vendimi i 9 prillit 2019, nr. 11236/09, §§ 79-82.

309 Shih <https://www.refworld.org/pdfid/44c489364.pdf> "Përgjigjja e Qeverisë Shqiptare ndaj Raportit të Komitetit Evropian për Parandalimin e Torturës dhe Trajtimin ose Ndëshkimit Çnjerëzor ose Poshtëruar (CPT) gjatë vizitës së tij në Shqipëri nga 23 maji deri më 3 qershor 2005", CPT/Inf (2006) 24, CoEI § 54.

310 *OG dhe PI k. Prokurorisë Publike në Lübeck dhe në Zwickau*, vendimi i Dhomës së Madhe i 27 majit 2019, nr. C-508/18 dhe C-82/19 PPU.

311 *S.M. k. Kroacisë*, vendimi i Dhomës së Madhe i 19 korrikut 2018, nr. 60561/14, §§ 309-311.

312 *Rantsev k. Qipros dhe Rusisë*, vendimi i 7 janarit 2010, nr. 25965/04; *Chowdury dhe Të Tjerë k. Greqisë*, vendimi i 30 marsit 2017, nr. 21884/15, §§ 123-127; *S.M. k. Kroacisë*, vendimi i Dhomës së Madhe i 19 korrikut 2018, nr. 60561/14, § 305.

#### iv) Neni 5 – E drejta për liri dhe siguri

Neni 5 mbron të drejtën për lirinë dhe sigurinë e personit. Qëllimi i nenit 5 është të mbrojë individin nga paraburgimi arbitrar, përfshirë të siguarit që akti i heqjes së lirisë i nënshtrohet shqyrtimit juridik.<sup>[313]</sup>

Neni 5 § 1 (a) i Konventës parashikon:

*“Askujt nuk mund t’i hiqet liria, me përjashtim të rasteve që vijnë dhe në përputhje me procedurën e parashikuar me ligj: (a) kur burgoset ligjërisht pas një dënimi të dhënë nga një **gjykatë kompetente**.”* (Theksi i shtuar)

Termi gjykatë kompetente në këtë dispozitë i referohet një institucioni që është ngritur me ligj,<sup>[314]</sup> i cili duhet të jetë i pavarur nga ekzekutivi dhe palët në procedurë, i cili zhvillon procedura të natyrës juridike<sup>[315]</sup> dhe ka fuqi juridike; që do të thotë kompetencën për të vendosur ligjshmërinë e paraburgimit dhe më pas autorizimin e lirimit të të paraburgosurit në qoftë se paraburgimi gjendet se është i paligjshëm.<sup>[316]</sup>

Neni 5 § 3 parashikon:

*“Çdo person i arrestuar ose i paraburgosur në rrethanat e parashikuara në paragrafin 1(c) të këtij neni duhet të çohet menjëherë para një gjyqtari ose një zyrtari të autorizuar me ligj për të ushtruar funksione gjyqësore, dhe ka të drejtë të gjykohet brenda një afati të arsyeshëm ose të lirohet në gjykim e sipër. Lirimi mund të kushtëzohet me dhënien e garancive për t’u paraqitur në procesin gjyqësor.”*

Roli i gjyqtarit ose zyrtarit të përmendur në nenin 5 § 3 është të shqyrtojë rrethanat pro dhe ato kundër paraburgimit dhe të vendosë, duke iu referuar kriterëve ligjore: i) nëse ka arsye që justifikojnë paraburgimin; dhe ii) të urdhërojë lirimin në qoftë se nuk ka arsye të tilla. Ashtu si gjykata kompetente sipas nenit 5 § 1 (a) që përshkruhet lart, gjyqtari ose zyrtari gjyqësor që ushtron fuqi juridike në fakt duhet të ketë fuqinë për të liruar personin e paraburgosur në qoftë se masa e paraburgimit gjendet se është e paligjshme ose e pajustificuar.<sup>[317]</sup>

313 *Aquilina k. Maltës*, vendimi i Dhomës së Madhe i 29 prillit 199, nr. 25642/94, § 49.

314 *Yefimenko k. Rusisë*, vendimi i 12 shkurtit 2013, nr. 152/04, §§ 109-11.

315 *De Wilde, Ooms dhe Versyp k. Belgjikës*, vendimi i 18 qershorit 1971, nr. 2832/66, 2835/66 dhe 2899/66, § 78.

316 *Weeks k. Mbretërisë së Bashkuar*, vendimi i 2 marsit 1987, nr. 9787/82, § 61.

317 *McKay k. Mbretërisë së Bashkuar*, vendimi i Dhomës së Madhe i 3 tetorit 2006, nr. 543/03, § 40.

Referimi tek “një gjyqtar ose zyrtar tjetër të autorizuar me ligj për të ushtruar fuqi gjyqësore” është konsideruar nga Gjykata si sinonim i termit “gjykatë kompetente” të përshkruar më lart sipas nenit 5 § 1 (a).<sup>[318]</sup> Prandaj, ai duhet të respektojë të njëjtat cilësi të përshkruara më lart, për të garantuar që personit të paraburgosur nuk i hiqet liria në mënyrë arbitrare ose të pajustificuar.<sup>[319]</sup> Këto kushte përfshijnë faktin që një zyrtar duhet të jetë i pavarur nga ekzekutivi dhe nga palët. Në qoftë se zyrtari mund të ndërhyjë më vonë në procedurat vijuese si përfaqësues i autoritetit prokurorial, ai/ ajo nuk mund të shihet si i/e pavarur nga palët në atë fazë paraprake, sepse është e mundur që ai/ajo të bëhet një prej palëve në një fazë të mëvonshme të procedurës.<sup>[320]</sup>

Më tej, pavarësia dhe paanshmëria e zyrtarit gjithashtu mund të përcaktohet në qoftë se ai ka rol të dyfishtë në zbatimin e disiplinës dhe urdhërimin e paraburgimit, si dhe në marrjen e vendimeve rreth lirimimit. Ky do të ishte problem posaçërisht në qoftë se një prej arsyeve që lejojnë që zyrtari ta refuzojë lirimimin e një individi ka të bëjë me interesat e disiplinës.<sup>[321]</sup>

Neni 5 § 4 parashikon:

*“Çdo person të cilit i është hequr liria me arrestim ose me burgim ka të drejtë të bëjë ankim në gjykatë me qëllim që kjo e fundit të vendosë, brenda një afati të shkurtër, për ligjshmërinë e burgimit të tij dhe të urdhërojë lirimimin, në qoftë se burgimi është i paligjshëm.”*

Forma e shqyrtimit gjyqësor që zhvillohet sipas nenit 5 § 4 mund të varet nga natyra e heqjes së lirisë sipas nenit 5 § 1, dhe forma e shqyrtimit mund të dallojë nga njëra fushë në tjetrën.<sup>[322]</sup> Megjithatë, pavarësisht nga konteksti ose forma e shqyrtimit, gjykata në të cilën personi të cilit i është hequr liria duhet të ketë qasje sipas nenit 5 § 4 duhet të jetë organ gjyqësor i pavarur.<sup>[323]</sup> Parimet e përgjithshme në lidhje me pavarësinë dhe paanshmërinë e gjykatës për qëllimet e nenit 6

318 *Schiesser k. Zvicrës*, vendimi i 4 dhjetorit 1979, nr. 7710/76, § 29.

319 *Hood k. Mbretërisë së Bashkuar*, vendimi i Dhomës së Madhe i 18 shkurtit 1999, nr. 27267/95; *Nikolova k. Bullgarisë*, vendimi i Dhomës së Madhe i 25 marsit 1999, nr. 31195/96, § 49.

320 *Hood k. Mbretërisë së Bashkuar*, vendimi i Dhomës së Madhe i 18 shkurtit 1999, nr. 27267/95; *Brincat k. Italisë*, vendimi i 26 nëntorit 1992, nr. 13967/88, § 20.

321 *Hood k. Mbretërisë së Bashkuar*, vendimi i Dhomës së Madhe i 18 shkurtit 1999, nr. 27267/95, § 58.

322 *Khlaifa dhe Të Tjerë k. Italisë*, vendimi i Dhomës së Madhe i 15 dhjetorit 2016, nr. 16483/12, § 129.

323 *Stephens k. Maltës (Nr. 1)*, vendimi i 21 prillit 2009, nr. 11956/07; *Baş k. Turqisë*, vendimi i 3 marsit 2020, nr. 66448/17, § 266.

të Konventës<sup>[324]</sup> zbatohen njësoj për nenin 5 § 4.<sup>[325]</sup> Sipas Gjykatës, do të ishte e pakonceptueshme që neni 5 § 4 i Konventës, i cili ka të bëjë me çështje aq të ndjeshme siç është heqja e lirisë, të mos parashikonte njësoj, si kriter themelor, paanshmërinë e gjykatës që vendos mbi çështje të tilla.<sup>[326]</sup>

### **v) Neni 8 – E drejta e jetës private dhe familjare**

Neni 8 i KEDNj-së mbron të drejtën e një personi për respekt ndaj jetës private dhe familjare, shtëpisë dhe korrespondencës. Sipas nenet 8 § 2, ndërhyrja tek të drejtat e mbrojtura nga neni 8 § 1 lejohet në qoftë se ndërhyrja synon një qëllim legjitim, është në pajtueshmëri me ligjin dhe është proporcionale me qëllimin legjitim të synuar.

Ky kriter i proporcionalitetit sipas nenet 8 ngërthen si mbrojtje procedurale, ashtu edhe substanciale.<sup>[327]</sup> Prandaj, në situata të caktuara, mbrojtjet e nenet 8 mund t'i japin shkas të drejtës për seancë dëgjimore para një gjykate të pavarur, edhe kur nuk angazhohet neni 6.<sup>[328]</sup>

Kur një Shtet ndërhyr tek të drejtat e individit nga neni 8, procesi i vendimmarrjes që çon tek masat e ndërhyrjes duhet të jetë mjaftueshëm i drejtë sa të tregojë respektin e duhur për interesat e mbrojtura të individit nga neni 8.

Shkalla e mbrojtjeve procedurale për të siguruar pajtueshmërinë me nenin 8 varet nga pesha dhe natyra e ndërhyrjes. Për shembull, në kontekstin e procedurave të posedimit, meqenëse “*humbja e shtëpisë është formë shumë ekstreme e ndërhyrjes tek e drejta e respektit për shtëpinë*”, çdo person në rrezik ndërhyrjeje “të kësaj shkalle” duhet të ketë mundësinë që proporcionaliteti i masës të caktohet nga gjykata, duke marrë parasysh parimet përkatëse nga neni 8.

Shqyrtimi i situatës nga një gjykatë e pavarur, në përputhje me parimet e vendosura nga praktika gjyqësore e Gjykatës, është garanci e fortë e ligjshmërisë dhe proporcionalitetit në shumë situata të ndryshme sipas nenet 8 të Konventës, një

324 Elaboruar nga Gjykata tek *Ramos Nunes de Carvalho e Sá k. Portugalisë*, vendimi i Dhomës së Madhe i 6 nëntorit 2018, nr. 55391/13, 57728/13 dhe 74041/13, §§ 144-150 (përfshirë si përmbledhje në publikim).

325 *Baş k. Turqisë*, vendimi i 3 marsit 2020, nr. 66448/17, § 267.

326 *Ali Osman Özmen k. Turqisë*, vendimi i 5 korrikut 2016, nr. 42969/04, § 85.

327 *McCann dhe Tërë k. Mbretërisë së Bashkuar*, vendimi i 13 gushtit 2008, nr. 19009/04.

328 *McCann dhe Tërë k. Mbretërisë së Bashkuar*, vendimi i 13 gushtit 2008, nr. 19009/04; *Connors k. Mbretërisë së Bashkuar*, vendimi i 27 majit 2004, nr. 66746/01.

prej të cilave është migrimi,<sup>[329]</sup> dëbimet,<sup>[330]</sup> sekreti i korrespondencës,<sup>[331]</sup> përgjimet telefonike<sup>[332]</sup> ose masat e vëzhgimit në përgjithësi<sup>[333]</sup> dhe qasja në informacione.<sup>[334]</sup>

Edhe kur procedura që çon drejt ndërhyrjes mund të kontestohet me anë të shqyrtimit gjyqësor, kjo nuk mjafton si mbrojtje procedurale në qoftë se procedura e shqyrtimit gjyqësor nuk ofron mundësi të përshtatshme për të rishqyrtuar çështjet faktike përkatëse.<sup>[335]</sup> Duhet të jetë mundësia që një gjykatë e pavarur ta shqyrtojë proporcionalitetin e masës që ndërhyrjen tek neni 8, duke marrë parasysh të gjitha çështjet përkatëse faktike si dhe ligjore.

## ***vi) Neni 10 – Liria e shprehjes***

Neni 10 i KEDNJ-së mbron të drejtën e një personi për lirinë e shprehjes. Sipas nenit 10 § 2, ndërhyrja tek të drejtat e mbrojtura nga neni 10 § 1 lejohet në qoftë se ndërhyrja është në përputhje me ligjin, synon një qëllim legjitim dhe është proporcionale me qëllimin legjitim të synuar.

Kriteri që ndërhyrja të jetë “në përputhje me ligjin” ose “e parashikuar me ligj” kërkon që masa në fjalë të jetë e bazuar në të drejtën vendase dhe që e drejta vendase të jetë deri diku cilësore. Për shembull, e drejta vendase duhet të jetë e përdorshme dhe e parashikueshme, dhe duhet të ofrojë mbrojtje ligjore kundër ndërhyrjeve arbitrare nga autoritetet publike tek të drejtat e mbrojtura nga Konventa.<sup>[336]</sup>

Prandaj, kriteri që ndërhyrja tek neni 10 të jetë “në përputhje me ligjin” mund t’i japë shkas detyrimit për t’u siguruar që ndërhyrja tek neni 10 t’i nënshtrohet shqyrtimit nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, si garanci procedurale për të

329 *Levakovic k. Danimarkës*, vendimi i 23 tetorit 2018, nr. 7841/14, § 42.

330 *Ozdi dhe Tërë k. Republikës së Moldavisë*, vendimi i 11 qershorit 2019, nr. 42305/18, § 68.

331 *Ozdi dhe Tërë k. Republikës së Moldavisë*, vendimi i 11 qershorit 2019, nr. 42305/18, § 68.

332 *Petri Sallinen and Others k. Finland*, vendimi i 27 shtatorit 2005, nr. 50882/99, § 92.

333 *Roman Zakharov k. Rusisë*, vendimi i Dhomës së Madhe i 04 dhjetorit 2015, nr. 47143/06, § 275.

334 *M.G. k. Mbretërisë së Bashkuar*, vendimi i 24 shtatorit 2002, nr. 39393/98, §§ 31-32.

335 *McCann dhe Tërë k. Mbretërisë së Bashkuar*, vendimi i 13 gushtit 2008, nr. 19009/04, § 53: “mbrojtjet procedurale” që kërkon neni 8 për vlerësimin e proporcionalitetit të ndërhyrjes nuk janë përmbytur me mundësinë e kërkuesit për të kërkuar shqyrtim gjyqësor dhe për të pasur një këqyrje nga gjykatat të ligjshmërisë dhe arsyshmërisë së vendimeve të autoriteteve lokale. Procedura e shqyrtimit gjyqësor u gjet se ishte e papërshtatur me konstatimin e çështjeve të ndjeshme faktike, të cilat do të trajtoheshin më efektivisht nga Gjykata Krahinore përgjegjëse për urdhërimin e posedimit.

336 *Sanoma Uitgevers B.B. k. Hollandës*, vendimi i Dhomës së Madhe i 14 shtatorit 2010, nr. 38224/03, § 81.

siguruar që e drejta e lirisë së shprehjes të mos i nënshtrohet ndërhyrjeve arbitrare nga autoritetet publike.

Për shembull, duke pasur parasysh rëndësinë jetike të lirisë së shtypit, në rastet që kanë të bëjnë me mbrojtjen e burimeve gazetareske, neni 10 kërkon që çdo urdhër për të zbuluar një burim gazetarie t'i nënshtrohet shqyrtimit nga një gjyqtar ose një organ tjetër të pavarur vendimmarrës. Sipas nenit 10, një organ që është i pavarur nga ekzekutivi, dhe nga çdo palë tjetër e interesuar, duhet të ketë fuqinë për të peshuar interesat e ndryshme të përfshira dhe të përcaktojë nëse interesi publik i zbulimit të burimit është më i rëndësishëm sesa parimi i mbrojtjes së burimeve gazetareske.<sup>[337]</sup>

Ky organ i pavarur duhet të jetë në gjendje të peshojë rreziqet potenciale dhe interesat përkatëse para çdo zbulimi dhe, sa i përket materialit në fjalë, të mbrojë mjaftueshëm të drejtën e konfidencialitetit të burimeve të gazetarisë. Një shqyrtim i pavarur që zhvillohet pas zbulimit nuk mjafton për ta mbrojtur këtë të drejtë.<sup>[338]</sup>

### **vii) Neni 13 – E drejta për zgjidhje efektive**

Neni 13 i KEDNj-së parashikon:

*“Çdokush, të cilit i janë shkelur të drejtat dhe liritë e përcaktuara në këtë Konventë, ka të drejtën e një zgjidhjeje efektive para një organi kombëtar, pavarësisht se shkelja është kryer nga persona që veprojnë në përmbushje të funksioneve zyrtare.”*

Qëllimi i nenit 13 është të ofrojë mënyra përmes të cilave individët mund të gjejnë zgjidhje në shkallë kombëtare për shkeljet e të drejtave të tyre të Konventës, para se t'u duhet të vënë në lëvizje instrumentet ndërkombëtare të një ankese para Gjykatës.<sup>[339]</sup>

“Autoriteti” i përmendur në nenin 13 jo gjithmonë duhet të jetë institucion gjyqësor në sensin e ngushtë të gjykatës brenda kuptimit të neneve 6 § 1 dhe 5 § 4 të Konventës.<sup>[340]</sup> Për shembull, mund të jetë një organ thujse-gjyqësor, si avokati i popullit, një autoritet administrativ si një ministër i qeverisë, ose një autoritet

337 *Sanoma Uitgevers B.B. k. Hollandës*, vendimi i Dhomës së Madhe i 14 shtatorit 2010, nr. 38224/03, §§ 90-93.

338 *Sanoma Uitgevers B.B. k. Hollandës*, vendimi i Dhomës së Madhe i 14 shtatorit 2010, nr. 38224/03.

339 *Kudła k. Polonisë*, vendimi i Dhomës së Madhe i 26 tetorit 2000, nr. 30210/96, § 152.

340 *Golder k. Mbretërisë së Bashkuar*, vendimi i 21 shkurtit 1975, nr. 4451/70, § 33; *Klass dhe Tjërë k. Gjermanisë*, vendimi i 6 shtatorit 1978, nr. 5029/71, § 67.



politik si një komision parlamentar.<sup>[341]</sup> Megjithatë, fuqitë e autoritetit dhe mbrojtjet procedurale që jep ai merren në konsideratë për të vendosur nëse zgjidhja është efektive, përfshirë faktin nëse ndonjë “autoritet” jogjyqësor është i pavarur.<sup>[342]</sup>

Për shembull, autoriteti shqyrtues nuk mund të jetë organi politik që ka lëshuar udhëzimet e kontestuara, përndryshe do të ishte gjyqtar i çështjes së vet.<sup>[343]</sup>

Në kontekstin specifik të kërkesave për azil, sadoqë nuk hyjnë brenda nenit 6 § 1, neni 13 kërkon: “*këqyrje të pavarur dhe të rreptë të një pretendimi që ekzistojnë baza substanciale për t’iu frikësuar rrezikut real të trajtimit në kundërshtim me nenin 3.*”<sup>[344]</sup> (Theksi i shtuar)

### viii) Neni 1 i Protokollit Nr. 1

Neni 1 i Protokollit Nr. 1 mbron të drejtën për gëzimin paqësor të pasurisë. Megjithëse Neni 1 i Protokollit Nr. 1 nuk përmban kritere procedurale të shprehura në mënyrë specifike, ai kuptohet në mënyrë të atillë që do të thotë se personave të prekur nga masat që ndërhyjnë tek “pasuria” e tyre duhet t’u ofrohen mundësi të arsyeshme për ta sjellë çështjen e tyre para autoriteteve përgjegjëse me qëllim të kontestimit efektiv të atyre masave.<sup>[345]</sup> Në rrethana të caktuara, Shtetet duhet të ofrojnë mekanizmat e përshtatshme ligjore për t’i mundësuar një pale të dëmtuar të vërë në vend të drejtat e saj në mënyrë efektive.

Përveç pavarësisë dhe paanshmërisë së organit shqyrtues, është e nevojshme të vlerësohet nëse procedura i ka ofruar kërkuarit mundësinë e drejtë të mbrojtjes së interesave të tij/saj.<sup>[346]</sup> Megjithatë, kur një masë që ndërhyr tek të drejtat e Neni 1

341 *Leander k. Suedisë*, vendimi i 26 marsit 1987, nr. 9248/81; *Boyle dhe Rice k. Mbretërisë së Bashkuar*, vendimi i 27 prillit 1988, nr. 9659/82 dhe 9658/82; *Klass dhe Tjërë k. Gjermanisë*, vendimi i 6 shtatorit 1978, nr. 5029/71.

342 *Klass dhe Tjërë k. Gjermanisë*, vendimi i 6 shtatorit 1978, nr. 5029/71, § 67; *Leander k. Suedisë*, vendimi i 26 marsit 1987, nr. 9248/81, § 77.

343 *Silver dhe Tjërë k. Mbretërisë së Bashkuar*, vendimi i 25 marsit 1983, nr. 5947/72, 6205/73, 7052/75, 7061/75, 7107/75, 7113/75 dhe 7136/75, § 116: për shembull, një Ministër kompetent, i cili trajton një ankesë në lidhje me vlefshmërinë e një Urdhri ose Udhëzimi mbi të cilin ai ka pasur kontroll, nuk do të ishte në pozicion mjaftueshëm të pavarur për të përmbushur kriteret e nenit 13. Megjithatë, ai mund të konsiderohej mjaftueshëm i pavarur për të vendosur në një ankesë ku pretendohet se masa e kontestuar ka ardhur si rezultat i keqzbatimit të njërit prej atyre urdhrave ose direktivave.

344 *Jabari k. Turqisë*, vendimi i 11 korrikut 2000, nr. 40035/98, § 50.

345 *Jokela k. Finlandës*, vendimi i 21 majit 2002, nr. 28856/95, § 45.

346 *Bäck k. Finlandës*, vendimi i 20 korrikut 2004, nr. 37598/97, § 63.

të Protokollit Nr. 1 është shqyrtuar në shkallë kombëtare nga një autoritet i pavarur, për shembull me anë të procedurave të kontradiktoritetit në gjykatë, ky është faktor i rëndësishëm gjatë vlerësimit nëse masa përbën ndërhyrje proporcionale tek të drejtat e Nenit 1 të Protokollit Nr. 1.<sup>[347]</sup>

Siç diskutohet në seksionin e këtij Udhërrëfyesi: ‘*Mbrojtja e pavarësisë dhe paanshmërisë*’ (‘*Zbatimi i vendimeve gjyqësore*’), dështimi i degëve ekzekutive dhe legjislativë të qeverive për të zbatuar vendimet përfundimtare është në gjendje të dëmtojë besueshmërinë dhe autoritetin e gjyqësorit si dhe dukjen e pavarësisë dhe paanshmërisë.

Neni 1 i Protokollit Nr. 1 u cakton Shteteve detyrimin pozitiv që të organizojnë një sistem të zbatimit të vendimeve përfundimtare i cili të jetë efektiv në ligj dhe në praktikë, dhe të sigurohen që procedurat e ngërthyer në ligjin për zbatimin e vendimeve përfundimtare të respektohen pa vonesa të panevojshme.<sup>[348]</sup>

Kur autoritetet janë të detyruara të zbatojnë një vendim përfundimtar dhe nuk e bëjnë këtë, mosveprimi i tyre në disa rrethana mund të angazhojë përgjegjësinë e Shtetit mbi bazat e nenit 6 § 1 të Konventës dhe Nenit 1 të Protokollit Nr. 1.<sup>[349]</sup> Shkalla e detyrimeve të Shtetit sipas Nenit 1 të Protokollit Nr. 1 ndryshon varësisht nga fakti nëse borxhliu është Shteti apo një person privat.<sup>[350]</sup> Dështimi në garantimin e zbatimit të një vendimi gjyqësor përfundimtar kundër Shtetit në një çështje ku bëhet fjalë për pretendime materiale kundër një Shteti normalisht përbën shkelje të nenit 6 dhe Nenit 1 të Protokollit Nr. 1. Kur Shteti është borxhli, ai duhet të veprojë në përputhje me vendimin e gjykatës plotësisht dhe në kohë.<sup>[351]</sup>

### ***ix) Neni 3 i Protokollit Nr. 1***

Neni 3 i Protokollit Nr. 1 përmban një detyrim për Shtetet që të zhvillojnë zgjedhje të cilat të sigurojnë shprehjen e lirë të mendimit të popullit. Dispozita është interpretuar si e tillë që përmbledh të drejtat individuale, përfshirë të drejtën për të votuar dhe të drejtën për të garuar në zgjedhje.<sup>[352]</sup>

347 *Jokela k. Finlandës*, vendimi i 21 majit 2002, nr. 28856/95, §§ 59-60.

348 *Valeriy Fuklev k. Ukrainës*, vendimi i 16 janarit 2014, nr. 6318/03, § 91.

349 *Valeriy Fuklev k. Ukrainës*, vendimi i 16 janarit 2014, nr. 6318/03, § 84.

350 *Anokhin k. Rusisë*, vendimi i 31 majit 2007, nr. 25867/02.

351 *Burdov k. Rusisë*, vendimi i 7 majit 2002, nr. 59492/00, §§ 33-42.

352 *Mathieu-Mohin dhe Clerfayt k. Belgjikës*, vendimi i 2 marsit 1987, nr. 9267/81, §§ 48-51; *Ždanoka k. Letonisë*, vendimi i Dhomës së Madhe i 16 marsit 2006, nr. 58278/00, § 102.

Neni 3 i Protokollit Nr. 1 ka të bëjë jo vetëm me procesin e organizimit dhe administrimit të procesit të votimit, por edhe me mënyrën e shqyrtimit të rezultatit të zgjedhjeve dhe mosmarrëveshjeve në lidhje me numërimin e votave dhe vlefshmërinë e rezultateve të zgjedhjeve.<sup>[353]</sup>

Ndërkohë që neni 6 nuk zbatohet në mosmarrëveshjet që dalin nga zbatimi i këtyre të drejtave, meqenëse ato kategorizohen si të drejta ‘politike’ më shumë sesa ‘civile’,<sup>[354]</sup> Neni 3 i Protokollit Nr. 1 i jep shkas disa detyrimeve pozitive të caktuara procedurale.

Sipa Nenit 3 të Protokollit Nr. 1, autoritetet përgjegjëse për administrimin zgjedhor duhet të funksionojnë në mënyrë transparente dhe të ruajnë paanshmërinë dhe pavarësinë nga manipulimet politike, dhe vendimet e tyre duhet të jenë të mirëarsyetuara.<sup>[355]</sup>

Më tej, Shtetet duhet të vendosin një sistem kombëtar për shqyrtimin efektiv të ankesave individuale dhe apeleve në lidhje me çështje që kanë të bëjnë me të drejtat zgjedhore. Rastet e veçanta të dështimeve për të garantuar zgjedhje demokratike duhet të jenë të hapura për t’u kontestuar nga individët para një gjykate kombëtare kompetente e cila është në gjendje ta trajtojë çështjen efektivisht. Organi i apelit në çështje zgjedhore duhet të jetë ose një komisioni i pavarur zgjedhor ose një gjykatë.<sup>[356]</sup>

## b) Të drejtat e gjyqtarëve

Gjyqtarët, si të gjithë qytetarët në Shtetet Anëtare, gëzojnë të drejta dhe liri themelore të mbrojtura nga KEDNJ-ja. Megjithatë, në kontekste të caktuara, ushtrimi i të drejtave dhe lirive të tyre të KEDNJ-së mund të dëmtojë paanshmërinë dhe/ose pavarësinë e tyre. Prandaj, duhet të vendoset një ekuilibër i arsyeshëm mes të

353 *Namat Aliyev k. Azerbajxhanit*, vendimi i 8 prillit 2010, nr. 18705/06, § 81; *Davydov dhe Të Tjerë k. Rusisë*, vendimi i 30 majit 2017, nr. 75947/11.

354 *Pierre-Bloch k. Francës*, vendimi i 21 tetorit 1997, nr. 24194/94, § 50.

355 *Davydov dhe Të Tjerë k. Rusisë*, vendimi i 30 majit 2017, nr. 75947/11.

356 *Yumak dhe Sadak k. Turqisë*, vendimi i 8 korrikut 2008, nr. 10226/03; shih gjithashtu <http://www.eods.eu/library/default%20oen.pdf> “Komisioni Evropian për Demokraci përmes Së Drejtës (Komisioni i Venedikut) Kodi i Praktikave të Mira në Çështje Zgjedhore, Direktiva dhe Raport Shpjegues” [“European Commission for Democracy Through Law (Venice Commission) Code of Good Practice in Electoral Matters Guidelines and Explanatory Report”], CDL-AD (2002) 23 rev. 23 maj 2003, § 3.3(a): “Organi i apelit në çështje zgjedhore duhet të jetë ose një komision zgjedhor ose një gjykatë. Për zgjedhjet parlamentare, mund të lejohet një apel drejtuar Parlamentit në shkallën e parë. Sidoqoftë, duhet të mundësohet apeli përfundimtar në gjykatë.”

drejtave të gjyqtarëve, për shembull e drejta e tyre për lirinë e shprehjes, besimit, tubimit dhe organizimit, dhe kriteri që ata të ruajnë pavarësinë dhe paanshmërinë e gjyqësorit gjatë kryerjes së detyrave të tyre.<sup>[357]</sup>

Gjatë vënies së këtij ekuilibri, është e nevojshme të kihet parasysh se sistemi gjyqësor mund të funksionojë si duhet vetëm në qoftë se gjyqtarët nuk janë të izoluar nga shoqëria në të cilën jetojnë. Pjesëmarrja e tyre aktive në jetën sociale i ndihmon ata të marrin përvojë të drejtpërdrejtë në lidhje me çështje që kanë rëndësi për vendimet që duhet të marrin. Megjithatë, përfitimi publik i kësaj përfshirjeje dhe pjesëmarrjeje duhet të balancohet me nevojshmërinë e ruajtjes së besueshmërisë publike tek gjyqësori, me të drejtën për gjyq të drejtë dhe paanshmëri, integritet dhe pavarësi të sistemit gjyqësor në tërësi.

### ***i) Neni 5 – E drejta e lirisë dhe sigurisë***

Gjyqtarët, si të gjithë qytetarët e Shteteve Anëtare, përfitojnë nga të drejtat e mbrojtura me nenin 5. Kur shqyrtohen masat e marra për heqjen e lirisë së një gjyqtari, duhet të merret parasysh në mënyrë të veçantë roli i veçantë që luan gjyqësori në shoqëri i cili, si garantues i drejtësisë, duhet të gëzojë besim tek publiku nëse do që t'i kryejë detyrat e veta me sukses. Heqja e lirisë së një gjyqtari mund ta dëmtojë këtë besim. Prandaj masat e marra për heqjen e lirisë duhet t'i nënshtrohen mbrojtjeve të lartësuara procedurale kundër arbitraritetit.<sup>[358]</sup>

Neni 5 § 1 kërkon që çdo heqje lirie të jetë “në përputhje me një procedurë të parashikuar me ligj”. Gjatë shqyrtimit të ligjshmërisë së heqjes së lirisë në kontekstin e paraburgosjes së gjyqtarëve, pajtueshmëria me rregullat e ligjeve të zakonshme mund të mos mjaftojë për të përmbushur kriterin e “cilësisë së ligjit” sipas nenit 5 § 1. Duke pasur parasysh nevojshmërinë e mbrojtjes së pavarësisë dhe paanshmërisë së gjyqësorit, gjyqtarët mund të përfitojnë nga mbrojtjet e shtuara kundër paraburgimit në të drejtën vendase. Kur e drejta vendase ofron mbrojtje gjyqësore për anëtarët e gjyqësorit me qëllim që të mbrojnë ushtrimin e pavarur të funksioneve të tyre, është thelbësore që këto organizime të respektohen si duhet.<sup>[359]</sup>

357 KKGJE (2002) Op. N° 3.

358 *Alparslan Altan k. Turqisë*, vendimi i 16 prillit 2019, nr. 12778/17.

359 *Alparslan Altan k. Turqisë*, vendimi i 16 prillit 2019, nr. 12778/17.

## **ii) Neni 8 – E drejta e jetës private dhe familjare**

---

Ekzistojnë dy situata kryesore në të cilat mund të angazhohet neni 8 në kontekstin e mbrojtjes së pavarësisë dhe paanshmërisë së gjyqësorit: i) kur një gjyqtar shkarkohet prej rolit të tij për shkak të aktiviteteve të kryera në jetën personale; dhe ii) kur shkarkimi i një gjyqtari nga detyra përbën ndërhyrje tek e drejta e tij për jetë private.

### **Shkarkimi për shkak të aktiviteteve në jetën private të një gjyqtari**

---

Mbrojtja e pavarësisë dhe paanshmërisë së gjyqësorit përbën qëllim legjitim, në kuadër të të cilit e drejta e një gjyqtari për jetë private mund të lejohet që të kufizohet.

Detyrat dhe detyrimet etike që u vihen gjyqtarëve për të mbrojtur pavarësinë dhe paanshmërinë munden që, deri në njëfarë mase, të shkelin mbi jetën e tyre private, dhe është e lejueshme sipas nenit 8 që gjyqtarët të detyrohen të bëjnë kufizime në jetën e tyre private për t'u siguruar që sjellja e tyre të mos njollosë imazhin, reputacionin ose paanshmërinë e gjyqësorit.<sup>[360]</sup>

Megjithatë, çdo ndërhyrje tek e drejta e një gjyqtari për jetë private duhet të jetë në përputhje me parimin e proporcionalitetit. Një gjyqtar mund të shkarkohet nga detyra mbi bazën e veprimeve të ndërmarra në jetën private në qoftë se Shteti mund të provojë se veprimet e marra në jetën e tij private kanë ndikuar në rolin e tij gjyqësor, për shembull duke influencuar në vendimet e tij ose duke ndikuar në dukjen e pavarësisë dhe paanshmërisë.<sup>[361]</sup>

Më tej, mbrojtjet procedurale janë posaçërisht të rëndësishme kur zhvillohen hetime rreth jetës së tij private. Çdo gjyqtar që përballlet me shkarkim për arsye të jetës së tij private ose familjare duhet të ketë garanci kundër arbitraritetit dhe në mënyrë të veçantë garanci për procedura kontradiktorialiteti para një organi mbikqyrës të pavarur dhe të paanshëm.<sup>[362]</sup>

---

360 Özpınar k. Turqisë, vendimi i 19 tetorit 2010, nr. 20999/04, §§ 55-56.

361 Özpınar k. Turqisë, vendimi i 19 tetorit 2010, nr. 20999/04, §77.

362 Özpınar k. Turqisë, vendimi i 19 tetorit 2010, nr. 20999/04, §88.

## Impakti i shkarkimit në jetën private të një gjyqtari

Nocioni i jetës private sipas nenit 8 mund të përfshijë aktivitete të natyrës profesionale ose biznesore,<sup>[363]</sup> dhe kufizimet e vëna ndaj qasjes në profesion ose shkarkimi nga detyra është gjetur se ndikojnë në “jetën private”.<sup>[364]</sup> Çështjet e lidhura me mbrojtjen e nderit dhe reputacionit gjithashtu hyjnë brenda fushëveprimit të së drejtës për respekt të jetës private.<sup>[365]</sup>

Prandaj, shkarkimi i një gjyqtari, në rrethana të caktuara, mund të përbëjë ndërhyrje tek e drejta e tij për jetë private. Për t’u angazhuar neni 8 si pasojë e shkarkimit nga detyra, shkarkimi duhet të shkaktojë pasoja shumë të rënda ose domethënëse në lidhje me: i) “rrethin e brendshëm” të individit, veçanërisht kur ka pasoja të rënda materiale; ii) mundësitë e individit për të “vendosur dhe mbajtur marrëdhënie me të tjerët”; dhe iii) reputacionin e individit.<sup>[366]</sup>

Rreptësia e këtyre pasojave duhet të vlerësohet duke krahasuar jetën e gjyqtarit para dhe pas shkarkimit. Ato duhet të tregojnë në mënyrë bindëse që pragu i rreptësisë është arritur në rastin e tij/saj. Faktorët relevantë përfshijnë:<sup>[367]</sup>

- » Nëse shkarkimi ka pasur pasoja konkrete për mirëqenien materiale të gjyqtarit dhe familjes së tij, për shembull për shkak të reduktimit të pagës, ose për shkak të sulmeve publike ndaj reputacionit të gjyqtarit ose familjes së tij.
- » Nëse gjyqtari është ndaluar krejtësisht që të praktikojë profesionin si gjyqtar, ose nëse gjyqtari e ka mbajtur punën në ndonjë cilësi, për shembull në një rol tjetër gjyqësor ose në një gjykatë tjetër, dhe nëse ai e ka mbajtur mundësinë për të vendosur dhe mbajtur marrëdhënie të natyrës profesionale si pasojë.
- » Arsyet e shkarkimit dhe fokusi i procedurave të hapura kundër gjyqtarit, dhe impakti rezultues mbi reputacionin e tij profesional:

363 *Niemietz k. Gjermanisë*, vendimi i 16 dhjetorit 1992, nr. 13710/88, § 29.

364 *Sidabras dhe Džiautas k. Lituaniës*, vendimi i 27 korrikut 2004, nr. 55480/00 dhe 59330/00, § 47; *Özpinar k. Turqisë*, vendimi i 19 tetorit 2010, nr. 20999/04, §§ 43-48.

365 *Shih Pfeifer k. Austrisë*, vendimi i 15 nëntorit 2007, nr. 12556/03, § 35.

366 *Denisov k. Ukrainës*, vendimi i Dhomës së Madhe i 25 shtatorit 2018, nr. 76639/11, § 107 (përfshirë si përmbledhje në publikim).

367 *Oleksandr Volkov k. Ukrainës*, vendimi i 6 shkurtit 2018, nr. 21722/11 (përfshirë si përmbledhje në publikim); *Denisov k. Ukrainës*, vendimi i Dhomës së Madhe i 25 shtatorit 2018, nr. 76639/11 (përfshirë si përmbledhje në publikim); *Xhoxhaj k. Shqipërisë*, vendimi i 9 shkurtit 2021, nr. 15227/19.

- Neni 8 ka më shumë gjasa të angazhohet kur procedurat kanë të bëjnë me performancën e gjyqtarit si gjyqtar, janë në lidhje me kompetencën dhe profesionalizmin e tij gjyqësor ose vënë në pyetje moralin ose etikën e tij, për shembull procedurat për shkelje të betimit gjyqësor ose procedurat në lidhje me korrupsionin gjyqësor.
- Neni 8 ka më pak gjasa të angazhohet kur procedurat janë në lidhje vetëm me shkathtësitë menaxheriale të një gjyqtari ose me kryerjen e detyrave administrative, meqenëse çështje të tilla nuk kanë të bëjnë me thelbin e reputacionit profesional të kërkuesit.
- » Reptësia e humbjes së vetbesimit të gjyqtarit dhe nëse kjo shkakton paragjykime serioze në ambientet profesionale.
- » Nëse procedura disiplinore është pjesë e përpjekjeve më të gjera për të reformuar sistemin gjyqësor, kur ekziston ‘nevoja shoqërore urgjente’ për zbatimin e një reforme të tillë, për shembull për shkak të korrupsionit të përhapur brenda gjyqësorit.

Ndërkohë që shkarkimi nga detyra gjyqësore mund të përbëjë mjet legjitim për mbrojtjen e pavarësisë dhe paanshmërisë, kur neni 8 angazhohet për shkak të pasojave të shkarkimit të një gjyqtari nga detyra, procedura për shkarkimin e gjyqtarit duhet të jetë në përputhje me ligjin dhe duhet të përbëjë një masë proporcionale për arritjen e atij qëllimi.

### **iii) Neni 9 – Liria e fesë**

---

Për të ruajtur paanshmërinë, gjyqtarët nuk duhet të lejojnë që pikëpamjet e tyre personale fetare të ndërhyjnë ose të ndikojnë tek mënyra se si i kryejnë detyrat e tyre gjyqësore.

Neni 9 § 2 parashikon:

*“Liria e shfaqjes së fesë ose besimeve të dikujt nuk mund t’i nënshtrohet kufizimeve të tjera, përveçatyre të parashikuara nga ligji dhe që përbëjnë masa të nevojshme në një shoqëri demokratike në interes të sigurisë publike, për mbrojtjen e rendit publik, të shëndetit ose të moralit ose për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të të tjerëve.”*

Mbrojtja e pavarësisë dhe paanshmërisë së gjyqësorit është qëllim legjitim për të cilin liria e shfaqjes së fesë mund të kufizohet.<sup>[368]</sup> Për shembull, shkarkimi i një

---

368 Pitkevich k. Rusicë, vendimi i 8 shkurtit 2001, nr. 47936/99 (përfshirë si përmbledhje në publikim).

gjyqtari i cili shpreh pikëpamje fetare gjatë procedurave ose i cili lejon që pikëpamjet e tij fetare të ndikojnë në rezultatin e procedurave nuk shkel nenin 9, në qoftë se shkarkimi bëhet me qëllim të mbrojtjes së paanshmërisë.

Kriteri i paanshmërisë nuk do të thotë se gjyqtarëve duhet t'u ndalohet përkatësia në një grup fetar dhe/ose pasja e pikëpamjeve fetare në përgjithësi. Gjyqtarët kanë lirinë që të shfaqin besimet e tyre fetare kur veprojnë në cilësi private. Prandaj çdo masë disiplinore e marrë kundër tyre për shkak të shprehjes fetare duhet të bazohet mbi veprimet e bëra gjatë kryerjes së funksioneve të tyre gjyqësore.<sup>[369]</sup> Për shembull, lutja publike gjatë seancave gjyqësore, premtimi ose dhënia e një rezultati të favorshëm për palët në qoftë se ato përkrahin pikëpamjet fetare të gjyqtarit, ose kritikata ndaj moralit të palëve në procedurë për shkak të besimit të tyre fetar.

#### **iv) Neni 10 – Liria e shprehjes**

Siç diskutohet në seksionet e këtij Udhërrëfytyesi: *'Paanshmëria personale – deklaratat publike rreth çështjes'* dhe *'Dukja e pavarësisë'*, gjyqtarëve mund t'u kërkohet që të kufizojnë shprehjen publike të pikëpamjeve të tyre për të mbrojtur pavarësinë dhe paanshmërinë e tyre. Këto kufizime të shprehjes, për shembull sanksionet e vëna pas shprehjes së pikëpamjeve nga ana e një gjyqtari, në disa raste mund të angazhojnë, e madje edhe të shkelin, nenin 10 (e drejta për lirinë e shprehjes). Seksioni në vijim parashtron testin që duhet përdorur për të përcaktuar nëse janë shkelur të drejtat e gjyqtarit nga neni 10.

#### **Shprehja publike e pikëpamjeve nga një gjyqtar**

##### **1. A angazhohet neni 10?**

Gjykata ka afirmuar se neni 10 zbatohet në vendin e punës dhe se shërbyesit civilë, përfshirë gjyqtarët, gëzojnë të drejtën për lirinë e shprehjes.<sup>[370]</sup>

Për t'u siguruar nëse angazhohet neni 10 në rastet e procedurave disiplinore kundër gjyqtarëve, shkarkimit ose emërimit të tyre, së pari është e nevojshme të vlerësohet nëse kufizimi, kushti ose masa disiplinore kundër një gjyqtari faktikisht ka lidhje me ushtrimin e lirisë së tyre të shprehjes. Ose, nëse masa disiplinore ka lidhje me ushtrimin e funksionit të tij gjyqësor ose me sjelljen e tij profesionale. Për t'u angazhuar neni 10 duhet të ekzistojë një lidhje shkakësore mes ushtrimit nga gjyqtari të lirisë së shprehjes dhe masës disiplinore të marrë kundër tij.

369 Pitkevich k. Rusisë, vendimi i 8 shkurtit 2001, nr. 47936/99 (përfshirë si përmbledhje në publikim).

370 Wille k. Lihtenshtajnit, vendimi i Dhomës së Madhe i 28 tetorit 1999, nr. 28396/95, § 41.



Konteksti në të cilin një gjyqtar ka folur, ka shprehur një opinion ose ka vepruar, dhe arsytimi i vendimit për sanksione ndaj gjyqtarit, janë relevante në këtë vlerësim. Për shembull, masat disiplinore të marra kundër një gjyqtari për shkak të shprehjes së pikëpamjeve të tij në një forum publik, si për shembull kur një gjyqtar mban një ligjëratë publike,<sup>[371]</sup> bën deklarata në media,<sup>[372]</sup> u shkruan letra politikanëve ose personave në poste publike, ose mban një fjalim, ose lëshon një komunikatë publike, të gjitha këto përbëjnë ndërhyrje tek neni 10.<sup>[373]</sup>

Neni 10 nuk angazhohet kur gjyqtari sanksionohet kryesisht për shkak të aftësisë së tij profesionale për të ushtruar funksionet e tij gjyqësore. Edhe kur procedurat disiplinore i referohen pjesërisht pikëpamjeve që mund të jenë shprehur nga gjyqtari, neni 10 nuk angazhohet në qoftë se masat kundër gjyqtarit nuk janë “nxitur ekskluzivisht dhe kryesisht prej atyre pikëpamjeve”, por në fakt kanë të bëjnë kryesisht me vlerësimin e kualifikimeve të tij profesionale dhe cilësive të tij personale në kontekstin e aktiviteteve dhe sjelljeve të gjyqtarit në kuadër të administrimit të drejtësisë.<sup>[374]</sup>

## 2. A synon ndërhyrja një qëllim legjitim?

Neni 10 § 2 parashikon:

*“Ushtrimi i këtyre lirive, që **përmban detyrime dhe përgjegjësi**, mund t’u nënshtrohet atyre formaliteteve, kushteve, kufizimeve ose sanksioneve të parashikuara me ligj dhe që janë të nevojshme në një shoqëri demokratike ... për mbrojtjen e dinjitetit ose të **të drejtave të të tjerëve ... ose për të garantuar autoritetin dhe paanshmërinë e pushtetit gjyqësor.**”* (Theksi i shtuar)

Prandaj, mbrojtja e autoritetit dhe paanshmërisë së gjyqësorit është qëllim legjitim në synim të të cilit e drejta për lirinë e shprehjes mund të kufizohet.

Neni 10 § 2 gjithashtu njeht faktin se ushtrimi i lirisë së shprehjes përmban disa “detyra dhe përgjegjësi” të caktuara. Këto detyra dhe përgjegjësi kanë të bëjnë me gjyqtarët në mënyrë të veçantë, duke pasur parasysh vendin e rëndësishëm të gjyqësorit mes organeve të Shtetit në një shoqëri demokratike. Gjykata në shumë

371 Wille k. Lihtenshtajnit, vendimi i Dhomës së Madhe i 28 tetorit 1999, nr. 28396/95, §§ 48-50.

372 Kudeshkina k. Rusisë, vendimi i 26 shkurtit 2009, nr. 29492/05, § 79.

373 Baka k. Hungarisë, vendimi i Dhomës së Madhe i 23 qershorit 2016, nr. 20261/12, § 145 (përfshirë si përmbledhje në publikim).

374 Harabin k. Sllovakisë, vendimi i 20 nëntorit 2012, nr. 58688/11, §§ 149-153 (përfshirë si përmbledhje në publikim).

raste ka theksuar rolin e veçantë të gjyqësorit i cili, si garantues i drejtësisë, duhet të gëzojë besimin publik për të kryer detyrat e tij në mënyrë të suksesshme.<sup>[375]</sup> Prandaj autoritetet gjyqësore dhe zyrtarët publikë që shërbejnë në gjyqësor pritet që të jenë të përmbajtur në ushtrimin e lirisë së tyre të shprehjes kurdo që ka gjasa që autoriteti dhe paanshmëria e gjyqësorit të vihen në pyetje.<sup>[376]</sup> Kërkesat e larta të drejtësisë dhe natyra e ngritur e detyrës gjyqësore nënkuptojnë që gjyqtarëve mund t'u imponohen me arsye kritere më të larta të përmbajtjes.

Kjo detyrë për përmbajtje ka të bëjë me komentet publike të bëra nga gjyqtarët në lidhje me çështje të cilat janë duke i gjykuar, si dhe me komentet publike të bëra nga gjyqtarët në lidhje me kolegët e tyre gjyqtarë ose me institucionin e gjyqësorit.

### **Detyra e gjyqtarëve për përmbajtje në lidhje me komentet publike rreth çështjeve të tyre**

Prej autoriteteve gjyqësore kërkohet që të ushtrojnë diskrecion maksimal në lidhje me çështjet që trajtojnë me qëllim që të ruhet imazhi i tyre si gjyqtarë të paanshëm. Gjyqtarët duhet të përmbahen nga komentimi rreth çështjeve të tyre në shtyp, edhe kur provokohen ose iu kërkohet të komentojnë.<sup>[377]</sup> Komentet publike nga një gjyqtar të cilat janë kritike për një palë në procedurë, ose parashikimet publike të rezultatit të gjyqit, janë në papajtueshmëri me kriterin e paanshmërisë të nenit 6 § 1.<sup>[378]</sup> Fjalë të tilla mund të kufizohen në mënyrë legjitime sipas nenit 10, për të mbrojtur paanshmërinë e gjyqësorit dhe për të mbrojtur të drejtën për proces të drejtë nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme sipas nenit 6.

### **Detyra e gjyqtarëve për përmbajtje nga komentet e tyre në lidhje me njerëz të tjerë, kolegë dhe gjyqtarë të tjerë**

Ndërkohë që gjyqtarët, ashtu si shërbyesit e tjerë civilë, përfitojnë nga e drejta e lirisë së shprehjes në sferën e punës, Gjykata ka njohur se punonjësit gjithashtu i detyrohen punëdhënësve të tyre besnikëri, rezervim dhe diskrecion. Kjo vlen më

375 *Morice k. Francës*, vendimi i Dhomës së Madhe i 23 prillit 2015, nr. 29369/10, § 128 (përfshirë si përmbledhje në publikim); *Baka k. Hungarisë*, vendimi i Dhomës së Madhe i 23 qershorit 2016, nr. 20261/12, §§ 163-164 (përfshirë si përmbledhje në publikim).

376 *Wille k. Lihntenshtajnit*, vendimi i Dhomës së Madhe i 28 tetorit 1999, nr. 28369/95, § 64; *Kudeshkina k. Rusisë*, vendimi i 26 shkurtit 2009, nr. 29492/05, § 86; *Baka k. Hungarisë*, vendimi i Dhomës së Madhe i 23 qershorit 2016, nr. 20261/12, § 164 (përfshirë si përmbledhje në publikim).

377 *Buscemi k. Italisë*, vendimi i 16 shtatorit 1999, nr. 29569/95, § 67.

378 *Lavents k. Letonisë*, vendimi i 28 nëntorit 2002, nr. 58442/00, §§ 118-119 (përfshirë si përmbledhje në publikim).

shumë në rastin e gjyqtarëve, duke pasur parasysh rëndësinë e besimit publik tek gjykatat, në mënyrë që gjyqësori të mund të kryejë detyrat e tij me sukses.<sup>[379]</sup>

Prandaj, mund të lindë nevoja që të kufizohet liria e shprehjes e gjyqtarëve në mënyrë që të mbrohet besimi publik tek gjyqësori kundër sulmeve shkatërrimtare, posaçërisht ato që janë të pabazuara dhe të pavërtetuara, e sidomos duke marrë parasysh që gjyqtarët që janë kritikuar i nënshtrohen diskrecionit i cili i pengon ata nga të dhënit përgjigje.<sup>[380]</sup> Për shembull, do të ishte legjitime të caktohen sanksione ndaj një gjyqtari i cili publikisht ka bërë akuza të pavërtetuara për korrupsion në gjyqësor<sup>[381]</sup> ose ka përhapur thashetheme serioze dhe të pabazuara rreth një kolegu gjyqtar,<sup>[382]</sup> duke ditur potencialin që kanë veprime të tilla për të dëmtuar rëndë dukjen e paanshmërisë dhe besimin publik tek gjyqësori në tërësi.

Megjithatë, është e rëndësishme që çdo kufizim ndaj shprehjes së gjyqtarëve, në fakt, t'i shërbejë qëllimit legjitim të mbrojtjes së pavarësisë dhe paanshmërisë së gjyqësorit. Masat disiplinore të marra kundër gjyqtarëve, siç janë përfundimi i parakohshëm i mandatit të tyre, gjithashtu rrezikojnë të dëmtojnë pavarësinë dhe paanshmërinë e gjyqësorit.<sup>[383]</sup> Një Shtet nuk mund të përdorë pavarësinë e gjyqësorit si arsye për të sanksionuar një gjyqtar për ushtrimin e lirisë së tij të shprehjes, në qoftë se masat e marra kundër tij faktikisht do të kishin efektin e kundërt. Për shembull, përfundimi i parakohshëm i mandatit të një gjyqtari të gjykatës si pasojë e ushtrimit nga ana e tij të lirisë së shprehjes që mund të dëmtonte paanshmërinë, kur përfundimi nuk ka qenë në përputhje me ligjin, nuk ka pasur lidhje me ndonjë bazë paaftësie profesionale ose sjellje të pahijshme, dhe nuk ka pasur lidhje me ndonjë fjalim që në vetvete ka dëmtuar paanshmërinë.<sup>[384]</sup>

### 3. A është ndërhyrja e nevojshme në një shoqëri demokratike?

Çdo kufizim ndaj të shprehurit duhet gjithashtu të jetë mjet i nevojshëm dhe proporcional i synimit të qëllimit legjitim të mbrojtjes së pavarësisë, paanshmërisë

379 *Simić k. Bosnia and Herzegovina*, vendimi i 15 November 2016, nr. 75255/10, §32.

380 *Kudeshkina k. Rusisë*, vendimi i 26 shkurtit 2009, nr. 29492/05, § 86; *Simić k. Bosnje dhe Hercegovinës*, nr. 75255/10, 15 nëntor 2016.

381 *Simić k. Bosnje dhe Hercegovinës*, vendimi i 15 nëntorit 2016, nr. 75255/10.

382 *Di Giovanni k. Italisë*, vendimi i 9 korrikut 2013, nr. 51160/06.

383 Shih seksionet e këtij Udhërrëfyesi: 'Mandatit në detyrë', 'Garancitë kundër presioneve të jashtme' dhe 'Ruajtja e pavarësisë dhe paanshmërisë'.

384 *Baka k. Hungarisë*, vendimi i Dhomës së Madhe i 23 qershorit 2016, nr. 20261/12, § 156 (përfshirë si përmbledhje në publikim).

dhe autoritetit të gjyqësorit. Për të vlerësuar proporcionalitetin e një mase, duhet të merren parasysh rrethanat e secilës çështje, natyrën e deklarimeve të dhëna, dhe konteksti në të cilin janë bërë ato,<sup>[385]</sup> për të vlerësuar nëse është vendosur një ekuilibër i drejtë mes të drejtës themelore për lirinë individuale të shprehjes dhe interesit legjitim të një Shteti demokratik për t'u siguruar që shërbimi i tij civil i përmbahet qëllimeve të renditura në nenin 10 § 2.

Faktorët e mëposhtëm janë relevantë për një vlerësim të tillë të proporcionalitetit:

- » Domethënia e veçantë e “detyrave dhe përgjegjësi” të cekura në nenin 10 § 2 në kontekstin e shprehjes nga gjyqtarët, duke marrë parasysh vendin e rëndësishëm që zë gjyqësori mes organeve të Shtetit në një shoqëri demokratike, gjë që justifikon dhënien e njëfarë hapësire vlerësimi autoriteteve kombëtare kur vlerësojnë nëse ndërhyrja e kontestuar është proporcionale me qëllimin e mësipërm.<sup>[386]</sup>
- » Roli i veçantë i gjyqësorit në shoqëri, i cili, si garantues i drejtësisë, vlerë themelore në një Shtet të qeverisur nga ligji, duhet të gëzojë besimin publik për të kryer me sukses detyrat e veta, dhe duke pasur parasysh këtë, detyra e gjyqtarëve për të treguar përmbajtje, rezervim dhe diskrecion.
- » Rëndësia e ndarjes së pushteteve dhe rëndësia e mbrojtjes së pavarësisë së gjyqësorit, që do të thotë se çdo ndërhyrje tek shprehja e një gjyqtari duhet të këqyret me kujdes.
- » Drejtësia e procedurave dhe garancitë procedurale që ekzistojnë gjatë vlerësimit të proporcionalitetit të një ndërhyrjeje tek liria e shprehjes e garantuar me nenin 10, si dhe cilësia e shqyrtimit gjyqësor që është në dispozicion për nevojshmërinë e masës.
- » Nëse shprehja në fjalë ka të bëjë me gjykime sipas fakteve apo vlerave dhe, kur shprehja është gjykim sipas vlerave, nëse ka pasur bazë të mjaftueshme faktike për të mbështetur gjykimin, ose nëse shprehja ka të bëjë me thashetheme të pabazuara ose kritika të pavërtetuara.<sup>[387]</sup>
- » Nëse shprehja ka të bëjë me çështje ose pyetje me interes publik në një shoqëri demokratike, ku publiku ka interes legjitim për t'u informuar, dhe të cilat hyjnë brenda fushëveprimit të debatit politik:
  - Shprehjet në lidhje me ndarjen e pushteteve, me reforma kushtetuese dhe legjislativë, me funksionimin dhe reformimin e sistemit gjyqësor, dhe me

385 *Morice k. Francës*, vendimi i Dhomës së Madhe i 23 prillit 2015, nr. 29369/10, § 162 (përfshirë si përmbledhje në publikim).

386 *Vogt k. Gjermanisë*, vendimi i 2 shtatorit 1996, nr. 17851/91, § 53.

387 *Di Giovanni k. Italisë*, vendimi i 9 korrikut 2013, nr. 51160/06.

pavarësinë dhe mos shkarkimin e gjyqtarëve, hyjnë brenda fushës së interesit publik, dhe debate të tilla gëzojnë një shkallë të lartë mbrojtjeje nga neni 10.<sup>[388]</sup>

- Sulmet e paarsyeshme personale ndaj një kolegu gjyqtar nuk kanë gjasa të kenë mbrojtje.
- » Natyra dhe rreptësia e sanksionit të vënë. Për shembull, dhënia e një paralajmërimi me gjasë është më proporcionale sesa përfundimi i mandatit të gjyqtarit ose ndalimi i mbajtjes së detyrës zyrtare.<sup>[389]</sup>
- » Nëse sanksioni me gjasë mund të ketë ‘efekt dekurajues’ mbi shprehjen dhe pjesëmarrjen e gjyqtarëve në debate publike rreth çështjeve që kanë të bëjnë me gjyqësorin.

### **Rëndësia e pjesëmarrjes së gjyqtarëve në debate publike rreth çështjeve që kanë të bëjnë me gjyqësorin dhe administrimin e drejtësisë**

Siç u cek më lart, prononcimet e gjyqtarëve në lidhje me çështje të rëndësishme publike gëzojnë një shkallë të lartë mbrojtjeje nga neni 10. Çdo kufizim i vënë ndaj lirisë së shprehjes së gjyqtarëve nuk duhet të ketë efekt dekurajues mbi vullnetin e tyre për të marrë pjesë në debate publike rreth çështjeve që kanë të bëjnë me gjyqësorin, për shembull reformat legjislativë ose çështje të lidhura me pavarësinë e gjyqësorit.<sup>[390]</sup>

Gjyqtarët luajnë rol të rëndësishëm në debatin publik rreth efektivitetit dhe reformave në institucionet gjyqësore. Instrumentet e Gjykatës dhe të KE-së njohin faktin se çdo gjyqtar ka përgjegjësi për promovimin dhe mbrojtjen e pavarësisë gjyqësore<sup>[391]</sup> dhe se gjyqtarët dhe gjyqësori duhet të konsultohen dhe të përfshihen në përgatitjen e legjislacionit mbi statusin e tyre dhe, përgjithësisht, funksionimin e sistemit gjyqësor.<sup>[392]</sup>

Prandaj, mund të ndodhë që nuk është vetëm e drejtë por edhe detyrë e një gjyqtari që të shprehje mendimin e tij rreth reformave që prekin gjyqësorin.<sup>[393]</sup> Në cilësinë e tij si ekspert ligjor, ai mund të shprehë pikëpamjet e tij, përfshirë edhe kritika, ndaj reformave ligjore të nisura nga Qeveria. Një qëndrim i tillë, i shprehur në

388 *Kudeshkina k. Rusisë*, vendimi i 26 shkurtit 2009, nr. 29492/05, § 86; *Morice k. Francës*, vendimi i Dhomës së Madhe i 23 prillit 2015, nr. 29369/10, §§ 125-128 (përfshirë si përmbledhje në publikim).

389 *Kudeshkina k. Rusisë*, vendimi i 26 shkurtit 2009, nr. 29492/05.

390 *Kudeshkina k. Rusisë*, vendimi i 26 shkurtit 2009, nr. 29492/05; *Baka k. Hungarisë*, vendimi i Dhomës së Madhe i 23 qershorit 2016, nr. 20261/12 (përfshirë si përmbledhje në publikim).

391 *Magna Carta e Gjyqtarëve*, § 3.

392 *KKGJE (2002) Op. N° 3*, § 34; *Magna Carta e Gjyqtarëve*, § 9.

393 *Baka k. Hungarisë*, vendimi i Dhomës së Madhe i 23 qershorit 2016, nr. 20261/12 (përfshirë si përmbledhje në publikim).

mënyrë të përshtatshme, nuk e prek reputacionin e gjyqësorit e as nuk komprometon paanshmërinë e tij në një rast të dhënë.<sup>[394]</sup>

### Kritikat ndaj gjyqtarëve prej personave që nuk janë pjesë e gjyqësorit

Siç diskutohet në seksionin e këtij Udhërrëfyese: *‘Kujt / Cilave organe u zbatohet kriteri i pavarësisë dhe paanshmërisë?’* dhe *‘Ruajtja e pavarësisë dhe paanshmërisë së gjyqësorit’*, detyrimet nga neni 6 për të ruajtur pavarësinë dhe paanshmërinë e gjyqësorit iu zbatohen edhe organeve të tjera të shtetit dhe mediave, përveç vetë gjyqësorit.

Prandaj, mbrojtja e pavarësisë, paanshmërisë dhe autoritetit të gjyqësorit mund të përbëjë qëllim legjitim në vijim të të cilit është e lejueshme që të kufizohet shprehja e atyre që janë jashtë gjyqësorit.

Gjatë vlerësimit nëse një kufizim i shprehjes në këtë kontekst shkel nenin 10, duhet të vlerësohet nëse kufizimi është mënyrë e nevojshme dhe proporcionale me anë të së cilës mbrohet paanshmëria e gjyqësorit. Shumë prej faktorëve të njëjtë të përmendur në seksionin e këtij Udhërrëfyese: *‘Shprehja publike e pikëpamjeve të gjyqtarëve’* janë relevantë për këtë vlerësim të proporcionalitetit.

Në përgjithësi, komentet ose raportet mbi funksionimin e gjyqësorit ose trajtimin e një çështjeje përbëjnë debate rreth çështjeve me interes publik, dhe mund të meritojnë një shkallë të lartë mbrojtjeje sipas nenit 10, me një hapësirë të ngushtë vlerësimi për Shtetet. Duke marrë parasysh që gjyqtarët janë pjesë e një institucioni themelor të Shtetit, kur veprojnë në cilësi zyrtare ata mund të presin që t’i nënshtrohen një pragu më të gjerë të kritikave të pranueshme sesa qytetarët e thjeshtë, përfshirë edhe kritika personale.

Duke pasur parasysh rëndësinë e ruajtjes së besimit tek gjyqësori, ofendimet personale, të cilat përfshijnë: vënia në pyetje e kompetencës profesionale të një gjyqtari; mveshja e sjelljeve fajësuese një gjyqtari siç janë gënjeshttrat, shtrembërimi i qëllimshëm i realitetit, ose lëshimi i një raporti të pavërtetë; ose përshkrimi i një gjyqtari me fjalë veçanërisht poshtëruese; me gjasë nuk përfitojnë nga mbrojtja e nenit 10. Megjithatë, vërejtjet kritike që kanë të bëjnë me mënyrën se si gjyqtari i zhvillon procedurat, ose që kanë të bëjnë me performancën e gjyqtarit në një çështje, kanë më shumë gjasa të mbrohen nga neni 10.<sup>[395]</sup>

394 *Previti k. Italisë*, vendimi i 8 dhjetorit 2009, nr. 45291/06, §§ 249-269.

395 *Radobuljac k. Kroacisë*, vendimi i 28 qershorit 2016, nr. 51000/11.

Edhe kur shprehja përfshin gjykime sipas vlerave të cilat dëmtojnë reputacionin e një gjyqtari, kufizimet mbi shprehje të tilla ende mund të përbëjnë shkellje të nenit 10 në qoftë se dënimi i vënë është aq i rëndë saqë rrezikon të dekurajojë diskutimet e hapura rreth çështjeve të interesit publik.<sup>[396]</sup>

### **Kritikat nga avokatët**

---

Statusi i veçantë i avokatëve i vë ata në pozicion qendror në administrimin e drejtësisë si ndërmjetës mes publikut dhe gjykatave. Prandaj ata luajnë rol kyç në sigurimin që gjykatat të gëzojnë besimin e publikut.

Ky rol i avokatëve si profesionistë të pavarur do të thotë që ata duhet të jenë në gjendje të tërheqin vëmendjen e publikut drejt mangësive të mundshme në sistemin e drejtësisë. Ata madje mund ta kenë për detyrë një gjë të tillë kur gjyqësori mund të përfitonte nga kritikak konstruktive.<sup>[397]</sup>

Prandaj, avokatët kanë të drejtë të komentojnë publikisht rreth administrimit të drejtësisë, në qoftë se shprehja e tyre nuk kalon përtej caqeve të caktuara. Për shembull, ata nuk duhet të bëjnë sulme të paarsyeshme dhe të pabazuara ndaj gjyqësorit, thjesht për shkak të dëshirës ose ndonjë strategjie për t'u siguruar që debati gjyqësor ndiqet në media, ose për të marrë hak ndaj gjyqtarëve që trajtojnë një çështje të caktuar.<sup>[398]</sup>

### **v) Neni 11 – Liria e tubimit dhe organizimit**

---

Neni 11 § 2 specifikon që:

*“Ky nen nuk ndalon kufizime të ligjshme të ushtrimit të këtyre të drejtave nga pjesëtarë të forcave të armatosura, të policisë ose të administratës shtetërore.”*

Në situata të caktuara, Shtetet mund të caktojnë kufizime ndaj të drejtës së një gjyqtari për lirinë e tubimit dhe organizimit, kur një gjë e tillë mbron pavarësinë dhe

---

396 *Narodni List D.D. k. Kroacisë*, vendimi i 8 nëntorit 2018, nr. 2782/12: ku një gazetar shprehu gjykime sipas vlerave në dëm të reputacionit të një gjyqtari, dhe kompania kërkuese u urdhërua të paguante 6,870 euro dëme jomateriale. Gjykata gjeti shkellje të nenit 10 sepse dëmi ndaj reputacionit të gjyqtarit nuk u gjet se ishte në shkallë aq të madhe sa të justifikonte një dëmshpërbllim të asaj lartësie, dhe lartësia e atij dëmshpërbllimi mund të dekurajonte diskutimet e hapura rreth çështjeve të interesit publik.

397 *Morice k. Francës*, vendimi i Dhomës së Madhe i 23 prillit 2015, nr. 29369/10 (përfshirë si përmbledhje në publikim).

398 *Morice k. Francës*, vendimi i Dhomës së Madhe i 23 prillit 2015, nr. 29369/10 (përfshirë si përmbledhje në publikim).

paanshmërinë. Për shembull, si pjesë e detyrave të përgjithshme të gjyqtarëve për t'u përmbajtur në jetën e tyre private, mund të vihen kufizime mbi të drejtën e tyre për t'u anëtarësuar në grupe ose shoqata të caktuara.

Megjithatë, kufizime të tilla duhet të jenë të parashikuara në ligj dhe të jetë mjaft të qarta për t'i mundësuar gjyqtarit të parashikojë se anëtarësia e tij në një grup të caktuar mund të çojë në procedura disiplinore kundër tij.<sup>[399]</sup>

---

399 *Maestri k. Italisë*, vendimi i Dhomës së Madhe i 17 shkurtit 2004, nr. 39748/98 (përfshirë si përmbledhje në publikim).



## (9) PËRFUNDIM

Kriteret që një gjykatë të jetë e pavarur, e paanshme dhe e ngritur me ligj sipas nenit 6 janë të gjitha pjesë integrale të mbështetjes së parimit themelor të shtetit të së drejtës dhe ruajtjes së besimit publik tek gjykatat, ku të dyja janë tipare thelbësore të çdo shoqërie demokratike.

Ky Udhërrëfyes ka theksuar rëndësinë e veçantë të këtyre mbrojtjeve sipas nenit 6 në kontekstin e procedurave disiplinore kundër gjyqtarëve. Ekzistenca e mundësisë së nisjes së procedurave disiplinore kundër një gjyqtari është pa dyshim e nevojshme për të garantuar pajtueshmërinë me detyrimet e tij profesionale, përfshirë detyrimin për të qenë i pavarur dhe i paanshëm. Megjithatë, ekziston rreziku që procedura të tilla mund të përdoren nga qeveritë për të ndëshkuar gjyqtarët për rezultatet ose përmbajtjen e vendimeve të tyre, duke ndërhyrë kështu tek pavarësia dhe paanshmëria e tyre. Mbrojtjet e nenit 6 duhet të zbatohen rreptësisht për t'u siguruar që kërcënimi i procedurave disiplinore kundër gjyqtarëve të mos keqpërdoret nga Shtetet për të bërë presion ndaj gjyqtarëve, duke dëmtuar kështu, në vend që të avancojnë, pavarësinë dhe paanshmërinë e tyre.

Po ashtu, duhet theksuar se e drejta për qasje në gjykatë të pavarur dhe të paanshme të ngritur me ligj shërben jo vetëm për të siguruar pajtueshmërinë me kriteret e nenit 6, por edhe për të siguruar mbrojtjen praktike dhe efektive të të gjitha të drejtave të Konventës. Kapitulli 8 i këtij Udhërrëfyesi analizon disa shembuj të mënyrave se si kriteret institucionale të nenit 6 ndërveprojnë me të drejta të tjera të Konventës. Në të vërtetë, ekzistenca e një gjyqësori të pavarur dhe të paanshëm të ngritur me ligj është pjesë thelbësore e mbështetjes së të gjitha të drejtave të tjera në Konventë, meqenëse operimi i një gjyqësori të pavarur dhe të paanshëm ofron një mekanizëm kyç përmes të cilit individët mund të kërkojnë llogari prej Shteteve për ndërhyrjet tek të drejtat e tyre të Konventës.

Në fund, ajo që është e qartë nga përmbajtja e këtij Udhërrëfyesi është se detyra e ruajtjes së pavarësisë dhe paanshmërisë së gjyqësorit kërkon një qasje shumëplanëshe; detyrimet e vëna nga neni 6 nuk kufizohen vetëm me gjyqësorin. Legjislativi, ekzekutivi, media dhe këshillat gjyqësore, për shembull, të gjitha duhet të luajnë rol në inkurajimin e transparencës së procedurave gjyqësore, zbatimin e vendimeve gjyqësore përfundimtare, dhe ruajtjen e besimit publik tek pavarësia dhe paanshmëria e gjyqësorit.

## Përmbledhje të Çështjeve

### (1) E Drejta për Gjykatë të Ngritur me Ligj

*Pjesëmarrja e një gjyqtareje, emërimi i së cilës u karakterizua nga shkelje të rënda të së drejtës vendase, në apelin penal të kërkuarit shkeli nenin 6 § 1 sepse dështoi në vënien e ekuilibrit të duhur mes sigurisë ligjore dhe të drejtës së kërkuarit për gjykatë të krijuar me ligj*

#### VENDIMI I DHOMËS SË MADHE NË ÇËSHTJEN GUÐMUNDUR ANDRI ÁSTRÁÐSSON K. ISLANDËS

(Kërkesa nr. 26374/18)  
**1 dhjetor 2020**

#### 1. Faktet kryesore

*Çështja penale e kërkuarit*

Kërkuari kishte lindur në vitin 1985 dhe jetonte në Kópavogur. Në mars 2017 ai u dënua për drejtim automatik pa patentë të vlefshme nën ndikimin e drogave. Apeli i tij u dëgjua nga Gjykata e sapoemëruar e Apelit e cila ishte formuar në janar 2018. Kërkuari kërkoi pa sukses tërheqjen e gjyqtarës A.E. nga çështja e tij mbi bazën e një vendimi të Gjykatës Supreme të 19 dhjetorit 2017 i cili kishte gjetur parregullsi në emërimin e saj.

Gjykata e Apelit konfirmoi dënimin e kërkuarit në prill 2018. Ai apeloj në Gjykatë Supreme duke parashtruar që emërimi i A.E. nuk kishte qenë në përputhje me ligjin dhe që për këtë arsye ai nuk kishte gëzuar gjyq të drejtë para një gjykate të pavarur dhe të paanshme të krijuar sipas ligjit. Ai gjithashtu pretendoi që pas emërimit të saj qëndronin motive politike. Megjithatë, Gjykata Supreme e rrëzoi apelin e tij më 24 maj 2018. Megjithëse gjykata pranoi që kishte pasur parregullsi në procedurën e emërimit të gjyqtarës, ajo [Gjykata] deklaroi që emërimi i saj ishte i vlefshëm dhe që kishte arsye të pamjaftueshme për të arritur në përfundimin që kërkuarit nuk i ishte dhënë gjyq i drejtë brenda kuptimit të nenit 6 § 1 të Konventës.

*Emërimi gjyqësor i A.E.*

Komiteti i pavarur islandez i Vlerësimit (këtu e tutje ‘Komiteti’) kishte bërë vlerësimin e 33 kandidatëve për 15 poste gjyqësore në Gjykatën e sapoemëruar të

Apelit. Prej atyre 33 kandidatëve, Komiteti më pas kishte rekomanduar një listë prej 15 kandidatësh të cilët i konsideronte më të kualifikuar për detyrë. Ministrja e Drejtësisë (këtu e tutje ‘Ministrja’) lejohej të mos e merrte parasysh këtë rekomandim vetëm në përputhje me Aktin Juridik Nr. 50/2016 (këtu e tutje ‘Akti’) ku: (i) Komiteti konsideronte që kandidatët e propozuar i plotësonin kriteret minimale për detyrën sipas Aktit; dhe (ii) propozimi pranohej nga Parlamenti.

Përfundimisht, Ministrja zgjodhi 11 kandidatë prej rekomandimeve të Komitetit, dhe shtoi katër të tjerë duke përfshirë edhe A.E.. Parlamenti e pranoi propozimin për të hequr katër kandidatë nga lista e Komitetit dhe për të shtuar katër kandidatët e Ministres me një votim të vetëm nga shumica në qershor 2017. Presidenti i Islandës firmosi letrat e emërimit të gjyqtarëve të rinj, përfshirë edhe për A.E., më vonë atë muaj.

Dy prej katër kandidatëve të cilët ishin hequr nga lista e Komitetit pas propozimit të Ministres ngritën padi ndaj Shtetit me pretendimin që emërimet gjyqësore vijuese kishin qenë të paligjshme. Megjithëse Gjykata Supreme i refuzoi pretendimet e tyre për dëme materiale, ajo u caktoi secilit prej tyre nga 700,000 korona islandeze (ISK) (afërsisht 5,700 Euro) për dëm moral.

Në dy vendime të 19 dhjetorit 2017, Gjykata Supreme gjeti që Ministrja kishte shkelur dispozitat e brendshme për emërimet gjyqësore meqenëse kishte dështuar të paraqiste para Parlamentit një arsytim të mbështetur në hetime të pavarura në lidhje me ndryshimet e bëra prej saj në listën e Komitetit. Gjithashtu, ajo [Gjykata] deklaroi që procedura përmes së cilës Parlamenti e kishte miratuar propozimin ishte e mangët sepse për listën e ndryshuar ishte votuar *en bloc*, në vend që të votohej për secilin kandidat ndaras siç kërkohej nga Akti.

## **2. Vendimi i Gjykatës**

Kërkuesi u ankua që një prej gjyqtareve të Gjykatës së sapoemëruar të Apelit e cila kishte mbështetur dënimin e tij penal nuk ishte emëruar në përputhje me të drejtën përkatëse vendase. Ai pretendoi që për këtë arsye akuzat penale kundër tij nuk ishin përcaktuar nga një “gjykatë e krijuar me ligj” sipas kuptimit të nenit 6 § 1 të Konventës. Në lidhje me atë parashtrim, kërkuesi më tej u ankua që atij i ishte mohuar e drejta për gjykatë të pavarur dhe të paanshme brenda kuptimit të po asaj dispozite.

Në vendimin e saj të 12 marsit 2019, Dhoma deklaroi që kishte pasur shkelje të së drejtës së kërkuesit për gjykatë të krijuar sipas ligjit në përputhje me nenin 6 § 1.

Rrjedhimisht, Dhoma deklaroi se nuk kishte pasur nevojë që të shqyrtoheshin ankesat e kërkuessit në lidhje me të drejtën e tij për gjykatë të pavarur dhe të paanshme sipas asaj dispozite. Me kërkesë të Qeverisë sipas nenit 43, çështja iu referua Dhomës së Madhe.

### Neni 6 § 1

Çështja në fjalë i dha Gjykatës mundësinë për të qartësuar konceptin e “gjykatës së krijuar me ligj” dhe marrëdhënien e saj me kriteret institucionale të “pavarësisë dhe paanshmërisë”.

#### *E drejta për gjykatë të krijuar me ligj*

Gjykata përsëriti që nëse një gjykatë nuk ngrihet në përputhje me qëllimet e legjislaturës, asaj i mungon legjitimiteti i kërkuar në një shoqëri demokratike për të zgjidhur mosmarrëveshjet ligjore. Megjithatë, e drejta për gjykatë të krijuar sipas ligjit nuk është e atillë që çdo parregullsi dhe të gjitha parregullsitë në procedurën e emërimit do të përbënin shkelje të asaj të drejte. E drejta për gjyq të drejtë sipas kësaj dispozite duhet të interpretohet nën dritën e parimeve të tjera të shtetit të së drejtës siç është siguria ligjore dhe mos-shkarkimi i gjyqtarëve. Mbrojtja e të drejtës së një gjykate të krijuar me ligj në dëm të këtyre parimeve mundet që, në disa rrethana, t'i shkaktojë dëm të mëtejshëm shtetit të së drejtës dhe besimit publik tek gjyqësori. Prandaj, sipas praktikës së vendosur gjyqësore të Gjykatës, distancimi nga parimet e sigurisë ligjore justifikohet vetëm nga rrethana të një natyre substanciale dhe detyruese, si për shembull korrigjimi i defekteve themelore ose dënimit të padrejtë. Distancimi nga parimi i mos-shkarkimit të gjyqtarëve është i pranueshëm vetëm nëqoftëse është proporcional me një qëllim legjitim. I takon Gjykatës të përcaktojë nëse është arritur ekuilibri i duhur mes këtyre parimeve themelore të Konventës.

Kështu, Gjykata formuloi një test me tre hapa për të vlerësuar nëse parregullsitë në një emërim të dhënë gjyqësor ishin aq të rënda sa të ngërthenin shkelje të së drejtës për gjykatë të krijuar sipas ligjit.

#### i) *Hapi i parë*

Në parim, së pari duhet të ketë shkelje të dukshme të së drejtës vendase. Gjykata përgjithësisht e pranon interpretimin e gjykatave kombëtare nëse ka pasur apo jo shkelje të tilla, për sa kohë që gjetja e saj nuk konsiderohet arbitrare apo dukshëm e paarsyeshme.

Në çështjen në fjalë, në vendimet e saj të 19 dhjetorit 2017 dhe 24 majit 2018, Gjykata Supreme e Islandës kishte arritur në përfundimin që emërimi i katër gjyqtarëve të Gjykatës së Apelit nga ana e Ministres kishte shkelur të drejtën vendase në dy aspekte. Së pari, Ministria nuk kishte zhvilluar hetime të pavarura, në kundërshtim me seksionin 10 të Aktit të Procedurave Administrative, ku si rezultat ajo nuk kishte dhënë arsye të mjaftueshme për distancimin nga propozimi i Komitetit. Së dyti, Parlamenti islandez kishte dështuar të vepronte në përputhje me procedurën e posaçme të votimit sipas Aktit. Nuk kishte arsye për t'u distancuar nga interpretimi i të drejtës vendase nga Gjykata Supreme në rastin konkret, dhe prandaj kushti i parë i testit ishte i plotësuar.

Megjithatë, Gjykata theksoi që mungesa e një shkeljeje të dukshme të së drejtës vendase nuk është fatale për gjetjen e një shkeljeje të kësaj të drejte. Mund të ketë rrethana në të cilat emërimi në dukje është në pajtueshmëri me rregullat vendase por megjithatë prodhon rezultate që nuk janë në pajtueshmëri me objektin dhe qëllimin e të drejtës për gjykatë të krijuar me ligj, dhe në një rast të tillë Gjykata duhet ta vazhdojë shqyrtimin e saj sipas hapave 2 dhe 3 të testit.

ii) *Hapi i dytë*

Më tej, shkelja duhet të vlerësohet duke marrë parasysh impaktin e saj mbi objektin dhe qëllimin e të drejtës për gjykatë të krijuar me ligj. Pra, impakti i saj mbi mundësinë e gjyqësorit për të ushtruar gjykim pa ndërhyrje të papërshtatshme. Prandaj, shkeljet të cilat janë të natyrës krejtësisht teknike dhe nuk kanë efekt mbi mundësinë e gjyqësorit për të mbrojtur dhe ruajtur shtetin e së drejtës bien nën pragun e këtij testi. Rrjedhimisht, vetëm shkeljet të cilat kanë të bëjnë me procedurat themelore të emërimeve gjyqësore kanë gjasa të rezultojnë me shkelje të së drejtës në fjalë.

Në Islandë, Komiteti kishte fuqinë të jepte rekomandime detyruese për emërimet gjyqësore prej të cilave Ministria mund të devijonte përjashtimisht, gjithnjë nën kontrollin e Parlamentit. Meqenëse qëllimi i këtij mekanizmi ishte të kufizonte influencën e ekzekutivit mbi emërimet gjyqësore, duke fuqizuar kështu pavarësinë e gjyqësorit në Islandë, respektimi i rekomandimeve të Komitetit ishte rregull themelor i procedurës nacionale për emërimet gjyqësore. Gjykata më tej mori në shqyrtim të dy shkeljet e kryera nga Ministria dhe mangësitë e procedurës parlamentare.

Ministrja kishte shpjeguar në Parlament që vendimi i saj për t'u distancuar nga vlerësimi i Komitetit ishte i bazuar mbi dëshirën: (i) për t'i dhënë më shumë peshë eksperiencës gjyqësore; dhe (ii) për të arritur ekuilibër gjinor mes të emëruarve. Megjithatë, vendimi i Komitetit për t'i dhënë eksperiencës gjyqësore të njëjtën peshë si eksperiencia e mosmarrëveshjeve ligjore dhe administrative kishte qenë në përputhje me të drejtën vendase. Në lidhje me ekuilibrin gjinor, në vendimin e saj të 19 dhjetorit 2017 Gjykata Supreme e Islandës shënoi që konsideratat sipas Aktit të Barazisë ishin relevante vetëm në rastet kur dy kandidatë të gjinive të ndryshme konsideroheshin njësoj të kualifikuar, duke arritur në përfundimin që konsiderata të tilla nuk mund të bëheshin në këtë rast për shkak të mangësive në hetimet e Ministres.

Megjithatë, edhe po të supozohet se Ministrja nuk kishte vepruar sipas rekomandimeve të Komitetit për arsye legjitime, gjetja nga Gjykata Supreme e një shkeljeje në vendimin e saj të 19 dhjetorit 2017 përfundimisht u bazua në faktin që Ministrja thjesht kishte dështuar të shpjegonte përse kishte zgjedhur një kandidat/e në vend të një tjetri/e, siç kërkohej nga seksioni 10 i Aktit të Procedurave Administrative. Ndërkohë që të katër kandidatët e shtuar në listë nga Ministrja kishin më shumë pikë në aspektin e përvojës gjyqësore sesa katër kandidatët që ajo hoqi nga lista e Komitetit, kishte pasur kandidatë të tjerë në listë të cilët kishin më pak përvojë gjyqësore sesa katër të hequrit nga lista. Ngjashëm, kishte kandidatë të tjerë (përfshirë një kandidate) që kishin më shumë pikë sipas përvojës gjyqësore sesa katër të zgjedhurit eventual të Ministres. Prandaj, ky vlerësim nuk ofronte shpjegim bindës lidhur me arsyen pse pikërisht ato tetë kandidatë ishin shtuar apo hequr nga lista. Megjithëse Qeveria argumentoi që Ministrja kishte marrë në konsideratë gjithashtu edhe "sukseset" në karrierën e kandidatëve, nuk ishte paraqitur asnjë shpjegim rreth mënyrës se si ishte vlerësuar ky aspekt. Për pasojë, objektiviteti i procesit në përzgjedhjes ishte në pikëpyetje.

Përfundimisht, pasiguria rreth motiveve të Ministres ngriti shqetësime serioze në lidhje me ndëhyrje të papërshtatshme nga ekzekutivi, gjë që njollose legjitimitetin e tërë procedurës. Kësaj i shtohet fakti që Ministrja i përkiste njëres prej partive politike që përbënte shumicën në qeverinë e koalicionit në Islandë, ku propozimi i saj në Parlament ishte miratuar vetëm me votat e asaj partie. Ndërkohë që Gjykata nuk ishte në pozitë që të përcaktonte nëse Ministrja faktikisht kishte vepruar për motive politike, veprimet e saj kishin ngritur shqetësime objektivisht të justifikuara në masë të atillë sa mjaftonin për të zvogëluar transparencën e procesit të përzgjedhjes gjyqësore. Në fund, Gjykata iu referua vendimeve të Gjykatës Supreme në dhjetor 2017 të cilat kishin arritur në përfundimin që ajo kishte vepruar "në shpërfillje të plotë të rrezikut të qartë" ndaj reputacionit të kandidatëve që ishin hequr.

Prandaj, Gjykata arriti në përfundimin që shkeljet e Ministres nuk ishin thjesht parregullsi teknike apo procedurale por shkonin drejt e në thelb të së drejtës për gjykatë të krijuar me ligj.

Për sa i përket mangësive në procedurën parlamentare, Gjykata theksoi se Parlamenti islandez kishte dështuar të kërkonte nga Ministria arsye objektive për propozimet e saj. Ai gjithashtu kishte dështuar të vepronte në përputhje me rregullat e posaçme të votimit duke e kaluar propozimin e saj me një votim të vetëm, në vend që të mbaheshin votime të ndara për secilin kandidat, siç kërkohet nga Akti. Ndërkohë që ky dështimi i fundit në vetvete nuk do të kishte përbërë shkelje të së drejtës për gjykatë të krijuar sipas ligjit, (sidomos duke pasur parasysh që anëtarëve të parlamentit u ishte dhënë mundësia për të zhvilluar votim të ndarë) procedura e votimit i zmadhoi shkeljet e kryera nga Ministria dhe minoi rolin e Parlamentit si roje kundër diskrecionit të papërshtatshëm të ekzekutivit. Rrjedhimisht, besimi i kërkuesit që vendimi i Parlamentit ishte nxitur kryesisht nga konsideratat politike të partisë nuk ishte i paarsyeshëm.

Duke pasur parasysh konsideratat e mësipërme, Gjykata arriti në përfundimin që kishte pasur shkelje të rëndë të një rregulle thellore në procedurën islandeze të emërimeve gjyqësore.

### iii) *Hapi i tretë*

Hapi i tretë dhe përfundimtar përfshin një vlerësim të shqyrtimit të zhvilluar nga gjykatat kombëtare mbi shkeljen. Gjetja nga gjykatat kombëtare e një shkeljeje në procedurën vendase të emërimeve gjyqësore, dhe pasojat e saj ligjore, janë domethënëse për përcaktimin nëse një shkelje e tillë ka përbërë shkelje të së drejtës për gjykatë të krijuar sipas ligjit. Kur shqyrtimi vendas ishte në përputhje me Konventën, Gjykatës do t'i duheshin arsye të forta për të zëvendësuar vlerësimin e vet me atë të gjykatave kombëtare. Më tej, megjithëse nuk ishte në kompetencë të Gjykatës të vendoste një afat të caktuar kohor gjatë të cilit mund të kontestohet një emërim i parregullt, ajo konsideroi që ruajtja e parimit të sigurisë ligjore ka peshë gjithnjë e më të madhe kur matet kundrejt të drejtës së një kërkuesi për gjykatë të krijuar sipas ligjit me kalimin e kohës.

Në shqyrtimin e saj të çështjes së tanishme, Gjykata Supreme dështoi në zhvillimin e një vlerësimi në përputhje me Konventën. Së pari, pavarësisht nga pushteti i saj për të ndrequr efektet e parregullsive në emërim, gjykata nacionale kishte dështuar në nxjerrjen e përfundimeve të nevojshme nga vetë gjetjet e saj. Megjithëse gjykata nacionale njohu faktin që kishte pasur parregullsi në emërimin e A.E., ajo konsideroi

që kërkuesi sidoqoftë kishte gëzuar gjyq të drejtë. Me këto veprime, ajo kishte vënë theks më të madh mbi faktin që emërimet gjyqësore ishin bërë zyrtare sesa mbi aftësinë e vet asaj për ta ndrequr parregullsinë. Së dyti, gjykata ishte fokusuar më shumë për të parë nëse parregullsitë kishin ndikuar tek pavarësia dhe paanshmëria e A.E. sesa për të trajtuar argumentet me vend të kërkuesit në lidhje me të drejtën për gjykatë të krijuar sipas ligjit. Për pasojë, vendimi nuk ndriçoi arsytet përse shkeljet procedurale nuk kishin komprometuar ligjshmërinë e emërimit të A.E. e rrjedhimisht ligjshmërinë e pjesëmarrjes së saj në çështjen e kërkuesit. Së treti, kalimi i kohës nuk e kishte anuar ekuilibrin në favor të parimit të sigurisë ligjore në rastin konkret, meqenëse emërimet gjyqësore përkatëse ishin kontestuar menjëherë pas finalizimit të procedurës së emërimit mbi bazën e parregullsive që ishin konstatuar përpara se ata të emëroheshin zyrtarisht.

Roli i kufizuar i Gjykatës Supreme në këtë çështje, çka rezultoi me dështimin e saj në vënien e ekuilibrit të duhur mes parimit të sigurisë ligjore dhe ruajtjes së respektit për ligjin, nuk ishte tipar dallues vetëm i çështjes në fjalë por praktikë e ngulitur. Kjo praktikë minonte rolin thelbësor të gjyqësorit në ruajtjen dhe ndarjen e pushteteve. Më tej, efektet e këtyre shkeljeve nuk kufizoheshin me kandidatët gjyqësorë ndaj të cilëve ishte gabuar duke mos i emëruar, por përbënin shqetësim edhe më të madh për publikun e gjerë në aspekt të sundimit të ligjit.

Në përfundim, duke pasur parasysh testin trehapësh më lart, Gjykata deklaroi që kërkuesit i ishte mohuar e drejta për gjykatë të krijuar me ligj për shkak të pjesëmarrjes së një gjyqtareje emërimi i së cilës kishte pasur parregullsi të rënda të cilat e kishin dëmtuar të drejtën në fjalë. Prandaj, kishte pasur shkelje të nenit 6 § 1.

#### *E drejta për gjykatë të pavarur dhe të paanshme*

Ankesa e kërkuesit në lidhje me pavarësinë dhe paanshmërinë rridhte nga i njëjti problem brenda ankesës së mësipërme: defektet procedurale në emërimin gjyqësor të A.E. në Gjykatën e Apelit. Këto parregullsi procedurale ishin kaq të rënda sa që kishin minuar vetë thelbin e të drejtës për t'u gjykuar para një gjykate të krijuar sipas ligjit. Kështu, Gjykata konsideroi që nuk ishte e nevojshme të përcaktohej nëse këto parregullsi kishin komprometuar edhe pavarësinë dhe paanshmërinë e të njëjtës gjykatë.

#### Neni 46

Gjykata theksoi që përfaqësuesi i kërkuesit fillimisht kishte deklaruar se kërkuesi nuk do të synonte rihapjen e procedurave penale kundër tij në rast shkeljeje të nenit



6. Ajo konsideroi se kërkesa e tij e mëpasme për ta tërhequr këtë deklaratë nuk kishte ofruar justifikim të mjaftueshëm për të shpjeguar ndryshimin e qëndrimit të kërkuarit.

I binte për detyrë Shtetit të merrte të gjitha masat e përgjithshme që nevojiteshin për të trajtuar përfundimet e vendimit në fjalë. Rrjedhimisht, ajo nënvizoi që gjetja e një shkeljeje në këtë çështje nuk ishte e atillë sa t'i kërkohej Shtetit që të rihapte të gjitha çështjet e ngjashme të cilat prej asaj kohe ishin bërë res judicata në përputhje me të drejtën islandeze.

#### Neni 41

Gjykata vendosi që gjetja e një shkeljeje përbënte shpërblim të drejtë të mjaftueshëm në çështjen në fjalë. Ajo i caktoi kërkuarit 20,000 Euro për kosto dhe shpenzime.

*Emërimi i gjyqtarëve në Gjykatë Kushtetuese në kundërshtim me dispozitat e të drejtës vendase dhe duke shkelur vazhdimisht vendimet e Gjykatës Kushtetuese përbëri shkelje të së drejtës për gjykatë të ngritur me ligj sipas nenit 6 § 1*

VENDIMI NË ÇËSHTJEN  
**XERO FLOR W POLSCE SP. Z O.O. K. POLONISË**

---

(Kërkesa nr. 4907/18)

**7 maj 2021**

**1. Faktet kryesore**

Procedurat civile të kompanisë kërkuese

Kompania kërkuese, Xero Flor w Polsce sp. z o.o., ishte një prej prodhuesve më të mëdhenj të terreneve të barit në Poloni. Për shumë vite me radhë ajo kishte pësuar dëme në terren për shkak të drerëve dhe derrave të egër. Në vitin 2010, ajo nisi procedura kundër menaxherit të zonës së shumimit të kafshëve të gjahut, dhe ra dakord me një paketë kompensimi në shumën 199,920 zlota polake (PN) (të barasvlershme me rreth 50,000 euro).

Në shtator 2012, ajo paditi Thesarin e Shtetit, duke kundërshtuar pragu e caktuar prej 25% mbi kompensimin për të gjitha dëmet e pësuar para 15 prillit 2010. Në të njëjtën procedurë, kompania kërkuese i kërkoi gjykatës që t'i referonte tri çështje Gjykatës Kushtetuese për vendimmarrje paraprake. Këto kishin të bënin me kushtetutshmërinë e paragrafëve 4 dhe 5 të Urdhëresës së Ministrit të Ambientit të 8 marsit 2010 ("Urdhëresa") dhe seksionit 49 të Ligjit të Gjuetisë. Aty argumentohej se efekti i këtyre dispozitave ishte që personat që kultivonin të mbjella shumëvjeçare të viheshin në një pozicion më pak të favorshëm sesa ata që kultivonin të mbjella vjetore, dhe që dispozitat ishin jokushtetuese sepse ato ishin akte nënligjore.

Gjykata Rajonale e refuzoi argumentin e kompanisë kërkuese që pragu prej 25% nuk duhet të zbatohet, dhe gjeti që terreni i barit nuk ishte e mbjellë shumëvjeçare. Vendimi u mbështet nga Gjykata e Apelit në vitin 2014. Gjykata Supreme refuzoi të dëgjonte apelin në kasacion në vitin 2015. Në fund, Gjykata Kushtetuese e rrëzoi ankesën kushtetuese të kompanisë kërkuese me shumicë votash 3 me 2, në vitin 2017.

### *Emërimet gjyqësore në Gjykatën Kushtetuese*

Nga fundi i vitit 2015, Sejm-i (dhoma e ulët e Parlamentit dydhomësh të Polonisë) duhet të emëronte pesë gjyqtarë të rinj për të plotësuar pesë vende të sapoliruara në Gjykatën Kushtetuese. Gjatë kësaj periudhe, lindi një mosmarrëveshje në lidhje me legjitimitetin e zgjedhjes së gjyqtarëve në Gjykatën Kushtetuese.

Më 6 nëntor 2015, u liruan tre vende. Më 8 tetor 2015, anëtarët në dalje të Sejm-it të shtatë zgjodhën tre gjyqtarë të rinj (R.H., A.J., K.Ś.) për t'i plotësuar ato vende. Sejm-i i ri me një shumicë tjetër u zgjodh më 25 tetor 2015, dhe mbajti seancën e parë më 12 nëntor 2015. Sipas Kushtetutës, kjo nënkuptonte se mandati i Sejm-it të mëparshëm kishte përfunduar më 11 nëntor 2015. Më 25 nëntor 2015, Sejm-i i ri miratoi rezoluta sipas të cilave zgjedhjet gjyqësore të zhvilluara nga Sejm-i i mëparshëm nuk kishin fuqi ligjore. Më pas, ai zgjodhi tre gjyqtarë të rinj, përfshirë një gjyqtar që ishte pjesë e panelit në çështjen e kompanisë kërkuese (M.M.), më 2 dhjetor 2015, për të plotësuar vendet që ishin liruar më 6 nëntor 2015.

## **2. Vendimi i Gjykatës**

Kompania kërkuese u ankua që refuzimi i gjykatës vendase për të dhënë përgjigje bindëse për parashtrimet e saj lidhur me kushtetutshmërinë e dispozitave përbënte shkelle të detyrimit të saj për të ofruar vendime të arsyetuara brenda kuptimit të nenit 6 § 1 të Konventës. Më tej, ajo u ankua që parregullsitë në zgjedhjen e njërit prej gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese (M.M.) i cili kishte dëgjuar ankesën e saj kushtetuese përbënte shkelle të së drejtës së saj për gjykatë të ngritur me ligj, po ashtu sipas nenit 6 § 1. Në fund, kompania kërkuese u ankua që kishte pasur ndërhyrje tek e drejta e saj për gëzimin paqësor të pasurisë sipas nenit 1 të Protokollit Nr. 1 të Konventës.

### Neni 6 § 1

#### *E drejta për vendim të arsyetuar*

Gjykata e gjeti ankesën të pranueshme meqenëse kishte të bënte me fushëveprimin e të drejtës së kompanisë kërkuese për kompensim, që ishte e drejtë civile brenda kuptimit të nenit 6 § 1.

Gjatë shqyrtimit të themeleve të ankesës, Gjykata deklaroi se çështja nëse një gjykatë vendase ka dështuar të japë arsye duhet të trajtohet duke pasur parasysh çështjen në fjalë. Ajo gjithashtu e pranoi, pjesërisht, argumentin e Qeverisë që nuk

ekzistonte e drejta automatike që çështja para një gjykate t'i referohet një gjykate tjetër për vendimarrje paraprake, por deklaroi se dështimi për ta bërë një gjë të tillë mund të shkelë drejtësinë e procedurave në raste të caktuara.

Kompania kërkuese e kishte kundërshtuar Urdhëresën mbi bazën se ajo i trajtonte kultivuesit e të mbjellave shumëvjeçare në mënyrë më pak të favorshme sesa kultivuesit e të mbjellave vjetore, sa i përket kompensimeve për dëmet e shkaktuara nga kafshët e gjahut. Në mënyrë të veçantë, ajo argumentoi se paragrafi 5 i Urdhëresës kufizonte të drejtat e pronarëve në mënyrë të atillë që ishte në papajtueshmëri me nenin 64 § 3 të Kushtetutës (i cili parashikonte që çdo kufizim i të drejtave pronësore duhet të rregullohej me anë të një statuti të miratuar nga Parlamenti) për shkak se ishte legjislacion sekondar.

Gjykata e njohu këtë si çështje kyçe: të tri gjykatat vendase kishin dështuar të jepnin arsye për mospajtimin me argumentin e kompanisë kërkuese, të cilin ajo e kishte paraqitur në të gjitha fazat e procedurave. Duke qenë se argumenti ishte “specifik, me vend dhe i rëndësishëm”, çështja në fjalë hynte brenda kategorisë në të cilën ekzistonte detyrimi për të referuar një çështje të rëndësishme kushtetuese. Kështu, dështimi i gjykatave vendase për të dhënë arsye për refuzimin e tyre për ta referuar çështjen në Gjykatë Kushtetuese përbëri shkelje të detyrës së autoriteteve për të marrë vendime të arsyetuara, sipas nenit 6 § 1.

### *E drejta për gjykatë të ngritur me ligj*

Qeveria kishte kundërshtuar pranueshmërinë e ankesës për dy arsye: së pari, që mekanizmi i Ankesave Kushtetuese nuk e angazhonte nenin 6 § 1; së dyti, që çështja nuk kishte lidhje të drejtpërdrejtë me të drejtat civile të kompanisë kërkuese. Në lidhje me kundërshtimin e parë, Gjykata njohu faktin se Kushtetuta Polake bënte dallim të qëllimshëm mes ‘gjykatave’ dhe ‘tribunaleve’, por mbështetej në praktikën gjyqësore të vet për të përcaktuar se Gjykata Kushtetuese ishte ‘tribunal’ brenda kuptimit të nenit 6 § 1 të Konventës. Në lidhje me kundërshtimin e dytë, Gjykata njohu dy kufizime kyçe të mekanizmit polak për Ankesat Kushtetuese: së pari, që Ankesa Kushtetuese mund të bëhej vetëm kundër një dispozite dhe jo kundër një vendimi per se; dhe së dyti, që pamundësia e Gjykatës Kushtetuese për të prishur një vendim të mëhershëm nënkuptonte se fuqia e saj për zgjidhje ishte e kufizuar. Megjithatë, duke qenë se një kërkues i suksesshëm mund të bënte kërkesë për të rihapur procedurat e mëparshme (sipas Nenit 190 § 4 të Kushtetutës), rezultati ishte direkt vendimtar për të drejtat civile të kompanisë kërkuese, që do të thotë se ky kundërshtim mbi bazat e pranueshmërisë gjithashtu do të dështonte dhe ankesa do të deklarohet e pranueshme.

Gjatë analizës nëse kishte pasur shkelje të së drejtës së kompanisë kërkuese për gjykatë të ngritur me ligj, Gjykata zbatoi testin me tre hapa të vendosur në Guðmundur Andri Ástráðsson k. Islandës.

i) *A ka pasur shkelje të dukshme të së drejtës vendase?*

Gjykata gjeti se kishte pasur tri shkelje të dalluara të së drejtës vendase. Së pari, kishte pasur shkelje në lidhje me rezolutat e 25 nëntorit 2015. Gjykata gjeti se këto nuk kishin efekt ligjor sepse Sejm-i nuk kishte fuqinë të modifikonte një vendim të mëparshëm për zgjedhjen e një gjyqtari të Gjykatës Kushtetuese. Së dyti, kishte pasur shkelje të Nenit 194 § 1 të Kushtetutës, i cili parashikonte se gjyqtari duhet të zgjidhet nga Sejm-i, mandati i së cilës mbulon datën kur lirohet vendi aty. M.M. ishte zgjedhur për të plotësuar një vend që ishte liruar më 6 nëntor 2015 nga Sejm-i i tetë, mandati i të cilit kishte filluar me seancën e tij të parë më 12 nëntor. Së treti, kishte pasur shkelje të kriterit që Presidenti i Republikës të bënte betimin e gjyqtarëve të sapozgjedhur të Gjykatës Kushtetuese. Megjithëse ai e kishte dëgjuar menjëherë betimin e gjyqtarëve të zgjedhur në mënyrë jokushtetuese më 2 dhjetor 2015, Presidenti i Republikës kishte refuzuar të dëgjonte betimin e tre gjyqtarëve të cilët ishin zgjedhur në mënyrën e duhur nga Sejm-i i shtatë. Gjykata bëri dallim të theksuar mes përgjegjësisë së Presidentit të Republikës për të bërë betimin e gjyqtarëve të rinj të Gjykatës Kushtetuese dhe aftësisë për të vendosur përbërjen e saj, që ishte kompetencë ekskluzive e Sejm-it. Kështu, kishte pasur shkelje të dukshme të së drejtës vendase në lidhje me zgjedhjen e gjyqtarëve në Gjykatën Kushtetuese nga Sejm-i i tetë dhe Presidenti i Republikës.

ii) *Cili ishte impakti i shkeljes mbi objektin dhe qëllimin e së drejtës për gjykatë të ngritur me ligj?*

Sipas Guðmundur Andri Ástráðsson, gjatë vendosjes nëse një shkelje e së drejtës vendase ka përbërë shkelje të nenit 6, Gjykata mori në konsideratë si qëllimin e ligjit të shkelur ashtu edhe faktin nëse ajo shkelje ka dëmtuar thelbin e të drejtës për gjykatë të ngritur me ligj.

Gjykata gjeti se shkeljet e mësipërme kishin të bënin me rregullën themelore të zgjedhjeve, të dalë nga Neni 194 § 1 i Kushtetutës, që gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese duhet të zgjidheshin nga Sejm-i mandati i të cilit mbulon datën në të cilën lirohet vendi. Thelbi i kësaj rregulle gjithashtu ishte shkelur nga dështimi i Presidentit të Republikës për të dëgjuar betimin e tre gjyqtarëve të zgjedhur në mënyrë kushtetuese. Gjykata theksoi se këto shkelje përmblihdeshin nga fakti që Presidenti i Republikës dhe Sejm-i i tetë me këmbëngulje kishin shpërfillur gjetjet e Gjykatës

Kushtetuese të 3 dhjetorit 2015 (K 34/15) që tre gjyqtarët e zgjedhur nga Sejm-i i mëparshëm ishin zgjedhur në mënyrë legjitime. Më tej, ato përmblihdeshin nga fakti që Sejm-i i tetë kishte tentuar të impononte pranimin e gjyqtarëve të zgjedhur në mënyrë jokushtetuese nga këshilli i Gjykatës Kushtetuese. Ky refuzim ngulmues për të respektuar vendimet e Gjykatës Kushtetuese kishte dëmtuar autoritetin e gjyqësorit; parimin e ndarjes së pushteteve; dhe parimin e sigurisë ligjore, që është aspekt themelor i shtetit të së drejtës.

iii) *Deri ku shkonte vlerësimi që kishin ndërmarrë gjykatat vendase për shkeljen?*

Gjykata gjeti se nuk ishte ofruar ndreqje sepse në ligjet polake nuk kishte procedura sipas të cilave kompania kërkuese mund të kishte kontestuar defektet e pretenduara në procesin e zgjedhjes së gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese. Prandaj, kjo fazë e testit u përmbush.

iv) *Përfundim*

Gjykata gjeti se Sejm-i i tetë dhe Presidenti i Republikës kishin shkelur rregulla themelore të zgjedhjes së gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese. Në mënyrë të veçantë, tre gjyqtarë (përfshirë M.M.) ishin zgjedhur në vende të cilat tashmë ishin plotësuar në mënyrë legjitime nga Sejm-i i mëparshëm. Përveç kësaj, Presidenti i Republikës kishte refuzuar të bënte betimin e tre gjyqtarëve të zgjedhur si duhet. Për shkak të pjesëmarrjes së M.M. në procedurat e kompanisë kërkuese para Gjykatës Kushtetuese, kompanisë kërkuese i ishte mohuar e drejta për gjykatë të ngritur me ligj siç garantohet nga neni 6 § 1.

#### Neni 1 i Protokollit Nr. 1

Gjykata konsideroi se çështjet ligjore kryesore të ankesës së kompanisë kërkuese tashmë ishin trajtuar me anë të analizës së nenit 6 § 1, dhe që për këtë arsye nuk ishte e nevojshme të shqyrtohej kjo ankesë ndaras.

#### Neni 41

Gjykata e rrëzoi pretendimin e kompanisë kërkuese për kompensim mbi bazën e faktit se ajo nuk mund të pikaste lidhje shkakësore mes shkeljeve të pësuarra dhe dëmit material të pretenduar. Ajo i caktoi kompanisë kërkuese 15,556 PLN (të barasvlershme me 3,418 euro) për kosto dhe shpenzime.

## **(2) Pavarësia – nga Degët e tjera të Qeverisë (përfshirë Përgjegjësinë e Degëve të tjera të Qeverisë për të mbështetur Pavarësinë dhe Paanshmërinë)**

*Ndërhyrjet politike në procedurat e kthimit të pronave të konfiskuara pas Luftës së Dytë Botërore komprometuan parimin e paanshmërisë*

### **VENDIMI NË ÇËSHTJEN KINSKÝ k. REPUBLIKËS ÇEKE**

(Kërkesa nr. 42856/06)  
**9 shkurt 2012**

#### **1. Faktet kryesore**

Kërkuesi, z. František Oldřich Kinsky, ishte shtetas austriak i cili kishte lindur në vitin 1936 dhe vdiq në prill 2009. Përmes më shumë se njëqind padive civile të depozituara në gjykatat çeke kundër shtetit, komunave lokale dhe personave të tretë, ai u përpoq të rimerrte pronat e veta, të cilat i ishin konfiskuar nga Çekosllovakia pas Luftës së Dytë Botërore, vlera e përgjithshme e të cilave llogaritej të ishte mbi 2 miliardë euro.

Në procedurën në fjalë, padia e kërkuesit kundër Shtetit u rrëzua nga Gjykata e Qarkut Děčín në tetor të vitit 2003, e cila vendosi se prona ishte konfiskuar në mënyrë të rregullt në vitin 1945, në bazë të Dekretit të Presidentit nr. 12/1945. Në nëntor të vitit 2005, Gjykata e Lartë e hodhi poshtë ankesën e kërkuesit të bazuar mbi pika të ligjit, duke u shprehur se, ndërsa nuk mund të vendosej përfundimisht se prona ishte konfiskuar në mënyrë të rregullt, pronat që i ishin transferuar Shtetit para vitit 1990 nuk mund të pretendoheshin të merreshin përmes proceseve civile por vetëm mbi bazën e ligjeve për kthimin e pronave. Më 18 prill 2006, Gjykata Kushtetuese e rrëzoi ankesën kushtetuese të kërkuesit që ai nuk kishte pasur proces të drejtë dhe ishte diskriminuar. Gjykata Kushtetuese u mbështet në Opinionin e saj nr. Pl. Na-St. 21/05, sipas të cilit një padi civile për përcaktimin e pronësisë nuk mund të përdorej për të anashkaluar legjisllacionin e kthimit të pronave, dhe rrjedhimisht gjeti se argumentet e detajuara që kundërshtonin themelin e vendimeve ishin jo relevante.

Ndërsa proceset para gjykatave vazhdonin, anëtarë të ndryshëm të Qeverisë dhe Parlamentit shprehën publikisht mosaprovimin e tyre për kthimin e pronave atyre që kishin qenë “dukshëm” nazistë, duke pretenduar se familja e kërkuesit ishte e tillë. Në një intervistë në korrik të vitit 2003, Ministri i Kulturës shprehu mospajtimin e tij

me vendimin e një gjykatave që i kishte dhënë të drejtë pretendimeve të kërkuarit në një çështje tjetër, dhe deklaroi se gjyqtarët që merrnin vendime të tilla do të duhet të “mbanin përgjegjësi të plotë” për detyrimin e shtetit për të dhënë pronat. Për më tepër, disa politikanë, përfshirë Presidentin dhe Kryeministrin, organizuan disa takime për çështjen e procedurave civile për kthimin e pronave të fituara para vitit 1948, të cilat rezultuan në miratimin e rekomandimeve për shmangien e vendimeve gjyqësore si në rastin e kërkuarit, përfshirë propozimin për t’i kërkuar Gjykatës së Lartë unifikimin e praktikës së ndryshme gjyqësore për këtë çështje.

Në janar të vitit 2004, Ministria e Drejtësisë u kërkoi gjykatave rajonale që kishin të bënin me trajtimin e çështjes së kërkuarit që t’i jepnin asaj informacione mbi proceset në baza mujore. Vetëm në nëntor të vitit 2007, Ministria i informoi gjykatat e përfshira se nuk ishte më e nevojshme që të paraqitej ky informacion.

Në vitin 2004, policia ngriti një grup të posaçëm me qëllim të hetimit të çështjes së kthimit të pronave, në raste të ngjashme si ai i kërkuarit. Në këtë kuadër, nisën hetimet penale kundër kërkuarit dhe avokatit të tij, bazuar në dyshimet se ata kishin tentuar të mashtronin duke fshehur qëllimisht fakte dhe informacione të caktuara lidhur me proceset civile për të mbështetur padinë e tij. Policia shqyrtoi aktivitetet kërkimore të avokatit mbrojtës, në mënyrë të veçantë në arkivat kombëtare, ku ai kishte kërkuar dëshmi në mbështetje të padisë civile të klientit të tij. Gjithashtu, policia gjeti një urdhër nga një gjykatë rrethi në lidhje me monitorimin e telefonatave të avokatit për një periudhë kohe në vitin 2004. Vetëm në qershor të vitit 2006 kërkuari dhe avokati i tij rastësisht morën vesh se kishin qenë objekt i hetimeve policore.

Në dhjetor 2006 avokati i kërkuarit bëri apel kushtetues pranë Gjykatës Kushtetuese të Çekisë kundër urdhrin të gjykatës së rrethit për vëzhgim, duke u bazuar tek e drejta për konfidencialitetin e komunikimeve me klientin e tij, dhe duke kontestuar dhënien e regjistrimeve të komunikimeve të tij telefonike sipas Nenit 13 të Kartës për të Drejtat dhe Liritë Themelore në Çeki. Në shtator 2007, Gjykata Kushtetuese e prishi urdhrin për monitorimin e komunikimeve telefonike, dhe urdhëroi policinë që t’i shkatërronte të gjitha provat e regjistruara, e njëkohësisht deklaroi se nuk kishte pasur dyshime të arsyeshme për ndonjë krim.

## 2. Vendimi i Gjykatës

Bazuar në nenin 6 (e drejta për proces të rregullt ligjor) dhe të nenin 1 të Protokollit 1 (mbrojtja e pronës), kërkuari pretendoi se ai nuk kishte pasur proces të drejtë dhe rrjedhimisht atij i ishin shkëlur të drejtat e e pronës. Ndërkohë që kërkuari vdiq në vitin 2009, djali i tij, z. Carlos Kinský, informoi Gjykatën se ai donte ta vazhdonte



padinë e babait të tij. Gjykata e pranoi këtë kërkesë meqenëse ai ishte trashëgimtari i vetëm i kërkuarit dhe kishte interes legjitim në ndjekjen e kërkesës fillestare në vend të kërkuarit.

#### Neni 6 § 1

Gjykata e ndau vlerësimin e saj në dy pjesë. Së pari, ajo mori në shqyrtim efektin e deklaratave negative të politikanëve rreth kërkuarit dhe mbikqyrjen e çështjes së tij nga Ministria e Drejtësisë. Më pas, ajo mori në shqyrtim efektin e hetimeve penale rreth kërkuarit.

Në lidhje me deklaratat negative të politikanëve për kërkuarin dhe mbikqyrjen e çështjes së tij nga Ministria e Drejtësisë, Gjykata nisi të shqyrtonte nëse ishte komprometuar paanshmëria e gjyqtarëve siç pretendohet nga kërkuari. Gjykata mund ta kuptonte se media dhe politikanët ishin të interesuar në çështjen e kthimit të pronave të konfiskuara para vitit 1990 me anë të masave të përgjithshme për përcaktimin e pronësisë, pasi suksesi i atyre mund të kishte rezultuar në kthimin e pronave me vlerë miliarda euro jo vetëm për kërkuarin por edhe për shumë njerëz të tjerë. Prandaj, Gjykata ra dakord me qeverinë çeke se interesi i politikanëve në këtë çështje dhe takimet e tyre për të gjetur zgjidhje ishin legjitime dhe nuk përbënin problem sa i përket Konventës.

Megjithatë, politikanë të ndryshëm, përfshirë Ministrin e Kulturës, kishin shprehur qëndrimin e tyre se vendimet e gjykatave që mbështesin këto lloj pretendimesh ishin të gabuara dhe të padëshirueshme. Akoma dhe më shqetësues ishte fakti që një politikan i rangut të lartë e kishte lidhur kërkuarin me nazistët dhe kishte deklaruar se ai do të bënte gjithçka që mundej për ta parandaluar atë dhe të tjerët në pozitën e tij nga fitimi i kauzave të tyre. Të dyja këto deklarata i drejttoheshin direkt gjyqtarëve që do të vendosnin për çështjet. Ndërkohë që Gjykata nuk e pa të arsyeshme të spekulonte se çfarë efekti mund të kenë pasur ndërhyrje të tilla në rrjedhën e proceseve, Gjykata qe dakord me një deklaratë të Gjykatës Kushtetuese ku ndërhyrjet e politikanëve përshkruheshin si ‘të papranueshme në një sistem të bazuar në shtetin e së drejtës’. Gjykata gjithashtu theksoi se deklaratat ishin bërë përpara vendimit të shkallës së parë dhe se, pas vitit 2003, asnjë prej padive të kërkuarit nuk kishte dalë me sukses. Në ato rrethana, shqetësimet e tij lidhur me pavarësinë dhe paanshmërinë e gjykatave nuk kishin qenë të paarsyeshme.

Gjykata theksoi se Ministria e Drejtësisë kishte të drejtën, sipas ligjeve vendase, që të mblidhte informacione për të monitoruar dhe vlerësuar ushtrimin e proceseve gjyqësore me qëllim që të sigurohej se po respektoheshin standardet e dinjitetit të

sjelljes së gjyqtarëve dhe etikës. Gjithashtu, Ministria kishte të drejtën që të niste procedura disiplinore kundër gjyqtarëve. Në vazhden e çështjes së vetë kërkuetit, Ministria e Drejtësisë kishte kërkuar dhe kishte marrë rregullisht informacione në lidhje me zhvillimin e procedurave nga gjykatat rajonale, përfshirë emrat e gjyqtarëve të përfshirë në çështje. Ndërsa mbajti shënim pohimin e Qeverisë se Ministria kishte marrë vetëm informacione të përgjithshme administrative dhe se nuk kishte asnjë tregues për abuzim apo presion mbi gjyqtarët e përfshirë, Gjykata theksoi se dukja e paanshmërisë ishte në rrezik. Pa dyshim që aktivitetet i kishin bërë gjyqtarët të ndërgjegjshëm se hapat e tyre po monitoroheshin nga afër prej politikanëve të cilët kishin pushtet mbi karrierat e tyre e njëkohësisht kishin deklaruar se do të bënin gjithçka të mundur për të arritur një rezultat të caktuar në çështje. Në këto kushte, Gjykata arsyetoi se dyshimet rreth paanshmërisë së gjyqtarëve të çështjes nuk mund të ishin thjesht subjektive dhe të pajustificuara.

Për sa i përket efektit të hetimeve penale kundër kërkuetit, Gjykata konstatoi se mënyra sesi ishin nisur dhe zhvilluar proceset ishte haptazi abuzive. Ndërkohë që, sipas ligjit çek, një kërkuet në një padi civile nuk është i detyruar t'i japë gjykatës të gjitha provat që ka në posedim, policia kishte marrë informacione në atë drejtim dhe kështu kishte qenë në gjendje të parashikonte saktë kursin e veprimit të kërkuetit, përfshirë edhe opsionet e mundshme të argumentimit ligjor dhe mocionet procedurale, me një shkallë saktësie e cila do të kishte qenë e paarritshme po të kishte qenë ndryshe. Çdo përpjekje për të kriminalizuar ushtrimin e të drejtave të palës ndërgjyqëse në një mosmarrëveshje civile, sidomos në procedurat ku pala e paditur është Shteti, është në kundërshtim me të drejtën për proces të rregullt ligjor.

Duke pasur parasysh këto konsiderata, Gjykata arriti në përfundimin se, marrë në tërësi, procedurat nuk i kishin plotësuar kërkesat për proces të rregullt ligjor, dhe se kishte pasur shkelje të nenit 6 të Konventës.

#### Neni 1 i Protokollit 1

Kërkueti u ankua se ligji vendas ishte zbatuar gabim dhe se si rezultat ai nuk kishte qenë në gjendje të rimernte pronat, megjithëse ai ishte pronari i ligjshëm. Përderi sa ai nuk e ngriti këtë çështje para Gjykatës Kushtetuese, Gjykata e refuzoi atë për mos-shërim të mjeteve ligjore në vend.

#### Neni 14

Për sa i përket ankesës së kërkuetit se ai ishte diskriminuar në bazë të origjinës së tij për shkak se Gjykata Kushtetuese e kishte hedhur poshtë ankesën e tij thjesht

duke iu referuar Opinionit të saj në çështjen nr. Pl. ÚS-St. 21/05, Gjykata pranoi se nuk kishte pamje arbitrareteti, paarsyeshmërie të shprehur apo trajtimi të ndryshëm të kërkuesit. Gjykata Kushtetuese e kishte zbatuar në mënyrë konsistente Opinionin në të gjitha rastet që ngrenë të njëjtat çështje si ato të kërkuesit. Për këtë arsye, kjo pjesë e kërkesës u refuzua nga Gjykata.

#### Neni 41

Gjykata vendosi që Çekia t'i paguajë kërkuesit 10,000 euro në lidhje me dëme jomateriale dhe 3,830 euro për kostot dhe shpenzimet e procesit.

*Kur një gjyqtar ka kryesuar miratimin e një ligji, parimi i paanshmërisë sipas nenit 6 me gjasë e përjashton atë gjyqtar nga dëgjimi i çështjeve për mosmarrëveshje lidhur me faktin nëse ai ligj duhet të ndryshohet*

## VENDIMI NË ÇËSHTJEN **McGONNELL k. MBRETËRISË SË BASHKUAR**

---

(Kërkesa nr. 28488/95)

**8 shkurt 2000**

### **1. Faktet kryesore**

Në vitin 1982 Richard McGonnell, shtetas britanik i lindur në vitin 1955, bleu Vreshtën Calais në St Martin, Guernsey. Pasi nuk arriti të merrte lejen e planifikimit të zonës për të ndërtuar rezidenca në tokën e tij, në vitin 1986 ose 1987 ai filloi të jetonte në një kasolle ku paketoheshin lulet, duke e shfrytëzuar atë si vendbanim.

Në vitin 1988 kërkuesi u paraqit në një seancë informuese rreth planit të tokës ku, *inter alia*, u diskutua ndarja e zonave në tokën e kërkuesit. Në vitin 1990, Zv/Përmbartuesi për Guernsey, z. Graham Dorey, miratoi Planin Zhvillimor në të cilin toka e kërkuesit u klasifikua si tokë e rezervuar për qëllime bujqësore e jo banimi. Një kërkesë e mëtejshme për leje planifikimi nga kërkuesi në mënyrë që ta konvertonte kasollen ku jetonte në vendbanim u refuzua në vitin 1991.

Në vitin 1992, kërkuesi u shpall fajtor për veprën e ndërrimit të shfrytëzimit të kasolles si vendbanim pa leje, dhe në vitin 1993 Komisioni Zhvillimor i Ishullit (IDC) bëri kërkesë pranë Gjykatës së Thjeshtë lokale që të lëshohej një leje për ta trajtuar shkëljen nga kërkuesi të ligjit për planifikimin e tokës dhe për ta kthyer kasollen në përdorim bujqësor. Kjo kërkesë u pranua por vetëm pasi z. Graham Dorey, si Zv/Përmbartues, kishte deklaruar se ai nuk donte ta dëgjonte personalisht këtë çështje për shkak se ai ishte marrë me kërkuesin gjatë finalizimit të Planit Zhvillimor.

Kërkuesit iu refuzua një tjetër kërkesë për ndryshimin e përdorimit të kasolles, dhe më 6 qershor 1995 apeli i tij para Gjykatës Mbretërore u rrëzua duke iu referuar kriterëve të Planit Zhvillimor. Çështja u kryesua nga, tani, Sir Graham Dorey, ish-përmbartuesi i dikurshëm. Gjatë seancës para Gjykatës Mbretërore, Sir Graham e përmbloodhi çështjen para Juratëve (anëtarë të jurisë së Guernsey) dhe i udhëzoi ata se barra e provës binte mbi IDC-në që të tregonte se vendimi i saj ishte i arsyeshëm. Apeli i kërkuesit u rrëzua njëzëri megjithëse për vendimin e Gjykatës Mbretërore nuk u dhanë arsye.

## 2. Vendimi i Gjykatës

Kërkuesi u ankua sipas nenit 6 (e drejta për proces të drejtë) se lidhjet e afërta mes funksioneve gjyqësore të Përmbarusit dhe roleve ligjvënëse dhe ekzekutive të tij nënkuptonin se ai nuk mund të përmbushte kriteret e pavarësisë dhe paanshmërisë të kërkuara nga neni 6 gjatë kryesimit të çështjeve gjyqësore.

### Neni 6

Para se të shqyrtonte faktet e çështjes, Gjykata përshkroi postin e Përmbarusit në Kushtetutën dhe në të drejtën e Guernsey. Në kohët moderne, Përmbarusi i Guernsey vepronte si gjyqtar profesional në Gjykatën Mbretërore dhe si Kryetar i Gjykatës së Apelit të Guernsey. Përmbarusi gjithashtu mbante edhe role jo-gjyqësore, ku vlen të shënohet roli i tij si Kryetar i Bordit të Emërimeve, i Këshillit të Emergjencës, i Komisionit Legjislativ dhe i Komisionit për Rregullat e Procedurës.

Gjykata theksoi se nuk kishte sugjerime në çështjen e kërkuesit që Përmbarusi kishte qenë subjektivisht paragjykses ose i njëanshëm kur kishte dëgjuar apelin e kërkuesit për planin e tokës në vitin 1995, dhe as nuk u pretendua se pjesëmarrja e Përmbarusit si Zv/Përmbarus në autorizimin e planit zhvillimor kishte sjellë mungesë të paanshmërisë. Prandaj, Gjykata e kufizoi shqyrtimin e saj tek pyetja nëse Përmbarusi e kishte 'dukjen' e kërkuar të pavarësisë ose paanshmërinë 'objektive' të kërkuar.

Gjatë zbatimit të testit për këtë çështje, Gjykata nuk e pranoi premisën e argumenteve të Qeverisë që Përmbarusi thjesht mbante poste jo-gjyqësore dhe nuk ushtronte funksione jo-gjyqësore. Gjykata deklaroi se edhe një rol thjesht ceremonial duhet të klasifikohet si funksion, dhe se funksione të tilla mund të mos jenë në pajtueshmëri me kriteret e parimit të pavarësisë dhe paanshmërisë. Në lidhje me mosmarrëveshjen në fjalë, Përmbarusi ishte i përfshirë personalisht dhe drejtpërdrejt gjatë tërë kohës në çështjen e kërkuesit, për faktin se ai kishte kryesuar miratimin e Planit Zhvillimor të vitin 1990, dhe më pas ishte bërë Kryetar i Gjykatës Mbretërore e cila kishte vendosur mbi apelin e kërkuesit për planin e tokës në qershor 1995. Gjykata deklaroi se çdo përfshirje direkte në miratimin e ligjeve ose të rregullave ekzekutive me gjasë është e mjaftueshme për të hedhur dyshime mbi paanshmërinë gjyqësore të një personi që më pas është ftuar për të vendosur mbi një mosmarrëveshje rreth faktit nëse një ligj ose disa rregulla të caktuara duhet të ndryshohen. Më tej, ishte e qartë se, meqenëse Përmbarusi kishte të drejtë vote në komisionet jo-gjyqësore ku ai ishte kryetar, postet e tij në këto komisione ishin më shumë se ceremoniale.

Gjykata gjeti se thjesht fakti që Përmbaruesi kishte kryesuar miratimin e Planit Zhvillimor ishte i mjaftueshëm për të hedhur dyshime mbi paanshmërinë e tij gjatë vendosjes për apelin e kërkuarit në lidhje me atë plan. Prandaj, kjo përbënte shkelje të nenit 6 § 1. Meqenëse shkelja u konstatua, Gjykata e konsideroi të panevojshme të merrte në shqyrtim aspektet e tjera të ankesës.

#### Neni 41

Gjykata konsideroi se gjetja e një shkeljeje ishte e mjaftueshme si shpërblim i drejtë, dhe i caktoi kërkuarit 20,913.90 paund në lidhje me kostot.

*Konfiskimi, shpronësimi dhe shembja e ndërtesës së kërkuësve në kundërshtim me një urdhër të përkohshëm të marrë nga gjykatat vendase shkeli Konventën*

## VENDIMI NË ÇËSHTJEN SHARRXHI DHE TË TJERË K. SHQIPËRISË

---

(Kërkesa nr. 10613/16)

**11 janar 2018**

### **1. Faktet kryesore**

Kërkuësit ishin 19 pronarë të apartamenteve në Rezidencën Jon ('rezidenca') të lindur mes viteve 1939 dhe 1986. Kërkuësi i parë dhe i dytë ishin bërë pronarë apartamenti dhe dyqani si pronarët origjinalë të parcelës së tokës, ndërsa kërkuësit e tjerë ishin bërë pronarë të apartamenteve dhe dyqaneve përmes marrëveshjeve të shitblerjes.

Rezidenca ishte ndërtuar në vijim të lejes nga autoritetet lokale e lëshuar në gusht 2010. Pas përfundimit të ndërtimit të godinës, shumica e apartamenteve dhe dyqaneve ishin mobiluar dhe shumë prej kërkuësve kishin hyrë për të banuar.

Megjithatë, pa njoftim paraprak, inspektorati ndërtimor urbanistik dhe policia e konfiskuan rezidencën më 3 nëntor 2013 duke e rrethuar me shiritin e verdhë të policisë me shkrimin "skenë krimi - nuk lejohet kalimi" për shkak të problemeve rreth ligjshmërisë së lejes së ndërtimit. Edhe pse kërkuësit u lejuan të hynin në apartamentet e tyre pasi paraqitën certifikatën e pronësisë dhe letërnjoftimin, ata fillimisht u ndaluan të hynin në banesat e tyre apo të merrnin gjërat e tyre.

Kërkuësit ngritën padi në gjykatat administrative më 7 nëntor 2013, pas së cilës u lëshua një urdhër i përkohshëm i cili u kërkonte autoriteteve të mos ndërmerren veprime që mund të shkelnin të drejtat pronësore të kërkuësve. Autoritetet e shembën rezidencën mes 4 dhjetorit dhe 8 dhjetorit 2013, pavarësisht nga karakteri detyrues i urdhrit të përkohshëm.

Në janar 2014, gjykata administrative mori një vendim mbi themelet e çështjes, i cili gjeti se konfiskimi nga autoritetet i rezidencës më 3 nëntor 2013 kishte qenë i paligjshëm për shkak të mos-respektimit të urdhrit të përkohshëm.

Në ndërkohë, Qeveria i shpronësoi pronat e kërkuësve për interes publik dhe urdhëroi pagesën e kompensimit për ta. Megjithatë, kërkuësit e kontestuan shumën

e kompensimit për shkak se procedura e shpronësimit ishte zhvilluar në shkelje flagrante të ligjit vendas. Ato procedura ishin ende në pritje para Gjykatës Supreme në kohën e vendimit të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, por më 15 janar 2015 e kishin pezulluar zbatimin e vendimit të gjykatës më të ulët për t'u caktuar kërkesve 1,580,712,321 lek (afro 11,639,800 euro) si kompensim.

## 2. Vendimi i Gjykatës

Kërkuesit u ankuan që konfiskimi, shpronësimi dhe shembja e pronave të tyre në kundërshtim me urdhrin e përkohshëm të gjykatës administrative kishte shkelur të drejtat e tyre sipas neneve 6 § 1, 8, dhe nenit 1 të Protokollit Nr. 1 të Konventës. Ata më tej u ankuan që nuk kishin pasur zgjidhje efektive për këto shkelje në kundërshtim me nenin 13.

Kërkuesit po ashtu u ankuan që konfiskimi dhe mohimi i qasjes në shtëpitë e tyre kishte përbërë shkelje të prezumimit të pafajësisë sipas nenit 6 § 2, ku ata u ankuan edhe për shkelje të së drejtës së tyre mbi reputacionin sipas nenit 8. Në fund, kërkuesit pretenduan se ata ishin diskriminuar për shkak se ndërtesa e tyre e ndërtuar ligjërisht ishte shembur ndërkohë që ndërtesa të tjera të ndërtuara ligjalisht në shëtitoren Lungomare nuk ishin shembur.

### Neni 6 § 1 i marrë vetëm dhe në lidhje me nenin 13

Qeveria diskutoi që kërkuesit nuk mund të konsideroheshin viktimat meqenëse gjykatat vendase kishin marrë vendime të arsyetuara në favor të tyre. Ndërkohë që gjykatat vendase kishin gjetur se autoritetet në fakt e kishin shpërfillur urdhrin e përkohshëm, ato nuk u caktuan kërkesve kompensim. Sidoqoftë, vendimet kishin mbetur të paekzekutuara dhe kishin dështuar në parandalimin e shembjes së ndërtesës. Rrjedhimisht, autoritetet kombëtare nuk i kishin dhënë zgjidhje ankesës së kërkuesve, dhe këto të fundit ende mund të pretendonin të ishin viktimat të mos-zbatimit të urdhrin të përkohshëm. Prandaj ankesat e kërkuesve u deklaruan të pranueshme.

Gjykata nisi duke shqyrtuar nëse kishte pasur shkelje të nenit 6 § 1 në lidhje me nenin 13. Ajo konsideroi se një kërkesë për dëmshpërblim sipas neneve përkatëse nuk u ofronte kërkuesve zgjidhje efektive në rastin konkret, meqenëse ata ishin ankuar jo për mungesë kompensimi por për mos-zbatimin e masës së përkohshme, si pasojë e së cilës ata nuk patën mundësi për shqyrtimin e duhur të themeleve të çështjes së tyre. Rrjedhimisht, kishte pasur shkelje të nenit 13 në lidhje me nenin 6 § 1, dhe kundërshtimi i Qeverisë në lidhje me mos-shterimin e zgjidhjeve u rrëzua.



Ekzekutimi i një vendimi të gjykatës, përfshirë vendimin që rezultoi nga procedurat e përkohshme, është pjesë përbërëse e “gjqyt” për qëllimet e nenit 6 sepse e drejta për qasje në gjykatë do të bëhej iluzive po qe se një urdhër i ndërmjetëm në pritje të vendimit përfundimtar do të bëhej jofunksional në dëm të njëjës palë. Ky parim ka domethënie edhe më të madhe në kontekstin e procedurave administrative kur rezultati është vendimtar për të drejtat civile të palës ndërgjyqjës.

Sipas arsyeve të dhëna nga Gjykata e Rrethit dhe një vendimi vijues të Gjykatës Administrative të Apelit, urdhri i përkohshëm në fjalë kishte pasur për qëllim të parandalonte shembjen e ndërtesës së kërkuesve. Urdhrat e përkohshëm ishin direkt të zbatueshëm dhe detyrues për të gjitha institucionet e shtetit, sipas nenit 510 të Kodit të Procedurës Civile. Urdhri i përkohshëm në rastin konkret u drejtohej të gjitha organeve zyrtare dhe duhet të mbetej në fuqi deri sa të merrej një vendim në lidhje me themelet e çështjes. Megjithatë, para se të mund të bëhej një gjë e tillë, Këshilli i Ministrave bëri shpronësimin e ndërtesës së kërkuesve në interes publik dhe e shembi atë, duke i bërë procedurat kryesore të panevojshme. Gjykata theksoi që gjykatat vendase në të gjitha shkallët kishin dështuar të vepronin në përputhje me urdhrin e përkohshëm.

Prandaj, autoritetet kombëtare nuk kishin vepruar në përputhje me urdhrin e përkohshëm të 7 nëntorit 2013 që mbronte të drejtat pronësore të kërkuesve. Rrjedhimisht, kishte pasur shkelje të nenit 6 § 1.

#### Neni 8 i marrë vetëm dhe në lidhje me nenin 13

Kërkesa që kërkuesit të paraqisnin prova të vendbanimit në rezidencë në mënyrë që të hynin në ndërtesë kishte ndërhyrë tek e drejta e tyre për respekt ndaj shtëpisë së tyre, dhe për të nuk kishte pasur bazë ligjore. Prandaj, kishte pasur shkelje të nenit 8 dhe të nenit 13 në lidhje me nenin 8, sepse, megjithëse gjykatat vendase kishin gjetur që të drejtat e kërkuesve ishin shkelur, atyre nuk u ishte caktuar kompensim. Nuk ishte e nevojshme të shqyrtohej kjo ankesë në lidhje me shpronësimin dhe shembjen e ndërtesës.

#### Neni 1 i Protokollit 1 i marrë vetëm dhe në lidhje me nenin 13

Kishte pasur ndërhyrje tek të drejtat e kërkuesve sipas nenit 1 të Protokollit 1 në lidhje me faktin që atyre u ishte refuzuar qasja në pronat e tyre për një periudhë një-mujore, prej 3 nëntorit deri më 4 dhjetor 2013, për çka nuk ishte dhënë justifikim ligjor. Kjo ndërhyrje ishte e paligjshme sipas të drejtës vendase sidoqoftë, sepse autoritetet kishin shpërfillur urdhrin e përkohshëm të dhënë nga gjykatat e vendit. Rrjedhimisht, kishte pasur shkelje të nenit 1 të Protokollit 1 dhe të nenit 13 në lidhje

me nenin 1 të Protokollit 1 meqenëse kërkuesve nuk u ishte caktuar kompensim.

Për sa i përket shpronësimit dhe shembjes së ndërtesës, Gjykata konsideroi që kërkuesit kishin statusin e viktimës meqenëse ata nuk kishin marrë kompensim të përshtatshëm për shpronësim siç kërkohet me ligjin vendas. Për më tepër, duke rrezuar argumentin e Qeverisë rreth mos-shterimit të zgjidhjeve në këtë aspekt, Gjykata konsideroi se nuk mund të ishte pritur që kërkuesit ta kundërshtonin urdhrin për shembje meqenëse ata tashmë e kishin shfrytëzuar zgjidhjen që ishte efektive dhe e mjaftueshme, pra urdhrin e përkohshëm. Rrjedhimisht, kishte pasur shkelje të nenit 13 në lidhje me nenin 1 të Protokollit 1 për faktin se kërkuesit nuk kishin pasur mundësi të kundërshtonin shembjen ose të kërkonin një urdhër të ri të përkohshëm.

Gjatë shqyrtimit nëse shpronësimi dhe shembja kishin shkelur të drejtat e kërkuesve sipas nenit 1 të Protokollit 1, Gjykata gjeti që, edhe pse kërkuesve u ishte dhënë një urdhër i përkohshëm, ata nuk mund t'i gëzonin pronat e tyre. Më tej, shembja e rezidencës ua kishte mohuar atyre çdo mundësi në të ardhmen për gëzimin e pasurisë së tyre dhe kështu i kishte privuar ata nga e drejta për të gëzuar pronën e tyre brenda kuptimit të kësaj dispozite.

Sa i përket faktit nëse kjo ndërhyrje ishte e justifikueshme, gjykatat vendase kishin gjetur që shembja ishte e paligjshme për shkak të mos-veprimit të autoriteteve në përputhje me urdhrin e përkohshëm, dhe Gjykata konsideroi që shpronësimi dhe shembja e rezidencës kishin ngërthyer pasoja mjaftueshëm të rënda për kërkuesit. Duke marrë parasysh të gjitha rrethanat, ndërhyrja ishte në papajtueshmëri me të drejtën e kërkuesve për gëzimin paqësor të pasurisë së tyre. Rrjedhimisht, kishte pasur shkelje të nenit 1 të Protokollit 1 për shkak të shpronësimit dhe shembjes së pronave të kërkuesve.

#### Shkelje të tjera

Gjykata konsideroi se ankesat e kërkuesve në lidhje me prezumimin e pafajësisë sipas nenit 6 § 2 dhe të drejtën e reputacionit sipas nenit 8 ishin dukshëm të pabazuara, dhe se ankesa e tyre sipas nenit 14 në lidhje me nenet 6 § 1 dhe 8 nuk ishte ngritur në shkallë vendi, kështu që të gjitha këto u deklaruan të papranueshme.

#### Neni 41

Gjykata u caktoi kërkuesve 13,098,600 euro së bashku në lidhje me dëme materiale, kërkuesit të parë dhe të dytë 7,800 euro secilit, dhe 17 kërkuesve të tjerë 13,000 euro secili në lidhje me dëme jomateriale. Ajo u caktoi kërkuesve 112,100 euro në total për kosto dhe shpenzime.

*Anulimi nga Shteti, përmes një mase administrative, i një kompensimi të arbitrazhit që Shteti u detyrohej kërkuësve, gjatë kohës që procedurat e arbitrazhit vazhdonin, ka shkelur Konventën*

## VENDIMI NË ÇËSHTJEN E RAFINERIVE GREKE STRAN DHE STRATIS ANDREADIS k. GREQISË

---

(Kërkesa nr. 13427/87)  
**9 dhjetor 1994**

### 1. Faktet kryesore

Kërkuësit ishin një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, Rafineritë Greke Stran, e cila ishte e regjistruar në Athinë, dhe aksioneri i vetëm i saj, z. Stratis Andreadis. Kërkuësi i dytë vdiq në vitin 1989, pasi e kishte dorëzuar kërkesën e tij. Djali dhe trashëgimtari i tij, z. Pedro Andreadis, e ndoqi kërkesën.

Kompania kërkuëse kishte lidhur një kontratë me Shtetin grek në korrik 1972, në një kohë kur Shteti ndodhej nën regjim ushtarak. Kompania kërkuëse kishte marrë përsipër të ndërtonte një rafineri naftë në rajonin Megara pas blerjes nga Shteti të një parcele toke të përshtatshme për një projekt të tillë. Regjimi ushtarak eventualisht vendosi që të mos e vazhdonte projektin në nëntor 1973. Kur u rivendos demokracia në vitin 1974, Qeveria vendosi ta përfundonte kontratën për arsye se ishte kontratë preferenciale dhe paragjykuëse ndaj ekonomisë kombëtare. Kontrata u përfundua në tetor 1977, dhe kërkuësit nuk e kontestuan këtë vendim.

Megjithatë, kompania kërkuëse depozitoi një padi për kompensim kundër Shtetit pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Athinës për shenzimet që kishte pasur në lidhje me kontratën. Shteti e kontestoi juridiksionin e gjykatës për shkak se mosmarrëveshja duhet të ishte trajtuar në arbitrazh, dhe bëri kërkesë për arbitrazh në qershor 1980. Më 27 shkurt 1984, procedurat e arbitrazhit rezultuan me kompensim arbitrazhi në favor të kompanisë kërkuëse në shumën 116,273,442 dhrahmi, 16,054,165 dollarë amerikanë dhe 614,627 franga franceze. Shteti apeloj pa sukses kundër kompensimit të arbitrazhit pranë Gjykatës së Shkallës së Parë dhe Gjykatës së Apelit.

Shteti apeloj pranë Gjykatës së Kasacionit në dhjetor 1986. Megjithatë, seanca dëgjimore u shty me kërkesë të Shtetit më 4 maj 1987 për shkak të një projektligji i cili ishte relevant për çështjen para Parlamentit. Gjyqtari raportues i Gjykatës së Kasacionit ua kishte dërguar palëve opinionin e tij, duke rekomanduar që gjykata ta rrëzonte apelin e Shtetit, para kësaj kërkesë.

Parlamenti miratoi Ligjin Nr. 1701/1987 (Ligji) më 22 maj 1987, i cili hyri në fuqi më 25 maj të të njëjtit vit. Neni 12 i Ligjit hiqte juridiksionin e gjykatës vendase për të shqyrtuar kushtet, formulimet dhe klauzolat (përfshirë klauzolat e arbitrazhit) e kontratave të përfunduara nga Shteti të cilat ishin lidhur gjatë regjimit ushtarak të Shtetit. Gjykata e Kasacionit refuzoi ta zbatonte Ligjin për arsye pakushtetutshmërie dhe, në përputhje me ligjin vendas, e riktheu çështjen në Divizionin e Parë i cili, në prill 1990, e deklaroi kompensimin e arbitrazhit të pavlefshëm (nul).

## 2. Vendimi i Gjykatës

Kërkuesit u ankuan që miratimi i nenit 12 të Ligjit dhe zbatimi i tij në çështjen e tyre nga Gjykata e Kasacionit i kishte privuar ata nga e drejta për gjyq të drejtë sipas nenit 6 § 1 të Konventës. Ata gjithashtu u ankuan që gjatësia dhe vlefshmëria e procedurave për caktimin e kompensimit në arbitrazhin e datës 27 shkurt 1984 e kishte tejkaluar “kohën e arsyeshme” brenda kuptimit të së njëjtës dispozitë.

Kërkuesit më tej u ankuan që miratimi i Ligjit kishte efektin e privimit të të drejtave të tyre në lidhje me borxhin që u detyrohej atyre, gjë që ishte njohur nga Gjykata e Shkallës së Parë në Athinë dhe kompensimin e arbitrazhit, sipas nenit 1 të Protokollit 1.

### Neni 6 § 1

E drejta e kërkuesve përtë marrë kompensimin e arbitrazhit si rezultat i procedurave të arbitrazhit ishte e drejtë “civile” brenda kuptimit të nenit 6, pavarësisht nga marrëdhënia kontraktuale e palëve sipas ligjeve greke.

Gjykata fillimisht mori në konsideratë pretendimin e kërkuesve që ata ishin privuar nga gjyqi i drejtë dhe nga e drejta e tyre për qasje në gjykatë si pasojë e heqjes nga Shteti të juridiksionit të gjykatave me anë të dekretimit të nenit 12 të Ligjit. Ajo shënoi se dekretimi i kësaj dispozite pa diskutim që përbënte kthesë të madhe në procedurat para gjykatave të zakonshme dhe gjykatave të arbitrazhit, të cilat deri në atë moment kishin qenë në favor të kërkuesve.

Qeveria debatoi që ishte e nevojshme të dekretohej neni 12 në mënyrë që të ofrohej një interpretim autoritativ i Ligjit pas vitesh të tëra debatesh të shtuara të natyrës akademike, juridike dhe publike rreth validitetit të klauzolës së arbitrazhit. Ndërkohë që Gjykata e njohu qëllimin e Qeverisë për të zhdukur masat e mbetura të regjimit ushtarak me anë të legjislationit demokratik, ajo përsëriti rëndësinë e garancive të gjyqit të drejtë, përfshirë barazinë e armëve; gjë të cilën Greqia ishte

zotuar ta respektonte pas rianëtarësimit në Këshillin e Evropës më 28 nëntor 1974. Prandaj, koha dhe mënyra e miratimit të nenit 12 të Ligjit duhet të shqyrtohej me imtësi.

Ishte merëndësi që Shteti kishte kërkuar shtyrjen e çështjes mbi bazën e projektligjit pasi që palët kishin marrë opinionin e gjyqtarit raportues ku rekomandohej që Gjykata e Kasacionit të rrëzonte apelin e Shtetit. Megjithëse neni 12 i Ligjit nuk e përmendte kompaninë kërkuese me emër, ai realisht synonte kompaninë kërkuese. Kështu, ishte fakt i pashmangshëm që ndërhyrja e legjislatcionit në rastin konkret kishte ndodhur gjatë kohës që procedurat gjyqësore, ku Shteti ishte palë, vazhdonin.

Nuk kishte dyshim që dukja e drejtësisë ishte ruajtur në çështjen në fjalë; kërkuesit mund të kishin kërkuar shtyrje për të përgatitur argumentet e tyre, dhe paragrafi 1 i nenit 12 lejonte shqyrtimin gjyqësor të pavlefshmërisë (nulitetit) së kompensimit të arbitrazhit. Megjithatë, si parimi i sundimit të ligjit ashtu edhe nocioni i gjyqit të drejtë përjashtojnë çdo ndërhyrje nga legjislatura që ka për qëllim të ndikojë në përcaktimin gjyqësor të një mosmarrëveshjeje. Teksti i paragrafëve 1 dhe 2 të nenit 12, marrë së bashku, efektivisht përjashtonte çdo shqyrtim domethënës të çështjes nga Gjykata e Kasacionit, ku si pasojë vendimi vijues i Divizionit të Dytë bëhej i paevitueshëm. Prandaj, Shteti kishte ndërhyrë në mënyrë të atillë që ishte vendimtare për një rezultat të favorshëm për të [Shtetin]. Rrjedhimisht, kishte pasur shkelje të nenit 6 § 1.

Megjithatë, Gjykata konsideroi që nuk kishte pasur shkelje të nenit 6 § 1 në lidhje me ankesën e kërkuesve që çështja e tyre nuk ishte trajtuar brenda një “kohe të arsyeshme”. Të vetmet procedura të cilat ishin të hapura për kritika ishin ato para Gjykatës së Kasacionit, të cilat kishin zgjatur mbi tre vjet. Megjithatë, kjo periudhë justifikohet për shkak të kalimit të Ligjit përmes Parlamentit dhe detyrimit të Gjykatës së Kasacionit për ta referuar një çështje në gjykatë plenare kur ajo refuzon të zbatojë një ligj për shkak se ai është jokushtetues. Prandaj, nuk kishte pasur shkelje të nenit 6 § 1 në këtë aspekt.

### Neni 1 i Protokollit 1

Kompensimi i arbitrazhit përbënte posedim brenda kuptimit të kësaj dispozite, meqenëse ai ishte përfundimtar, detyrues dhe i zbatueshëm sipas ligjeve greke. Më tej, pamundësia e kërkuesve për ta realizuar këtë kompensim arbitrazhi përbënte ndërhyrje tek e drejta e tyre e pronësisë. Gjatë shqyrtimit nëse kjo ndërhyrje ishte e justifikuar, Gjykata njohu nevojshmërinë e Shtetit demokratik të Greqisë që t’u jepte fund kontratave, si ajo që ishte lidhur me kërkuesit, të cilat ishin paragjyquese

ndaj interesave të tij ekonomike; pra, kontrata preferenciale të lidhura me regjimin ushtarak. Megjithatë, për një veprim të tillë e drejta ndërkombëtare kërkonte pagimin e kompensimit. Duke marrë parasysh që përfundimi i njëanshëm i një kontrate nuk prekte klauzolat thelbësore të kontratës (siç janë klauzolat e arbitrazhit), lejimi i bërjes së një amendamenti autoritativ në një klauzolë të tillë, siç u veprua në rastin konkret, mundësonte që Shteti t'i shmangej juridiksionit në këtë mosmarrëveshje.

Prandaj, duke ndërhyrë në atë fazë të procedurave para Gjykatës së Kasacionit, Shteti kishte trazuar, në dëm të kërkuësve, ekuilibrin e kërkuar mes mbrojtjes së të drejtave pronësore të kërkuësve dhe interesit publik. Rrjedhimisht, kishte pasur shkelje të nenit 1 të Protokollit 1.

#### Neni 50 (tani neni 41)

Gjykata u caktoi kërkuësve 116,273,442 dhrahmi greke (afro 341,228.50 euro), \$16,054,165 dollarë amerikanë (afro 13,193,200 euro) dhe 614,627 franga franceze (afro 93,700 euro) për dëme materiale, dhe 125,000 paund (afro 138,222.5 euro) për kosto dhe shpenzime.

*Pushteti i një Ministri për të përmbysur vendimin përfundimtar të një Gjykate dhe për të penguar hyrjen e tij në fuqi ishte shkelje e nenit 6 § 1 sepse të drejtat civile dhe detyrimet e kërkuarit nuk u vendosën nga një gjykatë*

## VENDIMI NË ÇËSHTJEN VAN DE HURK k. HOLLANDËS

---

(Kërkesa nr. 16034/90)

**19 prill 1994**

### **1. Faktet kryesore**

Kërkuari, i cili kishte lindur në vitin 1945, ishte bujk që merrej me produkte bylmeti në provincën Noord-Brabant. Më 29 qershor 1984 ai bëri kërkesë për një sasi më të madhe qumështi pa tatim, kërkesë të cilën ia drejtoi Kryetarit të Zyrës së Rrethit të Bordit për Zbatimin e Masave Bujqësore në provincën Noord-Brabant. Ai deklaroi se kishte marrë përsipër detyrime për të investuar në një numër më të madh vendmbajtjesh për lopë bylmeti dhe për lopë të mbarsura duke nisur nga janari 1984.

Kërkesa e tij iu përcoll Drejtorit të Bujqësisë, ku u refuzua. Më pas kërkuari bëri ankesë pa sukses pranë Ministrit të Bujqësisë dhe Peshkatarisë.

Kërkuari bëri apel pranë Gjykatës për Apele Industriale. Ai kërkoi një masë të përkohshme me qëllim që, në pritje të vendimit përfundimtar të Gjykatës, ai të mos paguante tatimin shtesë për vitet 1984-85. Kryetari i Gjykatës i kërkoi Ministrit të prononcohej nëse ishte i gatshëm ta rishikonte vendimin e tij. Ministri mbajti qëndrimin fillestar që rritja e vendmbajtjeve të lopëve nuk e arrinte minimumin e kërkuar nga Urdhëresa e vitit 1984, dhe më tej shtoi se investimi i kërkuarit i referueshëm për atë rritje nuk e arrinte minimumin e kërkuar prej 100,000 gulden. Kërkuari argumentoi që Ministri ishte i ndaluar që ta shfrytëzonte këtë argument, i cili nuk ishte përdorur asnjëherë si arsye për të refuzuar pretendimin fillestar të kërkuarit dhe që, përndryshe, llogaritjet e Ministrit ishin të gabuara.

Më 7 korrik 1987, Kryetari i Gjykatës mori vendim për të refuzuar masën e përkohshme të kërkuar. Kryetari e pranoi argumentin alternativ të Ministrit në lidhje me investimin e kërkuarit dhe e refuzoi parashtrimin e kërkuarit që Ministri ishte i ndaluar që të mbështetej mbi atë bazë, duke deklaruar se seksioni 51 i Ligjit për Apelet Industriale i vitit 1954 (Akti) i lejonte atij që të plotësonte argumentet e tij ndërkohë që kërkuari jo vetëm që kishte pasur mundësi të mjaftueshme për t'iu përgjigjur deklaramëve të Ministrit por edhe e kishte bërë një gjë të tillë.

Kërkuesi e vazhdoi procedurën, dhe më 19 prill 1989 u mbajt një seancë dëgjimore publike gjatë së cilës kërkuesi sërish e kontestoi metodën e llogaritjes së Ministrit. Gjykata refuzoi ta konsideronte çmimin e dhënë nga kërkuesi në seancë dhe e pranoi metodën e llogaritjes së Ministrit. Rrjedhimisht, duke dalë në përfundimin e investimi i kërkuesit nuk e arrinte minimumin e kërkuar, Gjykata e refuzoi apelin e kërkuesit.

## 2. Vendimi i Gjykatës

Duke u mbështetur në nenin 6 § 1 të Konventës, kërkuesi argumentoi se çështja e tij nuk ishte vendosur nga një “gjykatë e pavarur”, meqenëse seksioni 74 i Aktit të vitit 1954 lejonte që Kurora (dekret i firmosur nga Monarku dhe Ministri) të vendoste që vendimet përfundimtarë të Gjykatës nuk duhet të zbatoheshin. Kërkuesi më tej pretendoi se procedura ishte e padrejtë sepse atij iu kërkua të paraqiste të gjitha argumentet dhe provat e tij që në fillim, dhe se disa prova të paraqitura prej tij nuk u pranuan nga Gjykata.

### Neni 6 § 1

Gjykata deklaroi që fuqia për të marrë një vendim detyrues i cili nuk mund të modifikohet nga një autoritet jo-gjyqësor në dëm të një pale individuale është i ngërthyer brenda nocionit të një “gjykatë”, siç konfirmohet nga fjala “vendosje”. Në lidhje me argumentin e kërkuesit që fuqia e Kurorës sipas seksionit 74 për të vendosur që vendimet e Gjykatës (së vendit) nuk duhet të zbatohen e dëmtonte pavarësinë e asaj gjykatë, Gjykata gjeti që nuk kishte tregues se vetë ekzistenca e fuqive të Kurorës sipas seksionit 74 kishte ndonjë ndikim mbi mënyrën se si Gjykata (e vendit) trajtonte dhe vendoste për çështjet që kishte përpara. Në mënyrë të veçantë, nuk mund t’i atribuohet ndonjë domethënie suksesit të ulët të apeleve kundër vendimeve të marra nga Gjykata (e vendit). Fakti nëse kriteret e nenit 6 ishin plotësuar nuk mund të vlerësohej vetëm duke iu referuar shanseve që kishte kërkuesi për t’ia dalë me sukses, sepse kjo dispozitë nuk garantonte ndonjë rezultat të caktuar.

Megjithatë, Gjykata, teksa e pranoi argumentin që seksioni 74 nuk i jepte Kurorës fuqinë për të përmbysur vendimet përfundimtare të Gjykatës (së vendit) sa i përket arsytimit të tyre, vuri në dukje se për një paditës individual me rëndësi janë pasojat e padisë. Gjykata nuk mund të shpërfillte faktin që asgjë nuk e pengonte Kurorën prej shfrytëzimit të fuqive që i ishin dhënë asaj sikur ta kishte konsideruar të nevojshëm ose të dëshirueshëm një kurs të tillë veprimi duke pasur parasysh atë që perceptohej si interesi i përgjithshëm. Rrjedhimisht, në kohën materiale seksioni 74 i Aktit të vitit 1954, i cili mbeti në fuqi deri më 1 janar 1994, i lejonte Ministrit pjesërisht ose



plotësisht që ta privonte një vendim përfundimtar të Gjykatës (së vendit) nga hyrja në fuqi në dëm të një pale individuale. Një prejtributeve themelore të “gjykatës” pra mungonte.

Gjykata deklaroi se një defekt i kësaj natyre, sidoqoftë, mund të ndreqet përmes vënies në dispozicion të një forme shqyrtimi vijues nga një organ gjyqësor që ofron të gjitha garancitë e kërkuara nga neni 6. Megjithatë, në lidhje me rigjykimin, Gjykata theksoi se seksioni 75 i Aktit të vitit 1954 nuk i lejonte Gjykatës (së vendit) që të distancohej nga vendimi i Kurorës sipas seksionit 74. Sa i përket ngritjes së padisë në gjykatat civile mbi bazat që Gjykata (e vendit) nuk mund të konsiderohej gjykatë e pavarur, gjykatat civile deklaruan se Gjykata (e vendit) plotësonte garanci të mjaftueshme të shqyrtimit gjyqësor. Rrjedhimisht, kishte shkelje të nenit 6 § 1 për faktin se të drejtat civile dhe detyrimet e kërkuarit nuk u “vendosën” nga një “gjykatë”.

Në lidhje me drejtësinë e procedurës, Gjykata deklaroi se kjo ankesë e anashkalonte faktin që seksioni 51 i Aktit të vitit 1954 e plotësonte kriterin e “barazisë së armëve” sepse u lejonte të dy palëve në procedurë para Gjykatës (së vendit) që “të modifikonin pretendimet e tyre ose mbrojtjen e tyre dhe bazat e dhëna për t’i mbështetur ato”. Megjithëse gjatë procedurës para Gjykatës (së vendit) Ministri i bazoi argumentet e tij mbi fakte të reja të cilat ndryshonin prej atyre mbi të cilat ai kishte mbështetur refuzimin e tij fillestar të kërkesës së kërkuarit, kërkuarit iu lejua të paraqiste një raport të hartuar nga llogaritari i tij si dhe kundërgjegjeve. Prandaj, kërkuari jo vetëm që pati mundësi të vërtetë për t’u përgjigjur por ai edhe e bëri një gjë të tillë. Prandaj, nuk u konstatua shkelje e parimit të “barazisë së armëve” e rrjedhimisht nuk pati shkelje të nenit 6.

Kërkuari më tej argumentoi se çështja e tij nuk ishte trajtuar drejt sepse Gjykata (e vendit) kishte refuzuar të merrte në konsideratë llogaritjet e tij. Gjykata deklaroi se efekti i nenit 6 ishte që ta vinte “gjykatën” nën detyrimin për të zhvilluar shqyrtimin e duhur të parashtrimeve, argumenteve dhe provave të paraqitura nga palët, pa paragjykim në vlerësimin nëse ato ishin relevante për vendimin e saj. Gjykata (e vendit) kishte zbatuar një metodë llogaritjeje të ndryshme nga ajo që donte kërkuari dhe prandaj kishte dalë në një përfundim i cili nuk ishte i favorshëm për të (kërkuarin). Nuk i takonte Gjykatës ta kritikonte këtë zgjedhje; si rregull i përgjithshëm, vlerësimi i fakteve është brenda fushëveprimit të gjykatave vendase, kështu që refuzimi i Gjykatës (së vendit) për të marrë në konsideratë shifrën e re të kërkuarit nuk përbëri shkelje të nenit 6.

Neni 50 (tani neni 41)

Gjykata e refuzoi pretendimin e kërkuarit për dëme materiale sepse nuk u bë e qartë se rezultati i çështjes do të kishte qenë ndryshe në mungesë të shkeljes së gjetur në lidhje me nenin 6 § 1. Kërkuarit iu caktua shuma 35,000 gulden holandeze plus TVSH, plus 6,336 franga franceze (afro 26,871 euro) në lidhje me kosto dhe shpenzime.

Ndërhyrja legjislative e Shtetit në procedurat e gjykatës, ku ai ishte palë, shkeli të drejtën e kërkuësve për proces të drejtë sipas nenit 6 § 1

## VENDIMI I DHOMËS SË MADHE NË ÇËSHTJEN ZIELINKSKI DHE PRADAL DHE GONZALEZ DHE TË TJERË K. FRANCËS

(Kërkesat nr. 24846/94, nr. 34165/96 deri në nr. 34173/96)

**28 tetor 1999**

### 1. Faktet kryesore

Kërkuësit ishin njëmbëdhjetë banorë të Francës të cilët punonin për organet e sigurimeve shoqërore në Alsas-Mosel. Kërkuësi i parë ishte z. Zielinski, i lindur në vitin 1954. Kërkuësi i dytë ishte z. Patrick Pradal, i lindur në vitin 1955. Kërkuësja e tretë ishte znj. Jeanine Gonzalez, e lindur në vitin 1956.

Më 28 mars 1953, përfaqësuesit e zyrave të sigurimeve shoqërore të rajonit të Strasburgut firmosën një marrëveshje kolektive me përfaqësuesit e sindikatave e cila përcaktonte një “shpërblim të veçantë për vështirësi pune” (*indemnitë de difficultés particulières* - “IDP”). Megjithatë, zbatimi i marrëveshjes shkaktoi vështirësi, dhe disa anëtarë të stafit në zyrat lokale të sigurimeve shoqërore ngritën padi. Kërkuësit iu drejtuan gjykatave industriale.

Gjykata industriale e Colmar lejoi kërkesat e kërkuësit të dytë dhe kërkuëses së tretë në korrik 1991. Zyra e Sigurimeve Shëndetësore e Colmar dhe Drejtori i Çështjeve Shëndetësore dhe Shoqërore apeluan. Ndërkohë, gjykata industriale e Metz lejoi kërkesat e kërkuësit të parë dhe të dytë, gjë që u konfirmua nga Gjykata e Apelit e Metz. Prefekti i Shtetit dhe Drejtori i Çështjeve Shëndetësore dhe Shoqërore apeluan në Gjykatën e Kasacionit.

Në të njëjtën kohë, Gjykata e Kasacionit mori një vendim mbi procedurat e ngritura nga anëtarë të tjerë të stafit që mbuloheshin nga e njëjta marrëveshje e vitit 1953, vendim i cili prishi vendimet e gjykatave më të ulëta. Gjykata e Apelit e Besançon, përgjegjëse për ridëgjimin e çështjeve sipas kornizave të vëna nga Gjykata e Kasacionit, vendosi një metodë pagese e cila ishte në favor të kërkuësve. Megjithatë, Parlamenti miratoi një amendament (seksioni 85) të Ligjit Nr. 94-43 të 18 janarit 1994 (Akti) i cili mbështeti, me efekt prapaveprues, shumën e IDP-së të parashtruar nga prefekti i Shtetit gjatë procedurave gjyqësore.

Më 13 janar 1994, Këshilli Kushtetues shpalli që seksioni 85 i Aktit ishte kushtetues. Rrjedhimisht, Gjykata e Kasacionit e prishi vendimin e Gjykatës së Apelit të Metz i cili

kishte qenë në favor të kërkuësve. Po ashtu, duke u mbështetur në seksionin 85 të Aktit, Gjykata e Apelit e Colmar konfirmoi apelin e prefektit të Shtetit.

## 2. Vendimi i Gjykatës

Kërkuësit u ankuan që ndërhyrja e Shtetit në çështje duke miratuar seksionin 85 të Aktit kishte shkelur të drejtën e tyre për gjyq të drejtë sipas nenit 6 § 1 të Konventës. Më tej, ata pretenduan që procedurat para Gjykatës së Apelit të Colmar nuk ishin zhvilluar brenda një kohe të arsyeshme në shkelje të asaj dispozite.

### Neni 6 §1

Gjatë vlerësimit të impaktit që kishte miratimi i seksionit 85 të Aktit mbi drejtësinë e procedurave të kërkuësve, Gjykata nuk mund të anashkalonte përmbajtjen e seksionit të marrë së bashku me metodën dhe kohën e miratimit të tij. Megjithëse seksioni 85 nuk kishte të bënte me vendimet e gjykatës të cilat kishin marrë formë të prerë mbi bazën e themeleve, ai kishte zgjidhur, me prapaveprim, një herë e mirë mosmarrëveshjet që ndodheshin para gjykatave të zakonshme në atë kohë. Më tej, amendamenti i seksionit 85 për të ndryshuar *IDP*-në u soll në tavolinë vetëm pasi që Gjykata e Apelit e Besançon e kishte marrë vendimin e saj.

Ajo gjithashtu theksoi që seksioni 85 thjesht kishte mbështetur qëndrimin e Shtetit në procedurat në vazhdim dhe që shumica e vendimeve të mëparshme të gjykatës kishin qenë në favor të kërkuësve. Ndërkohë që vendimi i Gjykatës së Apelit të Metz ishte në kundërshtim me vendimin e Gjykatës së Apelit të Colmar, Gjykata e Apelit e Besançon luajti një rol të veçantë në çështjen aktuale si gjykata që kishte për detyrë të përcaktonte çështjet e faktit brenda kornizës ligjore të ofruar nga vendimet e Gjykatës së Kasacionit më 22 prill 1992. Me këtë veprim, Gjykata e Apelit e Besançon kishte refuzuar metodën llogaritëse të Shtetit dhe kishte vendosur një pikë referimi të re për mënyrën se si duhej llogaritur kuota. Efekti praktik i këtij vendimi ishte i favorshëm për kërkuësit sepse e dyfishonte kuotën e paguar nga zyrat e sigurimeve shoqërore dhe iu njihte të drejtën për pagesat e prapambetura që prej disa vitesh.

Vendimet kontradiktore të Gjykatave të Apelit në Metz dhe Colmar nuk kishin kërkuar ndërhyrje legjislative gjatë kohës që procedurat vazhdonin në gjykatat më të larta. Vendimet gjyqësore kontradiktore ishin pasojë e pandarë e çdo sistemi gjyqësor me një rrjet gjykatash për gjyq dhe apel. Ishte pikërisht detyrë e Gjykatës së Kasacionit që të zgjidhte vendimet kontradiktore të gjykatave më të ulëta. Më tej, ishte e pamundur të hamendësohej se çfarë vendimi mund të kishte marrë ajo sikur të mos kishte ndërhyrë Shteti.

Reethanat e çështjes nuk ishin të atilla që ndërhyrja e legjislativitet ishte e parashikueshme, as nuk e mbështesnin argumentin që qëllimi fillestar i tij ishte trazuar nga fakti që konflikti lindi për shkak të një marrëveshjeje të miratuar sipas një procedure të parashkruar nga punonjësit dhe sindikatat përkatëse. Për më tepër, rreziku i pretenduar financiar ndaj Qeverisë nuk e justifikonte që legjislativi të zëvendësonte si palët e marrëveshjes kolektive ashtu edhe gjykatat në arritjen e zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

Miratimi i seksionit 85 në realitet kishte përcaktuar substancën e mosmarrëveshjes duke e bërë të pakuptimtë vazhdimin e procedurave. Duke pasur parasysh një gjë të tillë, Gjykata konsideroi që asnjë vendim përfundimtar nuk ishte marrë në lidhje me themelet, kështu që nuk mund të bëhej asnjë dallim i vlefshëm mes kërkuesve në çështjen në fjalë.

Sa i përket argumentit të Qeverisë që mosmarrëveshja nuk kishte qenë mes kërkuesve dhe Shtetit, legjislativi kishte ndërhyrë në një kohë kur procedurat ligjore në të cilat Shteti ishte palë ishin ende duke vazhduar. Duke pasur parasysh këto konsiderata, kishte pasur shkelje të nenit 6 § 1 në lidhje me të drejtën e kërkuesve për gjyq të drejtë.

Më tej, Gjykata mori në shqyrtim nëse procedurat para Gjykatës së Apelit të Colmar ishin zhvilluar brenda një kohe të arsyeshme. Asgjë nuk sugjeronte që kërkuesit kishin qenë përgjegjës për zgjatjen e procedurave të cilat kishin vazhduar për tre vjet, tetë muaj e tetë ditë. Megjithëse kërkuesit e kishin depozituar ankesën e tyre më 10 shtator 1991, seanca dëgjimore nuk ishte caktuar deri më 12 korrik 1994, vonesë për të cilën nuk ishte dhënë shpjegim bindës. Ajo theksoi se Gjykata e Apelit e Colmar tashmë kishte marrë vendim në çështjen e *IDP*-së më 23 shtator 1993. Më tej, vendimi i Gjykatës së Apelit në rastin konkret nuk u shpall deri më 19 maj 1995, thuhet një vit pas miratimit të Aktit.

Duke pasur parasysh këto konsiderata, procedurat nuk ishin zhvilluar brenda një kohe të arsyeshme. Rrjedhimisht, kishte pasur shkelje të nenit 6 § 1 në lidhje me atë aspekt.

### Neni 13

Duke pasur parasysh gjetjen e një shkeljeje të nenit 6 § 1, Gjykata konsideroi që nuk ishte e nevojshme të shqyrtohej kjo ankesë.

#### Neni 41

Gjykata u caktoi 47,000 franga franceze (afro 6,702.85 euro) secilit prej kërkuesve të parë dhe të dytë, dhe 80,000 franga franceze (afro 11,409 euro) secilit prej nëntë kërkuesve të tjerë në lidhje me të gjitha kërkesat për dëmshpërblim të marra së bashku. Ajo u caktoi 30,000 franga franceze (afro 4,278.41 euro) secilit prej kërkuesve të parë dhe të dytë për kosto dhe shpenzime, dhe 4,000 franga franceze (afro 570.46 euro) secilit prej nëntë kërkuesve të tjerë.

### **(3) Pavarësia – nga Palët në Procedura dhe nga Gjyqtarët e tjerë ose Anëtarët e tjerë të Gjyqësorit**

*Procedurat e falimentimit kundër rafinerisë më të madhe të naftës në Ukrainë të nisura nga një kompani private përfshinë shkelje të shumta të nenit 6 § 1 për shkak të kohëzgjatjes së tyre dhe mungesës së pavarësisë, paanshmërisë dhe sigurisë ligjore*

#### **VENDIMI NË ÇËSHTJEN AGROKOMPLEKS I. UKRAINËS**

(Kërkesa nr. 23465/03)

**6 tetor 2011**

##### **1. Faktet kryesore**

Kërkuesja, Agrokompleks, ishte një kompani private me seli në Ukrainë e cila, në kohën e ngjarjeve, bënte biznes me kompani ruse të përfshira në operacione shkëmbimi, përfshirë shkëmbimin e materialeve bazë ushqimore të Ukrainës me naftë bruto të Rusisë dhe shitjen e produkteve të kompletuara të naftës.

Në fillim të viteve '90, kompania kërkuese furnizoi me 375,000 ton naftë bruto rafinerinë më të madhe të naftës në atë kohë në Ukrainë, shumica e së cilës ishte në pronësi të shtetit – më vonë e riemërtuar LyNOS – për ta përpunuar. Në vitin 1993, rafineria i dorëzoi kompanisë kërkuese vetëm një pjesë të vogël të produkteve të naftës për të cilat ishte rënë dakord. Në mars 1993 dhe nëntor 1994, Gjykata e Lartë e Arbitrazhit (“GjLA”), pas padisë së bërë nga kompania kërkuese, konfirmoi detyrimet kontraktuale të rafinerisë dhe e urdhëroi këtë të fundit që të dorëzonte produktet e naftës për të cilat ishte rënë dakord. Në vitin 1995, Departamenti i Shtetit për Naftë, Gaz dhe Industrinë e Rafinimit të Naftës gjeti se pretendimet e kompanisë kërkuese kishin baza të forta, dhe theksoi se arsyeja kryesore për dështimin e rafinerisë për t’iu përmbajtur detyrimeve të veta ishte devijimi i papaguar i produkteve të naftës nga autoritetet rajonale drejt industrive lokale në vitin 1993. Në korrik 1996, GjLA i caktoi kompanisë kërkuese kompensim për mos-zbatimin për një kohë të gjatë të vendimeve në favor të saj.

Gjithashtu në korrik, kompania kërkuese nisi procedurën e falimentimit kundër LyNOS, duke iu referuar mos-zbatimit të vendimeve në favor të saj. Në një vendim përfundimtar të 2 korrikut 1998, GjLA e caktoi borxhin që LyNOS i detyrohej kompanisë kërkuese në shumën 216,150,544 hrivnja ukrainase (UAH) (të barasvlershme me afërsisht 19.5 milionë euro).

Megjithatë, më vonë në korrik 1998, Qeveria krijoi një ekip (taskforcë) me përfaqësues të autoriteteve të larta shtetërore për të përcaktuar arsyet e borxheve të LyNOS-it dhe për të analizuar pasojat e tyre. Në raportin e tij të gushtit 1998, ekipi këshilloi se ishte e nevojshme të verifikohej shuma e punëve të prapambetura, dhe pas kësaj u urdhërua një auditim nga Zv/Kryeministri i Parë. Në raportin e tij të prillit 2000, Departamenti i Auditimit i Rajonit Lugansk doli me përfundimin se gjetjet e GjLA-së më 2 korrik 1998 ishin në kundërshtim me ligjet e aplikueshme dhe borxhi i LyNOS-it në fakt ishte 36,401,894 UAH.

LyNOS u mbështet mbi atë përfundim dhe bëri kërkesë në GjLA për rishikimin e vendimit të 2 korrikut 1998. Ndërkohë që në shtator 2000 GjLA gjeti se raporti i Departamentit të Auditimit nuk përmbante informacione të reja dhe konfirmoi vendimin që përcaktonte shumën përfundimtare të borxhit, kryetari i gjykatës më pas udhëzoi zëvendësit e tij që ta rishikonin atë gjetje. Në qershor 2001, GjLA e reduktoi borxhin në 97,406,920 UAH dhe, pas apelit të kompanisë kërkuese, Gjykata Komeriale e Apelit në Donetsk e reduktoi atë më tej në 90,983,077 UAH në tetor 2001.

Apelet e kompanisë kërkuese kundër atij vendimi dhe sërish një marrëveshje miqësore mes LyNOS dhe kreditorëve të saj, sipas së cilës pretendimet e kreditorëve do të zgjidheshin përmes shkëmbimit të tyre me asetet e borxhliut, qenë të pasuksesshme. Në nëntor 2004, Gjykata Supreme e refuzoi kërkesën e kompanisë kërkuese për leje për të apeluar në kasacion.

Në shumë raste, LyNOS iu ankua disa autoriteteve shtetërore për vendimet e gjykatave, dhe aktorë të ndryshëm shtetërorë ndërhyjnë në procedura në emër të saj (LyNOS). Në mënyrë të veçantë, në shtator 1998, Zv/Kryeministri i Parë i kërkoi kryetarit të GjLA-së të merrte në shqyrtim gjetjet e taskforcës në lidhje me nevojën e rivlerësimit të borxhit, “duke pasur parasysh rëndësinë [e LyNOS] për ekonominë dhe sigurinë e Shtetit”. Në dhjetor 2000, Presidenti i Ukrainës përcolli një letër nga LyNOS drejtuar kryetarit të GjLA-së në të cilën LyNOS ankohej me të madhe për “pretendimet e ekzagjeruara” të kompanisë kërkuese në procedurat e falimentimit. Kryetari i GjLA-së u përgjigj me raportet e statusit të procedurave dhe me shpjegimin e masave të marra.

## **2. Vendimi i Gjykatës**

Kompania kërkuese u ankua sipas nenit 6 § 1 për kohëzgjatjen e tepruar dhe padrejtësinë e procedurave të falimentimit, duke pretenduar se gjykatat nuk ishin të pavarura ose të paanshme duke pasur parasysh presionin e lartë politik për shkak të interesave të mëdha të autoriteteve shtetërore në rezultatin e tyre. Më tej ajo u



ankua se gjykatat kishin shkelur parimin e sigurisë ligjore duke prishur vendimin përfundimtar të korrikut 1998. Duke u mbështetur në nenin 1 të Protokollit nr. 1, ajo u ankua se nuk kishte mundësi t'i rimerrte të plota 375,000 tonët e naftës që ia kishte furnizuar rafinerisë.

#### Neni 6 § 1

Gjykata vuri re se autoritete të shumta ukrainase kishin ndërhyrë në procedurat gjyqësore në disa raste. Ato ndërhyrje kishin ndodhur në mënyrë të hapur dhe këmbëngulëse, shpesh të kërkuara shprehimisht nga kundërshtarja e kompanisë kërkuese, LyNOS. Në praktikën e saj gjyqësore, Gjykata i ka dënua fuqimisht përpjekjet e autoriteteve jogjyqësore për të ndërhyrë në procedurat e gjykatës, duke i konsideruar ato në papajtueshmëri me nocionin e “gjykatës së pavarur dhe të paanshme” të nenit 6 § 1. Ajo theksoi se fushëveprimi i detyrimit të Shtetit për të garantuar gjykimin nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme nuk ishte i kufizuar tek gjyqësori, por nënkuptonte edhe detyrimin e çdo autoriteti tjetër shtetëror për të respektuar dhe për t’iu përmbajtur gjykimeve dhe vendimeve të gjykatave.

Më tej, pavarësia gjyqësore kërkonte që gjyqtarët individualë të ishin të çliruar nga ndikimet e papërshtatshme, përfshirë ato brenda gjyqësorit. Fakti që kryetari i GjLA-së i kishte dhënë udhëzime të drejtpërdrejta zëvendësve të tij që të rishqyrtonin vendimin e gjykatës të shtatorit 2000 ishte në kundërshtim me parimin e pavarësisë së brendshme gjyqësore.

Rrjedhimisht, kishte pasur shkelje të nenit 6 § 1 për shkak të mungesës së pavarësisë dhe paanshmërisë së gjykatave.

Më tej, Gjykata përsëriti se siguria ligjore, një aspekt themelor i shtetit të së drejtës, kërkonte që kur gjykatat e kanë vendosur përfundimisht një çështje vendimi i tyre nuk duhet të vihet në pikëpyetje. Në rastin konkret, vendimi i korrikut 1998 ishte përcaktim gjyqësor përfundimtar i shumës së punëve të pakryera që LyNOS i kishte borxh. Megjithatë, autoritetet jogjyqësore të Shtetit e kishin vënë në pikëpyetje atë vendim, e kishin rishikuar atë siç kishin dashur, dhe i kishin kritikuar gjetjet e tij si të paligjshme. Për më tepër, rishikimi jogjyqësor i borxhit ishte baza mbi të cilën gjykatat e kishin rikonsideruar shumën e tij, në dëm të kompanisë kërkuese.

Rihapja e çështjes përfundimisht të përcaktuar ligjore të shumës së punëve të pakryera ishte bazuar thjesht mbi faktin që autoritetet shtetërore nuk ishin dakord me të, çka përbënte shkelje flagrante të parimit të sigurisë ligjore në kundërshtim me nenin 6 § 1.

Në lidhje me kohëzgjatjen e procedurave, Gjykata vërejti se periudha që duhet marrë në konsideratë, që nga data e hyrjes në fuqi të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut në Ukrainë e deri në vendimin përfundimtar të Gjykatës Supreme, kishte zgjatur mbi shtatë vjet. Ndërkohë që çështja kishte qenë komplekse nga aspekti faktik dhe ligjor, vonesat e mëdha mund të shpjegoheshin me përpjekjet e autoriteteve për ta rishikuar shumën e borxhit, pavarësisht nga vendimi gjyqësor përfundimtar në lidhje me të. Asnjë vonesë procedurale nuk iu atribua kompanisë kërkuese. Prandaj, kishte pasur gjithashtu shkelje të nenit 6 § 1 në lidhje me kohëzgjatjen e procedurave.

#### Neni 1 i Protokollit nr. 1

Meqenëse borxhi i LyNOS ndaj kompanisë kërkuese u konfirmua me anë të një vendimi gjyqësor përfundimtar, ai përbënte pjesë të “pasurisë” së kompanisë brenda kuptimit të nenit 1 të Protokollit nr. 1. Reduktimi i tij i mëpasëm, për shkak të rihapjes së çështjes, përbëri ndërhyrje tek e drejta e kompanisë kërkuese për gëzimin paqësor të atyre pasurive. Prishja e vendimit të GjLA-së të korrikut 1998 e lëkundti fort mbështetjen e kompanisë kërkuese mbi një vendim gjyqësor detyrues dhe e privoi atë nga mundësia për të marrë paratë që priste të merrte në mënyrë legjitime. Pra rishikimi i shumës së borxhit vuri një barrë të tepërt mbi supet e kompanisë kërkuese dhe ishte në papajtueshmëri me nenin 1 të Protokollit nr. 1.

Duke pasur parasysh gjetjet e Gjykatës që gjykatave vendase në këtë çështje u mungoi pavarësia dhe paanshmëria e kërkuar, ajo konsideroi se nuk ishte vënë “ekuilibri i drejtë” mes nevojave të interesit publik dhe nevojës për të mbrojtur të drejtën e kompanisë për gëzimin paqësor të pasurive të veta. Rrjedhimisht, kishte pasur shkelje të nenit 1 të Protokollit nr. 1.

#### Neni 41

Gjykata në fillim e rezervoi çështjen e shpërblimit të drejtë dhe ftoi palët të paraqisnin, brenda tre muajsh nga data e bërjes përfundimtar të vendimit, vërejtjet e tyre në lidhje me çështjen dhe ta informonin Gjykatën për arritjen e ndonjë marrëveshjeje. Më pas, më 9 dhjetor 2013, Gjykata e udhëroi Shtetin t’i paguante kompanisë kërkuese 27,000,000 euro në lidhje me dëme materiale dhe jomateriale dhe 30,000 euro në lidhje me kostot dhe shpenzimet.

*Kodi Gjyqësor i cili e pengoi kërkuesin që t'u përgjigjej parashtrimeve të avokatit të përgjithshëm dhe ta lejonte këtë të fundit të merrte pjesë në vendim-marrjen e gjykatës ka shkelur të drejtat e mbrojtjes dhe barazisë së armëve sipas nenit 6 § 1*

## VENDIMI NË ÇËSHTJEN **BORGERS k. BELGIKËS**

---

(Kërkesa nr. 12005/86)

**30 tetor 1991**

### **1. Faktet kryesore**

Kërkuesi ishte avokat që ushtronte profesionin në Dhomën e Avokatisë së Hasselt. Ai ishte zgjedhur këshilltar i provincës në nëntor 1981, dhe menjëherë pas kësaj kishte dhënë dorëheqjen nga posti i zëvendësgjyqtarit të rrethit. Sipas Kodit Gjyqësor, posti i zëvendësgjyqtarit të rrethit ishte i papajtueshëm me detyrën e tij të re në të cilën ishte zgjedhur.

Në maj 1982, Gjykata e Apelit në Antwerp e dënoi kërkuesin për falsifikim dhe përdorim të dokumenteve të rreme, dhe e dënoi me kusht me gjashtë muaj burgim dhe gjobë në shumën 40,000 franga belge (afro 991.58 euro). Megjithatë, Gjykata e Kasacionit e lejoi apelin e kërkuesit dhe e rrëzoi vendimin për shkak se Gjykata e Apelit nuk e kishte arsyetuar si duhej vendimin. Gjykata e Kasacionit kishte dëgjuar parashtrimet e avokatit të përgjithshëm (anëtar i zyrës së prokurorit të përgjithshëm), i cili gjithashtu merrte pjesë në vendimarrje në përputhje me nenin 1109 të Kodit Gjyqësor.

Çështja iu rikthye Gjykatës së Apelit në Gent, e cila e gjeti kërkuesin fajtor në nëntor 1984 dhe konfirmoi dënimin e mëparshëm. Kësaj radhe, apeli i kërkuesit u rrëzua nga Gjykata e Kasacionit në një vendim të 18 qershorit 1985. Gjykata e Kasacionit kishte dëgjuar parashtrimet e avokatit të përgjithshëm, dhe e lejoi atë të merrte pjesë në vendimarrje.

### **2. Vendimi i Gjykatës**

Kërkuesi u ankua se fakti që ai nuk kishte pasur mundësi t'u përgjigjej parashtrimeve të avokatit të përgjithshëm dhe që ky i fundit kishte marrë pjesë në vendimarrjen e gjyqtarëve kishte shkelur të drejtën e tij për seancë dëgjimore të drejtë nga një gjykatë e paanshme sipas nenit 6 § 1 të Konventës.

Neni 6 § 1

Gjykata fillimisht deklaroi se gjetjet në çështjen *Delcourt k. Belgjikës*<sup>[400]</sup> në lidhje me çështjen e pavarësisë dhe paanshmërisë së Gjykatës së Kasacionit dhe departamentit të saj të prokurorit të përgjithshëm ishin tërësisht të vlefshme. Rrjedhimisht, nuk ishte perceptuar ndonjë shkelje e Konventës në rastin konkret për sa i përket çështjes së pavarësisë dhe paanshmërisë. Ndërkohë që prej atëherë në Belgjikë kishte hyrë në fuqi Kodi Gjyqësor, shumë prej dispozitave të tij konfirmonin rregulla ekzistuese në këtë fushë, disa prej të cilave ishin shqyrtuar në seancën e saj dëgjimore të 29 shtatorit 1969.

Kështu, Gjykata më tej mori në shqyrtim nëse ishin respektuar të drejtat e mbrojtjes dhe parimi i barazisë së armëve, si koncepte më të gjera të një procesi të drejtë. Këto koncepte kishin kaluar nëpër një evolucion të konsiderueshëm në praktikën gjyqësore të Gjykatës, posaçërisht sa i përket rëndësisë që i jepet dukjes dhe ndjeshmërisë së shtuar të publikut ndaj administrimit të drejtë të drejtësisë.

Objektiviteti me të cilin departamenti i prokurorit të përgjithshëm kishte zhvilluar funksionin e tij në Gjykatën e Kasacionit nuk u vu në pikëpyetje. Ai ishte miratuar nga Parlamenti në disa raste, dhe në Belgjikë kishte pasur konsensus në lidhje me krijimin e tij. Pavarësisht nga kjo, opinioni i avokatit të përgjithshëm nuk mund të shihej si asnjë nga këndvështrimi i palëve në procedurat e Gjykatës së Kasacionit, meqenëse rekomandimi zyrtar i avokatit të përgjithshëm për të pranuar ose rrëzuar apelin e të akuzuarit do ta bënte atë [avokatin], nëse flitet objektivisht, aleat ose kundërshtar të të akuzuarit.

Në çështjen në fjalë, kërkuesi nuk kishte qenë në dijeni, as nuk ishte lejuar t'u përgjigjej parashtrimeve të avokatit të përgjithshëm në seancën dëgjimore të 18 qershorit 1985. Pas ndërhyrjes së avokatit të përgjithshëm, kërkuesit i ishte ndaluar madje edhe dhënia e një përgjigjeje me shkrim sipas nenit 1107 të Kodit Gjyqësor. Nuk kishte justifikim për kufizime të tilla mbi të drejtat e mbrojtjes, meqenëse kërkuesit i interesonte mundësia për të paraqitur vërejtjet e tij para se të mbyllej seanca. Fakti që juridiksioni i Gjykatës së Kasacionit ishte i kufizuar vetëm në çështje të ligjit nuk kishte ndikim mbi këtë gjetje.

Më tej dhe mbi të gjitha, kjo pabarazi ishte rritur nga pjesëmarrja e avokatit të përgjithshëm në vendimmarrjen e gjykatës. Megjithatë ndihma këshilluese e avokatit të përgjithshëm mund të ketë pasur njëfarë dobie në hartimin e vendimeve,

---

400 *Delcourt k. Belgjikës*, vendim i 17 janarit 1970, Nr. 2689/65

nëse është bërë me objektivitet të plotë, kjo detyrë i takonte pikësëpari vetë Gjykatës së Kasacionit. Megjithatë, ishte e vështirë të kuptohej se si mund të kufizohej një ndihmë e tillë brenda konsideratave stilistike, duke qenë se këto të fundit shpesh ishin të pandashme nga çështjet substanciale. Kjo bëhej edhe më e vërtetë në qoftë se ndihma ishte e qëllimshme, siç pohoi Qeveria, për të ruajtur qëndrueshmërinë e praktikës gjyqësore të gjykatës. Edhe sikur ndihma e dhënë në çështjen në fjalë të ishte kufizuar vetëm brenda konsideratave stilistike, me arsye mund të arrihej në përfundimin që vendimmarrja i kishte dhënë avokatit të përgjithshëm një mundësi shtesë për të argumentuar, pa frikën e kundërshtimit nga kërkuesi, parashtrimet e tij që apeli duhet të rrëzohej.

Duke pasur parasysh dukjen në lidhje me kriteret e të drejtave të mbrojtjes dhe barazisë së armëve, kishte pasur shkelje të nenit 6 § 1.

#### Neni 50 (tani neni 41)

Gjykata deklaroi që gjetja e një shkeljeje përbënte shpërblim të drejtë të mjaftueshëm në lidhje me dëmet jomateriale, dhe i caktoi kërkuetit 113,250 franga belge (afro 2807.39 euro) për kosto dhe shpenzime.

*Procedura disiplinore e zhvilluar nga një Bord Vizitorësh të një burgu nuk ka shkelur kriterin e gjykatës së pavarur dhe të paanshme sipas nenit 6*

## VENDIMI NË ÇËSHTJEN **CAMPBELL DHE FELL k. MBRETËRISË SË BASHKUAR**

(Kërkesat nr. 7819/77; Nr. 7878/77)

**28 qershor 1984**

### **1. Faktet kryesore**

Kërkuesi i parë, z. John Joseph Campbell, ishte shtetas i Mbretërisë së Bashkuar, i lindur në Irlandën Veriore në vitin 1944. Në nëntor 1973, ai u dënua për disa vepra, përfshirë komplotim për të kryer grabitje dhe posedim të një arme zjarri me qëllim të kryerjes së grabitjes, dhe u dënua me dhjetë vjet burg. Kërkuesi i dytë, Ati Patrick Fell, ishte shtetas i Mbretërisë së Bashkuar, i lindur në Angli në vitin 1940. Ai ishte prift katolik roman. Në nëntor 1973, pas shpalljes fajtor për komplotim për të kryer zjarrvënie, komplotim për të shkaktuar dëm keqdashës, dhe pjesëmarrje në kontrollimin dhe menaxhimin e një organizate duke përdorur mjete të dhunshme për qëllime politike, ai u dënua me dymbëdhjetë vjet burg. Të dy kërkuesit u mbajtën në Burgun Albany, Ishulli Wight. Gjatë tërë kohës relevante, të dy kërkuesit ishin të klasifikuar si të burgosur të “kategorisë A”, dhe autoritetet besonin që ata kishin qenë të lidhur me Ushtrinë Republikane Irlandeze.

Më 16 shtator 1976, në Burgun Albany ndodhi një incident. Kërkuesit u përfshinë në një protestë për trajtimin e një të burgosuri tjetër, duke u ulur në një korridor të burgut dhe duke refuzuar të lëviznin. Ata u hoqën prej aty nga rojet e burgut pas një përlëshjeje, dhe gjatë këtij procesi u pësuan lëndime nga disa anëtarë të stafit dhe të dy kërkuesit. Kërkuesi i parë u transferua në spitalin e Burgut Parkhurst për trajtim dhe u kthye në Burgun Albany më 30 shtator 1976. Të burgosurit u ngarkuan me akuza disiplinore nga Bordi i Vizitorëve të Burgut. Bordi e dëgjoi çështjen e kërkuesit të dytë më 24 shtator 1976 dhe atë të kërkuesit të parë më 1 tetor 1976.

Kërkuesi i parë kishte marrë para seancës dëgjimore një raport ku shënoheshin akuzat kundër tij dhe një kopje të një formulari ku shënohej procedura e tyre. Ai nuk mori pjesë në seancë, duke deklaruar para seancës se ai do të merrte pjesë vetëm në qoftë se kishte përfaqësim ligjor. Kërkesa e tij për përfaqësim ligjor para Bordit u refuzua. Më 6 tetor 1976, ai u gjet fajtor për të dy akuzat dhe, për veprat e rebelimit dhe dhunës, iu dhanë respektivisht 450 ditë dhe 120 ditë humbje të shlyerjes së dënimit të vuajtur. Ai vendosi që të mos apelonte për rishikim të këtij vendimi nga

një instancë më e lartë meqenëse avokatët e tij konsideruan se procedura do të ishte e destinuar të dështonte për shkak se ai kishte refuzuar të mernte pjesë në gjykim.

Kërkuesi i dytë u akuzua dhe u gjet fajtor nga Bordi i Vizitorëve të Burgut për vepra disiplinore kundër Rregullores së Burgut të vitit 1964. Në fillim ai nuk bëri apel, por më vonë kërkoi të prishte vendimin e bordit mbi bazën e “padrejtësisë substanciale”, sidoqoftë kërkesa e tij dështoi si në shkallën e parë ashtu edhe në apel.

Të dy kërkuesit bënë petition para Sekretarit të Shtetit duke kërkuar që të konsultoheshin me avokatin e tyre. Më 9 shkurt 1977 Sekretari i Shtetit i lejoi kërkuesit të dytë mundësinë për të marrë këshillim ligjor. Sekretari i Brendshëm e refuzoi kërkesën e kërkuesit të parë për shkak se ai nuk kishte dhënë hollësi të mjaftueshme për të nisur hetime të brendshme të mirëfillta. Të dy kërkuesit më pas morën këshillim ligjor, dhe më 13 shtator 1979 nisën procedurat kundër rojeve të burgut, Zv/Guvernatorit dhe Ministrisë së Brendshme duke pretenduar sulmim.

## 2. Vendimi i Gjykatës

Kërkuesit pretenduan se ishin dënuar nga Bordi i Vizitorëve për akuza disiplinore që përbënin në thelb akuza “penale”, pa u mbajtur një seancë dëgjimore në përputhje me nenin 6 të Konventës. Më tej, kërkuesit thanë se vonesa në dhënien e lejes për të marrë këshillim ligjor në lidhje me padinë civile ku kërkohet kompensim për lëndimet e pësuar gjatë incidentit përbënte mohim të qasjes në gjykatë, në shkelje të nenit 6. Përveç kësaj, kërkuesi i dytë u ankua që kufizimi i korrespondencës së tij personale ishte shkelje e nenit 8.

### Neni 6

Në lidhje me çështjen e pranueshmërisë, Gjykata deklaroi që ekzistenca e një zgjidhjeje duhet të jetë mjaftueshëm e sigurt para se të ekzistojë detyrimi për ta shteruar atë. Në kohën e kërkesës së kërkuesit të dytë para organeve të Strasburgut në mars 1977, nuk kishte asnjë tregues që rishikimi nga një instancë më e lartë ishte i mundur në lidhje me vendimin e Bordit të Vizitorëve. Në këtë situatë ai ishte i justifikuar për mos-bërjen e kërkesës para gjykatave vendase për shqyrtim gjyqësor, dhe ankesa e tij ishte e pranueshme. Megjithatë, në lidhje me ankesën e kërkuesit të dytë që kontestonte vendimin e Bordit mbi bazën e “padrejtësisë substanciale”, zgjidhjet e duhura nuk ishin shteruar dhe ankesa e tij sipas nenit 6 u deklarua e papranueshme.

Gjatë marrjes në konsideratë të një ‘akuze penale’ Gjykata tha se garancia e një seance dëgjimore të drejtë është një prej parimeve themelore të çdo shoqërie

demokratike, brenda kuptimit të Konventës; drejtësia nuk mund të ndalojë tek porta e burgut dhe, në raste të përshtatshme, nuk ka urdhër për privimin e të burgosurve nga mbrojtjet e nenit 6. Prandaj, duke pasur parasysh si karakterin “tejet të rëndë” të veprave me të cilat u akuzua kërkuesi i parë ashtu edhe natyrën dhe peshën e dënimit që ai rrezikonte të merrte dhe që në fakt mori, Gjykata gjeti që neni 6 ishte i zbatueshëm në vendimin e Bordit të Vizitorëve në rastin e tij.

Gjykata deklaroi se nuk vihej në diskutim në rastin konkret që Bordi i Vizitorëve, gjatë kryerjes së detyrave të veta vendimmarrëse, ishte “gjykatë e ngritur me ligj”. Gjatë përcaktimit nëse një organ mund të konsiderohet “i pavarur” – kryesisht nga ekzekutivi dhe nga palët në çështje – Gjykata merr parasysh mënyrën e emërimit të anëtarëve të tij dhe kohëzgjatjen e mandatit të tyre, ekzistencën e garancive kundër presioneve të jashtme dhe çështjen nëse organi paraqet dukjen e pavarësisë.

Në këtë aspekt, Gjykata theksoi se anëtarët e Bordit kishin mandat për tre vjet ose më pak sipas emërimit të Sekretarit të Brendshëm. Gjykata vuri në dukje se arsyeja për këtë qëndronte tek fakti që anëtarët nuk paguheshin dhe që do të kishte qenë e vështirë të gjendeshin individë që kishin vullnetin dhe ishin të përshtatshëm për të marrë përsipër detyrat e vështira dhe të rëndësishme që përfshinte posti sikur periudha të ishte më e gjatë. Gjykata gjeti që Rregullorja nuk përmbante ndonjë rregull për shkarkimin e anëtarëve të një Bordi e as ndonjë garanci për mos-shkarkimin e tyre. Megjithatë dukej se Sekretari i Brendshëm mund të kërkonte dorëheqjen e një anëtari, kjo do të bëhej vetëm në raste të jashtëzakonshme dhe ekzistenca e kësaj mundësie nuk shihej si kërcënuese ndaj ndonjë aspekti të pavarësisë së anëtarëve të Bordit gjatë kryerjes së funksioneve të tyre gjyqësore. Gjykata po ashtu theksoi se pavarësia e Bordit nuk ishte kërcënuar duke pasur parasysh faktin që ajo kishte edhe rol gjyqësor edhe rol mbikqyrës. Ekzistimi i ndjesisë mes të burgosurve që Bordet ishin të lidhura ngusht me ekzekutivin dhe administratën e burgut nuk ishte i mjaftueshëm për të konstatuar mungesën e pavarësisë. Gjykata deklaroi se thjesht fakti që kishte kontakte mes një Bordi dhe autoriteteve nuk krijonte përshtypjen që i pari ishte i varur nga i dyti. Kështu, Gjykata nuk pa arsye për të dalë në përfundimin se Bordi në fjalë nuk ishte “i pavarur”, brenda kuptimit të nenit 6.

Në lidhje me paanshmërinë, Gjykata deklaroi që, sipas testit subjektiv, paanshmëria e anëtarëve të një organi sipas nenit 6 duhet të presupozohet deri në momentin që ka prova për të kundërtën. Në rastin konkret, kërkuesi nuk nxori prova për t'i dhënë Gjykatës ndonjë shkak për të dyshuar në këtë aspekt. Në lidhje me testin objektiv, dukja mund të ketë njëfarë rëndësie dhe duhet të merren parasysh çështjet e organizimit të brendshëm. Megjithatë, para 6 tetorit 1976, Bordi i Vizitorëve të Burgut Albany nuk luajti asnjë rol në procedurën disiplinore kundër z. Campbell; kur e trajtoi



çështjen atë ditë, Bordi e mori në dorë për herë të parë çështjen e tij. Prandaj, Gjykata nuk perceptoi asgjë rreth organizimit konkret të marrjes së vendimit që mund të reflektonte negativisht mbi paanshmërinë objektive të Bordit.

Në lidhje me ankesën e kërkuesit që vendimmarrja e Bordit të Vizitorëve në çështjen e tij nuk ishte zhvilluar në publik, Gjykata deklaroi se, duke pasur parasysh faktorët e përmendur nga Qeveria rreth problemeve të sigurisë së procedurave disiplinore të zhvilluara në publik, kërkesa që procedura të tilla disiplinore ndaj të burgosurve të dënuar të zhvillohen në publik vinin një barrë joproporcionale mbi autoritetet. Megjithatë, në lidhje me ankesën e kërkuesit që Bordi i Vizitorëve nuk e kishte shpallur publikisht vendimin e vet në çështjen e tij, Gjykata gjeti shkelje të nenit 6 § 1 në këtë pikë.

#### Neni 6 § 2

Gjykata e refuzoi ankesën që vendimmarrja e Bordit kishte shkelur të drejtën sipas nenit 6 § 2 që secili i akuzuar për vepër penale presupozohet i pafajshëm deri kur vërtetohet fajtor sipas ligjit. Kur kërkuesi i parë nuk mori pjesë në seancën dëgjimore, deklarimi “jo fajtor” për të dy akuzat u bë në emër të tij dhe ai nuk paraqiti asnjë provë për të konstatuar që Bordi kishte proceduar ndryshe e jo mbi bazën e atij deklarimi.

#### Neni 6 § 3

Në lidhje me ankesën e kërkuesit të parë që ai nuk ishte informuar si duhej rreth natyrës së akuzave kundër tij, Gjykata nuk gjeti shkelje të nenit 6 § 3. Gjykata theksoi se, para seancës, ai kishte marrë një raport që përshkruante akuzat kundër tij. Në lidhje me ankesën që, duke pasur parasysh natyrën e akuzave kundër tij, ai duhet të kishte pasur mundësi të merrte këshillim ligjor, Gjykata konsideroi që në të gjitha rrethanat kërkuesit i ishte dhënë kohë e mjaftueshme për të përgatitur mbrojtjen e tij. Kërkuesi i parë u informua për akuzat kundër tij pesë ditë para se të mblidhej Bordi dhe ai po ashtu mori një raport me hollësi të mëtejshme. Përveç kësaj, duke marrë parasysh faktin që kërkuesi i parë nuk pranoi të merrte pjesë në seancën vendimmarrëse, Gjykata e refuzoi ankesën në lidhje me ekzaminimin e dëshmitarëve.

#### Neni 6 dhe neni 8

*Qasja e kërkuesve në këshillim ligjor lidhur me pretendimin e tyre për lëndime personale*

Kërkuesit parashtuan se vonesa në dhënien e lejes për të kërkuar këshillim ligjor në lidhje me padinë civile ku kërkohet kompensim për lëndimet e pësuarat gjatë

incidentit përbënte mohim të qasjes në gjykatë, në shkelje të nenit 6. Ndërkohë që ishte e vërtetë se kërkuesve më pas iu dha leja që kërkuan, qasja e shpejtë në këshillim ligjor ishte e rëndësishme në çështjet që kanë të bëjnë me lëndime personale. Kështu, Gjykata gjeti shkelje të nenit 6 dhe më tej shkelje të nenit 8 duke marrë parasysh pamundësinë e kërkuesve për të pasur korrespondencë me avokatët e tyre.

#### *Kufizimet në korrespondencën personale të Atit Fell*

Gjykata arriti në përfundimin se refuzimi për të lejuar kërkuesin e dytë që të mbante korrespondencë me dy murgesha përbënet shkelje të nenit 8.

#### *Kushtet për vizitat e avokatëve tek Ati Fell*

Gjykata deklaroi se kishte pasur shkelje të nenit 6 § 1. Megjithëse konsideratat e sigurisë mund të justifikonin njëfarë kufizimi ndaj kushteve për vizita nga avokati tek një i burgosur, Qeveria nuk kishte argumentuar para Gjykatës se ishin bërë konsiderata të tilla në çështjen në fjalë.

#### Neni 13

Gjykata gjeti që kufizimet ndaj qasjes së kërkuesit të dytë në këshillim ligjor dhe në korrespondencën personale ishin rezultat i zbatimit të normave të cilat ishin në papajtueshmëri me Konventën. Në këto rrethana, nuk mund të kishte pasur “zgjidhje efektive” siç kërkohet nga neni 13.

#### Neni 50 (tani neni 41)

Gjykata deklaroi se gjetja e shkeljeve përbënte shpërblim të drejtë të mjaftueshëm. Gjykata u caktoi kërkuesve shumën 13,000 paund në lidhje me kosto dhe shpenzime.

*Garancia e një gjykate të pavarur dhe të paanshme në procedurat e gjyqit ushtarak*

## VENDIMET E DHOMËS SË MADHE NË ÇËSHTJET **COOPER k. MBRETËRISË SË BASHKUAR DHE GRIEVES k. MBRETËRISË SË BASHKUAR**

---

(Kërkesat nr. 48843/99 dhe nr. 57067/00)

**16 dhjetor 2003**

### **1. Faktet kryesore**

Në çështjen *Cooper k. Mbretërisë së Bashkuar*, kërkuesi Graham Cooper kishte lindur në vitin 1968 dhe jetonte në Birmingham të Mbretërisë së Bashkuar. Në kohën relevante, ai ishte në shërbim të Forcave Ajrore Mbretërore (RAF).

Më 18 shkurt 1998 kërkuesi u shpall fajtor për vjedhje sipas Ligjit për Vjedhje të vitit 1968 nga një Gjykatë Ushtarake e Rrethit (DCM), në kuadër të RAF-it. Ai u dënua me 56 ditë burg, me zbritje nga rangu dhe me shkarkim nga shërbimi ushtarak. DCM-ja përbëhej nga një kryetar i përhershëm, dy oficerë të tjerë me rang më të ulët dhe një gjyqtar avokat. Kryetari i përhershëm në gjyqin ushtarak të kërkuesit ishte në postin e fundit para daljes në pension dhe raportet vlerësuese ndaj tij kishte pushuar qysh prej gushtit 1997. Dy anëtarët e zakonshëm të trupit gjykues ushtarak kishin vijuar një kurs në vitin 1993 i cili përfshinte trajnim për procedura disiplinore.

Më 3 prill 1998 Autoriteti Shqyrtues, me këshillë të Gjyqtarit Avokat të Përgjithshëm, konfirmoi gjetjen dhe dënimin e DCM-së. Kërkuesi apeloj pa sukses në Gjykatën e Apelit të Gjykatave Ushtarake (CMAC).

Në çështjen *Grievès k. Mbretërisë së Bashkuar*, kërkuesi Mark Anthony Grievès kishte lindur në vitin 1968 dhe jetonte në Devon të Mbretërisë së Bashkuar. Në kohën relevante, ai ishte në shërbim të Marinës Mbretërore (RN).

Më 18 qershor 1998 kërkuesi u shpall fajtor nga një Gjykatë Ushtarake e Marinës Mbretërore për plagosje të paligjshme dhe keqdashëse me qëllim të shkakimit të lëndimit të rëndë trupor, në kundërshtim me Ligjin për Vepra Kundër Personit të vitit 1861. Ai u dënua me tre vjet burg, u zbrit nga rangu, u shkarkua nga shërbimi dhe u urdhërua të panguante 700 paund kompensim. Trupi gjykues ushtarak përbëhej nga një kryetar (kapiten në Marinën Mbretërore), katër oficerë të marinës dhe një gjyqtar avokat, i cili ishte oficer i marinës në shërbim dhe jurist që punonte si këshilltar

ligjor i marinës në FLEET (komanda ushtarake përgjegjëse për organizimin dhe pozicionimin e të gjitha anijeve në det).

Më 29 shtator 1998 Bordi i Admiralëve, me këshillë të Gjyqtarit Avokat të Flotës (JAF), konfirmoi gjetjen dhe dënimin e gjykatës ushtarake. Kërkuesi apeloj pa sukses në CMAC.

## 2. Vendimi i Gjykatës

Të dy kërkuesit u ankuan sipas nenit 6 § 1 (e drejta për proces të drejtë) që gjykatave ushtarake që i kishin gjykuar ata, me strukturën e përcaktuar nga Ligji i vitit 1996, u mungonte pavarësia dhe paanshmëria, dhe kështu që atyre iu ishte mohuar seanca e drejtë dhe publike nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e ngritur me ligj.

### Neni 6 § 1

Gjykata konsideroi se, duke pasur parasysh natyrën e akuzave kundër kërkuesve, marrë së bashku me natyrën dhe rreptësinë e dënimeve të dhëna (56 ditë burgim dhe tre vjet burgim), procedurat e gjyqit ushtarak përbënin përcaktimin e akuzave penale. Duke gjetur se ankesat e kërkuesve ngrinin çështje të ligjit të cilat ishin aq serioze sa që përcaktimi i tyre duhet të varej nga shqyrtimi i themeleve, Gjykata i deklaroi ankesat të pranueshme.

Tek *Cooper*, Gjykata e refuzoi deklaratën e përgjithshme të kërkuesit që gjykatat e Shërbimit Ushtarak, parimisht, nuk mund të gjykonin akuza kundër personelit të Shërbimit në përputhje me kriteret e pavarësisë dhe paanshmërisë të nenit 6 § 1. As praktika e mëparshme e Gjykatës e as dispozitat e nenit 6 nuk e përjashtonin në parim përcaktimin nga gjykatat e Shërbimit të akuzave kundër personelit të shërbimit. Çështjet e pavarësisë dhe paanshmërisë duhet të shqyrtoheshin në lidhje me secilin rast individual në kuadër të të cilit ngriheshin.

Gjykata gjithashtu e refuzoi ankesën e tij në lidhje me pavarësinë dhe paanshmërinë e organeve të përfshira në procedurat para seancës në gjyqin ushtarak. Parashtrimet e tij nuk hodhën dyshime mbi origjinalitetin e ndarjes së roleve të ndjekjes penale, mbledhjes së trupës dhe gjykimit në procesin e gjyqit ushtarak ose pavarësisë së organeve vendimmarrëse prej ndikimit nga zinxhiri i komandës, rangu apo Shërbimi.

Duke iu kthyer pavarësisë dhe paanshmërisë së vetë gjykatës ushtarake, Gjykata deklaroi se nuk kishte baza mbi të cilat të vihej në pikëpyetje pavarësia e gjyqtarit avokat të RAF-it, meqenëse ai ishte civil i emëruar nga Lordi Kancelar (civil) dhe

caktohej pranë gjykatave ushtarake të caktuara nga Gjyqtari Avokat i Përgjithshëm (gjithashtu civil). Gjatë një gjykimi ushtarak, gjyqtari avokat luante rol qendror në procedurë, të barasvlershëm me një anëtar të trupit gjykues. Gjyqtari avokat ishte përgjegjës për zhvillimin e drejtë e të ligjshëm të procedurës së gjyqit ushtarak, dhe vendimet e tij gjatë prezantimit të provave dhe të gjitha çështjeve të ligjit ishin detyruese dhe duhet të shpalleshin në gjyq të hapur. Ndërkohë që gjyqtari avokat nuk votonte për vendimin përfundimtar të gjyqit ushtarak, ai përmbledhte provat dhe refuzonte të pranonte vendimin përfundimtar në qoftë se konsideronte se ai ishte 'në kundërshtim me ligjin'. U gjet se prania e një civili me kualifikime të tilla dhe me një rol kaq qendror në procedurat e gjyqit ushtarak përbënte garanci domethënëse për pavarësinë e atyre procedurave. Më tej, Kryetari i Përhershëm i Gjykatave Ushtarake (PPCM) i emëruar në gjyqin ushtarak në çështjen aktuale ishte i pavarur, për shkak të moshës së tij, të mungesës së perspektivës së tij për ngritje të mëtejshme në detyrë (çka i jepte atij pavarësi nga eprorët meqë nuk i përgjigjej askujt dhe nuk kishte frikë efektive se shkarkohej), dhe faktit që ishte nën mbikqyrjen e gjyqtarit avokat. Në fakt, Gjykata arriti në përfundimin se kryetari i përhershëm jepte kontribut të madh në pavarësinë e një gjykate e cila përndryshe ishte *ad hoc*.

Duke iu kthyer anëtarëve të thjeshtë të trupit gjykues ushtarak, Gjykata gjeti që emërimi i tyre *ad hoc* në gjykatë ushtarake dhe rangun relativisht të ulët (junior) në vetvete nuk e prekni pavarësinë e tyre, sepse kishte mbrojtje kundër presioneve të jashtme mbi ta. I akuzuari kishte të drejtën për të kundërshtuar çdo anëtar të thjeshtë që caktohej në gjyqin e tij ushtarak, oficeri më i ri prej të gjithë anëtarëve të thjeshtë gjithmonë jepte i pari vendimin e tij përfundimtar për të shmangur konfliktin e vetëdijshëm me një oficer më të lartë, dhe anëtarët e thjeshtë mund të ndiqeshin penalisht për shtrembërimin e kursit të drejtësisë në qoftë se nuk e kryenin rolin e tyre sipas standardeve të kërkuara. Fakti që anëtarëve të thjeshtë të gjykatave ushtarake u mungonin kualifikimet ligjore nuk e dëmtonte pavarësinë dhe paanshmërinë e tyre për shkak se gjatë punës së tyre ata drejtoheshin nga gjyqtari avokat i cili ishte i kualifikuar dhe me përvojë. Pavarësia dhe paanshmëria ishin edhe më tej të garantuara nga prania e PPCM-së dhe nga gjyqtari avokat, ndalimi i raportimit mbi vendimmarrjen gjyqësore të anëtarëve, dhe notat raportuese që u shpërndaheshin anëtarëve të cilat ofronin orientim hap-pas-hapi rreth procedurave të gjyqit ushtarak, si dhe një doracak rreth natyrës dhe kufizimeve të rolit dhe funksioneve të gjyqtarit avokat dhe PPCM-së. Ishte veçanërisht relevante që këto shënime përgatitore përmbanin udhëzime të plota rreth nevojës për të funksionuar në mënyrë të pavarur dhe të paanshme dhe rreth rëndësisë që kishte dukja që po veprime pikërisht kështu. Gjithashtu, ky ishte tregues praktik dhe i saktë se si pavarësia dhe paanshmëria mund të arriheshin ose të dëmtoheshin në situata të caktuara.

Gjykata theksoi se Autoriteti Shqyrtues, i cili shqyrtonte automatikisht vendimet përfundimtare dhe dënimet e gjyqeve ushtarake dhe formonte një pjesë të procesit përmes të cilit çdo vendim përfundimtar ose dënim mernte formë të prerë, ishte anomali në sistemin e tanishëm të gjyqit ushtarak, dhe shprehu shqetësime rreth një procedure penale që i jepte fuqi një autoriteti jogjyqësor për të ndërhyrë në konstatime gjyqësore. Megjithatë, Gjykata gjeti se roli i Autoritetit Shqyrtues nuk e dëmtonte pavarësinë e gjykatës ushtarake, sepse vendimi përfundimtar në procedura gjithmonë i mbetet një organi gjyqësor, CMAC-së.

Rrjedhimisht, në *Cooper*, Gjykata doli me përfundimin që procedurat e gjyqit ushtarak nuk mund të thuhej se kishin qenë të padrejta dhe që prandaj nuk kishte pasur shkelje të nenit 6 § 1.

Tek *Grievies*, Gjykata krahasoi sistemin e gjyqit ushtarak në Marinën Mbretërore (RN) me sistemin e gjyqit ushtarak në RAF të cilin e kishte pasur parasysh në *Cooper*. Gjykata e konsideroi të rëndësishme që posti i PPCM-së nuk ekzistonte në sistemin e marinës; kryetari i një gjyqi ushtarak të Marinës Mbretërore emërohej me rastin e fillimit të secilit gjyq. Gjykata konsideroi që mungesa e një PPCM-je me kohë të plotë, pa shpresën e ngritjes në detyrë dhe pa frikën efektive të shkarkimit, dhe vendimmarrja gjyqësore e të cilit nuk kalonte përmes filtrit vlerësues, i privonte gjykatat ushtarake nga dhënia e një kontributi të madh në pavarësinë e një gjykatë që përndryshe ishte e ngritur *ad hoc*.

Më së rëndësishmi, Gjykata theksoi se, megjithëse gjyqtarët avokatë të Marinës Mbretërore përbushin të njëjtin rol thelbësor në gjyqet ushtarake si homologët e tyre në RAF, këto gjyqtarë avokatë ishin oficerë në shërbim të marinës të cilët, kur nuk merrnin pjesë në gjyq ushtarak, kryenin detyrat e rregullta të marinës. Gjyqtari avokat i RAF-it ishte civil që punonte me orar të plotë për Gjyqtarin Avokat të Përgjithshëm, i cili ishte vetë civil. Përveç kësaj, gjyqtarët avokatë të Marinës Mbretërore emëroheshin nga një oficer i marinës, Kryegjyqtari Avokat i Marinës (CNJA).

Gjykata ishte e shqetësuar nga disa praktika raportimi në lidhje me gjyqtarët avokatë të Marinës Mbretërore që ishin relevante në kohën përkatëse. Për shembull, raporti i JAF-it në lidhje me performancën gjyqësore të një gjyqtari avokat mund t'i përcillej oficerit epror të gjyqtarit avokat. Gjykata konsideroi që, edhe në qoftë se gjyqtari avokat i emëruar në gjyqin ushtarak të kërkuesit mund të shihej si i pavarur pavarësisht nga këto praktika raportuese, pozicioni i gjyqtarit avokat të marinës nuk mund të konsiderohej garanci e fortë e pavarësisë së një gjyqi ushtarak në Marinën Mbretërore. Rrjedhimisht, mungesa e një civili në rolin thelbësor të një gjyqtari avokat e privonte gjyqin ushtarak të Marinës Mbretërore nga një prej garancive më të rëndësishme të pavarësisë që kanë gjykatat ushtarake të Shërbimeve të tjera.

Më tej, Gjykata konsideroi se notat raportuese dërguar anëtarëve të gjyqit ushtarak të Marinës Mbretërore ishin thelbësisht më pak të hollësishme dhe shumë më pak të qarta sesa notat e RAF-it. Rrjedhimisht, ato ishin më pak efektive në mbrojtjen e pavarësisë së anëtarëve të thjeshtë të gjykatave ushtarake nga ndikimet e papërshtatshme prej jashtë.

Rrjedhimisht, Gjykata gjeti që dallimet mes sistemit të gjyqit ushtarak të Forcave Ajrore Mbretërore të adresuara në çështjen *Cooper* dhe sistemit të gjyqit ushtarak të Marinës Mbretërore diskutuar në *Grievés* ishin të tilla që mosbesimi i kërkuesit në çështjen e fundit ndaj pavarësisë dhe paanshmërisë së gjyqit të tij ushtarak, sipas Ligjit të vitit 1996, mund të konsiderohej se ishte objektivisht i justifikuar. Kështu që procedura e gjyqit ushtarak kundër tij ishte e padrejtë dhe prandaj kishte pasur shkelje të nenit 6 § 1.

#### Neni 41

Gjykata i caktoi kërkuesit *Grievés* shumën 8,000 euro për kosto dhe shpenzime, minus shumën e marrë për këshillim ligjor.

*Roli qendror që luajti një oficer mbledhës në organizimin e një gjyqi ushtarak ishte shkelje e kriterit për gjykatë të pavarur dhe të paanshme sipas nenit 6*

## VENDIMI NË ÇËSHTJEN FINDLAY k. MBRETËRISË SË BASHKUAR

---

(Kërkesa nr. 22107/93)  
**25 shkurt 1997**

### 1. Faktet kryesore

Kërkuesi ishte i lindur në vitin 1961 dhe jetonte në Windsor të Anglisë. Në vitin 1980 ai iu bashkua ushtrisë britanike dhe në vitin 1982 mori pjesë në fushatën e Falklands. Gjatë betejës ai qe dëshmitar i vdekjes dhe gjymtimit të shumë prej shokëve të tij, dhe ai vetë u plagos në kyçin e dorës nga shpërthimi i predhës së një mortaje, dhe si pasojë e këtyre përvojave në betejë ai vuajti nga stresi post-traumatik (PTSD). Në vitin 1987 ai pësoi lëndime gjatë stërvitjes për shërbim ushtarak në Irlandën Veriore, ku dëmtoi rëndë shpinën e tij. Në vitin 1990, pasi kishte pirë shumë, ai drejtoi armën kundër pjesëtarëve të njësisë së tij dhe kërcënoi se do të vriste veten dhe disa prej kolegëve. Ai qëlloi dy të shtëna, të cilat nuk ishin të drejtuara kundër asnjërit, dhe goditi një televizor. Më pas ai u arrestua.

Kërkuesi u ekzaminua nga një psikiatër i cili gjeti se kërkuesi ishte përgjegjës për veprimet e tij në kohën e incidentit. Megjithatë, kombinimi i streseve dhe faktit që ai kishte pirë shumë atë ditë kishin shkaktuar një incident thuajse të pashmangshëm, dhe u rekomandua që atij t'i jepej një dënim minimal i përshtatshëm. Raporti mjekësor konfirmoi se ai ishte në gjendje të deklarohej dhe se ai e dinte se çfarë po bënte në kohën e incidentit. Megjithatë, ishte kombinimi i problemit kronik të shpinës së tij së bashku me streset e luftimeve dhe një sasi shumë e madhe alkoli që shkaktuan këtë sjellje të rrezikshme. Më vonë kërkuesi u diagnostikua me sindromën e stresit post-traumatik (ang. PTSD).

Oficeri mbledhës për gjyqin ushtarak të kërkuesit e caktoi kërkuesin për të dalë në gjyq për tetë akuza nga incidenti, dhe vendosi që ai të gjykohej nga një gjyq ushtarak i përgjithshëm. Oficeri mbledhës e mblodhi gjyqin e përgjithshëm ushtarak dhe emëroi personelin ushtarak që do të vepronte si oficer prokuror, officer ndihmësprukuror dhe oficer ndihmësmbrojtës, si dhe anëtarët e gjyqit ushtarak.

Kërkuesi u dënua me dy vjet burg. Sipas Ligjit të Ushtrisë të vitit 1955, vendimi i gjyqit ushtarak nuk hynte në fuqi deri sa të konfirmohej nga oficeri konfirmues. Në



rastin e kërkuetit, siç ishte praktikë e zakonshme, oficeri konfirmues ishte i njëjti person si oficeri mbledhës. Kërkueti bëri kërkesë para tij për reduktimin e dënimit. Pas këshillimit nga Zyra e Përgjithshme e Gjyqtarit Avokat, oficeri konfirmues e informoi kërkuetin që dënimi ishte konfirmuar. Kërkueti apeloj dy herë të tjera, dhe në të trija fazat këshillat e Zyrës së Përgjithshme të Gjyqtarit Avokat nuk iu bënë të ditura kërkuetit, e as nuk iu dhanë arsyet e vendimeve që konfirmuan dënimin e tij dhe refuzuan kërkesat e tij.

Kërkueti bëri kërkesë para Gjykatës Divizionale që të merrte leje për të kontestuar shqyrtimin gjyqësor të vlefshmërisë së gjetjeve të gjyqit ushtarak. Ai pretendoi se dënimi i dhënë ishte i tepërt, procedura ishte në kundërshtim me rregullat e drejtësisë natyrale dhe se gjyqtari avokat kishte qenë i ashpër ndaj tij në dy raste para seancës së gjyqit ushtarak. Gjykata Divizionale e refuzoi lejen mbi bazën se gjyqi ushtarak ishte zhvilluar në përputhje të plotë me Aktin e Ushtrisë të vitit 1955 dhe se nuk kishte prova të sjelljes së papërshtatshme ose të ashpër nga ana e gjyqtarit avokat.

Kërkueti nisi padi civile për neglizhencë kundër autoriteteve ushtarake, duke pretenduar dëme për shkak të lëndimit të shpinës së tij dhe PTSD. Padia civile u vendos nga Sekretari i Shtetit për çështje të Mbrojtjes, i cili i pagoi kërkuetit shumën 100,000 paund dhe kostot ligjore, pa pranuar përgjegjësinë.

## 2. Vendimi i Gjykatës

Duke u mbështetur në nenin 6 § 1, kërkueti u ankua që gjyqi ushtarak nuk ishte gjykatë e pavarur dhe e paanshme sepse të gjithë oficerët e emëruar aty ishin vartës të drejtpërdrejtë të oficerit mbledhës i cili po ashtu kryente rolin e autoritetit prokurorial. Më tej, ai argumentoi që mungesa e kualifikimeve ligjore të oficerëve që merrnin vendimet e bënte të pamundur që ata të vepronin në mënyrë të pavarur ose të paanshme. Përveç kësaj, ai u ankua se atij nuk iu ofrua seancë publike, se nuk iu dhanë arsyet e vendimeve të marra, se procesi i konfirmimit dhe shqyrtimit të vendimit përfundimtar dhe dënimin u zhvilluan me dyer të mbyllura, dhe se gjyqi ushtarak nuk ishte gjykatë e ngritur sipas ligjit.

### Neni 6

Gjykata kujtoi që, për të përcaktuar nëse një gjykatë mund të konsiderohet e pavarur, duhet të merret parasysh, *inter alia*, mënyra e emërimit të anëtarëve të saj dhe mandati i tyre, ekzistenca e garancive kundër presioneve të jashtme, dhe çështja nëse një organ paraqet dukjen e pavarësisë. Sa i përket çështjes së paanshmërisë, ka dy aspekte për këtë kriter. Së pari, gjykata duhet të jetë subjektivisht e çliruar nga

paragjykimet personale ose njëanshmëria. Së dyti, ajo duhet të jetë e paanshme nga pikëpamja objektive, që do të thotë se ajo duhet të ofrojë garanci të mjaftueshme për të përjashtuar çdo dyshim legjitim në këtë aspekt.

Së pari, Gjykata diskutoi nëse oficeri mbledhës ishte qenësor gjatë ndjekjes penale të kërkuesit dhe i lidhur ngusht me autoritetet prokuroriale. Gjykata vuri në dukje se oficeri mbledhës luante rol domethënës para dëgjimit të çështjes. Ai vendoste se cilat akuza do të ngrihen dhe çfarë lloj gjyqi ushtarak ishte më i përshtatshmi. Ai mblidhte gjyqin ushtarak dhe emëronte anëtarët e tij, si dhe oficerët prokurorialë dhe mbrojtës. Gjykata vuri re se ai kishte detyrën e dërgimit të përmbledhjes së provave oficerit prokuror dhe gjyqtarit avokat, dhe mund të nënvizonte pjesë të caktuara të cilat mund të ishin të papranueshme. Ai siguronte pjesëmarrjen në gjyq të dëshmitarëve të akuzës dhe dëshmitarëve “të kërkuar me arsye” nga mbrojtja. Dakordësimi me të ishte i nevojshëm përpara se oficeri prokuror të mund të pranonte një kërkesë për akuza më të lehta nga një i akuzuar, dhe zakonisht kërkohej para se të tërhiqeshin akuzat. Për këto arsye Gjykata konsideroi se oficeri mbledhës ishte qenësor në ndjekjen penale të kërkuesit dhe i lidhur ngusht me autoritetet prokuroriale. Prandaj, duke pasur parasysh këtë, Gjykata shqyrtoi nëse anëtarët e gjyqit ushtarak ishin mjaftueshëm të pavarur nga oficeri mbledhës dhe nëse organizimi i gjyqit para mbajtjes së gjyqit ushtarak kishte ofruar garanci të mjaftueshme të paanshmërisë.

Gjykata theksoi se të gjithë anëtarët e gjyqit ushtarak jo vetëm që ishin emëruar nga oficeri mbledhës por edhe ishin vartës të drejtpërdrejtë të tij sipas rangut dhe nën komandën e tij. Më tej, oficeri mbledhës kishte fuqinë për ta shpërndarë gjyqin ushtarak para ose gjatë gjyqit. Prandaj, meqenëse të gjithë anëtarët e gjyqit ushtarak të cilën vendosën në çështjen e kërkuesit ishin vartës sipas rangut ndaj oficerit mbledhës dhe ndodheshin nën zinxhirin e tij të komandës, dyshimet e kërkuesit rreth pavarësisë dhe paanshmërisë së gjykatës mund të ishin objektivist të justifikuar. Përveç kësaj, Gjykata e gjeti domethënëse që oficeri mbledhës po ashtu vepronte si “oficer konfirmues”, ku vendimi i gjyqit ushtarak nuk hynte në fuqi deri sa të ratifikohej nga oficeri mbledhës. Kjo ishte në kundërshtim me parimin që fuqia për të marrë një vendim detyrues i cili nuk mund të ndryshohet nga një autoritet jo-gjyqësor është i ngërthyer brenda vetë nocionit të gjykatës dhe mund të shihet si element përbërës i pavarësisë që kërkohet nga neni 6.

Gjykata deklaroi se mangësitë themelore në sistemin e gjyqit ushtarak nuk ndreqeshin nga prania e mbrojtjeve, siç është përfshirja e gjyqtarit avokat, i cili nuk ishte vetë anëtar i gjykatës dhe këshillat e të cilin nuk bëheshin publike. Mangësitë e cekura më lart as nuk mund të korrigjohen me anë të një procedure shqyrtuese të

mëpasme. Meqenëse seanca e kërkuetit kishte të bënte me akuza penale serioze, ai kishte të drejtë të kishte një gjykatë të shkallës së parë e cila të përmbushte plotësisht kërkesat e nenit 6 § 1.

Për të gjitha këto arsye, dhe veçanërisht duke pasur parasysh rolin qenësor që luante oficeri mbledhës në organizimin e gjyqit ushtarak, Gjykata konsideroi që dyshimet e kërkuetit rreth pavarësisë dhe paanësisë së gjykatës që trajtoi çështjen e tij ishin objektivist të justifikuara, dhe prandaj kishte pasur shkelje të nenit 6 § 1 të Konventës. Për sa u tha më lart, Gjykata vendosi se nuk ishte e nevojshme që ajo të merrte në shqyrtim ankesën tjetër të kërkuetit sipas nenit 6 § 1 që atij nuk i ishte dhënë një seancë publike nga një gjykatë e ngritur me ligj.

#### Neni 50 (tani neni 41)

Gjykata nuk i caktoi kërkuetit kompensim për dëme materiale sepse nuk u konstatua ndonjë lidhje shkakësore mes shkeljes dhe dëmit material të pretenduar. Në lidhje me dëme jomateriale, Gjykata tha se gjetja e një shkeljeje në vetvete i ofronte kërkuetit ndreqje të mjaftueshme. Gjykata i caktoi kërkuetit shumën 23,956.25 paund (afro 27,657.50 euro) për kosto dhe shpenzime.

*Një sërë mangësish në procesin e rëndësishëm ndaj ish-udhëheqësit të PKK-së, ndër të cila prania e një gjyqtari ushtarak në trupin gjyqësor, çuan në disa shkelje të Konventës*

## VENDIMI I DHOMËS SË MADHE NË ÇËSHTJEN **ÖCALAN k. TURQISË**

---

(Kërkesa nr. 46221/99)

**12 maj 2005**

### **1. Faktet kryesore**

Kërkuesi, Abdullah Öcalan, ishte i lindur në vitin 1949. Në kohën e këtij vendimi ai ishte i burgosur në Burgun İmralı në Turqi.

Në kohën e ngjarjeve në fjalë, gjykatat turke kishin lëshuar disa urdhërarreste për arrestimin e kërkuesit dhe Interpoli kishte qarkulluar një urdhërrreshtim (notë e kuqe). Kërkuesi ishte akuzuar nga shteti turk për themelimin e një bande të armatosur për të shkatërruar integritetin e Shtetit turk dhe për nxitjen e akteve terroriste me rezultat humbjen e jetëve.

Më 9 tetor 1998, kërkuesi u dëbua nga Siria, ku kishte jetuar për shumë vite. Prej aty ai shkoi në Greqi, Rusi, Itali dhe më pas sërish në Rusi dhe Greqi, para se të shkonte në Kenia ku, mbrëmjen e 15 shkurtit 1999, në rrethana të diskutueshme, ai u mor me avion në aeroportin e Nairobit dhe u arrestua nga zyrtarët turq. Më pas ai u dërgua me avion për në Turqi.

Pas mbërritjes në Turqi, kërkuesi u dërgua në Burgun İmralı, ku u mbajt në paraburgim nga policia prej 16 deri më 23 shkurt 1999 dhe u mor në pyetje nga forcat e sigurisë. Gjatë kësaj periudhe ai nuk pati ndihmë ligjore. Avokati i tij në Turqi u pengua nga forcat e sigurisë që të udhëtonte për ta vizituar. Edhe 16 avokatëve të tjerë gjithashtu iu refuzua leja për vizitë më 23 shkurt 1999.

Më 23 shkurt 1999, kërkuesi doli para një gjyqtari të Gjykatës së Sigurisë së Shtetit në Ankara, i cili urdhëroi që ai të vihej në paraburgim paragjyqësor. Kërkuesit iu lejua vetëm qasje e kufizuar tek avokatët e tij, të cilët nuk u autorizuan nga autoritetet e burgut që t'i jepnin atij kopje të dokumenteve nga dosja e lëndës, përveç aktakuzës. Vetëm në seancën e 4 qershorit 1999 Gjykata e Sigurisë së Shtetit i dha kërkuesit leje që të konsultonte dosjen nën mbikqyrjen e dy kancelarëve, dhe autorizoi avokatët e tij që t'i jepnin kopje të dokumenteve të caktuara.

Më 29 qershor 1999, Gjykata e Sigurisë së Shtetit në Ankara e gjeti kërkuesin fajtor për kryerjen e veprimeve të llogaritura për të sjellë ndarjen e një pjese të territorit turk dhe për formimin dhe udhëheqjen e një bande të armatosur për ta arritur atë qëllim. Ajo e dënoi atë me vdekje, sipas Nenit 125 të Kodit Penal. Ai vendim u konfirmua nga Gjykata e Kasacionit.

Sipas Ligjit Nr. 4771, të publikuar më 9 gusht 2002, Asambleja Turke vendosi të shfuqizonte dënimin me vdekje në kohë paqeje. Më 3 tetor 2002, Gjykata e Sigurisë së Shtetit e zëvendësoi dënimin me vdekje të kërkuesit me dënim me burgim të përjetshëm.

## 2. Vendimi i Gjykatës

Kërkuesi u ankua sipas neneve 2 (e drejta e jetës), 3 (ndalimi i torturës dhe trajtimit çnjerëzor e poshtëruës) dhe 14 (ndalimi i diskriminimit) që caktimi dhe/ose ekzekutimi i dënimit me vdekje që i ishte dhënë atij do të shkelte Konventën. Më tej kërkuesi u ankua sipas nenit 3 që kushtet në të cilat ai ishte transferuar nga Kenia për në Turqi dhe ishte mbajtur në ishullin İmralı përbënin trajtim çnjerëzor. Sipas nenit 5 (e drejta e lirisë dhe sigurisë) kërkuesi u ankua që ai ishte privuar nga liria në mënyrë të paligjshme dhe që nuk ishte sjellë menjëherë para një gjyqtari. Ai gjithashtu u ankua sipas nenit 6 § 1 (e drejta për proces të drejtë) që ai nuk kishte pasur proces të drejtë sepse nuk ishte gjykuar nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, që gjyqtarët ishin ndikuar nga raportimet armiqësore në media, dhe që avokatët e tij nuk kishin pasur qasje të mjaftueshme në dosjen e lëndës për ta përgatitur si duhej mbrojtjen e tij. Në fund, ai u ankua sipas nenit 34 (e drejta për kërkesë individuale) që përfaqësuesit e tij ligjorë në Amsterdam ishin penguar ta kontaktonin pas arrestimit të tij, dhe që Qeveria turke kishte dështuar t'i përgjigjej kërkesës për informacione nga Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut.

Në vendimin e saj të Dhomës më 12 mars 2003, Gjykata deklaroi, mes të tjerash, se kishte pasur shkelje të nenit 5 §§ 3 dhe 4, nenit 6 §§ 1 dhe 3 (b) dhe (c), dhe gjithashtu të nenit 3 për shkak të faktit se dënimi me vdekje ishte dhënë pas një procesi të padrejtë. Çështja iu referua Dhomës së Madhe me kërkesë të kërkuesit dhe të Qeverisë.

### Neni 5

#### *Neni 5 § 1 - Privimi i lirisë*

Dhoma e Madhe konsideroi që arrestimi i kërkuesit më 15 shkurt 1999 dhe paraburgimi i tij kishin qenë në përputhje me një “procedurë të parashikuar me ligj” dhe që prandaj nuk kishte pasur shkelje të nenit 5 § 1.

*Neni 5 § 3 - E drejta për t'u sjellë menjëherë para një gjyqtari*

E tërë periudha që kërkuesi kaloi në paraburgim policor që minimumi shtatë ditë. Dhoma e Madhe nuk mundi të pranonte se kishte qenë e nevojshme që kërkuesi të mbahej për një periudhë të tillë pa u sjellë para një gjyqtari. Rrjedhimisht kishte pasur shkelje të nenit 5 § 3.

Neni 6*Pavarësia dhe paanshmëria e gjykatës*

Këtu, kërkuesi u ankua se ai nuk ishte gjykuar nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme meqenëse në trupin gjykues në një pjesë të procedurave para Gjykatës së Sigurisë Kombëtare kishte marrë pjesë një gjyqtar ushtarak.

Gjykata që dakord se prania e një zyrtari ushtarak që vepron si gjyqtar në një gjykatë të sigurisë kombëtare e cila gjykon një çështje lidhur me pretendime për vepra të rënda që kanë të bëjnë me sigurinë kombëtare ngrinte pyetje rreth pavarësisë së gjykatës së sigurisë kombëtare nga ekzekutivi. Gjykata deklaroi se për këtë arsye kërkuesi kishte frikën legjitime që Gjykata e Sigurisë Kombëtare mund t'i kishte lejuar vetes të ndikohej në mënyrë të papërshtatshme nga konsiderata që nuk kishin të bënin me çështjen e tij.

Fakti që gjyqtari ushtarak në Gjykatën e Sigurisë Kombëtare ishte zëvendësuar me një gjyqtar civil para dënimit të kërkuesit jo domosdoshmërisht e zgjidhte problemin e shpjeguar lart. Efekti i përbërjes së trupit gjykues në pavarësinë e tij nuk varej vetëm nga përbërja e tij kur shpallte vendimin përfundimtar. Mbrojtjet e nenit 6 kërkonin që gjykata relevante të shihej si e pavarur nga ekzekutivi dhe legjislativi në secilën prej tri fazave të procedurave penale në Turqi: hetimet, gjyqi, dhe vendimi përfundimtar. Në këtë rast, gjyqtari ushtarak që i pranishëm në dy seanca paraprake, në gjashtë seanca lidhur me themelet, dhe kur u morën vendimet e përkohshme. Gjykata gjithashtu theksoi se gjyqtari ushtarak kishte marrë pjesë në një ose më shumë prej vendimeve të përkohshme që kishin qëndruar në fuqi gjatë tërë procedurave, edhe pasi ai ishte zëvendësuar. Më tej, Gjykata përsëriti rregullën e saj të përgjithshme që kur një gjyqtar ushtarak merr pjesë në vendimet e përkohshme që formojnë pjesë integrale të procedurave kundër një civili, e tërë procedura rrjedhimisht është e privuar nga dukja se është zhvilluar nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme. Përveç kësaj, asnjë prej vendimeve të gjyqarit ushtarak nuk u shqyrtua pasi ai u zëvendësua.

Gjykata gjithashtu iu referua praktikës së saj gjyqësore të vendosur duke vënë në pah se çdo situatë ku një civil duhet të dalë para një trupi gjykues të përbërë, qoftë edhe pjesërisht, nga anëtarë të forcave të armatosura, ndikon seriozisht mbi besimin që gjykatat duhet të frymëzojnë në një shoqëri demokratike. Në rrethana të tilla, Gjykata ishte e qartë që kërkuesi ishte i arsyeshëm në shqetësimet e tij rreth pavarësisë dhe paanshmërisë së gjyqit të tij, dhe prandaj kishte pasur shkelje të nenit 6 § 1.

### *Drejtësia e procedurave*

Dhoma e Madhe konsideroi që gjyqi i kërkuesit ishte i padrejtë sepse: ai nuk pati ndihmë nga avokatët e tij gjatë marrjes në pyetje gjatë mbajtjes në polici; ai nuk mundi të komunikonte me avokatët e tij pa praninë e palëve të treta; ai nuk mundi të kishte qasje të drejtpërdrejtë në dosjen e lëndës deri në një fazë të vonshme të procedurave; pati kufizime mbi numrin dhe kohëzgjatjen e vizitave të avokatëve të tij; dhe avokatëve të tij nuk iu lejua qasja e duhur në dosjen e lëndës deri më vonë atë ditë. Dhoma e Madhe gjeti që efekti i tërësishëm i atyre vështirësive të marra së bashku i kishte ngushtuar kaq shumë të drejtat e mbrojtjes sa që ishte shkelur parimi i procesit të drejtë, siç parashtrohet në nenin 6.

### Dënimi me vdekje (nenet 2, 3 dhe 14)

#### *Zbatimi i dënimit me vdekje*

Dënimi me vdekje ishte shfuqizuar në Turqi dhe dënimi i kërkuesit ishte zëvendësuar me burgim të përjetshëm. Rrjedhimisht, nuk kishte pasur shkelje të neneve 2, 3 dhe 14 për shkak të zbatimit të dënimit me vdekje.

#### *Dënimi me vdekje pas një procesi të padrejtë*

Gjatë shqyrtimit të caktimit të dënimit me vdekje sipas nenit 3, duhet të merrej në konsideratë neni 2, i cili përjashtonte zbatimin e dënimit me vdekje për një person i cili nuk kishte pasur proces të drejtë.

Sipas mendimit të Dhomës së Madhe, caktimi i dënimit me vdekje për një person pas një procesi të padrejtë nënkuptonte se ai person përjetonte frikën se do të ekzekutohej. Frika dhe pasiguria për të ardhmen të shkaktoara nga një dënim me vdekje, në rrethana ku ekzistonte mundësia reale që dënimi do të zbatohet, pa dyshim sollën një shkallë të konsiderueshme ankthi njerëzor. Një ankth i tillë nuk mund të shkëputej nga padrejtësia e procedurave që i paraprinë një dënim i cili, meqenëse bëhej fjalë për një jetë njerëzore, u bë i paligjshëm sipas Konventës.

Dhoma e Madhe vuri në dukje se kishte pasur një pezullim të përkohshëm të zbatimit të dënimit me vdekje në Turqi që prej vitit 1984 dhe që, në rastin e kërkuarit, Qeveria turke kishte vepruar në pajtueshmëri me masën e përkohshme të Gjykatës sipas Rregullës 39 të Rregullores së Gjykatës për pezullimin e ekzekutimit.

Megjithatë, e kaluara e kërkuarit si udhëheqës dhe themelues i PKK-së, një organizatë e cila ishte angazhuar në një fushatë të vazhdueshme dhune që kishte shkaktuar mijëra të vdekur, e kishte bërë atë njeriun më të kërkuar nga policia në Turqi. Rreziku që dënimi do të ekzekutohej vazhdoi të ekzistonte mbi tre vjet pas paraburgimit të kërkuarit në Imralı.

Rrjedhimisht, Dhoma e Madhe arriti në përfundimin që caktimi i dënimit me vdekje për kërkuarin pas një procesi të padrejtë nga një gjykatë pavarësia dhe paanshmëria e së cilës linin vend për dyshime përbënte trajtim çnjerëzor në shkelje të nenit 3.

### Neni 3

#### *Kushtet e transferimit të kërkuarit*

Nuk ishte përcaktuar 'përtej çdo dyshimi të arsyeshëm' se arrestimi i kërkuarit dhe kushtet në të cilat ishte transferuar nga Kenia për në Turqi e kishin tejkaluar masën e zakonshme të poshtëritimit që ishte e ngërthyer në çdo arrestim dhe paraburgosje, ose që kishin arritur nivelin minimal të ashpërsisë që kërkohet për t'u zbatuar neni 3. Rrjedhimisht, nuk kishte pasur shkelje të nenit 3 në lidhje me atë pikë.

#### *Kushtet e paraburgimit*

Kushtet e përgjithshme në të cilat ishte mbajtur kërkuari në Burgun Imralı nuk e kishin arritur nivelin minimal të ashpërsisë që kërkohet për të përbërë trajtim çnjerëzor ose poshtëruar brenda kuptimit të nenit 3. Prandaj, nuk kishte pasur shkelje të nenit 3 në lidhje me atë pikë.

### Neni 34

Dhoma e Madhe theksoi se nuk kishte asgjë që tregonte se kërkuari ishte penguar të ushtronte në masë të konsiderueshme të drejtën e tij për kërkesë individuale. Rrjedhimisht, nuk kishte pasur shkelje të nenit 34.



#### Neni 46

Dhoma e Madhe konsideroi që, kur një individ, siç është rasti i kërkuarit, është dënuar nga një gjykatë e cila nuk i ka plotësuar kriteret e Konventës për pavarësi dhe paanshmëri, rigjykimi ose rihapja e çështjes, po qe se kërkohet, përfaqëson në parim një mënyrë të përshtatshme për të riparuar një shkelje të tillë.

Megjithatë, masat e veçanta riparuese, nëse ka, që i kërkohen një Shteti të paditur për të përmbushur detyrimet e tij sipas nenit 46 duhet të vareshin nga rrethanat e veçanta të çështjes individuale dhe të përcaktohen nën dritën e vendimit të Gjykatës në lidhje me atë çështje, dhe duke marrë parasysh si duhet praktikën gjyqësore të Gjykatës.

#### Neni 41

Gjykata vendosi që gjetjet e saj të shkeljeve të neneve 3, 5 dhe 6 në vetvete përbënin shpërblim të drejtë të mjaftueshëm për të gjitha dëmet e pësuar nga kërkuari, dhe u caktoi avokatëve të kërkuarit 120,000 euro për kosto dhe shpenzime.

*Prania e një anëtarit të trupit gjykues që ishte vartës i një përfaqësuesi të Qeverisë në procedurat para gjykatës shkeli parimin e pavarësisë sipas nenit 6 § 1*

## VENDIMI NË ÇËSHTJEN SRAMEK k. AUSTRIË

---

(Kërkesa nr. 8790/79)

**22 tetor 1984**

### 1. Faktet kryesore

Kërkuesja ishte shtetase e Shteteve të Bashkuara që jetojnte në Mynih të Gjermanisë. Me shpresën që të ndërtonte një rezidencë pushimesh në Hopfgarten, pas negociatave, kërkuesja me sa duket bleu një parcelë toke me anë të një kontrate fillestare të vitit 1973. Kontrata përfundimtare u përpilua më 13 janar 1977.

Megjithatë, kontrata nuk do të bëhej efektive në qoftë se nuk vërtetohej nga Autoriteti vendas i Transaksioneve të Patundshmërisë (autoriteti lokal), siç kërkohet nga seksioni 3 i Ligjit të Tirolit për Transaksionet e Patundshmërisë (Akti 1970/1973) i cili ishte ndryshuar nga Akti i vitit 1973 dhe kishte hyrë në fuqi më 1 janar 1974.

Autoriteti lokal në Hopfgarten e vërtetoi kontratën në mars të vitit 1977. Megjithatë, Zyrtari i Transaksioneve të Patundshmërisë (Zyrtari i Transaksioneve), duke vepruar në emër të Qeverisë, e apeloj vendimin e Autoritetit Rajonal të Transaksioneve të Patundshmërisë (Autoriteti Rajonal) me arsyetimin se ai ishte në kundërshtim me seksionin 4(2) të Aktit 1070/1973. Ai deklaroi se tashmë ishin 110 pronarë të huaj tokash në Hopfgarten, dhe që ekzistonte rreziku i dominimit prej të huajve. Prandaj, vërtetimi i kontratës do të ishte në kundërshtim me interesat sociale dhe ekonomike të bashkisë sipas asaj dispozite.

Qeveria e Tirolit ishte e përbërë nga disa grupe me nën-ndarje. Zyrtari i Transaksioneve ishte drejtori i grupit III, dhe për sekretariatit e tij kujdesej divizioni III b. 2. Për sekretariatit dhe raportuesin e Autoritetit Rajonal kujdesej divizioni III b. 3. Autoriteti Rajonal e mbështeti apelin e Qeverisë në qershor 1977, dhe refuzoi të vërtetonte transferimin e titullit mbi tokën tek kërkuesja. Pas kësaj kërkuesja apeloj pa sukses në Gjykatë Kushtetuese mbi disa baza, përfshirë faktin që Autoriteti Rajonal nuk ishte gjykatë e pavarur brenda kuptimit të nenit 6 të Konventës. Gjykata arsyetoi që ai ishte gjykatë e pavarur sepse nuk i bindej udhëzimeve ekzekutive në lidhje me ushtrimin e funksioneve të saj. Më tej, anëtarët e gjykatës nuk mund të shkarkoheshin gjatë mandatit të tyre tre-vjeçar, përveç se në rrethana të kufizuara.

Përpara se Gjykata Kushtetuese të merrte vendimin e saj, parcela në fjalë iu shit një austriaku i cili me sa duket e ktheu atë në tokë kullote.

## 2. Vendimi i Gjykatës

Kërkuesja pretendoi se Autoriteti Rajonal nuk ishte gjykatë e pavarur dhe e paanshme brenda kuptimit të nenit 6 § 1 të Konventës, dhe se sido që të ishte ai nuk i kishte ofruar asaj seancë dëgjimore publike, në kundërshtim me po atë dispozitë.

### Neni 6 § 1

Neni 6 § 1 ishte i zbatueshëm në çështjen në fjalë meqenëse një vendim i pafavorshëm mbi vlefshmërinë e marrëveshjes së shitblerjes ishte “vendimtar për të drejtat dhe detyrimet private”. Kjo ishte pranuar nga Qeveria.

Autoriteti Rajonal ishte gjykatë e krijuar në përputhje me ligjet austriake sipas Aktit 1970/1973. Kështu, ai përbënte gjykatë për qëllimet e nenit 6 duke pasur parasysh funksionin e tij për të vendosur çështje mbi bazën e rregullave të ligjit në kompetencë të tij, duke zhvilluar procedura në një mënyrë të përcaktuar.

Akti 1970/1973, i modifikuar me vendim të Gjykatës Kushtetuese, i plotëson kërkesat e nenit 6 në lidhje me kohëzgjatjen e mandatit të anëtarëve të gjykatës me mundësi të kufizuar shkarkimi. Megjithëse pushtetin për emërimin e anëtarëve ndihmësgjyqtarë e kishte Qeveria e Landit, kjo në vetvete nuk mjaftonte për të hedhur dyshime mbi pavarësinë dhe paanshmërinë e anëtarëve, sepse ata nuk kishin pushtet në cilësinë e individit. Më tej, ligji e ndalonte ekzekutivin që t’u jepte udhëzime anëtarëve.

Trupi gjykues në çështjen në fjalë përbëhej nga një kryebashkiak i Tirolit, i cili ishte bujk; një gjyqtar i Gjykatës së Apelit të Insbrukut; një ekspert bujqësor dhe bujk; një avokat; dhe tre shërbyes civilë nga Qeveria e Landit. Pavarësia dhe paanshmëria e gjyqtarit dhe e ekspertit të bujqësisë nuk u vu në diskutim. Ngjashëm, Gjykata e refuzoi parashtrimin e kërkueses se avokati mund të kishte marrë udhëzime nga Qeveria e Landit nëse ishte angazhuar ta përfaqësonte atë në procedura ligjore, meqenëse: (a) kjo nuk kishte ndodhur në rastin konkret; dhe (b) kjo në vetvete nuk mjaftonte për të vënë në pikëpyetje paanshmërinë e tij. Njëkohësisht, pavarësia e kryebashkiakut nuk mund të vihej në pikëpyetje vetëm për shkak se funksionet e postit të tij ishin nën mbikqyrjen e Landit ose Federatës, meqenëse ai sidoqoftë ishte në gjendje të vepronte në mënyrë të pavarur në çështje të ndryshme, siç ishte roli i tij si Kryetar i Autoritetit Rajonal, i cili ishte jashtë kuadrit të pushtetit të tij si kryetar bashkie.

Më tej, Gjykata mori në konsideratë pavarësinë dhe paanshmërinë e shërbyesve civilë të cilëve u kërkohej të ishin anëtarë të Autoritetit Rajonal sipas Aktit 1970/1973. Në rastin konkret, Qeveria kishte marrë statusin e palës kur kishte apeluar vendimin e autoritetit lokal i cili kishte qenë në favor të kërkuases. Përveç kësaj, Qeveria ishte përfaqësuar nga një Zyrtar i Transaksioneve para Autoritetit Rajonal, i cili ishte në fakt mbikqyrësi sipas hierarkisë i njërit prej tre shërbyesve civilë në fjalë. Për më tepër, i njëjti shërbyes civil kishte mbajtur një post kyç brenda Autoritetit si raportuesi përgjegjës për të komentuar mbi rezultatet e hetimeve dhe për të paraqitur përfundimet.

Megjithëse Zyrtarit të Transaksioneve i ndalohej të ushtronte postin e tij të eprorit për t'i dhënë udhëzime raportuesit (duke mos pasur prova që ai e kishte bërë, ose kishte tentuar ta bënte, një gjë të tillë në rastin konkret), Gjykata theksoi se dukja gjithashtu mund të ketë rëndësi kur bëhet fjalë për çështjen e pavarësisë sipas nenit 6. Kur anëtarët e një gjykate përfshijnë një person që është në pozitë vartësi ndaj njërit prej palëve, në aspektin e detyrave të tij dhe organizatës së cilës i shërben, palët paditëse mund të kenë dyshime legjitime në lidhje me pavarësinë e atij anëtari, çka mund të ndikojë seriozisht mbi besimin publik tek gjykatat e një shoqërie demokratike. Rrjedhimisht, kishte pasur shkelje të nenit 6 § 1.

Duke pasur parasysh gjetjen e saj më lart, Gjykata konsideroi që nuk ishte e nevojshme të shqyrtoheshin ankesat e kërkuases në lidhje me ofrimin e një seance dëgjimore publike të drejtë.

#### Neni 50 (tani neni 41)

Pretendimet e kërkuases për dëme materiale bazoheshin mbi supozimin që, sikur Autoriteti Rajonal vërtet të kishte përbërë gjykatë të pavarur dhe të paanshme, ai do ta kishte vërtetuar kontratën e saj të shitblerjes. Megjithatë, provat në dosjen e saj nuk e mbështetën këtë përfundim, dhe prandaj kërkesa e saj për dëme materiale u refuzua. Sidoqoftë, Gjykata i caktoi kërkuases 100,000 shilinga (afro 7,267.28 euro) për kosto ligjore.

*Paraburgimi i një njeriu me urdhër të një ministri qeveritar, në vend të një gjykate, shkeli nenin 5 të Konventës sepse ekzistenca e fuqive të tilla ekzekutive nuk ishte në përputhje me nocionin e ndarjes së pushteteve ose parimin e shtetit të së drejtës dhe mbrojtjen nga arbitrariteti*

## VENDIMI NË ÇËSHTJEN **STAFFORD K. MBRETËRISË SË BASHKUAR**

---

(Kërkesa nr. 46295/99)

**28 maj 2002**

### **1. Faktet kryesore**

Kërkuesi, z. Dennis Stafford, u shpall fajtor për vrasje në vitin 1967. Në vitin 1979 ai u lirua me kusht, një pjesë e të cilit kërkonte që ai që mbetej në Mbretërinë e Bashkuar për sa kohë që nuk autorizohet për t'u larguar. Pas kësaj, kërkuesi udhëtoi jashtë vendit pa autorizim, dhe në vitin 1980 iu hoq kushti, që do të thoshte se ai kishte dalë nga paraburgimi në mënyrë të paligjshme. Në vitin 1989 ai u rikthye në Mbretërinë e Bashkuar me një pasaportë fallco dhe u arrestua. Pasi pagoi gjobë për posedim të një dokumenti fallco, kërkuesi qëndroi në paraburgim për shkak të heqjes së kushtit. Në vitin 1991, pas një shqyrtimi, ai sërish u lirua me kusht. Megjithatë, në vitin 1993 ai u arrestua përsëri dhe u shpall fajtor për akuza të mashtrimit, për çka u dënua me gjashtë vjet burgim. Kushti në lidhje me dënimin e tij me burgim të përjetshëm u hoq përsëri.

Në vitin 1996, çështja e tij u mor në shqyrtim dhe Bordi i Lirimit me Kusht rekomandoi që ai të lirohej. Ky rekomandim u refuzua nga Sekretari i Shtetit. Kërkuesi bëri shqyrtim juridik të këtij refuzimi dhe vendimi i Sekretarit të Shtetit u prish mbi bazën e faktit që Sekretari i Shtetit nuk kishte autoritet për të paraburgosur një të burgosur të dënua me burg të përjetshëm pasi ai e kishte vuajtur dënimin me burg dhe kur nuk kishte ndonjë rrezik të njohur të përsëritjes së veprave të dhunshme nga ana e tij. Megjithatë, vendimi i Sekretarit të Shtetit u konfirmua nga Gjykata e Apelit, ku Dhoma e Lordëve e ndaloi apelimin e mëtejshëm. Në vitin 1998, kërkuesi më në fund u lirua me kusht, më se një vit pas kohës kur ishte dashur të lirohej për dënimin e tij për mashtrim sikur Sekretari i Shtetit të mos e kishte e refuzuar lirimin e tij.

### **2. Vendimi i Gjykatës**

Duke u mbështetur në nenet 5 § 1 (e drejta për lirinë dhe sigurinë e personit) dhe 5 § 4 (e drejta për vendosjen e shpejtë nga gjykata të ligjshmërisë së paraburgimit të

personit) të Konventës, kërkuesi u ankua para Gjykatës që paraburgimi i tij ashtu siç ishte vendosur nga Sekretari i Shtetit ishte arbitrar dhe që ai duhet të kishte pasur mundësinë për të bërë kërkesë para një organi i cili mund ta kishte shqyrtuar dhe do të kishte vendosur për vazhdimin e paraburgimit të tij, në vend të një organi që mund të lëshonte vetëm rekomandime jodetyruese.

#### Neni 5 § 1

Gjykata në fillim përcaktoi se, ndërkohë që ajo e kishte konsideruar nëse regjimi i Mbretërisë së Bashkuar për burgimin e përjetshëm kishte qenë në pajtueshmëri me Konventën në çështje të mëparshme, në interes të vazhdimësisë dinamike dhe evolutive të Konventës dhe në mënyrë që të drejtat që përmban ai të jenë praktike dhe efektive, ishte e nevojshme të rivlerësohej regjimi i dënimeve që ishin me burgim të përjetshëm në 'kushtet e sotme' në Mbretërinë e Bashkuar. Në mënyrë të veçantë, Gjykata ishte e mendimit se, ndryshe nga çështjet e mëparshme, tani ishte konstatuar në të drejtën vendase që dënimi i përjetshëm që kishte marrë kërkuesi nuk ishte ndëshkim i pacaktuar apo tërëjetësor por dënim i caktuar vazhdimi i të cilit, pas plotësimit të një periudhe të deklaruar burgimi, ishte i bazuar mbi vlerësimin e karakteristikave të personit të burgosur.

Në çështjen në fjalë, kërkuesi e kishte përfunduar periudhën e burgimit për sa i përkiste dënimit me burg të përjetshëm në vitin 1979 kur u lirua së pari me kusht. Prandaj, Gjykata arsyetoi që, pasi periudha e burgimit të tij në lidhje me dënimin për mashtrim kishte përfunduar më 1 korrik 1997, vazhdimi i paraburgimit të tij sipas kushteve të dënimit të tij të përjetshëm të detyrueshëm nuk mund të shihej si i justifikuar si ndëshkim për krimin e tij origjinal. As Sekretari i Shtetit nuk e justifikoi mbajtjen e vazhduar në burg të kërkuesit me rrezikshmërinë e tij për publikun. Gjykata më tej shpjegoi që, sipas nenit 5 § 1 (a), një individ mund të privohej nga e drejta e lirisë dhe sigurisë së personit në rastet kur privimi kryhej përmes një procedure të parashikuar me ligj dhe kur ai përbënte paraburgim të ligjshëm të personit pas dënimit nga një gjykatë kompetente. Në mënyrë që të ndodhë kjo 'pas dënimit' duhet të ekzistojë një lidhje shkakësore mes dënimit dhe paraburgimit. Në këtë rast, Gjykata nuk e gjeti një lidhje të tillë shkakësore mes paraburgimit të kërkuesit pas 1 korrikut 1997 dhe dënimit të tij origjinal për vrasje.

Gjykata vuri në dukje se në të drejtën vendase nuk kishte pushtet që autorizonte caktimin e paraburgimit ndaj një personi për një kohë të pacaktuar me qëllim që të parandalohet kryerja prej tij e veprave të tjera jo të dhunshme. Gjykata më tej doli në përfundimin se paraburgimi i kërkuesit nga Sekretari i Shtetit mbi bazën e frikës së përgjithshme që ai mund të kryente vepra jo të dhunshme në të ardhmen nuk

ishite në pajtueshmëri me theksin që Konventa vë tek shteti i së drejtës dhe mbrojtja nga arbitrariteti. Prandaj, Gjykata gjeti se paraburgimi i kërkuesit pas përfundimit të periudhës së burgimit të tij për mashtrim nuk përmbushte kriteret e justifikimit sipas nenit 5 § 1 (a) dhe se prandaj kishte pasur shkelje të nenit 5 § 1.

#### Neni 5 § 4

Gjykata filloi duke përsëritur që, meqenëse burgimi i kërkuesit përmbante elementin ndëshkues të dënimit të tij me burg të përjetshëm, vendimi i Sekretarit të Shtetit për ta vazhduar burgimin e tij ishte praktikë dënimi e rrjedhimisht brenda fushëveprimit të nenit 5 § 4. Gjykata arsyetoi se nuk ishte e mjaftueshme që kriteret e nenit 5 § 4 të ishin përmbushur vetëm gjatë procesit gjyqësor origjinal dhe procedurave të apelit, por ato duheshin përmbushur gjatë përcaktimit vijues të paraburgimit. Gjykata ishte e qartë se, meqë paraburgimi i kërkuesit pas përfundimit të periudhës së burgimit të tij për mashtrim ishte urdhëruar nga Sekretari i Shtetit, ligjshmëria e paraburgimit të kërkuesit gjatë asaj kohe nuk ishte vendosur nga një 'gjykatë'. Gjykata u shpreh qartë se procesi përmes të cilit Sekretari i Shtetit kishte urdhëruar paraburgimin e kërkuesit nuk kishte përmbajtur mbrojtjet e kërkuara të një gjykatë, përfshirë, për shembull, mundësinë e një seance dëgjimore me gojë. Prandaj, kishte pasur shkelje të nenit 5 § 4.

#### Neni 41

Gjykata vendosi që kërkuesit duhet t'i caktohej shuma 16,500 euro në lidhje me dëme materiale dhe jomateriale së bashku, dhe 17,865.10 paund në lidhje me kosto dhe shpenzime.

## (4) Pavarësia – Emërimi i Gjyqtarëve

---

*Përfshirja e dy ndihmësgjyqtarëve të emëruar nga Shoqatat e Qiradhënësve dhe Qiramarrësve respektivisht shkeli nenin 6 sepse të dy organet kishin interes në rezultatin e çështjes së kërkuarit*

### VENDIMI NË ÇËSHTJEN LANGBORGER K. SUEDISË

---

(Kërkesa nr. 11179/84)

**22 qershor 1989**

#### 1. Faktet kryesore

Kërkuarisi ishte shtetas suedez i lindur në vitin 1922. Ai ishte inxhinier konsulent, dhe më 1 tetor 1982 ai mori me qira një apartament në dalje të Stokholmit. Kontrata e qirasë përmbante një “klauzolë negociuese”. Seksioni 2 i Ligjit për Negociimin e Qirasë i vitit 1978 e përkufizonte kaluzolën negociuese si dispozitë në një kontratë qiraje sipas së cilës qiramarrësi pajtohej që t’i nënshtrohej kushteve të kontratës, veçanërisht në lidhje me qiranë, sipas pranimit nga shoqata që zhvillonte negociatat. Në lidhje me kontratën e qirasë së kërkuarit, Seksioni 1 i Ligjit kërkonte që palët të merrnin përsipër të praninin, pa përfundim paraprak të kontratës, qiranë dhe kushtet e tjera të dakorduara mes, nga njëra anë, unionit të qiradhënësit, që ishte pjesë e Federatës Suedeze të Pronarëve, dhe një qiradhënësi, i cili me pronën e tij ishte pjesë e një unioni të tillë, dhe, nga ana tjetër, unionit të qiramarrësve, që ishte pjesë e Unionit Nacional të Qiramarrësve. Për zhvillimin e negociatave, unioni i qiramarrësit në fjalë merrte një komision prej 0.3% të qirasë.

Kërkuarisi ishte i pakënaqur me qiranë dhe me faktin që ai përfaqësohej nga Unioni i Qiramarrësve të Zonës së Madhe të Stokholmit. Prandaj, ai dërgoi një notë ku paralajmëronte qëllimin e tij për të përfunduar kontratën e qirasë në përputhje me Kreun 12, Seksionin 54 të Ligjit të Tokës, me synim që të ndryshonte kushtet e kontratës.

Kërkuarisi i propozoi qiradhënësit lidhjen e një marrëveshjeje të re me qira të fiksuar dhe pa klauzolë negociuese. Pas refuzimit të ofertës së tij, ai e ngriti çështjen në Bordin e Shqyrtimit të Qirave në Qarkun e Stokholmit më 23 qershor 1983. Sipas Seksionit 5 të Ligjit për Bordet e Shqyrtimit të Kontratave të Qirave dhe Bordet e Shqyrtimit të Qirave i vitit 1973, secili bord i shqyrtimit të qirave ishte i përbërë nga një kryetar (Gjyqtar i Qirasë) dhe dy ndihmësgjyqtarë, njëri prej të cilëve duhet të



kishte njohuri për çështjet e administrimit të pronës dhe tjetri duhet të kishte njohuri për çështjet e qiramarrësve. Të dy ndihmësgjyqtarët emëroheshin respektivisht nga Federata Suedeze e Pronarëve dhe Unioni Nacional i Qiramarrësve. Më 17 nëntor 1983, Bordi i Shqyrtimit të Qirave mbajti një seancë dëgjimore në të cilën ishin të pranishëm kërkuesi dhe përfaqësuesi i tij si dhe përfaqësuesi i qiradhënësit.

Kërkuesi i kontestoi dy ndihmësgjyqtarët sepse ata ishin emëruar nga një shoqatë pronarësh dhe një organizatë qiramarrësish. Kërkuesi parashtroi që ata nuk mund ta vendosnin çështjen e tij në mënyrë objektive dhe të paanshme sepse ekzistenca e Unionit të Qiramarrësve varej nga shumat që i paguheshin atij Unioni për zhvillimin e negociatave për qira, dhe njëkohësisht arsyeja për ekzistencën e Unionit të Pronarëve mbështetej në masë të madhe tek pjesëmarrja në këto negociata. Ndaras, ai kërkoi fshirjen e klauzolës negociuese nga kontrata e qirasë dhe kontestoi shumën e qirasë. Kryetari e rrëzoi kontestimin e kërkuetit sepse rregullat për emërimin e ndihmësgjyqtarëve në vetvete nuk përbënin bazë për një kontest të tillë. Në lidhje me fshirjen e klauzolës negociuese, Bordi i Shqyrtimit i rrëzoi pretendimet e kërkuetit. Vendimi i tij u referua deklaratave të ministrit kompetent gjatë shqyrtimit të Projektligjit për Negociimin e Qirasë në lidhje me diskrecionin që kishin bordet e shqyrtimit të qirave për të vendosur nëse klauzolat negociuese duhet të qëndronin.

Kërkuesi apeloj kundër këtij vendimi në Gjykatën e Banimit dhe Qiramarrjes, dhe gjithashtu kontestoi ndihmësgjyqtarët e kësaj Gjykate.

Gjykata e Banimit dhe Qiramarrjes që shqyrtoi apelin e kërkuetit përbëhej nga katër anëtarë, dy gjyqtarë të brendshëm dhe dy ndihmësgjyqtarë. Dy ndihmësgjyqtarët (ashtu si edhe ndihmësgjyqtarët e Bordit të Shqyrtimit të Qirave) ishin emëruar, respektivisht, nga Federata Suedeze e Pronarëve dhe Unioni Nacional i Qiramarrësve. Më 23 shkurt 1984, Gjykata e refuzoi kërkesën që kontestonte dy ndihmësgjyqtarët, duke deklaruar se rregullat e emërimit të tyre në vetvete nuk mund të përbënin baza të vlefshme për skualifikimin e tyre. Më 2 prill 1984, Gjykata e Banimit dhe Qiramarrjes rrëzoi pjesën e mbetur të apelit të kërkuetit dhe konfirmoi vendimin e Bordit të Shqyrtimit të Qirave. Ajo e shpalli këtë vendim me dyer të mbyllura, në mungesë të palëve, dhe pa zhvilluar seancë dëgjimore. Vendimi i saj qe përfundimtar.

## **2. Vendimi i Gjykatës**

Kërkuesi argumentoi që pretendimi i tij për qira të fiksuar dhe për mos-pasjen e klauzolës negociuese nuk ishte shqyrtuar nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme dhe kishte shkelur nenin 6. Më tej kërkuesi argumentoi shkelje të neneve 8, 11, 13 dhe nenit 1 të Protokollit nr. 1.

## Neni 6

Gjykata e kufizoi shqyrtimin e saj me Gjykatën e Banimit dhe Qiramarrjes meqenëse kjo Gjykatë ishte organi i fundit nacional që përcaktonte si çështjet e faktit ashtu edhe çështjet ligjore në mosmarrëveshje. Ajo theksoi se, megjithëse pavarësia dhe paanshmëria e gjyqtarëve profesionalë nuk viheshin në dyshim, qëndrimi i dy ndihmësgjyqtarëve mbetet të analizohej. Gjykata filloi duke deklaruar që, për të përcaktuar nëse një organ mund të konsiderohet “i pavarur”, duhet të merret parasysh, *inter alia*, mënyra e emërimit të anëtarëve të tij dhe kushtet e mandatit të tyre, ekzistenca e garancive kundër presioneve të jashtme, dhe nëse organi paraqet dukjen e pavarësisë. Sa i përket pavarësisë, duhet të bëhet dallimi mes një testi subjektiv, që kërkon të përcaktojë bindjen personale të një gjyqtari të dhënë në një çështje të dhënë, dhe një testi objektiv, që kërkon të sigurojë nëse një gjyqtar ka ofruar garanci të mjaftueshme për të përjashtuar çdo dyshim legjitim në këtë aspekt.

Megjithëse ndihmësgjyqtarët dukeshin, në parim, jashtëzakonisht të kualifikuar për të marrë pjesë në gjykimin e mosmarrëveshjeve mes pronarëve dhe qiramarrësve dhe çështjeve specifike që mund të dalin nga mosmarrëveshje të tilla, kjo nuk e përjashtonte mundësinë që pavarësia dhe paanshmëria e tyre mund të linin vend për dyshime në çështje të caktuara. Megjithatë, në rastin konkret Gjykata deklaroi se nuk kishte arsye të dyshohej tek paanshmëria personale e ndihmësgjyqtarëve në mungesë të provave.

Sa i përket paanshmërisë së tyre objektive dhe pyetjes nëse ata paraqisnin dukjen e pavarësisë, sidoqoftë, Gjykata theksoi që ata ishin emëruar nga, dhe kishin lidhje të afërta me, dy shoqata ku të dyja kishin interes në ekzistencën e vazhdueshme të klauzolës negociuese. Gjykata gjeti që, meqë kërkuesi kërkonte fshirjen e kësaj klauzole nga kontrata e qirasë, ai mund të kishte frikë legjitime që ndihmësgjyqtarët kishin interes të përbashkët të kundërt me interesin e tij, dhe prandaj ekuilibri i interesave, i ngërthyer në përbërjen e Gjykatës së Banimit dhe Qiramarrjes në çështje të tjera, me gjasë do të lëkundej kur të vinte momenti që gjykata të vendoste në lidhje me pretendimin e tij. Fakti që Gjykata e Banimit dhe Qiramarrjes gjithashtu përfshinte dy gjyqtarë profesionalë, pavarësia dhe paanshmëria e të cilëve nuk vihej në pikëpyetje, nuk ndryshonte asgjë në këtë aspekt. Rrjedhimisht, Gjykata vendosi që kishte pasur shkelje të nenit 6.

## Nenet 8, 11, 13 dhe neni 1 i Protokollit nr.1

Kërkuesi argumentoi që pushteti, dhënë Unionit të Qiramarrësve, për të negociuar në emër të tij shumën e qirasë për apartamentin ku ai jetonte ishte shkelje e të drejtës

për respektim të “shtëpisë” së tij brenda kuptimit të nenit 8. Kërkuesi gjithashtu u ankua për shkelje të lirisë së organizimit e garantuar me nenin 11, mbi bazën e faktit që ai duhet të pranonte, kundër vullnetit të tij, shërbimet e Unionit të Qiramarrësve në negociata, shërbime për të cilat ai gjithashtu duhet të paguante. Gjykata vendosi që çështjet e ngritura sipas atyre titujve nuk hynin brenda fushëveprimit të neneve të bazuara. Argumenti i kërkuesit që detyrimi ligjor për t’i dhënë kontribute financiare Unionit të Qiramarrësve përfshinte privim të posedimeve në kundërshtim me nenin 1 të Protokollit nr. 1 u rrëzua. Në fund, sa u përket shkeljeve të pretenduara të nenit 6, Gjykata nuk e gjeti të nevojshëm argumentin e kërkuesit sipas nenit 13 që ai nuk kishte pasur zgjidhje efektive kundër shkeljeve të shumta të Konventës për të cilat ai u ankua.

#### Neni 50 (tani neni 41)

Gjykata i caktoi kërkuesit shumën totale 63,475 korona suedeze (afro 6,290 euro) në lidhje me kosto dhe shpenzime.

*Pjesëmarrja e Presidentit francez si palë civile në gjyqin penal të kërkuarit nuk shkeli parimet e barazisë së armëve ose të pavarësisë dhe paanshmërisë sipas nenit 6 § 1*

## VENDIMI NË ÇËSHTJEN THIAM K. FRANCËS

---

(Kërkesa nr. 80018/12)  
**18 tetor 2018**

### 1. Faktet kryesore

Kërkuesi ishte i lindur në vitin 1978 dhe jetonte në Limay.

Banka Société Générale depozitoi një padi penale kundër personave të panjohur në shtator 2008 për falsifikim, duke cekur dokumente të falsifikuara, dhe mashtrim, në vijim të ankesave të bëra nga z. Sarkozy, Presidenti i atëhershëm i Republikës (prej këtu 'Presidenti'), në lidhje me një pagesë mashtruese për telefona celularë nga llogaria e tij. Prokurori publik hapi hetime penale për mashtrim në tetor 2008 në lidhje me një bandë të organizuar, ku gjatë këtyre hetimeve Presidenti bëri kërkesë që t'i bashkohej procedurës si palë civile.

Kërkuesi dhe gjashtë persona të tjerë u akuzuan për pajisjen me telefona celularë dhe pagimin e abonimeve duke përdorur informacionin bankar të një pale të tretë, dhe pas kësaj u caktua gjyqi në qershor 2009. Para se të fillonte gjyqi, kërkuesi u ankua pa sukses për kërkesën e Presidentit për t'iu bashkuar procedurave si palë civile. Kërkuesi u shpall fajtor dhe u dënua me një vit burgim, por gjykata e shtyu afatin e vendimit të saj mbi bazën e pretendimit të Presidentit për dëmshpërblim. Në janar 2010, Gjykata e Apelit e Versajës e ndryshoi dënimin në tetë muaj burgim, dhe e urdhëroi kërkuesin t'i paguante Presidentit kompensim në shumën 1 euro dhe shpenzimet e gjykatës.

Kërkuesi apeloj dhe kërkoi që Gjykata e Kasacionit të referonte një vendim paraprak mbi kushtetutshmërinë (*question prioritaire de constitutionnalité* – QPC) tek Këshilli Kushtetues në lidhje me ndarjen e pushteteve, të drejtat e mbrojtjes, dhe të drejtën për gjyq të drejtë. Gjykata e Kasacionit refuzoi ta referonte tek QPC-ja dhe gjeti që Presidenti kishte pasur të drejtën për t'iu bashkuar procedurave si palë civile gjatë mandatit të tij, por e riktheu çështjen pjesërisht për shkak të dështimit që të merrte në konsideratë dënimin me kusht. Gjykata e Apelit e Versajës e ndryshoi dënimin e kërkuesit në dhjetë muaj burgim me kusht.

## 2. Vendimi i Gjykatës

Kërkuesi u ankua se dalja e Presidentit të Republikës si palë civile në procedura penale shkelte parimin e barazisë së armëve dhe shkelte të drejtën e tij për të pasur qasje në një gjykatë të pavarur dhe të paanshme brenda kuptimit të nenit 6 §§ 1 dhe 3 (d) të Konventës.

### Neni 6 §§ 1 dhe 3 (d)

Gjykata theksoi që zgjedhja e legjislativit francez për të lejuar Presidentin që të vepronte në procedura penale si palë civile gjatë mandatit të tij në detyrë nuk mund të ishte objekt i shqyrtimit të mosmarrëveshjes përpara Gjykatës. Ndërkohë që koncepti i ndarjes së pushteteve mes ekzekutivit dhe gjyqësorit është i rëndësishë gjithnjë e më të madhe në jurisprudencën e saj, as neni 6 e as ndonjë dispozitë tjetër e Konventës nuk i kërkojnë Shteteve që të miratojnë ndonjë model të posaçëm kushtetues të ndërveprimit mes pushteteve.

Për sa i përket parimit të barazisë së armëve, kërkuesi u ankua për përfshirjen e Presidentit në çështjen e tij për mosbalancin e krijuar nga neni 67 i Kushtetutës i cili parashikonte mbrojtje për Presidentin nga paditë kundër përdorimit të paduhur të ndërhyrjes së tij si palë civile. Megjithatë, Gjykata e Kasacionit konsideroi që kërkuesi nuk do të kishte mundur të niste padi të tilla ligjore sidoqoftë, meqenëse atij nuk i ishte dhënë mosvazhdim apo shfajësim, dhe Presidenti nuk e kishte nisur vetë ndjekjen penale. Duke pasur parasysh këtë gjetje, Gjykata konsideroi që ndërhyrja e Presidentit në procedurat e kërkuesit nuk ia kishte mohuar këtij të *fundit trajtimin e barabartë*.

Sipas Kushtetutës, Presidenti nuk mund të detyrohet të paraqitet si dëshmitar. Kërkuesi pretendoi që, në mënyrë që gjyqi i tij të ishte i drejtë, do të duhej të kishte pasur mundësi për ballafaqim të drejtpërdrejtë me Presidentin gjatë procedurave verbale. Megjithatë, mungesa e Presidentit në gjyq nuk përbëri shkelje të nenit 6, meqenëse ajo ishte e mbështetur mbi një bazë të fortë ligjore për mbrojtjen e detyrës së Kreut të Shtetit që parashikohet nga Kushtetuta. Për më tepër, vendimet e gjykatave vendase nuk i ishin referuar ndonjë prove inkriminuese vendimtare të dhënë nga Presidenti, çka do të kishte kërkuar marrjen e tij në pyetje në seancë dëgjimore për qëllime kredibiliteti dhe besueshmërie.

Në fund, nuk kishte tregues nga dosja e lëndës që Presidenti kishte inkurajuar prokurorinë publike që të vepronte në mënyrë të atillë që do të kishte pasur ndikim të paduhur mbi gjykatën penale. Po kështu, nuk kishte prova që kërkuesit i ishte

mohuar pjesëmarrja në procedura që respektonin parimin e kontradiktoritetit.

Duke pasur parasysh konsideratat e mësipërme, Gjykata arriti në përfundimin se ndërhyrja e Presidentit në procedura penale si palë civile nuk kishte pasur efektin konkret të krijimit të çekuilibrit në të drejtat e palëve. Rrjedhimisht, nuk kishte pasur shkelje të nenit 6 § 1 në lidhje me parimin e barazisë së armëve.

Për sa i përket pretendimit të kërkuarit në lidhje me mungesën e paanshmërisë së gjykatës, ishte me rëndësi të shënohej që fajësia e kërkuarit ishte konstatuar nga prova të cilat ishin të ndara prej padisë civile të Presidentit. Është domethënëse që kërkuari nuk kishte pretenduar që Gjykata e Kasacionit kishte vepruar sipas udhëzimeve të Presidentit apo që kishte shfaqur ndonjë formë njëanshmërie. Prandaj, nuk kishte asgjë që sugjeronte se gjyqi i kërkuarit nuk kishte qenë i paanshëm.

Më tej, në lidhje me të drejtën e kërkuarit për tribunal të pavarur, Gjykata përsëriti që dukja e pavarësisë është element i rëndësishëm i kësaj të drejte. Si pasojë, e drejta e një kërkuari/eje për gjykatë të pavarur do të minohej nëqoftëse frika e tij/saj në lidhje me këtë aspekt do të justifikohej në mënyrë objektive. Megjithatë, ajo konsideroi që kushtet e detyrës së gjyqtarëve dhe ekzistenca e mbrojtjes kundër presionit të jashtëm në rastin konkret, garantonte pavarësinë funksionale të gjykatave nacionale prej ekzekutivit. Siç u theksua nga Gjykata e Kasacionit, gjyqtarët nuk ishin mvartës të Ministrisë së Drejtësisë e prandaj nuk i nënshtroheshin presionit gjatë ushtrimit të detyrave të tyre. Më tej, në Francë siguria e mandatit të vazhdueshëm gjyqësor ishte e garantuar me Kushtetutë dhe ishte e shoqëruar me rregulla për avancimin dhe disiplinën.

Gjykata theksoi që thjesht emërimi i gjyqtarëve nga Presidenti nuk nënkuptonte marrëdhënie varësie për sa kohë që, pas emërimit, ekzekutivi nuk mund të influenconte apo të ushtronte presion mbi gjyqësorin gjatë ushtrimit të rolit të tij. Në Francë, emërimet gjyqësore i nënshtroheshin miratimit nga Këshilli i Lartë i Magjistraturës (*conseil supérieur de la magistrature* – CSM) sipas nenit 65 të Kushtetutës. Pas emërimit të tyre, transferimet gjyqësore, promovimet, dhe ndryshimet e tjera të karrierës i nënshtroheshin ndërhyrjes së CSM-së pas procedurave me palë kundërshtare. CSM-ja gjithashtu ishte direkt përgjegjëse për çështjet disiplinore, dhe vendimet e saj në këtë aspekt ishin të karakterit juridik. Prandaj, firmosja nga Presidenti e emërimeve gjyqësore ishte thjesht formalitet dhe nuk minonte pavarësinë e gjyqtarëve në fjalë.

Kërkuari nuk kishte paraqitur prova konkrete për të treguar që ai kishte pasur frikën objektivist të justifikuar që gjyqtarët e gjykatave vendase ishin nën ndikimin e paduhur të Presidentit. Gjykata po ashtu shënoi që çështja në fjalë nuk kishte pasur

ndonjë lidhje me detyrat politike të Presidentit. Përveç kësaj, vendimi i Gjykatës së Kasacionit u shpall në një datë kur Presidenti nuk ishte më në krye të CSM-së; ku ky rol i ishte transferuar Kryetarit të Gjykatës së Kasacionit.

Ndërkohë që Gjykata e konsideroi të nevojshme të përsëriste që pjesëmarrja e një personaliteti të rangut të lartë, me rol institucional në zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve, si paditës në procedura mund të hedhë dyshime legjitime rreth pavarësisë dhe paanshmërisë së një tribunali, duke marrë parasysh konsideratat e mësipërme dhe objektin e mosmarrëveshjes, nuk kishte arsye të sugjerohej që gjykata nuk ishte e pavarur në këtë rast. Rrjedhimisht, nuk kishte pasur shkelje të nenit 6 § 1 në lidhje me të drejtën e kërkuarit për tribunal të pavarur dhe të paanshëm.

## (5) Pavarësia – Garancitë kundër Presioneve të Jashtme

---

*Pavarësisht nga interesi i madh i medias në çështjen e kërkuarit nuk pati asgjë që të sugjeronte se kjo kishte ndikuar tek gjyqtarët për vendimin e tyre – nuk ka shkelje të nenit 6 mbi këtë bazë*

### VENDIMI NË ÇËSHTJEN CRAXI K. ITALISË

---

(Kërkesa nr. 34896/97)  
**5 dhjetor 2002**

#### 1. Faktet kryesore

Benedetto Craxi ishte shtetas italian i lindur në vitin 1934. I njohur më shumë me emrin Bettino Craxi, para vdekjes së tij në janar 2000 ai kishte shërbyer si Sekretar i Partisë Socialiste të Italisë dhe Kryeministër i Italisë. E veja dhe dy fëmijët e tij deklaruan që, si trashëgimtarë të tij, donin ta vazhdonin procedurën në vend të kërkuarit.

Kundër kërkuarit u hapën procedura penale pasi u zbuluan parregullsi serioze në negociatat lidhur me një marrëveshje mes grupeve Eni dhe Montedison për të formuar kompaninë Enimont. Në vitin 1992, kërkuari dhe shumë të tjerë u akuzuan për mbajtje të llogarive të rreme, financim të paligjshëm të partive politike, korrupsion, zhvatje dhe manipulim, ku të gjitha veprat ishin kryer pikërisht në kohën e shitjes së aksioneve të Montedison tek Enimont. Në tërësi, kundër tij u lëshuan 26 nota të qëllimit për të hapur procedura penale. Procedurat penale kundër kërkuarit dhe figurave të tjera politike, ekonomike dhe pjesëtarëve të institucioneve u raportuan nga shtypi.

Kërkuarit iu caktua gjyqi në Gjykatën e Rrethit të Milanos në gjashtë grupe të procedurave. Ai u shpall fajtor në të gjitha çështjet përveç njëjës, dhe u dënua me burgim deri në tetë vjet e gjysmë.

Në njëjës prej gjashtë çështjeve, çështja Eni-Sai, kërkuari u ndoq penalisht për korrupsion. Ai u akuzua se kishte ndikuar dhe ndihmuar një sipërmarrje të përbashkët të planifikuar mes tri kompanive që i përkisnin sektorit të sigurimeve. U pretendua se ai dhe disa prej të bashkëpunuarve u kishin paguar ilegalisht shuma të mëdha zyrtarëve publikë dhe drejtorëve të kompanive të lartpërmendura.



Sipas avokatëve të tij, kërkuesi nuk mori pjesë në seancën e parë të kësaj çështjeje për shkak të shëndetit të dobët dhe rrezikut ndaj sigurisë së tij personale. Ai nuk mori pjesë në asnjërën prej 55 seancave të tjera dëgjimore sepse shkoi për të jetuar në Tunizi në maj të vitit 1994. Gjatë gjyqit disa prej të bashkakuarve të tij deklaruan se dëshironin të qëndronin në heshtje, kështu që deklaratat e tyre u bashkangjitën si shtojca në dosjen e lëndës. Të pandehurit e tjerë në procedura të ndërlidhura u morën në pyetje në gjyq, dhe procesverbali i pyetje-përgjigjeve po ashtu iu bashkangjit dosjes së lëndës.

Në një vendim të 6 dhjetorit 1994, kërkuesi u dënua *in absentia* me pesë vjet e gjysmë burgim. Ai apeloi pa sukses kundër atij vendimi, duke kontestuar në mënyrë të veçantë përdorimin e procesverbaleve të deklaratave nga dëshmitarë të cilët ai nuk kishte mundur t'i merrte në kundërpjetje. Gjykata e Kasacionit gjithashtu rrëzoi një apel nga kërkuesi për një vendim të 12 nëntorit 1996, ku thuhej se dënimi i tij nuk ishte bazuar ekskluzivisht mbi ato deklaratat meqenëse ato ishin vërtetuar nga prova të dëshmitarëve.

## 2. Vendimi i Gjykatës

Duke u mbështetur në nenin 6, kërkuesi u ankuu për padrejtësinë e procedurave penale kundër tij. Ai parashtroi sipas nenit 6 § 1 dhe 3 (b) që ai nuk kishte pasur kohën dhe pajisjet e duhura për të përgatitur mbrojtjen e tij dhe, sipas nenit 6 § 1 dhe 3 (d), që ai nuk kishte pasur mundësi të merrte në pyetje, ose të merreshin në kundërpjetje, dëshmitarët e akuzës. Më tej ai pretendoi që sipas nenit 6 § 1 fushata e zhvilluar në shtyp kundër tij kishte ndikuar tek gjyqtarët që kishin vendosur për akuzat kundër tij.

### Neni 6 §§ 1 dhe 3 (b)

Kërkesa e tanishme ishte deklaruar e pranueshme vetëm për sa i përket padrejtësisë së pretenduar të procedurave në çështjen Eni-Sai, kështu që Gjykata e kufizoi shqyrtimin e saj vetëm në këtë pikë.

Nga 18 tetori 1994 deri në marrjen e vendimit mbi themelet më 6 dhjetor 1994, seancat dëgjimore ishin caktuar sipas një orari me të cilin kishin rënë dakord avokatët e kërkuesit. Prandaj kërkuesi nuk mund të ankohej për procedura që ishin caktuar me pajtimin e avokatëve të tij. Sa i përket periudhës para 18 tetorit 1994, Gjykata theksoi se në çështjen Eni-Sai ishin mbajtur 38 seanca dëgjimore, në të njëjtën kohë ose rreth të njëjtës kohë me shumë seanca të tjera në çështjet e tjera për të cilat kërkuesi po ndiqej penalisht.

Kërkuesi, i cili nuk kishte marrë pjesë në seancën e parë dëgjimore, ishte larguar nga Italia me vendim të vet dhe ishte vendosur në Tunizi, dhe lirisht kishte zgjedhur të mos paraqitej në gjykatë. Mbrojtja e kërkuesit më pas ishte zhvilluar me anë të avokatëve të cilët kishin marrë pjesë në një numër të madh seancash brenda një harku të shkurtër kohor. Megjithatë, nga provat që Gjykata kishte përpara nuk dukej se prezantimi i çështjes nga ana e tyre kishte qenë i mangët apo joefektiv. Për më tepër, avokatët e kërkuesit nuk i kishin dhënë Gjykatës ndonjë shpjegim relevant lidhur me arsyen përse, deri më 9 nëntor 1994, ata nuk kishin tërhequr vëmendjen e autoriteteve për problemet që kishin hasur gjatë përgatitjes së mbrojtjes së tij. Rrjedhimisht, Gjykata vendosi që nuk kishte pasur shkelje të nenit 6 sipas atij titulli.

#### Neni 6 §§ 1 dhe 3 (d)

Kodi i Procedurës Penale parashikonte mundësinë, gjatë përcaktimit të themeleve të një akuze, për të përdorur deklaratat e dhëna para gjyqit nga të bashkëpandehurit të cilët më tej kishin ushtruar të drejtën e tyre për të qëndruar në heshtje, ose nga persona të cilët kishin vdekur para se të kishin mundësinë për të dhënë dëshmi në gjykatë. Megjithatë, ai fakt nuk e privonte një të akuzuar nga e drejta për të shqyrtuar çdo provë materiale kundër tij në procedura që respektojnë parimin e kontradiktoritetit. Në rastin konkret, dukej nga vendimi i Gjykatës së Kasacionit të 12 nëntorit 1996 se kërkuesi ishte shpallur fajtor vetëm mbi bazën e deklaratave të dhëna përpara fillimit të seancave gjyqësore nga të pandehur të tjerë të cilët kishin zgjedhur që të mos jepnin dëshmi në gjykatë dhe nga një person që kishte vdekur më pas. Kërkuesi dhe avokatët e tij nuk kishin pasur mundësi të merrnin në kundërpjetje ata dëshmitarë e rrjedhimisht nuk kishin qenë në gjendje të kontestojnë deklaratat që kishin formuar bazën ligjore për shpalljen fajtor të kërkuesit.

Në lidhje me këtë, Gjykata shënoi që avokatët e kërkuesit nuk kishin ngritur ndonjë kundërshtim në Gjykatën e Rrethit të Milanos për të kontestuar ligjshmërinë apo këshillueshmërinë e bashkangjittjes së deklaratave në dosjen e lëndës. Megjithatë, duke qenë se deklaratat ishin bashkangjitur në dosje në përputhje me ligjet vendase në fuqi në kohën materiale, Gjykata konsideroi se çdo kundërshtim do të kishte pasur pak gjasa suksesi dhe që mos-ngritja e një kundërshtimi të tillë nuk mund të shihej si heqje dorë në heshtje nga e drejta për të marrë në kundërpjetje dëshmitarët e akuzës, sidomos duke pasur parasysh që kërkuesi më pas e kishte ngritur çështjen në Gjykatën e Apelit dhe Gjykatën e Kasacionit. Rrjedhimisht Gjykata vendosi që kishte pasur shkelje të nenit 6 §§ 1 dhe 3 (d) sipas atij titulli.

### Neni 6 § 1

Gjykata më pas iu kthye pretendimeve të kërkuarit që mbulimi nga shtypi i çështjes së tij kishte ndikuar tek gjyqtarët në seancën e tij dëgjimore. U konfirmua që, sipas praktikës gjyqësore të Gjykatës, një fushatë mediale mund të minonte në disa raste drejtësinë e një gjyqi duke ndikuar në opinionin publik e rrjedhimisht edhe në opinionin e gjyqtarëve të ngarkuar me detyrën e përcaktimit të fajësisë së të akuzuarit. Megjithatë, u përsërit po ashtu që gjykatave nuk mund t'u kërkohej që të operojnë brenda një vakuumi dhe që publiku gjithashtu kishte të drejtë të merrte informacionet dhe idetë e komunikuar nga media, sidomos në çështje që përfshinin figura të njohura dhe politikanë. Pavarësisht nga rëndësia e kësaj të drejte, Gjykata bëri të qartë se e drejta për proces të drejtë ishte kaq thelbësore në një shoqëri demokratike saqë sipas dispozitave të nenit 6 Shtetet nuk mund të lejonin që komentet në media, me ose pa qëllim, të zvogëlonin shanset e një personi për proces të drejtë ose të minonin besimin e publikut tek gjykatat si organe me autoritet në administrimin e drejtësisë penale.

Në këtë rast, Gjykata vërejti që niveli i lartë i interesimit në media dhe në publik vinte nga posti i shquar politik i kërkuarit, konteksti politik në të cilin kishin ndodhur veprat e supozuara, si dhe nga natyra dhe pesha e atyre veprave. Sipas mendimit të Gjykatës, ishte e pashmangshme në një shoqëri demokratike që shtypi nganjëherë të bënte komente të ashpra në lidhje me çështje delikate si rasti në fjalë, i cili vinte në pikëpyetje moralin e zyrtarëve të lartë publikë dhe marrëdhëniet mes biznesit dhe politikës.

Gjykata më tej shënoi që gjykatat që ishin marrë me çështjen e kërkuarit kishin qenë të përbëra ekskluzivisht nga gjyqtarë profesionistë, e jo ndihmësgjyqtarë që ishin pjesëtarë të publikut. Këto gjyqtarë kishin përvojë dhe përgatitje të mjaftueshme profesionale për të shmangur ndikimet nga fushata mediale në lidhje me kërkuarin. Gjykata po ashtu theksoi se kërkuari ishte shpallur fajtor pas procedurave që respektonin parimin e kontradiktoritetit, ku kërkuari i kishte pasur të gjitha mundësitë për të sjellë para gjykatës vendase çdo argument që mendonte se mund ta ndihmonte pozicionin e tij.

Pa dyshim, Gjykata kishte gjetur shkelje të kriterit të procesit të drejtë në këtë çështje, por ajo kishte rezultuar prej zbatimit nga gjyqtari të dispozitave legjislative me fushëveprim të përgjithshëm dhe i zbatoheshin secilit. Prandaj, nuk kishte asgjë në çështjen në fjalë që sugjeronte se gjyqtarët ishin ndikuar nga deklaratat e bëra në shtyp. Rrjedhimisht, Gjykata vendosi që nuk kishte pasur shkelje të nenit 6 sipas atij titulli.

#### Neni 41

Gjykata vendosi që gjetja e një shkeljeje përbënte në vetvete shpërblim të drejtë të mjaftueshëm në këtë çështje dhe që, meqë kërkuesi nuk kishte paraqitur prova për kostot e tij, sipas atij titulli nuk do të caktohej pagesë.

*Shkarkimi i kërkuesit nga posti i kryetarit të një gjykate apeli shkeli nenin 6 § 1 sepse gjykata nuk arriti të siguronte shqyrtimin e pavarur dhe të paanshëm të çështjes së tij*

## VENDIMI I DHOMËS SË MADHE NË ÇËSHTJEN **DENISOV k. UKRAINËS**

(Kërkesa nr. 76639/11)

**25 shtator 2018**

### **1. Faktet kryesore**

Kërkuesi, z. Denisov, e filloi karrierën e tij gjyqësore në vitin 1976, kur u zgjodh për herë të parë në postin e gjyqtarit të një gjykate rrethi. Gjatë karrierës së tij gjyqësore kërkuesi mbajti postin e kryetarit në disa gjykata. Në dhjetor 2005 kërkuesi u zgjodh në postin e gjyqtarit të Gjykatës Administrative të Apelit të Kievit, dhe në shkurt 2009 u emërua kryetar i asaj gjykate nga Këshilli i Gjyqtarëve të Ukrainës (organ i vetqeverisjes gjyqësore). Ai u emërua me mandat pesë-vjeçar duke u kuptuar se ai do të arrinte moshën e pensionit në korrik 2013, para përfundimit të atij mandati.

Më 24 maj 2011, Këshilli i Gjyqtarëve të Gjykatës Administrative (një tjetër organ i vetqeverisjes gjyqësore), i kryesuar nga Gjyqtari K., bëri një parashtrësë pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë (“KLD”) duke propozuar shkarkimin e kërkuesit nga posti i kryetarit të Gjykatës Administrative të Apelit në Kiev për shkak të dështimit për të zhvilluar si duhej detyrat e tij administrative. Më 14 qeshor 2011, KLD shqyrtoi çështjen në mungesë të kërkuesit dhe vendosi ta shkarkonte atë nga posti i kryetarit të gjykatës. KLD deklaroi se “në organizimin e punës së Gjykatës Administrative të Apelit të Kievit ishin gjetur mangësi, mosveprime dhe gabime domethënëse, si dhe shkelje të rënda të themeleve të organizimit dhe administrimit të drejtësisë të parashikuara me ligj”. Ai tha se organizimi i papërshtatshëm i punës së gjykatës ishte shkaktuar nga kërkuesi.

Vendimi u votua nga KLD, ku anëtarët që ishin të pranishëm me atë rast përfshinin Gjyqtarin K., Prokurorin e Përgjithshëm dhe anëtarë të tjerë gjyqësorë dhe jo-gjyqësorë. Prej tetëmbëdhjetë anëtarëve të pranishëm, tetë ishin gjyqtarë. Pati katërmëdhjetë vota në favor të shkarkimit të kërkuesit. Sipas kërkuesit, përbërja e KLD-së në çështjen e tij përfshinte dy anëtarë të cilët më parë kishin nisur procedura për shkarkimin e tij nga posti i gjyqtarit për kinëse shkelje të betimit. Kërkuesi gjithashtu pretendoi se Kryetari i KLD-së dhe një anëtar tjetër i KLD-së kishin tentuar më parë – sadoqë pa sukses – që të ndikonin tek ai gjatë aktiviteteve të tij profesionale.

Më 23 qershor 2011, kërkuesi u shkarkua nga posti i tij administrativ, megjithëse vazhdoi të mbetej në detyrë si gjyqtar.

Kërkuesi e kontestoi vendimin e KLD-së para Gjykatës së Lartë Administrative (“GjLA”). Ai parashtroi se KLD kishte dështuar të vepronte në përputhje me kërkesat për një gjykatë të pavarur dhe të paanshme. Më tej kërkuesi argumentoi se e drejta e tij për të marrë pjesë në seancë dëgjimore nuk ishte garantuar, dhe se vendimi i KLD-së ishte i formuluar me fjalë të përgjithshme dhe nuk përmendte fakte specifike. Kërkuesi gjithashtu kërkoi kompensim për dëmet materiale të shkaktuara nga reduktimi i pagës së tij si rezultat.

Më 25 gusht 2011, GjLA zhvilloi një seancë dëgjimore në praninë e kërkuesit dhe vendosi ta rrezonte pretendimin e tij për dëme materiale pa e marrë në shqyrtim. Më 11 tetor 2011, GjLA refuzoi pretendimin e kërkuesit që shkarkimi i tij nga posti administrativ ishte i pavërtetuar. GjLA deklaroi se kërkuesi nuk i kishte kontestuar faktet që formonin bazën e shkarkimit të tij, dhe prandaj ato fakte ishin marrë si të konstatuara. GjLA arriti në përfundimin se vendimi i KLD-së kishte qenë i ligjshëm dhe se e drejta e kërkuesit për të marrë pjesë personalisht në procedurë nuk ishte shkelur sepse KLD i kishte marrë të gjitha masat e nevojshme për ta informuar atë rreth seancës dhe kërkuesi nuk kishte pasur arsye të vlefshme për mungesën e tij në seanca.

Pas shkarkimit nga posti i kryetarit të Gjykatës Administrative të Apelit në Kiev, kërkuesi vazhdoi të punonte si gjyqtar i rregullt në të njëjtën gjykatë deri më 20 qershor 2013, kur Parlamenti e shkarkoi nga posti i gjyqtarit pasi ai paraqiti dorëheqjen e tij.

## **2. Vendimi i Gjykatës**

Duke u mbështetur në nenet 6 § 1 dhe 8, kërkuesi u ankua se shkarkimi i tij nga posti i kryetarit nuk ishte bërë në përputhje me kriteret e pavarësisë dhe paanshmërisë, dhe përbënte ndërhyrje të paligjshme dhe joproporcionale në jetën e tij private.

### Neni 6 § 1

Kërkuesi u ankua sipas nenit 6 § 1 se procedurat para KLD-së dhe GjLA-së në lidhje me shkarkimin e tij nga posti i kryetarit të Gjykatës Administrative të Apelit në Kiev nuk kishin qenë në pajtueshmëri me kriteret e pavarësisë dhe paanshmërisë. Përveç kësaj, ai u ankua se GjLA nuk e kishte shqyrtuar mjaftueshëm çështjen e tij, duke dëmtuar të drejtën e tij për qasje në gjykatë.

Gjykata së pari mori në shqyrtim pranueshmërinë e pretendimit. Qeveria kishte parashtruar se pjesa civile e nenit 6 nuk ishte e zbatueshme sepse në këtë çështje nuk bëhej fjalë për të drejta “civile”. U argumentua se mosmarrëveshja kishte qenë krejtësisht brenda sferës së të drejtës publike, dhe pretendimi i kërkuesit për dëme materiale bënte fjalë për një shumë të vogël, e cila nuk kishte përbërë disavantazh të madh për të.

Gjykata theksoi se fushëveprimi i konceptit “civil” tek neni 6 nuk kufizohej nga lënda e mosmarrëveshjes. Përkundrazi, ai mbulonte çështje të cilat fillimisht mund të mos duken se kanë të bëjnë me një të drejtë civile por që kanë pasojë të drejtpërdrejta dhe domethënëse mbi një të drejtë private materiale ose jomateriale që i përket një individ. Gjykata kujtoi prezumimin që neni 6 zbatohet në rastet e “mosmarrëveshjeve të rëndomta të punës” mes një shërbyesi civil dhe Shtetit, dhe që i takonte Qeverisë së paditur të tregonte se një shërbyes civil nuk ka pasur të drejtë për qasje në gjykatë sipas ligjeve vendase dhe që ky përjashtim i të drejtave nga neni 6 ka qenë i justifikuar.

Gjykata përsëriti se një mosmarrëveshje në të drejtën publike mund të fusë në lojë pjesën civile në qoftë se aspektet e të drejtës private mbizotërojnë ndaj atyre të së drejtës publike, sa u përket pasojave direkte për një të drejtë civile materiale ose jomateriale. Më tej, Gjykata zbatoi prezumimin e përgjithshëm që pasojë të tilla direkte për të drejtat civile ekzistojnë në “mosmarrëveshjet e rëndomta të punës” ku përfshihen anëtarë të shërbimit publik, përfshirë gjyqtarët. Ajo doli në përfundimin se kjo çështje kishte të bënte me një “mosmarrëveshje të rëndomtë pune” meqenëse ajo në thelb ndikonte tek (i) fushëveprimi i punës që kërkuesi duhet të kryente si punonjës, dhe (ii) paga si pjesë e punësimit të tij. Nuk kishte arsye të arrihej në përfundimin se nuk kishte element “civil” në mosmarrëveshjen e kërkuesit apo se një element i tillë nuk ishte aq domethënës sa të fuste në lojë pjesën “civile” të nenit 6. Rrjedhimisht kundërshtimi i Qeverisë në lidhje me zbatueshmërinë e nenit 6 § 1 u rrëzua.

Më tej, duke marrë në shqyrtim themelet e ankesës, Gjykata kujtoi që në vendimin e saj tek *Oleksandr Volkov k. Ukrainës*<sup>[40]</sup> ajo kishte analizuar të njëjtat organe dhe të njëjtin organizim kushtetues si në çështjen e tanishme, dhe kishte gjetur shkelje të nenit 6 § 1 të Konventës në lidhje me Z. Volkov i cili ishte shkarkuar prej postit të gjyqtarit në mënyrë të ngjashme. U theksua se çështja e kërkuesit të tanishëm ishte dëgjuar dhe vendosur nga tetëmbëdhjetë anëtarë të KLD-së, prej të cilëve vetëm tetë ishin gjyqtarë. Prandaj anëtarët jo-gjyqësorë përbënin

401 *Oleksandr Volkov k. Ukrainës*, vendimi i 9 janarit 2013, nr. 21722/11, (i përfshirë si përmbledhje në këtë publikim).

një shumicë e cila ishte në gjendje të vendoste rezultatin e procedurës. Më tej, Gjyqtari K., i cili ishte anëtar i KLD-së, fillimisht në cilësinë e kryetarit të Këshillit të Gjyqtarëve të Gjykatës Administrative, kishte luajtur rol në hetimet paraprake të çështjes së kërkuarit dhe në bërjen e propozimit para KLD-së për shkarkimin e tij, gjë që hidhte dyshime objektive mbi paanshmërinë e Gjyqtarit K. Prandaj, Gjykata arriti në përfundimin se procedurës para KLD-së i kishin munguar garancitë e pavarësisë dhe paanshmërisë duke pasur parasysh mangësitë strukturore dhe dukjen e njëanshmërisë personale.

Gjykata gjithashtu konsideroi nëse GjLA kishte ofruar shqyrtim të mjaftueshëm të apelit të kërkuarit. Në vendimin e saj, GjLA konsideroi se kërkuari nuk i kishte kontestuar faktet që formonin bazën për shkarkimin e tij dhe prandaj ato fakte ishin marrë si të konstatuara. Gjykata konsideroi se ky përfundim ishte i papajtueshëm me bazat e pretendimit të kërkuarit para GjLA-së, ku ai qartazi i kontestoi ato fakte. Së dyti, GjLA nuk bëri asnjë përpjekje të vërtetë për të shqyrtuar një argument tjetër të rëndësishëm nga kërkuari ku pretendohet mungesa e pavarësisë dhe paanshmërisë në procedurën para KLD-së. GjLA arriti në një përfundim të përgjithshëm që KLD nuk kishte shkelur Kushtetutën e as ligjet e Ukrainës, por nuk dha arsye për ta mbështetur këtë. Prandaj, shqyrtimi i çështjes së kërkuarit nga GjLA-ja nuk kishte qenë i mjaftueshëm. Rrjedhimisht, Gjykata doli me përfundimin që KLD kishte dështuar të ofronte shqyrtimin e pavarur dhe të paanshëm të çështjes së kërkuarit, dhe shqyrtimi vijues i çështjes së tij nga GjLA-ja nuk i kishte rregulluar ato defekte. Prandaj, kishte pasur shkelje të nenit 6 § 1.

### Neni 8

Kërkuari u ankua se e drejta e tij për respektim të jetës private ishte shkelur me shkarkimin e tij nga posti i kryetarit të Gjykatës Administrative të Apelit në Kiev.

Gjykata theksoi se arsyet specifike për shkarkimin e kërkuarit nga posti i kryetarit të Gjykatës Administrative të Apelit në Kiev kishin të bënin ekskluzivisht me performancën e tij në sferën publike, pra me dështimet e tij të supozuara menaxheriale, të cilat u tha se kishin dëmtuar funksionimin e duhur të gjykatës. U theksua se ato arsye kishin lidhje vetëm me detyrat administrative të kërkuarit në vendin e punës dhe nuk kishin lidhje me jetën e tij private.

Më pas Gjykata konsideroi nëse shkarkimi kishte pasur pasoja negative për aspektet që përbënin "jetën private" të tij. U tha se shkarkimi nuk kishte rezultuar me heqjen e tij nga profesioni. Më tej, kërkuari nuk dha prova për të treguar se reduktimi vijues i pagës së tij mujore kishte ndikuar seriozisht në "qarkun e brendshëm" të



jetës së tij private. Më tej, reputacioni i tij profesional nuk ishte prekur sepse puna e tij si gjyqtar nuk u vu asnjëherë në pikëpyetje.

Prandaj, Gjykata arriti në përfundimin se shkarkimi kishte pasur efekte negative të kufizuara mbi jetën private të kërkuarit, dhe nuk e kishte kapërcyer pragun e seriozitetit deri aty sa të ngrihej një çështje sipas nenit 8. Prandaj, ankesa u deklarua e papranueshme.

#### Neni 1 i Protokollit nr. 1

Kërkuari u ankua për shkelje të të drejtave të tij materiale sipas nenit 1 të Protokollit nr. 1 sepse ai ishte përjashtuar nga marrja e një page më të lartë dhe pensioni më të lartë më vonë. Gjykata deklaroi se ky nen ka të bëjë vetëm me posedimet ekzistuese të një personi dhe nuk krijon të drejtën për të fituar pasuri. Prandaj, të hyrat e ardhshme nuk mund të konsiderohen se përbëjnë “pasuri” në qoftë se nuk janë fituar ende ose janë definitivisht të pagueshme. Prandaj, ankesa u deklarua e papranueshme.

#### Neni 41

Gjykata vendosi që Ukraina do t'i paguante kërkuarit 3,000 euro në lidhje me dëme jomateriale dhe 3,000 euro në lidhje me kosto dhe shpenzime.

*Mungesa e pavarësisë së gjykatës së shkallës së parë të përbërë nga një ndihmësgjyqtare shkeli nenin 6 § 1 të Konventës*

## VENDIMI NË ÇËSHTJEN HENRYK URBAN DHE RYSZARD URBAN k. POLONISË

---

(Kërkesa nr. 23614/08)  
**30 nëntor 2010**

### 1. Faktet kryesore

Kërkuesit ishin të lindur në vitet 1962 dhe 1960 respektivisht, dhe jetonin në Uherce Mineralne, Poloni. Më 2 tetor 2007 ata u dënuan nga Gjykata e Rrethit të Leskos për mos zbulimin e identitetit të tyre para policisë. Kërkuesit apeluan, duke kundërshtuar faktin që çështja e tyre ishte vendosur nga një 'ndihmësgjyqtare' e jo nga një gjyqtare.

Ligji i 27 korrikut 2001 mbi Organizimin e Gjykatave (prej këtu e tutje 'Akti i vitit 2001') parashtronte kriteret që duheshin plotësuar për të marrë detyrën e gjyqarit të një gjykate rrethi. Ndihmësgjyqtarët ishin kandidatë për gjyqtarë të gjykatës së rrethit të cilët, sipas 'Aktit të vitit 2001', duhet të punonin të paktën tre vjet si ndihmësgjyqtarë në një gjykatë rrethi pas përfundimit të trajnimit dhe provimeve të tyre.

Në kundërshtimin e tyre, kërkuesit u mbështetën fuqimisht mbi një vendim të Gjykatës Kushtetuese të 24 tetorit 2007 i cili kishte gjetur që mvëshja e ndihmësgjyqtarëve me fuqi gjyqësore nga Ministri i Drejtësisë ishte jokushtetuese sepse ndihmësgjyqtarët nuk gëzonin garancitë e nevojshme të pavarësisë që kërkoheshin prej gjyqtarëve. Pavarësisht nga kjo, më 10 dhjetor 2007 Gjykata Rajonale e Krosnos konfirmoi vendimin e Gjykatës së Rrethit. Zyra e ndihmësgjyqtarëve më vonë u mbyll krejtësisht dhe, në janar 2009, Parlamenti i Polonisë miratoi një ligj të ri për ngritjen e një institucioni gjithëpërfshirës dhe të centralizuar për trajnimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve.

### 2. Vendimi i Gjykatës

Duke u mbështetur në nenin 6 § 1 të Konventës, kërkuesit argumentuan që ata ishin privuar nga gjyqi i drejtë për shkak të mungesës së pavarësisë së gjykatës së shkallës së parë.

### Neni 6 § 1

Kërkuesit argumentuan që legjislacioni mbi statusin e ndihmësgjyqtarëve nuk e kishte përmbushur standardin një “gjykate të pavarur” të kërkuar nga neni 6. Gjykata nisi duke theksuar se në analizën e saj të çështjes së pavarësisë së ndihmësgjyqtarëve Gjykata Kushtetuese kishte nënvizuar që neni 45 i Kushtetutës së Polonisë ishte hartuar sipas modelit të nenit 6 § 1 të Konventës. Për Gjykatën kishte rëndësi që Gjykata Kushtetuese kishte gjetur se mënyra se si ishte hartuar legjislacioni mbi statusin e ndihmësgjyqtarëve në Poloni ishte e mangët, sepse i mungonin garancitë e pavarësisë të kërkuara nga neni 45 § 1 i Kushtetutës, garanci të cilat ishin substancialisht identike me ato të nenit 6 § 1 të Konventës. Kështu, duke pasur parasysh ngjashmërinë mes kritereve kushtetuese dhe atyre të Konventës në lidhje me pavarësinë gjyqësore, Gjykata vendosi që gjetjet e Gjykatës Kushtetuese ishin të zbatueshme në çështjen në fjalë.

Gjykata nënvizoi që Gjykata Kushtetuese kishte vënë mënjanë kornizën rregullatore që qeveriste institucionin e ndihmësgjyqtarëve ashtu siç ishte vendosur në Aktin e vitit 2001. Ajo theksoi, megjithatë, se Gjykata Kushtetuese nuk e përjashtoi mundësinë që ndihmësgjyqtarët apo zyrtarë të ngjashëm të ushtronin fuqi gjyqësore në qoftë se kishin garancitë e kërkuara të pavarësisë. Pikësynimi i Gjykatës në këtë çështje nuk ishte të vendoste *in abstracto* në lidhje me pajtueshmërinë me Konventën të institucionit të ndihmësgjyqtarëve por të shqyrtonte mënyrën se si Polonia e kishte rregulluar statusin e ndihmësgjyqtarëve. Në këtë pikë, Gjykata ritheksoi që kur përcaktohet nëse një organ mund të konsiderohet “i pavarur” duhet të merret parasysh, mes të tjerash, mënyra e emërimit të anëtarëve të tij dhe kohëzgjatja e mandatit të tyre, ekzistenca e garancive kundër presioneve të jashtme dhe çështja nëse organi paraqet dukjen e pavarësisë.

Arsyeja kryesore për gjetjen e Gjykatës Kushtetuese ishte e lidhur me pushtetin e Ministrisë për të hequr një ndihmësgjyqtare e cila ushtronte fuqi gjyqësore dhe me mungesën e mbrojtjeve të përshtatshme substanciale dhe procedurale kundër ushtrimit të diskrecionit në lidhje me atë fuqi. Ashtu si Gjykata Kushtetuese, Gjykata konsideroi që ndihmësgjyqtarës në çështjen e kërkuesve i kishte munguar pavarësia, meqenëse ajo mund të ishte shkarkuar nga Ministri i Drejtësisë kurdo gjatë mandatit të saj në detyrë, dhe që nuk kishte pasur garanci të mjaftueshme për ta mbrojtur atë nga ushtrimi në mënyrë arbitrare i asaj fuqie nga Ministri.

Gjykata gjeti që këto dështime nuk ishin korrigjuar gjatë apelit pranë Gjykatës Rajonale. Në çështjen e kërkuesve, Gjykata Rajonale nuk e kishte pushtetin që ta prishte vendimin duke u bazuar në faktin që Gjykata e Rrethit kishte qenë e

përbërë nga ndihmësgjyqtarja, meqenëse ndihmësgjyqtarët me fuqi gjyqësore ishin të autorizuar të dëgjonin çështje në gjykatat e shkallës së parë. Kështu që Gjykata Rajonale e rrëzoi si të pabazuar çështjen e mungesës së pavarësisë së ndihmësgjyqtares. Prandaj, Gjykata vendosi që Gjykata e Rrethit e Leskos nuk kishte qenë e pavarur, në shkelje të nenit 6 § 1.

#### Neni 41

Gjykata vendosi që, në rrethanat e veçanta të çështjes, gjetja e një shkeljeje përbënte në vetvete shpërblim të drejtë të mjaftueshëm për çdo dëm jomaterial që mund mund të kishin pësuar kërkuesit.

Duke pasur parasysh parimin e sigurisë ligjore, Gjykata u shpreh se nuk kishte bazë mbi të cilën asaj i kërkohej të drejtonte rihapjen e vendimeve përfundimtare të marra nga ndihmësgjyqtarët në periudhën kur mënyra e dhënies së fuqive gjyqësore atyre nuk ishte vënë në pyetje nga aspekti i kushtetueshmërisë. Megjithëse papajtueshmëria kushtetuese e identifikuar në vendimin e saj kërkoi ndërhyrje legjislative për ta sjellë statusin e ndihmësgjyqtarëve në përputhshmëri me Kushtetutën, nuk kishte ndërlidhje automatike mes asaj papajtueshmërie dhe vlefshmërisë së çdo vendimi të marrë më parë nga ndihmësgjyqtarët në çështje individuale. Për më tepër, Gjykata theksoi se autoritetet vendase kishin zbatuar vendimin e Gjykatës Kushtetuese për shfuqizimin e dispozitës jokushtetuese tetëmbëdhjetë muaj pas shpalljes së vendimit të saj. Kështu, Gjykata vendosi që papajtueshmëria kushtetuese dhe e Konventës në lidhje me statusin e ndihmësgjyqtarësve ishte korrigjuar nga autoritetet vendase brenda kornizës së përcaktuar kohore. Në fund, meqenëse kërkuesit nuk kishin paraqitur prova në lidhje me pretendimin e tyre për kosto, një shpërblim i tillë nuk u dha.

*Nuk kishte arsye për të vënë në pikëpyetje pavarësinë e anëtarëve ndërkombëtarë të Gjykatës së Bosnje dhe Hercegovinës, gjë që i bëri ankesat në lidhje me nenin 6 të papranueshme, megjithatë zbatimi prapaveprues i Kodit Penal të vitit 2003 ndaj dy kriminelëve të luftës shkeli nenin 7*

## VENDIMI I DHOMËS SË MADHE NË ÇËSHTJEN **MAKTOUF DHE DAMJANOVIĆ k. BOSNJE DHE HERCEGOVINËS**

---

(Kërkesat nr. 2312/08 dhe nr. 34179/08)

**18 korrik 2013**

### **1. Faktet kryesore**

Kërkuesi i parë, Abduladhim Maktouf, ishte shtetas irakian i lindur në vitin 1959, dhe kërkuesi i dytë, Goran Damjanović, ishte shtetas i Bosnje dhe Hercegovinës i lindur në vitin 1966. Të dy kërkuesit u shpallën fajtorë nga Gjykata e Bosnje dhe Hercegovinës (“Gjykata e Shtetit”) për krime lufte të kryera kundër civilëve gjatë luftës së viteve 1992-1995.

Kërkuesi i parë ndihmoi në rrëmbimin e dy civilëve në vitin 1993 në Travnik për t’i shkëmbyer ata me anëtarë të forcave të ARBH-së (kryesisht të përbëra nga boshnjakë) të cilët ishin kapur nga forcat e HVO-së (kryesisht të përbëra nga kroatë). Më 1 korrik 2005, një dhomë gjyqi e Gjykatës së Shtetit e shpalli kërkuesin e parë fajtor për dhënien e ndihmës në marrjen e pengjeve (krim lufte) dhe e dënoi me pesë vjet burg sipas Kodit Penal të vitit 2003 të Bosnje dhe Hercegovinës (“Kodi Penal i vitit 2003”). Më 4 prill 2006, një dhomë apeli e Gjykatës së Shtetit e konfirmoi shpalljen fajtor dhe dënimin e tij pas një seance të re me pjesëmarrjen e dy gjyqtarëve ndërkombëtarë.

Kërkuesi i dytë pati rol të spikatur në rrahjen e boshnjakëve të kapur në Sarajevë në vitin 1992, për t’i ndëshkuar ata për shkak se kishin bërë rezistencë ndaj një sulmi serb. Më 18 qershor 2007, një dhomë gjyqi e Gjykatës së Shtetit e shpalli atë fajtor për torturë (krim lufte) dhe e dënoi me 11 vjet burg sipas Kodit Penal të vitit 2003. Më 18 nëntor 2007, një dhomë apeli e Gjykatës së Shtetit e konfirmoi atë vendim.

Ankesat kushtetuese të kërkuesve përfundimisht u refuzuan. Ankesa e kërkuesit të parë u rrëzua si e jashtëkohshme më 15 prill 2009. Çështja e kërkuesit të dytë rezultoi me një vendim më 23 qershor 2007 nga Gjykata Kushtetuese, e cila gjeti se asnjë prej të drejtave të z. Maktouf sipas Konventës nuk ishte shkelur.

## 2. Vendimi i Gjykatës

Duke u mbështetur në nenin 6 § 1 (e drejta për proces të drejtë), kërkuesi i parë pretendoi se procedura kundër tij kishte qenë e padrejtë, kryesisht sepse gjyqtarët ndërkombëtarë që kishin vendosur për çështjen e tij në apel nuk kishin qenë të pavarur. Duke u mbështetur në nenin 7 (nuk ka dënim pa ligj), të dy kërkuesit u ankuan që Gjykata e Shtetit kishte zbatuar ndaj tyre në mënyrë prapavepruese një ligj penal më të ashpër, Kodin Penal të vitit 2003, sesa ligji që kishte qenë i zbatueshëm në kohën e kryerjes prej tyre të veprave penale, pra Kodi Penal i Republikës Socialiste Federale të Jugosllavisë i vitit 1976 (“Kodi Penal i vitit 1976”). Më tej, duke u mbështetur në nenin 14 (ndalimi i diskriminimit) dhe nenin 1 të Protokollit nr. 12 (ndalimi i përgjithshëm i diskriminimit), ata gjithashtu u ankuan se ishin trajtuar ndryshe nga ata që ishin gjykuar para gjykatave të Entitetit, çka normalisht zbatohet në çështjet e krimeve të luftës sipas Kodit Penal të vitit 1976 dhe kishte dënime më të lehta sesa Gjykata e Shtetit.

Çështja iu kalua Dhomës së Madhe sipas nenit 30.

### Neni 6 § 1

Kërkuesi i parë e kontestoi pavarësinë e dy anëtarëve ndërkombëtarë të trupit gjykues meqenëse Zyra e Përfaqësuesit të Lartë i kishte emëruar ata për një periudhë të rinovueshme prej dy vitesh.

Gjykata filloi duke përsëritur faktorët që përdoren për të përcaktuar nëse një organ mund të përshkruhet si i pavarur, siç është mënyra e emërimit të anëtarëve të tij, kohëzgjatja e mandatit të tyre në detyrë, ekzistenca e garancive kundër presioneve të jashtme dhe çështja nëse organi paraqet dukjen e pavarësisë. U theksua se emërimi i gjyqtarëve nga ekzekutivi ose legjislativi është i lejueshëm, në qoftë se të emëruarit janë të çliruar nga ndikimet ose presionet gjatë kryerjes së rolit të tyre gjykues.

Sa u përket fakteve, Gjykata nuk gjeti arsye të vinte në pikëpyetje pavarësinë e anëtarëve ndërkombëtarë të Gjykatës së Shtetit nga Përfaqësuesi i Lartë. Emërimet e tyre ishin bërë mbi bazën e rekomandimeve nga figurat më të larta gjyqësore në Bosnje dhe Hercegovinë, dhe ata kishin të njëjtat detyra dhe përgjegjësi si anëtarët vendas pavarësia e të cilëve ishte e padiskutueshme. Më tej, fakti që gjyqtarët ndërkombëtarë ishin caktuar në mesin e gjyqtarëve profesionistë të vendeve të tyre përkatëse ishte garanci shtesë kundër presioneve të jashtme. Megjithatë mandati i tyre ishte relativisht i shkurtër, kjo ishte e kuptueshme në kontekstin e emërimit të tyre nga shtetet e veta dhe duke pasur parasysh karakterin e përkohshëm të pranisë ndërkombëtare në Gjykatën e Shtetit.

Kështu, nuk kishte arsye për të vënë në pikëpyetje gjetjen e Gjykatës Kushtetuese të Bosnje dhe Hercegovinës se Gjykata e Shtetit ishte e pavarur brenda kuptimit të nenit 6 § 1. Rrjedhimisht, ankesa u gjet se ishte dukshëm e pabazuar dhe u deklarua e papranueshme.

### Neni 7

Të dy kërkuesit u ankuan se ligji penal që u zbatua në çështjet e tyre, Kodi Penal i vitit 2003, ishte më i ashpër sesa ligji i zbatueshëm në kohën e kryerjes prej tyre të veprave penale, Kodi Penal i vitit 1976.

Gjykata i konsideroi të dy kornizat dënuese në lidhje me krimet e luftës që përmbaheshin në dy Kodet Penale. Gjykata e Shtetit e kishte dënuar kërkuesin e parë me pesë vjet burg, dënimi më i ulët i mundshëm sipas Kodit të vitit 2003. Nga ana tjetër, sipas Kodit të vitit 1976, ai mund të ishte dënuar me një vit burg. Kërkuesi i dytë ishte dënuar me 11 vjet burg, pak më shumë se minimumi prej dhjetë vjetësh. Sipas Kodit të vitit 1976, do të kishte qenë e mundur të caktohej një dënim prej vetëm pesë vjetësh. Kishte rëndësi të veçantë që Kodi i vitit 1976 ishte më i lehtë sa i përket dënimit minimal, sepse kërkuesi i parë kishte marrë dënimin më të ulët të parashikuar dhe kërkuesi i dytë kishte marrë një dënim që ishte pak më shumë se dënimi më i ulët i parashikuar. Gjykata e pranoi që dënimet e kërkuesve ishin brenda hapësirës si të Kodit Penal të vitit 1976 ashtu edhe të Kodit Penal të vitit 2003. Ndërkohë që nuk mund të thuhej me siguri, kërkuesit mund të kishin marrë dënime më të ulëta sikur të ishte zbatuar Kodi i vitit 1976. Rrjedhimisht, meqë ekzistonte mundësia reale që zbatimi prapaveprues i Kodit të vitit 2003 vepronte në disavantazh të kërkuesve në lidhje me dënimin, Gjykata gjeti që nuk mund të thuhej se atyre u ishin ofruar mbrojtje efektive kundër caktimit të një dënimi më të rëndë, në shkelje të nenit 7 § 2.

Më tej, Gjykata e refuzoi argumentin e Qeverisë që, në qoftë se një akt ishte kriminal duke pasur parasysh “parimet e përgjithshme të së drejtës të njohura nga kombet e qytetëruara” brenda kuptimit të nenit 7 § 2 në kohën e kryerjes, atëherë rregulla e mos-prapaveprimit të krimeve dhe ndëshkimeve nuk ishte e zbatueshme. Ky argument ishte në mospërputhje me qëllimin e hartuesve të Konventës, sepse neni 7 § 2 ishte përfshirë me qëllim që të siguronte se nuk kishte dyshime mbi vlefshmërinë e ndjekjes penale pas Luftës së Dytë Botërore në lidhje me krimet e kryera gjatë asaj lufte. Ishte e qartë sipas mendimit të Gjykatës se hartuesit e Konventës nuk kishin pasur për qëllim të lejonin përjashtime të përgjithshme nga rregulla e mos-prapaveprimit.

Rrjedhimisht, kishte pasur shkelje të nenit 7 në çështjet e të dy kërkuessve. Megjithatë, Gjykata theksoi se kjo nuk do të thoshte se duhet të ishin caktuar dënimet më të ulëta, por thjesht që duhet të ishin zbatuar dispozitat ndëshkuese të Kodit të vitit 1976.

#### Neni 14 së bashku me nenin 1 të Protokollit nr. 12

Gjykata i deklaroi të papranueshme ankesat e kërkuessve sipas nenit 14 dhe/ose nenit 1 të Protokollit nr. 12. Gjykata ishte në dijeni të faktit që gjykatat e Entitetit në përgjithësi jepnin dënime më të lehta sesa Gjykata e Shtetit në atë kohë. Megjithatë, ai trajtim nuk duhet të përshkruhej nga aspekti i karakteristikave personale (siç është kombësia, përkatësia fetare apo etnike) dhe prandaj nuk përbënte trajtim diskriminues.

#### Neni 41

Gjetja e një shkeljeje u deklarua se përbënte shpërblim të drejtë të mjaftueshëm për dëmet jomateriale të pësuar. Megjithatë, Gjykata e urdhëroi Bosnje dhe Hercegovinën t'i paguante secilit kërkuess 10,000 euro në lidhje me kosto dhe shpenzime.



*Procedura sekrete e lustracionit kundër kërkuesit u gjet se ishte procedurë penale, dhe fshehja e dokumenteve të rëndësishme nga kërkuesi gjatë procedurës për arsye konfidencialiteti u gjykua se ishte e padrejtë sipas nenit 6 § 1 së bashku me nenin 6 § 3*

## VENDIMI NË ÇËSHTJEN MATYJEK k. POLONISË

---

(Kërkesa nr. 38184/03)

**24 prill 2007**

### **1. Faktet kryesore**

Kërkuesi, Tadeusz Matyjek, shtetas polak, ishte i lindur në vitin 1935 dhe jetonte në Varshavë.

Çështja kishte të bënte me të ashtuquajturat “procedura lustracioni” në Poloni. Në vitin 1997, Ligji i Lustracionit në Poloni i detyroi personat që ushtronin funksione publike që të bënin të ditur nëse kishin punuar ose bashkëpunuar me shërbimin e sigurimit të Shtetit (“shërbimi sekret”) mes viteve 1944 dhe 1990. Kërkuesi, i cili kishte qenë deputet në parlamentin e Polonisë, deklaroi se ai nuk kishte bashkëpunuar me shërbimin sekret gjatë asaj periudhe. Pas kësaj, kundër kërkuesit u hap procedurë nga Komisioneri i Interesit Publik. Seancat u zhvilluan *in camera* në shtator dhe tetor 1999.

Më 17 dhjetor 1999, Gjykata e Apelit e Varshavës, duke u mbështetur mbi një opinion ekspert të përgatitur nga Departamenti i Kriminologjisë dhe Kimisë pranë Zyrës së Sigurimit të Shtetit, gjeti se kërkuesi kishte qenë bashkëpunëtor i vullnetshëm dhe i fshehtë i shërbimit sekret dhe se ai kishte gënjyer në deklaratën e tij të lustracionit. Kërkuesit iu paraqit pjesa operative e vendimit, ndërsa arsyetimi i vendimit u konsiderua “sekret”. Arsyetimi mund të konsultohet vetëm në “sekretarinë sekrete” të gjykatës.

Kërkuesi apeloj, duke pohuar se kontaktet e tij me Milicinë Civile dhe me një agjent të shërbimit sekret kishin qenë thjesht private dhe nuk kishin marrë asnjëherë formën e bashkëpunimit të ndërgjegjshëm. Ai gjithashtu kërkoi ekzaminimin e më shumë dëshmitarëve dhe kërkoi dhënien e një opinionit të pavarur nga një ekspert i cili nuk i përkiste asnjë agjencie të Zyrës së Sigurimit të Shtetit. Më 17 shkurt 2000 apeli i kërkuesit u rrëzua. Si përpara, kërkuesit nuk iu paraqit arsyetimi me shkrim për këtë rrëzim. Më pas Gjykata Supreme e prishi vendimin dhe gjeti mangësi të rënda procedurale për shkak se kërkesa e kërkuesit për të ftuar dy dëshmitarë të tjerë ishte shpërfillur.

Në dhjetor 2000, Kryetari i Zyrës së Sigurimit të Shtetit i hoqi kufizimet e konfidencialitetit nga dosja e kërkuesit.

Gjatë procedurave të mëtejshme, Gjykata e Apelit mori në pyetje dëshmitarët e emërtuar nga kërkuesi, mblodhi dokumentacione të reja në lidhje me kërkuesin nga Zyra e Sigurimit të Shtetit, zhvilloi një seancë publike dhe urdhëroi hartimin e një opinionit ekspert nga Instituti i Kriminologjisë pranë Universitetit të Varshavës. Megjithatë, pas një seance tjetër të mbajtur *in camera*, Gjykata e Apelit e Varshavës gjeti se kërkuesi kishte gënjyer në deklaratën e tij të lustracionit. Në maj 2003, Gjykata Supreme e rrëzoi përfundimisht apelin e kërkuesit në kasacion.

Sipas të drejtës vendase në fuqi në kohën relevante, vendimi i Gjykatës së Apelit i 17 shkurtit 2000 u konsiderua përfundimtar. Prandaj, duke nisur nga ajo datë kërkuesi u privua nga mandati i tij si deputet dhe u ndalua të garonte si kandidat në zgjedhje ose të mbante poste publike për 10 vitet e ardhshme.

## 2. Vendimi i Gjykatës

Duke u mbështetur në nenin 6 të Konventës, kërkuesi u ankua për padrejtësinë e procedurave të lustracionit kundër tij. Në mënyrë të veçantë ai iu referua natyrës së pabarabartë dhe sekrete të procedurave, konfidencialitetit të dokumenteve përkatëse dhe procedurave të padrejta për qasjen në dosje.

Në vendimin mbi pranueshmërinë të 30 majit 2006 Gjykata vendosi që neni 6 sipas titullit të tij penal ishte i zbatueshëm në procedurat e lustracionit.

### Neni 6 § 1 në lidhje me nenin 6 § 3

Gjykata pranoi se, në situata të caktuara, mund të ketë arsye imponuese për mbajtjen sekret të dokumenteve, madje edhe atyre të dala nga regjimi i kaluar. Pavarësisht nga kjo, një situatë e tillë mund të shfaqej në raste të pazakonta, dhe i takonte Qeverisë të vërtetonte ekzistencën e një interesi të tillë.

U theksua se të paktën një pjesë e dokumenteve në lidhje me lustracionin e kërkuesit ishin klasifikuar si “top secret”. Shërbimi i sigurimit kishte pasur fuqinë për ta hequr atë klasifikim sigurie, duke e bërë një gjë të tillë në dhjetor 2000 për disa materiale në dosje. Megjithatë, megjithëse kërkuesit i ishte lejuar qasja në dosjen e tij prej asaj date e tutje, ende kishte kufizime për dokumentet e shtuara më vonë në dosje.

U vu në dukje se në fazën para gjyqit, Komisioneri i Interesit Publik kishte pasur të drejtën e qasjes në të gjitha materialet rreth kërkesit që ishin mbledhur nga shërbimi i sigurimit të mëparshëm. Kur filloi gjyqi, kërkesit iu lejua qasja në dosjen e tij por dokumentet konfidenciale mund t'i shihte vetëm në “sekretarinë sekrete” të gjykatës. Të njëjtat kufizime identike iu vunë edhe avokatit të tij. U theksua se kërkesit i ishte dashur të përdorte vetëm kujtesën e vet dhe kjo ia kishte pamundësuar përdorimin efektiv të shënimeve ose dhënien e tyre një eksperti për opinion. Çka ishte më e rëndësishme, ai pretendoi se nuk ishte lejuar as t'i shfrytëzonte ato shënime për të mbrojtur veten gjatë gjyqit të tij, një akuzë që nuk u kontestua nga Qeveria.

Duke pasur parasysh se çka ishte në rrezik në procedurat e lustracionit – pra reputacioni i kërkesit, humbja e postit të deputetit në parlament, dhe ndalimi nga mbajtja e posteve publike për 10 vjet – Gjykata konsideroi se kishte qenë me rëndësi që ai të kishte pasur qasje të pakufizuar në dosjen e tij dhe të gjitha shënimet që kishte mbajtur, duke përfshirë, po qe nevoja, edhe mundësinë e bërjes së kopjeve të dokumenteve të rëndësishme.

Gjykata arriti në përfundimin se procedura e lustracionit kundër kërkesit, e marrë në tërësi, ishte e padrejtë sipas nenit 6 § 1 i marrë së bashku me nenin 6 § 3, dhe rrjedhimisht kishte pasur shkelje të atyre dispozitave.

#### Neni 41

Gjykata deklaroi se gjetja e një shkeljeje përbënte shpërblim të drejtë të mjaftueshëm për dëme jomateriale dhe i caktoi kërkesit 1,220 euro për kosto dhe shpenzime.

*Procedurat gjyqësore që çuan në shkarkimin e një gjyqtari të Gjykatës së Lartë nuk ishin të pavarura dhe të paanshme dhe shkelën nenet 6 dhe 8 të Konventës*

## VENDIMI NË ÇËSHTJEN OLEKSANDR VOLKOV k. UKRAINËS<sup>[402]</sup>

(Kërkesa nr. 21722/11)  
**9 janar 2013**

### 1. Faktet kryesore

Kërkuesi, z. Oleksandr Fedorovych Volkov, ishte zgjedhur në postin e gjyqtarit të Gjykatës Supreme të Ukrainës më 5 qershor të vitit 2003. Më 2 dhjetor 2005, ai u bë Zëvendëskryetar i Këshillit të Gjyqtarëve të Ukrainës, dhe më 30 mars u zgjodh Kryetar i Dhomës Ushtarake të Gjykatës Supreme.

Më 7 dhjetor 2007, kërkuesi u zgjodh anëtar i Këshillit të Lartë të Drejtësisë (“KLD”), por nuk e mori detyrën sepse nuk u lejua të bënte betimin për shkak të hetimeve paraprake që po kryheshin për sjellje të mundshme të papërshtatshme profesionale nga ana e tij.

Në dhjetor të vitit 2008 dhe mars të vitit 2009, përkatësisht, dy anëtarë të KLD-së, R.K. dhe V.K. (i cili u zgjodh kryetar i KLD-së në mars të vitit 2010), i paraqitën KLD-së kërkesa të veçanta për të përcaktuar nëse kërkuesi mund të shkarkohej nga posti i gjyqtarit për “shkelje të betimit”, me pretendimin se, në disa raste, kërkuesi kishte shqyrtuar vendime të dhëna nga Gjyqtari B., vëllai i së shoqes, dhe se kishte kryer një numër shkeljesh procedurale flagrante kur kishte trajtuar çështje gjyqësore që kishin të bënin me mosmarrëveshje korporatash, ku përfshihej një shoqëri tregtare me përgjegjësi të kufizuara.

Më 26 maj 2010, KLD-ja mori në konsideratë kërkesat e paraqitura nga R.K. dhe V.K. dhe miratoi dy vendime të cilat rezultuan në propozime nga KLD-ja para Parlamentit që kërkuesi të shkarkohej nga posti i tij si gjyqtar. Më 17 qershor 2010, pasi kishte marrë në konsideratë parashtrimet e KLD-së, si dhe rekomandimet e Komisionit parlamentar për Gjyqësorin (“Komisioni parlamentar”), Parlamenti votoi për shkarkimin e kërkuesit.

Kërkuesi e kundërshtoi këtë shkarkim përpara Gjykatës së Lartë Administrative (“GJLA”), e cila, sidoqoftë, vërejti se kërkesa e KLD-së për shkarkimin e tij, pas hetimit

402 Ky vendim është përfundimtar.

nga V.K., kishte qenë e ligjshme dhe e arsyetuar. Megjithatë, GjLA-ja gjithashtu gjeti se kërkesa për shkarkimin e kërkuetit pas hetimeve të R.K. kishte qenë e paligjshme sepse kërkueti dhe vëllai i gruas së tij nuk konsideroheshin të afërm sipas ligjeve në fuqi në atë kohë. Sidoqoftë, GjLA-ja refuzoi të anulonte veprimet e KLD-së, duke u shprehur se nuk ishte e autorizuar ta bënte këtë, në bazë të dispozitave në fuqi. Më tej, GjLA-ja vuri në dukje se nuk kishte pasur shkelje procedurale përpara Komisionit Parlamentar ose Parlamentit.

## 2. Vendimi i Gjykatës

Duke u mbështetur veçanërisht në nenin 6 § 1 (e drejta për proces të rregullt) dhe nenin 8 (e drejta për respektimin e jetës private dhe familjare) të Konventës, kërkueti u ankua se procesi gjyqësor kundër tij ishte i padrejtë dhe se shkarkimi i tij për shkelje të standardeve themelore të profesionit gjyqësor kishte çuar tek ndërhyrje në jetën e tij private dhe profesionale. Më tej, ai u ankua se nuk kishte asnjë zgjidhje efektive ligjore për shkarkimin e tij të paligjshëm, në kundërvajtje të nenit 13.

### Neni 6 § 1

Kërkueti paraqiti shtatë pretendime të ndryshme mbështetur në nenin 6 § 1 të Konventës. Ai u ankua se: (i) çështja e tij nuk ishte shqyrtuar nga një “gjykatë e pavarur dhe e paanshme”; (ii) procedurat përpara KLD-së kishte qenë të padrejta, pasi nuk ishin kryer në mbështetje të procedurës së parashikuar nga Kapitulli 4 i Aktit të KLD-së i vitit 1998 i cili ofronte një grup garancish të rëndësishme procedurale, përfshirë periudhat e parashkrimit për masat disiplinore; (iii) Parlamenti e kishte marrë vendimin për shkarkimin e tij në seancë plenare duke abuzuar me sistemin elektronik të votimit; (iv) çështja e tij nuk ishte gjykuar nga një “gjykatë e ngritur me ligj”; (v) vendimet në çështjen e tij ishin marrë pa një vlerësim të përshtatshëm të provave, dhe argumentet e rëndësishme që ishin ngritur nga mbrojtja nuk ishin trajtuar si duhet; (vi) mungesa e kompetencës së mjaftueshme nga ana e GjLA-së për të shqyrtuar aktet e miratuara nga KLD-ja shkonin në kundërshtim me të drejtën e tij për t’iu drejtuar gjykatës dhe (vii) parimi i barazisë së armëve nuk ishte respektuar.

Gjykata filloi duke shqyrtuar nëse mbrojtjet e nenit 6 zbatoheshin në çështjen e kërkuetit meqenëse në çështjet të mëhershme ajo kishte vendosur që mosmarrëveshjet e punësimit mes autoriteteve dhe shërbyesve civilë ishin të përjashtuara nga fushëveprimi i nenit 6 sepse nuk konsideroheshin mosmarrëveshje civile. Prandaj, Gjykata zbatoi testin e përcaktuar fillimisht tek *Vilho Eskelinen k. Finlandës*<sup>[403]</sup>: a

403 *Vilho Eskelinen k. Finlandës*, vendimi i Dhomës së Madhe i 19 prillit 2007, nr. 63235/00.

e kishte përjashtuar Shteti shprehimisht qasjen në gjykatë për mosmarrëveshje punësimi të lidhura me postin ose kategorinë e punonjësit në fjalë, dhe a ishte ky përjashtim i justifikuar mbi baza objektive në interes të Shtetit. Meqenëse çështja e kërkuarit ishte shqyrtuar nga dy organe gjyqësore, KLD dhe GjLA, ishte e qartë se e drejta vendase nuk e përjashtonte shprehimisht kërkuarin nga qasja në gjykatë për pretendimin e tij. Prandaj, neni 6 ishte i zbatueshëm sipas titullit të tij civil.

Sa u përket pyetjeve rreth “pavarësisë dhe paanshmërisë”, Gjykata gjeti se faktet e çështjes tregonin praninë e mangësive strukturore në procedurat para KLD-së si dhe praninë e njëanshmërisë personale në disa prej anëtarëve të tij. Sipas ligjeve në fuqi në atë kohë, stafi jo-gjyqësor, i emëruar direkt nga Qeveria dhe Parlamenti, kishin përbërë shumicën e gjerë të anëtarëve të KLD-së. Në mesin e 16 anëtarëve që kishin vendosur në çështjen e kërkuarit, vetëm tre prej tyre ishin gjyqtarë. Më tej, fakti që Ministri i Drejtësisë dhe Prokurori i Përgjithshëm ishin anëtarë ex officio të KLD-së – një organ i ngarkuar me emërimin, disiplinimin dhe shkarkimin e gjyqtarëve – kishte krijuar rrezikun që gjyqtarët, duke e perceptuar praninë e tyre si kërcënim potencial ndaj punësimit të tyre, nuk do të vepronin në mënyrë të paanshme duke cenuar nevojshmërinë e garantimit të pavarësisë gjyqësore. Gjykata po ashtu theksoi se anëtarët e KLD-së të cilët kishin kërkuar shkarkimin e kërkuarit më pas kishin marrë pjesë në vendimet për shkarkimin e tij nga detyra.

Duheshin marrë në konsideratë edhe akuzat e kërkuarit për njëanshmëri personale ndaj z. S.K., kryetar i Komisionit Parlamentar për gjyqësorin, i cili njëkohësisht vepronte si anëtar i KLD-së. z. S.K. kishte pasur rol në refuzimin për ta lejuar kërkuarin të bënte betimin si anëtar i KLD-së dhe kishte botuar një opinion në të cilin kundërshtonte me forcë veprimin e kërkuarit në një çështje gjyqësore ku ky kishte qenë paditës.

Mangësitë strukturore të procedurave ishin përforcuar në fazën parlamentare të procedurave duke qenë se dy anëtarët e KLD-së kishin qenë edhe anëtarë të Komisionit Parlamentar. Kjo vetëm kishte shërbyer për të kontribuar në politizimin e procedurës dhe për të cenuar parimin e ndarjes së pushteteve. Prandaj, mangësitë në paanshmëri lidhur me kryetarin e KLD-së ishin po ashtu relevante edhe në procedurat parlamentare. Në mbledhjen plenare të Parlamentit, çështja ishte prezantuar nga kryetari i Komisionit Parlamentar dhe nga kryetari i KLD-së, dhe procedura kishte konsistuar thjesht në shkëmbimin e mendimeve të përgjithshme.

Më tej Gjykata nuk u bind se procedura para GjLA-së kishte ofruar shqyrtim të mjaftueshëm të çështjes në fjalë. Ajo theksoi se nuk ishte e mundur që GjLA-ja të prishte formalisht një vendim të KLD-së ose të Parlamentit, edhe kur këto vendime

ishin shpallur të paligjshme. Më tej, Gjykata tha se mungonin rregullat e zhvillimit të procedurave disiplinore. Qeveria më tej konfirmoi se një deklaratë e GjLA-së nuk mund të shpinte automatikisht në rikthimin e një gjyqtari në detyrë. Po ashtu, disa argumente të rëndësishme të paraqitura nga kërkuesi, në mënyrë të veçantë pretendimet e tij në lidhje me paanshmërinë, nuk ishin adresuar si duhej nga GjLA-ja. Për më tepër, gjyqtarët e GjLA-së të cilët e kishin zhvilluar shqyrtimin gjyqësor ishin gjithashtu nën juridiksionin disiplinor të KLD-së dhe mund t'i ishin nënshtruar edhe vetë mbikqyrjes disiplinore prej tij. Meqë u vu në pikëpyetje pavarësia dhe paanshmëria e procedurave, Gjykata arriti në përfundimin se kishte pasur shkelje të nenit 6.

Më tej, Gjykata deklaroi se kishte pasur shkelje të tjera të nenit 6 në lidhje me parimin e sigurisë dhe finalitetit ligjor sepse ligji ukrainas në fuqi në atë kohë nuk parashikonte kufij kohorë në procedurat për shkarkimin e një gjyqtari për “shkelje të betimit”. Neni 6 gjithashtu ishte shkelur sepse shkarkimi i kërkuesit gjatë një mbledhjeje plenare të Parlamentit ishte miratuar duke shkelur procedurën parlamentare e rrjedhimisht të drejtën vendase dhe parimin e shtetit të së drejtës.

Lidhur me ankesën se GjLA-ja nuk kishte qenë “gjykatë e ngritur me ligj”, Gjykata theksoi se përbërja e trupit gjykues ishte vendosur nga një gjyqtar i cili, pavarësisht nga fakti se mandati i tij pesëvjeçar si kryetar i GjLA-së tashmë kishte përfunduar, vazhdonte të vepronte në këtë rol. Ky dështim për të emëruar një kryetar të ri kishte qenë për shkak të faktit se e drejta vendase sipas së cilës emëroheshin kryetarët e gjykatave ishte shpallur jokushtetuese dhe dispozitat e reja nuk ishin futur ende. Për pasojë, emërimet e tilla ishin bërë çështje polemikash serioze në mesin e autoriteteve ukrainase. Në këto rrethana, Gjykata nuk mundi të gjente se trupi që kishte vendosur për çështjen kishte qenë i përbërë në mënyrë të atillë që i përmbushte kriteret e një “gjykate të ngritur me ligj” dhe se prendaj kishte pasur shkelje të nenit 6.

Në lidhje me tri ankesat e mbetura, Gjykata gjeti se ato nuk ngrinin çështje të ndara dhe se nuk ishte e nevojshme të shqyrtoheshin sipas këtij titulli.

### Neni 8

Palët ranë dakord se kishte pasur ndërhyrje në të drejtën e kërkuesit për respektimin e jetës së tij private, dhe Gjykata nuk pa asnjë arsye për të vendosur ndryshe mqenëse jeta private përfshin të drejtën e individit që të krijojë dhe zhvillojë raporte me qenie të tjera njerëzore, përfshi raporte me natyrë profesionale ose biznesi. Konstatimi i gjykatës në kuadrin e nenit 6 se votimi parlamentar për vendimin e shkarkimit nga detyra të kërkuesit nuk kishte qenë i ligjshëm, sipas legjislacionit kombëtar, ishte i mjaftueshëm për të konstatuar se kishte pasur shkelje të nenit 8.

Edhe pse ky përfundim në vetvete do kishte qenë i mjaftueshëm, Gjykata e shqyrtoi më tej ankimin e kërkuarit dhe vërejti se në kohën kur ishte marrë vendim për çështjen e tij nuk kishte udhëzime apo praktika që vendosnin një interpretim të njëtrajtshëm të konceptit “shkelje e betimit” dhe nuk kishte garanci të mjaftueshme procedurale që të parandalonin zbatimin arbitrar të dispozitave përkatëse. Në mënyrë të veçantë, legjislacioni kombëtar nuk kishte të përcaktuar asnjë kufi kohor për procedurat kundër një gjyqtari në rastin e “shkeljes së betimit”, gjë që e u kishte dhënë organeve disiplinore diskrecion të pakufishëm dhe kishte cenuar parimin e sigurisë ligjore. Për më tepër, e drejta kombëtare nuk kishte përcaktuar një shkallë të përshtatshme sanksionesh për shkeljet disiplinore dhe nuk kishte hartuar rregulla që të siguronin zbatimin e tyre në përputhje me parimin e proporcionalitetit. Së fundi, Gjykata, bazuar në nenin 6, konstatoi se nuk kishte pasur një kuadër të përshtatshëm për gjykim të pavarur dhe të paanshëm në rastin e shkarkimit për “shkelje të vendimit”. Për pasojë, Gjykata vendosi se kishte pasur shkelje të nenit 8 të Konventës.

#### Neni 13

Duke pasur parasysh gjetjet në kuadrin e nenit 6, Gjykata vendosi se nuk ishte e nevojshme të shqyrtohej ankesa sipas nenit 13.

#### Neni 46

Gjykata deklaroi se kjo çështje zbulonte probleme themelore sistemike në sistemin ligjor ukrainas që rridhnin nga mosrespektimi i parimit të ndarjes së pushteteve nga ana e Shtetit dhe dështimi për të ofruar garanci të mjaftueshme kundër abuzimit dhe keqpërdorimit të masave disiplinore në dëm të pavarësisë gjyqësore. Për pasojë, Gjykata rekomandoi që Ukraina të ristrukturonte urgjentisht bazën institucionale të sistemit të saj ligjor me qëllim që të reformonte organizimin e disiplinës së saj gjyqësore, duke marrë një sërë masash të përgjithshme, përfshirë reforma legjislative.

Në përgjigje të pyetjes se cilat masa individuale do të ishin më të përshtatshme për t’iu dhënë fund shkeljeve në çështjen aktuale, Gjykata nuk e mori në konsideratë rihapjen e procedurave gjyqësore në vend si formë e duhur korrigjimi të shkeljeve të drejtave të kërkuarit, pasi nuk kishte arsye për të hamendësuar se çështja e tij do të rigjykohej në përputhje me nenin 6 në të ardhmen e afërt. Duke pasur parasysh rrethanat tejet të jashtëzakonshme të çështjes, Gjykata vendosi se Ukraina duhet t’i siguronte kërkuarit rikthimin në postin e gjyqtarit të Gjykatës Supreme në datën më të afërt të mundshme.



Neni 41

Gjykata i caktoi kërkuetit 6,000 euro për dëme jomateriale dhe 12,000 euro për kostot dhe shpenzimet si rrjedhojë e çështjes.

*Procedurat para Gjykatës Supreme në lidhje me procedimet disiplinore kundër një gjyqtari nuk shkelën kriterin e pavarësisë dhe paanshmërisë, megjithatë mangësitë në zhvillimin e procedurave përbënë shkelje të nenit 6*

## VENDIMI NË ÇËSHTJEN RAMOS NUNES DE CARVALHO E SÁ K. PORTUGALISË

---

(Kërkesat nr. 55391/13, nr. 57728/13 dhe nr. 74041/13)

**6 nëntor 2018**

### **1. Faktet kryesore**

Kërkuesja, Paula Cristina Ramos Nunes de Carvalho e Sá, ishte e lindur në vitin 1972. Në vitet 2010 dhe 2011 kundër saj nisën tri procedura disiplinore, ndërkohë që kërkuesja ishte gjyqtare në Gjykatën e Shkallës së Parë të Vila Nova de Famalicão: së pari, se kishte quajtur inspektorin gjyqësor përgjegjës për vlerësimin e performancës së saj “gënjeshhtar” gjatë një bisede telefonike dhe se e kishte akuzuar atë për “inerci dhe mungesë zelli”; së dyti, se kishte përdorur dëshmi të rreme në procedura të mëhershme; dhe së treti, se i kishte kërkuar hetuesit gjyqësor, në një bisedë private, që të mos ndërmernte veprime disiplinore kundër dëshmitarit në emër të saj i cili ishte ftuar gjatë procedurës së parë.

Mes viteve 2011 dhe 2012, Këshilli i Lartë i Gjyqësorit (prej këtu e tutje “KLGj”) që vendosi të tri procedurat, respektivisht e urdhëroi kërkuesen të paguante 20 ditë gjobë (20 ditë pa pagë) për veprime që vinin në kundërshtim me pozitën e saj si gjyqtare; e pezulloi atë nga detyra për 100 ditë për shkelje të detyrimit të saj për ndershmëri; dhe e pezulloi atë për 180 ditë për veprime në shkelje të detyrimeve të saj për besnikëri dhe jo në përputhje me funksionet gjyqësore. Në vitin 2013 Divizioni Gjyqësor i Gjykatës Supreme njëzëri rrëzoi tre apelet e bëra nga kërkuesja kundër vendimeve të KLGj-së pa mbajtur seancë dëgjimore. Gjykata Supreme gjeti, mes të tjerash, që detyra e saj nuk ishte të shqyrtonte faktet por vetëm të analizonte nëse konstatimi i fakteve kishte qenë i arsyeshëm dhe logjikisht i kuptueshëm. Në vitin 2014 KLGj-ja plenare i përmbodhi dënimet e dhëna në tre grupe procedurash disiplinore dhe caktoi një dënim të vetëm me 240 ditë pezullim për kërkuesen.

### **2. Vendimi i Gjykatës**

Duke u mbështetur në nenin 6, kërkuesja pretendoi shkelje të së drejtës së saj për gjykatë të pavarur dhe të paanshme, të drejtën e saj për shqyrtim të fakteve ashtu siç janë konstatuar nga KLGj-ja, dhe të drejtën e saj për seancë dëgjimore publike.

Më tej ajo u ankua se, duke pasur parasysh riklasifikimin e fakteve nga KLGj-ja, ajo nuk ishte informuar me hollësi rreth natyrës së akuzave kundër saj e rrjedhimisht nuk kishte pasur kohë dhe mundësi të mjaftueshme për të përgatitur mbrojtjen e saj. Në një vendim të 21 qershorit 2016, një Dhomë e Gjykatës vendosi që kishte pasur shkelje të nenit 6 të Konventës. Me kërkesë të Qeverisë sipas nenit 43, çështja iu referua Dhomës së Madhe.

### Neni 6

Në lidhje me mungesën e pretenduar të pavarësisë dhe paanshmërisë të KLGj-së, Gjykata theksoi se kërkesja nuk e kishte bërë këtë ankesë në kërkesën e saj fillestare. Rrjedhimisht, Gjykata doli në përfundimin që kjo ankesë ishte bërë jashtë kohe meqenëse procedurat vendase kishin përfunduar mbi gjashtë muaj përpara se të paraqitej ankesa, dhe e deklaroi këtë pjesë të kërkesës të papranueshme.

Në lidhje me ankesën e kërkueses që ajo nuk ishte informuar me hollësi për akuzat kundër saj dhe që nuk kishte pasur kohë dhe mundësi për të përgatitur mbrojtjen, Gjykata vuri në dukje se çështja kishte të bënte me procedura disiplinore që u zbatoheshin gjyqtarëve. Meqenëse as autoritetet prokuroriale e as gjykatat penale nuk kishin qenë të përfshira në përcaktimin e çështjeve, Gjykata gjeti që procedurat disiplinore kundër kërkueses nuk kishin të bënin me përcaktimin e një akuze penale brenda kuptimit të nenit 6 të Konventës. Megjithëse shumica e gjobës kishte qenë e konsiderueshme dhe dënimi ishte pra i natyrës ndëshkimore, rreptësia e tij nuk e sillte veprën brenda sferës penale. Rrjedhimisht, Gjykata e refuzoi si të papranueshme këtë pjesë të ankesës së kërkueses.

Më tej Gjykata mori në shqyrtim pavarësinë dhe paanshmërinë e Divizionit Gjyqësor të Gjykatës Supreme, dhe theksoi se ankesa e kërkueses kishte dy aspekte. I pari kishte të bënte me faktin që Kryetari i Gjykatës Supreme ishte njëkohësisht Kryetari i KLGj-së, ndërsa i dyti kishte të bënte me faktin se gjyqtarët e Gjykatës Supreme ishin nën autoritetin e KLGj-së për sa i përkiste karrierës dhe procedurave disiplinore kundër tyre.

Në lidhje me aspektin e parë, Gjykata deklaroi se ankesa e kërkueses kishte të bënte me gjykatën më të lartë në Portugali, e cila përbëhej vetëm nga gjyqtarë profesionalë të cilët ishin të pavarur dhe u nënshtroheshin rregullave të pajtueshmërisë që garantonin pavarësinë dhe paanshmërinë e tyre. Përbërja e Divizionit Gjyqësor të Gjykatës Supreme ishte e përcaktuar nga Ligji për Statusin e Gjyqtarëve mbi bazën e kriterëve objektive si vjetërsia e gjyqtarëve dhe anëtarësia e tyre në një divizion të caktuar, dhe Kryetari i Gjykatës Supreme nuk ishte pjesë e atij divizioni *ad hoc*.

Në praktikë, anëtarët e divizionit formalisht emëroheshin nga Zv/Kryetari më i vjetër i Gjykatës Supreme. Për më tepër, kërkuesja nuk pretendoi se gjyqtarët e Divizionit Gjyqësor kishin vepruar sipas udhëzimeve të Kryetarit të Gjykatës Supreme ose ishin ndikuar prej tij, ose që ata kishin treguar njëanshmëri. Në mënyrë të veçantë, nuk u konstatua që ata gjyqtarë ishin caktuar me qëllim të gjykimit të çështjes së saj. Roli i dyfishtë i Kryetarit të Gjykatës Supreme pra nuk ishte i tillë që hidhte dyshime mbi pavarësinë dhe paanshmërinë objektive të asaj gjykate.

Në lidhje me aspektin e dytë, roli i KLGj-së në karrierat e gjyqtarëve të Gjykatës Supreme dhe në procedurat disiplinore kundër tyre, Gjykata iu referua vendimit të saj në çështjen *Oleksandr Volkov k. Ukrainës*<sup>[404]</sup> lidhur me një problem të ngjashëm. Ndryshe nga çështja e *Oleksandr Volkov*, nuk ishin identifikuar probleme serioze me mangësi strukturore ose dukjen e njëanshmërisë brenda KLGj-së portugeze. Gjykata theksoi se pavarësia e gjyqësorit në Portugali ishte e mbrojtur si nga Kushtetuta ashtu edhe nga dispozita të tjera në të drejtën vendase, dhe sistemi ku juridiksioni për apelet kundër vendimeve të KLGj-së i caktohej Divizionit Gjyqësor të Gjykatës Supreme ishte mbështetur në disa raste nga Gjykata Kushtetuese.

Më tej ajo theksoi se gjyqtarët e Gjykatës Supreme, të cilët shpesh ishin në fazën e fundit të karrierës së tyre, nuk bënë më vlerësime të performancës ose nuk ishin më në kërkim të ngritjes profesionale, dhe se autoriteti disiplinor i KLGj-së mbi ta ishte realisht më shumë teorik. Gjykata gjithashtu theksoi mungesën e provave konkrete për mungesën e paanshmërisë, siç ishte ekzistenca e procedurave disiplinore kundër njërit prej anëtarëve të trupit gjykues që kishin shqyrtuar apelin e kërkueses. Më tej, nuk kishte as prova konkrete të mungesës së paanshmërisë. Prandaj, fakti që vetë gjyqtarët që dëgjonin çështjet ende i nënshtroheshin ligjit në përgjithësi, dhe rregullave të disiplinës profesionale dhe etikës në veçanti, dhe mbase mund të gjindeshin në pozita të ngjashme me njërin prej palëve në momente të caktuara, nuk ishte në vetvete bazë e mjaftueshme për të gjetur shkelje të kriterit të paanshmërisë. Një rrezik krejt abstrakt i këtij lloji nuk mund të shihej si i tillë që mund të hidhte dyshime mbi paanshmërinë e një gjyqtari në mungesë të rrethanave konkrete të situatës së tij apo të saj. Kështu, Gjykata nuk gjeti prova të mungesës së pavarësisë dhe paanshmërisë nga ana e Divizionit Gjyqësor të Gjykatës Supreme, dhe vendosi që nuk kishte pasur shkelje të kriterit të pavarësisë dhe paanshmërisë sipas nenit 6 § 1 të Konventës.

Pika përfundimtare që duhet të shqyrtonte Gjykata ishte ankesa e kërkueses në lidhje me pamjaftueshmërinë e pretenduar të shqyrtimit të zhvilluar nga Divizioni

404 *Oleksandr Volkov k. Ukrainës*, vendim i 9 janarit 2013, Nr. 21722/11, (i përfshirë si përmbledhje në këtë publikim).

Gjyqësor i Gjykatës Supreme dhe ankesa e saj për mungesën e një seance dëgjimore – këto u shqyrtuan së bashku meqenëse ishin të lidhura ngusht.

Gjykata konsideroi, së pari, se shqyrtimi i një vendimi që cakton dënim disiplinor për një shkelje të pretenduar të detyrimeve profesionale dallonte nga shqyrtimi i një vendimi administrativ që nuk ngërthente një element të tillë ndëshkimit. Së dyti, ajo theksoi se procedurat disiplinore në rastin konkret kishin të bënin me një gjyqtare. Edhe në qoftë se nuk hynin brenda fushëveprimit të nenit 6 sipas titullit të tij penal, dënimet disiplinore gjithsesi mund të përmbanin pasoja serioze për jetën dhe karrierën e gjyqtarëve. Shqyrtimi gjyqësor i zhvilluar duhet të ishte i përshtatshëm për lëndën e mosmarrëveshjes, që do të thotë me natyrën disiplinore të vendimeve administrative në fjalë. Kjo konsideratë zbatohet me forcë edhe më të madhe në procedurat disiplinore kundër gjyqtarëve, të cilët duhet të gëzonin respektin e nevojshëm për kryerjen e detyrave të tyre dhe kur besimi i publikut tek funksionimi dhe pavarësia e gjyqësorit ishin në rrezik.

Procedurat para KLGj-së i kishin dhënë kërkueses mundësinë të përgatiste mbrojtjen e saj. Megjithatë, procedurat kishin qenë me shkrim, pavarësisht nga fakti se kërkuësja me gjasë do të përballlej me dënime të rënda. Ajo nuk kishte pasur mundësi të merrte pjesë në asnjërën prej tri procedurave në lidhje me të, meqenëse KLGj-ja nuk ishte e autorizuar me ligj që të zhvillonte seanca dëgjimore publike, dhe nuk kishte pasur mundësi të bënte përfaqësime verbale qoftë në lidhje me çështje faktike apo në lidhje me çështje të ndryshme ligjore. Për më tepër, KLGj-ja nuk kishte dëgjuar deklaratat dëshmitarësh, megjithëse jo vetëm kredibiliteti i kërkueses por edhe ai i dëshmitarëve thelbësorë kishte qenë në rrezik. Rrjedhimisht, KLGj-ja nuk e kishte ushtruar fuqinë e diskrecionit mbi një bazë të përshtatshme faktike.

Në procedurat para Divizionit Gjyqësor të Gjykatës Supreme kërkuësja e kishte mohuar që e kishte quajtur inspektorin gjyqësor “gënjeshtar” dhe që kishte kërkuar mos-hapjen e procedurave kundër dëshmitarit që ajo donte të ftonte. Këto fakte ishin “vendimtare” dhe kërkuësja ishte përballur me mundësinë e dënimeve shumë të rënda të cilat përmbanin një shkallë të konsiderueshme stigme që mund të kishte pasoja të pakthyeshme mbi jetën dhe karrierën e saj. Sa i përket shkallës së shqyrtimit të zhvilluar nga Divizioni Penal i Gjykatës Supreme në lidhje me konstatimin e fakteve, ai divizion kishte deklaruar shprehimisht që nuk kishte juridiksion të plotë në çështje disiplinore por ishte thirrur vetëm për të shqyrtuar ligjshmërinë e vendimeve të kontestuara. Në mënyrë të veçantë, ai kishte theksuar se nuk kishte juridiksion kur vinte puna tek “mbledhja e provave apo konstatimi i fakteve kyçe”. Dukej pra se Divizionit Gjyqësor të Gjykatës Supreme nuk i ishte dhënë fuqia për

të shqyrtuar pikat vendimtare në procedura, konkretisht përmbajtjen e bisedave të kërkuases me inspektorin gjyqësor dhe me hetuesin gjyqësor.

Gjykata theksoi se vlerësimi i fakteve përfshinte shqyrtimin e çështjeve në drejtim të kredibilitetit të kërkuases dhe dëshmitarit. Pasi ishte gjetur që nuk kishte juridiksion për të rishqyrtuar faktet dhe provat, qoftë edhe mbi bazën e materialeve në dosjen që i ishte dërguar, Divizioni Gjyqësor i Gjykatës Supreme rrjedhimisht e kishte refuzuar kërkesën e kërkuases për seancë dëgjimore publike. Sipas mendimit të Gjykatës, mosmarrëveshja në lidhje me faktet dhe pasojat e dënimeve disiplinore mbi reputacionin e kërkuases e kishin bërë të nevojshme që Divizioni Penal i Gjykatës Supreme të zhvillonte një shqyrtim që ishte aq i thellë sa t'i mundësonte atij që së pari të përcaktonte, për shembull, nëse kërkuësja kishte bërë vërejtje të caktuara gjatë bisedës së saj telefonike me inspektorin gjyqësor ose gjatë takimit të saj privat me hetuesin gjyqësor, dhe, së dyti, të formonte përshtypjen e tij rreth kërkuases duke i dhënë asaj mundësinë për të shpjeguar gojarisht versionin e saj të situatës. Gjykata përsëriti në lidhje me atë pikë se në KLGj-ja nuk ishte mbajtur asnjë seancë dëgjimore dhe se Divizioni Penal i Gjykatës Supreme kishte qenë organi i parë dhe i fundit gjyqësor që kishte shqyrtuar apelet e kërkuases kundër vendimeve të KLGj-së. Në rastin konkret, kërkuësja kishte kërkuar seancë dëgjimore publike. Prandaj ajo duhet ta kishte pasur mundësinë për zhvillimin e një seance të tillë; kjo do të kishte lejuar ballafaqim verbal mes palëve dhe shqyrtim më të plotë të fakteve të cilat ishin kontestuar.

Gjykata arriti në përfundimin se, duke pasur parasysh kontekstin specifik të procedurave disiplinore të zhvilluara kundër një gjyqtareje, peshën e rëndë të dënimeve, faktin që garancitë procedurale para KLGj-së kishin qenë të kufizuara, dhe nevojshmërinë e vlerësimit të provave faktike për kredibilitetin e kërkuases dhe të dëshmitarit, çka përbënte aspekt vendimtar të çështjes – efekti i kombinuar i dy faktorëve, pra pamjaftueshmëria e shqyrtimit gjyqësor të zhvilluar nga Divizioni Gjyqësor i Gjykatës Supreme dhe mungesa e një seance dëgjimore qoftë në fazën e procedurave disiplinore apo në fazën e shqyrtimit gjyqësor, nënkuptonin se çështja e kërkuases nuk ishte dëgjuar në përputhje me kriteret e nenit 6 § 1 të Konventës.

#### Neni 41

Gjykata nuk pa ndonjë lidhje shkakësore mes shkeljeve të gjetura dhe dëmeve materiale të pretenduara, dhe e rrëzoi pretendimin e kërkuases për shpërbllim të drejtë. Në lidhje me kosto dhe shpenzime, kërkuësja i kishte paraqitur dokumentet vetëm para Dhomës së Madhe pa ofruar shpjegime, dhe prandaj edhe ky pretendim u rrëzua.

*Meqenëse vendimi i gjykatës vendase në çështjen e kërkujeses përmbushi standardet subjektive dhe objektive të pavarësisë dhe paanshmërisë, rishikimi gjyqësor i një emërimi në gjyqësor nuk përbëri shkelje të nenit 6*

## VENDIMI NË ÇËSHTJEN TSANOVA-GECHEVA k. BULLGARISË<sup>[405]</sup>

(Kërkesa nr. 43800/12)

**15 shtator 2015**

### **1. Faktet kryesore**

Kërkujesja, znj. Velichka Asenova Tsanova-Gecheva, ishte gjyqtare. Më 14 korrik 2009 ajo u caktua Zëvendëskryetare e Gjykatës së Qytetit të Sofjes. Kur posti i Kryetarit mbeti bosh, kërkujesja u caktua që ta mbulonte këtë post përkohësisht duke filluar prej 22 nëntorit të vitit 2010.

Një muaj më pas, Këshilli Gjyqësor Suprem nxori një njoftim për shpalljen e konkursit, me qëllim që të plotësonte vendin e mbetur bosh. Kërkujesja paraqiti kërkesën dhe, pas vlerësimit të të gjitha kërkesave, mes të gjithë kandidatëve ajo u rendit në krye bashkë me znj. V.Y. U zhvilluan dy votime të fshehta dhe të dyja herët znj V.Y. mori shumicën e votave, e për rrjedhojë në maj të vitit 2011 ajo u emërua Kryetare e Gjykatës së Qytetit të Sofjes.

Për shkak të pretendimit për miqësinë e ngushtë me Ministrin e Brendshëm bullgar, kandidatura e znj. V.Y. dhe emërimi i saj u mbuluan gjerësisht në media dhe u kritikuan ashpër nga një sërë gazetarësh dhe figurash publike. Dy gjyqtarë të Këshillit Gjyqësor Suprem dhanë dorëheqjen dhe kritikuan publikisht procedurën e emërimit, duke deklaruar se ajo kishte qenë jodemokratike dhe se rezultati ishte i paracaktuar.

Kërkujesja u ankua në Gjykatën Administrative Supreme kundër vendimit të Këshillit Gjyqësor Suprem me anë të një rshikimi gjyqësor, me argumentin se ai ishte marrë në shkelje të ligjit dhe të rregullave procedurale në fuqi. Më 3 nëntor 2011, Gjykata Administrative Supreme mori vendim me një trupë prej tre gjyqtarësh për të hedhur poshtë vendimin e ankimuar, megjithëse këtë e bëri vetëm për shkak se votimi i fshehtë ishte në kundërshtim me dispozitat statutores që përcaktonte se votimi duhet të zhvillohej me gritjen e duarve.

405 Ky vendim është përfundimtar.

Znj. V.Y. dhe Këshilli Gjyqësor Suprem paraqitën ankesë mbi pika të ligjit kundër vendimit të Gjykatës Administrative Supreme. Në konstatimet e saj, kërkuesja e kundërshtoi vendimin gjyqësor të 3 nëntorit 2011 i cili, sipas saj, nuk ishte shoqëruar me arsye të mjaftueshme. Ajo pretendoi se, duke hedhur poshtë argumentet e saj lidhur me mungesën e arsyeve të vendimit të Këshillit Gjyqësor Suprem, Gjykata Administrative Supreme nuk kishte kryer një shqyrtim të gjerë të mjaftueshëm dhe nuk kishte ekzaminuar të gjitha çështjet ligjore e faktike që ishin vendimtare për rezultatin e çështjes.

Më 12 janar 2012, Gjykata Administrative Supreme, me një kolegjin prej pesë anëtarësh, vendosi se votimi i fshehtë i zhvilluar nga Këshilli Gjyqësor Suprem ishte i ligjshëm. Për pasojë, vendimi i këtij të fundit kishte qenë i vlefshëm dhe vendimi i datës 3 nëntor 2011, që e kishte hedhur poshtë atë, kishte qenë zbatim i gabuar i ligjit. Më tej, ajo vendosi se nuk ishte e nevojshme të merrej vendim në bazë të argumenteve të paraqitura nga kërkuesja, duke qenë se vendimi i ankimit kishte qenë në favor të saj.

## 2. Vendimi i Gjykatës

Kërkuesja pretendoi se objekti i rishikimit gjyqësor të ankimit të saj kundër vendimit të Këshillit Gjyqësor Suprem për emërimin e Kryetares së re të Gjykatës së Qytetit të Sofjes ishte i pamjaftueshëm dhe i papërshtatshëm dhe shkelte të drejtën e saj për seancë të drejtë, duke shkelur nenin 6 § 1 (e drejta për proces të rregullt) të Konventës.

### Neni 6 § 1

Gjykata në fillim deklaroi se Konventa nuk garantonte të drejtën për t'u ngritur në detyrë ose për të mbajtur poste publike. Megjithatë, ajo konfirmoi se po që se njiheshin të drejta të caktuara punësimi, së paku mbi baza të argumentueshme, sipas të drejtës vendase – përderisa gjykatat vendase e njihnin ekzistencën e tyre dhe i kishin ekzaminuar arsyet e ngritura nga personat në fjalë – atëherë të drejtat e nenit 6 ishin të zbatueshme në lidhje me zbatimin në vend të atij ligji vendas. Më tej, meqenëse kërkuesja pati qasje në gjykatë sipas të drejtës vendase në lidhje me ankesën e saj, kufizimi nga Gjykata i fushëveprimit të nenit 6 në lidhje me mosmarrëveshjet e punësimit mes Shtetit dhe zyrtarëve në administratën e tij nuk zbatohet në këtë rast. Prandaj, neni 6 ishte i zbatueshëm nën titullin e tij civil.

Gjatë shqyrtimit të ankesës së kërkueses, Gjykata vijoi me shqyrtimin e faktit nëse kërkuesja kishte pasur qasje në një gjykatë që përmbush kërkesat e nenit 6



dhe, më konkretisht, nëse shtrirja e rishikimit gjyqësor të zhvilluar nga Gjykata Administrative Supreme ishte e mjaftueshme.

Sipas këndvështrimit të Gjykatës, Gjykata Administrative Supreme kishte pasur të drejtën për të anuluar emërimin e znj. V.Y. si Kryetare e Gjykatës së Qytetit të Sofjes, bazuar mbi një sërë arsyesh paligjshmërie lidhur me dispozitat procedurale dhe ato materiale të parashikuara me ligj dhe për t'ia rikthyer çështjen Këshillit Gjyqësor Suprem për të marrë vendim të ri, në përputhje me udhëzimet e mundshme të nxjerra nga vetë Gjykata Administrative Supreme lidhur me parregullsitë e konstatuara. Megjithatë, ajo nuk ishte e autorizuar për të shqyrtuar të gjitha aspektet e vendimit të Këshillit Gjyqësor Suprem. Në mënyrë të veçantë, ajo nuk mundej, përveç rasteve të shpërdorimit të pushtetit, të vinte në diskutim zgjedhjen e bërë nga Këshilli Gjyqësor Suprem se cili ishte kandidati më i mirë për postin, dhe nuk mund të kishte zëvendësuar vlerësimin e saj me atë të Këshillit Gjyqësor Suprem.

Megjithatë, Gjykata shpjegoi se në kushtet e rishikimit gjyqësor neni 6 nuk u garantonte individëve të drejtën për mundësinë që një gjykatë vendase të zëvendësonte opinionin përkatës të autoriteteve administrative me opinionin e vet [gjykatës]. Në këtë aspekt, theks i veçantë duhet të vihej mbi respektin që duhet t'i akordohej vendimeve të autoriteteve administrative të marra për shkak të shpejtësisë, dhe atyre që shpesh përfshijnë fusha të specializuara të ligjit. Në rastin konkret, megjithëse praktika gjyqësore vendase i jepte diskrecion mjaft të gjerë Këshillit Gjyqësor Suprem gjatë vlerësimit të cilësive të kandidatëve dhe zgjedhjes së personit më të kualifikuar për një post, Gjykata Administrative Supreme e kishte kufizuar fushëveprimin e rishikimit të saj brenda faktit nëse vendimi i Këshillit Gjyqësor Suprem kishte përfshirë abuzim të pushtetit, pra nëse kjo ishte bërë në shkelje të qëllimeve të ligjit. Përveç kësaj, ajo gjithashtu kishte shqyrtuar nëse Këshilli Gjyqësor Suprem kishte vepruar në përputhje me kriteret përkatëse të cekura shprehimisht në të drejtën vendase.

Lidhur me natyrën e vendimit në fjalë, ai kishte të bënte me emërimin e kryetarit të një gjykate. Kjo përfshinte ushtrimin e kompetencave të gjera të Këshillit Gjyqësor Suprem meqenëse është autoriteti që ka mandatin specifik për të siguruar funksionimin autonom të gjyqësorit, veçanërisht kur bëhet fjalë për emërimet dhe rregullat disiplinore që qeverisin anëtarët e gjyqësorit me synim të sigurimit të pavarësisë gjyqësore. Më tej, vendimi i Këshillit Gjyqësor Suprem ishte marrë duke ndjekur një procedure rigoroze dhe të hollësishme përzgjedhjeje, e përcaktuar me ligj dhe me një numër garancish procedurale në përmbajtje, me qëllim që të garantohej një proces përzgjedhës i ndershëm dhe transparent. Gjykata Administrative Supreme kishte shqyrtuar thjesht pajtueshmërinë me këto rregulla,

me kërkesë të saj dhe në përgjigje të parashtrësave të palëve. Më në përgjithësi, ajo iu ishte përgjigjur argumenteve kryesore të ngritura nga kërkuësja, e cila, për më tepër, nuk kishte paraqitur asnjë pretendim për lidhjet e mundshme midis znj. V.Y. dhe Ministrit të Brendshëm të asaj kohe. Po kështu, Gjykata Administrative Supreme kishte konfirmuar se arsyet e dhëna nga Këshilli Gjyqësor Suprem për këtë qëllim kishin qenë të mjaftueshme.

Gjykata pranoi se pretendimet lidhur me mungesën e transparencës dhe ndërhyrjen nga autoritetet politike në procedurën e emërimit në fjalë, si dhe kritikën e bëra në këtë drejtim nga organet kompetente ndërkombëtare, përbënin shkak për shqetësim. Megjithatë, edhe pse e vetëdijshme për rëndësinë e procedurave për emërimin dhe ngritjen në detyrë të gjyqtarëve dhe ndikimin e tyre në pavarësinë dhe mirëfunksionimin e sistemit gjyqësor, ajo e pranoi se nuk ishte detyra e saj që të shprehej lidhur me përshtatshmërinë e zgjedhjeve të Këshillit Gjyqësor Suprem ose për kriteret që duhen mbajtur parasys. Për rrjedhojë, Gjykata doli në përfundimin se objekti i shqyrtimit të Gjykatës Administrative Supreme kishte qenë i mjaftueshëm për qëllimet e nenit 6.

Gjykata gjithashtu analizoi në mënyrë specifike nëse Gjykata Administrative Supreme kishte dështuar në përmbushjen e kriterëve të pavarësisë dhe paanshmërisë që kërkohen nga neni 6. Para këtij vendimi ishin ngritur pyetje rreth procedurës së emërimit të gjyqtarëve dhe rreth pavarësisë së Këshillit Gjyqësor Suprem nga Komisioni Evropian dhe Komisioni Këshillimor i Gjyqtarëve Evropianë pranë Bashkimit Evropian në disa publikime që nuk kishin lidhje me këtë çështje. Për të përcaktuar nëse një gjykatë është e pavarur, duhet pasur parasys mënyra e caktimit të anëtarëve të saj dhe mandati i tyre në detyrë, ekzistenca e garancive kundrejt trysnisë së jashtme, dhe çështja nëse organizmi shfaq pavarësi në dukje. Sa i përket paanshmërisë, ajo përcakton mungesën e paragjyqimit apo njëanshmërisë. Sipas jurisprudencës së vendosur të Gjykatës, ekzistenca e paanshmërisë duhet përcaktuar sipas një testi subjektiv, ku duhet marrë parasys bindja dhe sjellja personale e gjyqtarit, dhe një testi objektiv, i cili vërteton nëse gjykata ka ofruar garanci të mjaftueshme për të përjashtuar çdo dyshim legjitim rreth paanshmërisë së saj. Në këtë rast, Gjykata nuk gjeti shkelje të së drejtës së kërkuësës për gjykatë të pavarur dhe të paanshme, duke qenë se nuk kishte asnjë trysni nga jashtë mbi gjyqtarët e Gjykatës Administrative Supreme, ata ishin emëruar në përputhje me procedurat e përcaktuara dhe ishte marrë një vendim i vlefshëm, në përputhje me legjislacionin vendas.

Në dritën e këtyre vlerësimeve, Gjykata vendosi njëzëri se nuk kishte pasur asnjë shkelje të nenit 6 të Konventës.

## (6) Dukja e Pavarësisë

*Përbërja e një bordi të policisë bashkiake i dha shkas dyshimeve legjitime rreth pavarësisë dhe paanshmërisë së tij, duke çuar në shkelje të nenit 6 § 1*

### VENDIMI NË ÇËSHTJEN **BELIOS k. ZVICRËS**

(Kërkesa nr. 10328/83)

**29 prill 1988**

#### **1. Faktet kryesore**

Kërkuesja, znj. Belios, ishte shtetase zvicerane dhe studente që jetonte në Lozanë të Zvicrës. Kërkuesja mori një gjobë prej 200 frangash zvicerane për kinëse pjesëmarrjen në një protestë të paligjshme më 4 prill 1981. Gjoha u caktua nga Bordi i Policisë bashkiake (Bordi) në një takim të 29 majit 1981 në të cilin kërkuesja nuk mori pjesë. Më pas kërkuesja bëri kërkesë për apel ndaj Bordit sipas Ligjit për Vendimet Bashkiake në Vaud, mbi bazën e faktit se ajo ishte gjykuar pa u ftuar.

Provat e nxjerra nga kërkuesja përfshinin dëshminë e ish-bashkëshortit të saj që në kohën e demonstratave ai faktikisht ndodhej në kafene bashkë me të. Megjithatë, Bordi u mbështet tek një deklaram kontradiktor i një polici, dhe arriti në përfundimin që ai [Bordi] ishte “bindur gjatë hetimeve të veta se e pandehura vërtet [kishte] marrë pjesë në demonstratë”. Bordi e konfirmoi dënimin dhe urdhëroi që kërkuesja të paguante kostot, edhe pse e reduktoi gjobën në 120 franga zvicerane për shkak se kërkuesja nuk kishte luajtur rol aktiv.

Kërkuesja më pas apeloj pranë Divizionit Penal të Kasacionit në Gjykatën Kantonale të Vaud (Gjykata Kantonale). Kërkuesja argumentoi që Bordi nuk ishte gjykatë e paanshme dhe e pavarur, dhe që Gjykata Kantonale duhet të merrte në konsideratë dëshminë e ish-bashkëshortit të saj. Gjykata Kantonale deklaroi se, për shkak të rezervave të shprehura nga Qeveria zvicerane ndaj nenit 6 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut në deklaramet e saj interpretuese, detyrimi për të mbajtur seancë dëgjimore publike dhe për të shpallur vendimin publikisht nuk i përfshinte procedurat në lidhje me konstatimin e një akuze penale para një autoriteti administrativ. Fakti që procedura e apelit ishte në formë të shkruar, pa argumente verbale ose pa marrë prova, u deklarua se nuk ishte në kundërshtim me nenin 6 § 1. Rrjedhimisht, apeli u rrëzua.

Pas kësaj, kërkesja apeloj pranë Gjykatës Federale, duke argumentuar se deklarimi interpretues i Zvicrës nuk nënkuptonte se një autoritet administrativ si Bordi kishte autoritet të vendoste për akuza penale në një kontekst ku vendimet e tij nuk i nënshtroheshin asnjë forme të shqyrtimit gjyqësor. Megjithatë, Gjykata Federale e refuzoi këtë argument mbi bazën e faktit se deklarimet interpretuese i kufizonin detyrimet e Zvicrës nga neni 6 § 1 thjesht me shqyrtim të ligjshmërisë së vendimit të gjykatës së shkallës së parë.

## 2. Vendimi i Gjykatës

Kërkesja u ankua sipas nenit 6 § 1 se ajo nuk ishte gjykuar nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme me juridiksion të plotë për të shqyrtuar dhe vendosur për çështje të faktit dhe të ligjit.

### Neni 64

Gjykata së pari konsideroi nëse deklarimi interpretues i bërë nga Zvicra gjatë depozitimit të instrumentit të ratifikimit e përjashtonte Zvicrën nga pajtueshmëria me disa prej detyrimeve të saj nga neni 6 § 1. U arrit në përfundimin se natyra e përgjithshme e deklarimit interpretues dhe fakti që ai nuk përmbante deklarim të shkurtër të ligjit e bënte atë rezervim të pavlefshëm. Kështu që Zvicra vazhonte të kishte detyrime ndaj nenit 6 § 1.

### Neni 6 § 1

Kërkesja parashtroi se Bordi, i cili përbëhej nga një zyrtar i vetëm, ishte e sigurt që do të vepronte sipas vullnetit të autoriteteve policore. Për më tepër, ajo pretendoi se as Gjykata Kantonale e as Gjykata Federale nuk ofronin “kontroll përfundimtar të gjyqësorit” të shtrirë sa duhej, sepse ato nuk qenë në gjendje të rikonsideronin gjetjet e bëra nga Bordi, i cili ishte thjesht organ administrativ.

Në lidhje me paanshmërinë, Gjykata rikujtoi që “gjykata” përkufizohet nga funksioni i saj gjyqësor substancial: vendosja e çështjeve në kompetencë të saj duke u mbështetur në shtetin e së drejtës, dhe zhvillimi i procedurave në mënyrë të parashikuar. Sipas nenit 6 ajo duhet të përmbushë kriteret e pavarësisë dhe paanshmërisë, dhe Gjykata konsideroi që në rastin konkret, ndërkohë që anëtari i vetëm i Bordit ishte emëruar nga bashkia, kjo në vetvete nuk mjaftonte për të hedhur dyshime mbi paanshmërinë e personit në fjalë. Më tej, u theksua se shërbyesi civil bashkiak kryente detyrën në cilësi personale, dhe në parim nuk mund të shkarkohej nga mandati i detyrës. Për më tepër, paanshmëria personale e zyrtarit nuk ishte vënë në pikëpyetje.

Pavarësisht, Gjykata theksoi se drejtësia jo vetëm që duhet të vihet në vend, por edhe duhet të shihet që po vihet në vend. Meqenëse Bordi përbëhej vetëm nga një shërbyes civil i lartë, i cili duhet t'u kthehej detyrave të tjera në departamentin e vet, qytetarët e zakonshëm të Lozanës, siç ishte kërkuesi, me gjasë do ta shihnin atë si pjesëtar të policisë që i nënshtrohet eprorëve dhe është besnik ndaj kolegëve. Rrjedhimisht, dyshimet e kërkuesit lidhur me pavarësinë dhe paanshmërinë organizacionale të Bordit ishin legjitime.

Gjykata kujtoi që ajo duhet të bindej se format e apelit në dispozicion për kërkuesin duhet ta kishin bërë të mundur ndreqjen e mangësive të vëna në dukje gjatë procedurës në shkallën e parë. Gjykata iu referua vendimit të Gjykatës Kantonale i cili theksoi se procedura para saj ishte vetëm shqyrtim i ligjshmërisë së saj dhe nuk përfshinte fjalime verbale ose marrjen e provave. Po ashtu, u bë referencë ndaj vendimit të Gjykatës Federale që Gjykata Kantonale “nuk kishte pasur kompetencë të plotë për të rishqyrtuar faktet”. Përveç kësaj, Gjykata qe dakord me kërkuesin që pamundësia e Gjykatës Federale për të rishqyrtuar çështje të faktit ose të ligjit (ku ajo merrej vetëm parandalimin e arbitrarishtetit) e bënte atë të paaftë për ndreqjen e mangësive të mëparshme. U arrit në përfundimin se format e shqyrtimit që janë në dispozicion në nivel të Gjykatës Kantonale dhe Gjykatës Federale ishin të pamjaftueshme.

Në përfundim, Gjykata gjeti shkelje të nenit 6 § 1 sa i përket parimit të paanshmërisë dhe pavarësisë së gjykatës dhe mjaftueshmërisë së mënyrave të apelit.

#### Neni 50 (tani neni 41)

Gjykata theksoi se ajo nuk kishte fuqi sipas nenit 50 të prishte shpalljen e fajësisë dhe dënimit, e as të modifikonte ligjet vendase, dhe e refuzoi kërkesën e kërkueses për të kërkuar anulimin dhe rimbursimin e gjobës si dhe ndryshimin e Ligjit për Vendimet Bashkiake në Vaud. Megjithatë, ajo urdhëroi Qeverinë që t'i paguante kërkueses në lidhje me kosto dhe shpenzime shumë më 11,750 franga zvicerane (afro 15,000 euro), duke zbritur shumë më paguar kërkueses nga Këshilli i Evropës për ndihmë ligjore.

## (7) Paanshmëria – Paanshmëria Objektive dhe Subjektive

*Dështimi për të hetuar dhe trajtuar si duhet akuzat që disa gjyqtarë që kryesuan procedurat gjyqësore kundër Kryetarit të Gjykatës Supreme të Sllovakisë nuk ishin të paanshëm shkeli nenin 6*

### VENDIMI NË ÇËSHTJEN HARABIN k. SLLOVAKISË<sup>[406]</sup>

(Kërkesa nr. 58688/11)  
**20 nëntor 2012**

#### 1. Faktet kryesore

Kërkuesi, z. Štefan Harabin, ishte gjyqtar në Gjykatën e Lartë. Në kohën e këtij vendimi ai kishte qenë Kryetar i Gjykatës së Lartë që prej qershorit të vitit 2009 (pasi e kishte mbajtur më parë këtë post në periudhën nga viti 1998 deri në vitin 2003). Ai kishte qenë Ministër i Drejtësisë i Republikës së Sllovakisë në periudhën ndërmjet korrikut të vitit 2006 dhe qershorit të vitit 2009.

Në korrik dhe gusht të vitit 2010, kërkuesi, në cilësinë e tij si Kryetar, pengoi një grup auditorësh të udhëzuar nga Ministri i Financave nga kryerja e një auditimi në Gjykatën e Lartë qëllimi i të cilit ishte shqyrtimi i përdorimit të fondeve publike, efikasiteti i menaxhimit financiar dhe eliminimi i mangësive të identifikuara në auditimin e mëparshëm. Kërkuesi më pas njoftoi Ministrin e Financave që ministrisë i mungonte baza ligjore dhe kompetenca për ta kryer auditimin dhe se organi që kishte autoritetin për ta bërë këtë në respektim të parimit të pavarësisë së gjyqësorit ishte Zyra e Auditimit të Lartë.

Në nëntor të vitit 2010, pas informimit nga Ministri i Financave, Ministri i Drejtësisë nisi procedura disiplinore para Gjykatës Kushtetuese kundër kërkuesit për pengim të auditimit. Gjatë procedurës, Ministri i Drejtësisë akuzoi tre gjyqtarë kushtetues për njëanshmëri, me arsyetimin se ata kishin pasur marrëdhënie personale me kërkuesin për disa vite dhe se ishin emëruar në detyrat e tyre nga e njëjta parti politike. Po ashtu, kërkuesi akuzoi katër gjyqtarë të ndryshëm të Gjykatës Kushtetuese për anshmëri. Ai argumentoi se dy prej tyre kishin bërë deklarata negative rreth tij në media për dy raste të ndryshme, që një gjyqtar i tretë ishte anëtar i të njëjtës dhomë si dy gjyqtarët e parë, dhe se një gjyqtar i katërt ishte dënuar për një vepër të

406 Ky vendim është përfundimtar.

lidhur me taksat dhe ishte kritikuar për injorimin e ftesës së Gjykatës Kushtetuese për të rishikuar pozicionin e tij si gjyqtar. Në përgjigje të këtyre kundërshtimeve, asnjëri prej gjyqtarëve nuk e konsideroi veten të njëanshëm, dhe në maj të vitit 2011 Gjykata Kushtetuese vendosi të mos përjashtonte asnjërin nga shtatë gjyqtarët prej shqyrtimit të çështjes. Gjykata Kushtetuese theksoi se përcaktimi i shkeljes disiplinore për të cilën dyshohej kërkuesi hynte brenda juridiksionit ekskluziv të sesionit të saj plenar, dhe ishte e mendimit se e formalizmi i tepruar përbënte rrezik për bërjen jo efektive të procedurave.

Më 29 qershor të vitit 2011, kërkuesi u shpall fajtor dhe u dënua me një sanksion disiplinor i cili përbëhej nga një reduktim prej 70% të pagës së tij për një vit.

## **2. Vendimi i Gjykatës**

Duke u mbështetur në nenin 6 (e drejta për proces të rregullt ligjor), kërkuesi u ankua se proceset përpara Gjykatës Kushtetuese kishin qenë të padrejta, duke pretenduar se disa prej gjyqtarëve të cilët kishin vendosur për çështjen e tij kishin qenë të njëanshëm. Ai bëri edhe disa ankesa të tjera, duke përfshirë edhe ankesën që Gjykata Kushtetuese kishte interpretuar gabimisht dispozitat përkatëse lidhur me elementet e një vepre të rëndë disiplinore; se ai ishte sanksionuar për opinionet e tij ligjore; se e drejta e tij për respektimin e pasurisë ishte cenuar; se ai ishte diskriminuar lidhur me gëzimin e të drejtave të tij të lartpërmendura; dhe se ai nuk kishte pasur mjete ligjore efektive në dispozicion për të kundërshtuar vendimin e Gjykatës Kushtetuese, në shkelje të nenit 10 (liria e shprehjes), nenit 1 të Protokollit 1 (mbrojtja e pronës), nenit 13 (e drejta për zgjidhje efektive) dhe nenit 14 ( ndalimi i diskriminimit) të Konventës.

### Neni 6

Pasi theksoi se detyra e saj në këtë çështje ishte vetëm të përcaktonte nëse ishin respektuar të drejtat e kërkuesit të parashikuara në Konventë në proceset përpara Gjykatës Kushtetuese, ku ai u sanksionua për shkelje disiplinore, Gjykata vijoi duke trajtuar çështjen lidhur me pretendimin për mungesë paanshmërie nga gjyqtarët kushtetues.

Gjykata theksoi se është veçanërisht e rëndësishme që garancitë e së drejtës për gjykim të drejtë, të parashikuara nga neni 6 i Konventës, të respektohen në proceset e nisura nga një Qeveri kundër një gjyqtari në cilësinë e Kryetarit të Gjykatës së Lartë, duke qenë se ishte në rrezik besimi i publikut tek funksionimi i gjyqësorit në nivelin më të lartë kombëtar. Sipas ligjit sllovak, proceset disiplinore kundër Kryetarit

të Gjykatës së Lartë mund të vendosen vetëm nga një shumicë e një seance plenare të Gjykatës Kushtetuese. Gjykata Kushtetuese, e përballur me një situatë ku shtatë prej trembëdhjetë gjyqtarëve të saj u kundërshtuan nga palët për njëanshmëri, duhej të gjente një barazpeshë midis nevojës për t'iu përgjigjur kërkesave për përjashtimin e këtyre gjyqtarëve dhe nevojës për të ruajtur kapacitetin për të vendosur për çështjen. Gjykata vlerësoi se, duke vepruar kështu, Gjykata Kushtetuese nuk kishte arritur të merrte qëndrim të duhur nga pikëpamja e garancive të nenit 6. Së pari, dy prej gjyqtarëve të kundërshtuar nga kërkuesi dhe dy prej gjyqtarëve të kundërshtuar nga Ministri ishin përjashtuar nga disa procese të mëparshme të Gjykatës Kushtetuese ku përfshihej kërkuesi. Për shkak se mund të lindnin dyshime në lidhje me paanshmërinë e tyre, Gjykata Kushtetuese duhej të kishte paraqitur në mënyrë të qartë argumente bindëse se pse kundërshtimet nuk do të mund të pranoheshin në proceset disiplinore. Së dyti, Gjykata Kushtetuese nuk kishte marrë qëndrim lidhur me faktin nëse ndonjë nga arsyet e tjera të ngritura nga palët do të kishte justifikuar përjashtimin e ndonjërit prej gjyqtarëve përkatës.

Pyetja nëse kishte ndonjë nevojë dhe justifikim të shpallur për mos-përjashtimin e ndonjërit prej gjyqtarëve mund të kishte lindur vetëm pas përgjigjes së argumenteve të palëve dhe pas përcaktimit nëse kundërshtimet ndaj gjyqtarëve ishin të justifikuara ose jo. Arsyet e dhëna nga Gjykata Kushtetuese, pra nevoja për të ruajtur kapacitetin e saj për të përcaktuar lëndën, për pasojë, nuk mund të justifikonin pjesëmarrjen e gjyqtarëve, ku dyshimet rreth mungesës së pretenduar të paanshmërisë së tyre Gjykata Kushtetuese nuk kishte arritur t'i zhdukte bindshëm. Për pasojë, është shkelur e drejta e kërkuesit për t'u gjykuar nga një gjykatë e paanshme.

Duke pasur parasysh këtë përfundim, dhe duke ditur se ajo kishte kompetenca të kufizuara për të trajtuar gabime të faktit ose të ligjit kinëse të kryera nga gjykatat kombëtare, Gjykata nuk e konsideroi të nevojshme të shqyrtonte veçmas ankesat e tjera të kërkuesit lidhur me pretendimin për padrejtësi të procedurës disiplinore kundër tij.

### Neni 10

Kërkuesi ishte sanksionuar me urdhër të Ministrit të Drejtësisë dhe pasi Gjykata Kushtetuese kishte konstatuar se ai nuk i kishte përmbushur detyrimet lidhur me administrimin e gjykatës, siç përcaktohej në legjislacionin përkatës të brendshëm. Sjellja profesionale e kërkuesit në kuadër të administrimit të drejtësisë dhe në lidhje me një autoritet tjetër shtetëror përfaqësoi aspektin thelbësor të çështjes dhe përcaktoi zbatimin e sanksionit të kontestuar. Prandaj nuk kemi të bëjmë me ndërhyrje tek ushtrimi i së drejtës së kërkuesit për lirinë e shprehjes, siç garantohet me nenin 10.



### Neni 1 Protokollit 1

Sipas kërkesit, sanksioni i vënë ndaj tij në formën e reduktimit prej 70% të pagës së tij për një vit ishte joproporcional dhe në kundërshtim me të drejtën e tij për gëzimin paqësor të pasurisë së tij. Gjykata gjeti se ndërhyrja ishte e parashikuar me ligj dhe synonte një qëllim legjitim në interes publik (pra sigurimi i monitorimit të përdorimit të duhur të fondeve publike dhe pajtueshmëria e kërkesit me detyrimet e tij statutore si Kryetar i Gjykatës Supreme). Prandaj, Gjykata e refuzoi këtë pjesë të kërkesës si dukshëm e pabazuar.

### Neni 14

Kërkesi nuk ishte trajtuar ndryshe në krahasim me individë të tjerë në të njëjtën situatë si ai, dhe kjo pjesë e kërkesës u refuzua nga Gjykata.

### Neni 13

Gjykata përsëriti se kur kërkesi pretendon shkeljen e një të drejte të Konventës nga autoriteti gjyqësor përfundimtar në sistemin e brendshëm ligjor, zbatimi i nenit 13 nënkuptohet se është i kufizuar. Prandaj, Gjykata e hodhi poshtë këtë aspekt të ankesës së kërkesit.

### Neni 41

Gjykata vendosi që Sllovakia duhet t'i paguante kërkesit 3,000 euro në lidhje me dëme jomateriale dhe 500 euro për kostot dhe shpenzimet e çështjes.

*Neni 6 është i zbatueshëm në procedurën e ndërmjetme e cila është “civile” dhe ku masa e ndërmjetme përcakton të drejtën “civile” që është në rrezik, sepse pavarësia dhe paanshmëria duhet të garantohen edhe në procedura të ndërmjetme; lidhjet e afërta familjare mes një gjyqtari dhe avokatit të një pale u deklarua se kishin shkelur nenin 6 § 1*

---

## VENDIMI NË ÇËSHTJEN MICALLEF K. MALTËS

---

(Kërkesa nr. 17056/06)  
15 tetor 2010

### 1. Faktet kryesore

Kërkuesi, Joseph Micallef, ishte shtetas maltez i lindur në vitin 1929 dhe me banim në Maltë. Në vitin 1985 motra e tij, znj. M., e cila tashmë ka vdekur, u padit në gjykatat civile nga fqinji i saj në lidhje me një mosmarrëveshje mes tyre. Kryetari i trupit gjykues të gjykatës që dëgjoi çështjen i dha fqinjit një urdhër parandalimi në mungesë të znj. M., e cila nuk ishte informuar rreth datës së seancës. Në vitin 1992, gjykata vendosi kundër znj. M. në lidhje me themelet.

Në ndërkohë, znj. M. kishte nisur procedurën në Gjykatën Civile, nën juridiksionin e saj të thjeshtë, duke pretenduar se urdhri i parandalimit ishte dhënë në mungesë të saj dhe pa i dhënë asaj mundësinë për të dëshmuar. Në tetor 1990, Gjykata Civile gjeti se urdhri gjyqësor ishte lëshuar në shkelje të parimit të kontradiktoritetit dhe e deklaroi të pavlefshëm.

Në shkurt 1993, Gjykata e Apelit konfirmoi një apel të bërë nga fqinji dhe vuri nën pyetje vendimin e Gjykatës Civile në favor të znj. M. Gjykata e Apelit u kryesua nga Kryegjyqtari, në trupin gjykues së bashku me dy gjyqtarë të tjerë. Znj. M. më pas bëri apel kushtetues pranë Gjykatës Civile, nën juridiksionin e saj kushtetues, ku pretendoi se Kryegjyqtari nuk kishte qenë i paanshëm duke pasur parasysh lidhjet e tij familjare me avokatët që përfaqësonin palën tjetër. Ajo vuri në dukje se ai ishte vëllai dhe xhaxhai, respektivisht, i avokatëve që kishin përfaqësuar fqinjin e saj. Apeli kushtetues, i cili u mor përsipër nga kërkuesi pas vdekjes së motrës së tij, u rrëzua në janar 2004. Në tetor 2005 një apel tjetër i bërë para Gjykatës Kushtetuese u rrëzua gjithashtu.

### 2. Vendimi i Gjykatës

Duke u mbështetur në nenin 6 § 1 të Konventës, kërkuesi u ankua për mungesën e paanshmërisë së Gjykatës së Apelit për shkak të lidhjeve familjare mes kryetarit të

trupit gjykues dhe avokatëve të palës tjetër. Ai shtoi se kjo kishte shkaktuar shkelje të parimit të barazisë së armëve.

Në një vendim të 15 janarit 2008, një Dhomë e Gjykatës deklaroi se kishte pasur shkelje të nenit 6 § 1 të Konventës për shkak të mungesës së paanshmërisë objektive të Gjykatës së Apelit. Çështja iu referua Dhomës së Madhe sipas nenit 43 me kërkesë të Qeverisë.

### Neni 6

Gjykata së pari shqyrtoi pranueshmërinë e ankesës dhe deklaroi se, në kundërshtim me argumentin e Qeverisë, kërkuesi e kishte statusin e viktimës, së pari sepse atij i ishin vënë mbi supe kostot e çështjes së nisur nga motra e tij e për pasojë mund të konsiderohej se ai kishte interes trashëgimor në çështje, dhe, së dyti, sepse çështja ngrinte probleme në lidhje me administrimin e drejtë të drejtësisë e për pasojë një pikë të rëndësishme me interes të përgjithshëm. Gjykata gjithashtu gjeti që kërkuesi i kishte shteruar zgjidhjet vendase.

Problemi kryesor në lidhje me pranueshmërinë kishte të bënte me argumentin e Qeverisë që garancitë e nenit 6 § 1 nuk zbatoheshin në procedura si këto, të cilat kishin të bënin me masa të ndërmjetme ose të përkohshme. Këtu Gjykata përsëriti se procedurat paraprake, si ato që kanë të bëjnë me dhënien e një mase të ndërmjetme siç është urdhri i parandalimit, normalisht nuk hynin brenda mbrojtjes së nenit 6. Gjykata vuri në dukje se tani kishte konsensus të gjerë mes Shteteve anëtare të Këshillit të Evropës në lidhje me zbatueshmërinë e nenit 6 në masat e ndërmjetme, përfshirë procedurat e urdhrave të parandalimit. I njëjti qëndrim është përqafuar edhe në praktikën gjyqësore të Gjykatës së Drejtësisë të Bashkimit Evropian. Gjykata theksoi se vendimi i një gjyqtari për urdhër parandalimi shpesh përbënte vendim në lidhje me themelet e një kërkesë për një periudhë të konsiderueshme kohore, ose edhe në mënyrë permanente në raste të pazakonta. Nga kjo rridhte se, shpeshherë, procedurat e ndërmjetme dhe ato kryesore vendosnin për të njëjtat “të drejta ose detyrime civile”, brenda kuptimit të nenit 6, dhe prodhonin të njëjtat efekte. Në këto rrethana, Gjykata nuk e gjeti më të justifikueshme t’i karakterizonte automatikisht procedurat e urdhrat të parandalimit si të tilla që nuk vendosnin mbi të drejtat ose detyrimet civile. As nuk qe e bindur që një defekt në këto procedura domosdoshmërisht do të rregullohej gjatë procedurave në lidhje me themelet meqenëse çdo paragjykim i pësuar në ndërkohë mund të jetë bërë i pakthyeshëm deri në atë moment.

Prandaj, Gjykata konsideroi se ishte e nevojshme të ndryshohej praktika gjyqësore. Neni 6 do të ishte i zbatueshëm në qoftë se e drejta për të cilën bëhet fjalë si në procedurën kryesore ashtu edhe në procedurën e urdhrin parandalues ishte “civile” brenda kuptimit të nenit 6 dhe masa e ndërmjetme vendoste për të drejtën “civile” në fjalë. Megjithatë, Gjykata e pranoi që në raste të pazakonta mund të mos jetë e mundur të veprohet në pajtueshmëri me të gjitha kriteret e nenit 6, sadoqë pavarësia dhe paanshmëria e gjykatës ose gjyqtarit mbeteshin mbrojtje të patjetërsueshme.

Në rastin konkret, thelbi i të drejtës në fjalë në procedurën kryesore kishte të bënte me shfrytëzimin nga fqinjët të të drejtave pronësore në përputhje me ligjin maltez, pra një e drejtë me karakter “civil” sipas të drejtës vendase dhe sipas praktikës së Gjykatës. Qëllimi i urdhrin parandalues ishte të vendoste rreth të njëjtës të drejtë si ajo që kontestohet në procedurën kryesore dhe ishte menjëherë i jetësueshëm. Prandaj neni 6 ishte i zbatueshëm.

Më tej, gjatë shqyrtimit të themeleve të çështjes Gjykata përsëriti se ajo e vlerësonte paanshmërinë e një gjykate ose gjyqtari sipas testit subjektiv i cili merrte parasysh sjelljen e gjyqtarit, dhe sipas testit objektiv i cili, larg sjelljes së gjyqtarit, kërkonte të përcaktonte nëse kishte fakte të vërtetueshme, siç janë lidhje hierarkie apo të tjera mes gjyqtarit dhe aktorëve të tjerë në procedurë të cilat mund të ngrinin dyshime rreth paanshmërisë së tij. Gjykata theksoi se edhe dukja mund të kishte njëfarë rëndësie në atë aspekt.

Gjykata vuri në dukje se sipas ligjeve në Maltë, ashtu siç ishin në kohën relevante, nuk ekzistonte detyrimi automatik që një gjyqtar të tërhiqej në rastet kur paanshmëria mund të ishte problem. Po kështu, një palë në procedurë gjyqësore nuk mund të kontestonte një gjyqtar mbi bazën e marrëdhënieve vëllazërore – e jo më një marrëdhënie xhaxha-nip – mes gjyqtarit dhe avokatit që përfaqëson palën tjetër. Që nga ajo kohë ligji në Maltë është ndryshuar, dhe tani përfshin marrëdhëniet vëllazërore si bazë për tërheqjen e një gjyqtari. Në mosmarrëveshjen në fjalë, Gjykata që e mendimit se lidhjet e afërta familjare mes avokatit të palës kundërshtare dhe Kryetarit të trupit gjykues mjaftonin për të justifikuar në mënyrë objektive frikën se trupit gjykues i mungonte paanshmëria. Rrjedhimisht, ajo arriti në përfundimin se kishte pasur shkelje të nenit 6 § 1.

#### Neni 41

Gjykata konsideroi se gjetja e një shkeljeje përbënte shpërblim të drejtë të mjaftueshëm, por i caktoi kërkuesit 2,000 euro në lidhje me kosto dhe shpenzime.

## (8) Paanshmëria – Paanshmëria Personale

*Emërimi i anëtarit të trupit gjykues në gjyqin e rëndësishëm rreth skandalit të përvetësimit në Poloni përbëri shkelje të nenit 6 për shkak se gjykata nuk ishte ngritur sipas ligjit, megjithatë nuk u gjetën shkelje të tjera të nenit 6*

### VENDIMI NË ÇËSHTJEN CHIM DHE PRZYWIECZERSKI k. POLONISË

(Kërkesat nr. 36661/07 dhe nr. 38433/07)

12 prill 2018

#### 1. Faktet kryesore

Kërkuesja e parë ishte Janina Irena Chim, e lindur në vitin 1950 me banim në Poloni. Kërkuesi i dytë ishte Dariusz Przywieczerski, i lindur në vitin 1946 me banim në Shtetet e Bashkuara. Znj. Chim ishte zv/drejtoreshë e përgjithshme e Fondit për Shërbimin e Borxhit të Jashtëm (FOZZ) që administrohej nga shteti. Z. Przywieczerski ishte drejtor menaxhues dhe kryetar i bordit të një kompanie që kryente transaksione rregullisht me FOZZ-in. Qëllimi i FOZZ-it ishte të mblidhte dhe të menaxhonte fondet e dedikuara për borxhin e jashtëm të Polonisë.

Në maj 1991, nisën hetimet pas një ankese nga një individ në konsullatën polake në Köln të Gjermanisë. Akuzat ndaj kërkuesve u ngritën në janar 1998, dhe në mars 2005 të dy u shpallën fajtorë për përvetësim të fondeve të FOZZ-it dhe vepra të tjera. Kërkuesja e parë dhe kërkuesi i dytë u dënuan respektivisht me gjashtë vjet burgim dhe dy vjet e gjysmë burgim, përveç gjobave.

Kërkuesit apeluan kundër dënimeve të tyre pranë Gjykatës së Apelit të Varshavës. Ata pretenduan se emërimi i Gjyqtarit A.K. në gjyqin rreth çështjes së tyre me urdhër të Kryetarit të Divizionit të 8-të kishte shkelur Kodin e Procedurës Penale (KPP) të Polonisë dhe ishte i paligjshëm. Më tej, ata pretenduan se atij i mungonte paanshmëria. Kërkuesi i dytë vuri theksin tek deklaratat e bëra nga Gjyqtari A.K. në fillim të gjyqit dhe tek disa paragrafë në arsyetimin e vendimit që tregonin qëndrime negative karshi kërkuesit të dytë. Gjithashtu, u tërhoq vëmendja drejt një interviste të dhënë nga Gjyqtari A.K. në të cilën, sipas kërkuesve, ai kishte presupozuar fajësinë e të pandehurve dhe kishte deklaruar se të ashtuquajturat “jaka të bardha” duhet të ishin dënuar rreptësisht. Më tej, kërkuesit vunë në dukje lidhjet e supozuara të Gjyqtarit A.K. me partinë e Ligjit dhe Drejtësisë dhe përfshirjen e tij në hartimin e ligjeve për amendamente në periudhat e kufizimit

për veprat e përmbajtura në aktakuzën e kërkuesit të dytë (Amendamenti i vitit 2005).

Apeli qe pjesërisht i suksesshëm. Në janar 2006, Gjykata e Apelit në Varshavë prishi disa prej dënimeve dhe zbriti gjobat e vëna ndaj kërkuesve. Gjykata e Apelit njohu defektet në emërimin e Gjyqtarit A.K. në çështje, dhe konstatoi se ai kishte tentuar në mënyrë aktive që të ndikonte tek Amendamenti i vitit 2005 në dëm të kërkuesve. Megjithatë, Gjykata e Apelit e konfirmoi dënimin e kërkuesve për përvetësim të pasurisë së FOZZ-it në vlerë të konsiderueshme, mbi bazën që mangësitë e pranuar nuk ndikonin tek përmbajtja e gjykimit të Gjyqtarit A.K., dhe e rrëzoi pjesën e mbetur të apeleve.

Prokurori i Përgjithshëm e apeloj çështjen pranë Gjykatës Supreme. Në shkurt 2007, Gjykata Supreme prishi një pjesë të vendimit të Gjykatës së Apelit dhe lejoi ndërprerjen e procedurës kundër kërkuesit të dytë, duke deklaruar se Gjykata e Apelit i kishte tejkaluar fuqitë e saj duke refuzuar të zbatonte një ligj që ajo e shihte si jokushtetues. Me udhëzim të Gjykatës Supreme, Gjykata e Apelit i kërkoi Gjykatës Kushtetuese të shqyrtonte kushtetutshmërinë e Amendamentit të vitit 2005. Në shkurt 2009 Gjykata Kushtetuese iu referua vendimit të saj të mëhershëm në vitin 2008 që Amendamenti i vitit 2005 ishte kushtetues dhe nuk kishte ndikuar në përcaktimin gjyqësor të çështjes FOZZ.

## 2. Vendimi i Gjykatës

Kërkuesit u ankuan sipas nenit 6 § 1 (e drejta për proces të drejtë) që Gjyqtari A.K. ishte emëruar në shkelje të ligjeve vendase, që ai nuk kishte qenë i paanshëm dhe që kishte pasur ndërhyrje legjislative në procedurat penale për shkak të Amendamentit të vitit 2005.

### Neni 6 § 1

Kërkuesit kishin argumentuar që trupi gjykues nuk kishte qenë “gjykatë e ngritur me ligj” sepse ai nuk ishte përbërë në përputhje me KPP-në dhe prandaj ishte i paligjshëm. Nga ana tjetër, Qeveria kishte parashtuar që emërimi i Gjyqtarit A.K. nuk ishte arbitrar por ishte bërë pas një vendimi të Bordit të Gjykatës Rajonale të Varshavës. Qeveria gjithashtu kishte përmendur konsiderata praktike: shkalla dhe kompleksiteti i çështjes kërkonin që kjo çështje t’i caktohej një gjyqtari që mund ta shqyrtonte atë me shpejtësi. Gjykata theksoi se Gjykata Supreme e kishte shqyrtuar këtë çështje me hollësi, dhe qe dakord me gjetjen e mëparshme të Gjykatës Supreme që emërimi i Gjyqtarit A.K. kishte shkelur KPP-në. U arrit në përfundimin se trupi i

gjyqit nuk mund të shihej si “gjykatë e ngritur me ligj” dhe rrjedhimisht kishte pasur shkelje të nenit 6 § 1.

Më pas Gjykata mori në shqyrtim pretendimet e kërkuësve për njëanshmërinë e Gjyqtarit A.K. Gjykata kujtoi se testi i paanshmërisë përfshin testin subjektiv, i cili shqyrtonte bindjet personale dhe sjelljen e gjyqtarit për të përcaktuar nëse këto përmbajnë ndonjë paragjykim personal ose *njëanshmëri* në një çështje të dhënë, dhe testin objektiv, i cili vlerëson nëse ka fakte të vërtetueshme që mund të hedhin dyshime mbi paanshmërinë e gjyqtarit.

Në lidhje me testin subjektiv, Gjykata u pajtua me gjetjet e mëparshme të Gjykatës së Apelit që paragrafët e arsytimit nuk mund të konsideroheshin të tillë që tregonin paragjykime personale ose njëanshmëri. Gjykata e Apelit gjeti që kërkuësi i dytë nuk mundi të vërtetonte se në ç’mënyrë paragrafët e cituar të arsytimit të gjyqtarit përbënin prova të qëndrimit negativ. Sa u përket deklarimeve në media, ndërkohë që u vu në dukje se do të kishte qenë e preferueshme që Gjyqtari A.K. të ishte përmbajtur plotësisht nga shprehja e pikëpamjeve të tij në media, megjithatë ai nuk kishte lënë të kuptohej se kishte krijuar mendim të pafavorshëm për kërkuësit ose nuk kishte bërë ndonjë deklaram të fajësisë së tyre. Më tej, nuk rridhte domosdoshmërisht nga komentet në favor të një politike penale të rreptë që Gjyqtari A.K. i konsideronte kërkuësit fajtorë. Kështu, u deklarua se kërkuësit nuk e kishin konstatuar njëanshmërinë personale nga ana e Gjyqtarit A.K.

Në lidhje me testin objektiv, kërkuësit pretenduan paanshmërinë mbi bazën e: i) emërimit të Gjyqtarit A.K. në çështjen e kërkuësve në shkelje të KPP-së dhe ii) përfshirjen e tij të supozuar në miratimin e Amendamentit të vitit 2005, pavarësisht nga përfshirja e tij në çështjet e kërkuësve.

Në lidhje me të parin, u theksua se kërkuësit nuk kishin arritur të demonstrosnin para Gjykatës Supreme që emërimi kishte rezultuar me ndonjë mangësi në çështjen e tyre. Kjo, së bashku me mungesën e ndonjë sugjerimi që Gjyqtari A.K. kishte bërë që çështja t’i caktohej atij për arsye personale çuan në përfundimin se pretendimet e kërkuësve për paanshmëri nuk ishin objektivist të justifikuar. Në lidhje me të dytin, Gjykata theksoi se Gjykata Supreme i) refuzoi gjetjen e Gjykatës së Apelit që Gjyqtari A.K. kishte kërkuar në mënyrë aktive të ndikonte mbi amendamentin e ligjit; dhe ii) përjashtoi mundësinë që debati parlamentar kishte ndodhur njëkohësisht me seancat gjyqësore. Më tej, Gjykata analizoi procesverbalet e komisionit parlamentar që kishte mbikëqyrur Amendamentin e vitit 2005 dhe vuri re që Gjyqtari A.K. më shumë kishte munguar në diskutime; në njërin rast që kishte qenë i pranishëm, ai ishte penguar të komentonte. Gjithashtu, u tha se kërkuësit nuk kishin arritur të

paraqisnin prova për të mbështetur pretendimet që Gjyqtari A.K. i kishte këshilluar deputetët e tij të opozitës rreth Amendamentit 2005 ose që ai kishte faktikisht lidhje politike me partinë e Ligjit dhe Drejtësisë. Prandaj, Gjykata arriti në përfundimin se nuk kishte shkelje të nenit 6 për shkak të paanshmërisë së supozuar të Gjyqtarit A.K.

Në fund, Gjykata shqyrtoi pretendimet e kërkuësve për ndërhyrje legjislative. Gjykata theksoi se ankesa e kërkuësës së parë nuk ishte e pranueshme për shkak se Amendamenti 2005 për shtyrjen e periudhave të kufizimit nuk ndikonte në periudhat e kufizimit për veprat për të cilat ajo ishte shpallur fajtoresh, kështu që u refuzua. Gjykata arriti në përfundimin se ankesat e kërkuësve të dytë ishin të pranueshme. Megjithatë, iu bë referencë arsyetimit të Gjykatës Kushtetuese që ligji nuk e kishte prekur në mënyrë substanciale përcaktimin gjyqësor të çështjes së kërkuësve të dytë por thjesht kishte shtyrë afatin kohor për përgjegjësinë penale. Gjykata po ashtu reflektoi mbi praktikën gjyqësore ekzistuese ku thuhej se periudhat e kufizimit ishin ligje procedurale të cilat nuk caktonin dënime ose nuk përkufizonin vepra. Në mungesë të arbitraritetit në çështjen e kërkuësve të dytë, Gjykata arriti në përfundimin që nuk kishte pasur shkelje të nenit 6 § 1 për shkak të ndërhyrjes legjislative.

Në përfundim, Gjykata gjeti shkelje të nenit 6 § 1 për sa i përket parimit të “gjykatës së ngritur me ligj”, por nuk gjeti shkelje në lidhje me ankesat e tjera të kërkuësve.

#### Neni 41

Gjykata refuzoi pretendimin e kërkuësës së parë për kompensim të dëmeve materiale dhe jomateriale dhe pretendimin e kërkuësve të dytë për dëme materiale, duke përfunduar se pretendimi i tij në lidhje me dëme materiale përmbushej vetëm me gjetjen e një shkeljeje. U urdhërua që Qeveria t'i paguante 5,000 euro kërkuësve të dytë për kosto dhe shpenzime, plus interesin.



*Hetimi dhe gjyqi i një figure të lartë në një bankë të falimentuar përfshiu shumë shkelje të të drejtave të kërkuarit sipas nenit 6 për t'u gjykuar nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme të ngritur me ligj dhe për të pasur një seancë brenda një kohe të arsyeshme, përveç shkeljeve të neneve 5 dhe 8*

## VENDIMI NË ÇËSHTJEN LAVENTS k. LETONISË

---

(Kërkesa nr. 58442/00)

**28 nëntor 2002**

### **1. Faktet kryesore**

Kërkuesi, Aleksandrs Lavents, ishte i lindur në vitin 1959 dhe jetonte në Riga të Letonisë. Ai ishte kryetar i bordit mbikqyrës të bankës më të madhe në Letoni. Banka kaloi në likuidim, duke shkaktuar dëme të mëdha për ekonominë kombëtare dhe shkatërrimin financiar të qindra mijëra njerëzve. Prokurori që u mor me çështjen e kërkuarit e konsideronte atë të dyshuar për veprën e sabotimit për autorizimin e transferimit të afro 139 milionë eurove në një bankë ruse me seli në Moskë në këmbim të zotimit për një pagesë në formën e obligacioneve qeveritare ruse. Kërkuesi gjithashtu u akuzua për kryerjen e veprimeve mashtruese me qëllim të krijimit të imazhit të qëndrueshmërisë dhe prosperitetit për bankën.

Më 1 qershor 1995, kërkuesi u deklarua formalisht i dyshuar për akuzën e sabotimit dhe u mor në pyetje, dhe më 28 qershor 1995 ai u vu nën hetime. Pas një urdhri për paraburgimin e tij në pritje të gjyqit, ai u paraburgos më 14 korrik 1995. Gjatë hetimeve, paraburgimi paragjyqësor i kërkuarit u vazhdua disa herë, pavarësisht nga disa apele. Përveç kësaj, gjatë asaj periudhe ai u shtrua dy herë në spital nën kujdesin mjekësor për shkak të problemeve me zemër.

Më 12 qeshor 1997, gjyqi i çështjes u caktua të mbahej në Gjykatën Rajonale të Rigës. Gjykata e rrëzoi kërkesën e kërkuarit për lirim, mbi bazën se ai akuzohej për vepra të rënda dhe se gjendja e tij shëndetësore nuk kërkonte ndryshimin e masës së ndalimit ndaj tij. Pas një sulmi në zemër gjatë seancës së 14 tetorit 1997, kërkuesi u vendos në arrest shtëpiak; ai u mbajt nën vëzhgim dhe u ndalua të largohej nga banesa e tij. Të nesërmen e atij vendimi, gazeta ditore më e madhe në Letoni në atë kohë botoi një deklaratë nga Kryeministri dhe Ministri i Drejtësisë ku ata shprehnin mospajtimin e tyre me ndryshimin e masës së ndalimit ndaj kërkuarit. Ditën e nesërme, gjyqtarët e çështjes u tërhoqën për shkak të presionit “nga Qeveria dhe publiku”, dhe çështja iu caktua një trupi gjykues tjetër nga e njëjta gjykatë.

Gjithashtu në tetor 1997, korrespondenca e kërkuetit – përfshirë ajo me avokatët e tij – u bastis dhe u ekzaminua mbi bazën e një urdhri nga një gjyqtar. Në kohën e vendimit të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, ajo masë ishte ende në fuqi. Më 14 shtator 1998 kërkueti u burgos. Ai bëri gjithsej nëntë kërkesa për lirim, ku të gjitha u refuzuan për shkak se karakteri i tij dhe natyra e rëndë e akuzave e bënë të nevojshme mbajtjen e tij prapa hekurave. Për shkak të gjendjes së tij shëndetësore, ai sërish u shtrua në spital, si në burg – ku iu mohuan vizitat familjare – ashtu edhe në qendra spitalore të jashtme.

Në disa raste gjatë gjyqit, kërkueti e kontestoi kryetaren e trupit gjykues të Gjykatës Rajonale, znj. Šteinerte, dhe dy gjyqtarët e tjerë në trup, duke i akuzuar ata për njëanshmëri dhe për fshehjen e një prove të rëndësishme shfajësuese. Një urdhër nga dy gjyqtarët e tjerë që znj. Šteinerte të tërhiqej u anulua më 14 dhjetor 1999 nga Senati i Gjykatës Supreme, me kërkesë të palës së akuzës. Kontesti më pas iu referua Gjykatës Rajonale të Rigës e cila, me një trup gjykues të përbërë nga pikërisht të njëjtët anëtarë dhe me znj. Šteinerte si kryetare të trupit gjykues, e rrëzoi atë. Më tej, në nëntor dhe dhjetor 1999 znj. Šteinerte dha disa deklaratat për shtyp në dy gazeta ku kritikoi zhvillimin e mbrojtjes dhe aludoi rreth rezultatit të gjyqit. Ajo gjithashtu shprehu habinë e saj për faktin që kërkueti ngulte këmbë në mohimin e akuzave, dhe i bëri thirrje atij që ta vërtetonte pafajësinë e tij.

Në një vendim të 28 dhjetorit 2001, kërkueti u shpall fajtor dhe u dënua me nëntë vjet burg. Në kohën e vendimit të Gjykatës Evropiane, procedura e apelit ishte ende në vazhdim.

## 2. Vendimi i Gjykatës

Kërkueti u ankua sipas nenit 5 për kohëzgjatjen e paraburgimit të tij në pritje të gjyqit dhe për mungesën e shqyrtimit gjyqësor efektiv të paraburgimit. Sipas nenit 6, ai parashtrio se ai nuk kishte pasur seancë dëgjimore brenda një kohe të arsyeshme ose të zhvilluar nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme të ngritur me ligj dhe se deklaratat e bëra në shtyp nga gjyqtarja në lidhje me çështjen e tij kishin treguar që ajo ishte e bindur për fajësinë e tij. Më tej ai parashtrio se bastisja dhe ekzaminimi i korrespondencës së tij dhe ndalimi i vizitave familjare gjatë një pjese të qëndrimit të tij në paraburgim kishin shkelur nenin 8.

### Neni 5 § 3

Gjykata theksoi se për 11 muaj kërkueti kishte qenë gjatë tërë kohës i ngjuar brenda banesës së tij nën mbikqyrje, i ndaluar rreptësisht që të largohej prej aty. Ajo

tha se shkalla e kufizimit e ngërthyer nga një masë e tillë ishte e mjaftueshme për ta parë atë si privim i lirisë brenda kuptimit të nenit 5. E njëjta gjë vlente edhe për periudhat e kaluara në spital.

Gjykata mundi vetëm të merrte në shqyrtim periudhën pas 27 qershorit 1997, data kur kishte hyrë në fuqi Konventa në lidhje me Letoninë. Megjithatë, ajo duhet të merrte parasysh edhe periudhën tashmë të kaluar në paraburgim deri në atë datë në mënyrë që të vlerësonte nëse kohëzgjatja e paraburgimit ishte e arsyeshme. Kështu ajo vuri re se kishin kaluar gjashtë vjet, pesë muaj e 14 ditë që nga data e arrestimit të kërkuesit e deri në datën kur një gjykatë kishte vendosur në lidhje me themelet e akuzave kundër tij, përfshirë një periudhë prej katër vjet e gjashtë muaj pasi Konventa kishte hyrë në fuqi në lidhje me Letoninë.

Gjykata theksoi se, pas hyrjes në fuqi të Konventës, Gjykata Rajonale kishte refuzuar në nëntë raste kërkesat për lirimin e kërkuesve pa dhënë arsye të mjaftueshme të hollësishme. Sipas mendimit të Gjykatës, baza të tilla nuk mund të justifikonin paraburgimin e zgjatur të kërkuesit dhe nuk i qëndronin testit të kohës së nevojshme për mbajtjen e procesit, rrjedhimisht kishte pasur shkelje të nenit 5 § 3.

#### Neni 5 § 4

Gjykata kishte juridiksion për ta shqyrtuar këtë ankesë vetëm sa i përket periudhës pas 27 qershorit 1997, dhe kjo do të thoshte që ekzaminimi i efektivitetit të shqyrtimit gjyqësor kishte të bënte vetëm me fazën e gjyqit në procedurë.

Gjykata Rajonale e Rigës ishte ftuar të merrte në shqyrtim themelet dhe gjithashtu kishte pasur detyrën e shqyrtimit të kërkesave të kërkuesit për lirim. Në lidhje me këtë, Gjykata iu referua përfundimeve të saj (poshtë) sipas nenit 6 § 1 për faktin se kërkuesi nuk ishte gjykuar nga një gjykatë e pavarur dhe se trupi gjyqësor që kishte trajtuar çështjen e tij nuk kishte qenë “i ngritur me ligj” sa i përket periudhës pas 14 dhjetorit 1999. Rrjedhimisht, Gjykata deklaroi se kishte pasur shkelje të nenit 5 § 4.

#### Neni 6 § 1

Gjykata përcaktoi se procedurat në çështjen e kërkuesit kishin filluar kur ai ishte marrë në pyetje për herë të parë si i dyshuar më 28 dhjetor 2001. Pra, procedurat, apeli ndaj të cilave ende vazhdonte, kishin zgjatur pothuajse gjashtë vjet e shtatë muaj. Megjithëse Gjykata mund ta shqyrtonte këtë ankesë vetëm duke nisur nga data e hyrjes në fuqi të Konventës në lidhje me Letoninë, ajo vuri në dukje se ajo duhet të

merрте parasysht fazën deri ku kishin shkuar procedurat deri në atë datë. Deri në atë datë, hetimet e çështjes kishin marrë dy vjet e 27 ditë.

Çështja ishte tepër komplekse dhe shumë vonesa ishin shkaktuar nga gjendja shëndetësore e kërkuesit, megjithëse kërkuesi nuk mund të mbahej përgjegjës për vonesa të tilla sepse ato kishin qenë pasojë e një force madhore. Sa i përket sjelljes së autoriteteve nacionale, pothuajse 11 muaj kishin kaluar mes datës kur gjyqtarët ishin tërhequr nga çështja e tij, duke dhënë si shkas presionin qeveritar, dhe datës kur çështja i ishte dhënë një trupi gjykues tjetër, ku për këtë mosveprim nuk ishin dhënë arsye. U arrit në përfundimin që autoritetet gjyqësore nuk kishin treguar zellin e duhur për zhvillimin e procedurave, dhe u deklarua që kishte pasur shkelje të nenit 6 § 1.

Gjykata shënoi se urdhri për tërheqjen e znj. Šteinerte ishte anuluar nga Senati i Gjykatës Supreme me kërkesë të prokurorisë. Në kundërshtim me udhëzimet e dhëna nga Senati në urdhrin e tij, çështja iu referua të njëjtit trup gjykues të Gjykatës Rajonale të Rigës që ishte tërhequr fillimisht. Më tej Gjykata theksoi se pas anulimit të vendimit nga dy gjyqtarët jo-kryetarë të trupit gjykues, ata gjyqtarë ishin skualifikuar me ligj nga të gjykuarit e asaj çështjeje. Kështu, trupi gjykues i Gjykatës Rajonale nuk ishte përbërë në përputhje me ligjin, dhe prandaj kishte pasur shkelje të nenit 6 § 1 në atë pikë.

Gjykata theksoi se në shtyp znj. Šteinerte kishte kritikuar sjelljen e mbrojtjes, kishte bërë parashikime rreth rezultatit të gjyqit dhe kishte shprehur habinë e saj rreth faktit që kërkuesi me këmbëngulje deklarohet i pafajshëm, duke i bërë thirrje atij që të vërtetonte pafajësinë e vet. Sipas mendimit të Gjykatës, ato deklarata përbënin marrje e një qëndrimi definitiv në lidhje me rezultatin e gjyqit, me preferencë të spikatur për shpalljen fajtor të kërkuesit. Deklaratat shkaktuan frikë te kërkuesi se gjyqtarja në fjalë nuk ishte e paanshme. Rrjedhimisht, Gjykata deklaroi se kishte pasur shkelje të nenit 6 § 1 për shkak të mungesës së paanshmërisë së gjykatës, dhe deklaroi që gjetja e bënte të panevojshëm shqyrtimin e ndarë të çështjes nëse gjykata kishte qenë “e pavarur”.

#### Neni 6 § 2

Gjykata theksoi se nga deklaratat e znj. Šteinerte në shtyp dukej se ajo ishte e bindur për fajësinë e kërkuesit. Madje ajo kishte sugjeruar që ai ta vërtetonte se nuk ishte fajtor, një sjellje e cila ishte ndryshe nga parimi i prezumimit të pafajësisë. Rrjedhimisht, Gjykata deklaroi se kishte pasur shkelje të nenit 6 § 2.

### Neni 8

Gjykata përcaktoi se kishte pasur ndërhyrje tek e drejta e kërkuesit për respektim të korrespondencës së tij. Ajo nënvizoi se masa në fjalë ishte urdhëruar nga një gjyqtar mbi bazën e Kodit të Procedurës Penale, i cili e autorizonte një masë të tillë në rastet e personave të akuzuar për vepra posaçërisht të rënda. Sipas mendimit të Gjykatës, ajo dispozitë i jepte gjykatave hapësirë të tepërt duke cekur thjesht llojet e veprave dhe duke mos specifikuar periudhën e vlefshmërisë së masës ose arsyet për të cilat ajo vendosej. Ligji që ishte zbatuar nuk e parashikonte mjaftueshëm fushëveprimin dhe mënyrën e ushtrimit të diskrecionit dhënë autoriteteve. Gjykata deklaroi se ndërhyrja nuk kishte qenë e parashikuar me ligj dhe prandaj kishte pasur shkelje të nenit 8.

Gjykata gjithashtu theksoi se kishte pasur ndërhyrje tek e drejta e kërkuesit për respektim të jetës së tij familjare. Bashkëshortja dhe vajza e kërkuesit nuk ishin lejuar ta vizitonin atë gjatë tri periudhave, ku më e gjata kishte qenë pothuaj një vit e shtatë muaj. Për më tepër, ndalimi kishte qenë absolut. Më tej, Gjykata vuri në dukje se kërkuesi nuk u përfshi në asnjë formë në marrëveshje të fshehta apo pengim të hetimeve rreth çështjes së tij gjatë periudhës së arrestit shtëpiak, pavarësisht se kishte kontakte të palimituara me familjen e tij. Prandaj, Gjykata nuk qe e bindur se zbatimi i një mase kaq të shtrënguar kishte qenë proporcional. Kështu ajo vendosi se kishte pasur shkelje të nenit 8 në atë aspekt.

### Neni 41

Gjykata i caktoi kërkuesit 15,000 euro për kosto dhe shpenzime.

*Frika e kërkuetit rreth paanshmërisë së trupit gjykues, ku kryetari i trupit gjykues kishte punuar me dhe për një gjyqtar tjetër i cili ishte protagonist në çështje, ishte objektivisht e justifikuar në shkelje të nenit 6*

## VENDIMI NË ÇËSHTJEN MITROV k. ISH-REPUBLIKËS JUGOSLLAVE TË MAQEDONISË

---

(Kërkesa nr. 45959/09)  
**2 qershor 2016**

### 1. Faktet kryesore

Kërkueti, Slobodan Mitrov, ishte i lindur në vitin 1974 dhe jetonte në Strumnicë. Në nëntor të vitit 2006, kërkueti u përfshi, si shofer, në një aksident trafiku në të cilin vajza 18-vjeçare e kryetares së seksionit penal të Gjykatës së Shkallës së Parë të Strumnicës, Gjyqtare M.A., humbi jetën. Në kohën kur nisi procedura penale, në seksionin penal të gjykatës punonin katër gjyqtarë (Gjyqtarët M.A., C.K., T.D. dhe G.M). Gjyqtari C.K., para se të emërohej gjyqtar në vitin 2005, kishte punuar si nëpunës dhe më pas me Gjyqtaren M.A. dhe dy gjyqtarë të tjerë. Përveç kësaj, Gjyqtari B.B. ishte gjyqtar hetues në trupin gjykues, Gjyqtari V.D. punonte me çështje të lidhura me vepra të kundërvajtjes, dhe Gjyqtari S.D. ishte në pushim shëndetësor.

Në prill 2007, pas hetimeve të zhvilluara nga Gjyqtari B.B., të cilat përfshinë, *inter alia*, paraqitjen e një raporti ekspert “raporti i parë ekspert”), prokurori publik ngriti aktakuzën kundër kërkuetit për “krime të rënda kundër sigurisë së personave dhe pronave në trafik”. Në maj 2007, një trup gjykues me tre anëtarë, i kryesuar nga Gjyqtari T.D., e rrëzoi kundërshtimin e kërkuetit ndaj aktakuzës. Në qershor 2007, me kërkesë të kërkuetit u hartua një raport ekspert tjetër nga një agjenci private ekspertësh (“raporti i dytë ekspert”).

Në korrik të vitit 2007, kërkueti i kërkoi kryetarit të trupit gjykues që të përjashtonte gjyqtarët e trupit gjykues që kishin shërbyer në procedurën penale, si dhe Gjyqtarët G.M., S.D. dhe T.D. Më tej, ai u ankua se hetimet kishin qenë të padrejta, dhe pretendoi se Gjyqtari B.B. kishte qenë i njëanshëm. Kryetari i trupit gjykues e rrëzoi kërkesën për përjashtim të Gjyqtarëve C.K. dhe T.D. dhe e refuzoi si të papranueshme kërkesën në lidhje me Gjyqtarët G.M. dhe S.D., të cilët nuk kishin shërbyer në atë çështje. Gjyqi vazhdoi, dhe në të njëjtën ditë kërkueti bëri një kërkesë të re për përjashtimin e Gjyqtarit T.D., i cili më pas u konfirmua nga kryetari i trupit gjykues.

Në mars 2008, trupi gjykues e shpalli kërkesin fajtor dhe e dënoi me katër vjet e gjashtë muaj burg. Ai gjithashtu konfirmoi kërkesën për kompensim të bërë nga Gjyqtarja M.A., bashkëshorti i saj dhe vajza tjetër e saj kundër kompanisë së sigurimeve të kërkesit, e cila e kishte njohur kërkesën.

Në prill 2008, kërkuesi apeloj kundër vendimit përfundimtar duke argumentuar, *inter alia*, se çështja duhet t'i ishte caktuar një gjykate tjetër. Ai gjithashtu u ankua se trupi gjykues nuk i kishte pranuar provat e propozuara prej tij. Kërkuesi më tej kërkoi që çështja të rikthehej dhe të dëgjohej nga një trup tjetër gjykues ose para një gjykate tjetër. Në shtator 2008, gjykata e apelit e rrëzoi apelin e kërkesit, konfirmoi apelin e prokurorit, dhe e rriti dënimin në gjashtë vjet burg.

Në nëntor 2008 kërkuesi bëri kërkesë për shqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit përfundimtar, por kjo më pas u rrëzua nga Gjykata Supreme, e cila mbështeti gjetjet dhe arsyetimin e gjykatave më të ulëta, pa dhënë arsye të mëtejshme në lidhje me ankesën e kërkesit në lidhje me njëanshmërinë e pretenduar të gjyqtarëve. Në shtator 2010 dhe mars 2011, Gjykata Supreme rrëzoi dy kërkesa të kërkesit për lehtësimin e dënimit të tij.

## **2. Vendimi i Gjykatës**

Kërkuesi u ankua sipas nenit 6 § 1 të Konventës se çështja e tij nuk ishte dëgjuar nga një gjykatë e paanshme, sepse gjyqtarëve të trupit gjykues u mungonte paanshmëria e nevojshme. Më tej, ai u ankua për shkelje të parimit të barazisë së armëve për shkak se gjykatat kishin refuzuar të pranonin provat e propozuara prej tij.

### Neni 6 § 1

Gjykata përsëriti që, sipas praktikës së saj gjyqësore të vendosur, ekzistenca e paanshmërisë për qëllimet e nenit 6 § 1 duhet të përcaktohet sipas testit subjektiv në një çështje të dhënë, dhe gjithashtu sipas një testi objektiv, çka i mundësonte Gjykatës të siguronte nëse vetë gjykata dhe, mes aspekteve të tjera, përbërja e saj, ofronin garanci të mjaftueshme për të përjashtuar çdo dyshim të përligjur rreth paanshmërisë së saj. Në rastin konkret, Gjykata gjeti se nuk ishin dhënë prova të njëanshmërisë personale nga ana e gjyqtarëve të trupit gjykues që kishin gjykuar çështjen e kërkesit. Më pas, ajo mori në shqyrtim nëse dyshimet e kërkesit lidhur me paanshmërinë e gjyqit të tij, që rridhnin nga rrethanat specifike, mund të shiheshin si objektivisht të justifikuar në rrethanat e çështjes.

Gjykata filloi duke shpjeguar se në praktikën e saj gjyqësore testi objektiv më shumë kishte të bënte me lidhjet hierarkike mes kryetarit të trupit gjykues dhe protagonistëve të tjerë në procedurë. Megjithatë, në këtë rast Gjykata u përqendrua tek fakti nëse ekzistonin lidhje personale mes kryetarit të trupit gjykues dhe protagonistëve të tjerë në procedurë. Këtu, Gjykata gjeti që nuk mund të përjashtohej se ekzistonin lidhje personale mes gjyqtarëve të tjerë në seksionin penal të gjykatës ku u mbajt gjyqi dhe Gjyqtarës M.A., duke pasur parasysh numrin e kufizuar të gjyqtarëve të emëruar në seksionin penal të gjykatës ku u mbajt gjyqi në kohën relevante si dhe faktin që ata të gjithë punonin me orar të plotë dhe kryenin funksione të ngjashme.

Duke pasur parasysh që këto lidhje ekzistonin, Gjykata vlerësoi se natyra e këtyre lidhjeve ishte e rëndësishë kyçe për të përcaktuar nëse frika e kërkuesit rreth paanshmërisë së gjyqit të tij ishte objektivisht e justifikuar. Në atë aspekt, Gjykata vlerësoi marrëdhënien mes Gjyqtarës M.A. dhe Gjyqtarit C.K., i cili kishte qenë kryetar i trupit gjykues në gjyqin e kërkuesit. Këtu, Gjyqtarës M.A. dhe familjes së saj iu dha statusi i viktimës në procedurën kundër kërkuesit, dhe kështu u njohën si protagonistë në procedurë. Në këtë kontekst, Gjyqtari C.K. ishte koleg i Gjyqtarës M.A. si gjyqtar në gjykatën penale, dhe kishte punuar direkt nën mbikqyrjen e saj si nëpunës para se të emërohej gjyqtar. Duke ditur këtë lidhje personale, Gjykata konsideroi se fakti që Gjyqtari C.K. kishte qenë kryetar i trupit gjykues në gjyqin e kërkuesit për vrasjen e vajzës së Gjyqtarës M.A. i jepte shkas dyshimeve objektivisht të justifikuara lidhur me objektivitetin dhe paanshmërinë e Gjyqtarit C.K. Gjykata gjithashtu theksoi se lidhje të tilla të ngjashme po ashtu ekzistonin mes të gjithë gjyqtarëve të gjykatës penale dhe Gjyqtarës M.A.

Më tej, fakti që e drejta vendase ofronte mundësinë e transferimit të çështjes në një gjykatë tjetër kompetente në qoftë se kërkohet, dhe që kjo praktikë ishte ndjekur në një çështje tjetër me rrethana të ngjashme por jo në çështjen e kërkuesit në fjalë, më tej i shtonte peshë dyshimeve të kërkuesit rreth paanshmërisë së gjyqit të tij.

Konsideratat e mësipërme ishin të mjaftueshme që Gjykata të arrinte në përfundimin se në rastin konkret frika e kërkuesit rreth paanshmërisë së trupit gjykues mund të konsiderohej objektivisht e justifikuar, kështu që kishte pasur shkelje të nenit 6 § 1.

Në fund, Gjykata gjeti që nuk ishte e nevojshme të merrej një vendim i ndarë mbi ankesën e kërkuesit sipas nenit 6 për shkelje të parimit të barazisë së armëve.



#### Neni 41

Gjykata i caktoi kërkuetit 3,600 euro në lidhje me dëme jomateriale, dhe 660 euro për kosto dhe shpenzime.

*Procedura disiplinore kundër ish-Kryetarit të Gjykatës Supreme të Kroacisë ka shkelur nenin 6 meqenëse ka ekzistuar frika objektivist e justifikuar rreth mungesës së paanshmërisë së gjyqtarëve*

## VENDIMI NË ÇËSHTJEN OLUJIĆ k. KROACISË<sup>[407]</sup>

---

(Kërkesa nr. 22330/05)  
5 shkurt 2009

### 1. Faktet kryesore

Kërkuesi, Krunislav Olujić, ishte shtetas kroat i lindur në vitin 1952. Ai ishte gjyqtar dhe Kryetar i Gjykatës Supreme, si dhe Anëtar i Këshillit Kombëtar Gjyqësor ('KKGJ'), përpara se të shkarkohej në tetor 1998.

Në vitin 1996, kundër kërkuesit nisën procedurat disiplinore: ai u akuzua se kishte kryer marrëdhënie seksuale me të mitur dhe se kishte përdorur postin për të mbrojtur veprimtaritë financiare të dy individëve të njohur për aktivitetet e tyre kriminale. KKGJ-ja konstatoi se kërkuesi e kishte përdorur vërtet postin në mënyrë të papërshtatshme; ai vendim u konfirmua edhe nga Dhoma e Konteve e Parlamentit. Sidoqoftë, të dy këto vendime u hodhën poshtë në prill të vitit 1998 nga Gjykata Kushtetuese dhe çështja iu kthye për rishqyrtim KKGJ-së.

Në procesin e rinisur përpara KKGJ-së, akuzat kundër kërkuesit u reduktuan: ai u akuzua për miqësi në publik me dy individët që kishin historik kriminal. Në tetor të vitit 1998, kërkuesi u shpall fajtor dhe u shkarkua nga detyra. Në nëntor, Dhoma e Konteve e Parlamentit e konfirmoi vendimin e KKGJ-së.

Në dhjetor të të njëjtit vit, kërkuesi paraqiti një ankesë në Gjykatën Kushtetuese, duke pretenduar, mes të tjerash, se procesi disiplinor nuk ishte mbajtur në publik; se tre anëtarë të KKGJ-së, konkretisht, A.P., V.M. dhe M.H., kishin bërë deklarata kundër tij në media e për rrjedhojë nuk mund të konsideroheshin të paanshëm, dhe se dëshmitarët në favor të tij nuk ishin dëgjuar. Në dhjetor të vitit 2004, ankesa u hodh poshtë si e pabazuar.

---

407 Ky vendim është përfundimtar.

## 2. Vendimi i Gjykatës

Duke u mbështetur veçanërisht në nenin 6 § 1, kërkuesi u ankua për padrejtësinë dhe periudhën e tejzgjatur të procesit disiplinor kundër tij.

### Neni 6 § 1

Gjykata fillimisht mori në shqyrtim pretendimet e kërkuetit në lidhje me paanshmërinë e tre anëtarëve relevantë të KKGj-së. Ajo theksoi rëndësinë e paanshmërisë për shoqërinë demokratike, duke pohuar se ishte thelbësore që gjykatat të ngjallnin besim tek publiku e sidomos tek ata që ishin objekt i vendimeve të tyre. Për Gjykatën, paanshmëria përfaqësonte mungesën e paragjykimit ose njëanshmërisë. Paanshmëria mund të identifikohet duke përdorur një qasje ose test subjektiv i cili merrte parasysh bindjet ose interesat personale e një gjyqtari të dhënë në një çështje të caktuar, dhe një qasje ose test objektiv i cili konsideronte nëse ekzistonin garanci të mjaftueshme për të përjashtuar çdo dyshim legjitim rreth paanshmërisë. Në lidhje me këto dy qasje, Gjykata theksoi se, gjatë zbatimit të testit subjektiv për paanshmërinë e një gjykate, duhet të presupozohet paanshmëria personale e një gjyqtari deri sa s'kishte prova për të kundërtën. Ndërkohë që kjo ishte qartazi pengesë për çdo kërkuet, Gjykata konsideroi se kriteret e testit objektiv mbeteshin garanci e rëndësishme e paanshmërisë. Në lidhje me qasjen objektive, Gjykata deklaroi se çështjet që hynin brenda testit objektiv të paanshmërisë së një gjykatë gjithashtu mund të ngrinin probleme në qoftë se merreshin parasysh gjatë qasjes subjektive. Prandaj, fakti nëse një çështje duhet të shqyrtohet kryesisht ose vetëm me njërin test apo tjetrin, ose nëse duhet të shqyrtohet me të dy testet, do të varej nga faktet e çështjes.

Tre anëtarët e KKGj-së për të cilët ishin ngritur pyetje rreth paanshmërisë ishin A.P., V.M. dhe M.H. Gjykata vërejti se, në shkurt të vitit 1997, gazeta e përditshme *Večernji list* kishte botuar një intervistë me V.M., ndërkohë që çështja ishte në pritje të shqyrtimit nga Dhoma e Konteve. Në atë intervistë V.M. kishte zbuluar se ai e kishte mbështetur kërkuetin kur ky kishte kërkuar tërheqjen e V.M. nga çështja, kishte votuar publikisht kundër emërimit të kërkuetit si Kryetar i Gjykatës Supreme, dhe se ai vetë kishte qenë kandidat i mundshëm për të njëjtin post. Prandaj kjo kishte krijuar një situatë që kishte ngritur dyshime legjitime rreth paanshmërisë së V.M. gjatë kryesimit të çështjes së kërkuetit.

Lidhur me A.P., i cili në atë kohë ishte Kryetar i KKGj-së, Gjykata vërejti se e njëjta gazetë, *Večernji list*, kishte botuar një intervistë të tijën në mars 1997, kur çështja ishte në pritje të gjykimit përpara Gjykatës Kushtetuese, pra nuk ishte vendosur akoma.

Në atë intervistë A.P. kishte deklaruar se kërkuesi kishte kryer aktivitete të turpshme, në mënyrë të veçantë që ai kishte përdorur ndikimin dhe kontaktet e tij personale me qëllim që të mbronte interesat e dy njerëzve me prejardhje kriminale, duke shtuar se akuzat e mbrojtjes se çështja ishte e motivuar politikisht kishin qenë të pavërteta. Këto deklarata nënkuptonin se A.P. kishte krijuar tanimë një opinion të pafavorshëm për çështjen e kërkuesit dhe ishin qartazi në papajtueshmëri me pjesëmarrjen e tij në procedurë, meqenëse ato krijojnë frikën e justifikuar objektive se atij i mungonte paanshmëria.

Gjykata vërejtë më tej se një intervistë e M.H. ishte botuar në një tjetër gazetë të përditshme, *Slobodna Dalmacija*, në shtator 1997, kur çështja ishte po ashtu në pritje të gjykimit nga Gjykata Kushtetuese. Në intervistë M.H. e përshkruante kërkuesin si person të cilit i mungonte përvoja dhe njohuritë dhe si *corpus alienum* (trup i huaj) në gjyqësorin kroat. Gjykata vlerësoi se këto shprehje kishin treguar qartë njëanshmërinë e M.H. kundër kërkuesit dhe se pjesëmarrja e tij në proces pas botimit të intervistës kishte qenë e papajtueshme me kriterin e paanshmërisë.

Për rrjedhojë, Gjykata vendosi se kriteri i paanshmërisë nuk ishte përmbushur nga këta tre aëtarë të KKGJ-së dhe prandaj kishte pasur shkelje të nenit 6 § 1.

Më tej, Gjykata mori në shqyrtim ankesën e kërkuesit në lidhje me të drejtën e tij për seancë publike. Këtu Gjykata konstatoi se KKGJ-ja e kishte përjashtuar publikun nga procesi i gjykimit të çështjes me arsyetimin se kjo ishte e nevojshme për të mbrojtur si dinjitetin e kërkuesit, ashtu edhe atë të gjyqësorit. Megjithatë, vetë kërkuesi kishte kërkuar që procesi të ishte publik dhe kishte treguar, kështu, se nuk e kishte menduar që dinjiteti i tij kërkonte mbrojtje. Për më tepër, duke pasur parasysh që procesi kishte lidhje me një figurë kaq të njohur publike dhe se tashmë ishin ngritur akuza që sugjeronin se çështja kundër tij ishte e motivuar politikisht, ishte e qartë se ishte edhe në interes të kërkuesit, ashtu edhe të publikut të përgjithshëm, që procesi para KKGJ-së të ishte i hapur për t'u vëzhguar nga publiku. Po kështu, mungesa e qasjes së publikut nuk ishte korrigjuar as në procesin përpara Dhomës së Konteve të Parlamentit apo në Gjykatën Kushtetuese. Prandaj, meqenëse nuk ishte respektuar e drejta e kërkuesit për seancë publike, kishte pasur shkelje të nenit 6 § 1.

Më pas, Gjykata mori në shqyrtim ankesën e kërkuesit në lidhje me parimin e barazisë së armëve. Gjykata vlerësoi se arsyet mbi të cilat KKGJ-ja ishte mbështetur për të refuzuar pranimin e dëshmitarëve të thirrur për llogari të kërkuesit me qëllim arsyetimin e linjës së tij të mbrojtjes nuk kishin qenë të mjaftueshme. Në të vërtetë, KKGJ-ja i kishte pranuar të gjitha propozimet për të dëgjuar provat e paraqitura nga dëshmitarët e caktuar nga avokati i Qeverisë dhe nuk kishte pranuar asnjë nga

propozimet e paraqiturs nga kërkuesi. Për rrjedhojë, Gjykata vërejtë se refuzimi i autoriteteve kroate për të marrë në pyetje dëshmitarët e mbrojtjes kishte çuar në kufizimin e aftësisë së kërkuesit për të mbrojtur çështjen e tij, në shkelje të nenit 6 § 1.

Në fund, Gjykata vlerësoi se kohëzgjatja e procesit të rifilluar – mbi gjashtë vjet – kishte qenë e tepruar, sidomos duke pasur parasysh se çka rrezikonte kërkuesi, konkretisht shkarkimin e tij. kjo zgjatje e procedurave kishte përbërë shkelje të nenit 6 § 1.

#### Neni 41

Gjykata i akordoi kërkuesit 5,000 euro për dëme jomateriale por jo për kosto dhe shpenzime për shkak se kërkuesi nuk pati pretendime në lidhje me atë aspekt.

## (9) Paanshmëria – Paanshmëria Funktionale

*Ushtrimi i funksioneve të gjyqtarit hetues dhe gjyqtarit të trupit gjykues nga i njëjti person në të njëjtën çështje shkeli kriterin e gjykatës së pavarur dhe të paanshme sipas nenit 6*

### VENDIMI NË ÇËSHTJEN DE CUBBER k. BELGIKËS

(Kërkesa nr. 9186/80)

**26 tetor 1984**

#### 1. Faktet kryesore

Kërkuesi ishte i lindur në vitin 1926 dhe jetonte në Bruksel. Më 4 prill 1977, ai u arrestua nga policia në shtëpinë e tij dhe u dërgua në stacionin e policisë në Oudenaarde ku u mor në pyetje në lidhje me një vjedhje makine. Kundër kërkuesit u lëshuan urdhërarreste për falsifikimin dhe lëshimin në qarkullim të dokumenteve fallso nga gjyqtari hetues z. Pilate të nesërmen, më 6 maj dhe më 23 shtator 1977. Pas hetimeve paraprake që zgjatën mbi dy vjet, një dhomë e gjykatës e çoi kërkuesin në gjyq.

Për qëllime të gjyqit, gjykata penale e Oudenaarde u mblodh me trupin gjykues të përbërë nga një kryetar dhe dy gjyqtarë, përfshirë z. Pilate. Kërkuesi deklaroi se ai e kundërshtoi gojarisht praninë e këtij të fundit meqenëse ai kishte qenë gjyqtari hetues dhe tani ishte anëtar i trupit gjykues në të njëjtën çështje. Pasi një seance dëgjimore gjykata penale mori vendimin përfundimtar më 29 qershor 1979, ku e shpalli kërkuesin të pafajshëm për dy akuza dhe e dënoi për pjesën e mbetur. Rrjedhimisht, ai u dënua, në lidhje me një të njëjtën çështje, me pesë vjet burg dhe me gjobë në shumën 60,000 franga belge (afro 1,487 euro) dhe, në lidhje me një çështje tjetër, me një vit burg dhe me gjobë në shumën 8,000 franga belge (afro 198 euro).

Edhe kërkuesi, edhe prokurori publik apeluan. Më 4 shkurt 1980, Gjykata e Apelit në Ghent e reduktoi dënimin e parë në tre vjet burg dhe zbriti gjobën. Kërkuesi apeloj në Gjykatën e Kasacionit, duke ngritur rreth dhjetë pika të ligjit. Një prej bazave të tij, mbështetur në Nenin 292 të Kodit Juridik dhe nenin 6 § 1 të Konventës Evropiane të Drejtave të Njeriut, ishte që z. Pilate kishte qenë edhe gjyqtar edhe palë në çështje sepse pas përfundimit të hetimeve paraprake ai kishte vepruar si një prej gjyqtarëve në trupin gjykues. Gjykata e Kasacionit deklaroi se ky kombinim i funksioneve nuk kishte shkelur as Nenin 292 të Kodit Juridik e as nenin 6 § 1 të Konventës.

## 2. Vendimi i Gjykatës

Duke u mbështetur në nenin 6, kërkuesi argumentoi që ai nuk kishte pasur një seancë dëgjimore nga një “gjykatë e paanshme” meqenëse njëri prej tre gjyqtarëve të gjykatës penale të Oudenaarde kishte qenë më parë gjyqtari hetues në çështje.

### Neni 6

Duke konsideruar së pari testin subjektiv në lidhje me kriterin e paanshmërisë, Gjykata theksoi se kërkuesi pretendoi që z. Pilate ishte treguar me vite të tëra disi i pamëshirshëm në lidhje me punët e kërkuesit. Megjithatë, Gjykata deklaroi se paanshmëria personale e një gjyqtari duhet të presupozohet përdërisa nuk ka prova që vërtetojnë të kundërtën, dhe në rastin konkret prova të tilla nuk u paraqitën para Gjykatës. Në mënyrë të veçantë, nuk kishte asgjë që tregonte se në të kaluarën z. Pilate kishte demonstruar ndonjë ashpërsi ose keqdashje ndaj kërkuesit ose se e kishte rregulluar që t’i caktoheshin atij hetimet paraprake të hapura ndaj kërkuesit në vitin 1977. Më tej, në lidhje me testin objektiv, Gjykata tha se duhet të merren parasysh konsideratat rreth funksioneve të ushtruara dhe organizimit të brendshëm. Në këtë aspekt, edhe dukja mund të ketë rëndësi – elementi i rrezikuar është besimi që gjykatat në një shoqëri demokratike duhet të ushqejnë tek publiku dhe mbi të gjitha, sa u përket procedurave penale, tek i akuzuarit.

Gjykata vuri në dukje se në këtë çështje ajo po trajtonte ushtrimin e funksioneve të gjyqarorit hetues dhe gjyqarorit të trupit gjykues nga i njëjti person në të njëjtën çështje. Mund të jetë e kuptueshme që i akuzuari mund të ndihet pak në siklet në qoftë se shihet se në trupin gjykues që do të vendosë për akuzat kundër tij bën pjesë gjyqtari që ka urdhëruar paraburgimin e tij paragjyqësor dhe i cili e ka marrë në pyetje disa herë gjatë hetimeve, sadoqë pyetjet kanë pasur për qëllim nxjerrjen e së vërtetës. Për më tepër, gjyqtari në fjalë, ndryshe nga kolegët e tij, do të kishte mësuar shumë kohë para seancës njohuri të hollësishme rreth çështjes. Rrjedhimisht, ishte e konceptueshme që, së pari, ai mund të jetë dukur se është në pozicion të atillë që i mundësonte një rol thelbësor në gjyq dhe, së dyti, edhe se mund të kishte një mendim të para-formuar i cili me gjasë mund të kishte peshë të madhe në momentin e vendimit. Përfundimisht, paanshmëria e gjykatës penale të Oudenaarde ishte në gjendje të dukej para kërkuesit se ishte e hapur për dyshime objektive dhe kishte pasur shkelje të nenit 6.

Më tej, Gjykata e refuzoi argumentin e Qeverisë që, meqenëse neni 6 § 1 ka të bëjë kryesisht me gjykatat e shkallës së parë, procedurat para gjykatës penale të Oudenaarde ishin jashtë fushëveprimit të nenit 6. Garancitë themelore, përfshirë

paanshmërinë, gjithashtu duhet të ofrohen nga të gjitha gjykatat që një Shtet Anëtar mund të ketë vendosur të ngrejë. Ajo gjithashtu e refuzoi argumentin që ndërhyrja e mëtejshme e Gjykatës së Apelit në Ghent e përmirësoi gabimin e procedurës së shkallës së parë, sepse Gjykata theksoi se defekti në fjalë nuk qëndronte vetëm tek zhvillimi i procedurës në shkallën e parë. Në fund, Gjykata e refuzoi argumentin se një gjetje nga Gjykata e një shkeljeje të nenit 6 § 1 do të përmbante pasoja të rënda për gjykatat belge me staf të kufizuar. Shtetet Kontraktuese e kanë për detyrim të organizojnë sistemet e tyre ligjore në mënyrë të atillë që të garantojnë pajtueshmërinë me kriteret e nenit 6 § 1, dhe detyra e Gjykatës ishte të përcaktonte nëse Shtetet Kontraktuese e kishin arritur rezultatin, jo të tregonte se cilat mjete duheshin përdorur.

#### Neni 50 (tani neni 41)

Gjykata vendosi që çështja e shpërblimit të drejtë nuk ishte e gatshme për vendim, dhe e rezervoi atë.



*Mënyra e shkarkimit të pesë gjyqtarëve nga këshilli gjyqësor shtetëror u deklarua se kishte shkelur parimet e pavarësisë dhe paanshmërisë sipas nenit 6*

VENDIMI NË ÇËSHTJET  
**GEROVSKA POPČEVSKA, JAKŠOVSKI DHE  
TRIFUNOVSKI, dhe POPOSKI DHE DUMA k. ISH-  
REPUBLIKËS JUGOSLLAVE TË MAQEDONISË**

---

(Kërkesat nr. 48783/07, nr. 56381/09 dhe nr. 58738/09,  
dhe nr. 69916/10 dhe nr. 36531/11)

**7 janar 2016**

### **1. Faktet kryesore**

Çështjet në fjalë kishin të bënin me ankesa në tri kërkesa të ndryshme nga pesë gjyqtarë, të gjithë shtetas maqedonë, të cilët ishin shkarkuar nga posti për sjellje të pahijshme profesionale.

Në mars 2007, kërkuesja në çështjen e parë, znj. Gerovska Popčevska (“kërkuesja e parë”) u shkarkua nga Këshilli Gjyqësor Shtetëror (KGjSh) – një organ që kishte juridiksion për të vendosur në procedura lidhur me sjelljet e pahijshme profesionale – për sjellje të pahijshme profesionale, pasi shqyrtoi një çështje civile në lidhje me procedura kompensimi kundër Shtetit të cilat ajo i kishte gjykuar në shkallën e parë. KGjSh gjeti se kërkuesja e parë kishte zbatuar gabim të drejtën procedurale dhe materiale në atë çështje, të cilën ajo e kishte vendosur jashtë rendit të përcaktuar sipas të cilit duhet të gjykohen çështjet. Në këtë rast, një anëtar i KGjSh-së, Gjyqtari D.I., i cili i kishte nisur procedurat, mori pjesë në seancën plenare ku u vendos shkarkimi i kërkueses.

Kërkuesit në çështjen e dytë, z. Jakšovski (“kërkuesi i dytë”) dhe z. Trifunovski (“kërkuesi i tretë”), u shkarkuan nga posti i gjyqtarit për sjellje të pahijshme profesionale prej KGjSh-së në dhjetor 2008 dhe shkurt 2009, respektivisht. U gjet se kërkuesi i dytë nuk kishte qenë i zellshëm gjatë zhvillimit të procedurës në një çështje civile, ndërsa kërkuesi i tretë u gjet jo i zellshëm në hetimin e një incidenti që kishte ndodhur në një qendër paraburgimi.

Në çështjen e tretë, z. Poposki (“kërkuesi i katërt”) dhe znj. Duma (“kërkuesja e pestë”) u shkarkuan për sjellje të pahijshme profesionale nga KGjSh-ja në dhjetor 2009 dhe qershor 2010, respektivisht. Kërkuesi i katërt u shkarkua për shkeljen e rregullave të përfaqësimit ligjor të palëve në një çështje civile që ai e kishte gjykuar.

Kërkuesja e pestë u shkarkua nga posti i gjyqtares për dy arsye të ndryshme: ajo kishte dështuar të përcaktonte identitetin e një personi të dënuar në një çështje penale të cilën ajo e kishte gjykuar, dhe nuk ishte tërhequr nga një çështje tjetër penale në të cilën kishte konflikt të mundshëm interesi.

Të pesë kërkuesit i kontestuan shkarkimet e tyre në shkallën e dytë, pra para një komisioni apeli të formuar brenda Gjykatës Supreme, i ngritur *ad hoc* për secilën çështje ndaras. Komisioni i Apelit i rrëzoi të gjitha apelet, dhe konfirmoi vendimet e KGjSh-së. Kërkuesi i tretë po ashtu e kontestoi shkarkimin e tij para Gjykatës Administrative me anë të një padie si mosmarëveshje administrative, por padia e tij u refuzua si e papranueshme. Kërkuesja e parë dhe e pestë gjithashtu bënë apele kushtetuese, të cilat u refuzuan për shkak se Gjykata Kushtetuese nuk kishte juridiksion për të shqyrtuar ligjshmërinë e vendimeve të KGjSh-së. Në mënyrë të veçantë, sa i përket faktit nëse shkarkimi i kërkueses së parë dhe të pestë kishin ndikuar tek liria e tyre e shprehjes, gjykata deklaroi se duhet të bëhej dallimi mes ushtrimit të detyrës së gjyqtares dhe asaj lirie të veçantë, duke vendosur se posti i gjyqtares ngërthente të drejtën dhe detyrimin për të gjykuar në përputhje me ligjin, dhe se ajo e drejtë dhe ai detyrim nuk formonin pjesë të të drejtave dhe lirive për të cilat ajo ishte kompetente për të vendosur sipas Kushtetutës.

## 2. Vendimi i Gjykatës

Duke u mbështetur në nenin 6 § 1 të Konventës, të pesë kërkuesit në thelb pretenduan se organet të cilat kishin marrë në shqyrtim çështjet e tyre – pra KGjSh dhe/ose Komisioni i Apelit i ngritur pranë Gjykatës Supreme – nuk kishin qenë as të pavarur, as të paanshëm.

### Neni 6 § 1

Gjykata deklaroi se çështjet e të gjithë kërkuesve ishin shqyrtuar nga KGjSh-ja, në seancat plenare të të cilit u morën vendimet për shkarkimin e tyre, të cilat më pas u shqyrtuan nga Komisioni i Apelit – organ i përbërë nga gjyqtarë që kryenin një funksion gjyqësor. Në këto rrethana, Gjykata e gjeti nenin 6 të zbatueshëm në procedurën e kontestuar sipas titullit të tij civil.

Gjykata përsëriti se, si rregull, paanshmëria tregon mungesën e paragjykitimit ose njëanshmërisë. Sipas praktikës së saj gjyqësore, ekzistenca e paanshmërisë për qëllimet e nenit 6 § 1 duhet të përcaktohet pas testit subjektiv – në lidhje me bindjen personale ose sjelljen e një gjyqtari të caktuar në një çështje të dhënë – dhe testit objektiv – duke u siguruar nëse vetë gjykata dhe përbërja e saj ofronin garanci të

mjaftueshme për të përjashtuar çdo dyshim të përligjur në lidhje me paanshmërinë e saj. Megjithatë, ndarja mes dy testeve nuk është e pakundërshtueshme, e madje edhe dukja mund të ketë njëfarë rëndësie, dhe gjykatat në një shoqëri demokratike duhet të ushqejnë besim tek publiku: “drejtësia nuk duhet vetëm të realizohet, ajo duhet edhe të shihet që po realizohet”. Në fund, Gjykata vuri në dukje se konceptet e pavarësisë dhe paanshmërisë janë të lidhura ngushtë, dhe në rastin konkret ajo e pa të udhës t’i shqyrtonte ato çështje së bashku.

Kërkuesja e parë – Gjykata deklaroi se në vendimin për shkarkimin e kërkueses KGjSh-ja u mbështet mbi opinionin e Divizionit Civil dhe atë plenar të Gjykatës Supreme. Kërkuesja u shkarkua me votë njëzëri në seancën plenare të KGjSh-së, ku përfshihej Gjyqtari D.I. si anëtar *ex officio*, i cili, si Kryetar i Gjykatës Supreme, kishte marrë pjesë në opinionin gjyqësor të Divizionit Civil dhe kishte shprehur pikëpamje të pafavorshme për kërkuesen. Kështu, Gjykata gjeti se pjesëmarrja e tij e mëtejshme në procedurën e kontestuar për sjellje të pahijshme profesionale para KGjSh-së ishte në papajtueshmëri me kriterin e paanshmërisë sipas nenit 6 § 1. Konsiderata të ngjashme pati edhe për pjesëmarrjen e, në atë kohë, Ministrit të Drejtësisë në vendimin e KGjSh-së për të shkarkuar kërkuesen megjithëse ai kishte kërkuar, si Kryetar në atë kohë i Komisionit Shtetëror Anti-Korrupsion, që KGjSh-ja të shqyrtonte çështjen civile të gjykuar prej saj. Gjykata konsideroi se prania në atë organ e Ministrit të Drejtësisë, si anëtar i ekzekutivit, e dëmtonte pavarësinë e tij në këtë rast, dhe arriti në përfundimin se KGjSh-ja që gjykoi çështjen e kërkueses së parë nuk u vendos nga një gjykatë “e pavarur dhe e paanshme” siç kërkohet nga neni 6 § 1.

Kërkuesi i dytë dhe i tretë – Sipas të drejtës përkatëse vendase, Gjykata theksoi se çdo anëtar i KGjSh-së mund t’i kërkonte KGjSh-së të përcaktonte nëse kishte pasur sjellje të pahijshme profesionale nga ana e një gjyqtari. Në rastin konkret, V.V. kërkoi hapjen e kësaj prodedure në lidhje me kërkuesin e dytë, dhe R.P. kërkoi hapjen e procedurës në lidhje me kërkuesin e tretë. Gjykata gjeti që sistemi në të cilin ankuesit, të dy anëtarë të KGjSh-së që kishin zhvilluar hetime paraprake dhe kishin nisur procedurat e kontestuara, më pas morën pjesë në vendimet për t’i hequr kërkuesit nga posti, hidhte dyshime objektive mbi paanësinë e atyre anëtarëve gjatë vendimit rreth themeleve të çështjeve të kërkuesve. Prandaj Gjykata arriti në përfundimin se mbivendosja e roleve të ankuesve – V.V. në rastin e kërkuesit të parë dhe R.P. në rastin e kërkuesit të dytë – në procedurat e kontestuara duke rezultuar me shkarkimin e kërkuesve ka ngritur dyshime objektivisht të justifikuar rreth paanësisë së KGjSh-së. Rrjedhimisht, kishte pasur shkelje të nenit 6 § 1 në këtë aspekt. Kërkuesi i dytë dhe i tretë më tej u ankuar se Komisioni i Apelit i ngritur brenda Gjykatës Supreme kishte qenë i përbërë nga gjyqtarë karriera e të cilëve kishte qenë krejtësisht e varur nga KGjSh-ja. Duke pasur parasysh konsideratat e mësipërme dhe

përfundimin se kishte pasur shkelje të të drejtave të kërkuësve për seancë dëgjimore nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme sipas nenit 6 § 1, Gjykata konsideroi se nuk ishte e nevojshme të shqyrtoheshin ato ndaras.

Kërkuësi i katërt dhe kërkuësja e pestë – Sipas ligjeve të zbatueshme, çdo anëtar i KGjSh-së mund të kërkonte që KGjSh-ja të vendoste nëse kishte pasur sjellje të pahijshme profesionale nga ana e një gjyqtari. Në fakt, këto procedura u kërkuan nga N.H.A., anëtar i KGjSh-së, në lidhje me kërkuësin e katërt, dhe nga Ministri i Drejtësisë në lidhje me kërkuësen e pestë. Gjykata konsideroi se të dy ankuesit kishin të drejta si palë në procedurat e kontestuara. Si në çështjet e mëparshme, Gjykata konsideroi se një sistem në të cilin anëtarët e KGjSh-së që kishin zhvilluar hetimet paraprake dhe kishin kërkuar nisjen e procedurave të kontestuara më pas kishin marrë pjesë në vendimet për t'i shkarkuar kërkuësit nga posti i gjyqtarit/es, hidhte dyshime objektive mbi paanshmërinë e atyre anëtarëve gjatë vendimit rreth themeleve të çështjeve të kërkuësve. Gjykata vendosi se konfuzioni i roleve të ankuesve në procedurat e kontestuara që rezultuan me shkarkimin e kërkuësve hidhte dyshime objektivisht të justifikuar në lidhje me paanshmërinë e KGjSh-së, dhe prandaj kishte pasur shkelje të nenit 6 § 1.

#### Neni 41

Në të tri çështjet, Gjykata caktoi 4,000 euro secilit prej pesë kërkuësve për dëme jomateriale. Më tej, ajo i caktoi 900 euro kërkuëses së parë, 300 euro kërkuësit të tretë, dhe 150 euro kërkuëses së pestë në lidhje me kosto dhe shpenzime.

*Nuk ka arsye objektive për të dyshuar në pavarësinë dhe paanshmërinë e një organi gjyqësor përgjegjës për dëgjimin e apeleve për planifikimin e transportit të cilat kishin gjithashtu fuqi këshilluese – nuk ka shkelje të nenit 6 § 1*

## VENDIMI I DHOMËS SË MADHE NË ÇËSHTJEN KLEYN DHE TË TJERË k. HOLLANDËS

(Kërkesat nr. 39343/98, nr. 39651/98, nr. 43147/98 dhe nr. 46664/99)

**6 maj 2003**

### 1. Faktet kryesore

Çështja kishte të bënte me katër kërkesa të bashkuara të paraqitura nga 23 shtetas holandezë dhe 12 kompani holandeze, shtëpitë ose ambientet e biznesit të të cilëve ndodheshin në ose afër trasesë së një hekurudhe të re, hekurudha *Betuweroute*, e cila ishte duke u ndërtuar në kohën e vendimit dhe e cila kalonte nëpër Holandë nga porti i Roterdamit deri tek kufiri gjerman.

Të gjithë kërkuessit morën pjesë në procedurë duke kundërshtuar vendimin për përcaktimin e linjës së saktë të hekurudhës *Betuweroute*, i ashtuquajtur i Vendimi i Linjës. Ky Vendim i Linjës u mor sipas procedurës së parashikuar në Ligjin për Planifikimin e Infrastrukturës së Transportit, ashtu siç ishte në fuqi që prej 1 janarit 1994. Në vendimin e tij të 28 majit 1998, Divizioni i Juridiksionit Administrativ i Këshillit të Shtetit refuzoi shumicën e ankesave të kërkuessve. Sa u përket ankesave që u gjetën të bazuara, në vitin 1998 u morën disa vendime të reja të pjesshme në lidhje me linjën. Apelet kundër këtyre vendimeve të reja të pjesshme u rrëzuan nga Divizioni i Juridiksionit Administrativ në disa vendime të ndara të marra mes 16 prillit 1999 dhe 25 korrikut 2000.

### 2. Vendimi i Gjykatës

Kërkuessit u ankuan, sipas nenit 6 § 1 të Konventës, se Divizioni i Juridiksionit Administrativ i Këshillit të Shtetit nuk mund të shihej si gjykatë e pavarur dhe e paanshme sepse Këshilli i Shtetit ushtronte si funksione këshillimore, duke dhënë opinione këshilluese mbi projektligje, ashtu edhe funksione gjyqësore, duke vendosur apelet sipas të drejtës administrative. Duke u mbështetur në gjetjet e Gjykatës në çështjen *Procola k. Luksemburgut*<sup>[408]</sup>, ku u vendos se kryerja e vazhdueshme nga Gjykata Administrative Supreme e funksioneve këshilluese dhe gjyqësore në lidhje

408 *Procola k. Luksemburgut*, vendim i 28 shtatorit 1995, Nr. 14570/89.

me të njëjtat vendime me gjasë hidhte dyshime mbi paanshmërinë strukturore të atij institucioni, kërkuiesit u ankuan se Këshilli i Shtetit e kishte këshilluar Qeverinë në lidhje me Projektligjin për Ligjin e Planifikimit të Infrastrukturës së Transportit dhe se Vendimi i Linjës të cilin ata e kishin kontestuar para Divizionit Gjyqësor Administrativ ishte marrë mbi bazën e atij Ligji.

Juridiksioni iu dha Dhomës së Madhe sipas nenit 30.

### Pranueshmëria

Qeveria debatoi se vetëm dy prej kërkuiesve i kishin shteruar mjetet vendase, pjesa tjetër as nuk e kishin kontestuar Divizionin Gjyqësor Administrativ, as nuk kishin apeluar pranë gjykatave civile mbi bazën e faktit që procedurat administrative në fjalë nuk kishin ofruar garanci të mjaftueshme drejtësie. Meqenëse kontesti nga dy kërkuiesit, i cili bazohej në çështjen *Procola k. Luksemburgut*, ishte rrëzuar, Gjykata nuk e shihte se si një kontest nga kërkuiesit e tjerë i bazuar mbi të njëjtat argumente mund të kishte rezultuar me një vendim të ndryshëm. Më tej, kërkuiesit kishin konstatuar se zgjidhja civile e përmendur nga Qeveria nuk ofronte asnjë perspektivë të arsyeshme suksesi. Rrjedhimisht, kërkesat nuk mund të rrëzoheshin për mos-shterim të mjeteve vendase. Gjykata konsideroi se ankesa sipas nenit 6 § 1 ngrinte çështje të ligjit të cilat ishin aq serioze saqë kërkohej shqyrtimi i themeleve të tyre.

### Neni 6 § 1

Pyetja e vetme para Gjykatës ishte nëse, në rrethanat e kësaj çështjeje, Divizioni Gjyqësor Administrativ e kishte pasur dukjen e kërkuar të pavarësisë ose paanshmërinë e kërkuar objektive.

Gjykata nuk gjeti asgjë tek mënyra dhe kushtet e emërimit të anëtarëve të Këshillit të Shtetit në Holandë ose në detyrat e tyre për të vërtetuar shqetësimet e kërkuiesve në lidhje me pavarësinë e Këshillit të Shtetit. As nuk pati ndonjë tregues se kishte njëanshmëri personale nga ana e ndonjë anëtari të trupit që kishte dëgjuar apelet e kërkuiesve kundër Vendimit të Linjës.

Gjykata nuk besonte aq sa Qeveria se masat e brendshme të marra nga Këshilli i Shtetit me qëllim të futjes në fuqi që vendimit *Procola* në Holandë ishin të tilla që siguronin se në të gjitha apelet Divizioni Gjyqësor Administrativ përbënte gjykatë të pavarur sipas nenit 6 § 1. Megjithatë, nuk ishte detyra e Gjykatës që të vendoste në rrafsh abstrakt mbi pajtueshmërinë e sistemit holandez në lidhje me Konventën. Çështja para Gjykatës ishte nëse, sa u përkiste apeleve të kërkuiesve, ishte në

përputhje me kriterin e paanshmërisë objektive fakti që struktura institucionale e Këshillit të Shtetit i kishte lejuar disa prej këshilltarëve të tij të ushtronin si funksione këshilluese ashtu edhe gjyqësore.

Këshilli i Shtetit kishte dhënë këshillim në lidhje me Projektligjin për Planifikimin e Infrastrukturës së Transportit, ndërsa apelet e kërkuarve kishin qenë të drejtuara kundër Vendimit të Linjës. Gjykata gjeti se opinionet këshilluese të dhëna në lidhje me projektligjin dhe procedurat vijuese rreth apeleve kundër Vendimit të Linjës nuk mund të shiheshin si të lidhura me “të njëjtën çështje” ose “të njëjtin vendim”. Megjithëse planifikimi i hekurudhës *Betuweroute* ishte përmendur në këshillimin dhënë Qeverisë, kjo nuk mund të shihej me arsye si përcaktim paraprak i ndonjëres prej çështjeve që u vendosën nga ministrat përgjegjës për Vendimin e Linjës. Gjykata nuk mund të ishte dakord me kërkuarët se, duke sugjeruar emrin e vendeve ku *Betuweroute* do të fillonte dhe do të mbaronte, Këshilli i Shtetit në ndonjë formë kishte paragjykuar linjën e saktë se nga do të kalonte ajo hekurudhë.

Frika e kërkuarve në lidhje me mungesën e pavarësisë dhe paanësisë së Divizionit Gjyqësor Administrativ nuk mund të shihej si objektivist e justifikuar. Rrjedhimisht, nuk kishte pasur shkelje të nenit 6 § 1.

*Përfshirja e konsiderueshme e një gjyqtari të lartë në procedurën lidhur me shkarkimin e një gjyqtari tjetër shkeli kriterin e paanshmërisë sipas nenit 6 § 1*

## VENDIMI NË ÇËSHTJEN MITRINOVSKI k. ISH-REPUBLIKËS JUGOSLLAVE TË MAQEDONISË

---

(Kërkesa nr. 6899/12)  
**30 prill 2015**

### 1. Faktet kryesore

Kërkuesi, Jordan Mitrovski, ishte i lindur në vitin 1950 dhe jetonte në Shkup. Më parë ai kishte qenë gjyqtar në Gjykatën e Apelit të Shkupit.

Më 6 dhjetor 2010, kërkuesi (si anëtar i një trupi gjykues me tre anëtarë në Gjykatën e Apelit të Shkupit), votoi në favor të zëvendësimit të një urdhri paraburgimi në pritje të gjykimit për një të akuzuar me një urdhër për arrest shtëpiak. Ky vendim u kontestua nga Prokurori Publik i Shtetit, dhe më pas Gjykata Supreme gjeti që Gjykata e Apelit nuk kishte juridiksion për ta shqyrtuar çështjen.

Në të njëjtën ditë, divizioni penal i Gjykatës Supreme, i cili përfshinte kryetarin e asaj gjykate ('J.V.'), gjeti se dy prej gjyqtarëve të Gjykatës së Apelit të Shkupit të cilët kishin marrë pjesë në vendim, përfshirë kërkuesin, kishin kryer sjellje të pahijshme profesionale. J.V., i cili ishte anëtar i Këshillit Gjyqësor të Shtetit ('KGjSh') për shkak të postit që mbante, më pas i kërkoi KGjSh-së të përcaktonte se kërkuesi dhe një gjyqtar tjetër kishin kryer sjellje të pahijshme profesionale. Më 23 dhjetor 2010 seanca plenare e KGjSh-së, ku përfshihej J.V., e diskutoi këtë kërkesë dhe më pas ngriti një Komision për të marrë vendim mbi sjelljen e pahijshme nga ana e kërkuesit. Komisioni, i cili përbëhej nga pesë anëtarë, përfshinte Kryetarin e KGjSh-së por nuk përfshinte J.V.

Në maj 2011, seanca plenare e KGjSh-së e shkarkoi kërkuesin nga posti i gjyqtarit për shkak të sjelljes së pahijshme profesionale. U përmend në mënyrë të veçantë vendimi i 6 dhjetorit 2010 në lidhje me të cilin sjellja e kërkuesit u tha se kishte qenë joprofesionale.

Kërkuesi apeloj kundër vendimit para një Komisioni Apeli të ngritur brenda Gjykatës Supreme. Ky apel u rrëzua nga Komisioni i Apelit në shtator 2011, ku u konfirmua vendimi i KGjSh-së për shkarkimin e kërkuesit nga posti i gjyqtarit.



## 2. Vendimi i Gjykatës

Duke u mbështetur në nenin 6 të Konventës, kërkuesi u ankua se KGjSh-ja nuk ishte 'gjykatë e pavarur dhe e paanshme' për shkak se i) Kryetari i KGjSh-së, i cili kishte qenë anëtar i Komisionit në çështjen e tij, dhe ii) Kryetari i Gjykatës Supreme (J.V.), kërkesa e të cilit kishte vënë në lëvizje procedurën e kundërshtuar, kishin marrë pjesë më pas në vendimin e KGjSh-së për shkarkimin e tij.

### Neni 6 § 1

Gjykata theksoi se, sipas praktikës së saj gjyqësore të vendosur, ekzistenca e paanshmërisë për qëllimet e nenit 6 § 1 duhet të përcaktohet sipas një testi subjektiv dhe një testi objektiv. Megjithatë, nuk ka dallim absolut mes këtyre testeve, e madje edhe dukja ka rëndësi, meqenëse "drejtësia jo vetëm që duhet të realizohet, por edhe duhet të shihet që po realizohet". Në mungesë të paanshmërisë gjyqësore, mund të dëmtohet besimi publik tek gjykatat.

Gjykata vuri re se KGjSh-ja ishte e përbërë nga pesëmbëdhjetë anëtarë, ku J.V. ishte i përfshirë për shkak të postit të tij si Kryetar i Gjykatës Supreme. Sipas ligjeve përkatëse vendase, gjetja nga KGjSh-ja e sjelljes së pahijshme profesionale të një gjyqtari mund të çonte vetëm në shkarkimin e atij gjyqtari nga posti. Çdo anëtar i KGjSh-së mund t'i kërkonte KGjSh-së të përcaktonte nëse kishte pasur sjellje të pahijshme nga cilido gjyqtar. Në rastin e kërkuesit, kërkesa e J.V. drejtuar KGjSh-së u bë pas vendimit unanimit të divizionit penal të Gjykatës Supreme se kishte pasur sjellje të pahijshme profesionale nga dy gjyqtarët në seancën e 6 dhjetorit. Megjithëse kërkuesi nuk u përmend me emër, ishte e qartë se Gjykata Supreme ishte e mendimit që kërkuesi kishte kryer sjellje të pahijshme profesionale. J.V. kishte marrë pjesë në këtë gjetje dhe kishte votuar në favor të saj.

Në këto rrethana, Gjykata konsideroi se kërkuesi kishte baza legjitime për të dyshuar që J.V. kishte qenë personalisht i bindur se ai duhet të shkarkohej për sjellje të pahijshme profesionale përpara se çështja të shqyrtohej nga KGjSh-ja, duke zbuluar kështu një çështje paanshmërie subjektive. Kërkesa e J.V. kishte vënë në lëvizje procedurën para KGjSh-së, në të cilën ai paraqiti prova dhe argumente në mbështetje të pretendimeve për sjellje të pahijshme profesionale. Kështu, ai kishte vepruar si një lloj prokurori. Më tej ai kishte luajtur rol në marrjen e vendimit si anëtar i KGjSh-së.

Gjykata konsideroi se sistemi në të cilin J.V. mori pjesë në vendimin për ta shkarkuar kërkuesin nga posti i tij, hidhte dyshime objektive mbi paanshmërinë e tij gjatë marrjes së vendimit në lidhje me themelet e çështjes së kërkuesit. Prandaj, Gjykata

gjeti se roli i J.V. në procedurë dështonte si në testin e paanshmërisë subjektive ashtu edhe në testin e asaj objektive.

Rrjedhimisht, kishte pasur shkelje të nenit 6 § 1 për shkak të mungesës së paanshmërisë së kërkuar nga KGjSh-ja që e shqyrtoi çështjen e kërkuarit.

#### Neni 41

Gjykata deklaroi që Qeveria duhet t'i paguante kërkuarit 4,000 euro në lidhje me dëme jomateriale dhe 1,230 euro në lidhje me kosto dhe shpenzime.

*Një Gjykatë Apeli nuk ishte “gjykatë e pavarur dhe e paanshme” sepse ajo u kryesua nga i njëjti gjyqtar në procedurën e dytë ashtu si edhe në procedurën e parë*

## VENDIMI NË ÇËSHTJEN OBERSCHLICK k. AUSTRIË

(Kërkesa nr. 11662/85)

**23 maj 1991**

### **1. Faktet kryesore**

Kërkuesi ishte gazetar austriak me banim në Vjenë, dhe në kohën relevante ai ishte redaktor i revistës *Forum*. Më 29 mars 1983, gjatë një fushate zgjedhore, z. Walter Grabher-Meyer, politikan, kishte bërë deklaratat publike në lidhje me ndihmat financiare për familjet e të huajve, dhe kishte propozuar që persona të tillë duhet të marrin trajtim më pak të favorshëm sesa austriakët. Më 20 prill 1983, kërkuesi dhe disa persona të tjerë bënë ankesë penale kundër z. Grabher-Meyer. Megjithatë, prokuroria publike e Vjenës vendosi më 1 qershor 1983 që të mos e ndiqte atë penalisht. Ditën që u dorëzua, teksti i plotë i ankesës penale u botua nga kërkuesi në *Forum*.

Më 22 prill 1983, z. Grabher-Meyer ngriti padi private për shpifje kundër kërkuesit dhe nënshkruesve të tjerë të informacionit penal. Gjykata Rajonale e Vjenës gjeti që botimi nuk përbënte vepër penale, sepse çështja nuk kishte të bënte me atribuímin e gabuar të një sjelljeje të pandershme por vetëm me gjykimin e vlerës së një sjelljeje e cila, si e tillë, ishte përshkruar saktë. Gjykata e Apelit e Vjenës e përbërë nga z. Cortella, si Kryetar, dhe z. Schmidt dhe z. Hagen, e prishi vendimin e mësipërm më 31 maj 1983. Ajo vendosi se botimi i atij shkrimi duhet të ketë krijuar përshtypjen tek lexuesit e thjeshtë se një sjellje e caktuar përcmuese i atribuohet z. Grabher-Meyer.

Çështja iu referua sërish Gjykatës Rajonale për një procedurë të dytë, ku Gjykata mbajti seancë dëgjimore më 11 maj 1984 dhe mori vendimin përfundimtar në të njëjtën ditë. Kërkuesi u shpall fajtor për shpifje dhe u dënua me gjobë në shumën 4,000 shilinga austriake (afro 290 euro) ose, në rast mospagimi, me 25 ditë burg. Në vendimin e saj, Gjykata Rajonale deklaroi se ajo ishte e detyruar t'i përmbahej opinionit të shprehur nga Gjykata e Apelit në vendimin e saj të 31 majit 1983.

Gjykata Rajonale deklaroi se, ndërkohë që secili ishte i lirë për të raportuar në polici fakte që konsideronte se përbënin vepër penale, botimi i informacionit në këtë mënyrë duke e vënë në dispozicion të publikut të gjerë shkonte përtej thjesht raportimit të dyshimeve penale. Më 6 shtator 1984 kërkuesi bëri kërkesë pa sukses

pranë Gjykatës Rajonale për korrigjimin e procesverbalit të gjyqit i cili, sipas tij, nuk përmendte deklarata të caktuara të z. Grabher-Meyer të cilat ishin me rëndësi për vlerësimin e provave në lidhje vërtetësinë e pretendimeve të kërkuarit.

Më 17 dhjetor 1984, Gjykata e Apelit e Vjenës, e përbërë nga të njëjtit gjyqtarë si edhe në procedurën e parë të 31 majit 1983 dhe sërish nën kryesimin e z. Cortella, e rrëzoi apelin e kërkuarit kundër dënimit të tij. Gjykata e Apelit deklaroi se botimi në formën e informacionit penal kishte për qëllim që akuzat e bëra aty rreth karakterit të tij të bënin efekt veçanërisht të dukshëm tek lexuesit e thjeshtë.

## 2. Vendimi i Gjykatës

Kërkuari pretendoi se ai nuk kishte pasur “seancë dëgjimore të drejtë” nga një “gjykatë e pavarur e ngritur me ligj”, brenda kuptimit të nenit 6 § 1 të Konventës. Më tej, ai argumentoi se shpallja e tij fajtor për shpifje dhe vendimet e tjera të gjykatës kishin shkelur të drejtën e tij për lirinë e shprehjes e cila garantohet me nenin 10.

### Neni 6

Në lidhje me ankesën e kërkuarit për korrigjimin e procesverbalit të gjyqit dhe padrejtësinë e procedurave para Gjykatës Rajonale, nuk u gjat shkelje e nenit 6 § 1.

Më pas, kërkuari argumentoi që Gjykata e Apelit e Vjenës, gjatë dëgjimit të çështjes në procedurën e dytë, nuk kishte qenë “gjykatë e pavarur dhe e paanshme” dhe nuk kishte qenë “e ngritur sipas ligjit” sepse, në kundërshtim me Nenin 489 para. 3 të Kodit të Procedurës Penale, ajo ishte kryesuar nga i njëjti gjyqtar si në procedurën e parë. Para Gjykatës, kërkuari e plotësoi këtë ankesë duke pohuar se në ndërkohë ai ishte bërë të besonte se jo vetëm kryetari i trupit gjykues por edhe dy gjyqtarët e tjerë ishin të njëjtit në të dy rastet.

Gjykata theksoi se Kodi i Procedurës Penale thoshte që Gjykata e Apelit nuk duhet të përfshijë, në një çështje si kjo, asnjë gjyqtar që e ka trajtuar atë më herët në procedurën e parë, dhe shprehu shqetësimin e parlamentit të vendit për të fshirë të gjitha dyshimet e arsyeshme rreth paanshmërisë së asaj gjykate. Rrjedhimisht, dështimi për t’iu përmbajtur kësaj rregulle do të thoshte se apeli i kërkuarit ishte dëgjuar nga një gjykatë paanshmëria e së cilës u njoh nga ligjet vendase si e hapur për dyshime.

Në lidhje me argumentin e Qeverisë që, duke mos konstestuar ose kundërshtuar pjesëmarrjen e kryetarit të trupit gjykues, kërkuari kishte hequr dorë nga e drejta e

tij për ta zëvendësuar atë. Gjykata deklaroi se heqja dorë nga një e drejtë e garantuar nga Konventa duhet të konstatohet në mënyrë të qartë. Këtu, jo vetëm Kryetari por edhe dy anëtarët e tjerë të Gjykatës së Apelit duhet të ishin tërhequr në përputhje me Kodin e Procedurës Penale. Pavarësisht nga qëndrimi në lidhje me kryetarin e trupit gjykues, as kërkuesi e as avokati i tij nuk u vunë në dijeni deri pas seancës së 17 dhjetorit 1984 që dy gjyqtarët e tjerë po ashtu kishin marrë pjesë në vendimin e 31 majit 1983. Pra, nuk u konstatua që kërkuesi kishte hequr dorë nga e drejta që çështja e tij të vendosej nga një gjykatë “e paanshme”. Rrjedhimisht, kishte pasur shkelje të nenit 6 § 1 të Konventës në këtë aspekt.

### Neni 10

Nuk u vu në diskutim që shpallja e kërkuesit fajtor nga Gjykata Rajonale e Vjenës më 11 maj 1984 dhe e konfirmuar nga Gjykata e Apelit e Vjenës më 17 dhjetor 1984 përbënte “ndërrhyrje” tek e drejta e tij për lirinë e shprehjes. Diskutimi para Gjykatës u përqendrua tek pyetja nëse kjo ndërrhyrje ishte “e nevojshme në një shoqëri demokratike” për ta arritur atë qëllim. Në këtë aspekt, Gjykata kujtoi se liria e shprehjes përbën një prej themeleve esenciale të një shoqërie demokratike dhe një prej kushteve bazë për përparimin e saj dhe vetpërmbushjen individuale të secilit.

Gjykata theksoi se liria e debatit politik qëndron në thelb të konceptit të një shoqërie demokratike, dhe problemi tek çështja në fjalë qëndronte tek kufijtë e kritikave të pranueshme në kontekstin e një debati politik lidhur me një çështje politike të interesit publik. Gjykata tha se kërkuesi ishte shpallur fajtor për riprodhimin në shtyp të tekstit të një informacioni penal të cilin ai dhe persona të tjerë e kishin ngritur kundër z. Grabher-Meyer. Informacioni i botuar nga kërkuesi fillonte duke cituar faktet e raportuara në deklaratat e z. Grabher-Meyer. Më pas vijonte një analizë e atyre deklaratave, mbi bazën e së cilës autorët e informacionit dilnin me përfundimin se ky politikan kishte shprehur me vetëdije të plotë ide që përputhen me idetë e propaganduara nga nazistët. Gjykata tha se kërkuesi kishte botuar një deklaram të vërtetë të fakteve i ndjekur nga një gjykim mbi vlerën e atyre fakteve.

Më tej, Gjykata deklaroi se kërkesa e gjykatave austriake që ai duhet të jepte prova për vërtetësinë e pretendimeve të tij në vetvete ishte shkelje e lirisë së shprehjes. Sa i përket formës së botimit, Gjykata pranoi vlerësimin e bërë nga gjykatat austriake. Ajo shënoi se ato nuk e konstatuan që “prezantimi i artikullit në formën e informacionit penal” ishte çorientues në kuptimin që një numër i madh lexuesish ishin bërë të besonin se kundër z. Grabher-Meyer kishte nisur ndjekja penale ose madje se ai tashmë ishte shpallur fajtor. Për pasojë, kishte ndodhur shkelje e nenit 10 sepse

ndërhyrja tek ushtrimi i të drejtës së kërkuarit për lirinë e shprehjes nuk kishte qenë “e nevojshme në një shoqëri demokratike”.

Neni 50 (tani neni 41)

Gjykata i caktoi kërkuarit shumën 18,123.84 shilinga (afro 1,317 euro) në lidhje me dëmet dhe 85,285 shilinga (afro 6,197 euro) në lidhje me kosto dhe shpenzime.

*Në kontekstin e pranimit nga një anëtar i jurisë se ishte racist, mos-kontrollimi nëse gjykata i përmbushte kriteret e një gjykate të paanshme përbëri shkelje të nenit 6 § 1 të Konventës*

## VENDIMI NË ÇËSHTJEN REMLI k. FRANCËS

---

(Kërkesa nr. 16839/90)

**23 prill 1996**

### **1. Faktet kryesore**

Kërkuesi, Said André Remli, shtetas francez me origjinë algeriane, ndodhej në burg në Marsejë të Francës. Kërkuesi dhe një i burgosur tjetër (z. Boumédiène Merdji, me origjinë algeriane) vranë një roje burgu gjatë përpjekjes për t'u arratisur nga burgu, dhe u akuzuan për vrasje të qëllimshme me synim të lehtësimit, përgatitjes ose ekzekutimit të veprave të arratisjes dhe arratisjes në tentativë.

Kërkuesi dhe z. Merdji u gjykuan nga Gjykata e Assizës në Rhone më 12, 13 dhe 14 prill 1989. Më 12 prill, para fillimit të seancës, një palë e tretë (znj. M), dëgjoi njërin prej anëtarëve të jurisë në gjyq duke thënë “për më tepër, unë jam racist”. Znj. M vuri në dijeni avokatin e kërkuesit për këtë koment dhe identifikoi anëtarin e jurisë në fjalë. Më 13 prill avokati i kërkuesit bëri kërkesë që Gjykata e Assizës të bënte një notë formale të incidentit, gjë që u refuzua për shkak se deklarata ishte bërë para fillimit të seancës së parë dhe jo në prani të gjyqtarëve.

Më 14 prill, Gjykata e Assizës e dënoi kërkuesin me burgim të përjetshëm dhe z. Merdji me njëzet vjet burg. Kërkuesi apeloi pranë Gjykatës së Kasacionit mbi pika të ligjit, duke argumentuar se Gjykata e Assizës kishte shpërfillur nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut duke u shprehur se ajo nuk mund të mbante shënime rreth ngjarjeve që supozohej se kishin ndodhur jashtë pranisë së saj kur e kishte fuqinë për ta bërë një gjë të tillë. Gjykata e Kasacionit e rrëzoi apelin, duke deklaruar se Gjykata e Assizës “me të drejtë refuzoi të mbante shënim një ngjarje e cila, nëse vërtetohej, kishte ndodhur jashtë seancës, në mënyrë të atillë që ajo nuk do të kishte pasur mundësi ta mbante shënim”.

### **2. Vendimi i Gjykatës**

Kërkuesi pretendoi shkelje të nenit 6 (e drejta për proces të drejtë) në lidhje me nenin 14 (ndalimi i diskriminimit) për shkak se ai nuk ishte gjykuar nga një gjykatë

e paanshme dhe që ai kishte pësuar diskriminim mbi baza racore. Përveç kësaj, ai pretendoi shkelje të nenit 13 (e drejta për zgjidhje efektive).

### Pranueshmëria

Në lidhje me ankesën e bazuar mbi nenin 14 të marrë së bashku me nenin 6, Gjykata gjeti që mos-ankimi nga kërkuesi për diskriminim në gjykatat vendase do të thoshte se ai nuk i kishte shteruar zgjidhjet në vend, dhe kjo ankesë u deklarua e papranueshme. Ankesa sipas nenit 6 në lidhje me paanshmërinë e Gjykatës së Assizës u deklarua e pranueshme.

### Neni 6 § 1

Kërkuesi parashtrroi se kur një gjykatë që gjykon persona me origjinë nga një kombësi e huaj përfshinte një anëtar jurie i cili, para seancës, kishte shprehur publikisht ndjenja raciste, asaj i mungonte paanshmëria. Anëtar i jurisë në fjalë, argumentoi kërkuesi, nuk duhet të kishte marrë pjesë në një çështje të cilën ai nuk ishte në gjendje ta vlerësonte me objektivitet të plotë. Dështimi i Gjykatës së Assizës për të bërë një notë formale rreth një komenti kështu ia mohoi kërkuesit mundësinë për t'u gjykuar nga një gjykatë e paanshme, siç kërkohet nga neni 6 § 1. Qeveria pranoi se çdo gjykatë që përmbante një anëtar jurie i cili deklaronte në mënyrë aktive se ishte racist nuk mund të shihej si e paanshme. Megjithatë, duhet të konstatohej me siguri se opinionet raciste ishin bindje të vërteta dhe se ato kishin mundur të ndikonin tek vendimi rreth fajësisë. Fjalja “për më tepër, unë jam racist” mund të ishte thënë si shaka ose në lidhje me një çështje tjetër. Më tej, nuk mund të pritët që një gjykatë të verifikojë të gjitha komentet që mund të bëjë një anëtar i jurisë para tërheqjes së shortit.

Gjykata kujtoi që, gjatë marrjes së vendimit nëse ka arsye legjitime për të dyshuar se një gjyqtari të caktuar i mungon paanshmëria, faktori vendimtar nuk është këndvështrimi i të akuzuarit por fakti nëse frika e të akuzuarit mund të justifikohet objektivisht. Në rastin konkret, Gjykata theksoi domethënien e deklaratës në kontekstin e një gjyqi të dy burrave me origjinë afrikanoveriore. Gjykata vërejti se Gjykata e Assizës e rrëzoi kërkesën për të bërë notë formale mbi bazën se ajo nuk mund “të bënte notë formale për të gjitha ngjarjet që supozohej se kishin ndodhur jashtë pranisë së saj”, e as nuk urdhëroi që të mblidheshin prova për ta verifikuar raportimin.

Kështu, kërkuesi nuk pati mundësi që i) ta zëvendësonte anëtarin e jurisë në fjalë; ii) të shfrytëzonte komentet që e mbështesnin apelin e tij mbi pika të ligjit; ose iii)



të kontestonte anëtarin e jurisë, meqenëse juria ishte krijuar përfundimisht. Më tej, kërkuesi nuk pati mundësi ta apelonte vendimin e Gjykatës së Assizës përveç se mbi pika të ligjit. Gjykata konsideroi që neni 6 § 1 caktonte detyrimin që çdo gjykatë vendase të kontrollonte nëse i përmbushte kriteret e një “gjykatë të paanshme”. Sipas fakteve, dështimi i Gjykatës së Assizës për të vërtetuar që e kishte bërë këtë ia mohoi kërkuesit mundësinë për të ndrequr një situatë në kundërshtim me Konventën. Kjo, e parë në kuadër të nevojës që gjykata të ushqejë besim tek ata që i nënshtrohen juridiksionit të saj, përbëri shkelje të nenit 6 § 1.

#### Neni 50 (tani neni 41)

Gjetja e shkeljes së nenit 6 § 1 u deklarua të ishte e mjaftueshme si shpërblim i drejtë për kërkuesin. Megjithatë, Gjykata e urdhëroi Qeverinë që t’i paguante kërkuesit në lidhje me kostot dhe shpenzimet shumë më 60,000 franga franceze (afro 9,150 euro).

*Përfshirja e dy gjyqtarëve të cilët në procedura të tjera kishin vepruar si avokatë kundër kërkuessit ishte shkelje e kriterit për gjykatë të paanshme sipas nenit 6 § 1*

## VENDIMI NË ÇËSHTJEN WETTSTEIN k. ZVICRËS

---

(Kërkesa nr. 33958/96)  
**21 dhjetor 2000**

### 1. Faktet kryesore

Kërkuessi ishte i lindur në vitin 1930 dhe ishte biznesmen që jetonte në Pfäffikon, të Zvicrës. Ai ishte pronar i dy pronave, dhe ishte i përfshirë në një procedurë ndërtimore në bashkinë Kloten ku pala kundërshtare, një zyrë kantonale e sigurimeve pensionale, përfaqësohej nga një avokat, z. W. Kërkuessi gjithashtu ishte i përfshirë në një procedurë tjetër ndërtimore kundër bashkisë së Küssnacht, bashki e cila përfaqësohej nga një avokate, znj. R. Këto procedura zhvilloheshin para Gjykatës Administrative të Kantonit të Zyrihut, dhe si zgjidhje e fundit para Gjykatës Federale. Znj. R. dhe z. W. ishin avokatë me profesion të cilët në atë kohë kishin ambiente të përbashkëta të zyrave në Zyrih së bashku me z. L. Avokatët znj. R, dhe z. L., gjithashtu shërbenin si gjyqtarë me kohë të pjesshme në Gjykatën Administrative të Kantonit të Zyrihut.

Në procedurat lidhur me pronat e kërkuessit në Kloten, kërkuessi ngriti padi më 15 shkurt 1995 pranë Gjykatës Administrative të Kantonit të Zyrihut. Trupi gjykues i Gjykatës Administrative përbëhej nga pesë gjyqtarë, dhe mes gjyqtarëve të gjykatës administrative ishin R. dhe L., si gjyqtarë me kohë të pjesshme. Më 15 dhjetor 1995 gjykata e refuzoi padinë e kërkuessit.

Kërkuessi bëri apel mbi bazën e të drejtës publike pranë Gjykatës Federale, ku u ankua se gjyqtarja R. vetëm pak kohë më parë kishte qenë pjesë e një procedure tjetër apeli, të nisur nga kërkuessi, si përfaqësuese ligjore e palës kundërshtare, pra bashkisë së Küssnacht. Për më tepër, gjyqtarja R. ndante të njëjtat ambiente zyresh me gjyqtarin L., e gjithashtu edhe me W. i cili, në një procedurë tjetër të nisur nga kërkuessi, kishte qenë përfaqësues ligjor i palës kundërshtare. Apeli mbi bazën e të drejtës publike u rrëzua nga Gjykata Federale më 29 prill 1996.

## 2. Vendimi i Gjykatës

Kërkuesi diskutoi që përfshirja në procedura ndërtimore e dy gjyqtarëve të cilët në procedura të tjera kishin vepruar si avokatë kundër tij përbënte mungesë paanshmërie sipas nenit 6 § 1 të Konventës.

### Neni 6

Gjykata deklaroi që në fillim se nuk kishte arsye për të dyshuar se ligji dhe praktika në lidhje me gjyqësorin me kohë të pjesshme në përgjithësi mund të kurdisheshin në mënyrë të atillë që të ishin në pajtueshmëri me nenin 6. Ajo që vihej në diskutim ishte vetëm mënyra se si ishin zhvilluar procedurat në çështjen e kërkuesit. Sipas Gjykatës, kur përcaktohet paanshmëria e një gjykate për qëllimet e nenit 6 § 1, duhet të kihet parasysh bindja personale dhe sjellja e një gjyqtari të caktuar në një çështje të dhënë – qasja subjektive – si dhe nëse ajo ka ofruar garanci të mjaftueshme për të përjashtuar çdo dyshim të përligjur në këtë aspekt – qasja objektive. Sa i përket aspektit subjektiv të paanshmërisë, Gjykata gjeti se nuk kishte tregues në çështjen në fjalë të ndonjë paragjykimi apo njëanshmërie nga gjyqtarët R. dhe L.

Sa i përket qasjes objektive, duhet të përcaktohet, krejt ndaras prej sjelljes së gjyqtarit, nëse ka fakte të vërtetueshme që ngrisin dyshime rreth paanshmërisë së tij. Ajo që vihet në diskutim është besimi që duhet të frymëzojnë gjykatat në një shoqëri demokratike tek publiku, dhe në këtë aspekt edhe dukja mund të ketë rëndësi të caktuar. Kur vendoset nëse, në një çështje të dhënë, ka arsye legjitime për të dyshuar se një gjyqtari/eje të caktuar i mungon paanshmëria, qëndrimi i personit të përfshirë është i rëndësishëm por jo vendimtar – vendimtare është nëse ky dyshim mund të konstatohet se është objektivisht i justifikuar.

Në këtë aspekt, Gjykata theksoi se gjyqtarja R. kishte vepruar kundër kërkuesit në një procedurë tjetër ndërtimore si përfaqësuese ligjore e bashkisë së Künsnacht. Gjyqtarët R. dhe L. së bashku ndanin të njëjtat ambiente zyrahe me avokatin W. i cili kishte vepruar më përpara si përfaqësues ligjor në një procedurë tjetër ndërtimore në bashkinë Kloten. Ndërkohë që nuk kishte lidhje materiale mes çështjes së kërkuesit para Gjykatës Administrative dhe procedurave të tjera në të cilat R. dhe W. kishin vepruar si përfaqësues ligjorë, Gjykata theksoi se, kur kërkuesi nisi procedurën aktuale para Gjykatës Administrative me R. si gjyqtare e trupit gjykues, procedura paralele në të cilën R. kishte vepruar si përfaqësuese ligjore e bashkisë Künsnacht kundër kërkuesit ishte ende në vazhdim para Gjykatës Federale.

Më pak se dy muaj pas përfundimit të kësaj procedure të Gjykatës Federale kundër bashkisë Küsnacht, Gjykata Administrative mori vendimin e saj. Prandaj, kishte një përkim kohor të dy procedurave ku R. ishte në dy funksione, të gjyqtares nga njëra anë dhe të përfaqësueses ligjore të palës kundërshtare nga ana tjetër. Për pasojë, Gjykata deklaroi se në procedurën para Gjykatës Administrative kërkuesi kishte arsye të shqetësohej se gjyqtarja R. vazhdonte ta shihte atë si palë kundërshtare.

Gjykata gjeti se kjo situatë mund të kishte shkaktuar frikën e shtuar legjitime të kërkuetit që gjyqtarja R. mund të mos e trajtonte çështjen e tij me paanshmërinë e duhur. Fakti që W., koleg zyre i gjyqtarëve R. dhe L., kishte përfaqësuar palën kundërshtare karshi kërkuetit në një procedurë tjetër, mund të kishte konfirmuar më tej frikën e kërkuetit që gjyqtarja R. ishte kundër tij. Këto rrethana objektivist e justifikonin frikën që gjyqtares R. të Gjykatës Administrative i mungonte paanshmëria e nevojshme. Kështu, Gjykata vendosi që kishte pasur shkelje të nenit 6 § 1 të Konventës në lidhje me kriterin për gjykatë të paanshme.

#### Neni 41

Gjykata i caktoi kërkuetit shumën totale 9,000 franga zvicerane (afro 8328.19 euro) në lidhje me kosto dhe shpenzime.

## (10) Marrëdhënia mes Pavarësisë dhe Paanshmërisë, dhe aspekteve të tjera të nenit 6 dhe të drejtave të tjera të Konventës

*Përfundimi i parakohshëm, pa shqyrtim, i mandatit të Kryetarit të Gjykatës Supreme të Hungarisë si pasojë e shprehjes së pikëpamjeve të tij profesionale në lidhje me reformën legjislative shkeli nenet 6 dhe 10*

### VENDIMI I DHOMËS SË MADHE NË ÇËSHTJEN BAKA K. HUNGARISË

(Kërkesa nr. 20261/12)

**23 qershor 2016**

#### 1. Faktet kryesore

Kërkuesi, z. András Baka, ishte shtetas hungarez i lindur në vitin 1952. Nga viti 1991 deri në vitin 2008, kërkuesi ishte gjyqtar në Gjykatën Evropiane të të Drejtave të Njeriut. Më pas, për një vit ai ishte anëtar i Gjykatës së Apelit të Budapestit.

Më 22 qershor 2009, parlamenti hungarez e zgjodhi kërkuesin Kryetar të Gjykatës Supreme për një mandat gjashtëvjeçar. Ky rol përfshinte detyra menaxhuese dhe kryesimin e diskutimeve që rezultojnë në vendime uniformiteti. Kërkuesi ishte gjithashtu kryetar i Këshillit Kombëtar të Drejtësisë, gjë që i caktonte atij detyrimin statutor për të shprehur opinionin e tij në lidhje me ligjet në parlament që kishin të bënin me gjyqësorin, pas marrjes dhe përmbledhjes së opinionëve të gjykatave të ndryshme.

Në prill të vitit 2010, parlamenti hungarez filloi një program reformash gjithëpërfshirëse kushtetuese dhe legjislative. Gjatë tërë kësaj periudhe reformash, kërkuesi shprehu publikisht opinionet e tij profesionale për ligjet që kishin të bënin me gjyqësorin. Më 24 mars 2011, para parlamentit, kërkuesi shprehu opinionet e tij në lidhje me emrin e ri të Gjykatës Supreme (Kúria), fuqitë e reja që i ishin dhënë asaj për të siguruar vazhdimësi në praktikën gjyqësore dhe funksionimin e Këshillit Kombëtar të Drejtësisë, si dhe për futjen e një apeli kushtetues kundër vendimeve gjyqësore. Në prill të vitit 2011, kërkuesi, së bashku me kryetarë të tjerë të gjykatave, bëri një letër të hapur ku kritikohet propozimi për të reduktuar moshën e detyrueshme të pensionit të gjyqtarëve nga 70 vjeç në 62 vjeç. Në qershor 2011, kërkuesi e kontestoi ligjin për reformën gjyqësore para Gjykatës Kushtetuese. Më tej, në një fjalim të mbajtur në nëntor 2011, kërkuesi shprehu para parlamentit mosaprovimin e tij për Projektligjin për Organizimin dhe Administrimin e Gjykatave dhe Projektligjin për

Statusin Ligjor dhe Pagën e Gjyqtarëve. Kërkuesi tha se projektligjet nuk adresonin problemet strukturore të gjyqësorit por i linin ato në “diskrecionin e ekzekutivit të një administrimi të jashtëm (Kryetarit të Zyrës Gjyqësore Kombëtare të propozuar, e cila do të zëvendësonte Këshillin Kombëtar të Drejtësisë për menaxhimin e gjykatave), të cilit [do t’]i caktoheshin fuqi të tepërta dhe, në Evropë, pa precedent, pa llogaridhënie të përshtatshme”.

Parlamenti hungarez miratoi Ligjin Themelor, i cili vendosi që Gjykata Supreme të riemërohej Kúria, më 25 prill 2011. Pas kësaj, shumë politikanë deklaruan që ky ligj nuk do të rezultonte me një kryetar të ri të Gjykatës Supreme. Megjithatë, më 9 nëntor 2011, Ligji për Organizimin dhe Administrimin e Gjykatave u ndryshua, duke futur kriterin që kryetari i ri i Kúria-s duhet të kishte punuar të paktën pesë vjet si gjyqtar në Hungari. Puna në një gjykatë ndërkombëtare nuk llogaritej si punësim. Gjatë periudhës mes 19 dhe 23 nëntorit 2011, deputetë hungarezë paraqitën një sërë amendamentesh ku propozohej që mandati i kërkuesit si Kryetar i Gjykatës Supreme të përfundohej, meqenëse ai nuk e kishte përvojën që kërkohesh rishitaz. Në dhjetor të vitit 2011, parlamenti zgjodhi dy kandidatë, Péter Darák dhe Tünde Handó, për Kryetar të Kúria-s së re dhe Kryetar të Zyrës Gjyqësore Kombëtare. Kërkuesi mbeti në detyrë si kryetar i kolegjit civil të Kúria-s.

## 2. Vendimi i Gjykatës

Kërkuesi pretendoi se atij i ishte mohuar qasja në gjykatë për të mbrojtur të drejtat e tij në lidhje me shkarkimin e tij të parakohshëm, në shkelje të nenit 6 (e drejta për proces të drejtë), dhe që mandati i tij ishte përfunduar si pasojë e faktit që ai kishte shprehur opinionet e tij profesionale në lidhje me reformën legjislativë në shkelje të nenit 10 (e drejta e shprehjes). Më tej, ai u ankua që nuk kishte pasur zgjidhje efektive sipas nenit 13 (e drejta për zgjidhje efektive), dhe që ndaj tij kishte pasur diskriminim në shkelje të nenit 14 (ndalimi i diskriminimit).

Më 27 maj 2014, një Dhomë e Gjykatës vendosi që kishte pasur shkelje të neneve 6 dhe 10 të Konventës në lidhje me çështjen e kërkuesit. Më 15 dhjetor 2014, një trupë e Dhomës së Madhe pranoi kërkesën e Qeverisë për referimin e çështjes sipas nenit 43.

### Neni 6

Gjykata filloi duke përcaktuar nëse mbrojtjet e nenit 6 ishin të zbatueshme në çështjen e kërkuesit. Sipas praktikës së saj gjyqësore, për të qenë i zbatueshëm neni 6 § 1 duhet të ekzistonte një mosmarrëveshje e mirëfilltë dhe serioze në lidhje me një të drejtë që njihet nga e drejta vendase. Gjykata gjeti që, sipas të drejtës vendase,

kërkuesi ishte emëruar në postin e tij për një periudhë të fiksuar prej gjashtë vitesh (2009-2015) dhe që e vetmja bazë e lejueshme për heqjen e parakohshme nga ky post përmes shkarkimit përmbante të drejtën e personit që ishte objekt i shkarkimit për ta shqyrtuar atë vendim në aspekt gjyqësor. Më tej, Kushtetuta e vitit 1949 pohonte se gjyqtarët mund të hiqeshin vetëm për shkaqe të caktuara në përputhje me procedurat e parashikuara me ligj, dhe se gjyqtarët ishin të pavarur dhe të mbrojtur nga parimi i mos-shkarkimit. Ligjet e reja nuk mund të fshinin, në mënyrë prapavepruese, të drejtën e kërkuesit për të përfunduar mandatin e tij sipas rregullave të zbatueshme që ishin në fuqi në kohën e zgjedhjes së tij. Prandaj, duke pasur parasysh këto mbrojtje, Gjykata vendosi që ekzistonte një mosmarrëveshje e mirëfilltë dhe serioze në lidhje me një të drejtë mes kërkuesit dhe Qeverisë hungareze për të cilën kërkuesi mund të bënte padi mbi baza të argumentueshme në kuadër të së drejtës vendase.

Megjithatë, Gjykata më parë ka deklaruar se mosmarrëveshjet në lidhje me punësimin mes autoriteteve dhe shërbyesve civilë ishin të përjashtuara nga fushëveprimi i nenit 6 § 1 sepse nuk përbënin padi civile. Gjykata zbatoi testin nga *Vilho Eskelinen v. Finland*<sup>[409]</sup> për të parë nëse kërkuesi bënte pjesë në këtë kategori. Për t'u përjashtuar kërkuesi, së pari Shteti duhet t'i kishte të përjashtuara nga e drejta vendase mosmarrëveshjet e lidhura me postin ose kategorinë e personelit në fjalë. Së dyti, përjashtimi duhet të ishte i justifikuar mbi baza objektive në interes të Shtetit.

Duke analizuar kriterin e parë të *Vilho Eskelinen*, Gjykata gjeti që kërkuesi duhet të kishte pasur mundësi të kontestonte shkarkimin e tij para Tribunalit të Shërbimit (Service Tribunal). Mbrojtja e kërkuesit nga shkarkimi ishte e parashikuar me hollësi në të drejtën vendase, në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe evropiane të pavarësisë së gjyqësorit dhe me mbrojtjet procedurale të zbatueshme në çështjet që kishin të bënin me shkarkimin e gjyqtarëve. Por në këtë rast, pavarësisht nga mbrojtjet ligjore të përshkruara më lart, qasja e kërkuesit në gjykatë ishte penguar nga fakti që përfundimi i parakohshëm i mandatit të tij si Kryetar i Gjykatës Supreme ishte përfshirë në dispozitat kalimtare të Ligjit të ri për Organizimin dhe Administrimin e Gjykatave. Ky ligj ia ndalonte kërkuesit kontestimin e përfundimit të mandatit të tij para Tribunalit të Shërbimit, diçka që ai do të kishte mundur ta bënte në rast shkarkimi mbi bazën e kornizës ligjore paraekzistuese.

Megjithatë, Gjykata arsyetoi që kërkuesi nuk mund të përjashtohet në mënyrë legjitime nga qasja në gjykatë përmes të njëjtës masë që supozohej se përbënte ndërhyrje tek e drejta e kërkuesit sipas nenit 6. Përndryshe, Shtetet thjesht mund t'u mohonin shërbyesve civilë qasjen në gjykata dhe në mbrojtjet e nenit 6 duke e

409 *Vilho Eskelinen k. Finlandës*, vendimi i Dhomës së Madhe i 19 prillit 2007, nr. 63235/00.

përfshirë një dispozitë të tillë në çdo instrument statutor që fusin. Gjykata gjithashtu theksoi se, në mënyrë që legjislativi të përjashtonte qasjen në gjykatë sipas kritereve të nenit 6 § 1, ai duhet të ishte në përputhje me shtetin e së drejtës, çka do të thotë se çdo ndërhyrje në Konventë duhet të bazohet mbi një instrument të zbatimit të përgjithshëm. Më tej, Komisioni i Venedikut kishte deklaruar se ligjet që drejtohen kundër personave të caktuar ishin në kundërshtim me shtetin e së drejtës. Prandaj, meqenëse përjashtimi i kërkuarit nga qasja në gjykatë nuk ishte në përputhje me shtetin e së drejtës, nuk mund të vendosej që ai e përjashtonte shprehimisht kërkuarin nga mbrojtjet e nenit 6. Rrjedhimisht, kërkuari nuk ishte i përjashtuar nga mbrojtja e nenit 6.

Heqja e parakohshme e kërkuarit nga posti nuk u mor në shqyrtim, e as nuk qe e hapur për shqyrtim. Kjo mungesë e mundësisë për shqyrtim gjyqësor ishte gjithashtu rezultat i ligjeve, pajtueshmëria e të cilave me shtetin e së drejtës u konsiderua e dyshimtë nga Gjykata. Po ashtu Gjykata theksoi rëndësinë gjithnjë e më të madhe të drejtësisë procedurale në instrumentet ndërkombëtare dhe ato të Këshillit të Evropës, si dhe në praktikën gjyqësore të gjykatave ndërkombëtare dhe organeve të tjera ndërkombëtare, në çështjet që kishin të bënin me heqjen ose shkarkimin e gjyqtarëve. Si rezultat, Gjykata vendosi që kishte ndodhur shkelja e të drejtës së kërkuarit për qasje në gjykatë nga neni 6.

### Neni 10

Për të konstatuar nëse ishte shkelur e drejta e kërkuarit për lirinë e shprehjes, Gjykata së pari u desh të përcaktonte nëse masa e ankimuar përbënte ndërhyrje tek e drejta e kërkuarit për lirinë e shprehjes në formën e një “formaliteti, kushti, kufizimi ose gjobe” apo nëse ajo thjesht kishte prekur ushtrimin e të drejtës së tij për të mbajtur një post publik në administrimin e drejtësisë, që nuk ishte e drejtë e njohur. Në këtë rast, Gjykata theksoi se propozimet e Qeverisë për të përfunduar mandatin e kërkuarit, si dhe propozimi për një kriter të ri zgjedhshmërie për postin e Kryetarit të Kúria-s, të gjitha ishin paraqitur në Parlament brenda një kohe çuditërisht shumë të shkurtër, mes 9 dhe 23 nëntorit 2011, dhe pak kohë pasi kërkuari kishte shprehur publikisht pikëpamje kritike në lidhje me disa reforma legjislative që preknin gjyqësorin, veçanërisht më 3 nëntor. Më tej, intervistat e dhëna nga dy deputetë të shumicës parlamentare dhe garancitë qeveritare dhënë Komisionit të Venedikut që kërkuari nuk do të hiqej nga posti i tij të gjitha kishin ndodhur përpara fjalimit të tij në Parlament më 3 nëntor 2011, datë pas së cilës u paraqitën të gjitha propozimet për t’ia përfunduar mandatin dhe për të anuluar pagesat e tij pas mandatit.



Sipas mendimit të Gjykatës, duke pasur parasysh rrjedhën e ngjarjeve në tërësi, kishte prova *prima facie* të një lidhjeje shkakësore mes ushtrimit nga kërkuesi i të drejtës së tij për lirinë e shprehjes dhe përfundimit të mandatit të tij. Gjykata deklaroi se kur kishte prova *prima facie* në favor të versionit të kërkuesit dhe ekzistonte një lidhje shkakësore, barra e provës për ta mohuar një lidhje të tillë binte mbi Qeverinë. Në këtë rast, Qeveria dështoi të tregonte bindshëm se heqja e kërkuesit nga posti ishte nxitur nga eliminimi i postit dhe funksioneve të kërkuesit. Prandaj, Gjykata që dakord me kërkuesin që përfundimi i mandatit të tij ishte nxitur nga pikëpamjet dhe kritikrat që ai kishte shprehur publikisht në cilësi profesionale, duke shkaktuar ndërhyrje tek e drejta e tij për lirinë e shprehjes.

Më tej, Gjykata shqyrtoi nëse kjo ndërhyrje kishte qenë e justifikuar, d.m.th. nëse ishte e parashikuar me ligj, nëse kishte një qëllim legjitim, dhe nëse ishte e nevojshme në një shoqëri demokratike. Siç u tha më lart në lidhje me ankesën e kërkuesit sipas nenit 6, Gjykata kishte dyshime të konsiderueshme nëse ligjet që mbështesnin përfundimin e mandatit të kërkuesit ishin në pajtueshmëri me shtetin e së drejtës. Megjithatë, për qëllimet e kësaj çështjeje, Gjykata procedoi mbi supozimin që ndërhyrja në nenin 10 vërtet ishte e parashikuar me ligj.

Qeveria pretendoi që ligjet e reja dhe heqja e kërkuesit nga posti ishin përpjekje për të ruajtur autoritetin dhe paanshmërinë e gjyqësorit. Megjithatë, Gjykata tha se një Shtet nuk mund të përdorë si arsye legjitime pavarësinë e gjyqësorit për të justifikuar përfundimin e parakohshëm të mandatit të një kryetari gjykate për arsye të cilat nuk ishin përcaktuar me ligj dhe që nuk kishin të bënin me paaftësi profesionale apo sjellje të pahijshme. Më tej, masat ishin marrë si rezultat i ushtrimit të së drejtës së kërkuesit për lirinë e shprehjes, në një situatë ku kërkuesi ishte mbajtësi i postit më të lartë në gjyqësor dhe u ndalua të shërbente mandatin e tij të plotë në detyrë. Pra veprimet e Qeverisë nuk ishin në pajtueshmëri me qëllimin e tyre të deklaruar, dhe Gjykata vlerësoi se heqja e kërkuesit dukej të ishte në papajtueshmëri me qëllimin e ruajtjes së pavarësisë së gjyqësorit.

Ndërkohë që në këtë pikë u gjet shkelle e nenit 10, meqenëse referenca nuk ishte e justifikuar, Gjykata e konsideroi me rëndësi të shqyrtonte nëse ndërhyrja mund ishte konsideruar e nevojshme në një shoqëri demokratike. Gjatë shqyrtimit të parimeve të lirisë së shprehjes që u zbatoheshin gjyqtarëve, Gjykata theksoi se, duke ditur rëndësinë e ndarjes së pushteteve dhe ruajtjes së pavarësisë së gjyqësorit, çdo ndërhyrje tek liria e shprehjes së një gjyqtari kërkonte hetim të thellë. Për më tepër, pyetjet në lidhje me funksionimin e sistemit të drejtësisë dhe ndarjen e pushteteve ishin çështje të interesit publik, ku debatet dhe diskutimet rreth tyre gëzonin një shkallë të lartë mbrojtjeje nga neni 10.

Veprimet e Qeverisë u vlerësuan se nuk ishin të nevojshme në një shoqëri demokratike sepse ato komprometonin parimin e mos-shkarkimit të gjyqtarëve, element kyç për ruajtjen e pavarësisë gjyqësore, dhe kishin shkaktuar frikën e heqjes nga postet tek shumë gjyqtarë të tjerë, gjë që Gjykata e quajti “efekti dekurajues”. Ky efekt dekurajues bëri që gjyqtarët e tjerë të mos merrnin pjesë në debatet publike rreth çështjeve të administrimit të drejtësisë dhe gjyqësorit. Gjykata theksoi se nuk ishte vetëm e drejta e kërkuesit por edhe detyra e tij si Kryetar i Këshillit Kombëtar të Drejtësisë që të shprehte pikëpamjet e tij mbi reformat legjislativë që preknin gjyqësorin e posaçërisht pavarësinë e gjyqësorit, sidomos duke pasur parasysh faktin që çdo gjyqtar ishte përgjegjës për promovimin dhe mbrojtjen e pavarësisë gjyqësore. Kërkuesi thjesht foli në kuadër të përgjegjësisë profesionale të postit dhe profesionit të tij, dhe deklaratat e tij asnjëherë nuk shkuan përtej kritikave nga këndvështrimi strikt profesional për çështje të interesit të gjerë publik. Gjykata konsideroi se masat e Qeverisë që kishin vënë në shënjestër kërkuesin e godisnin, në vend që ta mbronin, qëllimin e ruajtjes së pavarësisë së gjyqësorit.

Prandaj Gjykata arriti në përfundimin që ndërhyrja tek ushtrimi nga kërkuesi i të drejtës së tij për lirinë e shprehjes nuk kishte qenë “e nevojshme në një shoqëri demokratike”, dhe kishte përbërë shkelje të nenit 10.

#### Neni 13

Gjykata gjeti se nuk ishte e nevojshme të shqyrtohej kërkesa ndaras sipas nenit 13 të Konventës në lidhje me nenin 10.

#### Neni 14

Gjykata gjeti se nuk ishte e nevojshme të shqyrtohej kërkesa ndaras sipas nenit 14 të Konventës në lidhje me nenet 6 dhe 10.

#### Neni 41

Gjykata vendosi që Hungaria duhet t'i paguante kërkuesit 70,000 euro në lidhje me dëme materiale dhe jomateriale, dhe 30,000 euro në lidhje me kosto dhe shpenzime.

*Komentet rreth akuzave të ngritura kundër kërkuesit, politikan i mirënjohur, nga një gjyqtar dhe një ministër u vendos se kishin shkelur të drejtën e tij për prezumim të pafajësisë*

## VENDIMI NË ÇËSHTJEN GUTSANOVI k. BULLGARISË

---

(Kërkesa nr. 34529/10)

**15 tetor 2013**

### **1. Faktet kryesore**

Kërkuesit ishin z. Borislav Gutsanov ('kërkuesi i parë'), një politikan i njohur vendas, bashkëshortja e tij dhe dy vajzat e vogla të tyre. Autoritetet kishin dyshime tek kërkuesi i parë për përfshirje në grup kriminal, abuzim me pushtetin dhe përvetësim të fondeve publike. Rreth orës 6:30 të mëngjesit më 31 mars 2010, një skuadër speciale që përfshinte policë të armatosur dhe të maskuar shkoi në shtëpinë e kërkuesit. Një kujdestar i informoi ata rreth pranisë së bashkëshortes dhe fëmijëve. Pasi që kërkuesit nuk iu përgjigjën urdhrit për të hapur derën, policët hynë brenda me forcë. Shtëpia u bastis dhe shumë sende u morën si prova. Kërkuesi i parë u arrestua dhe u shoqërua nga ambientet e shtëpisë në orën 1 të drekës, ndërkohë që kjo u incizua nga gazetarët dhe ekipet televizive. Të njëjtën ditë u mbajt një konferencë shtypi, ku një prokuror lajmëroi për akuzat kundër individëve të arrestuar, përfshirë kërkuesin e parë, si pjesë e një grupi kriminal. Në orën 10:55 të mbrëmjes, një prokuror depozitoi aktakuzën zyrtare kundër kërkuesit me akuzat të ndryshme dhe urdhëroi paraburgim 72-orësh për të siguruar praninë e tij në gjykatë. Më 1 prill një gazetë botoi fjalimin e prokurorit, së bashku me pjesë të shkëputura nga një intervistë me Ministrin e Brendshëm, gjatë së cilës ai foli për afërsinë e kërkuesit të parë me një të dyshuar tjetër dhe përfshirjen e tyre në "komplot". Më 3 prill 2010, një gjykatë e vendosi atë në paraburgim paragjyqësor për shkak të rrezikut që ai mund të kryente vepra të tjera. Më 5 prill 2010 Kryeministri dha intervistë të drejtpërdrejtë në lidhje me ngjarjet aktuale, në fund të së cilës iu kërkua të komentonte rreth arrestimeve të fundit, me ç'rast ai përmendi afërsinë e kërkuesit të parë me një të dyshuar tjetër dhe "përfitime materiale". Apeli i kërkuesit të parë kundër paraburgimit paragjyqësor më 13 prill 2010 dhe një kërkesë e mëtejme për t'u liruar më 18 maj 2010 u refuzuan. Më 25 maj 2010 Gjykata e Apelit e vendosi kërkuesin e parë në arrest shtëpiak, duke deklaruar se nuk ekzistonte më rreziku që ai të kryente vepra të tjera. Më 26 korrik 2010 gjykata vendosi ta lironte atë me dorëzani.

## 2. Vendimi i Gjykatës

Duke u mbështetur në nenin 3 (ndalimi i torturës dhe trajtimit çnjerëzor dhe poshtëruës), nenin 5 (e drejta për liri dhe siguri) dhe nenin 6 (e drejta për proces të drejtë), kërkuesit u ankuan që arrestimi, paraburgimi dhe gjyqi i kërkuesit të parë kishin shkelur Konventën. Kërkuesit gjithashtu pretenduan sipas nenit 8 (e drejta për respektim të jetës private dhe familjare) se bastisja e shtëpisë së tyre nuk kishte qenë e autorizuar si duhet, dhe sipas nenit 13 (e drejta për zgjidhje efektive) që ata nuk kishin pasur zgjidhje efektive në lidhje me trajtimin që i ishte bërë atyre gjatë arrestimit të kërkuesit të parë.

### Neni 3

Operacioni i policisë synonte qëllimin legjitim të kryerjes së arrestimit, bastisjes dhe gjetjes, në interesin e përgjithshëm të ndjekjes së veprave penale. Megjithatë, planifikimi dhe ekzekutimi i tij nuk mori parasysh një sërë faktorësh të rëndësishëm, siç ishte natyra e veprave për të cilat akuzohej kërkuesi i parë, fakti që ai nuk kishte histori penale, dhe prania e bashkëshortes dhe fëmijëve të tij. Këto faktorë tregonin se përdorimi i agjentëve specialë, të armatosur dhe të maskuar dhe metodeve si ardhja herët në mëngjes ishin të tepërta, më shumë sesa të nevojshme për të kapur të dyshuarin dhe për të mbledhur prova. Katër kërkuesit i ishin nënshtruar një përvoje të hidhur psikologjike që kishte shkaktuar ndjenja frike, ankthi dhe një ndjenjë që s'kishin nga t'ia mbanin, çka e kualifikonte këtë si trajtim poshtëruës. Prandaj, Gjykata gjeti shkelje të nenit 3.

### Neni 5

Kërkuesi i parë i filloi ankesat e tij sipas nenit 5 duke pretenduar se ai nuk ishte sjellë menjëherë para një gjyqtari, në shkelje të nenit 5 § 3. Kërkuesi i parë u mbajt në paraburgim pa gjyq për tre ditë e gjashtë orë, por nuk mori pjesë në asnjë masë hetimore pas ditës së parë. Ai nuk dyshohej për përfshirje në aktivitet të dhunshëm, dhe ishte në gjendje psikologjike delikate gjatë fazave fillestare të paraburgimit pas trajtimit poshtëruës që përjetoi gjatë operacionit të policisë, i cili u përkeqësua nga fama e tij negative publike. Ai u mbajt në paraburgim në të njëjtin qytet ku ndodhej edhe gjykata, dhe nuk pati nevojë për masa të tepruara sigurie. Këto elemente bënë që Gjykata të gjente shkelje të kriterit të nenit 5 për ta sjellë të dyshuarin menjëherë para një gjyqtari.

Kërkuesi i parë gjithashtu u ankua sipas nenit 5 § 3 që të drejtat e tij ishin shkelur në lidhje me kohëzgjatjen e paraburgimit të tij. Kërkuesi i parë u paraburgos për

një periudhë prej 118 ditësh (31 mars deri më 30 korrik 2010), ku gjatë kësaj periudhe dy muaj ishin arrest shtëpiak. Vendimet e gjykatave vendase për ta mbajtur atë në paraburgim ishin të bazuara mbi rrezikun që ai mund të kryente vepër të re, sidomos që ai mund të ndërhynte tek provat. Megjithatë, më 25 maj 2010, Gjykata e Apelit vendosi që pas dorëheqjes së kërkuesit të parë nga posti i tij, ky rrezik kishte kaluar. Sidoqoftë, në kundërshtim me detyrimet e saj ndaj ligjeve vendase, e njëjta gjykatë e vendosi kërkuesin e parë në arrest shtëpiak pa dhënë arsye për ta justifikuar këtë vendim. Prandaj, Gjykata doli në përfundimin që autoritetet kishin dështuar në detyrimin e tyre për të dhënë arsyet e duhura dhe të mjaftueshme për paraburgimin e kërkuesit të parë pas 25 majit 2010, dhe për këtë arsye kishin shkelur nenin 5 § 3.

Kërkuesi i parë gjithashtu iu ankua Gjykatës se ai nuk kishte pasur qasje në zgjidhje efektive sipas nenit 5 § 5. Ligji për Përgjegjësinë e Shtetit nuk i dha kërkuesit të parë zgjidhje efektive për padinë e dëmeve të pësuarra prej tij gjatë paraburgimit, sepse kjo kërkonte gjetje formale nga një gjykatë vendase që paraburgimi i tij kishte qenë i paligjshëm. Meqenëse procedura kundër kërkuesit të parë ishte në vazhdim, kjo nuk i zbatohet atij sepse paraburgimi i tij ende konsiderohej i ligjshëm nga gjykatat vendase. Meqenëse nuk ekzistonte ndonjë dispozitë vendase për kompensim, Gjykata gjeti shkelje të nenit 5 § 5 për të njëjtat arsye për të cilat ajo kishte rrëzuar kundërshtimin e Shtetit mbi bazën e mos-shterimit të zgjidhjeve vendase.

## Neni 6

Gjykata shqyrtoi pretendimet e kërkuesit të parë që disa zyrtarë të ndryshëm publikë kishin shkelur të drejtën e tij për prezumim të pafajësisë. Ai pretendoi se Kryeministri kishte sugjeruar në një intervistë televizive që kërkuesi i parë kishte pasur përfitime materiale falë lidhjeve të tij politike, ku ky ishte një element i akuzave kundër tij. Gjithashtu, ai pretendoi se prokurori rajonal, si përfaqësues i prokurorisë publike, kishte renditur akuzat potenciale kundër kërkuesit të parë dhe kishte insistuar që ai do të përballej me dënime të gjata për këto krime. Kërkuesi i parë gjithashtu pretendoi se Ministri i Brendshëm i ishte referuar kërkuesit të parë si pa diskutim fajtor për disa vepra të rënda. Në fund, kërkuesi pretendoi se një gjyqtar i caktuar për të vendosur nëse kishte prova të mjaftueshme për të dyshuar se kërkuesi i parë kishte kryer vepër penale, deklaroi që ishte i sigurt se ishte kryer vepër penale.

Pas mos-gjetjes së shkeljes në lidhje me intervistën e Kryeministrit dhe fjalimin e prokurorit në konferencën për shtyp, meqenëse asnjëra prej tyre nuk u konsiderua se kishte gjasa të sugjeronte që kërkuesi i parë ishte fajtor për një krim për të cilin nuk ishte gjykuar ende, Gjykata konsideroi çështjen e Ministrit të Brendshëm. Në intervistën e tij, Ministri deklaroi se ajo që “kanë bërë kërkuesi i parë dhe një i dyshuar

tjetër përfaqëson një komplot të sofistikuar gjatë një periudhe prej disa vitesh". Gjykata bëri dallimin mes natyrës së kësaj interviste, që kishte të bënte ekskluzivisht me operacionin, dhe fjalëve spontane të Kryeministrit pak ditë më vonë. Përveç kësaj, fakti që ky fjalim u bë publik të nesërmen e arrestimit të kërkuesit të parë (dhe para paraqitjes së tij në gjykatë) nga një zyrtar i lartë qeveritar i cili në ato rrethana duhet të kishte marrë masa për të shmangur konfuzionin ishte domethënëse. Fjalët ishin më shumë sesa një komunikim i thjeshtë informacioni, dhe në fakt sugjeronin fajësinë e kërkuesit të parë. Gjykata konfirmoi se mungesa e qëllimit të vërtetuar për të ndërhyrë tek prezumimi i pafajësisë nuk do të thoshte se nuk mund të gjendej shkelje e nenit 6 sipas atij titulli. Prandaj, kishte pasur shkelje të nenit 6 § 2.

Në fund, vendimi i gjyqtarit për kërkesën e kërkuesit të parë për t'u liruar deklaroi se gjykata "vazhdon të jetë e mendimit se ka pasur vepër penale dhe se i akuzuari ka qenë i përfshirë". Kjo frazë u konsiderua nga gjykata të ishte më shumë sesa një përshkrim i thjeshtë i dyshimit, dhe më tepër një deklarament fajësie para se të ishte marrë vendimi në lidhje me themelet e çështjes. Prandaj, edhe kjo deklaratë kishte shkelur të drejtën e kërkuesit për prezumim të pafajësisë sipas nenit 6 § 2.

### Neni 8

Gjykata theksoi se bastisja në fjalë ishte e bazuar mbi dispozita legislative të cilat nuk përbënin asnjë problem sa i përket qasshmërisë dhe parashikueshmërisë së tyre me qëllim që bastisja të ishte "në përputhje me ligjin". Sa i përket kushtit të fundit cilësor që duhet të përmbushej nga legjislacioni vendas, pra pajtueshmëria me shtetin e së drejtës, Gjykata kujtoi se në kontekstin e bastisjeve dhe konfiskimeve kërkohet që ligjet vendase të ofronin garanci të mjaftueshme kundër arbitraritetit. Në rastin konkret, bastisja e shtëpisë së kërkuesve u zhvillua pa autorizim paraprak të gjyqtarit. Një bastisje e tillë u lejua me kusht që një gjykatë ta shqyrtonte bastisjen në retrospektivë për t'u siguruar që ajo përmbushte kushtet e kërkuara materiale dhe procedurale. Në këtë rast, gjyqtari në fjalë, megjithatë, nuk dha arsye për miratimin e tij – ai thjesht kishte firmosur dhe vulosur procesverbalin i ndjekur nga fjala "miratohet". Si rezultat, Gjykata konsideroi se ai nuk kishte treguar kontroll efektiv mbi ligjshmërinë dhe nevojshmërinë e bastisjes. Prandaj, Gjykata konsideroi se ndërhyrja tek e drejta për respektim të shtëpisë nuk ishte e parashikuar "në ligj" e rrjedhimisht shkelte nenin 8.

### Neni 13 në kombinim me nenet 3 dhe 8

Në ligjet vendase nuk ekzistonte zgjidhje efektive me anë të së cilës kërkuesit mund të mbronin të drejtën e tyre për të mos iu nënshtruar trajtimit në kundërshtim

me nenin 3 dhe për respektim të shtëpisë së tyre sipas nenit 8. Prandaj, u gjet shkelje e nenit 13 në kombinim me këto dy nene.

#### Neni 41

Kërkuesve iu caktua shuma 40,000 euro si shpërblim i drejtë dhe shuma 4,281 për kosto dhe shpenzime.

*Padia disiplinore kundër një gjyqtari mbi bazën e anëtarësisë së tij në organizatën e Masonëve të Lirë u deklarua se kishte shkelur lirinë e organizimit sipas nenit 11*

## VENDIMI I DHOMËS NË ÇËSHTJEN MAESTRI k. ITALISË

---

(Kërkesa nr. 39748/98)  
**17 shkurt 2004**

### 1. Faktet kryesore

Kërkuesi, Angelo Massimo Maestri, ishte i lindur në vitin 1944 dhe jetonte në Itali. Në kohën e bërjes së kërkesës, ai ishte gjyqtar dhe në rolin e kryetarit të Gjykatës së Rrethit në La Spezia. Në nëntor 1993 kundër tij nisi procedura disiplinore, sipas Dekretit Legjislativ Mbretëror të 31 majit 1946 (“dekreti i vitit 1946”), për shkak se ai kishte qenë anëtar i lozhës së Masonëve nga viti 1981 deri në mars të vitit 1993.

Në një vendim të 10 tetorit 1995, seksioni disiplinor i Këshillit Kombëtar të Gjyqësorit gjeti se kërkuesi e kishte kryer veprën për të cilën akuzohej dhe i dha atij një qortim. Aty thuhej se që nga viti 1982 e tutje duhet të kishte qenë e mundur “të kishte një ide të qartë për humbjen e integritetit që rezultonte nga anëtarësia në Masonët e Lirë”, ku kjo ishte referencë ndaj Ligjit Nr. 17 të 25 janarit 1982 (“ligji i vitit 1982”) i cili përmbante dispozita mbi zbatimin e Nenit 18 të Kushtetutës italiane (e drejta për organizim) në lidhje me shoqatat sekrete dhe i cili e bënte anëtarësinë në shoqata sekrete vepër penale.

Seksioni disiplinor gjithashtu thoshte se ishte në kundërshtim me rregullat disiplinore që një gjyqtar të ishte Mason i Lirë, për shkak të papajtueshmërisë mes betimit masonik dhe betimit të gjyqtarit, marrëdhënies hierarkike mes Masonëve të Lirë, refuzimit të drejtësisë së Shtetit në favor të drejtësisë masonike, dhe natyrës së përhershme të lidhjes mes Masonëve të Lirë. Gjithashtu, ai iu referua direktivave të dhëna nga Këshilli Kombëtar i Gjyqësorit i cili theksonte konfliktin mes anëtarësisë në Masonët e Lirë dhe anëtarësisë në gjyqësor në mars të vitit 1990 (“direktiva e vitit 1990”) dhe korrik të vitit 1993. Sipas direktivës së vitit 1990, “anëtarësia e gjyqtarëve në shoqata që imponojnë lidhje të forta hierarkike dhe të ndërsjella me anë të vendosjes, përmes betimit solemn, të lidhjeve të tilla siç janë ato që kërkohen nga lozhat masonike, krijon probleme delikate sa i përket respektimit të vlerave të ngërthyera në Kushtetutën e Italisë”.

Kërkuesi apeloj mbi tri pika të ligjit para Gjykatës së Kasacionit. Ai pretendoi shkeljen e Nenit 18 të Kushtetutës italiane, mbrojtja pajtueshmërinë e detyrës



gjyqësore me anëtarësinë në Masonët e Lirë, dhe u ankua për mungesën e provave në gjetjen se një gjyqtar do të ishte i diskredituar në qoftë se ishte anëtar i Masonëve të Lirë. Apeli i tij u rrëzua më 20 dhjetor 1996.

Kërkuesi gjithashtu pohoi se karriera e tij kishte ngecur në vend pas vënies së sanksioneve disiplinore.

## **2. Vendimi i Gjykatës**

Kërkuesi pretendoi se vënia e sanksioneve ndaj tij për faktin se ishte Mason i Lirë përbënte shkelje të neneve 9 (e drejta për lirinë e mendimit, ndërgjegjes dhe fesë), 10 (liria e shprehjes) dhe 11 (liria e organizimit dhe tubimit). Juridiksioni iu dha Dhomës së Madhe sipas nenit 30.

### Neni 11

Gjykata konsideroi se ankesat e kërkuesit hynin veçanërisht brenda fushëveprimit të nenit 11. Rrjedhimisht, ajo i konsideroi ankesat që kishte përpara vetëm në kuadër të kësaj dispozite.

Gjykata konsideroi se kishte pasur ndërhyrje tek e drejta e kërkuesit për lirinë e organizimit e cila garantohet nga neni 11. Në lidhje me faktin nëse ndërhyrja kishte qenë e parashikuar nga ligji, Gjykata përsëriti se masa në fjalë duhet të kishte pasur bazë në të drejtën vendase dhe duhet të kishte qenë e përdorshme dhe e parashikueshme.

Në lidhje me atë pikë, Gjykata vuri në dukje se Neni 18 i dekretit të vitit 1946, i parë nën dritën e ligjit të vitit 1982 për të drejtën e organizimit dhe direktivën e vitit 1990, kishte qenë dispozita ligjore e përdorur si bazë për sanksionin e vënë ndaj kërkuesit.

Sa i përket cilësisë së ligjit, Gjykata theksoi në fillim se Neni 18 i dekretit të vitit 1946 ishte i përdorshëm meqenëse ai ishte publik dhe kërkuesi, falë profesionit të tij, mund të kishte mësuar rreth tij shumë lehtë. Së dyti, sa i përket faktit nëse ligji kishte qenë i parashikueshëm, pra nëse ligji italian i kishte shprehur me saktësinë e duhur kushtet në të cilat një gjyqtar nuk duhet t'i bashkohet Masonëve të Lirë, Gjykata konsideroi se duhet të bëhej dallimi mes dy periudhave: periudhës para miratimit nga Këshilli Kombëtar i Gjyqësorit të direktivës së vitit 1990, dhe periudhës pasuese.

Në lidhje me periudhën nga viti 1981 deri në mars 1990, Gjykata konsideroi se Neni 18 nuk i përmbushte kushtet e parashikueshmërisë dhe se, edhe pasi që Italia e

kishte miratuar ligjin e vitit 1982 për të drejtën e organizimit, kërkuesi nuk mund ta kishte parashikuar që anëtarësimi i një gjyqtari në një lozhë masonike mund t'i jepte shkas një çështjeje disiplinore.

E njëjta vlente edhe për periudhën nga miratimi i direktivës në mars 1990 deri në mars 1993. Megjithëse direktiva në fjalë ishte lëshuar në kontekstin e një shqyrtimi të çështjes së anëtarësimit të gjyqtarëve në organizatën e Masonëve të Lirë, debati para Këshillit Kombëtar të Gjyqësorit kishte pasur për qëllim të formulonte, e jo të zgjidhte, një problem. Gjykata deklaroi se formulimi i direktivës nuk kishte qenë aq i qartë sa t'i mundësonte kërkuesit, pavarësisht se ky ishte gjyqtar, që të vetëdijesohej se anëtarësia e tij në një lozhë masonike mund të çonte drejt vënies së sanksioneve mbi të. Vlerësimi i Gjykatës u konfirmua nga fakti që Këshilli Kombëtar i Gjyqësorit vetë e kishte ndier nevojën për t'iu kthyer çështjes në korrik të vitit 1993 dhe për të deklaruar me fjalë të qarta se ushtrimi i funksioneve gjyqësore ishte në papajtueshmëri me anëtarësinë në Masonët e Lirë.

Rrjedhimisht, ndërhyrja nuk kishte qenë e parashikuar me ligj. Pra kishte pasur shkelje të nenit 11.

#### Neni 41

Gjykata i caktoi kërkuesit 10,000 euro për dëme jomateriale dhe 14,000 euro për kosto dhe shpenzime.

*Dënimi për shpifje ndaj një avokati, i cili po punonte në një çështje vrasjeje me paramendim, ishte ndërhyrje joproporcionale tek e drejta e tij për lirinë e shprehjes*

## VENDIMI I DHOMËS SË LARTË NË ÇËSHTJEN **MORICE K. FRANCËS**<sup>[410]</sup>

(Kërkesa nr. 29369/10)  
**23 prill 2015**

### **1. Faktet kryesore**

Kërkuesi, z. Olivier Morice, ishte avokat francez dhe anëtar i Dhomës së Avokatëve të Parisit. Ai përfaqësoi Znj. Elisabeth Borrel, gjyqtare dhe e veja e gjyqtarit francez Bernard Borrel, trupi i të cilit u gjet më 19 tetor 1995, 80 kilometra nga qyteti i Xhibutit.

Në vitin 1997, hetimi gjyqësor francez për vdekjen e z. Borrel si vrasje me paramendim iu caktua gjyqtarëve hetues, znj. M. dhe z. L.L. Më 21 qershor 2000, në bazë të ankimit të paraqitur nga kërkuesi dhe kolegu i tij, Seksioni i Padive i Gjykatës së Apelit të Parisit hodhi poshtë vendimin e dy gjyqtarëve, në të cilin ata refuzuan të organizonin një rindërtim në vendngjarje në prani të palëve civile, duke ua hequr çështjen këtyre gjyqtarëve dhe duke ia transferuar një gjyqtari të ri hetues, Gjyqtarit P.

Gjyqtari i ri hetues paraqiti një raport më 1 gusht të vitit 2000 me konstatimet vijuese lidhur me çështjen e z. Borrel: një videoincizim që ishte bërë në mars të vitit 2000 në Xhibuti; një vizitë në vendngjarje nga gjyqtarët e mëparshëm hetues dhe ekspertët nuk figuronte në dosjen hetimore gjyqësore që i ishte dorëzuar atij dhe as nuk ishte regjistruar si provë materiale; pas kërkesës së tij, atij iu dërgua kasete nga Gjyqtarja M. me një zarf i cili nuk kishte asnjë shenjë vulosjeje dhe as nuk mbante emrin e gjyqtarit si marrësi, së bashku me një pusullë me shkrim dore dërguar asaj nga prokurori publik i Xhibutit si dërguesi; pusulla, e shkruar në gjuhë informale dhe që zbulonte, çuditërisht dhe fatkeqësisht, një afërsi të ndërsjellë midis Gjyqtarës M. dhe prokurorit publik të Xhibutit, hidhte dyshime mbi znj. Borrel dhe avokatët e saj, duke i akuzuar ata për “orkestrimin e manipulimit të tyre”.

Më 6 shtator të vitit 2000, kërkuesi dhe kolegu i tij i shkruan Ministrit francez të Drejtësisë, duke u ankuar rreth fakteve të konstatuara nga Gjyqtari P. në raportin e tij, i cili i referohej sjelljes së Gjyqtarëve M. dhe L.L. si “tërësisht në kundërshtim me parimet e paanshmërisë dhe ndershmërisë”. Ata kërkuan kryerjen e një hetimi

410 Ky vendim është përfundimtar.

nga Inspektoriati i Përgjithshëm i Shërbimeve Gjyqësore për mangësitë e shumta që ishin nxjerrë në pah gjatë hetimit gjyqësor. Të nesërmen, fragmente të asaj letre, së bashku me deklaratat e kërkuarit për gazetarin dhe pusullën e shkruar me dorë, u bënë pjesë e një artikulli në gazetën *Le Monde*. Artikulli i referohej, po ashtu, procedurës disiplinore kundër Gjyqtarës M. që ishte paraqitur përpara Komisionit Kombëtar të Shërbimit Ligjor për çështjen e Shkencologjisë (Scientology), për të cilën mbante përgjegjësi, veçanërisht për zhdukjen e dokumenteve nga dosja e çështjes. Kërkuari, i cili përfaqësonte palët civile në atë çështje, gjithashtu, kishte arritur përjashtimin e Gjyqtarës M. nga hetimi dhe, në vitin 2000, një vendim të gjykatës kundër shtetit për neglizhencë flagrante nga ana e shërbimit të gjykatave, për shkak të zhdukjes së dosjes së Shkencologjisë nga zyra e Gjyqtarës M.

Në tetor të vitit 2000, Gjyqtarët M. dhe L.L. ngritën padi penale kundër kryeredaktorit të *Le Monde*, gazetarit që kishte shkruar artikullin dhe kërkuarit, duke i akuzuar ata për veprën e shpifjes publike për një nëpunës civil. Së fundi, në vitin 2008, kërkuari u shpall fajtor si bashkëpunëtor në këtë vepër nga Gjykata e Apelit e Ruenit.

Kërkuari e ankmoi vendimin e Gjykatës së Apelit të Ruenit. Më 10 nëntor 2009, Gjykata e Kasacionit e hodhi poshtë ankimimin për interpretim të ligjit, duke vërejtur, posaçërisht, se ishin tejkaluar kufijtë e pranueshëm të lirisë së shprehjes në kritikën drejtuar veprimit të gjyqtarëve. Përbërja e trupës së Gjykatës së Kasacionit ishte e ndryshme nga ajo që iu ishte njoftuar më parë palëve: prania e Gjyqtarit J.M. çoi në ankesën e kërkuarit se gjyqtari në fjalë, në një Takim të Përgjithshëm të gjyqtarëve të *tribunal de grande instance* të Parisit, në korrik të vitit 2000, kishte shprehur mbështetjen për Gjyqtaren M. në kontekstin e procedurave disiplinore kundër mënyrës se si ajo e kishte trajtuar çështjen e Shkencologjisë.

## 2. Vendimi i Gjykatës

Çështja doli përpara Gjykatës Evropiane të Drejtave të Njeriut më 7 maj 2010. Më 11 qershor 2013, Seksioni i Pestë konstatoi se nuk kishte pasur shkelje të nenit 6 § 1 dhe asnjë shkelje të nenit 10 të Konventës. Me kërkesë të kërkuarit, çështja iu transferua Dhomës së Lartë, në përputhje me nenin 43.

Kërkuari pretendoi se në procesin e zhvilluar përpara Gjykatës së Kasacionit kishte pasur shkelje të parimit të paanshmërisë, sipas nenit 6 § 1 (e drejta për proces të rregullt) të Konventës dhe se liria e tij e shprehjes, sanksionuar në nenin 10 (liria e shprehjes) të Konventës ishte shkelur, për shkak të dënimit të tij për bashkëpunim në shpifje.

## Neni 6 § 1

Sipas jurisprudencës së vendosur të Gjykatës, ekzistenca e paanshmërisë duhet të përcaktohet në bazë të një testi subjektiv, ku duhet marrë parasysh bindja dhe sjellja personale e një gjyqtari të caktuar, pra nëse gjyqtari ka pasur ndonjë paragjykim apo njëanshmëri personale në një çështje të dhënë dhe, po ashtu, në bazë të një testi objektiv, duke vërtetuar nëse vetë gjykata dhe, mes aspekteve të tjera, përbërja e saj, ofronte garanci të mjaftueshme për të përjashtuar çdo dyshim legjitim në raport me paanshmërinë e saj.

Gjykata filloi duke konstatuar se kërkuesi e kishte pranuar se nuk ishte përcaktuar që Gjyqtari J.M. të kishte shfaqur ndonjë njëanshmëri personale kundër tij. Megjithatë, argumenti i tij ishte se vetë prania e tij në trupin gjykues kishte krijuar një situatë që justifikonte frikën për mungesë paanshmërie, duke qenë se ai kishte shprehur mbështetje për Gjyqtaren M. nëntë vjet më parë në çështjen e Shkencologjisë. Kështu, Gjykata e shqyrtoi çështjen nga këndvështrimi i testit të paanshmërisë objektive, duke iu përgjigjur pyetjes nëse dyshimet e kërkuesit mund të konsideroheshin si objektivisht të justifikuar në rrethanat e çështjes aktuale.

Së pari, gjuha e përdorur në vitin 2000 nga Gjyqtari J.M. në mbështetje të Gjyqtares M., ankimimi i së cilës kishte çuar në proces gjyqësor penal kundër kërkuesit, kishte mundur të ngrinte dyshime në mendjen e të pandehurit lidhur me paanshmërinë e trupës që gjykonte çështjen e tij. Sipas Gjykatës, vetë konteksti i veçantë i çështjes, që kishte të bënte me një avokat dhe një gjyqtar të cilët kishin qenë të përfshirë në fazën e hetimit gjyqësor të dy çështjeve me profil veçanërisht të lartë, nuk mund të kalohej pa u vënë re. Duke e bërë këtë, pasi theksoi se kërkuesi ishte dënuar në bazë të ankimimit të paraqitur nga Gjyqtarja M., Gjykata konstatoi se vetë vendimi i Gjykatës së Apelit kishte vendosur një lidhje midis komenteve të kërkuesit në çështjen Borrel dhe zhvillimeve në çështjen e Shkencologjisë, duke dalë në përfundimin se kjo sugjeronte ekzistencën e një armiqësie nga ana e kërkuesit për Gjyqtaren M. Ishte pikërisht ky vendim i Gjykatës së Apelit kundër të cilit kërkuesi kishte paraqitur ankimim për interpretim të ligjit që ishte shqyrtuar nga kolegji i Gjykatës së Kasacionit ku bënte pjesë Gjyqtari J.M.

Përveç kësaj, duke qenë se kërkuesi nuk ishte informuar se Gjyqtari J.M. do të ishte pjesë e trupit gjykues dhe nuk kishte arsye të besonte që ai do ta bënte këtë, ai rrjedhimisht nuk kishte pasur asnjë mundësi të kundërshtonte praninë e J.M.-së apo të bënte kërkesë për çështjen e paanshmërisë që lindi lidhur me këtë.

Gjykata vendosi se frika e kërkuesit mund të ishte konsideruar si objektivisht e justifikuar dhe se, për pasojë, kishte pasur një shkelje të Nenit 6 § 1.

## Neni 10

Palët nuk kishin mosmarrëveshje që dënimi i kërkuesit kishte përbërë ndërhyrje në ushtrimin e së drejtës së tij të lirisë së shprehjes, siç parashikohej në Aktin për Lirinë e Shtypit të vitit 1881, dhe se qëllimi i kësaj ndërhyrjeje ishte mbrojtja e emrit apo të drejtave të të tjerëve. Për rrjedhojë, Gjykata e pranoi këtë dhe vijoi me shqyrtimin, nëse ndërhyrja ishte “e nevojshme në një shoqëri demokratike”, nëse ishte proporcionale me qëllimin legjitim që kishte, dhe nëse arsyet e paraqitura nga gjykatat vendase ishin me vend dhe të mjaftueshme.

Kërkuesi ishte mbështetur tek e drejta e avokatëve për të mbrojtur klientët e tyre përmes bërjes së deklaratave për shtyp. Sipas Gjykatës, sa i përket statusit dhe lirisë së shprehjes së avokatëve, duhej bërë një dallim në varësi të faktit nëse komentet e avokatit ishin bërë brenda apo jashtë sallës së gjyqit. Duke qenë se avokatët nuk mund të barazohen me gazetarët, për shkak se pozicionet dhe rolet e tyre përkatëse në procesin gjyqësor janë thelbësisht të ndryshme, komentet e bëra në sallën e gjyqit përligjnin një shkallë të lartë tolerance ndaj kritikave. Sa u përket komenteve të bëra jashtë sallës së gjyqit, avokatët duhej t’iu shmangeshin atyre që përbënin sulm personal të paarsyeshëm, pa një lidhje të drejtpërdrejtë me faktet e çështjes. Kështu, në çështjen aktuale Gjykata nuk arriti të kuptonte se si mund të kishin ndikuar deklaratat e kërkuesit drejtpërdrejt në detyrën për të mbrojtur klientin e tij, duke qenë se në atë kohë hetimi gjyqësor i ishte besuar një gjyqtari tjetër, i cili nuk ishte subjekt kritikash.

Kërkuesi ishte mbështetur më tej tek e drejta e tij për të informuar publikun lidhur me mangësitë e procesit që po zhvillohej, me qëllim që të kontribuonte në debatin për çështjet me interes publik. Gjykata ishte e mendimit se komentet e tij, të cilat kishin të bënin me funksionimin e gjyqësorit dhe mënyrën e trajtimit të çështjes Borrel nga ana e tij, ishin në kontekstin e debatit për çështje të tilla, duke qenë se publiku kishte interes legjitim për t’u informuar për procesin penal. Në këtë kontekst, autoriteteve iu besua një hapësirë posaçërisht e ngushtë vlerësimi, kur bëhej fjalë për kufizimin e lirisë së shprehjes së avokatëve.

Sa i përket natyrës së komenteve të kundërshtuara të kërkuesit lidhur me integritetin profesional dhe moral të Gjyqtarëve M. dhe L.L., Gjykata ishte e mendimit se ato ishin gjykime vlerore e jo deklarata të pastra fakti dhe, si të tilla, nuk kërkonin prova, por, sidoqoftë, duhej të kishin baza të mjaftueshme faktike. Gjykata konstatoi në çështjen aktuale se kjo bazë ekzistonte dhe ishte e mjaftueshme. Së pari, ajo kishte përcaktuar se një objekt i rëndësishëm i provave – videoincizimi i bërë në Xhibuti – nuk ishte dorëzuar me dosjen e çështjes te gjyqtari i ri hetues, i cili kishte hartuar një raport për ta shënuar këtë fakt. Përveç kësaj, Gjyqtari P. kishte bërë një

numër konstatimesh faktike që lidheshin veçanërisht me mungesën e materialeve me vulë dhe praninë e një pusulle me shkrim dore, e cila tregonte një lloj miqësie nga ana e prokurorit publik të Xhibutit me Gjyqtaren M. dhe akuzonte avokatët e palëve se po “orkestronin manipulimin e tyre”. Së fundi, kërkuesi kishte vepruar në cilësinë e tij si avokat në dy çështje të profilit të lartë ku Gjyqtarja M. ishte gjyqtare hetuese, dhe në të dyja ato çështje ishin identifikuar mangësi në procedura, që kishin çuar në heqjen e çështjeve nga Gjyqtarja M., me kërkesë të kërkuesit. Sa u përket komenteve të kërkuesit, ato u konsideruan se ishin të lidhura ngusht me faktet e çështjes dhe nuk mund të shiheshin as si çorientuese, as si të paarsyeshme.

Gjykata theksoi se, në kontekstin e nenit 10, ajo duhej të merrte në konsideratë rrethanat dhe sfondin e përgjithshëm në të cilin ishin bërë deklaratat në fjalë. Në çështjen aktuale, sfondi mund të shpjegohej jo vetëm me sjelljen e gjyqtarëve hetues dhe marrëdhëniet e kërkuesit me një prej tyre, por edhe nga historiku shumë specifik i çështjes, përmasa e saj ndërshtetërore dhe mbulimi i konsiderueshëm nga media. Edhe pse ky kontekst specifik ishte me rëndësi të konsiderueshme, Gjykata e Apelit kishte bërë një vlerësim të zgjeruar për një pjesë të gjuhës së përdorur nga kërkuesi, për të cilën Gjykata nuk ishte dakord, duke qenë se termi “bashkëpunim i heshtur” nuk mund të përbënte në vetvete sulm serioz kundër ndershmërisë dhe emrit të personave të përfshirë.

Sipas Gjykatës, komentet e kërkuesit nuk mund të reduktoheshin thjesht në shprehjen e armiqësisë personale nga ana e tij për Gjyqtaren M., edhe sepse ishin në një kontekst më të gjerë, ku përfshihej edhe një tjetër gjyqtar. Përveç kësaj, edhe pse komentet e kërkuesit kishin konotacion negativ, ato kishin lidhje me mangësitë e pretenduara në një hetim gjyqësor – çështje për të cilën një avokat duhet të jetë në gjendje të tërheqë vëmendjen e publikut.

Sa i përket ruajtjes së autoritetit të gjyqësorit, Gjykata pranoi se komentet e kërkuesit nuk ishin në gjendje të minonin zhvillimin e duhur të procesit gjyqësor. Edhe pse gjyqtarët i nënshtroheshin detyrimit për të qenë të rezervuar, megjithëse mund të ishte e nevojshme që ata të mbroheshin nga sulme mjaft të dëmshme dhe të pabazuara, kjo nuk do të kishte si efekt ndalimin e individëve që të shprehnin pikëpamjet e tyre për çështje me interes publik të lidhura me funksionimin e sistemit të drejtësisë, përmes gjykimeve vlerore me një bazë të mjaftueshme faktike. Më tej, për të njëjtat arsye, nuk mund të konsiderohej se dënimi i kërkuesit mund të shërbente për ruajtjen e autoritetit të gjyqësorit. Sidoqoftë, Gjykata theksoi nevojën për ruajtjen e autoritetit të gjyqësorit dhe për të siguruar marrëdhënie të mbështetura në konsideratën dhe respektin e ndërsjellë midis protagonistëve të ndryshëm të sistemit të drejtësisë.

Sa i përket argumentit të Qeverisë për mundësinë e përdorimit të mjeteve efektive ligjore në dispozicion përpara gjykatave kompetente dhe jo në media për të mbrojtur klientin e tij, Gjykata vërejti se qëllimi fillestar i kërkuarit ishte të zgjidhte çështjen duke përdorur mjetet ligjore në dispozicion. Ai ia referoi çështjen Seksionit të Padive të Gjykatës së Apelit të Parisit, sidoqoftë, vetëm pasi ai mjet efektiv ligjor ishte përdorur, Seksioni i Padive nuk ishte më në pozicion që t'i shqyrtonte këto ankesa pasi ua kishte hequr çështjen tanimë Gjyqtarëve M. dhe L.L. Për më tepër, kërkesa për hetim paraqitur Ministrisë së Drejtësisë nuk mund të kualifikohej si mjet efektiv ligjor por thjesht si kërkesë për një hetim administrativ që ishte subjekt i vendimit që, si kompetencë, i takonte asaj. Më tej, Gjykata vërejti se nuk kishte asnjë procedurë disiplinore kundër kërkuarit për shkak të deklaratave të tij në shtyp.

Sa u përket sanksioneve të vendosura, Gjykata theksoi se, për vlerësimin e proporcionalitetit të ndërhyrjes merren në konsideratë si faktorë edhe natyra edhe masa e penalteteve të vendosura. U theksua se ndëshkimi i kërkuarit nuk ishte kufizuar në një dënim penal: sanksioni i vendosur nuk ishte “më i lehti i mundshëm” por kishte një farë rëndësie, duke pasur parasysh mbështetjen te statusi i tij si avokat për të justifikuar ashpërsinë më të madhe.

Në vijim të atyre që u thanë më sipër, Gjykata konstatoi vendimi kundër kërkuarit për bashkëpunim në shpifje përbënte ndërhyrje joproporcionale tek e drejta e tij për lirinë e shprehjes, që ishte e panevojshme në një shoqëri demokratike, dhe vendosi se kishte pasur shkelje të nenit 10.

#### Neni 41

Gjykata vendosi se Franca duhej t'i paguante kërkuarit 15,000 euro për dëme jomateriale, 4,270 euro për dëme pasurore dhe 14,400 euro për kostot dhe shpenzimet që kishin ardhur si rrjedhojë e çështjes gjyqësore.



*Hetimet e një gjykate ushtarake për rrethanat e një vdekjeje gjatë shërbimit ushtarak qenë mjaftueshëm të pavarura dhe të plota dhe nuk shkelën nenin 2*

## VENDIMI I DHOMËS SË MADHE NË ÇËSHTJEN MUSTAFA TUNÇ DHE FECIRE TUNÇ K. TURQISË

(Kërkesa nr. 24014/05)

14 prill 2015

### 1. Faktet kryesore

Kërkuesit, burrë e grua, ishin të lindur në vitet 1946 dhe 1952, dhe ishin nëna dhe babai i Cihan Tunç, i cili kishte lindur më 20 nëntor 1983 dhe vdiq më 13 shkurt 2004. Gjatë zhvillimit të shërbimit të tij ushtarak duke ruajtur një vendndodhje që i përkiste një kompanie private të naftës, djali i kërkuesve u plagos me armë zjarri. Ai u transportua menjëherë në spital dhe u shpall i vdekur pak pasi arriti aty. Menjëherë pas ngjarjes u informua prokuroria ushtarake dhe nisën hetimet gjyqësore. Pak orë pas ngjarjes, prokurori ushtarak shkoi në spitalin ku ishte dërguar Cihan Tunç i shoqëruar nga një ekip ekspertësh nga policia (xhandarmëria) kombëtare. Ai i kërkoi prokurorit civil të Kocaköy që t'i bashkohej për të mbikqyrur hetimet fillestare. U morën në pyetje ushtari dhe rreshteri që e kishin shoqëruar Cihan Tunç-in për në spital, dhe u zhvillua autopsia. Raporti shkencor doli me përfundimin që Cihan Tunç kishte qenë viktimë e një të shtëne të shkrepur nga afërsia.

Hetimet në vendin e ngjarjes zbuluan se në tokë ndodhej një fishek i harxhuar dhe se ishte përdorur arma e të vdekurit. Në kuadër të hetimeve të zhvilluara nga prokurori ushtarak, u morën në pyetje persona të tjerë në shërbimin ushtarak në lidhje me ditën e ngjarjes. Hetimet administrative dolën me përfundimin që ngjarja kishte qenë aksident. Në qershor 2004, duke u mbështetur mbi arsyetimin që nuk kishte bazë për të gjetur se një person tjetër kishte qenë përgjegjës për vdekjen e rreshterit, prokurori mori vendim për të mos nisur ndjekjen penale. Në tetor 2004, gjykata ushtarake mbështeti një apel të bërë nga kërkuesit, dhe urdhëroi shërbimin prokurorial të zhvillonte hetime të mëtejshme. Këto hetime gjetën se ngjarja nuk mund të kishte qenë vetëvrasje dhe që provat mbështesnin hipotezën e një aksidenti që kishte të bënte me përdorim të pakujdesshëm të armës.

Më 17 dhjetor 2004, e njëjta gjykatë ushtarake rrëzoi apelin e kërkuesve në lidhje me hetimet e mëtejshme të prokurorit të cilat kishin gjetur se ngjarja nuk mund të kishte qenë vetëvrasje. Më 10 janar 2007, Gjykata Administrative Ushtarake Supreme mbështeti pjesërisht një padi të ngritur nga kërkuesit ku kërkohet pagimi

i dëmshtëpërblimit material për vdekjen e djalit të tyre. Ajo theksoi se vdekja ishte shkaktuar nga përdorimi i pakujdesshëm i armës së shërbimit, duke lënë të kuptohej se kishte mungesë në stërvitje të mjaftueshme për përdorimin e armëve dhe neglizhencë në mbikqyrjen dhe mbrojtjen e të rekrutuarve. Kjo gjykatë gjeti se vdekja ishte pjesërisht pasojë e neglizhencës së autoriteteve, dhe u caktoi kërkuesve shuma në lidhje me dëmet jomateriale dhe materiale që kishin pësuar.

## 2. Vendimi i Gjykatës

Duke u mbështetur në nenin 2, kërkuesit pretenduan që hetimet për të konstatuar rrethanat e vdekjes së të afërmit të tyre nuk i kishin përmbushur kriteret e Konventës. Kërkuesit pretenduan se autoritetet kishin dështuar të zhvillonin hetime efektive rreth vdekjes së djalit të tyre dhe që ligjet në fuqi në atë kohë nuk kishin ofruar garancitë e nevojshme të pavarësisë.

Më 25 qershor 2013, një Dhomë e Gjykatës mori një vendim në të cilin deklaroi, me katër vota kundër tri votave, se kishte pasur shkelje të nenit 2 të Konventës në lidhje me pavarësinë e hetimeve. Me kërkesë të Qeverisë sipas nenit 43, çështja iu referua Dhomës së Madhe.

### Neni 2

Së pari, Gjykata theksoi se neni 6, i cili garanton të drejtën për proces të drejtë, gjithashtu parashton kriterin e pavarësisë. Megjithatë, Gjykata deklaroi se neni 6 nuk ishte i zbatueshëm në çështjen në fjalë sepse procedura e nisur nga një person për të kontestuar një vendim për të mos ndjekur penalisht dikë në vetvete nuk synon të përcaktojë “të drejtat dhe detyrimet civile”. Gjykata konsideroi se, ndërkohë që kriteret e procesit të drejtë mund të sjellin shqyrtimin e çështjeve procedurale sipas dispozitave të tjera, siç është neni 2, mbrojtjet e ofruara jo domosdoshmërisht duhet të vlerësohen në të njëjtën mënyrë. Më tej, Gjykata tha se pajtueshmëria me kriterin procedural të nenit 2 vlerësohet mbi bazën e disa parametrave thelbësore: mjaftueshmëria e masave hetimore, shpejtësia e hetimeve, përfshirja e familjes së të vdekurit, dhe pavarësia e hetimeve. Këto elemente janë të ndërlidhura dhe secili prej tyre, i marrë ndaras, nuk përbën qëllim në vetvete, siç është rasti në lidhje me kriterin e pavarësisë në nenin 6. Ato janë kritere të cilat, të marra së bashku, mundësojnë vlerësimin e shkallës së efektivitetit të hetimeve.

Gjykata theksoi se prokuroria ishte informuar menjëherë për ngjarjen dhe që masat e para hetimore ishin marrë në të njëjtën ditë. Më 30 qershor 2004, shërbimi prokurorial i komplettoi hetimet dhe mori vendim për të mos nisur ndjekjen penale.

Më 14 tetor 2004, gjykata ushtarake i pranoi kundërshtimet e kërkuessve dhe urdhëroi hetime të mëtejshme. Shërbimi prokurorial dorëzoi raportin e tij më 8 dhjetor 2004, pasi kishte ndërmarrë masat hetimore shtesë. Më 17 dhjetor 2004, gjykata ushtarake e rrëzoi apelin e kërkuessve. Një kopje e atij vendimi iu dërgua avokatit të kërkuessve pas pak ditësh. Në ato rrethana, Gjykata konsideroi që hetimet në fjalë ishin zhvilluar me zellin e duhur dhe që nuk kishte pasur vonesa të pajustificuara në hetime. Më tej, duke pasur parasysh dosjen e lëndës, Gjykata gjeti që kërkuessve u ishte lejuar qasja në informacionet e nxjerra nga hetimet në masë të mjaftueshme që ata të merrnin pjesë efektivisht në procedura.

Sa i përket pavarësisë së hetimeve, Gjykata përsëriti që mbrojtja procedurale e të drejtës për jetë e ngërthyer në nenin 2 të Konventës nënkupton që hetimet duhet të jenë mjaftueshëm të pavarura. Për më tepër, kur pavarësia statusore ose institucionale linte vend për dyshime, një situatë e tillë kërkonte një këqyrje më të rreptë nga ana e Gjykatës lidhur me faktin nëse hetimet ishin zhvilluar në mënyrë të pavarur. Kur dalin probleme në lidhje me pavarësinë dhe paanshmërinë e hetimeve, Gjykata deklaroi se qasja e saktë është të shqyrtohet nëse dhe deri ku rrethana e kontestuar ka komprometuar efektivitetin e hetimeve dhe mundësinë e saj për të hedhur dritë mbi rrethanat e vdekjes dhe për të dënuar përgjegjësit. Gjykata deklaroi se çështja e pavarësisë duhet të vlerësohet pikërisht në lidhje me këtë qëllim.

Në lidhje me pavarësinë e prokurorisë, Gjykata vuri në dukje se prokurori ushtarak nuk kishte lidhje, hierarkike apo të tjera, qoftë me të dyshuarin kryesor qoftë me policinë e stacionuar në atë vend, apo me policinë qendrore. Së dyti, Gjykata tha se prokurori përgjegjës për hetimet kishte mbledhur të gjitha provat e nevojshme, dhe që nuk kishte arsye që ai të kritikohet për mos-marrjen e një mase të caktuar hetimore. Në lidhje me hetuesit joprokurorialë, Gjykata tha se, megjithëse ata ishin anëtarë të policisë (xhandarmërisë), nuk kishte marrëdhënie hierarkie mes këtyre hetuesve dhe individëve që me gjasë kishin qenë të përfshirë. Për më tepër, ata nuk ishin përgjegjës për drejtimin e hetimeve, kontrolli i përgjithshëm i të cilave mbetej në duart e prokurorit.

Në lidhje me pavarësinë e gjykatës ushtarake, Gjykata vuri në dukje se, duke pasur parasysh rregulloret në fuqi në kohën materiale, kishte faktorë të cilët hidhnin dyshime mbi pavarësinë statusore të gjykatës ushtarake, gjykata e thirrur për të shqyrtuar apelin e kërkuessve kundër vendimit të prokurorisë për të mos nisur ndjekjen penale. Njëri prej tre gjyqtarëve të asaj gjykate ishte zyrtar shërbimi, dhe më tej, ashtu si prokurorët, gjyqtarët ushtarakë në kohën relevante gjithashtu vlerësoheshin nga komandanti i njësisë ushtarake në lidhje me të cilën ata kryenin detyrat e tyre. Megjithatë, ajo theksoi se anëtarët e gjykatës nuk kishin lidhje

hierarkike ose konkrete me policët (xhandarët) e stacionuar në atë vend, dhe as me policinë (xhandarmërinë) në përgjithësi. Gjykata tha se nuk kishte asgjë rreth sjelljes së gjykatës dhe gjyqtarëve të saj që tregonte se këto të fundit ishin të prirur për të mos hedhur dritë mbi rrethanat e vdekjes, për të pranuar pa pyetje përfundimet që iu paraqiteshin, ose për të penguar nisjen e procedurave penale kundër kryesve të mundshëm. Në fakt, gjykata ushtarake fillimisht e kishte lejuar apelin e kërkuar, duke urdhëruar hetime të mëtejshme për të testuar kredibilitetin e hipotezës së aksidentit të parashtruar nga prokuroria.

Në tërësi, Gjykata deklaroi se hetimet kishin qenë mjaftueshëm të pavarura brenda kuptimit të nenit 2. Duke pranuar që palët që kishin luajtur rol në hetime nuk gëzonin pavarësi të plotë statusore, neni 2 nuk kërkonte pavarësi absolute, dhe, për më tepër, pavarësia e hetimeve duhet të vlerësohej mbi bazën e fakteve të çështjes specifike. Gjykata tha se mbetet mungesa e lidhjeve hierarkike, institucionale ose të tjera të anëtarëve të gjykatës me policët e stacionuar në atë vend ose me policinë në përgjithësi. Së dyti, gjatë shqyrtimit të sjelljes specifike të atyre anëtarëve, Gjykata nuk gjeti mungesë pavarësie ose paanshmërie në mënyrën e trajtimit të hetimeve. Në fund, vdekja e të afërmit të kërkuar nuk kishte ndodhur në rrethana të cilat, *a priori*, mund t'i jepnin shkas dyshimeve kundër forcave të sigurisë si institucion, siç ndodh në rastet e vdekjeve të shkaktuara nga përleshjet ku përdoret forca në demonstrata, në operacione policore dhe ushtarake, ose në rastet e vdekjeve të dhunshme gjatë mbajtjes në polici.

Si përfundim, hetimet e zhvilluara në këtë çështje kishin qenë të plota dhe kishin lejuar përfshirjen e kërkuar në masë të mjaftueshme për t'u mundësuar atyre ushtrimin e të drejtave të tyre, dhe kishin qenë mjaftueshëm të pavarura. Rrjedhimisht, nuk kishte pasur shkelje të nenit 2 të Konventës.

*Ankesat e kërkuases sipas neneve 9 dhe 10 se shkarkimi i saj nga gjyqësori ishte i pajustificuar u deklaruan të papranueshme, sepse ajo shkeli detyrat e saj si gjyqtare dhe rrezikoi dukjen e paanshmërisë*

## VENDIMI NË ÇËSHTJEN **PITKEVICH K. RUSISË**

---

(Kërkesa nr. 47936/99)

**8 shkurt 2001**

### **1. Faktet kryesore**

Kërkuësja ishte e lindur në vitin 1946 dhe ishte gjyqtare në Gjykatën e Rrethit të Qytetit Noyabrsk. Gjithashtu, ajo ishte anëtare e Kishës së Besimit të Gjallë, që i përkiste Unionit Rus të Kishave Kristiane Evangjeliste. Në shkurt dhe mars 1997, ajo garoi për kryetare bashkie në Noyabrsk. Kandidati që u zgjodh më pas gjatë fushatës e akuzoi për faktin se ajo bënte pjesë në një sekt. Pas zgjedhjes së tij, ai i dërgoi një letër Kryetarit të Gjykatës së Rrethit të Qytetit Noyabrsk ku kërkonte shkarkimin e kërkuases nga gjyqësori për shkak se ajo ishte “kultiste” (anëtare e një kulturi). Kundër saj nisi procedura disiplinore nga një shoqatë gjyqtarësh para Komisionit të Kualifikimit Gjyqësor.

Komisioni dëgjoi kërkuesen dhe disa dëshmitarë, përfshirë zyrtarë të Këshillit të Qytetit Noyabrsk dhe të Gjykatës së Rrethit të Qytetit, të cilët dëshmuan kundër saj. Ai analizoi thellësisht deklaratat me shkrim të 41 personave, përfshirë shumë persona privatë që u ankuan për mënyrën se si kërkuësja i kishte trajtuar çështjet e tyre, megjithatë sipas kërkuases asaj iu refuzua kërkesa për të ftuar shumë dëshmitarë të saj. Komisioni i Kualifikimit Gjyqësor e shkarkoi kërkuesen nga posti dhe ia hoqi “gradën e kualifikimit të tretë” të gjyqtarës mbi bazën se ajo kishte “dëmtuar reputacionin e saj si gjyqtare” dhe kishte abuzuar postin e saj për konvertim. Komisioni vendosi që ajo kishte keqpërdorur postin e saj për të “vijuar aktivitetet fetare në interes të Kishës”, inter alia, duke rekrutuar si pjesëtarë të Kishës shumë zyrtarë të Gjykatës së Rrethit të Qytetit Noyabrsk.

Kërkuësja apeloj pa sukses pranë Komisionit Suprem të Kualifikimit Gjyqësor të Federatës Ruse, ku ajo pretendoi se përfaqësuesi i saj nuk ishte lejuar të merrte pjesë në seancë. Më pas, kërkuësja apeloj në Gjykatën Supreme, e cila vendosi se kërkuësja ishte përfshirë në propagandën e Kishës dhe në frikësimin fetar të palëve në procedurat që ajo kishte shqyrtuar, dhe se kjo kishte shkaktuar dyshime rreth paanshmërisë dhe pavarësisë së gjykatës. Kërkuësja pretendoi se ajo nuk kishte

pasur mundësi të merrte pjesë në seancën e Gjykatës Supreme sepse data kishte ndryshuar dhe ajo nuk ishte informuar.

## 2. Vendimi i Gjykatës

Duke u mbështetur në nenin 6 § 1, kërkuësja pretendoi se procedura për vendosjen e shkarkimit të saj ishte “civile”, dhe se ajo procedurë kishte shkelur parimin e drejtësisë. Sipas neneve 9, 10 dhe 14, ajo u ankua që shkarkimi i saj nga gjyqësori përbënte ndërhyrje të pajustificuar dhe diskriminuese tek ushtrimi i të drejtës së saj për lirinë e besimit fetar dhe lirinë e shprehjes. Sipas nenit 1 të Protokollit 1, kërkuësja argumentoi se shkarkimi i saj nga posti dhe heqja e “gradës së kualifikimit të tretë” kishin ndërhyrje në mënyrë të padrejtë tek të drejtat e saj pronësore.

### Neni 6

Sa i përket zbatueshmërisë së nenit 6 § 1 në procedurat në fjalë, Gjykata deklaroi se mosmarrëveshjet e punësimit mes autoriteteve dhe shërbyesve publikë detyrat e të cilëve zakonisht ishin aktivitete të shërbimit publik, për sa kohë që ky i fundit vepronte si bartësi i autoritetit publik përgjegjës për mbrojtjen e interesave të përgjithshme të Shtetit, nuk ishin “civile” dhe ishin të përjashtuara nga fushëveprimi i nenit 6 § 1. Shembulli i dukshëm i aktiviteteve të tilla ishin forcat e armatosura dhe policia, dhe gjyqësori, sadoqë nuk është pjesë e shërbimit civil të zakonshëm, është pjesë e shërbimit civil tipik. Një gjyqtar merr pjesë drejtpërdrejt në ushtrimin e fuqive të dhëna nga e drejta publike dhe kryen detyra që synojnë mbrojtjen e interesave të përgjithshme të Shtetit. Rrjedhimisht, mosmarrëveshja mes shkarkimit të kërkuësës nga gjyqësori nuk kishte të bënte me të drejtat ose detyrimet e saj “civile” brenda kuptimit të nenit 6, dhe kjo pjesë e kërkesës u deklarua e papranueshme sipas nenit 35 § 3.<sup>[411]</sup>

### Nenet 9 dhe 10

Gjykata vuri në dukje se kërkuësja ishte shkarkuar për aktivitetet e saj të veçanta gjatë kryerjes së funksioneve gjyqësore, ku ajo kishte shprehur pikëpamjet e saj fetare. Në këtë aspekt kishte pasur ndërhyrje tek liria e besimit fetar dhe liria e shprehjes së kërkuësës sipas neneve 9 dhe 10 të Konventës. Gjykata së pari mori në shqyrtim sipas nenit 10 nëse kjo ndërhyrje ishte e justifikuar.

411 Shih çështjen *Baka k. Hungarisë*, vendimi i Dhomës së Madhe i 23 qershorit 2016, nr. 20261/12, (i përfshirë si përmbledhje në këtë publikim), për mënyrën se si është zhvilluar interpretimi i nenit 6 në lidhje me procedurat në mosmarrëveshjet e punësimit për gjyqtarët prej kohës së vendimit në fjalë.

Gjykata e gjeti se masa ishte e parashikuar me ligj dhe synonte qëllimet legjitime të mbrojtjes së të drejtave të tjerëve dhe ruajtjen e autoritetit të gjyqësorit. Sa i përket faktit nëse ajo ishte e nevojshme në një shoqëri demokratike, kur shprehet në lidhje me moralitetin e një pale gjyqtarja mund të krijojë përshtypjen se është e njëanshme, në qoftë se një opinion i tillë nuk është i nevojshëm për të vendosur në një çështje. Në lidhje me proporcionalitetin e ndërhyrjes në këtë rast, çështja e kërkuësës u shqyrtua në prani të saj në të dy rastet, përfshirë para komisionit disiplinor suprem me 23 gjyqtarë. Përfundimet e komisionit u konfirmuan më pas nga Gjykata Supreme. Nuk kishte asgjë në dosjen e lëndës që sugjeronte se autoritetet u mungoi kompetenca ose mirëbesimi në konstatimin e fakteve. Mbi bazën e dëshmimeve dhe ankesave të shumta nga zyrtarë shtetërorë dhe persona privatë, u konstatua se kërkuësja, *inter alia*, kishte rekrutuar kolegë të së njëjtës bindje fetare, ishte lutur haptazi gjatë seancave dëgjimore, dhe u kishte premtuar palëve të caktuara në procedura rezultate të favorshme për çështjet e tyre nëse do t'i bashkoheshin komunitetit të saj fetar; për më tepër, ato aktivitete kishin shkaktuar vonesa në procedimin e çështjeve dhe një numër padish kundër saj.

Gjykata deklaroi se një sjellje e tillë ishte e papajtueshme me kushtet e detyrës së gjyqësisë dhe shtynte drejt shkarkimit të saj. Bazat për shkarkimin e saj ishin ekskluzivisht të lidhura me aktivitetet e saj zyrtare dhe jo me shprehjen e pikëpamjeve të saj në ambiente private. Për më tepër, asaj nuk iu ndalua garimi si kandidate në zgjedhjet lokale dhe shprehja e opinionit të saj politik. Fakti që kryebashkiaku dhe disa zyrtarë lokalë e kritikuan punën e saj në gjyqësor gjatë procedurave disiplinore nuk rezultoi me ndërhyrje tek liria e saj për të shprehur pikëpamjet e saj politike. Në tërësi, dukej qartë se kërkuësja kishte shkelur detyrimet e saj statutores si gjyqtare dhe kishte rrezikuar dukjen e paanshmërisë që çdo gjyqtar/e duhet ta paraqesë para publikut. Kështu, duke lejuar një hapësirë të caktuar vlerësimi në këtë aspekt, Gjykata gjeti që arsyet e dhëna nga autoritetet ishin të mjaftueshme për ta justifikuar ndërhyrjen.

Për pasojë, shkarkimi i kërkuësës nga posti i saj si gjyqtare ishte proporcional me qëllimet legjitime të synuara. Rrjedhimisht, kjo pjesë e kërkesës ishte dukshëm e pabazuar brenda kuptimit të nenit 35 § 3 të Konventës, dhe u deklarua e papranueshme. Gjykata gjithashtu gjeti për arsye të ngjashme se ankesa sipas nenit 9 ishte dukshëm e pabazuar brenda kuptimit të nenit 35 § 3.

#### Neni 14

Gjykata përsëriti se kërkuësja nuk ishte shkarkuar mbi bazën e faktit që ajo ishte pjesëtare e një Kise ose që kishte ndonjë “status” tjetër, por për shkak të

aktiviteteve të saj që ishin në papajtueshmëri me kushtet e postit të saj gjyqësor. Prandaj kjo ankesë gjithashtu ishte dukshëm e pabazuar brenda kuptimit të nenit 35 § 3 të Konventës.

#### Neni 1 i Protokollit 1

Gjykata vuri në dukje se shkarkimi i kërkueses dhe heqja e “gradës kualifikuese” të saj mund të kishin përfshirë pasoja materiale dhe jomateriale, si dhe ndërhyrje tek të drejtat e saj pronësore në këtë aspekt. Megjithatë, Gjykata kujtoi gjetjen e saj që shkarkimi në fjalë ishte në pajtueshmëri me të drejtat e kërkueses sipas neneve 9, 10 dhe 14. Ajo nuk gjeti tregues të shkeljes së nenit 1 të Protokollit 1, dhe vendosi që ky aspekt ishte dukshëm i pabazuar brenda kuptimit të nenit 35 § 3, e rrjedhimisht u refuzua.



## (11) Përmbledhje të Gjykatës së Drejtësisë së Bashkimit Evropian

### *Hyrje në Gjykatën e Drejtësisë së Bashkimit Evropian*

Para Traktatit të Lisbonës, Gjykatat e Komunitetit përbëheshin nga Gjykata e Drejtësisë (GJED), Gjykata e Shkallës së Parë (GjShP) dhe panelet gjyqësore. Traktati i Lisbonës e ndryshoi këtë. Termi ‘Gjykata e Drejtësisë e Bashkimit Evropian’ tani përfshin GJED-në, Gjykatën e Përgjithshme (pasuese e GjShP-së) dhe gjykatat e specializuara (më përpara, panelet gjyqësore). Të tre institucionet gjyqësore të Gjykatës së Drejtësisë së Bashkimit Evropian (GjDBE) marrin vendime në lidhje me çështjet që ngrihen para saj.

Pesë llojet më të zakonshme të çështjeve janë: kërkesa për vendimmarrje paraprake, padi për dështimin e përmbushjes së një detyrimi (që ngrihen kundër qeverive të BE-së për mos-zbatimin e të drejtës së BE-së), padi për anulim (që ngrihen kur mendohet se ligjet e BE-së shkelin traktatet e BE-së për të drejtat themelore), padi për mos-veprim (që ngrihen kundër institucioneve të BE-së kur nuk marrin vendimet e kërkuara), dhe padi të drejtpërdrejta.

Përmbledhja në vijim e çështjeve të GjDBE-së jep shembuj të marrë nga procedura e vendimmarrjes paraprake, dhe nga paditë për dështimin e përmbushjes së një detyrimi.

#### GjDBE dhe GjEDNj

GjDBE dhe GjEDNj janë sisteme gjyqësore të pavarura: autoriteti i GjDBE-së rrjedh nga sistemi ligjor i Bashkimit Evropian dhe ajo merr vendime në lidhje me zbatimin dhe interpretimin e të drejtës së BE-së, ndërsa autoriteti i GjEDNj-së rrjedh nga sistemi ligjor i Këshillit të Evropës, dhe ajo merr vendime në lidhje me zbatimin dhe interpretimin e KEDNj-së. Megjithatë, siç shpjegohet me hollësi në sesionet 1 dhe 2 të pjesës narrative të këtij udhërrëfyesi, të dy sistemet e gjykatave informalisht iu përbahen vlerave dhe parimeve të njëjta, dhe në disa rrethana ato formalisht mbështeten në arsyetimet dhe interpretimet e njëra-tjetrës në lidhje me disa të drejta të caktuara themelore të përbashkëta. Prandaj, për të kuptuar në tërësi parimet e pavarësisë dhe paanshmërisë në kontekstin e jurisprudencës së GjEDNj-së, është po ashtu e nevojshme të kuptohet se si i qaset GjDBE-ja të njëjtave parime në jurisprudencën e vet.

Çështjet e paraqitura më poshtë ofrojnë shembuj të rasteve ku GjDBE formalisht ka integruar jurisprudencën e GjEDNj-së në një pjesë të parimeve të përgjithshme të

së drejtës së BE-së.<sup>[412]</sup> Dhoma e Madhe e GjEDNJ-së qartazi është mbështetur në disa aspekte të këtyre çështjeve në vendimet e saj.<sup>[413]</sup>

### Procedura e Vendimmarrjes Paraprake

Gjykatat nacionale në secilin prej Shteteve Anëtare të BE-së janë përgjegjëse për garantimin e zbatimit të duhur të së drejtës së BE-së në atë Shtet. Për të shmangur rrezikun që gjykatat në Shtete të ndryshme ta interpretojnë drejtën e BE-së në mënyra të ndryshme, sipas Nenit 267 të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Evropian (TFBE) ‘procedura e vendimmarrjes paraprake’ i mundëson gjykatës nacionale të pyesë rreth interpretimit ose vlefshmërisë së një ligji të BE-së në qoftë se kryetari i trupit gjykues në atë gjykatë konsideron që ka dyshime rreth pikës së ligjit të BE-së. Të gjitha gjykatat e cilëso shkallë që zbatojnë të drejtën e BE-së kanë të drejtë të bëjnë referenca në adresë të GjDBE-së, dhe rregullat nacionale nuk mund t’ua ndalojnë një gjë të tillë. Megjithatë, ato nuk janë të detyruara të veprojnë kështu. Referencat mund të bëhen vetëm nga gjykatat më të larta, kundër vendimeve të të cilave nuk bëhet apel në vend. Referencat në këtë mënyrë mund të bëhen vetëm prej gjykatave. Palët mund t’i kërkojnë gjykatës që trajton çështjen e tyre që të bëjë referencë, por vendimi për ta bërë këtë është vetëm në dorë të gjykatës.

Përgjigjja nga GjDBE-ja merr formën e një vendimi ose urdhri të arsyetuar. Normalisht kësaj i paraprin një “Opinion” nga Avokati i Përgjithshëm i caktuar në çështje. Opinioni zakonisht përmban një analizë më të hollësishme të së drejtës së BE-së sesa vendimi i përmbledhur. GjDBE-ja nuk merr vendime mbi meritat e çështjes, që është detyrë e gjykatave nacionale, por gjykata që e kërkon vendimin është e lidhur pas interpretimit që i është dhënë nga GjDBE-ja të cilin ajo duhet t’ua zbatojë fakteve të çështjes, përfshirë identifikimin e fakteve që GjDBE-ja thotë se duhen konstatuar për zbatimin e saktë të së drejtës së BE-së. Interpretimi i GjDBE-së gjithashtu është detyrues edhe për gjykatat e tjera nacionale në Shtetet Anëtare të BE-së në çështje të tjera të krahasueshme.

### Padi për dështimin në përmbushjen e një detyrimi

Gjykatat nacionale në secilin prej Shteteve Anëtare të BE-së kanë përgjegjësinë për të siguruar që e drejta e BE-së të zbatohet si duhet në juridiksionet e tyre

412 Vendimi në A.K. k. *Krajowa Rada Sądowicta dhe CP dhe DO k. Sąd Najwyższy* (Çështjet Nr. C-585/18, C-624/18 dhe C-625/18) 19 nëntor 2019.

413 Për shembull: *Guðmundur Andri Ástráðsson k. Islandës*, vendimi i Dhomës së Madhe i 1 dhjetorit 2020, Nr. 26374/18, § 239 (i përfshirë si përmbledhje në këtë publikim).

përkatëse. Megjithatë, Neni 17(1) i Traktatit për Bashkimin Evropian (TBE) po ashtu i beson Komisionit Evropian (prej këtu e tutje ‘Komisioni’), si “rojtari i traktateve”, detyrën e sigurimit dhe mbikqyrjes së të drejtës së BE-së në Shtetet Anëtare. Neni 258 i Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Evropian (TFBE) i jep Komisionit fuqi të gjera për të nisur procedura për shkelje kundër Shteteve Anëtare kur konsideron se këto të fundit kanë shkelur detyrimet e tyre të BE-së, edhe pse kjo fuqi ushtrohet rrallë.

*Masat e përkohshme gjatë një padie për dështim në përmbushjen e një detyrimi*

Meqenëse një padi për dështim në përmbushjen e një detyrimi mund të marrë vite deri sa të përfundojë, Komisioni, në përputhje me Nenin 279 të TFBE-së, mund të kërkojë që GjDBE-ja të urdhërojë masa të përkohshme për të parandaluar shkaktimin e dëmeve të pakthyeshme nga Shteti Anëtar i BE-së gjatë periudhës para vendimit përfundimtar. GjDBE urdhëron masa të përkohshme vetëm në raste jashtëzakonisht urgjente dhe të rënda.

### **Pavarësia dhe paanshmëria e gjyqësorit në Poloni**

Pesë çështjet e para këtu poshtë i referohen një mosmarrëveshjeje të vazhdueshme mbi pavarësinë e gjyqësorit polak. Në vitin 2017 qeveria polake mori disa masa për riorganizimin e sistemit gjyqësor polak, të cilat Komisioni i BE-së gjykoi se komprometonin pavarësinë dhe paanshmërinë e gjykatave polake. Këto çështje kishin të bënin, *inter alia*, me:

1. Rëndësinë e parimit të pavarësisë dhe paanshmërisë për shtetin e së drejtës.
2. Rëndësinë e parimit të mos-shkarkimit për pavarësinë dhe paanshmërinë e gjyqësorit.
3. Mënyrën se si regjimi disiplinor i sistemit ligjor mund të ndikojë tek pavarësia dhe paanshmëria e këtij të fundit.
4. Mënyrën se si pavarësia dhe paanshmëria ndikojnë në ekzekutimin e udhërrësteve evropiane.

Këto çështje janë renditur poshtë sipas datave me qëllim që të theksohet progresioni dhe shtrirja e mosmarrëveshjes mes Polonisë dhe Komisionit të BE-së.

*Nëse një Shtet Anëtar i BE-së konsideron se ekziston rreziku real që një individ që i nënshtrohet urdhërarrestit evropian do të përballëj me gjyq të padrejtë në duart e gjyqësorit që e ka lëshuar urdhrin, atëherë urdhri nuk duhet të ekzekutohet*

## **VENDIMI I GJYKATËS SË DREJTËSISË SË BASHKIMIT EVROPIAN NË ÇËSHTJEN LM**

(Çështja Nr. C-216/18)

**25 korrik 2018**

Në këtë çështje, Gjykata e Apelit në Bruksel, Belgjikë, bëri kërkesë për vendimmarrje paraprake në adresë të GjDBE-së sipas Nenit 267 të TFBE-së. Shih hyrjen e këtij seksioni, lart, për një shpjegim më të hollësishëm të këtij procesi.

### **1. Faktet kryesore**

Në vitin 2012, gjykatat polake lëshuan tre urdhërarreste evropiane (UAE) të ndara për kapjen e Z. LM, në mënyrë që ai të ndiqej penalisht për trafik droge. Në maj 2017, LM u arrestua në vijim të atyre UAE-ve në Irlandë. Në seancën dëgjimore para Gjykatës së Lartë, LM refuzoi të jepte pëlqimin për dorëzimin e tij tek autoritetet polake, duke thënë se kjo do ta ekspozonte atë ndaj rrezikut real të pësimit të një shkeljeje të nenit 6 (e drejta për proces të drejtë) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ). Në mënyrë të veçantë, LM argumentoi që reformat e fundit legjislativë në Poloni do t'i mohonin atij të drejtën për proces të drejtë, dhe ato minonin sistemin e besimit reciprok mes vendeve të BE-së mbi të cilin bazohet autoriteti i UAE-së.

Këto reforma legjislativë ishin marrë në shqyrtim nga Komisioni Evropian (Komisioni) në një 'propozim të arsyetuar' në dhjetor 2017, i cili gjeti që në Poloni nuk kishte shqyrtim kushtetues të pavarur dhe legjitim, dhe që reformat e propozuara përbënin kërcënim për pavarësinë e gjykatave të rregullta. Propozimi ftonte Këshillin e Evropës të arrinte në përfundimin që në Poloni ekzistonin rreziqe të qarta për shkelje të rënda të vlerave të parashtruara në Nenin 2 të Traktatit për Bashkimin Evropian (TBE): respekti për dinjitetin njerëzor, liria, demokracia, barazia, shteti i së drejtës dhe respekti për të drejtat e njeriut, përfshirë të drejtat e personave që u përkasin pakicave.

Gjykata e Lartë e Irlandës, po ashtu në mënyrë të pavarur, vendosi që pavarësia e gjyqësorit nga ekzekutivi në Poloni ishte minuar rëndë nga ndërhyrjet politike dhe që Shteti nuk operonte më në kushtet e shtetit të së drejtës. Gjykata e Lartë vendosi që ekzekutimi i UAE-së do ta vinte LM para rrezikut të shkeljes së nenit 6, kështu

që dorëzimi i tij duhet të refuzohej. Në vendimmarrjen e saj gjykata irlandeze iu referua çështjes së GjDBE-së të vitit 2016, *Aranyosi dhe Căldăraru*, në të cilën GjDBE-ja konstatoi që një Shtet Anëtar (SHA) i BE-së mund të refuzonte dorëzimin e subjektit të një urdhërarresti evropian (UAE) kur ekzistonte rreziku që individi do të pësonte shkelje të nenit 3 si pasojë e problemeve të përgjithshme ose sistemike në Shtetin Anëtar që kishte lëshuar urdhrin. Në këtë rast gjykata irlandeze ishte e pasigurt nëse duhet të vlerësonte rreziqet specifike që i kanoseshin LM-së në Poloni pas gjetjes së shkeljeve sistemike në shtetin e së drejtës. Vërtet, duke pasur parasysh këto shkelje sistemike, gjykata irlandeze ngriti pyetjen nëse mund të jepeshin ndonjëherë garanci objektive dhe konkrete në lidhje me drejtësinë e gjyqit të LM-së nga autoritetet polake.

Gjykata irlandeze referoi dy pyetje në adresë të GjDBE-së për vendimmarrje paraprake. Pyetja e parë ishte nëse gjykata irlandeze duhet vlerësonte më tej, në mënyrë të hollësishme dhe të saktë, ekspozimin e LM-së ndaj rrezikut të procesit të padrejtë, duke pasur parasysh se gjykata irlandeze tashmë kishte arritur në përfundimin që sistemi polak i drejtësisë nuk operonte më në kushtet e shtetit të së drejtës. Pyetja e dytë ishte se, po qe se gjykata irlandeze duhet ta vlerësonte rrezikun që LM do të pësonte mohim të drejtësisë, a duhej që gjykata irlandeze të kërkonte informacione nga Polonia të cilat mund ta përmbysnin përfundimin e saj të mëparshëm që LM përballej me rrezikun e shkeljes së nenit 6, dhe si do të dukeshin në praktikë informacione të tilla.

## 2. Vendimi i GjDBE-së

GjDBE-ja i bashkoi të dy pyetjet, dhe deklaroi që themelet e të drejtës së BE-së qëndrojnë në ekzistencën e vlerave të përbashkëta të renditura në Nenin 2 të TBE-së. Këto vlera të përbashkëta krijojnë besim reciprok mes Shteteve Anëtare, duke lejuar zbatimin e përbashkët të së drejtës së BE-së. Ky besim nënkupton që Shtetet Anëtare, me përjashtim të rasteve të jashtëzakonshme, nuk mund të kontrollojnë nëse Shtetet e tjera Anëtare i respektojnë të drejtat themelore në raste të veçanta. Sistemi i urdhërarrestit evropian (UAE) mbështetet mbi parimin e besimit reciprok, kështu që UAE mund të refuzohej vetëm mbi baza të caktuara, të interpretuara në mënyrë strikte, të cilat renditen në Vendimin Kornizë 2002/584. Megjithatë, në *Aranyosi dhe Căldăraru*, GjDBE-ja kishte njohur faktin që mund të vihen kufizime në parimet e njohjes dhe besimit reciprok mes Shteteve Anëtare në 'rrethana të pazakonta'. Në mënyrë të veçantë, kur individi për të cilin lëshohet UAE ishte në rrezik të pësimit të trajtimit çnjerëzor ose poshtërues. Ky vendim u bazua mbi parimin e shënuar në Vendimin Kornizë 2002/584, ku thuhej se UAE nuk mund të përdoret në mënyrë të atillë që modifikon të drejtat themelore si dhe vlerat e parimet ligjore të Nenit 2 të TBE-së.

Më tej, GjDBE-ja deklaroi që pavarësia gjyqësore ishte thelbësore për mbrojtjen e të drejtës për proces të drejtë. Sipas të drejtës së BE-së, u takon gjykatave nacionale dhe GjDBE-së të sigurojnë që Shtetet Anëtare të zbatojnë ligjet e BE-së dhe të mbrojnë individët në përputhje me ligjin. Për ta realizuar këtë në mënyrë efektive, autoritetet nacionale duhet të sigurohen që gjykatat e tyre të përmbushin standardet bazë, ku një prej atyre standardeve është pavarësia gjyqësore. Sipas Vendimit Kornizë 2002/584, sistemi i UAE-së duhet të kishte të njëjtat garanci si çdo proces tjetër gjyqësor, ku gjykatat që lëshonin UAE duhet të ishin të pavarura dhe të paanshme. Prej kësaj rezultonte që sistemi i UAE-së do të shembej në qoftë se ekzistonte rreziku që individët mund të pësonin shkelje të të drejtës së tyre për gjykatë të pavarur e rrjedhimisht të drejtën e tyre për proces të drejtë.

GjDBE-ja theksoi se kishte aspekte të ndryshme të pavarësisë gjyqësore. Gjykatat duhet të operojnë pa presione dhe ndërhyrje të jashtme, dhe duhet të marrin vendime objektive duke mos marrë në konsideratë asgjë tjetër përveç zbatimit të shtetit të së drejtës. Gjithashtu, gjykatat duhet të qeverisen nga rregulla të caktuara për të hequr çdo dyshim rreth pavarësisë dhe paanshmërisë së tyre, ashtu si organet dhe institucionet që kanë për detyrë mbikqyrjen e gjykatave dhe gjyqësorit. Në qoftë se mangësitë sistemike ose të përgjithshme në gjyqësorin e një autoriteti lëshues linin të kuptohej se ekzistonte rrezik real që individit të pësonte shkelje të të drejtave të tij/saj, atëherë autoriteti gjyqësor ekzekutues duhet të vlerësonte nëse individit në fjalë përballëj me atë rrezik.

Në rastin konkret, meqenëse LM argumentoi që në Poloni kishte mangësi sistemike të cilat me gjasë ndikonin tek pavarësia e gjyqësorit në atë vend, autoriteteve ekzekutuese irlandeze iu kërkua të vlerësonin nëse ekzistonte rreziku real që LM si individ do të pësonte shkelje të të drejtave të tij. GjDBE-ja theksoi se ky vlerësim i dytë specifik ishte i nevojshëm edhe kur Shteti Anëtar që kishte lëshuar urdhrin ishte objekt i një propozimi të arsyetuar, të miratuar nga Komisioni, i cili përcaktonte se ekzistonte rreziku i qartë i një shkeljeje të rëndë të vlerave të cekura në Nenin 2 të TBE-së në atë Shtet si pasojë e dëmtimit të pavarësisë së gjykatave nacionale, dhe kur autoriteti gjyqësor ekzekutues kishte materiale që tregonin se kishte mangësi sistemike në lidhje me vlerat e Nenit 2 të TBE-së në nivel të gjyqësorit të Shtetit Anëtar lëshues. Sipas Vendimit Kornizë 2002/584, zbatimi i urdhërarrestit evropian (UAE) mund të pezullohej vetëm në rast shkeljeje të rëndë e të vazhdueshme të parimeve të Nenit 2 TBE, dhe një UAE mund të refuzohej automatikisht vetëm pas miratimit nga Këshilli i Evropës i një vendimi që konstatonte se kishte shkelje të rënda dhe të vazhdueshme të parimeve të cekura në Nenin 2 TBE.

Vlerësimi i rreziqeve ndaj individit që ishte objekt i UAE-së, në mënyrë të veçantë, duhet të përfshinte shqyrtimin e impaktit që do të kishin mangësitë sistemike ose

të përgjithshme të gjyqësorit të Shtetit Anëtar lëshues mbi procedurat gjyqësore në fjalë. Më tej, vlerësimi duhet të konsideronte nëse kishte baza substanciale për të besuar se subjekti i UAE-së do të përballëj me rrezikun real të shkeljes së të drejtës për proces të drejtë, duke pasur parasysh situatën personale të personit, natyrën e veprës për të cilën personi ndiqej, dhe bazën faktike për lëshimin e UAE-së. Si pjesë e vlerësimit autoriteti gjyqësor ekzekutues duhet të kërkonte çdo informacion shtesë që konsideronte të nevojshëm nga autoriteti gjyqësor lëshues. Megjithatë, në qoftë se pas kësaj kërkesë autoriteti gjyqësor ekzekutues ende besonte se ekzistonte rreziku real që individit në fjalë do të pësonte shkelje të së drejtës themelore për gjyq të drejtë, autoriteti ekzekutues duhet të përmbahej nga ekzekutimi i UAE-së.

Në përgjigjen e saj përfundimtare ndaj pyetjeve të Gjykatës irlandeze, GJDBE-ja deklaroi që autoriteti gjyqësor të cilit i kërkohet të ekzekutojë një UAE, por i cili kishte materiale që tregonin se kishte mangësi sistemike ose të përgjithshme në gjyqësorin e Shtetit Anëtar lëshues, duhet të hetonte rrezikun që individit i cili ishte objekt i urdhërarrestit do të pësonte shkelje të së drejtës së tij për proces të drejtë nëse UAE do të ekzekutohej. Autoriteti gjyqësor ekzekutues do të duhej të përcaktonte, në mënyrë të hollësishme dhe të saktë, në kontekstin e situatës personale të individit, natyrës së veprës për të cilën po ndiqet ai, dhe kontekstit faktik që formon bazën e UAE-së, dhe nëse ka baza substanciale për të besuar se individit përballëj me rrezikun real të shkeljes së të drejtës së tij për proces të drejtë po qe se ekzekutohet UAE. Në qoftë se konstatohet rreziku real, atëherë autoriteti ekzekutues do të duhej të refuzonte efektivizimin e UAE-së për të parandaluar që individit në fjalë të pësonte shkelje të nenit 6.

*Ligjet që rregullojnë moshën e pensionimit të gjyqtarëve të Gjykatës Supreme të Polonisë dhe fuqinë e diskrecionit të Presidentit të Polonisë mbi vazhdimësinë e mandatit të tyre u vendos se shkelnin parimin e pavarësisë dhe paanshmërisë gjyqësore*

## **VENDIMI I GJYKATËS SË DREJTËSISË SË BASHKIMIT EVROPIAN NË ÇËSHTJEN KOMISIONI EVROPIAN K. REPUBLIKËS SË POLONISË**

---

(Çështja Nr. C-619/18)

**24 qershor 2019**

Në këtë çështje Komisioni ngriti padi në GjDBE kundër Republikës së Polonisë për dështimin e përmbushjes së një detyrimi. Shih hyrjen e këtij seksioni, lart, për një shpjegim më të hollësishëm të këtij procesi.

### **1. Faktet kryesore**

Më 20 dhjetor 2017, Presidenti i Republikës së Polonisë firmosi ‘Ligjin e Ri për Gjykatën Supreme’ të 8 dhjetorit 2017. Ky Ligj i Ri për Gjykatën Supreme (Ligji i Ri) hyri në fuqi më 3 prill 2018. Sipas Nenit 37, Ligji i Ri zbriste moshën e pensionimit për gjyqtarët e Gjykatës Supreme prej 70 vjeç në 65 vjeç, dhe kushtëzonte vazhdimin e mandatit përtej moshës së pensionit me autorizimin nga Presidenti i Polonisë (Presidenti). Gjithashtu, Neni 39 i atij Ligji thoshte shprehimisht që Presidenti i Republikës do të ‘përcaktonte datën kur një gjyqtar i Gjykatës Supreme pensionohet ose del në pension’. Neni 111 i Ligjit të Ri, më tej, specifikonte se çdo gjyqtar i Gjykatës Supreme që e kishte arritur moshën 65-vjeçare në datën e hyrjes në fuqi të Ligjit të Ri automatikisht do të pensionohej brenda tre muajsh nëse Presidenti nuk i jepte autorizim për ta vazhduar detyrën. Qeveria polake gjithashtu miratoi Amendamentin e Ligjit të 10 marsit 2018, Neni 5 i të cilit i jepte Presidentit fuqi të mëtejshme për të lejuar ose refuzuar vazhdimin e punës së gjyqtarëve të Gjykatës Supreme pas moshës 65-vjeçare.

Si reagim pas miratimit të Ligjit të Ri, dhe pasi Polonia e mohoi që Ligji i Ri shkelte dispozitat ligjore të BE-së, Komisioni vendosi të ngrinte padi në GjDBE. Në padinë kryesore Komisioni ngriti dy ankesa. E para ishte që, me futjen e Ligjit të Ri, Republika e Polonisë kishte dështuar të vepronte në përputhje me detyrimet e saj nga Neni 19(1) i TBE-së (detyrimi i Shteteve Anëtare për të ofruar zgjidhje efektive për të siguruar mbrojtjen ligjore efektive të së drejtës së BE-së, dhe përgjegjësinë e GjDBE-së për të siguruar që ligji të respektohet gjatë interpretimit dhe zbatimit të Traktateve të BE-së) dhe Nenit 47 (e drejta për zgjidhje efektive dhe proces të drejtë) të Kartës së BE-së për të Drejtat Themelore (Karta). Në mënyrë të veçantë, Ligji i Ri shkelte parimin e



pavarësisë gjyqësore, posaçërisht parimin e mos-shkarkimit të gjyqtarëve. Ankesa e dytë ishte që Shteti Anëtar gjithashtu kishte shkelur po ato detyrime duke i dhënë Presidentit polak diskrecionin për të vazhduar mandatin e gjyqtarëve të Gjykatës Supreme pasi ta kishin plotësuar moshën e pensionimit të sapomiruar.

## 2. Vendimi i GjDBE-së

GjDBE-ja fillimisht komentoi që, për të qenë në pajtueshmëri me Nenin 19(1) të TBE-së, Shtetet Anëtare duhet të vendosnin një sistem ligjor që ofronte zgjidhje efektive për të siguruar mbrojtje gjyqësore efektive për individët. Në këtë rast, Neni 19(1) kërkonte që Polonia të ofronte zgjidhje që mjaftonin për të siguruar mbrojtje ligjore efektive, veçanërisht brenda kuptimit të Nenit 47 të Kartës, në fushat e mbuluara nga e drejta e BE-së. Në mënyrë të veçantë, çdo Shteti Anëtar i kërkohet nga Neni 19(1) të sigurojë që gjykatat dhe tribunalet e veta të përmbushin standardet e mbrojtjes gjyqësore efektive në fushat e së drejtës së BE-së. Prandaj, meqenëse Gjykatës Supreme të Polonisë mund t'i bëhej thirrje për të marrë vendim mbi çështjet e lidhura me zbatimin ose interpretimin e të drejtës së BE-së, ishte kërkesë e Nenit 19(1) që të plotësoheshin kriteret e mbrojtjes gjyqësore efektive. GjDBE-ja konsideroi që, për të ofruar mbrojtje gjyqësore efektive, Gjykata Supreme duhet të ishte e pavarur, sepse pavarësia ishte e ngërthyer në thelbin e mbrojtjes gjyqësore efektive. Kështu, Ligji i Ri mund të analizohet nën dritën e Nenit 19(1), dhe për këtë arsye ishte e nevojshme të shqyrtohej nëse ai Nen ishte shkelur.

### Ankesa e parë

GjDBE-ja më tej iu adresua ankesës së parë të Komisionit, në lidhje me faktin që mosha e reduktuar e pensionimit në Ligjin e Ri do të zbatohet ndaj gjyqtarëve që tashmë ishin të emëruar në gjykatë dhe kështu do të shkelte parimin e pavarësisë gjyqësore, veçanërisht parimin e mos-shkarkimit të gjyqtarëve. GjDBE-ja theksoi se kriteri që gjykatat të ishin të pavarura kishte dy aspekte. I pari ishte që gjykatat duhet të funksiononin në mënyrë autonome, pa iu nënshtruar pengesave hierarkike ose ndërhyrjeve apo presioneve të jashtme. I dyti ishte që gjyqtarët duhet të ishin objektivë dhe të mos kishin asnjë interes në rezultatin e çështjes përveç zbatimit të rreptë të shtetit të së drejtës. Për të siguruar një pavarësi të tillë, gjykatat duhet të qeveriseshin nga rregulla që largonin çdo dyshim të bazuar që anëtarët e tyre mund t'i nënshtroheshin presionit ose ndërhyrjes. Ndërkohë që GjDBE-ja theksoi se pranohej botërisht që gjyqtarët mund të shkarkoheshin në qoftë se vlerësohej se ishin të paafte për të kryer detyrën, kriteri i pavarësisë dhe parimi i mos-shkarkimit kërkonte që regjimi disiplinor të kishte garanci për të parandaluar që vetë ky regjim të mos përdorej si sistem kontrolli politik mbi vendimarrjen gjyqësore.

Tek çështja në fjalë, GjDBE-ja njohu faktin që Ligji i Ri ngrinte shqetësime në lidhje me parimin e mos-shkarkimit të gjyqtarëve. Në këto rrethana, GjDBE-ja vendosi që zbatimi i Ligjit të Ri do të ishte i pranueshëm vetëm nëse ishte i justifikuar nga një objektiv legjitim, nëse ishte proporcional, dhe nuk ngrinte ndonjë dyshim të arsyeshëm në mendjen e individëve sa i përket pavarësisë së gjykatave. Polonia pretendoi në parashtrimet e saj që objektivi legjitim ishte standardizimi i moshës së pensionimit për të gjithë punonjësit në vend dhe përmirësimi i ekuilibrit të moshës mes anëtarëve të moshuar të Gjykatës Supreme.

GjDBE-ja njohu që një objektiv i tillë mund të ishte legjitim, por që Komisioni Evropian për Demokraci përmes Ligjit (Komisioni i Venedikut) kishte ngritur dyshime serioze nëse Ligji i Ri vërtet ishte miratuar në vijim të objektivave të deklaruara. Gjithashtu, GjDBE-ja vërejtë që reduktimi i moshës së pensionit shoqërohej me një mekanizëm që i lejonte Presidentit të vendoste, sipas diskrecionit të tij, nëse një gjyqtari do t'i lejohej të vazhdonte punën pas moshës së pensionit. Më tej, sipas Ligjit të Ri, Presidenti mund të ushtronte diskrecionin e tij për të vazhduar mandatin e një gjyqtari të Gjykatës Supreme për gjashtë vjet të tjera pas pensionimit, në të njëjtën kohë që ligji kishte zbritur standardin e moshës së pensionimit me pesë vjet. Kjo hidhte dyshime nëse Ligji i Ri vërtet synonte standardizimin e moshës së pensionit ose përmirësimin e ekuilibrit të moshës në Gjykatën Supreme. Në fakt, GjDBE-ja theksoi se fakti që Presidenti mund të zgjidhte t'i mbante gjyqtarët në detyrë edhe pasi të kishin mbushur moshën e pensionit krijonte përshtypjen se qëllimi i Ligjit të Ri mund të kishte qenë përjashtimi i një grupi të paracaktuar gjyqtarësh nga Gjykata Supreme. GjDBE-ja po ashtu theksoi se Ligji i Ri do të impononte pensionimin e menjëhershëm të 27 prej 72 gjyqtarëve të Gjykatës Supreme në atë kohë, përfshirë Kryetarin e Gjykatës, dhe se një ristrukturim kaq i madh i gjykatës ngrinte dyshime rreth natyrës së reformës dhe qëllimeve të saj të vërteta.

Republika e Polonisë gjithashtu pranoi para GjDBE-së se mosha e përgjithshme e pensionimit të punonjësve nuk kërkonte daljen në pension të punonjësve të moshës 65-vjeçare, siç kërkonte Ligji i Ri, por vetëm u jepte atyre të drejtën për të pushuar aktivitetet profesionale dhe për të marrë pagesë pensioni. Në këtë aspekt, GjDBE-ja konsideroi që Polonia ende nuk kishte demonstruar që Ligji i Ri përbënte mjet të përshtatshëm për standardizimin e moshës së pensionit. Më tej, GjDBE-ja deklaroi që, sa i përket objektivit të standardizimit të moshave të pensionimit, zbritja e detyruar e moshës automatike të pensionit pa futjen e masave të përkohshme për mbrojtjen e pritshmërive legjitime të gjyqtarëve të prekur ishte joproporcionale. GjDBE-ja po ashtu vërejtë që gjyqtarët e Gjykatës Supreme nuk mund ta kontestonin zbatimin e menjëhershëm të reformës, dhe që kjo nuk mund të justifikohej nga argumentet e Polonisë që lejimi i sfidave do të mundësonte diskriminimin mes gjyqtarëve

ekzistues që shërbenin në Gjykatën Supreme dhe atyre që do t'i bashkoheshin asaj gjykate në të ardhmen.

Duke pasur parasysh të gjitha konsideratat e mësipërme, GjDBE-ja vendosi që masa në Ligjin e Ri që zbriste moshën e pensionimit të gjyqtarëve të Gjykatës Supreme nuk ishte e justifikuar nga një objektiv legjitim. Prandaj, masa minonte parimin e mos-shkarkimit, e rrjedhimisht të pavarësisë, së gjyqtarëve, dhe ankesa e parë e Komisionit duhet të pranohet.

### Ankesa e dytë

Ankesa e dytë e Komisionit ishte në lidhje me aspektin e Ligjit të Ri që i lejonte Presidentit diskrecionin për të vazhduar dy herë periudhën e punësimit të çdo gjyqtari të Gjykatës Supreme që mbushte moshën e re të pensionimit, pra 65 vjeç. Siç shpjegoi në lidhje me ankesën e parë, GjDBE-ka deklaroi që, për të qenë e pavarur dhe e paanshme, një gjykatë duhet t'i ushtronte funksionet e saj në mënyrë krejtësisht autonome, pa ndërhyrje ose presione të jashtme. Rregullat që qeverisnin pavarësinë dhe paanshmërinë e gjykatave gjithashtu duhet të zhdoknin çdo dyshim të arsyeshëm që gjykatat ishin të ndikuara nga faktorë të jashtëm. Në këtë rast GjDBE-ja theksoi se pushteti që i ishte besuar Presidentit për të vendosur ose për të mos vendosur vazhdimin e punësimit në Gjykatën Supreme nuk e minonte automatikisht pavarësinë e gjykatës. Megjithatë, duhet të kishte rregulla procedurale dhe kushte substanciale që nënkuptonin se nuk mund të ekzistonin dyshime të arsyeshme që pavarësia ose paanshmëria e gjyqtarëve prekej nga një pushtet i tillë. Këto rregulla procedurale duhet të siguronin që gjyqtarët të ishin të mbrojtur ndaj presionit ose ndikimit të jashtëm, qoftë direkt apo indirekt, i cili mund të kishte efekt mbi vendimet e gjyqtarëve në fjalë.

GjDBE-ja konfirmoi që rregullat procedurale në Ligjin e Ri që qeverisnin vazhdimin e punësimit të një gjyqtari të Gjykatës Supreme përtej moshës së pensionimit nuk i përmbushnin kriteret e pavarësisë dhe paanshmërisë. Së pari, GjDBE-ja theksoi se vazhdimi i punës së një gjyqtari të Gjykatës Supreme i nënshtrohej vetëm diskrecionit të Presidentit dhe nuk ishte i qeverisur nga ndonjë kriter i verifikueshëm për të cilin duhet të jepeshin arsye. Përveç kësaj, vendimi i Presidentit nuk mund të kontestohet në gjykatë. Së dyti, GjDBE-ja theksoi se, ndërkohë që Këshillit Kombëtar të Gjyqësorit (Këshilli) i kërkohet t'i paraqiste një opinion Presidentit para se ky i fundit të merrte vendim lidhur me vazhdimin e punës së një gjyqtari, Këshillit nuk i kërkohet të jepte arsye për opinionin e tij dhe as nuk e bënte një gjë të tillë në praktikë. Kështu, GjDBE-ja nuk besonte se opinionet e Këshillit ishin në gjendje t'i ofronin Presidentit informata objektive lidhur me ushtrimin e pushtetit të tij. Në fund, argumenti i

Republikës së Polonisë që Shtetet e tjera kishin rregulla të ngjashme u refuzua nga GjDBE-ja, e cila vendosi që një Shtet Anëtar nuk mund të justifikonte shkeljet e veta duke u mbështetur në shkeljet e Shteteve të tjera Anëtare. Si rrjedhojë, GjDBE-ja arriti në përfundimin që diskrecioni që kishte Presidentit për të vendosur kohëzgjatjen e karrierës së një gjyqtari të Gjykatës Supreme i jepte shkas dyshimeve të arsyeshme në lidhje me pavarësinë dhe paanshmërinë e asaj gjykate.

GjDBE-ja përfundoi që ankesa e dytë e Komisionit, dhe e tërë padia në tërësi, duhet të pranoheshin, dhe prandaj Republika e Polonisë kishte dështuar të përmbushte detyrimet e saj sipas paragrafit të dytë të Nenit 19(1) të TBE-së në lidhje me Nenin 47 të Kartës. Në përputhje me Nenin 138(1) të Rregullave të Procedurës të Gjykatës së Drejtësisë, Republika e Polonisë, si pala e pasuksesshme, u urdhërua të paguante kostot.

*Ligjet që rregullojnë moshën e pensionimit të gjyqtarëve polakë dhe dhënien e diskrecionit Ministrit të Drejtësisë për mundësinë e këtyre gjyqtarëve për të vazhduar në postet e tyre u vendos se ishin diskriminuese dhe shkelnin parimin e pavarësisë dhe paanshmërisë gjyqësore*

## **URDHRI I GJYKATËS SË DREJTËSISË SË BASHKIMIT EVROPIAN NË ÇËSHTJEN KOMISIONI K. POLONISË**

---

(Çështja Nr. C-192/18)

**5 nëntor 2019**

Në këtë çështje, Komisioni ngriti padi në GjDBE kundër Republikës së Polonisë për dështimin e përmbushjes së një detyrimi. Shih hyrjen e këtij seksioni, lart, për një shpjegim më të hollësishëm të këtij procesi.

### **1. Faktet kryesore**

Më 12 korrik 2017, Republika e Polonisë ('Polonia') miratoi një ligj që ndryshonte moshën e pensionimit për gjyqtarët e gjykatave të rregullta polake ('Ligji me Amendamente'). Këto amendamente i zbrisnin moshat normale të pensionimit prej 70 vjeç në 65 vjeç për burrat dhe në 60 vjeç për gratë. Më tej, Ligji me Amendamente kërkonte që gjyqtarët që kishin mbushur moshën e re të pensionimit të kërkonin autorizim nga Ministri i Drejtësisë ('Ministri') për të vazhduar punën deri sa të arrinin moshën e lartë të pensionit, 70 vjeç.

Komisioni ishte i mendimit që ky ligj nuk ishte në përputhje me të drejtën evropiane, posaçërisht Nenin 157 të TBE-së dhe Nenet 5(a) dhe 9(1)(f) të Direktivës 2006/54, sepse krijimi i moshave të ndryshme të pensionit për burrat dhe gratë përbënte diskriminim mbi baza gjinore. Neni 157 parashikonte që burrat dhe gratë duhet të merrnin pagë të barabartë për punë të barabartë ose për punë të vlerës së njëjtë. Neni 5(a) i Direktivës 2006/54 parashikonte që nuk duhet të kishte diskriminim mbi baza gjinore në skemat profesionale të sigurimeve shoqërore sa i përket fushëveprimit të skemave të tilla dhe kushteve për të qenë pjesë e tyre. Në fund, Neni 9(1)(f) i të njëjtës Direktivë thoshte që një shembull i diskriminimit të ndaluar nga ajo Direktivë ishte caktimi i moshave të ndryshme të pensionit të bazuara në përkatësinë gjinore.

Gjithashtu, Komisioni ishte i mendimit që aspektet e Ligjit me Amendamente që i jepnin Ministrit të Drejtësisë autoritet mbi moshat e pensionimit të gjyqtarëve dështonte të përmbushte kriteret e pavarësisë gjyqësore të shprehura në Nenin 19(1)

të TBE-së. Neni 19(1) i TBE-së i detyronte Shtetet Anëtare të siguronin që çdo organ shtetëror që kishte kompetenca për të vendosur mbi çështje lidhur me kërkesat për interpretimin e të drejtës së BE-së, për shembull gjykatat polake, duhet të plotësonin kriteret e pavarësisë gjyqësore. Kjo ishte për shkak se pavarësia gjyqësore përbënte një pjesë të thelbit të së drejtës themelore për proces të drejtë sipas Nenit 47 të Kartës së të Drejtave Themelore të Bashkimit Evropian ('Karta'). Në mënyrë të veçantë, Komisioni konsideroi që kriteret e ndjekura në vendimet e Ministrit ishin tepër të mjegullta, që Ministri kishte diskrecionin për t'i injoruar këto kritere gjatë vendimmarrjes, që Ligji me Amendamente nuk specifikonte periudhën kohore brenda së cilës duhet të merrej vendimi, që nuk ishte publikuar asnjë informacion që tregonte se në çfarë rrethanash autorizohej vazhdimi i karrierës së një gjyqtari, dhe që nuk ishte e mundur që vendimi i Ministrit të shqyrtohej në aspektin gjyqësor. Rrjedhimisht, Komisioni kishte arritur në përfundimin që Ligji me Amendamente minonte pavarësinë e gjyqtarëve polakë.

Më 28 korrik 2017, Komisioni i dërgoi një notë zyrtare Polonisë që ajo kishte shkelur detyrimet e saj sipas të drejtës së BE-së. Në gusht 2017 Polonia u përgjigj duke mohuar shkeljet e së drejtës së BE-së. Në shtator 2017 Komisioni dha një opinion të arsyetuar ku thuhej se dispozitat relevante të Ligjit me Amendamente të datës 12 korrik 2017 shkelnin të drejtën e BE-së. Pavarësisht nga thirrjet e Komisionit drejtuar Polonisë për ta ndryshuar ligjin shkelës brenda një muaji, qeveria polake vazhdoi të mohonte që kishte pasur shkelje. Në përgjigje ndaj kësaj Komisioni ngriti padi kundër Polonisë për dështim në përmbushjen e një detyrimi, padi e cila jepet e përmbledhur këtu.

## 2. Vendimi i GjDBE-së

GjDBE-ja filloi duke konfirmuar që, sipas praktikës së saj gjyqësore tashmë të vendosur, ajo duhet ta merrte në konsideratë një padi për dështim në përmbushjen e një detyrimi duke pasur parasysh kushtet që ekzistojnë në Shtetin Anëtar në fund të periudhës së caktuar në opinionin e arsyetuar. Prandaj, pavarësisht nga fakti që Polonia kishte bërë rregullime në Ligjin me Amendamente, këto nuk ishin futur deri në fund të tetorit 2017. Kështu që Gjykata duhet të merrte vendim në lidhje me padinë e ngritur nga Komisioni.

### Ankesa e parë

Praktika gjyqësore e GjDBE-së konfirmonte që përfitimet e skemës pensionale hyjnë brenda fushëveprimit të Nenit 157 të TBE-së dhe Direktivës 2006/54, meqenëse ato i dedikohen një punonjësi për shkak të marrëdhënies së punës mes atij punonjësi

dhe punëdhënësit të tij. Më tej, GjDBE-ja deklaroi se ishte e qartë që periudha e shërbimit të kryer nga një gjyqtar luante rol vendimtar në llogaritjen e pensionit të tij.

Nuk u vu në diskutim nga palët që Ligji me Amendamente i fiksonte moshat e pensionimit për disa gjyqtarë të caktuar mbi bazën e përkatësisë së tyre gjinore. Prandaj ishte e qartë për GjDBE-në se Ligji me Amendamente fuste në mënyrë të drejtpërdrejtë kritere diskriminuese mbi baza gjinore në skemat pensionale dhe që ato nuk ishin në pajtueshmëri me Nenin 157 të TBE-së dhe Nenin 5(1)(a) të Direktivës 2006/54, sidomos të marra në lidhje me Nenin 9(1)(f) të asaj Direktive.

GjDBE-ja më tej vendosi që, megjithëse Neni 157(4) i TBE-së i autorizonte Shtetet Anëtare të kishin ose të miratonin masa që ofronin avantazhe të caktuara për gratë për të kompensuar disavantazhe të tjera që ato mund të kishin në karrierën e tyre profesionale, këto masa duhet të kontribuonin për t'i ndihmuar gratë gjatë zhvillimit të karrierës së tyre profesionale mbi baza të barabarta me burrat. GjDBE-ja ishte e mendimit që pensionimi i hershëm nuk neutralizonte disavantazhet për gratë në karrierën e tyre, dhe as nuk mund të konsiderohej si zgjidhje për këto disavantazhe. Prandaj, GjDBE-ja gjeti që ankesa e Komisionit që pretendonte shkelje të Nenit 157 të TBE-së dhe Neneve 5(a) dhe 9(1)(f) të Direktivës 2006/54 duhet të mbështetej.

### Ankesa e dytë

GjDBE-ja filloi duke konfirmuar që Shtetet Anëtare janë të detyruara të veprojnë në pajtueshmëri me të drejtën e BE-së gjatë organizimit të sistemeve të tyre gjyqësore. Sipas Nenit 19(1) të TBE-së, çdo organ kompetent për të vendosur mbi kërkesat lidhur me zbatimin ose interpretimin e të drejtës së BE-së duhet të përmbushin kriteret e mbrojtjes gjyqësore efektive. Për t'u siguruar që gjykatat polake i plotësonin kriteret e mbrojtjes gjyqësore efektive GjDBE-ja përsëriti se ato duhet të ishin të pavarura, siç konfirmohet nga Neni 47 i Kartës. Pavarësia mbahej si pjesë e thelbit të së drejtës për proces të drejtë, çka në vetvete u përsërit se kishte rëndësi të jashtëzakonshme për mbrojtjen e të drejtave individuale të dala nga ligjet e BE-së. Prandaj, GjDBE-ja vendosi që rregullat nacionale të përmbajtura në Ligjin me Amendamente në lidhje me pensionimin e gjyqtarëve mund të shqyrtoheshin nën dritën e Nenit 19(1) të TBE-së.

GjDBE-ja u shpreh se pavarësia sipas Nenit 19(1) të TBE-së përbëhet nga dy pjesë. E para është që organi përkatës duhet të funksionojë në mënyrë krejtësisht autonome, pa iu nënshtruar kufizimeve ose ndonjë organi tjetër, dhe pa marrë urdhra apo udhëzime prej askujt tjetër. Aspekti i dytë ishte që gjyqtarët duhet ishin objektivë dhe

të mos kishin asnjë interes në rezultatin e procedurave gjyqësore përveç garantimit të shtetit të së drejtës. Më tej, GjDBE-ja konfirmoi që parimi i pavarësisë dhe paanshmërisë duhet të ruhej me anë të rregullave që mbrojnë gjyqtarët nga presioni që mund të dëmtojë gjykimin e tyre të pavarur, siç janë garancitë kundër shkarkimit nga posti. Parimi i mos-shkarkimit, kriter praktik kyç për pavarësinë, garantonte që gjyqtarët duhet të qëndronin në postet e tyre deri sa të arrinin moshën e pensionimit të detyruar ose deri kur t'u përfundonte mandati, në qoftë se ishte mandat i caktuar. Përjashtimet nga ky kriter duhet të kishin baza legjitime dhe imponuese, dhe duhet të ishin proporcionale me ato baza. Rrjedhimisht parimi i mos-shkarkimit kërkonte ekzistimin e garancive të mjaftueshme për të parandaluar që regjimi disiplinor që mbikqyrte gjyqtarët të mos përdorej si sistem kontrolli mbi vendimet gjyqësore.

Në këtë kontekst, GjDBE-ja theksoi se dhënia e fuqisë Ministrit të Drejtësisë për të vendosur nëse një gjyqtar mund të vazhdonte karrierën apo jo nuk nënkuptonte automatikisht se pavarësia gjyqësore ishte minuar. E rëndësishme thelbësore ishte nëse kushtet substanciale dhe rregullat e hollësishme procedurale mbi të cilat bazoheshin vendimet e Ministrit ishin të mjaftueshme për të parandaluar ngritjen e dyshimeve të arsyetuara rreth pavarësisë së gjyqtarëve dhe neutralitetit të tyre në çështjet që kishin përpara. Kushtet dhe rregullat procedurale që mund të plotësonin kriteret e Nenit 19(1) duhet të përjashtonin çdo ndikim direkt në vendimmarrjen gjyqësore dhe çdo potencial për ndikim indirekt që mund të influençojë vendimet e gjyqtarëve.

GjDBE-ja më tej gjeti që Ministrit të Drejtësisë nuk i kërkohet të deklaronte arsyetimin e tij kur vendoste nëse do të lejonte një gjyqtar për të vazhduar karrierën. Kriteret për marrjen e një vendimi të tillë ishin po ashtu tepër të mjegullta dhe të paverifikueshme, dhe vendimi i Ministrit nuk mund të kontestohet në procedura gjyqësore. Përveç kësaj, meqenëse një gjyqtari i kërkohet të paraqiste kërkesë për vazhdimin e karrierës para se të mbushnin moshën normale të pensionit, kombinuar me faktin që nuk kishte kornizë kohore brenda së cilës Ministri duhet të merrte vendimin e tij, GjDBE-ja arriti në përfundimin që gjatësia e kohës mes kërkesës dhe përgjigjes së Ministrit mund të përbënte një periudhë pasigurie gjatë së cilës karriera e një gjyqtari do të ishte nën diskrecionin e Ministrit. Rrjedhimisht, situata do të ngrinte dyshime të arsyeshme lidhur me pavarësinë dhe paanshmërinë e vendimmarrjes gjyqësore.

Më tej GjDBE-ja shqyrtoi nëse fuqitë e dhëna Ministrit të Drejtësisë sipas Ligjit me Amendamente dështonin në përputhshmërinë me parimin e mos-shkarkimit. Së pari, efekti i dyfishtë i zbritjes së moshës së pensionimit për gjyqtarët e rregullt dhe dhënia e diskrecionit Ministrit për të hequr gjyqtarët mbi atë moshë kishte çuar drejt dyshimeve të arsyeshme nëse qëllimi i Ligjit me Amendamente vërtet



ishite që t'i lejonte Ministrit të hiqte grupe të caktuara gjyqtarësh në detyrë. Së dyti, Ligji me Amendamente kishte krijuar një situatë në të cilën dhjetë vitet e fundit të karrierës së një gjyqtareje, dhe pesë vitet e fundit të karrierës së një gjyqtari, do të ishin krejtësisht nën diskrecionin e Ministrit të Drejtësisë. Së treti, pasi gjyqtarët të kërkonin, sipas Ligjit me Amendamente, leje për të vazhduar punën pas moshës normale të pensionimit, këto gjyqtarë duhet ta vazhdonin punën deri në momentin kur Ministri e refuzonte ose e pranonte kërkesën e tyre. Kjo do të thoshte që gjyqtarët ishin të ekspozuar ndaj mundësisë që të shërbenin si gjyqtarë për një periudhë relativisht të gjatë kohore, gjatë së cilës vazhdimësia e karrierës së tyre ishte nën diskrecionin e Ministrit. Rrjedhimisht, Ligji me Amendamente krijonte një situatë që dështonte në aspektin e pajtueshmërisë me parimin e mos-shkarkimit, dhe GjDBE-ja vendosi që ai kishte shkelur parimin e pavarësisë dhe paanshmërisë gjyqësore.

Prandaj, padia e Komisionit për dështim në përmbushjen e një detyrimi u mbështet në tërësi, dhe GjDBE-ja vendosi që Polonia kishte dështuar në përmbushjen e detyrimeve të saj sipas Nenit 19(1) të TBE-së. Si pala e pasuksesshme, Republika e Polonisë u urdhërua të paguante kostot e të dyja palëve.

*Në një çështje që përfshinte Dhomën Disiplinore polake, GjDBE-ja vendosi që e drejta e BE-së parandalonte që një gjykatë që nuk ishte e pavarur ose e paanshme të gjykonte çështje të lidhura me interpretimin e të drejtës së BE-së, dhe që çdo ligj që i jep një gjykatë të tillë juridiksionin për të vepruar kështu nuk duhet të zbatohet në përputhje me përparësinë e të drejtës së BE-së*

## **VENDIMI I GJYKATËS SË DREJTËSISË SË BASHKIMIT EVROPIAN NË ÇËSHTJEN A.K. K. KRAJOWA RADA SĄDOWNICTWA; DHE CP DHE DO K. SĄD NAJWYŻSZY**

**(Çështjet Nr. C-585/18, C-624/18 dhe C-625/18)  
19 nëntor 2019**

Në këtë çështje, Gjykata e Apelit në Bruksel, Belgjikë, bëri kërkesë pranë GjDBE-së për vendimmarrje paraprake sipas Nenit 267 të TFBE-së. Shih hyrjen e këtij seksioni, lart, për një shpjegim më të hollësishëm të këtij procesi.

### **1. Faktet kryesore**

Ky vendim i GjDBE-së kishte lidhje me një kërkesë për vendimmarrje paraprake e dalë nga kombinimi i dy çështjeve që kishin qenë para gjykatave nacionale në Poloni. E para, A.K. kundër Krajowa Rada Sądownicta ('Çështja e Parë'), dhe e dyta, CP dhe DO kundër Sądnajwyższy ('Çështja e Dytë'), që të dyja kishin të bënin me futjen e një ligji të ri nga qeveria polake në lidhje me moshën e pensionimit të gjyqtarëve polakë. Ky Ligj i Ri për Gjykatën Supreme ('Ligji i Ri'), *inter alia*, zbriste moshën e pensionimit të gjyqtarëve të Gjykatës Supreme të Polonisë nga 70 vjeç në 65 vjeç. Çdo gjyqtar që dëshironte të vazhdonte punën përtej kësaj moshe të re të pensionit duhet të aplikonte për këtë para Presidentit polak, i cili do ta bazonte vendimin e tij mbi një vlerësim të bërë nga Këshilli Kombëtar i Gjyqësorit ('KKGj'), një organ që përfshinte Ministrin e Drejtësisë dhe anëtarë të parlamentit polak, dhe gjyqtarët e të cilit do të zgjidheshin në postet e tyre nga anëtarë të parlamentit polak.

Në Çështjen e Parë, A.K., një gjyqtar i Gjykatës Supreme i cili e kishte mbushur moshën 65-vjeçare para hyrjes në fuqi të Ligjit të Ri, aplikoi për të vazhduar në postin e tij pas moshës 65 vjeç por u refuzua nga KKGj. Në gusht të vitit 2018, A.K. apeloj pranë Gjykatës Supreme polake duke u bazuar mbi faktin se vendimi i KKGj-së kishte shkelur të drejtën e BE-së, konkretisht Nenin 19(1) të TBE-së (detyrimi i Shteteve Anëtare që të ofrojnë zgjidhje efektive për të siguruar mbrojtjen ligjore efektive të së drejtës së BE-së, dhe përgjegjësia e GjDBE-së për t'u siguruar që të respektohet interpretimi dhe zbatimi i Traktateve të BE-së dhe të drejtës së BE-së), dhe mbi Nenin

47 të Kartës së të Drejtave Themelore të Bashkimit Evropian ('Karta') (e drejta për zgjidhje efektive dhe për proces të drejtë nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme), dhe Direktivën 2000/78 (e drejta për trajtim të barabartë dhe mos-diskriminim). Neni 9(1) i Direktivës 2000/78 parashikonte në mënyrë specifike që duhet të kishte procedura në dispozicion për cilindo që donte të kontestonte çdo diskriminim që mund të kishte pësuar.

Në Çështjen e Dytë, CP dhe DO, dy gjyqtarë të Gjykatës Supreme polake po ashtu e kishin mbushur moshën 65-vjeçare para hyrjes në fuqi të Ligjit të Ri. Asnjëri prej tyre nuk kishte bërë kërkesë për të vazhduar punën pas moshës 65 vjeç, e rrjedhimisht Presidenti polak i nxori në pension në korrik të vitit 2018. Të dy apeluan në Gjykatë Supreme për veprimin e Presidentit, në përputhje me Nenin 2(1) të Direktivës 2000/78 i cili ndalonte diskriminimin mbi bazën e moshës.

Në këto çështje, Gjykata Supreme kishte përpara dy probleme. I pari ishte që organi gjyqësor që duhet t'i dëgjonte çështjet ishte Dhoma Disiplinore, një organ i ri i krijuar nga Ligji i Ri. Megjithatë, duke qenë se gjyqtarët e Dhomës Disiplinore nuk ishin emëruar ende, dhoma nuk ekzistonte ende. Më tej, Gjykata Supreme ishte e shqetësuar për faktin se Dhoma Disiplinore nuk do të përmbushte kriteret e BE-së për pavarësi dhe paanshmëri sepse gjyqtarët e këtij organi do të emëroheshin nga Presidenti polak në vijim të rekomandimeve të KKGJ-së. Meqenëse kishte prova që KKGJ-ja ishte nën kontroll politik, një proces i tillë me gjasë e shpërfillte parimin e ndarjes së pushteteve dhe sundimit të ligjit.

Kështu, Gjykata Supreme bëri kërkesë në GjDBE për vendimmarrje paraprake. Në lidhje me Çështjen e Parë, Gjykata Supreme ('gjykata referuese') pyeti nëse, sipas Nenit 47 të Kartës dhe Nenit 9(1) të Direktivës 2000/78, ajo duhej të mos e zbatonte kriterin e Ligjit të Ri që Dhoma Disiplinore kishte juridiksion sepse ajo Dhomë nuk ishte ende operationale. Më tej, në qoftë se përgjigjja ndaj kësaj pyetjeje ishte negative, a do të thoshte kjo që, sipas Nenit 267 TFBE në lidhje me Nenin 19(1) TBE, Nenin 2 TBE (i cili përcakton parimet e respektit për dinjitetin njerëzor, lirinë, demokracinë, shtetin e së drejtës, dhe respektin për të drejtat e njeriut) dhe Nenit 47 të Kartës, Gjykata Supreme duhet ta dëgjonte çështjen vetë?

Në lidhje me Çështjen e Dytë, Gjykata Supreme e pyeti GjDBE-në nëse Neni 47 i Kartës, në lidhje me Nenin 9(1) të Direktivës 2000/78, i kërkonte Gjykatës Supreme që të mos zbatonte kërkesën e Ligjit të Ri që Dhoma Disiplinore kishte juridiksion sepse ajo Dhomë nuk ishte ende operationale. Gjykata referuese gjithashtu pyeti nëse Dhoma Disiplinore mund të konsiderohej gjykatë e pavarur brenda kuptimit të së drejtës së BE-së, dhe, nëse përgjigjja ndaj kësaj pyetjeje ishte negative, a do të

thoshte kjo që, sipas Nenit 267 TFBE, në lidhje me Nenin 19(1) TBE, Nenin 2 TBE dhe Nenin 47 të Kartës, Gjykata Supreme duhet ta shpërfillte Ligjin e Ri dhe ta dëgjonte çështjen vetë?

## 2. Vendimi i GjDBE-së

GjDBE-ja filloi duke i bashkuar të dy referimet në një çështje të vetme. Më pas, mori në shqyrtim pyetjen e parë të ngritur në Çështjen e Dytë, pra nëse Gjykata Supreme duhet të mos i zbatonte pjesët përkatëse të Ligjit të Ri duke qenë se Dhoma Disiplinore nuk ishte emëruar ende. Këtu, GjDBE-ja theksoi se Dhoma Disiplinore ishte formuar prej asaj kohe, dhe prandaj pyetja nuk ishte më relevante dhe nuk ishte e nevojshme që t'i jepej përgjigje.

Në fillim të përgjigjes ndaj pyetjeve të tjera që i ishin referuar, GjDBE-ja përsëriti se, ndërkohë që Shtetet Anëtare ishin përgjegjëse për organizimin e sistemeve të veta të drejtësisë, ato prapë se prapë ishin të detyruara të përmbushnin detyrimet e tyre ndaj të drejtës së BE-së, përfshirë garantimin e të drejtave themelore të përmbajtura në Kartë. Prandaj çështja ishte brenda juridiksionit të GjDBE-së për sa u përkiste çështjeve të lidhura me zbatimin ose interpretimin e të drejtës së BE-së. Më tej, pavarësisht nga fakti që Ligji i Ri ishte ndryshuar për të mos zbatuar moshën e pensionimit prej 65 vjeç për gjyqtarët që kishin nisur shërbimin në Gjykatë Supreme para 1 janarit 2019, GjDBE-ja vendosi që, meqenëse ajo kishte kompetencë për të shpjeguar pikat e të drejtës së BE-së në adresë të gjykatave referuese të cilat [pika] mund të zgjidhnin probleme të juridiksionit, ky amendament i Ligjit të Ri nuk i prekte pyetjet e ngritura në lidhje me Çështjen e Dytë. Megjithatë, meqë tani KKGJ ekzistonte dhe A.K. kishte mundësi të vazhdonte të qëndronte në postin e tij, nuk ishte më e nevojshme të vendosej në lidhje me ato pyetje të ngritura në lidhje me Çështjen e Parë.

Duke iu kthyer dy pyetjeve të mbetura, GjDBE-ja deklaroi që, meqenëse të drejtat e Kartës korrespondonin me të drejtat e garantuara nga Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut (KEDNJ), mbrojtjet e ofruara nga Neni 47 i Kartës nuk mund të binin nën nivelin e mbrojtjes të vendosur nga neni 6 i KEDNJ-së (e drejta për proces të drejtë) siç interpretohet nga Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ). Prandaj, Neni 47 i Kartës garantonte që secilit i takonte një seancë dëgjimore e drejtë nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme.

Sipas GjDBE-së, parimi i pavarësisë dhe paanshmërisë përbëhej nga dy pjesë. E para ishte që organi përkatës duhet të funksiononte në mënyrë krejtësisht autonome, pa iu nënshtruar pengimeve apo ndonjë organi tjetër, dhe pa marrë urdhra apo

udhëzime nga asnjë burim tjetër. E dyta ishte që gjyqtarët duhet të ishin objektivë dhe të mos kishin asnjë interes në çështjet para tyre përveç mbështetjes së shtetit të së drejtës. Më tej, parimi i pavarësisë dhe paanshmërisë duhet të mbrohej me anë të rregullave që mbronin gjyqtarët nga presioni që mund të dëmtonte gjykimin e tyre të pavarur, dhe që rregulla të tilla njëkohësisht të konfirmonin parimin e ndarjes së pushteteve, posaçërisht pavarësinë e gjyqësorit si pjesë e rëndësishme e shtetit të së drejtës. Neni 47 u vlerësua nga GjDBE-ja se pasqyronte kriteret e nenit 6(1) të KEDNj-së, i cili i jep peshë, *inter alia*, mënyrës së emërimit të gjyqtarëve në një organ gjyqësor dhe mandatit të tyre, ekzistencës së garancive kundër presionit të jashtëm mbi gjyqtarët, dhe nëse organi paraqiste dukjen e pavarësisë.

GjDBE-ja vendosi që, në thelb, kishte dyshime nëse Dhoma Disiplinore përmbushte kriteret e pavarësisë dhe paanshmërisë ashtu siç janë përshkruar në të drejtën e BE-së dhe KEDNj-së. Ky dyshim dilte nga rrethanat e krijimit të Dhomës, juridiksionit të saj, përbërjes së saj, dhe mënyrës se si emëroheshin gjyqtarët. Ndërkohë që fakti që gjyqtarët e Dhomës Disiplinore emëroheshin nga Presidenti polak nuk nënkuptonte automatikisht që mes tyre ekzistonte një marrëdhënie varësie, emërimi i gjyqtarëve gjithsesi kishte kushte substanciale dhe rregulla të hollësishme procedurale me qëllim të parandalimit të dyshimeve të bazuara që gjyqtarët mund të mos ishin të pavarur dhe të paanshëm. Në këtë rast, gjyqtarët emëroheshin nga Dhoma Disiplinore sipas rekomandimeve nga KKGj-ja. Ndërkohë që prania e një organi të tillë të specializuar në procesin e emërimit do të mund të minimizonte mundësinë e mungesës së pavarësisë së Dhomës, kjo do të kishte kërkuar që KKGj-ja të ishte mjaftueshëm e pavarur nga parlamenti, ekzekutivi dhe Presidenti.

Në mesin e faktorëve që u sollën në vëmendje të GjDBE-së nga gjykata referuese në lidhje me pavarësinë e KKGj-së ishte fakti që Ligji i Ri kishte reduktuar kohëzgjatjen e mandatit të anëtarëve të KKGj-së, duke reduktuar kështu numrin e anëtarëve në atë organ; që anëtarët e KKGj-së të cilët ishin zgjedhur më parë në atë organ nga anëtarë të tjerë të gjyqësorit tani zgjidheshin nga anëtarët e legjislaturës, duke siguruar që 23 prej 25 anëtarëve të KKGj-së emëroheshin nga autoritetet politike ose ishin anëtarë të ekzekutivit ose legjislaturës; dhe që kishte potencial të qartë për parregullsi që mund të ndikonin në mënyrë negative mbi procesin e emërimeve në KKGj. Këto faktorë ishin të rëndësishëm duke pasur parasysh rolin kushtetues të KKGj-së, përgjegjësinë e tij për të siguruar pavarësinë e gjykatave dhe gjyqësorit, dhe faktin që e vetmja rrugë për të konstestuar emërimet në Gjykatën Supreme ishte kontestimi i vendimeve të KKGj-së.

Për t'u rikthyer tek Dhoma Disiplinore, sipas Ligjit të Ri asaj i ishte dhënë juridiksion ekskluziv mbi çështjet që kishin të bënin me punësimin, sigurimet

shoqërore, dhe pensionimin e gjyqtarëve të Gjykatës Supreme, çështje me të cilat ishin marrë gjykatat e rregullta. GjDBE-ja theksoi se ky ndryshim ishte bërë në kontekstin e shumë ndryshimeve të tjera në organizatën e Gjykatës Supreme të Polonisë të cilat kishin ndodhur afërisht rreth të njëjtës kohë, në mënyrë të veçantë që qeveria polake e kishte zbritur moshën e pensionimit të gjyqtarëve të Gjykatës Supreme, dhe që GjDBE-ja kishte gjetur që këto masa komprometonin mosshkarkimin dhe pavarësinë e gjyqtarëve të Gjykatës Supreme dhe që Polonia kishte dështuar në përmbushjen e detyrimeve të saj sipas Nenit 19(1) të TBE-së.<sup>[414]</sup> Sipas Ligjit të Ri, Dhoma Disiplinore gjithashtu duhet të përbëhej vetëm nga gjyqtarë të sapoemëruar, asnjëri prej të cilëve nuk do të kishte shërbyer në Gjykatën Supreme më parë. GjDBE-ja theksoi se të gjithë këto faktorë nënkuptonin se Dhoma Disiplinore gëzonte një shkallë posaçërisht të lartë autonomie brenda Gjykatës Supreme. GjDBE-ja arsyetoi që, ndërkohë që secili prej këtyre faktorëve i vetëm mund të mos ishte i mjaftueshëm për të vënë në dyshim pavarësinë e Dhomës Disiplinore, të marrë së bashku kjo mund të mos ishte e vërtetë, sidomos duke pasur parasysh pyetjet e mëtejshme rreth pavarësisë së KKGj-së.

GjDBE-ja vendosi që i takonte gjykatës referuese të përcaktonte nëse, marrë së bashku dhe brenda kontekstit, këto faktorë kishin mundësi të ngrinin dyshime legjitime në lidhje me pavarësinë dhe paanshmërinë e Dhomës Disiplinore, përfshirë në lidhje me mundësinë e ndikimit direkt ose indirekt mbi organin nga legjislativi dhe ekzekutivi. Për ta vendosur këtë, Dhoma nuk u pa si e tillë që paragjykonte besimin tek drejtësia që duhet të frymëzojë një shoqëri demokratike. Në qoftë se do të kishte dyshime legjitime rreth pavarësisë dhe paanshmërisë së Dhomës Disiplinore, atëherë GjDBE-ja konfirmoi që Dhoma nuk do t'i përmbushte kriteret e Nenit 47 të Kartës dhe Nenin 9(1) të Direktivës 2000/78.

Pyetja e dytë të cilës duhet t'i jepej përgjigje nga GjDBE-ja ishte që, nëse Dhoma Disiplinore nuk i përmbushte kriteret e Nenit 47 të Kartës dhe Nenin 9(1) të Direktivës 2000/78, a i kërkonte përparësia e të drejtës së BE-së Gjykatës Supreme që të mos zbatonte dispozitatat e Ligjit të Ri që i jepnin juridiksion asaj dhome. GjDBE-ja në fillim deklaroi që e drejta e BE-së kishte përparësi ndaj ligjeve të Shteteve Anëtare, dhe që parimi i përparësisë kërkonte që të gjitha Shtetet Anëtare t'i jepnin efekt të plotë dispozitave të së drejtës së BE-së, dhe që e drejta e tyre nacionale të mos minonte të drejtën e BE-së. Nga kjo rridhte që e drejta nacionale duhet të interpretohej në përputhje me të drejtën e BE-së në maksimumin e mundshëm. Në rastet kur një ligj nacional nuk mund të interpretohej në përputhje me ligjet e BE-së, gjykatat nacionale duhet të mos e zbatonin një ligj të tillë nacional dhe të zbatonin direkt ligjin e BE-së.

414 Komisioni k. Polonisë, C-619/18, vendimi i 24 qershorit 2019 (i përfshirë si përmbledhje në këtë publikim).

Prandaj, në qoftë se Ligji i Ri kishte krijuar një dhomë që nuk përmbushte kriteret e Neni 47 të Kartës dhe Neni 9(1) të Direktivës 2000/78, atëherë përparësia e ligjeve të BE-së diktonte që gjykata nacionale duhet të siguronte efektivitetin e të drejtës së BE-së dhe të mos zbatonte elementet kontradiktore të ligjit nacional. Në një situatë të tillë, gjykata që do të kishte pasur juridiksion sikur të mos kishin qenë dispozitat që ishin në kundërshtim me ligjet e BE-së, dhe të cilat nuk përmbushnin kriteret e të drejtës së BE-së, do të duhej të merrte përsipër detyrat përkatëse.

Duke pasur parasysh konsideratat e mësipërme, GjDBE-ja arriti në përfundimin që Neni 47 i Kartës dhe Neni 9(1) i Direktivës 2000/78 duhet të interpretoheshin si të tillë që nuk e lejonin një gjykatë e cila gjykohej se nuk ishte e pavarur ose e paanshme që të dëgjonte çështjet në lidhje me zbatimin e të drejtës së BE-së. Një vendim i tillë mund të merrej kur karakteristikat dhe rrethanat në të cilat është formuar gjykata dhe janë emëruar anëtarët e saj ishin të tilla që ngrinin dyshime rreth pavarësisë dhe paanshmërisë së gjykatës. Megjithatë, i takonte gjykatës referuese, Gjykatës Supreme të Polonisë, që të vendoste nëse Dhoma Disiplinore nuk i përmbushte kriteret e pavarësisë dhe paanshmërisë. GjDBE-ja gjithashtu theksoi se parimi i përparësisë së të drejtës së BE-së kërkonte që gjykata referuese të mos zbatonin dispozitat e të drejtës nacionale që ia rezervonte juridiksionin për të dëgjuar dhe vendosur mbi çështje të të drejtës së BE-së një organi që nuk përmbushte kriteret e të drejtës së BE-së. GjDBE-ja vendosi që kostot duhet të përcaktoheshin nga gjykata referuese.

*Kërkesa e Komisionit Evropian për masa të përkohshme për të pezulluar funksionimin e Dhomës Disiplinore që mbikqyrte Gjykatën Supreme të Polonisë në pritje të rezultatit përfundimtar të çështjes u pranua nga GjDBE-ja*

## **URDHRI I GJYKATËS SË DREJTËSISË SË BASHKIMIT EVROPIAN NË ÇËSHTJEN KOMISIONI K. POLONISË**

---

(Çështja Nr. C-791/19 R)

**8 prill 2020**

Në këtë çështje, Komisioni ngrii padi në GjDBE kundër Republikës së Polonisë për dështim në përmbushjen e një detyrimi. Shih hyrjen e këtij seksioni, lart, për një shpjegim më të hollësishëm të këtij procesi.

Në vitin 2017, qeveria polake futi një ligj për krijimin e një regjimi të ri disiplinor për gjyqtarët e Gjykatës Supreme të Polonisë dhe për gjykatat e rregullta. Ligji parashikonte krijimin e një Dhome Disiplinore me juridiksionin për të dëgjuar çështje disiplinore në lidhje me gjyqtarët e Gjykatës Supreme polake dhe të gjykatave të rregullta. Dhoma Disiplinore përbëhej tërësisht nga gjyqtarë të emëruar nga një organ tjetër gjyqtarësh, Këshilli Kombëtar i Gjyqësorit, anëtarët e të cilit zgjidheshin në postet e tyre nga anëtarët e dhomës së ulët të parlamentit polak. Më 17 korrik 2019, Komisioni paraqiti një opinion të arsyetuar ku argumentohej se regjimi i ri disiplinor nuk ishte në përputhje me të drejtën e BE-së.

Më 17 shtator Republika e Polonisë iu përgjigj Komisionit, duke thënë se opinioni i tij ishte i pabazuar dhe që regjimi disiplinor ishte në përputhje me të drejtën e BE-së. Në përgjigje ndaj kësaj, Komisioni ngrii padi në GjDBE sipas Nenit 258 mbi bazën e faktit se Republika e Polonisë kishte shkelur detyrimet ndaj të drejtës së BE-së, në mënyrë të veçantë që, sipas regjimit të ri disiplinor, Dhoma Disiplinore nuk mund të konsiderohej e pavarur dhe e paanshme.

Më 19 nëntor 2019, në çështjet C-585/18, C-624/18 dhe C-625/18, të cilat tashmë i ishin referuar GjDBE-së nga Gjykata Supreme e Polonisë, GjDBE-ja gjeti që e drejta e BE-së nuk lejonte që çështjet në lidhje me zbatimin e të drejtës së BE-së, në këtë rast Direktiva 2000/78/EC për krijimin e një kornize të përgjithshme për trajtimin e barabartë në punësim dhe punë, të hynin brenda juridiksionit ekskluziv të një organi gjyqësor i cili nuk ishte i pavarur dhe i paanshëm. GjDBE-ja më tej deklaroi se rrethanat objektive në të cilat ishte formuar Dhoma Disiplinore, karakteristikat e saj dhe mënyra se si emëroheshin anëtarët e saj, kishin mundësi t'u jepnin shkas dyshimeve legjitime në lidhje me ndikimin e legjislativit dhe ekzekutivit mbi



Dhomën dhe neutralitetin e saj në çështjet para saj. GjDBE-ja ia kaloi përgjegjësinë Gjykatës referuese Supreme të Polonisë për ta zbatuar këtë interpretim të së drejtës së BE-së mbi Dhomën Disiplinore.

Gjykata Supreme e Polonisë, në vendimet e 5 dhjetorit 2019 dhe 15 janarit 2020, vendosi që, mes të tjerash, përfshirja e Këshillit Kombëtar të Gjyqësorit në përbërjen e Dhomës Disiplinore do të thoshte se Dhoma nuk mund të konsiderohej gjykatë legjitime sipas të drejtës së BE-së apo asaj polake sepse ajo nuk ishte, *inter alia*, organ i paanshëm që nuk varej nga degët legjislative dhe ekzekutive të qeverisë. Megjithatë, pavarësisht nga këto vendime, Dhoma Disiplinore vazhdoi të kryente funksionet e saj si përpara.

Në kontekstin e padisë së ngritur më 25 tetor 2019 dhe operimit të vazhdueshëm të Dhomës Disiplinore, Komisioni më 34 janar 2020 bëri kërkesë pranë GjDBE-së, sipas Nenit 279 të TBE-së, që të merreshin masa të përkohshme për të parandaluar dëme të pakthyeshme në rendin ligjor në Poloni nga regjimi disiplinor polak. Në mënyrë të veçantë, Komisioni kërkoi që GjDBE-ja ta urdhëronte Republikën e Polonisë që të pezullonte dispozitat e ligjeve polake të cilat përbënin bazën e autoritetit të Dhomës Disiplinore mbi të cilin ajo merrte vendime në çështje disiplinore lidhur me gjyqtarët, dhe të mos ia kalonte çështjet që do të kishin dalë para Dhomës Disiplinore asnjë gjykate tjetër që nuk përmbushte kriteret e pavarësisë dhe paanshmërisë. Në fund, në rast se GjDBE-ja do t'i lejonte masat e përkohshme, Polonia duhet ta informonte Komisionin, jo më vonë se një muaj pas urdhrit të GjDBE-së, në lidhje me të gjitha masat që kishte marrë për të qenë në pajtueshmëri me masat e përkohshme të vendosura.

## 1. Vendimi i GjDBE-së

GjDBE-ja filloi duke vendosur në lidhje me pranueshmërinë e kërkesës për masa të përkohshme. GjDBE-ja tha se, ndërkohë që organizimi i sistemit të drejtësisë në secilin Shtet Anëtar ishte brenda kompetencave të secilit Shtet Anëtar, prapë se prapë organizimi i secilit sistem të drejtësisë duhet të respektonte detyrimet nga e drejta e BE-së, përfshirë Nenin 19(1) të TBE-së. Kjo dispozitë kërkonte që Shtetet Anëtare t'i ngrinin sistemet e tyre të drejtësisë në mënyrë të atillë që të siguronin që organet gjyqësore që kishin për detyrë zbatimin e duhur të vetë ligjeve të BE-së të përmbushnin standardet ligjore të BE-së për pavarësi dhe paanshmëri efektive. Më pas, GjDBE-ja ceku që pavarësia gjyqësore përfshinte kërkesën që regjimi disiplinor që kishte për detyrë mbikqyrjen e gjyqësorit të posedonte mbrojtje të mjaftueshme për të siguruar pavarësinë e tij dhe të shmangte çdo rrezik që regjimi të përdorej si mjet kontrolli politik mbi vendimmarrjen gjyqësore. Në këtë kontekst, GjDBE-ja

vendosi që ajo nuk kishte kompetencë për të vendosur nëse vetë regjimi disiplinor për gjyqtarët që vendosnin në çështje të së drejtës së BE-së ishte në përputhje me të drejtën e BE-së. Meqenëse nuk u vu në diskutim që Dhoma Disiplinore kishte autoritetin për të vendosur në çështje disiplinore në lidhje me gjyqtarët e Gjykatës Supreme dhe të gjykatave të rregullta, çështje të së drejtës së BE-së sipas Direktivës 2000/78/EC, atëherë GjDBE-ja kishte autoritet për të marrë masat e përkohshme të kërkuara nga Komisioni. Prandaj, kërkesa për masa të përkohshme u gjykua se ishte e pranueshme.

GjDBE-ja shpjegoi që masat e përkohshme mund të urdhëroheshin në qoftë se konstatoheshin që marrja e këtyre masave ishte e justifikuar me fakte dhe me ligj, dhe që masat ishin urgjente, që do të thotë se ato ishin të nevojshme për të shmangur dëme serioze dhe të pariparueshme ndaj interesave të BE-së. GjDBE-së gjithashtu iu kërkuar të peshonte interesat e përfshira.

GjDBE-ja vendosi që masat e përkohshme do të ishin të justifikuara me fakte dhe me ligj në qoftë se të paktën njëri prej argumenteve në ligj mbi të cilat ishte bazuar kërkesi i padisë kryesore dukej, *prima facie*, se nuk ishte i pabazuar. GjDBE-ja parashtrroi se argumentet e kërkesit në ligj në padinë kryesore kishin lidhje me pyetjen nëse Dhoma Disiplinore ishte në pajtueshmëri me kriteret e pavarësisë dhe paanshmërisë sipas Nenit 19(1) të TBE-së. GjDBE-ja shënoi se ajo i kishte marrë në shqyrtim çështjet e pavarësisë dhe paanshmërisë nga Neni 19(1) i TBE-së në vendimet e saj të 19 nëntorit 2019. Në këto çështje, GjDBE-ja vendosi që regjimi disiplinor në Poloni e kishte bërë atë të dyshonte në pavarësinë e një organi si Këshilli Kombëtar i Gjyqësorit, e rrjedhimisht Këshilli Disiplinor të cilin ai mbikqyrte. Ndërkohë që GjDBE-ja ia la në dorë Gjykatës Supreme të Polonisë që të vendoste nëse ato dy organe ishin të pavarura dhe të paanshme, kjo ishte në pajtueshmëri me jurisprudencën e vendosur të GjDBE-së dhe nuk nënkuptonte që vendimet e vetë Gjykatës Supreme që organet nuk ishin të pavarura dhe të paanshme nuk ishin relevante në rastin konkret. Duke pasur parasysh këto fakte, GjDBE-ja vendosi që argumentet e Komisionit në ligj në padinë kryesore nuk ishin, *prima facie*, të pabazuara, dhe kështu që kërkesa për masa të përkohshme ishte e bazuar në fakte dhe në ligj.

Në lidhje me faktin nëse masat e përkohshme të kërkuara nga Komisioni ishin urgjente, GjDBE-ja parashtrroi se qëllimi i masave të përkohshme ishte të garantohej efektiviteti i plotë i çdo vendimi të ardhshëm nga GjDBE-ja duke parandaluar shkaktimin e dëmeve serioze dhe të pariparueshme ndaj palës kërkuese para atij vendimi përfundimtar. Në këtë rast, Komisioni kërkoi marrjen e masave të përkohshme për të parandaluar dëme serioze dhe të pariparueshme ndaj funksionimit të rendit ligjor të BE-së në Poloni. GjDBE-ja njohu që nuk ishte e nevojshme të vërtetohej se

një dëm i tillë do të ndodhte me siguri absolute, thjesht që një dëm i tillë ishte i parashikueshëm në një shkallë të mjaftueshme probabiliteti. GjDBE-ja vuri në dukje që çdo kompromis i pavarësisë së Gjykatës Supreme të Polonisë me gjasë do të shkaktonte dëme serioze ndaj rendit ligjor të BE-së në Poloni e në këtë mënyrë edhe ndaj të drejtave të qytetarëve të BE-së të cilat rrjedhin nga e drejta e BE-së dhe vlerat e saj, në mënyrë të veçantë sundimi i ligjit. Në këtë kontekst, vënia e Gjykatës Supreme nën mbikqyrjen e Këshillit Disiplinor, pavarësia e të cilit nuk mund të garantohej, kishte gjasa të shkaktonte dëme serioze dhe të pariparueshme ndaj rendit ligjor të BE-së në Poloni. Meqenëse Këshilli Disiplinor do të kishte nën mbikqyrje Gjykatën Supreme deri në vendimin përfundimtar të GjDBE-së, probabiliteti i dëmeve ndaj rendit ligjor të BE-së do të vazhdonte të qëndronte deri në atë moment. Prandaj, Gjykata vendosi që masat e përkohshme të kërkuara nga Komisioni ishin vërtet urgjente.

Duke peshuar interesat konkurruese të përfshira në zbatimin e masave të përkohshme, GjDBE-ja konsideroi që lejimi i masave të kërkuara nuk do të nënkuptonte domosdoshmërisht shpërbërjen e Dhomës Disiplinore, e as heqjen e mbështetjes së saj administrative dhe financiare, por do të kufizohej me pezullimin e përkohshëm të aktiviteteve të saj deri në shpalljen e vendimit përfundimtar. GjDBE-ja gjithashtu konsideroi që dëmi potencial i shkaktuar nga pezullimi i funksioneve të Dhomës Disiplinore ishte më i vogël se dëmi potencial i shkaktuar nga funksionimi normal i një organi mungesa e pavarësisë dhe paanshmërisë së të cilit nuk mund të përjashtohej *prima facie*. Prandaj, GjDBE-ja konsideroi që interesat konkurruese në këtë çështje peshonin drejt lejimit të masave të përkohshme.

Pasi konstatoi që masat e përkohshme të kërkuara nga Komisioni ishin të justifikuar në fakte dhe në ligj, urgjente, dhe që efektet pozitive të masave nuk ishin në rrezik nga interesat konkurruese në çështje, GjDBE-ja e pranoi kërkesën e Komisionit për masa të përkohshme.

*Meqenëse prokurorëve publikë në Holandë u mungonte pavarësia nga ekzekutivi, ata nuk mund të konsideroheshin autoritet gjyqësor sipas të drejtës së BE-së*

## **VENDIMI I GJYKATËS SË DREJTËSISË TË BASHKIMIT EVROPIAN NË ÇËSHTJEN AZ**

---

(Çështja Nr. C-510/19)

**24 nëntor 2020**

Në këtë çështje, Gjykata e Apelit në Bruksel, Belgjikë, bëri kërkesë në GjDBE, sipas Nenit 267 të TBE-së, për vendimmarrje paraprake. Shih hyrjen e këtij seksioni, lart, për një shpjegim më të hollësishëm të këtij procesi.

### **1. Faktet kryesore**

Më 26 shtator 2017, Gjykata e Shkallës së Parë në Leuven, Belgjikë, lëshoi një urdhërarrest evropian kundër AZ, shtetas belg. Urdhërarresti kërkonte dorëzimin e AZ në mënyrë që kundër tij të niste ndjekja penale për akuza të falsifikimit, mashtrimit dhe përdorimit të dokumenteve të rreme. AZ u arrestua në dhjetor 2017 në Holandë, dhe iu dorëzua autoriteteve belge në vijim të një urdhri të Gjykatës së Rrethit të Amsterdemit. Në janar 2018, një tjetër urdhërarrest evropian u lëshua kundër AZ nga gjykata në Leuven në lidhje me akuza të mëtejshme për falsifikim, mashtrim dhe përdorim të dokumenteve të rreme, të ndara nga akuzat që përmbante urdhërarresti i parë evropian. Në shkurt 2018 prokurori publik i Amsterdemit i dha leje gjykatës së Leuven që AZ të ndiqej penalisht për veprat e cekura në urdhërarrestin e dytë evropian.

Pas kësaj, AZ u ndoq penalisht dhe u shpall fajtor për kryerjen e veprave të renditura në të dy urdhërarrestet, si në të parin ashtu edhe në të dytin, dhe u dënua me tre vjet burgim. AZ apeloj kundër këtij dënimi, duke argumentuar se e drejta holandeze në lidhje me dorëzimin e një individi që ishte objekt i një urdhërarresti evropian nuk ishte në pajtueshmëri me kriteret e të drejtës së BE-së.

Sipas të drejtës së BE-së, në mënyrë të veçantë Neni 6(2) i Vendimit Kornizë 2002/584, autoriteti gjyqësor që ekzekuton një urdhërarrest evropian duhet të jetë kompetent sipas të drejtës vendase për t'i kryer këto veprime. Sipas Neneve 14 dhe 19(2) të të njëjtit vendim kornizë, në qoftë se një person i arrestuar nuk jep pëlqimin për dorëzimin e tij, ai ka të drejtën e një seance dëgjimore në lidhje me çështjen e tij para autoritetit gjyqësor ekzekutues sipas mënyrës se si parashikohet nga e drejta vendase e Shtetit Anëtar ekzekutues dhe sipas kushteve të dakorduara me marrëveshje reciproke mes Shteteve Anëtare lëshuese dhe ekzekutuese. Në fund, sipas Nenit 27 të

atij vendimi, thuhet që një person i dorëzuar në kuadër të një urdhërarresti evropian nuk mund të ndiqet penalisht ose të dënohet për vepra të kryera para dorëzimit të tij ose për vepra jo të përfshira në urdhërarrest në qoftë se autoriteti gjyqësor lëshues nuk ka kërkuar formalisht lejen e autoritetit gjyqësor ekzekutues dhe kjo leje është dhënë, ose në qoftë se të dy Shtetet Anëtare paraprakisht nuk e kanë informuar organin përkatës së BE-së që leja për këtë presupozohet të jetë dhënë dhe që asnjë kundërshtim ndaj këtij presupozimi nuk është deklaruar shprehimisht.

Sipas të drejtës nacionale holandeze në fuqi në atë kohë, e cila ishte futur për t'i dhënë efekt kritereve të Nenit 27 të Vendimit Kornizë 2002/584, dorëzimi i një të dyshuari tek një Shtet tjetër Anëtar i BE-së në kuadër të një urdhërarresti evropian ishte i lejuar vetëm me kusht që i dyshuari të mos ndiqej penalisht për vepra të kryera para dorëzimit të tij ose për vepra jo të përfshira në urdhërarrest, në qoftë se nuk ishte kërkuar dhe dhënë pëlqimi paraprak i *prokurorit publik* (autoriteti gjyqësor ekzekutues i caktuar në Holandë).

Në përgjigje të apelit të AZ, Gjykata e Apelit në Bruksel kërkoi një vendim paraprak nga GjDBE-ja. Në mënyrë të veçantë, Gjykata e Brukselit bëri një sërë pyetjesh në lidhje me zbatimin e Vendimit Kornizë 2002/584. Pyetja e parë ishte nëse termi 'autoritet gjyqësor' sipas Nenit 6(2) të vendimit kornizë përkatës përbënte një koncept autonom në kuadër të së drejtës së BE-së dhe, nëse po, cilat ishin kriteret për të përcaktuar se si kualifikohej autoriteti gjyqësor. Pyetja e dytë ishte nëse një urdhërarrest evropian i ekzekutuar nga një autoritet gjyqësor përbënte vendim gjyqësor. Pyetja e tretë ishte që, në qoftë se autoriteti gjyqësor ishte koncept autonom sipas të drejtës së BE-së dhe ekzekutimi i një urdhërarresti evropian ishte vendim gjyqësor, a ishte e lejueshme që një dorëzim fillestar në vijim të një urdhërarresti evropian të vlerësohej nga një autoritet gjyqësor, dhe që më pas një dorëzim suplementar të vlerësohej nga një autoritet i ndryshëm në rrethanat kur objekti i urdhërarrestit mund të mos e kishte të garantuar të drejtën e tij për qasje në gjykata. Pyetja e katërt ishte që, në qoftë se përgjigjja ndaj pyetjes së dytë ishte po, a duhej që një shërbim prokurorial publik që vepronte si autoritet gjyqësor ekzekutues të ofronte të drejtën e personit për qasje në gjykatë para se të jepej pëlqimi për ekzekutimin e një urdhërarresti që kishte lidhje me një vepër për të cilën nuk ishte kërkuar dorëzimi i personit. Pyetja e pestë dhe e fundit ishte nëse prokurori publik i Amsterdimit i cili e kishte dorëzuar AZ-në ishte autoriteti gjyqësor ekzekutues në këtë çështje, sipas Nenit 6(2) të Vendimit Kornizë 2002/584.

## 2. Vendimi i GjDBE-së

GjDBE-ja filloi duke marrë në shqyrtim pyetjen e parë të bërë nga gjykata referuese, pra nëse termi 'autoritet gjyqësor' sipas Nenit 6(2) të Vendimit Kornizë 2002/584

përbënte koncept autonom në kuadër të së drejtës së BE-së dhe, në qoftë se po, cilat ishin kriteret për të përcaktuar se si kualifikohej autoriteti gjyqësor.

Sipas Nenit 6(1) dhe (2) të vendimit kornizë përkatës, Shteteve Anëtare u kërkohet të caktonin autoritetin gjyqësor kompetent sipas të drejtës së tyre nacionale. Megjithatë, GjDBE-ja deklaroi që, ndërkohë që secili Shtet Anëtar mund të caktonte autoritetin gjyqësor, termi kishte një interpretim autonom dhe uniform, dhe prandaj koncepti i ‘autoritetit gjyqësor ekzekutues’ ishte koncept autonom i të drejtës së BE-së.

Më tej, GjDBE-ja vuri në pah kriteret për përcaktimin e kuptimit të ‘autoritetit gjyqësor ekzekutues’. Në praktikën gjyqësore të mëparshme, GjDBE-ja kishte deklaruar që koncepti i një ‘autoriteti gjyqësor’ në thelb përshkruante një autoritet i cili merr pjesë në administrimin e drejtësisë penale por i cili dallon prej atyre autoriteteve që janë pjesë e ekzekutivit, siç janë ministritë e qeverisë dhe shërbimet policore. Më tej, GjDBE-ja deklaroi se një ‘autoritet gjyqësor lëshues’ duhet të ishte në gjendje të ushtronte përgjegjësitë e veta në mënyrë objektive, pa pasur rrezik që vendimmarrja e tij t’u nënshtrohej drejtimeve apo udhëzimeve të jashtme, sidomos nga ekzekutivi. Çka është më e rëndësishme, nuk duhet të kishte dyshim që vendimi për lëshimin e urdhërarrestit evropian ishte vetëm në duart e autoritetit gjyqësor, jo në duart e ekzekutivit. Rrjedhimisht autoriteti lëshues duhet të ishte në pozicion të atillë që ta siguronte autoritetin gjyqësor ekzekutues që ai ishte i pavarur. Një siguri e tillë kërkonte praninë e rregullave statutore dhe një kornizë institucionale që garantonte se autoriteti gjyqësor lëshues nuk ishte i ekspozuar ndaj rrezikut të marrjes së udhëzimeve në asnjë rast prej ekzekutivit. Këto kritere zbatohen edhe kur autoriteti gjyqësor lëshues nuk është gjykatë. Çdo autoritet gjyqësor lëshues duhet të përmbushë plotësisht kriteret e mbrojtjes gjyqësore efektive. GjDBE-ja konfirmoi që statusi dhe karakteri i autoriteteve gjyqësore lëshuese dhe atyre ekzekutive ishin identike, përveç faktit që njëri e lëshon urdhërarrestin dhe tjetri e ekzekuton.

Më tej, GjDBE-ja shpjegoi që qëllimi i një urdhërarresti evropian ishte futja e një sistemi të dorëzimit mes autoriteteve gjyqësore që operonte pa ndërhyrjen e ekzekutivit. Vendimi Kornizë 2002/584 ishte i mbështetur mbi parimin që vendimet në lidhje me urdhërarrestet evropiane kishin garancitë e duhura. Prandaj ishte e qartë se si vendimi për të lëshuar ashtu edhe vendimi për të ekzekutuar një urdhërarrest duhet të ishin të shoqëruara nga të gjitha garancitë e ngërthyera në mbrojtjen gjyqësore efektive, përfshirë edhe pavarësinë dhe paanshmërinë. Pra e drejta e BE-së kërkonte që e tërë procedura e dorëzimit mes Shteteve Anëtare t’i nënshtrohej mbikqyrjes gjyqësore në çdo fazë. Kjo e përforconte interpretimin e GjDBE-së që

një autoritet gjyqësor duhet ta merrte vendimin për të lëshuar ose ekzekutuar një urdhërarrest në mënyrë të pavarur.

Procedura për lëshimin e një urdhërarresti evropian u përshkrua nga GjDBE-ja si e tillë që garantonte një nivel të dyfishtë mbrojtjeje për personin e përfshirë, si në lidhje me të drejtat e tij themelore ashtu edhe në lidhje me të drejtat e tij procedurale. Kjo do të thotë se një vendim që përmbush kriteret e ngërthyera në mbrojtjen gjyqësore efektive duhet të miratohet të paktën në njërin prej dy niveleve të asaj mbrojtjeje, dhe që enti që merr vendimin për lëshimin e urdhërarrestit evropian duhet të jetë në gjendje të veprojë në mënyrë objektive dhe të pavarur gjatë ushtrimit të përgjegjësive të veta, edhe kur urdhërarresti bazohet në një vendim nacional të marrë nga një gjyqtar apo gjykatë. Megjithatë, sipas Vendimit Kornizë 2002/584, ishte autoriteti gjyqësor ai që mbante përgjegjësinë për të siguruar që personi në fjalë gëzonte të gjitha të garantitë e duhura në lidhje me të drejtat e tij themelore dhe procedurale.

Prandaj, koncepti autonom i ‘autoritetit gjyqësor ekzekutues’ sipas nenit 6(2) të Vendimit Kornizë 2002/584 ishte ose gjyqtar ose gjykatë, ose një autoritet gjyqësor siç është shërbimi prokurorial publik kombëtar, i cili merrte pjesë në administrimin e drejtësisë në një Shtet Anëtar dhe gëzonte pavarësi nga ekzekutivi. Kur një organi të tillë i jepej kompetenca për të vepruar si autoritet gjyqësor ekzekutues nga e drejta nacionale, ai organ duhet të sigurohej që procedurat e tij për ushtrimin e përgjegjësive të ishin në pajtueshmëri me kriteret e ngërthyera në mbrojtjen gjyqësore efektive; përfshirë faktin që vendimet e tij do t’i nënshtroheshin një shqyrtimi gjyqësor efektiv.

GjDBE-ja vazhdoi me dhënien e përgjigjeve për pyetjen e dytë dhe të pestë së bashku, pra a përbënte prokurori publik në këtë çështje autoritet gjyqësor ekzekutues brenda kuptimit të Nenit 6(2) dhe Nenit 27 të Vendimit Kornizë 2002/584. Pasi përcaktoi kushtet në të cilat një autoritet gjyqësor mund të vendoste të dorëzonte një person që ishte objekt i një urdhërarresti evropian, GjDBE-ja shqyrtoi nëse një autoriteti gjyqësor i kërkohej gjithashtu të jepte pëlqimin për dorëzimin e personit që ishte objekti i urdhërarrestit evropian i cili do të ndiqej penalisht ose do të dënohej për vepra të kryera para dorëzimit të tij ose për vepra jo të përfshira në urdhërarrest, siç kërkohej nga Neni 27.

Një vendim për dhënien e pëlqimit sipas Nenit 27 u përshkrua nga GjDBE-ja si i ndryshëm prej një vendimi për të ekzekutuar një urdhërarrest evropian, sepse ai çonte drejt efekteve të ndryshme për personin e përfshirë. Ndërkohë që personi në fjalë mund t’i ishte dorëzuar tashmë Shtetit Anëtar lëshues të urdhërarrestit përpara se të kërkohej pëlqimi sipas Nenit 27, vendimi në lidhje me këtë pëlqim kishte ende mundësi të paragjykonte lirinë e atij personi sepse mund të çonte në dhënien e

një dënimi më të rëndë. Prandaj, GjDBE-ja arriti në përfundimin që organi që jep pëlqimin sipas Nenit 27 gjithashtu duhet të përmbushte kushtet e kërkuara për të qenë ‘autoritet gjyqësor ekzekutues’ brenda kuptimit autonom të atij koncepti të cekur më lart.

Në këtë rast, e drejta holandeze parashikonte që prokurori publik duhet t’i kërkonte gjykatës lokale të rrethit që të shqyrtonte urdhërarrestin evropian dhe të vendoste nëse ai duhet të ekzekutohej. Prandaj, ishte gjykata e rrethit ajo që përfundimisht mori vendimin për ekzekutimin e urdhërarrestit, jo prokurori publik. Megjithatë, vendimi vijues për të dhënë pëlqimin sipas Nenit 27 në lidhje me urdhërarrestin e dytë evropian ishte marrë ekskluzivisht nga prokurori publik. GjDBE-ja theksoi se, sipas të drejtës holandeze, ishte e mundur që prokurori publik të udhëzohej në raste të caktuara nga Ministria e Drejtësisë, prandaj të qenit ‘autoritet gjyqësor ekzekutues’ mund të mos ishte mjaftueshëm i pavarur nga ekzekutivi. Mundësia për zgjidhje gjyqësore në lidhje me vendimin e prokurorit publik nuk u konsiderua e mjaftueshme për të mohuar rrezikun që vendimmarrja e tyre mund të mos ishte e pavarur. Prandaj, duke pasur parasysh këtë mungesë pavarësie, Prokurori Publik i Amsterdami nuk mund të përbënte autoritet gjyqësor ekzekutues sipas dispozitave përkatëse të së drejtës së BE-së.

Duke pasur parasysh përgjigjet e dhëna më lart, GjDBE-ja vendosi që nuk ishte e nevojshme të merreshin në shqyrtim pyetjet e tjera që ishin referuar në adresë të saj. Meqenëse ky vendim paraprak ishte vetëm një pjesë e procedurave kryesore para gjykatës nacionale, GjDBE-ja vendosi që vendimi mbi kostot ishte çështje e asaj gjykate.



*Procedura për emërimin e anëtarëve të këshillit gjyqësor që janë përgjegjës për kryerjen e hetimeve dhe nisjen e procedurave disiplinore kundër gjyqtarëve nuk ishte në pajtueshmëri me të drejtën e BE-së kur ajo procedurë i dha shkas dyshimeve të arsyeshme që fuqitë dhe funksionet e këshillit mund të përdoshin për të ushtruar presion ose kontroll politik mbi aktivitetin e gjyqtarëve dhe prokurorëve*

## **VENDIMI I GJYKATËS SË DREJTËSISË SË BASHKIMIT EVROPIAN NË ÇËSHTJET E BASHKUARA TË ASOCIAËIA ‘FORUMUL JUDECĂTORILOR DIN ROMÂNIA’ V INSPECËIA JUDICIARĂ DHE PESË TË TJERËVE**

---

(Çështjet Nr. C-83/19, C-127/19, C-195/19, C-291/19, C-355/19 & C-397/19)

**18 maj 2021**

Në këtë çështje, GjDBE-ja mori një kërkesë nga disa gjykata rumune për vendimmarrje paraprak sipas Nenit 267 të TFBE-së (Traktati për Funksionimin e Bashkimit Evropian). Shih hyrjen e këtij seksioni lart për një shpjegim më të hollësishëm të këtij procesi.

### **1. Faktet kryesore**

Konteksti më i gjerë i çështjes në fjalë ishte një gamë e gjerë reformash që synonin luftimin e korrupsionit gjyqësor në Rumani. Të ashtuquajturat ‘Ligje të Drejtësisë’ ishin futur qysh në vitin 2004, rreth kohës së hyrjes së Rumanisë në Bashkimin Evropian. Ato kishin të bënin me rregullat në lidhje me gjyqtarët dhe prokurorët, organizimin e sistemit gjyqësor dhe Këshillim Suprem të Gjyqësorit. Një prej ndryshimeve të shumta ishte edhe ngritja e Inspektoratit Gjyqësor, një organ i ngarkuar me detyrën e hetimit të akuzave për shkelje të rregullave disiplinore nga magjistratët. Akuzat për korrupsion, nga ana tjetër, trajtoheshin nga Drejtorati Kombëtar Anti-Korrupsion (DNA). Mes vitit 2017 dhe 2019, Rumania bëri një sërë amendamentesh në Ligjet e Drejtësisë. Sipas njërit prej këtyre amendamenteve, u ngrit Seksioni për Hetimin e Veprave në Gjyqësor (SIJ), një divizion i Gjykatës së Lartë rumune të Kasacionit dhe Drejtësisë. Qëllimi kryesor i SIJ-it ishte hetimi i akuzave për krime të kryera nga gjyqtarët dhe prokurorët.

Procedurat në fjalë dolën prej gjashtë çështjeve në të cilat kërkuetit kontestuan pajtueshmërinë e atyre amendamenteve me dispozita të ndryshme të së drejtës së BE-së. Mes atyre gjashtë procedurave ndodheshin tri kërkesa kyçe. E para ishte Çështja C-83/19, e hapur nga Forumi i Gjyqtarëve Rumunë (RJF) kundër Inspektoratit Gjyqësor. Kërkueti u ankua që emërimi i nënshkruesit në mbrojtjen e Inspektoratit Gjyqësor, kryeinspektorit, ishte defektiv për shkak se mandati i tij në detyrë kishte përfunduar

në kohën kur u paraqit mbrojtja. Megjithëse ekzistonin ligjet, sipas Urdhëresës Qeveritare Nr. 77/2018, ku thuhej se një kryeinspektor të cilit i ka përfunduar mandati do të vepronte si zëvendës deri në plotësimin e postit, RJF argumentoi se kjo ishte jokushtetuese sepse dëmtonte rolin e Këshillit Suprem të Gjyqësorit si garantues i pavarësisë së gjyqësorit. Së dyti, Çështja C-127/19 u ngrit nga RJF dhe shoqata 'Lëvizja për Mbrojtjen e Statusit të Prokurorëve' kundër Këshillit Suprem të Gjyqësorit. Në këtë çështje, kërkuesit kontestuan dy vendime në lidhje me emërimin e prokurorëve në SIJ, duke argumentuar se ato shkelnin Nenin 148 të Kushtetutës së Rumanisë, sipas së cilës Rumania duhet të vepronte në përputhje me detyrimet e Traktateve të BE-së. Në fund, Çështja C-355/19 u ngrit nga RJF, Lëvizja për Mbrojtjen e Statusit të Prokurorëve dhe një individ kundër Prokurorit të Përgjithshëm të Rumanisë. Ky ishte kontestim i drejtpërdrejtë i një urdhri të Prokurorit të Përgjithshëm në lidhje me organizimin e SIJ-it, ku kërkuesit argumentuan që krikimi i SIJ-it ishte në papajtueshmëri me të drejtën e BE-së.

## 2. Vendimi i GjDBE-se

*Statusi ligjor i Vendimit 2006/928 dhe raportet e përpiluara nga Komisioni mbi bazën e atij vendimi*

Gjykata fillimisht vendosi që Vendimi dhe raportet e përpiluara sipas tij ishin akte të një institucioni të BE-së për qëllimet e Nenit 267. Si të tilla, ato ishin të hapura për interpretim me anë të mekanizmit të vendimmarrjes paraprake. Vendimi dhe direktivat e tij ishin gjithashtu detyruese në tërësi, dhe Rumania duhet t'i merrte ato në parasysh siç duhej kur të merreshin masa në fushat që mbulonin ato.

*Emërimet e përkohshme në pozitat menaxheriale të Inspektoratit Gjyqësor*

Gjykata përsëriti detyrën e Shteteve Anëtare për t'u siguruar që 'gjykatat ose tribunalet' e ndryshme që merreshin me çështje të së drejtës së BE-së duhet të përmbushin kriteret e mbrojtjes gjyqësore efektive. Kriteri qenësor ishte që gjykatat të ishin të pavarura, në mënyrë që të garantonin të drejtën për gjyq të drejtë dhe të siguronin që ato të drejta që janë të përbashkëta për të gjitha Shtetet Anëtare të BE-së, të përcaktuara nga Neni 2 i TFBE-së, të mund të mbroheshin. Mbrojtje të tilla mund të ekzistojnë vetëm kur respektohet parimi i ndarjes së pushteteve.

Aspekti themelor që rrezikohej ishte pavarësia e gjyqësorit dhe nevoja për të siguruar që ai të ishte i lirë nga ndikimet e papërshtatshme. Në kontekstin e rregullimit të gjyqësorit, kjo nënkuptonte garantimin e pavarësisë së gjyqtarëve nga kontrolli politik dhe ofrimin e një rregullatori vërtet të pavarur dhe të përdorshëm

ose një organi disiplinor që ishte vetë i pavarur nga kontrolli dhe presionet prej jashtë. Ndërkohë që vetë fakti që një qeveri kishte pushtetin për të emëruar anëtarët e atij organi disiplinor nuk përbënte provë të ndikimit të papërshtatshëm, rregullat e këtyre emërimeve duhet të dizajnohen në mënyrë të atillë që të mbrojnë parimet e cekura më lart. Gjykata gjeti që legjislacioni nacional në fjalë ishte në kundërshtim me të drejtën e BE-së sepse ai lejonte që Qeveria të bënte emërimin e përkohshëm në pozita menaxheriale të organit gjyqësor disiplinor pa ndjekur procedurën e duhur që parashikonte ligji vendas. Kjo i dha shkas dyshimeve të arsyeshme që fuqitë dhe funksionet e atij organi mund të përdreshin si instrument për ushtrimin e ndikimit, ose kontrollit politik, mbi aktivitetin e gjyqtarëve dhe prokurorëve.

*Krijimi i një njësie prokuroriale të veçantë për hetimin dhe ndjekjen e veprave të kryera nga gjyqtarët*

Gjykata më pas mori në shqyrtim nëse legjislacioni nacional për krijimin e një seksioni të specializuar të Prokurorisë Publike me kompetencën ekskluzive të hetimit të veprave gjyqësore ishte në pajtueshmëri me të drejtën e BE-së. Kriteret relevante ishin që legjislacioni nacional, së pari, duhet të ishte i justifikuar nga kërkesa objektive dhe të verifikueshme në lidhje me administrimin e shëndoshë të drejtësisë, dhe, së dyti, të garantonte që ai seksion nuk mund të përdorej si instrument i kontrollit politik, dhe që ai seksion të operonte në përputhje me Kartën e Të Drejtave Themelore të Bashkimit Evropian (“Karta”). Gjykata gjeti se u takonte gjykatave nacionale të vendosnin nëse këto kritere ishin përmbushur. Në mënyrë të veçantë, në lidhje me Kartën, gjykatat nacionale duhet të jenë të bindura që çështja e gjyqtarëve dhe prokurorëve ishte dëgjuar brenda një kohe të arsyeshme.

*Përgjegjësia financiare e Shtetit dhe përgjegjësia personale e gjyqtarëve në rast gabimi gjyqësor*

Më tej, Gjykata mori në shqyrtim nëse legjislacioni nacional në lidhje me përgjegjësinë financiare të Shtetit dhe përgjegjësinë personale të gjyqtarëve në lidhje me dëmin e shkaktuar nga gabimi gjyqësor mund të ishte në pajtueshmëri me të drejtën e BE-së. U gjet se ai mund të ishte në pajtueshmëri në raste të jashtëzakonshme kur një padi për dëmshpërblim përmbushte kritere objektive dhe të verifikueshme, dhe kur ekzistonin garanci për mbrojtje kundër presioneve të jashtme. Thjesht fakti i konstatimit të një gabimi gjyqësor nuk përbënte bazë të mjaftueshme mbi të cilën një gjyqtar të gjendej personalisht përgjegjës.

*Parimi i primatit të së drejtës së BE-së*

Gjykata përsëriti parimin e primatit të së drejtës së BE-së dhe kriterin që gjykatat nacionale të interpretojnë ligjin në përputhje me kërkesat e të drejtës së BE-së. Sa u përket ligjeve nacionale që pengojnë një gjykatë më të ulët nga e drejta për të mos zbatuar një dispozitë nacionale të angazhuar nga Vendimi që është në kundërshtim me të drejtën e BE-së, kjo kishte efektin e kundërshtimit të atij legjislacioni. Në praktikë, kur një gjykatë nacionale gjen që Traktati i BE-së ose Vendimi është shkelur, ajo gjykatë duhet të mos zbatonte dispozitën në fjalë, pavarësisht nga baza e saj ligjore.

#### *Kostot*

Duke qenë se kërkesat ishin pjesë e ndërmjetme e procedurave para gjykatave nacionale, Gjykata ua la çështjen e kostove atyre gjykatave vendase.



## Qendra AIRE

Qendra AIRE është organizatë jo-qeveritare e cila promovon zbatimin e te Drejtës Evropiane dhe ofron mbështetje për viktimat e shkeljes së të drejtave të njeriut. Një ekip i juristëve ndërkombëtarë ofron ekspertizë, dhe këshilla praktike në lidhje me standardet ligjore të Bashkimit Evropian dhe të Këshillit të Evropës dhe ka përvojë të posaçme në çështjet gjyqësore në Gjykatën Evropiane për të Drejtat e Njeriut në Strasburg, ku ka marrë pjesë në më shumë se 150 raste.

Gjatë këtyre 20 viteve, Qendra AIRE ka ndërtuar reputacionin e saj në vendet e Ballkanit Perëndimor, duke vepruar në të gjitha nivelet sistemit të drejtësisë në rajon. Ajo punon në bashkëpunim të ngushtë me ministrinë e drejtësisë, shkollat e trajnimit të gjyqtarëve dhe gjykatat e larta dhe kushtetuese për të drejtuar, ndihmuar, mbështetur dhe ndihmuar në drejtim të zhvillimit të shtetit ligjor dhe projekteve të reformave në terma afatgjatë. Gjithashtu, Qendra AIRE bashkëpunon me sektorin e organizatave jo-qeveritare në mbarë rajonin me qëllim mbështetjen e reformave në fushën e ligjit dhe të respektimit të të drejtave të njeriut. Puna e organizatës ka qenë gjithmonë e përqendruar në garantimin që secili mundet praktikisht dhe efektivisht të gëzojë të drejtat e tij. Në praktikë kjo do të thotë promovim dhe lehtësim në zbatimin e Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, duke ndihmuar në procesin e Integritimit Evropian përmes forcimit të shtetit të së drejtës dhe garantimit të njohjes së plotë të të drejtave të njeriut, dhe inkurajimit të bashkëpunimit mes gjyqtarëve dhe profesionistëve në fushën e së drejtës në mbarë rajonin.

## Civil Rights Defenders

Mbrojtësit e të Drejtave Civile është organizatë e të drejtave të njeriut e cila mbron të drejtat civile dhe politike dhe fuqizon mbrojtësit e të drejtave të njeriut që janë në rrezik. Ka mbi 30 vjet që mbështesim shoqërinë civile në vende të shtypura. Mënyra se si operojmë është unike dhe përfshin punën nga afër me aktivistë në terren, krijimin e kanaleve për komunikim dhe bashkëpunim ndërkombëtar, dhe ndërtimin e kapaciteteve të aktivistëve për të avokuar në mënyrë efektive për të drejtat e njeriut në shkallë kombëtare dhe ndërkombëtare. Gjatë dekadës së fundit kemi shkuar më tej, nga ofrimi i mbështetjes financiare për partnerët tek të qenit lojtarë për të drejtat e njeriut që i mbështesin partnerët duke kombinuar dialogun për strategji, mbështetjen financiare afatgjatë, mbështetjen në raste emergjencash, masat parandaluese të sigurisë, avokimin, rrjetëzimin, dhe ndërtimin e kapaciteteve me fokus tek shkathtësitë e të drejtave substanciale të njeriut. Ne



Përgatitja e këtij publikimi është mbështetur nga Qeveria e Mbretërisë së Bashkuar. Plikëpamjet e paraqitura në këtë publikim nuk reflektojnë domosdoshmërisht qëndrimin zyrtar të Qeverisë së Mbretërisë së Bashkuar.